

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

Buletini shkencor

Numër 3, Vëllimi 1, 2015
ISSN 2310-6719

BULETINI SHKENCOR
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë
Numër 3, Vëllimi 1, 2015
ISSN 2310-6719

Bordi Editorial

Redaktore e gjuhës angleze:

Ma. Erida Prifti

Redaktore letrare:

MSc. Etjona Hoxha

Person Kontakti:

Ma. Erida Prifti

Editore:

MSc. Roksana Nowak

MSc. Ina Çobani

Bordi Shkencor

Prof. Dr. Albert Qarri, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, Shqipëri (Kryetar)
Prof. David M. Kemme, University of Memphis, Tennessee, USA
Prof. Ronald W. Spahr, University of Memphis, Tennessee, USA
Prof. Dr. Dhori Kule, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
Prof. Dr. Jorgo Kaçani, Universiteti Politeknik i Tiranës, Shqipëri
PhD. Bill Croft, Sandhills Community College, North Carolina, USA
Prof. Dr. Llukan Puka, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
Prof. Dr. Shezai Rrokaj, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
Prof. Dr. Genci Burazeri, Universiteti i Mjekësisë, Shqipëri
Prof. Dr. Sulo Hadëri, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
Prof. Dr. Aurela Anastasi, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
PhD. Aleks Konomi, Seattle University, Washington, USA
Prof. Dr. Sherif Bundo, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
Prof. Dr. Bardhosh Gaçe, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, Shqipëri
Prof. Asoc. Kristofor Lapa, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, Shqipëri
Prof. Asoc. Mira Shehu, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, Shqipëri
Dr. Arjan Gjonça, the London School of Economics and Political Science, Londër, Angli
Prof. Dr. Fatmir Mema, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
Prof. Dr. Mynyr Koni, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
Prof. Dr. Pranvera Lazo, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
Prof. Dr. Kozeta Sevrani, Universiteti i Tiranës, Shqipëri

INFORMACION

Buletini Shkencor boton punime origjinale që sjellin njohuri të reja dhe të rëndësishme për avancimin e shkencës.

Ky organ botues është krijuar me idenë fillestare të promovimit të gjetjeve shkencore të akademikëve shqiptarë brenda dhe jashtë mjedisit universitar shqiptar. Rëndësia e botimit të buletinit disa herë në vit qëndron në dhënien e mundësisë për të gjithë kërkuesit akademik dhe jo vetëm të bëjnë të njohura gjetjet më të reja në fushat përkatëse të tyre si dhe në përditësimin në kohë të gjetjeve të mëparshme.

Dërgimi i dorëshkrimit nënkupton që punimi i paraqitur në të nuk është botuar më parë (përveçse në formën e një përmbledhjeje, leksioni apo tezave akademike), nuk është në shqyrtim për t'u botuar gjatë dhe se botimi është aprovuar nga të gjithë autorët, si dhe autoritetet përgjegjëse ku hulumtimi është kryer. Autorëve do t'ju kërkohet që të paraqesin, nëse ka ndonjë konflikt interesash, si dhe ndonjë burim financiar të veçantë të përdorur për kryerjen e kërkimit. Nëse dorëshkrimi pranohet për botim ai nuk mund të botohet në të njëjtën formë diku tjetër pa marrë më parë leje me shkrim nga Bordi i Buletinit Shkencor.

Plagjiatura nuk lejohet dhe do t'u raportohet si autorit, ashtu edhe autoriteteve përkatëse. Konkluzionet duhet të justifikohen nga skema eksperimentale dhe të dhënat e paraqitura. Informacioni duhet të jetë i detajuar në mënyre që të lejojë përsëritjen e punës nga shkencëtarë të tjerë të së njëjtës fushë. Autorët duhet t'i ruajnë të dhënat eksperimentale dhe t'ia paraqesin Këshillit Botues, nëse u kërkohen. Shkrimi duhet të jetë i qartë, i kuptueshëm, konçiz dhe korrekt nga ana gramatikore. Autorët mbajnë përgjegjësi për anën shkencore dhe formale të materialeve që paraqesin, si dhe për çdo korrespondencë me redaktorët.

Të interesuarit të paraqiten me arritjet më të reja nga fushat e angazhimeve të tyre profesionale – shkencore.

Artikujt duhet të jenë origjinale (të pakumtuara në ndonjë aktivitet tjetër), të pabotuara dhe jo në proces vlerësimi ose botimi (në ndonjë redaksi tjetër).

Autorët janë përgjegjës për redaktimin gjuhësor të tekstit të përmbledhjeve të tyre, qoftë në shqip, qoftë në anglisht.

Të gjithë autorët e interesuar për të botuar në Buletin Shkencor të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë mund të na kontaktojnë në adresën email: publikime.univlora@gmail.com

Përmbajtja

FAKTORËT E TREGTISË NDËRKOMBËTARE DHE MODELI I GRAVITETIT: RASTI I SHQIPËRISË
Visar Malaj (Dr), Soana Teka (Dr), Ahmet Mançellari (Prof. Dr.)

KOSTOT E TRANSAKSIONIT DHE EKONOMIKSI I RI INSTITUCIONAL
Florian Miti , Ilira Pulaj

A MANIFESTOJNË SJELLJE TË KONTROLLUARA NDAJ RISKUT, NË JETËN E TYRE TË PËRDITSHME,
QYTETARËT DHE FAMILJARËT NË VENDIN TONË?
Fjona Zeneli

EKSTRADIMI, SI NJË FORMË E VEÇANTË E BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR NË FUSHËN PENALE
Aleks Prifti

TRAFIKU I DROGES NE SHQIPERI
Ariana Llano

PËRGJEGJËSIA PENALE E PERSONAVE JURIDIKË NË SHQIPËRI
MSc. Ertit MEÇAJ

IMPACT OF CONSTITUTIONAL CHANGES 2008.
IS ALBANIA READY FOR A NEW CONSTITUTIONAL REFORM?
MND Oljana Hoxhaj

ZHVILLIMET E FUNDIT NË DISIPLINËN E QARKULLIMIT TË SHTETASVE TË VENDEVE TË TRETA NË
BE. RIKTHIMI I KONTROLLEVE NË KUFIJTË E BRENDSHËM
Ervis Moçka

DEMOKRACIA SI PRODUKT I ZHVILLIMIT TË SHOQËRISË
Dr. Ferit BAÇA

KONCEPTI I VEPRËS PENALE TË PASURIMIT TË PALIGJSHËM DHE MUNDËSITË E ZBATIMIT TË TIJ
NË LEGJISLACIONIN SHQIPTAR
Phd (cand). Fjorida BALLAURI (KALLÇO)

PËRBALLIMI I TË MITURVE NË KONFLIKT ME LIGJIN NË MJEDISIN E DETYRUAR (BURG)
Ardita Prendi

VOCATIONAL EDUCATION IN THE REPUBLIC OF ALBANIA
MSc: Belinda HALILAJ

VLERESIMI POTENCIALEVE NATYRORO-GJEOTURISTIKE: GJEOPARQET DHE GJEOMONUMENTET
GJEOLOGJIKE TE RAJONIT TE VLORES.
Msc. Ing. Ana QORRI, Prof.Dr. Çerçis DURMISHI, Dr. Shkelqim DAJA

DISA METODA EKSTRAKTIMI PËR PËRCAKTIMIN E DISA NDOTËSVE ORGANIKË NË MATRICA
MJEDISORE NDJEKUR NGA TEKNIKA GAZ KROMATOGRAFIKE
Anida Dukaj, Bilal Shkurtaj, Aurel Nuro

NUMRI I PËRGJITHSHËM I MIKROORGANIZMAVE TË STUDIUAR NË EPIDERMËN E GRURIT
Lorena Memushaj, Donika Prifti

VARIETETET DHE VAJRAT E ULLIRIT NË DISA VENDE TË MESDHEUT
Marinela Muço, Anila Kopali

DE RADA DHE VEPRA E TIJ “PARIMET E ESTETIKËS”
Prof. Dr. Bardhosh Gaçe

SHKRIMI UNIVERSITAR DHE ROLI I TIJ NE FORMIMIN E STUDENTEVE
Dafina Nazaj Ph.D student , Mcs.Suela Fakaj

VËZHGIM MBI DISA RASTE HUAZIMESH LEKSIKORE NGA GREQISHJA TË FJALORIT TEKNIK TË
SHQIPES
Eljana Mosko, Evanthia Baruta, Katerina Vasili

LEXICOGRAPHIC REFLECTION OF PHRASEOLOGICAL ASSET IN THE DICTIONARIES OF ALBANIAN
AND ENGLISH LANGUAGE
Evis Çelo (Ph.D)

MITOLOGJIA NË EPIKËN HISTORIKE TË LUFTËS SË VLORËS
MSc. Albert Habazaj

DUKURIA KUPTIMORE E SINONIMISË NË TERMINOLOGJINË E SË DREJTËS GJATË LUFTËS SË
DYTË BOTËRORE
Svjetllana Titini

SI NDIKOJNE PROFESIONET E NDRYSHME NE SHREHITE GJUHESORE (KRAHASIMI NDERMJET
GJUHES ANGLEZE DHE GJUHES SHQIPE)
MA Gerta SHAQE

KULTI I DETIT, ULLIRIT DHE I DIELLIT, SI KANË MBIJETUAR NË SHEKUJ NË BRIGJET E JONIT
PALASIKOT
Odise Çaçi

MËSUESI DHE ROLI I TIJ PARËSOR NË PROÇESIN E MËSIMDHËNIES
Phd.Candidate Eliona Naço

NDIKIMI I MJEDISIT LETRAR FAMILJAR NË ZHVILLIMIN GJUHËSOR NË MOSHËN PARASHKOLLORE
Drnt. Stela Dhima

PINOKU I SJELLË NË GJUHËN SHQIPE. MODALITETE TË NDRYSHME PËRSHTATJEJE

Manjola Sulaj

NJOHJA E KUPTIMIT TË FJALËS DHE LEKSIKU

Dr. Kozeta Hyso

DUKURITË GJUHËSORE PËRMES TEKSTIT LETRAR

Greta Jani

VORBULLA E PASHMANGSHME “GOOGLE TRANSLATE”

Dr. ILDA KANANI

EFFECTS OF SOCIAL MEDIA IN PROCESS ACADEMIC OF ADOLESCENTS

Irma LEKA (PEZA)

EFEKTI SOCIAL I EDUKIMIT GJINOR

Dr.Elvira DODE

FAKTORËT QË NDIKOJNË NË KOHËZGJATJEN E USHQYERJES EKSKLUZIVE ME GJI

Emirjona Kiçaj, Rudina Çerçizaj, Ela Peto, Emiljana Coraj

NURSE AND ERRORS THAT OCCURRED DURING THE ADMINISTRATION OF PHARMACEUTICALS

Rudina Cercizaj

ARE ROUTINE PREOPERATIVE MEDICAL TESTS NEEDED WITH CATARACT SURGERY?

Arjeta Grezda, Ermal Simaku, Mirela Hoxha

STUDIM KRAHASUES MBI GJENERATAT CELULARE 1G-5G, AVANTAZHET E RRJETIT 5G.

Msc.Ing.Eriselda MALAJ

REMINISHENCA MITOLOGJIKE NË EPIKËN HISTORIKE TË LUFTËS SË VLORËS

MSc. ALBERT HABAZAJ

Biblioteka Qendrore "Nermin Vlora Falaschi",
Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë, ALBANIA
albert_abazi_tr@yahoo.com
bertbiblioteka@gmail.com

Abstrakt

Qëllimi i këtij punimi është që, nëpërmjet një vështrimi etnofolklorik, të prezantojmë reminishencën mitologjike, ardhur si mbjetojë e shtresës mitologjike me ngjyrimet natyrale, që zbukurojnë ciklin e këngëve të Epikës historike të luftës së Vlorës (EHLV). Metodologjia e punimit është gërshetimi i trajtesës përshkruese me atë analitike, duke operuar në rrafshin folklorik me një prerje mitologjike për Epopenë termopiliane të Njëzetës. Jemi mbështetur në studimin e botimeve të nivelit akademik me literaturë nga Folklori dhe Mitologjia, duke shfrytëzuar fondet e Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe të Studimeve të Artit, Tiranë, për këtë ngjarje të rëndësishme të historisë së Shqipërisë. Njohja e arealit gjeografik dhe folklorik, ku u zhvillua kjo ngjarje, përvoja vetiake gati 40 vjeçare me kërkime, vëzhgime, mbledhje, studime, krahasime, klasifikime e përshkrime konkrete të lëndës folklorike, me musht artistik nga qeniet mitike e kultet e natyrës, si dhe ekspeditat në terren, na kanë ndihmuar të ndikojmë sapopak në pasurimin e folklorit shqiptar dhe etnokulturës shqiptare, për sa i përket luftës së Vlorës. Puna në terren dhe konsultimi me literaturën e shkruar për këtë ngjarje dhe për personazhet që e realizuan, na ka mundësuar të prezantojmë, ndoshta për herë të parë, se sa njësi folklorike me profil mitologjik bëjnë jetë aktive në hapësirat e caktuara në kohën e sotme, arsyet e këtyre mbijetojave dhe disa përfundime.

Fjalë çelës: mbijetoja të figurave mitologjike, folklor, histori, lufta e Vlorës.

Abstract

The purpose of this paper is to present the mythological mantle with mythological coloring which enhance the songs cycle of Historical Epic of Vlora War (HEVW) through an ethno-folkloric overview. The methodology of the work is the interweaving of narrative with analytical treatment, operating in the folkloric field with a mythological incision about thermopylae Epic of 1920s. We are based on the publications studies at academic level from folklore and mythology literature, using funds of the Cultural Anthropology and Art Studies Institute in Tirana for this important event in the history of Albania. Perception of geographic and folkloric realm, where this event took place, personal experience of nearly 40 years with research, surveys, meetings, studies, comparisons, real classifications and descriptions of folkloric case, with artistic cider from mythical cults and beings of the nature as well as the field expeditions have helped us to influence somehow in the enrichment of Albanian Folklore and Ethnoculture, regarding the Vlora War. The fieldwork and written literature reference about this event and characters who accomplished, have enabled us to present, probably for the first time, how many folkloric elements of mythological profile actively live in certain spaces at present, reasons of these survivals and some conclusions.

Key - words: mythological reminiscence, folklore, history, War of Vlora.

1. Hyrje

Kur flasim për mitologji e besime popullore, kemi parasysh çfarë ka mbetur nga ato ç'ka mendohej e besohej në kohët parake dhe çfarë e si ka ardhur në kohët e sotme: e pandryshuar, e ndryshuar, e mitizuar, e ç'mitizuar, sakrale apo e desakralizuar. Në këtë punim do të trajtojmë reminishencën e qenieve mitike në ciklin epik të këngëve për Epopenë e Vlorës, cili është dallimi midis mitologjisë (në rastin e këtij artikulli, i mbijetojave mitologjike, që vijnë natyrshëm si jehonë rikujtimi) dhe folklorit në tërësi, midis qenieve mitike dhe epikës historike të Luftës së Vlorës që, me shkurtim emërtime, e quajmë EHLV, cili është raporti midis këtyre disiplinave dhe nëndisiplinave shkencore, etj. Kur filloi besimi? Si ndjenjë sigurie, si bindje e fortë, besimi filloi kur njeriu u nda nga bota shtazore. Po ç'është besimi? Po miti? Besimi është bindje se ekziston e mbinatyrshmja, ndërsa miti është një rrëfim, një tregim që flet për: 1. të mbinatyrshmen, 2. ka bindjen se është kështu, 3. besimi. Miti besohet nga ata që e bëjnë, se do të ndodhë ashtu siç dëshiron. Miti ka brenda si përbërës anën tregimtare, rituale dhe besimin. Sot janë zbehur aq shumë, saqë duhen lente të fuqishme etnokulturore për t'i vërejtur dhe për t'i studiuar. Shoqëria parake kishte totemizmin si formë të lashtë besimi religjioz, si trajtë feje, sepse në

rendin fisnor mendohej prejardhja nga një i parë që mund të ishte një dru, shkëmb, yll, kafshë prej nga ka ardhur ky apo ai fis dhe adhurohej e shenjtërohej, sepse quhej themelues a mbrojtës i fisit. *“Pa mitin - thotë Niçe - çdo kulturë e humbet karakterin e saj të gjallë krijues, humbet forcën e vet të natyrshme”*¹.

Besimet popullore dhe krijimet folklorike kanë lidhje të ndërsjellta gjenetike dhe historike. Ato janë krijimtari kolektive, qarkulojnë gojë më gojë dhe kanë karakter sinkretik, por nuk mund të njësohen, sepse janë shtresa me përmbajtje dhe funksione të ndryshme në etnokulturën shqiptare. Sipas profesor Uçi, *“figurat folklorike të përbindëshave nuk na duken me vend të quhen figura demonologjike”*². Në demonologji, dragoi, kuçedra etj., janë përbindësia, egërsira tmerruese e shkatërruese, ndërsa në folklor, lënda mitike profanizohet, ritrajtohet e shfrytëzohet për funksione artistike, etiko - morale, në përshtatje me parimet specifike që ka. Me përshkrimin metaforik dhe alegorik e himnizon hijeshinë dhe bukurinë e njeriut të dalluar nga të tjerët, sipas parimit të zbukurimit, e lartëson, e himnizon trimin, heroin. Miti është dukuri etnologjike; kur përfshihet në folklor kthehet në estetikë. Lënda me burim mitologjik modifikohet, shndërrohet, përpunohej sipas ligjësorive të përvetësimit estetik. Çmitizimi i motiveve dhe i figurave me origjinë mitologjike, gjatë përfshirjes së elementëve mitikë në folklor, i jep një konceptim të ri, duke marrë një kuptim dhe funksion tjetër, atë estetik, duke e bërë një mjet të fuqishëm për edukimin shoqëror të njeriut në grup, në kolektiv.

2. Një vështrim i përgjithshëm mbi mitologjinë dhe mitet

Trajtimi i qenieve mitike dhe metamorfizimi i tyre në funksion të EHLV na kërkon të bëjmë një udhëtim përmes kohëve me trenin e literaturës shkencore, kapur nga studimet e dijetarëve të ndryshëm: gjuhëtarë, historianë, etnologë, folkloristë, antropologë, sociopsikologë, paleontologë. Meqenëse folkloristika ka marrëdhënie e raporte të caktuara me mitologjinë shqiptare dhe rajonale, gjykojmë të trajtojmë lakonikisht disa të dhëna për mitologjinë përgjatë rrjedhave të kohës, në hapësirën ku banojmë ne dhe ku kanë banuar të parët tanë, si dhe në hapësirën afër nesh, ku banojnë fqinjët tanë dhe ku kanë banuar të parët e tyre. Në thelb, mitologjia është studimi i miteve që mbeten themelore për vetëdijen njerëzore. Me mitologji kuptohet *“tërësia e miteve të një populli; pasqyrimi fantastik i botës në ndërgjegjen e njerëzve në periudhat më të hershme të jetës së popujve si përpyetje e parë për të shpjeguar dukuritë e*

¹) Nietzsche, Friedrich: *“Lindja e tragjedisë”*, Tiranë, Eugen, 2008, f. 183.

²) Uçi, Alfred: *“Mitologjia. Folkori. Letërsia”*, Tiranë, “Naim Frashëri”, 1982, f. 197.

*pakuptueshme të natyrës e të shoqërisë dhe si një nga elementët e çdo feje*³. Botimi më i ri i Fjalorit të Gjuhës Shqipe shpjegon: “Miti është rrëfenjë a tregim për qenie të mbinatyrshe ose për ngjarje të çuditshme; legjendë; fig. njeri, ngjarje ose diçka tjetër që mbivlerësohet me qëllim, duke e veshur me një petk përrallor”⁴. Njihet mitologjia shqiptare, ilire, ajo parailire, si dhe mitologjia greke, romake, kelte, spanjolle, apo miti pellazgjik, etj. Këndvështrimi i studiuesit, mitin pellazgjik e trajton si mit romantik jo si mit shkencor. Mitologjia klasike ka të bëjë me mitet e Greqisë dhe Romës së lashtë. Mitologjia është tërësia e miteve, është doktrinë, teori shkencore ose filozofike, si tërësi e parimeve teorike që shpjegon a që përlligj qenien e miteve. E përdorim shpesh fjalën “mit”, por jo pak herë kuptimi i termit interpretohet jo ashtu si duhet. Fjala “mit” e ka burimin nga greqishtja “mithos” e nga latinishtja “mithus”, që do të thotë “tregim”, “fabul”, “rrëfenjë”, “përrallë”, “legjendë”. Miti, sipas mitologut M. Tirta, “*në kuptimin e shkencës së etnologjisë, është tregim a rrëfenjë me origjinë popullore, që paraqet lidhje të së natyrshmes me të mbinatyrshten, në natyrë e në shoqëri*”⁵. Nga bashkimi i fjalëve të greqishtes “mythos” (rrëfim, gojëdhënë ose ligjërim: shën. im - AH) dhe “logos” (doktrinë) është formuar edhe fjala mitologji, e cila, sipas Prof. Uçit, përdoret në disa kuptime: “*a) si shkenca ose teoria që studion mitet; b) si tërësia e miteve të një populli; c) si krijimtari specifike shpirtërore krijuese, që përpunon mite*”⁶. Pra, miti është rrëfenjë tradicionale për të kaluarën, që rrjedh si tregim i shkurtër për një ndodhi të vërtetë ose të trilluar, zakonisht me shtjellim të thjeshtë, që shpesh herë përmban elemente fetare ose fantastike. Miti është një lloj i veçantë i krijimtarisë gojore popullore, rrëfenjë për një qenie të mbinatyrshe, përheronj legjendarë, për ngjarje e dukuri të çuditshme, ku pasqyrohen parafytyrimet primitive(parake) të njerëzve për prejardhjen e botës mbi tokë, përnatyrën dhe shoqërinë; rrëfenjë e trilluar për diçka që nuk ka qenë e nuk është vërtetë, përrallë, legjendë. Mitet e grekëvetë vjetër. Miti i Anteut. Miti i Prometeut. Miti i amazonave. Miti i Diellit. Miti i zjarrit. Miti i Krishtit. Miti i ringjalljes së hyjnive. Miti i parajsës (i ferrit). Mitet e fesë. Antropologët janë përpjekur të dallojnë mitin nga historia, por është e qartë se historia mund të kryejë po ato funksione si edhe miti dhe të dy llojet e rrëfimit për të kaluarën mund të përzihen njeri me tjetrin. Etnologu anglez James George Frazer (Frejzën) i konsideron mitet si formë e mendimit të

³) “*Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe*”: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1980, f. 1151.

⁴) “*Fjalor i Gjuhës Shqipe*”: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2006, f. 635.

⁵) Tirta, Mark: “*Etnologjia e Shqiptarëve*”, Tiranë, Geer, 2003, f. 397.

⁶) Uçi, Alfred: “*Mitologjia. Folkori. Letërsia*”, Tiranë, “Naim Frashëri”, 1982, f. 13.

hershëm fetar ose shkencor. Antropologu Bronislaw Malinoëski e kundërshon, duke i parë mitet si një përlligje të rendit shoqëror. Historiani i fesë, rumuno-amerikani Mircea Eliade e shihetë mitin “si dukuri fetare, orvajtje të njeriut për t’u rikthyer në aktin fillestar të krijimit. Strukturalisti mitolog dhe antropologu i njohur Claude Lévi - Strauss ka argumentuar se nuk është brendia por struktura e mitit ajo që është e rëndësishme, me që ajo [struktura mitike, shën. im, AH] zbulon proceset universal mendore”⁷. Me qeniet mitike, për të cilat është besuar ndër shekuj se kanë patur attribute të mbinatyrshme (të dobishme apo të dëmshme, pozitive apo negative, të mira apo të liga) është marrë mitologjia dhe demologjia, ku, pas autorëve të lashtësisë, Herodotit, Platonit, Ciceronit, Strabonit e Plutarkut, spikasin studiues të njohur, si Johann Georg von Hahn, Émile Durkheim, Edith Durham, Holger Pedersen, Franz Baron von Nopca, Maksimilian Lambreci, Alexander Haggerty Krappe, Aleksandar Stipçeviq, etj. Studiuesit e huaj kanë eksploruar etnokulturën tonë dhe na kanë lënë studime albanologjike serioze. Gjithsesi, na duhet të pohojmë se, disa prej tyre e kanë njejtësuar mitologjinë shqiptare thjesht me besimet fetare, pa përfillur sa duhet fondin mitologjik të folklorit dhe aspekte estetike të këtij fondi. Janë pikërisht studiuesit shqiptarë, që i kanë trajtuar me dinjitet shkencor dhe ndershmëri profesionale, në vështrim krahasimtar. Literatura mitologjike pasurohet me autorët e njohur shqiptarë si Sh. Gjeçovi, A. Xhuvani, E. Çabej, Sh. Demiraj, Rr. Zojzi, A. Kostallari, M. Tirta, M. Korkuti, M. Krasniqi, Q. Haxhihasani, Z. Sako, Gj. Komnino, etj. Fusha e mitologjisë ka qenë objekt studimor edhe për mjaft studiues të tjerë shqiptarë si I. Elezi, A. Uçi, Sh. Sinani, A. Xhagolli, B. Gaçe, Rr. Berisha, S. Fetiu, U. Xhemaj, M. Mustafa, M. Zeqo, K. Kasmi, B. Palaj, A. Gjergji, A. Onuzi, M. Dibra, Gj. Zheji, Todi Dhama, M. Begolli, A. Bido, B. Palaj, A. Belluschi, F. Altimari, N. Draga, A. Çetta, F. Gjabri, Z. Dukagjini, N. Bardhoshi etj. Mitologjia e mirëfilltë, sipas Prof. Tirtës, “përbën një gjymtyrë të rëndësishme të kompleksit kulturor etnik të Shqiptarëve; përshkon të gjithë damarët e kësaj etnokulture sikundër gjaku organizmin e njeriut”⁸

Areali i figurave mitike, i legjendave mitike, i demonëve, kulti i gjarprit (me gjarprin në folklor) nuk është vetëm hapësira shqiptare; ato qarkullojnë në arealin ballkanik, ndër popujt mesdhetarë, indoeuropianë, euroaziatikë e më tej dhe burimi i tyre, si duket, është kroi pagan me tisin e tij mistik. Mitet, si rrëfenja, si histori të vjetra, janë përfytyrime të mbinatyrshme edhe për ngjarje a persona, për njerëz realë, që bëmat e tyre i shndërrojnë në personazhe dhe

⁷) “Enciklopedia e Përgjithshme e Oksfordit”: Tiranë, Instituti i Dialogut dhe Komunikimit, 2006, f. 838.

⁸) Tirta, Mark: “Mitologjia ndër shqiptarë”, Tiranë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore, Dega e Etnologjisë, 2004, f. 15.

folklori i legjendarizon. Kur flasim për fondin mitologjik të folklorit shqiptar në EHLV, edhe pse numerikisht i vogël është i mjaftueshëm për të dalluar ngarkesën mitologjike në ato njësi folklorike që kemi regjistruar e klasifikuar. Edhe pse EHLV duket që është çliruar nga përfytyrimet mitologjike, edhe pse lënda mitologjike ka pësuar transformime e forca emocionale është e ndezur si bulëzim nga Eposi i Kreshnikëve, nga kënga “Fuqia e Mujit” dhe “Gjergj Elez Alia”, EHLV është aq e plotë me informacion, saqë feshitizimi mitologjik i luftës dhe i heronjve nuk ia dëmton fizionominë, por hijeshon thelbin estetik të këngës historike të Luftës së Vlorës. Nuk është parësor petku legjendar që u vesh kënga, por bëmat e tyre heroike, historia e tyre e merituar për këngë dhe legjenda. Në se në epikën legjendare kënga ka shtresë mitologjike, në epikën historike kjo shtresë vjen duke u tkurrur, deri sa në EHLV, nga kjo shtresë pikojnë thërime diellore, ku e bukura operon ndritshëm si kategori estetike. Vatra e kujtesës mitologjike në EHLV nuk është e ndezur, e zjarrtë, nuk flakëron, por as e shuar nuk është. Vera e vitit 2015 përkon me 95 vjetorin e kësaj ngjarjeje të madhe për kombin e për kohën dhe Lufta e Vlorës është histori e dhimbshme, por që i përket të kaluarës. Po afron një shekull dhe gjurmimet, gjetjet, studimet e botimet e nivelit akademik janë tregues që kjo vatër s’është fikur. Figurat e dragoit, të ezhderhasë (kuçedrës, me kuptim pozitiv: shën. im - AH), të gjarprit (astritit me pika), të drërit, etj., futen në këngë si elementë me karakter të drejtpërdrejtë mitologjik. Fakti që gjenden ende mbijetoja gati 100 vjeçare, tregon se këngë të tilla janë transmentuar e bartur gojë më gojë, qarkullojnë dhe pëlqehen, pra që ka edhe në kohën e sotme, sidomos në hapësirat e Labërisë njerëz e komunitete që i kanë për zemër dhe jo vetëm pleq. Qeniet mitike të desakralizuara në opusin sinkretik të këngës epike i qëndrojnë historisë së Luftës së Vlorës si dekorim, i rrinë si kostum folklorik, bukur dhe hijshëm. Mitologjia me besimet, e marrë në një kuptim të veçantë etnokulturor, ka formuar një nëndisiplinë të kërkimeve shkencore, që quhet etnologji religjioze. Etnologjia religjioze ose etnologjia e fesë, e besimeve operon meeksplorime në terren, në thesaret folklorike, në arkiva, në literaturën e shkruar, në monumentet historikë e arkeologjikë, në figura, në simbole besimi me origjinë parake, etj.

3. Lufta e Vlorës me syrin e mitologut dhe të folkloristit

Një nga parimet specifike, që e përveçojnë folklorin, si një lloj i veçantë artistik, është parimi i zbulimit. Për të realizuar këtë funksion, edhe epika historike e shqiptarëve, si një nënndarje e folklorit shqiptar e gjen pa vështirësi burimin e frymëzimit në gurrën popullore, që e ka zanafillën tek mitologjia e të parëve tanë. Me qenë se Lufta e Vlorës është një realitet historik, një ngjarje historike që ka ndodhur në një hapësirë konkrete, në një kohë të caktuar, nga

persona e bashkësi njerëzore përkatëse, me logjistikën, veshjen, ushqimin, me armatimin e mundshëm të kohës së zhvillimit, edhe këngaapo cikli i këngëve që i kushtohet kësaj ngjarjeje quhet Epika Historike e Luftës së Vlorës (EHLV), që operon mendërgjegjen poetike historike dhe është pasqyrim artistik i realitetit historik të ndodhur në Vlorë e në krahinat e saj gjatë verës së vitit 1920. Shpesh herë, cikli i këngëve për LV, të japin përshtypjen sikur janë fotografim i realitetit në vargje, autobiografia e kësaj epeopeje, që kalon gojë më gojë nga luftëtarët këngëtarë, nga banorët e bashkëkohësit, që qarkullon hapësirash dhe brezash. Kështu kënga historike na shfaq pamjen e saj realiste, e cila realizohet nga interpretuesit e bartësit, që bëjnë pasqyriomin e atypëratyshëm të ngjarjes së madhe dhe qarkullimit të nënngjarjeve reale të Vlorës së Njëzetës. Epikën Historike të Njëzetës, të cilën prof. Xhagolli e klasifikon në *“këngë të periudhës së shtetit të pavarur shqiptar”*⁹, do ta quanim stërmbesë të epikës legjendare, që ka trashëguar nga Mëmëzonia dhe ka ruajtur në një sepete filigrani të kujtesës sociale mbijetojat fantastike me mjete si personifikimi dhe hiperbolizimi i personave, që, nëpërmjet metamorfizimit, realizonin aktet heroike e bëmat e padëgjua më parë. Edhe nga kushërirat më të mëdha, nga familja e epikës historike, EHLV ka marrë të gatshme formula klishe të tipit *“Kishin pjellë ato nëna,/ kishin pjellë e bërë drëra”*. Në frymëzimet e reja të kësaj periudhe, vazhdojnë të përdoren elemente të traditës folklorike, si epitetet me karakter mitologjik: dragua, ezhdërha, gjarpër, shejtan etj., të cilat folkloristi i njohur Q. Haxhihasani i klasifikon *“me zanafillë nga mendimi poetik primitive”*¹⁰ i të parëve tanë në këto troje, sepse pranohen, pëlqehen, praktikohen e përhapen në komunitete lokale, ku ngjarja paraqet edhe interes shpirtëror. Me ciklin e këngëve të Njëzetës në fokus, nuk mund të bëhet fjalë për prurje masive nga mitologjia, as dhe për fragmente mitologjike, por kemi mundur të sigurojmë disa pikatore mitologjike shumë të çmueshme, të cilat e zbukurojnë dhe e hijeshojnë ciklin e këngëve të LV, sepse, përmes kategorisë estetike të së madhërishtes, i japin, në një trajtë tjetër, monumentalitetin karakteristik që gëzon eposi shqiptar i kreshnikëve, i ngarkuar mirë me shtresimet mitologjike. Trimat e Njëzetës kënga na i sjell si heronj mitikë, se ashtu i ndjen, i mendon, i nderon emocionalisht për aktin që kryen më sakrifikueshëm se të tjerët, kurse historia i ka personazhe realë, e i paraqet ashtu siç kanë qenë e ç’kandodhur me ta, na njih me njerëz konkretë dhe i përshkuan me vërtetësi e koherencë, pa zbukurime.

Nga studimi i literaturës mitologjike, mund të shprehemi në trajtë lakonike për disa nga figurat mitike, të cilat paraqesin interes për EHLV, nga që

⁹) Xhagolli, Agron: *“Etnologjia dhe Folklori Shqiptar”*, Vlorë, Triptik, 2007, f. 247.

¹⁰ *“Epika Historike”*, 3: Tiranë, Akademia e Shkencave e RPSSH, 1990, f. 25.

krijuesi anomim apo këngëtar i luftëtar i kësaj ngjarjeje historike me rëndësi kombëtare, pikërisht ato e aq sa ka dashur ka marrë nga shporta mitologjike dhe u ka veshur kostum folkorik heronjve të tij, shokëve të tij më të mirë që ka njohur dhe që janë shquar për bëma jehonëmëdha: **Dragoi**, në rrafshin mitologjik, është figurë e besimeve popullore, e përrallave popullore shqiptare, e tregimeve të moçme shqiptare, që përfytyrohej si një njeri shumë i fuqishëm, i cili luftonte me kuçedrën deri sa e vriste. Pra, dragoi ishte figurë mitologjike, që mendohej se mund të lindte si fëmija nga ndonjë grua, por ishte djalë me krahë dhe zhvillim të shpejtë. E ëma e mbante sekret, se, po ta tregonte, ai do të vdiste menjëherë. Ai i shfaqej në ëndërr gruas, një natë para se të lindte. Dragoi fluturonte natën, shkonte luftonte me lubinë apo e kuçedrën, besohej se dragoi e vriste kuçedrën. Në rrafshin figurativ (folkorik) dragoi simbolizon një trim të rrallë, që nuk e ka shokun. Kemi dëgjuar kur thonë e këndojnë: *“Dragonjtë e Skënderbeut”, “Trimat e Njëzetës luftan si dragonj”, “Përpara shokëve shkoi/ Selam Musai dragoi”, etj. Ezhdërhaja*, në aspektin mitologjik, është figurë e besimeve popullore që përfytyrohej si kuçedër; bollësharde, që zoologjikisht është një gjarpër i madh rreth dy metra e gjysmë, me lëkurë të trashë, të përhime e lara- lara, që i ngjan bollës, ndërsa mitologjikisht, si qenie që përfytyrohet në përrallat popullore si një gjarpër i madh me shumë koka. Sipas studiuesit B. Hysenaj, *“ka predominuar mendimi se, prejardhja e ezhdërhave me fuqi të mbinatyrshme mund të ishte diçka që nuk ishte parë nga njeriu. Më të mundshmit për tu bërë ezhdërha ishin gjarpërinjtë. Kur ktheheshin në ezhdërha, merrnin përmasa gjigande dhe ishin në gjendje të shkatërronin çdo gjë. Ezhdërhatë kishin armikun e vet, i cili ishte një zog i vogël cicërues, që nuk i shpëtonte asgjë pa parë. Ai u priste rrugën kafshëve që kërkonin të bëheshin ezhdërha. Kur ezhdërhaja shikonte cicërimat, lajmëronte një forcë të madhe e mbinatyrshme dhe aty ku ishte ezhdërhaja fillonte goditja e rrufeve, lëshoheshin zinxhirët nga qielli që mbërthenin trupat e vvarë të ezhdërhave, duke i ngritur lart në qiell. Njerëzit e fortë në punë ose në luftë barazoheshin me një nga figurat mitologjike si ezhdërhaja. Ezhdërhaja është e urtë, ashtu si edhe melaqetë, saqë nuk i afrohen dot as xhindet. Rapsodi në vargjet për Luftën e Vlorës 1920 përmend disa figura mitologjike: “Doli xhenerali, tha:/ -nga m’u futën në kala/ me pushk’ e flamur në dorë/ si dragonj, si ezhdërha”¹¹. Figurativisht, me ezhdërha kuptojmë një njeri me trup shumë të madh e të fortë; trim i madh, dragua. Ja dy vargje kënge: *“Bëjnë hyxhym përmbi ta/ u derdhnë si eshdërha”*. **Lubia** përfytyrohej si një gjarpër keqbërës shumë i madh, me bisht të gjatë, me disa krerë dhe i pangopshëm, i ngjashëm me kuçedrën. Në krahinën e Labërisë mendohej si një qenie gjigande, në formë bualli me shtatë kokë, ose gjarpër gjigand. Gojëdhënat, përrallat dhe legjendat tregojnë se kur inatosej lubia, shkaktonte shira,*

¹¹) Hysenaj, Bardho: *“Histori e Labërisë”*, Tiranë, Redona, 2011, f. 366-367.

shtërngata, bënte përmbytje, prishte të mbjella. Mund të qetësohej po t'i jepej bagëti për të ngrënë. Lubia e egërsuar shpesh herë zinte burimet, çezmat e ujit, duke ndaluar rrjedhën e tyre. Dëgjohej edhe sot shprehja habitore ndaj një të pangopuri: *"Po paska qenë lubi!"*. Në kohën e luftës së Njëzetës dhe pas saj këndohej: *"U shofsh me ujë Itali/ se paske qenë lubi/ matesh me një Shqipëri..."*. **Kuçedra** na vjen si figurë e përrallave popullore, që përfytyrohej si gjarpër shumë i madh me 7 deri 12 koka, i cili hante njerëz dhe bënte dëme e të këqia; përbindësh. Kur themi i përbindshëm, parafytyrojmë një qenie me përmasa jashtëzakonisht të mëdha e tipare shumë të shëmtuara, që të kall tmerrin, që është si përbindësh, që mund të shkaktojë dëme shumë të rënda e shkatërrime jashtëzakonisht të mëdha. Qenie e përbindshme. Mjetet (armët) e përbindshme të shfarosjes në masë; në kuptimin figurativ keqësues. Shumë i shëmtuar e i neveritshëm, që bëhet me egërsi të madhe e pa pikë mëshire, në mënyrë të poshtër e të pabesë. Fytyra e përbindshme e pushtuesve të huja. Krimet e përbindshme të nazistëve, të kolonizatorëve, të imperialistëve). Vetë **përbindshi** ishte një qenie përrallore që, sipas besimeve të njerëzve të fillimit, përfytyrohej si një kafshë grabitqare me trup jashtëzakonisht të madh e me pamje të shëmtuar dhe që u kallte datën, tmerrin njerëzve. Si term mjekësor, përbindëshi kupton një qenie njerëzore ose kafshë me formim krejt të çrregullt, ndërsa figurativisht na jep imazhin e një njeriu jashtëzakonisht të pashpirt e të neveritshëm, që mund të kryejë veprat më mizore e më të poshtra, vrasës e shfrytëzues shumë i egër e gjakpirës. Përdoret shprehja: *"Përbindëshat fashistë (nazistë)"*. Kënga e regjistruar na jep këtë informacion artistik të ngjarjes së pushtimit të Vlorës më para se të shpërthente Lufta Çlirimtare e Njëzetës: *"Si një përbindësh i detit/ sulen breshkaxhinjt' e mretit"*. **Gjarpri**, për njerëzit që ruajnë besimin, është kulti i të parëve dhe është quajtur symbol fati e mbarësie. Thonë, se diku në malësitë e Labërisë, ruhej një gorricë mbi 100 vjeçare (dardhë e egër). Ruhej me kujdes nga të gjithë pasardhësit e çdo brezi, me porosi që në këtë pemë të mos vihej sëpatë, të mos pritej, se ishte rrisku (fati) i shtëpisë, se në rrënjët e saj qëndronte një gjarpër i madh, i cili dilte shumë rrallë, të cilin s'guxonte njeri ta prekte. Besohet si ruajtës i varrit. Ai është personifikim i shpirtit të të vdekurit, prandaj edhe në çdo hyrje të varrezave gjeje të gdhendur në dru ose në gurë figurën e gjarpërit, si dhe në çdo arkivol. Gjarpri, siç besonin, ruan edhe shtëpinë, njerëzit e gjallë nga çdo fatkeqësi e sëmundje dhe ky quhej gjarpëri i shtëpisë. Në anë të vatrës, në vrim ëtë murit, sipas besimeve popullore, rri vitorja a Gjarpri i shtëpisë, që quhet dhe bolla. Është e tija vatra, shtëpia. Shtëpisë i sjell mbarësi në njerëz e në mjete jetese: bujqësi e blegtori. Kur një familjeje i ndodhnin fatkeqësi, thuhej se i është ligështuar **vitorja, bolla e shtëpisë** ose i ka vdekur... Sipas studimeve dhe ekspeditave të kryera në krahinat jugperëndimore të Shqipërisë, gjarpri i shtëpisë vigjëlonte mbi shëndetin dhe mbron shtëpinë. Gjarpri i shtëpisë, sipas miteve është pari i shtëpisë, pra stërgjysh i saj, shpirt i Shtëpisë, Ora mbrojtëse e vatrës, e shtëpisë. Kemi të

bëjmë me një zanafillë totemi. Gjarpri si figurë mitike, totemike, sipas akademikut Mark Tirta, “na dëshmoheq qartas te Ilirët, te Arbërit e Mesjetës e, po kështu, na del shumë qartë e me identitet të veçantë te Shqiptarët si Vitore, si Bollë, si zotërues i vatrës, i shtëpisë. Pra këtu kemi një vazhdimësi të identitetit si popull, si shqiptarë, me shumë doke e besime të natyrës së një organizimi sedentary që nga Lashtësia. Kuptim totemik të veçantë gjarpri ka pasur dhe ndër Ilirë. Kjo flet shumë për këtë vazhdimësi iliro- shqiptare, shprehur qartë dhe në kultin e vatrës, në mite e besime që e bëjnë atë të shenjtë”¹². Ja ç’pasqyrim artistik na sjell kënga e Njëzetës: “ Që në Gjorm e Llogora,/ Bir, o bir, Hodo Zeqiri, gjarpër-o Hysen Beqiri!/ një mjegull e madhe ra,/ ball’ i burrave ç’u vra...”. **Astriti**, zoologjikisht, është një gjarpër i madh me ngjyrë të verdhë e shpesh i shkruar me pika, që është shumë i shpejtë e i shkathët. Si figurë, astriti na jep një njeri shumë të shkathët, trim e sypatrembur. Mbahet mend kënga e vjetër: “Nuk njohu çar’ ishte frika/ Selmani, astrit me pika”.

4. Njësi folklorike me profil mitologjik

Me gjithë peshën e madhe të epizmit, këngët e Njëzetës, që quhen kryesisht këngë burrash, edhe pse na duken sikur e ndjekin në mënyrë shumë rigoroz luftën, me të gjithë rrjedhat e saj, si një fotoreporter epiko- historik, kanë vlera estetike. Këto vlera evidentohen sidomos nëpërmjet tekstit të kënduar apo të hedhur valle në zjarrin e luftës, në teatrin luftarak, nëpër transhe e bregore, në fusha e llogore, në gryka lumenjsh e qafa malesh, në ullishte e vreshta. Nuk është synimi ynë të bëjmë dublikata të regjistrimeve të bëra, të cilat janë botuar edhe në vëllimet e EH dhe ruhen në arkivin e IAKSA, por të gjejmë gjallimin e sotëm të asaj ç’ka ngelur nga mbijetojat e shtresës mitologjike (nga ato pikatoret e thesarta të EHLV), të vëzhgojmë jetën e gjallë të repertorit aktiv, në se ka, edhe pse një pjesë e konsiderueshme ka kaluar në arkiva e klasifikohet repertor pasiv. Synojmë të vëzhgojmë atje ku ka lindur kënga, gjithashtu, ta pasurojmë më shumë ciklin e Njëzetës me regjistrime autentike, që mendojmë se përbëjnë vlera të mirëfillta folklorike, që kanë vlera njohëse, edukative, etiko- morale, estetike e artistike, që gjykojmë se janë folklor dhe mund të shërbejnë si gjurmime folkloristike, që, ndërkohë, nuk janë përfshirë në botimet e cituara apo të mëparshme. Distanca dhe afria me ngjarjen, kur historia lokale dhe ajo kombëtare, me koherencë të ftohtë, e cilëson si pavarësia e dytë e vendit, ndërsa folklori lokal e këndon, ashtu siç e ndjen, me emocion të fuqishëm dhe na fokuson në literaturën e klasifikuar

¹²) Tirta, Mark “Vatra - simbol i jetës e i mbarësisë në traditën shqiptare”, shih: “Perla” 1, revistë shkencore- kulturore tremujore, 2011, nr.58, f.84.

folklorisike. Duke e ngushtuar në thellësi kërkimin e njësisive folklorike me profil mitologjik, jemi përqëndruar në tre botime të nivelit akademik dhe pikërisht në: “*Këngë popullore historike*”, “*Kujtime dhe këngë popullore për luftën çlirimtare të viteve 1918-1920*” dhe në vëllimin e tretë të Epikës Historike. Puna në terren dhe konsultimi me literaturë e shkruar në këtë fushë na ka dhënë dorë të shqyrtojme sinkretizimin e folklorit të EHLV me “trampolinë” mite e besime të burimit pagan, që, parë në kontekst, i japin tingull moral e atdhetar të fisnikëruar. Me gjithë rrudhjet që ka pësuar ky cikël, për shkak të përdorimit të rrallë dhe të ndryshimit kulurore, të rrethanave ekonomiko-sociale e gjeopolitike, përsëri nga pikatorja e çmuar mitologjike mund të japim këtë statistikë folkloriko-mitologjike, të cilën po e paraqesim sipas rendit kronologjik të botimit, duke respektuar parimin fonetik.

4.1 Njësi folklorike me musht mitologjik nga vëllimi “*Këngë popullore historike*”

E quajmë më me vend të ravijëzojmë më tepër optikën e këtij punimi vetëm në ato njësi, që janë spikatur me lëng mitologjik dhe që ende jetojnë si folklor aktiv, të cilat janë regjistruar në ato fshatra e krahina të Shqipërisë prej të cilave u nisën luftëtarë vullnetarë për në Vlorë në tërësi dhe veçanërisht nga Vlora dhe krahinat e saj, të cilat kishin dhe peshën kryesore të luftës.

Në librin “*Këngë popullore historike*” përfshihet edhe cikli i i këngëve për LV, me 43 njësi folklorike, nga të cilat, në 6 prej tyre kemi përdorim të figurave mitologjike. Përkatësisht, në njësinë nr. 289 përdoret si krahasim ezhderhaja, (me burim nga turqishtja), që si figurë e besimit popullor përfytyrohej si kuçedër dhe në tekstin poetik të këngës ka kuptimin e figurshëm pozitiv: trim i madh, dragua: “*Kur ra komita në Kotë,/ Në Kot’ komita kur ra,/ Ç’u vra Ziguri në portë,/ U vra Zigur Leluà.../ Dolli xhenerali thotë:/ ‘nga m’u funë në kalà?/ Me pushk’e flamur në dorë,/ Si trima si ezhderhà!*”¹³. Njësia folklorike nr. 295: “*Evropa shkruajn’ e thonë:/ ‘Ç’është kështu si dëgjijmë?/ ‘Bënet-ë dyfek në Vlorë,/ Shqipëtarët po lëfojnë/ Me një mbret dyzet melonë’/ ‘Po me se lëftojnë valë?/ Me sëpata, me hanxharë,/ Dyfeqet lidhur me gjalmë,/ Fyshekët në xhep i mbajnë’./ Paskan pjellë ato nëna,/ Paskan pjell’ e bërë drëra,/ Lëftojnë e s’u tundet këmba!*”¹⁴. Dreri është specia më madhështore, më trimërore, më e fuqishme e sorkadhes, e drenushës, e sutës. Dreri është simbol që mbron tufën dhe territorin e vet deri në vetsakrifikim; vritet dhe nuk e lë tufën. Thonë, kur vritet sorkadhja, derdh lot si njeri. Dreri vjen si mit e bëhet motiv, është simbol, është personifikim, është mishërim i trimit shqiptar në shekuj. Drerit, në dialektin e

¹³) “*Këngë popullore historike*”, bot. i Institutit të Shkencave, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë, “Mihal Duri”, 1956, f. 303.

¹⁴) Po aty, f. 305.

krahinës etnografike të Lumit të Vlorës, i thonë drë (drëra-shumës) dhe konsiderohet mburoja e vatrës, e shtëpisë, e fisit, e fshatit, e vendit. Në këngën e cituar, vjen si metaforë me burim mitik, në trajtën e një kaprolli vigan. Njësia folkorike nr. 307 na sjell vargjet: “*Qaf e Vlorës maja-maja,/ Ç’e qëllon me top Itajja,/ Ç’i vete tymi dumana,/ Dumana ç’i vete tymi,/ Sokëllin Caush Tafili,/ Sorkath mali e gju’ birbili...*”¹⁵. Kënga e popullit sorkadh mali cilëson figurativisht një djalë të lehtë e të shkathët, një luftëtar që lufton si dre, si kaproll e thërret me zë të lartë, kur lëshohet me tingull të fortë e të kumbueshëm, që bën jehonë në ballë të zjarrit çlirimtar. Thonë që sokëllimat e luftëtarëve i trembnin deri në lebeti agresorët në Kotë e në Gjorm, në Drashovicë e në Llogora, në Vreshtat e Mëdha e në Qafën e Koçiu. Lufta e Vlorës pati karakter popullor mbarëshqiptar, ishe masive dhe e rregullt. Banorëte organizuar në çeta ishin edhe luftëtarë të çlirimit, njëkohësisht edhe këngëtarë të këngëve kushtruese, frymëzuese, trimëriore, epike, që i thurnin e i këndonin aty për aty. Nuk kishte grupe polifonike, solistë skenashapo ansamble artistike në front. Për vullnetarëttrima, lufta dhe kënga kishin marrëdhënie njëkohësie, siç e kuptojmë dhe nga rasti i luftëtarit të dalluar Caush Tafil “gjuhëbirbilit”, që lufton dhe në të njëjtën kohë këndon e matet me biblilat. Këtë informacion artistik të realitetit historik na jep kënga e sipërpërmendur. Njësia folkorike nr. 308 nis me vargjet: “*Babicë, përmbi hapsanë,/ Dy djema, si dy asllanë...*”¹⁶. Epiteti “asllan” vjen nga turqishtja dhe në shqip ka kuptimin “luan”, shumë i fortë, simbol i guximit. Kuptohet që krijimi i kësaj kënge i përket një kohe më pas, nuk është këngë fronti, ndërsa krijuesi i saj duhet të ketë qenë i shkolluar, krahasuar me bashkëkohësit, ose “i dalë”, sepse luani nuk rron as në Vlorë, as në Labëri e as në Shqipëri, por rron në Afrikë, në Azi etj. Dhe në EHLV vjen si figurë e huazuar. Në vijim vjen kënga nr. 309 me vargjet: “*Mesovuni maja-maja!/ Të xhuman’ u bë hataja,/ U vranë djemt’ nga kazaja:/ Brahim Velo eshdërhaja...*”¹⁷. (Është interpretuar figura, kështu që s’po e përsërisim). Mbyllet ky libër, që është dhe botimi i parë i nivelit akademik (1956) me njësine folkorike nr. 319, që finalizohet me vargjet mallkuese: “*Itali, të rëntë pika!/ Ç’i bëre këshllat e rrymta?/ I lashë në vënt e ika,/ Se kishte pjellë Haxhika./ Kishin pjellë ato nëna,/ Kishin pjell’ e bërë drëra*”. (Është interpretuar figura).

4.2 Njësi folklorike me veshje mitologjike nga vëllimi “*Kujtime dhe këngë popullore për Luftën Çlirimtare të viteve 1918-1920*” dhe “*Epika Historike*”, 3

¹⁵) Po aty, f. 310.

¹⁶) Po aty, f. 311.

¹⁷) Po aty, f. 311.

Në librin *"Kujtime dhe këngë popullore për Luftën Çlirimtare të viteve 1918-1920"*, nga 108 këngë popullore historike, 100 i kushtohen LV. Ndër këngët e EHLV, figurat mitologjike përmenden në 15 njësi folklorike. Në tekstet poetike vërejmë figurat si dragoi, kuçedra (shih: ezhdërha), drëri, sorkadh mali, që i kemi gjetur deh në vëllimin e parë *"Këngë popullore historike"*, 1956. Vihen re edhe figura që s'përmenden në librin e sipërcituar si "mali i shenjtë", "diell", "gjarpër", "gjarpër me pika", "astrit me pika", "ujk" e "shejtan". Po i marrim me radhë: kënga nr.18: *"Maji më njëzet e nënt,/ Baçalla, në mal të shënjt,/ Ngrenë pllan populli vetë:/ - Të desëm për Dhen' e shtrenjtë"*¹⁸. Mitologjikisht, njihen nga besimet popullore kultet e bujqësisë dhe të blegtorisë, njihet dhe festa e Kultit të Malit. Trupat Kombëtare, që u mblodhën vullnetarisht në vendin e quajtur Barçalla, mbi mal të Dukatit, në juglindje të Vlorës, se i thirri zjarri i vatrës e dinjitetit i rrezikuar i Atdheut, e quajtën Barçallanë mal të shenjtë, vend të bekuar. Historia shkruan se më 29 maj 1920 në Barçalla u mbajt mbledhja e përfaqësuesve të popullit, që miratuan njëzëri fillimin e kryengritjes së armatosur kundër pushtuesve imperialistë, kolonizatorëve italianë. Caktimi i kryetarëve të çetave, sikundër këndohet dhe në këngë, u bë në mbledhjen e Beunit, më 2.06. 1920. Rrapi, rreth të cilit u mblodhën trimat ishte shekullor dhe quhej Rrapi i Gurrave. Ai u shndërrua në rrapi historik dhe luftëtarët e quajtën Rrapi i Burrave. Sipas kujtimeve të Beqir Velos, i cili ishte komandant i çetës së Kaninës, kënga *"Maji më njëzet e nënt"* është arketipi i folklorit të EHLV Mund të jetë kështu, se ai ka qenë dëshmitar okular dhe në ballë të forcave të çlirimtarëve. Veterani i Njëzetës shkruan: "Mbledhja e Barçallasë është bërë më 29 Maj 1920. Kjo tregohet dhe në këngën labe, që këndojmë qysh nga viti 1920..."¹⁹ dhe citon të plotë këngën e mësipërme, që nis me vargjet e cituara e vijon me emrat e "kumandarëve" të çetave pjesëmarrëse, përmendja e të cilëve e zgjeron objektin e këtij punimi. Përse e quajtën banorët mal të shenjtë Barçallanë? Dikur, populli bënte pelegrinazhe në male, në vende që i besonte si të shenjtë. Atje, dilnin që natën, ndizeshin zjarre, i faleshin diellit, bëheshin kurbanë në gërmadhat e ndonjë kishe, xhamie, teqeje a të ndonjë varri të shenjtë të bektashinjve. Edhe pse kishin dukje bektashiane, në përmbajtjen e tyre kryesore ishin ishin parakristiane. Me studimin e këtyre kulteve të natyrës janë marrë në gjerësi e në thellësi studiuesit Mark Tirta e Bardhosh Gaçe. Në rastin konkret, kënga e shenjtëron vendin ku u mblodhën burrat në Kuvendin e

¹⁸) *"Kujtime dhe këngë popullore për Luftën Çlirimtare të viteve 1918-1920"*, përgat. Muin Çami, Qemal Haxhihasani, Zihni Haskaj, Zihni Sako, Tiranë, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, 1970, f. 244.

¹⁹) *"Kujtime dhe këngë popullore për Luftën Çlirimtare të viteve 1918-1920"*, vep. e cit., shih: Velo, Beqir: "Demonstrata antiimperialiste e Vlorës e 28Nëntorit 1919", f. 117.

Çlirimit, që të marrë bekim lufta e drejtë, se luftojnë “për dhenë e shtrenjtë”. Përdoret si simbol artistik dhe pasqyron estetikisht forcën e besimit të vullnetarëve në të drejtën e tyre te Zoti. Kënga nr. 20: “*Memet Selimi, dragoi, / I pari aty qëlloi, / Mori Kartën edhe shkoi, / Kumandës ja dorëzoi*”. Nga historia dimë se është fjala për ultimatumin që Komiteti i “Mbrojtjes Kombëtare” të Vlorës, nëpërmjet trimit Mehmet Selimi, i dorëzon më 3 qershor komandantit të forcave italiane, S. Piaçentinit, ku ftohej të përgjigjej brenda datës 4 qershor. Komanda e pushtimit i dha përgjigje tallëse kërkesës serioze të Komitetit. Të nesërmen, më 5 qershor, shpërthen sulmi i përgjithshëm kundër garnizoneve italiane të pushtimit. Ngjarjet rrjedhin... Në demonologji, siç e kemi trajtuar, dragoi njihet si kryefigurë e besimeve popullore shqiptare, që përfytyrohej si njeri shumë i fuqishëm, i cili luftonte me një trimëri të rrallë me kuçedrën, deri sa e vriste. Bëhet fjalë kur kuçedrës i është hequr legjendariciteti i mirë dhe i vishet simboli i së keqes, i shkatërrimit, i zhdukjes së përparimit të njerëzve. Sipas besimeve popullore, kur trimat dragonj, me zjarrin e qiellit, me kokrrën e rrufesë, që quhet arma e Zotit, ndeshen, gjuajnë, mbysin e vrasin kuçedrën, fatkeqësitë marrin fund, sepse është realizuar paqtimi i furtunës. Përmbledhtazi, dragoi përmendet si figura më domethënëse e demonologjisë shqiptare, si hyjni mbrojtëse e bashkësisë njerëzore, e fisit, e krahinës, e prodhimit të së tyre, e lindur për të ndalur veprimet shkatërrimtare të kuçedrës (kulçedrës). Në gjuhët e ndryshme të Europës, emërtimi Dragon, Drako, Drakone, po thuaj ka kuptimin e një kuçedre, të një gjarpri a reptili tjetër, përbindësh, ndërsa në shqip, dragoi, gjithnjë, është heroi që lufton kundër kuçedrës, për të mirën e njerëzve, është hyjni. Njerëzit e përmendur si luftëtarë të dëgjuar besohet se kanë qenë dragonj. Ndër veçoritë kryesore të tyre, spikasin trimëria dhe guximi. Edhe Atlasi Folklorik i Njëzetës na jep të drejtën të kuptojmë se pa guxim s’ka lavdi. Dragoi është i lindur për ndeshje të mëdha, “*me një shtet dyzet melonë*”, siç këndohet kënga. Besohet se, atë që është Dragua, as pushka s’e zë. Për cilësitë e larta dhe me këto besime fluturoi Ultimatum i mbi pelë të bardhë nga burri dragua Mehmet Selim Shahaj Mallkeqi, njeri real, hero luftëtar, kalorës luftëtar, ndryshe nga Kreshnikët e këngëve legjendave që janë heronj kulturorë. Në popull besohet se Selam Musai, Sali Murati, Zigur Lelo, Kanan Maze, Selman Hyseni etj., kanë qenë vërtetë dragoj. Akti i tyre sublim i shndërroi në heronj të Çlirimit, por ata s’lindën spontanisht në Luftën e Vlorës. Ata kishin një përvojë të gjatë luftarake të mëparshme, që me luftën e Janinës (18.11. 1912- 07.03. 1913) apo dhe në luftime të tjera lokale e kombëtare; ata ishin burra kuvendi, “burra kazaje”, si thuhej në atë kohë. 58 ditë e netë vere e bënë Vlorën me Labëri e me Qafën e Koçiut një kurorë nderi e mburrjeje të merituar për kombin shqiptar, një Mekë, vend të shenjtë për shqiptarët, prandaj me të drejtë Halim Xhelo i jep përmasa legjendare kësaj epepeje, duke hequr

paralele me Spartën dhe Termopilet e Greqisë së Moçme²⁰ e duke na paraqitur një vështrim të goditur në mënyrë të krahasuar, ku koherenca rezonon fuqishëm me emocionin e motivuar. Në tekstet që po marrim në shqyrtim, kur gjenden figura që i kemi trajtuar, ato vetëm sa do t'i citojmë një njësitë folklorike ku janë pjesë organike specifike e tekstit poetik, nuk do t'i interpretojmë. Në njësinë folklorike nr. 29, kemi vargjet: “Mbi tela seç u vërvinë,/ S’na vlen jeta pa lirinë./ Kudhësi në tjetrin krà/ U derdhë si **eshdërhà**”²¹; nr. 36, kemi vargjet: “Si trima, si **eshdërhà**,/ bëjnë hyxhym përmbi ta!”²²; nr. 37: “Ç’paskan pjellë ato nëna?!/ Paskan pjell’ e bërë **drëra**!”²³; njësia folklorike nr. 40 vjen me këtë tekst poetik lakonik: “Që në Gjorm e Llogora,/ Bir, o bir, Hodo Zeqiri,/ **Gjarpër- o Hysen Beqiri**!/ Një mjegull e madhe ra, /Ball’ i burrave ç’u vra,/ Hodua që bën shaka,/ Hysen Beqir Jazuà/, Zenel Ramohitua..”²⁴, [Tërbaç-Vlorë, 1959], që mendojmë se është këngë e përvajshme. Nga mitologjia, ndër kultet e familjes, të të parëve e të të vdekurve, për kultin e gjarprit në shenjtërimin e tij janë ruajtur gjurmë të lashta të totemizmit, si mit që i takon familjes. Gjarpri ka atributet e mbinatyrshe të një qenieje që i përket kultit të tokës, “dheut”. Të parët tanë e konsideronin “të shenjtë”, “roje të shtëpisë”, fatndjellës në familje, simbarësiprurës në njerëz dhe në pasuri. Ende mbahen mend ritet me gjarprin për pjellori e mbarësi në malësitë e Labërisë, se e mendonin që gjarpri ishte shërues, del si shpirt i vatrës, si shpirt i shtëpisë, si shpirt i shqiptarit. Gjarpri i shtëpisë në të folurën popullore dhe në këngët historike të Jugut quhet edhe “bollë”; në këngët lirike quhet “vitore”. Kulti i tij është i lidhur ngushtë me kultin e vatrës, me animizimin e vatrës. Sidomos në këngët epike të LV, ai ka kuptim mirësues, pozitiv shumë të lartë, porsi dragoi i legjendave mitike, edhe si demon i pjellorisë së tokës, si zotërues i tokës. Duke lundruar në lundrën e këngës, siç këndon me frymëzim Lefter Çipa, marrim njësinë folklorike nr. 50, ku gjejmë variantin “Sokëllin si **ezhdërhà**”²⁵. Njësia nr. 54, regjistruar në Dhemblan, Tepelenë, 1963, fillon me vargjet: “- **Dielli maleve ku bie?**/- Në male të Salarie!/ Selam Musai kur vije,/ Kal’ i kuq e guna çile!./ Selam, zemërën me çika,/ e zure topin nga gryka!”²⁶. Përveç kontributit etnografik në lëmin e kostumologjisë, vargjet e këngës na fusin në një mjedis

²⁰) “Halim Xhelo-militant dhe ideolog i shquar revolucionar”, përgat.

Viron Koka, Sazan Xhelo,

Tiranë, Akademia e Shkencave të RPSH, Instituti i Historisë, Tiranë, 1975, f. 97.

²¹) “Kujtime dhe këngë popullore...”, vep.e cit., f. 255.

²²) Po aty, f. 262.

²³) Po aty, f. 263.

²⁴) Po aty, f.266.

²⁵) Po aty, f. 278.

²⁶) Po aty, f. 284.

melëndë mitologjike. Nga mbijetojat e kuleteve të lashtësisë është ruajtur kulti i Diellit. Kujtesa sociale na sjell shembuj të freskët, që banorë të vjetër të trevave malore të Mesaplikut e të Kurveleshit, të cilët kanë mundur të arrijnë pleqërinë e thellë deri në fund të shek.XX, betoheshin: “Për atë **Diell**, që shkon i lodhur në Çikë”! Dielli, qoftë edhe në mënyrë të zbehtë, shfaqet në kultin e vatrës, të zjarrit, të ujit e të maleve; ai gdhendej me gurë në oxhakun e vatrës, në portën e shtëpisë, punohej me dru në djepe etj. Motivet e Diellit ndër ne dëshmojnë karakterin religjioz, magjik e mbrojtës të vendeve të besuara si mikpritëse diellore. Me kultin e Diellit banorët frikësonin Kuçedrën a Lubinë. Në malësinë e Labërisë, kulti i Diellit me maja të larta është shumë i dukshëm në Kurorën e Malit, në majë të Këndrevicës (2122 m mnd), më i larti mal në Shqipërinë Jugperëndimore, që ndodhet afër Salarisë, vëndlindjes së Selam Musait. Fuqia e kultit të Kurorës së Malit është ruajtur dhe ruhet edhe sot e kësaj dite me pelegrinazhejo vetëm nga banorët e zonës, por edhe me flijime bagëtishë sikurse në Majë të Tomorrit, në Gjallicë të Lumës, në Pashtrik të Hasit, në Rumie të Krajës (ndër Shqiptarët e Malit të Zi), në Malin e Shën Ilisë enë atë të Bukanikut në Shpat të Elbasanit. Për EHLV Selam Musai është kryeheroi popullor për luftën legjendare të Njëzetës e me këtë gjykim, i përqasin portretit të tij epik diellin e madhërisëm, pikërisht atij, vetëm atij dhe jo një tjetri, sepse për banorët e bashkëkohësit ai ishte personifikimi i Luftës së Vlorës. Kjo ndodh se veprimi i pabesueshëm guximtar i Selam Musait la mbresa të pashlyeshme ndër bashkëluftëtarët dhe banorët e krahinës, sepse akti i trimit të luftës, i heroi të këngës ishte i madhërisëm, në kufijtë sipërorë të sublimes. Në këngët e LV, malet vijnë me hije të lartë të rëndë, të pushtetshme. Malet-pushtet, me pushtet trimi, pushtet legjendar i gjen vetëm në këngën epike. Në vijim kemi njësinë nr. 58: “*Gunën mbi tela ç’e shtroi,/ I shkreti Selam dragoi/ Me krahë mu si fajkoi*”²⁷ dhe atë me nr. 66, ku kemi vargun: “*Sorkath mali e gju’ birbili*”²⁸. (Fajkoi është pretit, sokol, djalë a burrë trim e i fuqishëm). Në njësinë folkorike nr. 67 kemi vargjet kushtuar trimit të tërbuar, Selman Hyseni, komandant i çetës së Tërbaçit; “*Selman, gjarpëri me pika,/ Nga Tërbaçi, ng’ato gryka,/ Që s’e një’ seç ishte frika./ Vetëtimë shënëndreu,/ Si ujku në dhën kërceu,/ Italianët -ë i shqeu*”²⁹. Vargu “*Vetëtimë shënëndreu*” na kujton atë dritë të fortë, që flakëron për një çast e me shpejtësi të madhe në qiellin me re, zakonisht në trajtë vijash zigzake a të degëzuara, e cila shkaktohet nga shkarkimet elektrike në atmosferë dhjetorit dimërak; rrufe, shkretimë, bubullimë, [këtu ka kuptimin shumë i shpejtë, shumë i shkathët e i fuqishëm, tërësisht në vlera morale e dokesore shumë i ndritshëm]. Nga mitologjia, rrufeja, guri i rrufesë, si gur reje, është një mbetje e shenjtë meteore ndër shqiptarë e vjen si komunikim vertikal i qiellit

²⁷) Po aty, f. 288.

²⁸) Po aty, f. 296.

²⁹) po aty, f. 297.

me tokën. me rrufe gjuhët e paudhi, i mallkuari, kuçedra. Tërbaçiotët e Lumit të Vlorës, që kishin komandant çete Selmani Hysen Gjondedën, besonin se ai qe vetëtimë shënndeu, i paparë, fat që sillte mbarësi, që kishte me vete gurin e rrufesë, që e mbante në udhëtim, në luftim e që s'e zinte plumbi. Dhe interesant. Trimi i madh, gjithë ai bredh shpirtëror e lavdie i Tërbaçit, nuk ra nga plumbi i pushtuesit, s'e nuk e zinte dot plumbi rrufenë, por nga bredhi natyror në një shpatull mali me borë, sipër Vargmaleve të Vetëtimës. Jemi në kufijtë e të pabesueshmes, por në territorin real të së vërtetës, sepse e shkruan historia lokale, e këndon kënga, e kujton memoria sociale e komunitetit tërbaçiot dhe të atyre që e kanë njohur nga afër heroin, që s'ezinte plumbi, se paskej lindur me këmishë...ndër kultte e gjallesave të natyrës, për popullin tonë ujku është egërsirë me attribute të mbinatyrshme, me origjinë ilire. Thuhet se ujku, kur bie ndër bagëti, ha vetëm pjesën e vet, gjënë e haramit; ai merr vetëm një nga bagëtitë, ndërsa të tjerat vetëm i dëmton e i lë në vend, në se janë të haramit. Lëkura a dhemb i ujkut përdoret si hajmali, si nuskë për fëmijën, që të mos sëmuret e të mos dëmtohet nga shtrigat a nga syri i keq, që mbahet me vete dhe që mendohet se të shëron e të sjell fat. Dhëmbin e ujkut ia varin në ballë dhe kalit, që të mos e zërë syri i keq. Në këngë, ujku simbolizon një njeri shumë të shëndetshëm, shumë të forë, shumë të aftë, të paparë për mirësi dhe nuk këndohet vend e pa vend, jo kujtdo mund t'i thuret ky epitë. Njësia nr. 84, përsëri në një variant tjetër, ka vargun më përfaqësues të EHLV: ".../kishin pjell' e bërë drëra!"³⁰. Njësia nr. 86 vjen me vargjet: "Një djalë nga Karbunari/ Briti shokëve: "Amáni!/ Mos lini këmbë dushmáni,/ Se nuk ka takat **shajtani**,/ Gjithë me dhëmbë t'i hani!"³¹. Sipas besimeve të të parëve, shejtani ishte i paudhi, djalli, dreqi, q'ësjell fatkeqësi, që të thith e të mbytet në ujë. Në rastin e këngës, duke respektuar kriterin kronologjik, mendojmë se krijuesi folkorik ka qenë bashkëkohës i dinamikës së luftimeve e ngjarjeve lidhur me LV, kur forcat pushtuese po tërhiqeshin dallueshëm dhe po humbisnin hapësirat e pushtuara, prandaj ai i ironizon por pa i mëshiruar, me logjikën që pushtuesi është pushtues, me uniformë ushtarake dhe armatim luftarak, nuk është turist, udhëtar, donator apo bamirës civil. Është interesant fakti, se në këtë botim, gjendet edhe një tekst poetik [njësia nr. 87] , regjistruar në Vranisht, Vlorë, 1956, që nis me vargjet : "Shqiptarët, bijt' e **Pellazgut**,/ Trima dhe të zot' e gjakut,/ Me pushkë të austriakut,/ U grinë zhapën e barkut,/...Në Fushë të Peshkëpisë,/ Aropllan' i Italisë,/ U këput e ra si mizë"³². Ndërkaq, unë di, që në këmbë të fshatit Tërbaç, afër vendit të quajtur Sinadane (tej shtëpitë të Xhelo Jahos, mu në majë, në qafë të Shurbes, përballë shtëpive të Jaupit) përdoret toponimi "Varri i Pellazgëve". E kam dëgjuar nga gjyshja ime, Shero Lushaj, që

³⁰) Po aty, f. 316.

³¹) Po aty, f. 318.

³²) Po aty, f. 319.

rrojti 100 vjeçe (1912- 2012), e cila e kishte dëgjuar nga nëna e saj, Bako, e cila dhe ajo kishte rrojur 100 vjet, e kam dëgjuar dhe nga pleq të tjerë që kanë ikur, po ashtu, nga nëna ime, që rron, si dhe nga banorët përreth. Nga sa kemi studiuar tipologjinë e figurave stilistike të artit specifik në tekstet poetike të EHLV, ku dominon hiperbola, bukurisht fisnike qëndron dhe litota, si në rastin konkret të aeroplanit të pushtimit, që për banorët e asaj kohe ishte përbindësh, të cilit sofistikimi i egër shfarosës i zbutet, i zvogëlohet, i pakësohet, sa që *“u këput e ra si mizë”*, duke krijuar tek njerëzit një ndikim të fuqishëm emocional, nxit përshtypje po aq të fuqishme, sa e madhja hiperbolë përballë. Litota për aeroplanin përbindësh që *ra si mizë*, është e pikuar, e qëndisur, të këput artistikisht. Ndërsa vargu i parë i këngës, në qoftë se s’kemi se si ta mohojmë që ekziston në folkorin polistadal, shkencërisht ka dritëhije dhe mbetet një çështje delikate për diskutim serioz dhe debat shkencor. Pellazgët ishin popullsi që banonte kryesisht në Pellgun e Egjeut dhe në krahët jugorë të Ballkanit para helenëve dhe ilirëve. Mendohet që ilirët janë pasardhës të pellazgëve, por nuk mund të thuhet ende me garanci shkencore, bazuar në dokumente origjinale apo edhe me metodën e karbonit C14, që pellazgët janë ilirë. Literatura e shkruar, që kemi në dispozicion nga studiuesit e huaj dhe ata shqiptarë thotë, se shqiptarët janë pasardhës të ilirëve. Kemi informacion shkrimor, që ilirët kanë pasë jetuar në një hapësirë të madhe, por që ka ardhur duke u tkurrur nga pushtimet e huaja dhe zaptimet fqinjve dhe të jofqinjve. Kënga *“Shqiptarët, bijt’ e Pellazgut...”* këndohet edhe sot nga moshatarët dhe vlera e folkorit qëndron tek jeta sinkretike aktive që bën me tekst, me muzikë (melodia), me kostume, me kërcime, në hapësirë dhe në kohë, me variante, se, ndërkohë, folkori sjell prurje nga koha në kohë, huazime shpirtërore, që vijnë natyshëm si përcjellje organike jomateriale. Në këngë, ky varg vjen nga përcjellja gojore brezave dhe qarkullimi folkorik. (I një legjende rurale?!). Sipas një bisede që kemi bërë në vitin 2011 me prof. Tirtën, dokumentohet qysh në shek. 15 p.e.r që indoeuropianët janë të ardhur nga jugu i Rosisë, pjesa aziatike. Ka pasur popullsi edhe më përpara jo indoeuropiane, para indoeuropiane - Pellazgët. Ata u shkrinë me popujt, që në lindje të Mesdheut deri në Gjibraltari. Ç’u bënë më tej pellazgët? U përzien me kulturën e popujve ardhës, u shkrinë me ta? Ndoshta studimet e thelluara ë vijimësi ndoshta do të hedhin fasha dritë kaq shumë pas. Kënga e ka lënë ndezur një pishë të saj... Njësia folkorike nr.93 na rijep variantin: *“Brahim Velo ezhdërhaja”*³³, trajtuar në pikën 4.2. Studiuesja M. Dibra, duke u bërë një lexim metaforik personazheve në këngët historike shprehet: *“Mjaft të shfrytëzuara janë metaforat e realizuara me elemente miologjik si trashëgimi e hershme, e ngulitur, të përcjella prej shekujsh si bartje me sukses të sigurt. P.sh...Mehmet*

³³) Po aty, f. 325.

*Selimi drangoi,/ i pari aty qëlloi*³⁴ dhe më tej: *“Trimi krahasohet me lulet në pranverë, me zogj të fortë si shqiponja, shpend simbolik për popullin tonë...trimi metaforizohet duke e krahasuar me gjarpërin:...Selmani, gjarpri me pika,/ nga Tërbaçi n’ato gryka,/ që s’e njih se ç’ishte frika*”³⁵. Në këngët historike të Jugut të Shqipërisë për LV (ndërkohë që popullsia veriore luftonte me kuçedrën pushtuese në Koplik dhe në Dibër) *“është zgjedhur një rrëshqanor i rrezishëm për t’u krahasuar me trimin. Figura funksionon, sepse është shfrytëzuar forca e gjarpërit për të nënvizuar forcën dhe guximin e personazhit historik, madje tenton të shprehë edhe vizionin e formuar të krijuesit popullor për të bukurën*”³⁶.

Libri vijues i nivelit akademik *“Epika Historike, 3”*³⁷, që kemi në shqyrtim, ka 500 këngë për të tri periudhat historike të gjysmës së parë të shek. XX, që shtrihen në kohë nga viti 1913-1939. Nga këto, 159 këngë i kushtohen ngjarjev që zhvillohen, personazheve që veprojnë brenda 2 muajve të stinës së verës të vitit 1920. Po të bëjmë një krahasim për të tri periudhat, kur për periudhë 6 vjeçare 1913-1919 janë regjistruar 183 njësi folkorike, për periudhën e tretë 14 vjeçare 1925-1939 janë ëshënuar 78 këngë, vërejmë se, EHLV është numerikisht superiore dhe artistikisht shumë e pasur, të pëlqyeshme, interesante, ku del në pah shpirti i zjarrtë liridashës shqiptar, pasi ngjizja e realiteti të ndjenjës kombëtare që realizuar qysh me rilindasit. Lufta e Njëzetës u zhvillua në Vlorë e në rrethinat e saj, por pjesëmarrësit ishin gati nga të gjitha trevat shqiptare. Shqiptarët u ngritën kundër perandorisë së re të kohës: *“Breshkaman i Breshkanmanit,/ Dil steresë, jo limanit!”*. Në ciklin e pasur të EHLV, gjejmë 43 njësi folkorike me figura mitologjike. Për ciklin e këngëve, që i kushtohet epopesë së madhe të Luftës së Vlorës më 1920, prof. Xhagolli nënvizon: *“Ai paraqitet nga më të plotët, nga më të bukurit, shumë i larmishëm, me një intensitet të madh ngjarjesh, tablosh, figurash, që sjellin informacione aq të gjera, sa që në një farë mënyre, e gjithë tabloja historike të duket sikur të vjen përpara syve*”³⁸. Për referencën morale, estetikën mitologjike dhe boën e pasur shpirtërore të këngës historike të epopesë së Vlorës kundër pushtuesve italianë, studiuesi B. Gaçe është i mendimit se vihet re natyrshëm sfondi atdhetar, i cili më von vjen e theksohet në skena monumentale të mbrojtjes së vendit. Ai vë theksin se një vend më të gjerë në këtë gjini të folkorit ka zënë cikli apo më

³⁴) Dibra, Miaser: *“Metafora në këngët popullore shqiptare”*, bot. i Akademisë së Shencave të Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë *“Nënë Tereza”*, 2007, f. 279-280.

³⁵) Po aty, f. 281.

³⁶) Po aty, f. 282.

³⁷) *“Epika Historike”*, vëll. 3, bot. i Akademisë së Shencave të RPSSH, IKP, Tiranë, 1990 [1989].

³⁸) Xhagolli, Agron: *“Etnologjia dhe folklori shqiptar”*, Vlorë, Triptik, 2007, f. 251.

saktë mikrocikli i këngëve himn, në të cilat shprehet vlerësimi për figurat e shquara të LV, si Osman Haxhiu, Sado Koshena, Selam Musai, Zigur Lelo, Sali Vranishti, Selman Hyseni, Mehmet Selimi, etj., që janë asete të historisë kombëtare. *“Me ndërtimin e tyre strukturor e kompozicional të veçantë, me figura artistike të bukura,- shkruan prof. Gaçe - ato himnizojnë luftrat dhe përpjekjet e shqiptarëve për liri e pavarësi”*³⁹.

5. Përfundime

Në ciklin e pasur të EHV pati një lulëzim energjish shpirtërore të mëdha, që motivohej nga fryma e lirisë, shpresa e fitores, që përjetohej me javë, me ditë, me orë... Sipas studiuesit B. Hysenaj, një historian francez thotë: *“Kulti i vërtetë i shqiptarëve është kulti i Atdheut”*⁴⁰. Nga gjurmimet e thelluara nëpër odat folklorike të EHLV, gjykojmë se, simboli i luftëtarëve të Njèzeëts ishte shamia e zezë, e lidhur në ballë, mbi kapele (feste), si shenjë dalluese e nisjes me dëshirë vullnetar për në luftë. Djali takohej me familjen, në fund e puthte nëna dhe në momentin e ndarjes ajo vinte një gjalmë të zi mbi ballë, duke e lidhur mbrapa flokëve. Kurse djali lidhte shaminë e zezë mbi ballë, pasi merrte bekimin e nënës: *“O djalë, të vaftë mbarë,/ m’u kthefsh me faqe të bardhë!”* Pastaj djali ia hipte kalit (ose nisej me shokët në çetë) për në luftë. Këta quheshin bijtë e gjalmëzezave (në kuptimin luftëtar). Në luftën e Njèzeëts, kur hidheshin çetat në sulm, ata ngjanin si shqiponja në fluturim. Është domethënëse dhe me mesazhe të qarta mbartja apo rimarrja e traditave atdhetare, etiko- morale dhe e motiveve folklorike te balada e djalit të vrarë në luftë, me fillesë individuale si krijim folklorik poetin e kulturuar popullor, dragoin e këngës labe Kujtim Mici (Tërbaç, Vlorë, 1937, me arsim të lartë): *“Ti grise këmishën,/ e ngjeve në gjak,/ ma dërgove nënës/ ta qëndis bajrak./ un’shamin’ e zezë/ e preva shqiponjë,/ ia qepa flamurit/ shokëve t’ua dërgojë”*⁴¹

Për mitologjinë në këngën epike të Luftës së Vlorës (EHLV) kemi operuar vetëm me grimca të qenieve mitike dhe kulteve të natyrës, se vetëm me “thërrime” mund të operohet, ngaqë folkori për këtë ngjarje, si nëndarje e epikës popullore, klasifikohet epikë historike dhe është pasqyrim i ndërgjegjes historike, riprodhim artistik i realitetit, ndërsa nëndarja tjetër, epika legjendare ka shtresa mitologjike, jo grimca, sepse ky lloj i krijimeve epike ka natyrë legjendare dhe karakterizohet nga zotërimi i trillimit, i elementëve fantastikë dhe i fantazisë artistike, që ka në qendër veprimin legjendarizues dhe operon

³⁹) Gaçe, Bardhosh: *“Kënga popullore e Lumit të Vlorës”*, Tiranë, Toena, 2009, f. 28.

⁴⁰) Hysenaj, Bardho: vep. e cit., f. 375.

⁴¹) Regjistrim gjatë ekspeditës vetiake, më 20.03. 1973, në Tërbaç, Vlorë, bartëse Shpresa Kapo, 55 vjeçe, me arsim të lartë.

me poetikën mitike, përrallore, fantastike, sepse zotërohet nga tipi i mendimit poetik legjendar. Harta fokorike e Njëzetës, me trashëgiminë sinkretike, që përmban EHLV, me dorëshkrimet e botimet për të, është e mjaftueshme dhe e bollshme për të dhënë mikrobotën mitologjike të barësve të kësaj poezie popullore të veçantë. Motivet dhe personazhet mitologjikë, me përfshirjen e tyre në krijimtarëinë folkorike, zhvishen nga fryma mistike, religjioze dhe ndikimet e saj, duke rritur ngarkesën e tyre estetike. Liria, nga brezi në brez, përcjell mesazhin “nderimi për dëshmorët, për njerëzit, që në solidaritet me njeri - tjetrin, bënë sakrificën sublime për vatrën e ndezur dhe mirëqenie, është një detyrim i brendshëm me përmasa shenjtërimi.

EKSTRADIMI, SI NJË FORMË E VEÇANTË E BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR NË FUSHËN PENALE

MSc. (Kandidat i Shkencave Juridike-Penale. Doktor) Aleks Prifti

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë

Abstrakt

Shqipëria është një vend me kriminalitet relativisht të lartë. Duke bërë një analizë të përgjithshme lidhur me kapjen e autorëve të ngjarjeve kriminale, rezulton se disa autorë kapen në flagrancë, menjëherë mbas kryerjes së krimit, disa identifikohen me vonesë dhe kapja e tyre realizohet në banesë ose në vende të frekuentuara prej tyre, ndërsa të tjerë largohen jashtë shtetit për t'iu shmangur përballjes me hetimin. Sidoqoftë, organet e zbatimit të ligjit, analizojnë provat dhe faktet e grumbulluara në vendngjarje dhe në bazë të hetimeve, pasi është bërë identifikimi i saktë i autorit apo i autorëve të kryerjes së veprës penale, kërkojnë ndalimin e tyre dhe bëjnë shpalljen në kërkim kombëtar ose ndërkombëtar, me qëllim kapjen dhe ndalimin e tyre. Kur ka informacion, se ndodhen jashtë shtetit, angazhohen shërbimet policore kombëtare të shteteve të ndryshme, të cilat mbasi bëjnë kapjen, koordinojnë me njëra-tjetrën nëpërmjet Interpolit, për t'u siguruar lidhur me identifikimin e plotë të personit dhe përcjelljen e dokumentacionit të nevojshëm, me qëllim që të realizojnë ekstradimin e tyre në vendin, që e ka shpallur në kërkim. Nëpërmjet marrëveshjeve bilaterale dhe multilaterale, shtetet kanë arritur të bëhen ndikuese pozitive në nxitjen e frymës së bashkëpunimit në fushën penale. Një nga instrumentet më efikas, që i shërben luftës ndaj kriminalitetit është ekstradimi.

Fjalët ky e: ekstradimi, marrëveshje bilaterale, marrëveshje multilaterale, kriminaliteti etj.

Abstract

Albania is a country with relatively high crime. By making an overall analysis regarding the capture of the perpetrators of criminal events, it turns out that some authors are caught in the act, immediately after the crime, some are identified late and realized their capture in flat or in places frequented by them, while the others flee abroad to avoid confrontation with the investigation. However, law enforcement, analyze evidence and evidence collected at the scene and on the basis of an investigation, as is done correctly identify the author or authors of the offense, seeking their detention and search related ad in national or international, to catching and stopping them. When there is information, that are overseas, undertake national police services of various countries, which do after catching coordinate with each other through Interpol, to ensure full on identification of the person and the transmission of documents necessary, in order to realize their extradition in the country, which is seeking. Through bilateral and multilateral agreements, states have managed to become influential in promoting positive spirit of cooperation in criminal matters. One of the most effective instruments that serve the fight against crime is extradition.

Key words: extradition, bilateral agreement, multilateral agreement, criminality etc.

Historik i shkurtër rreth ekstradimit

Fillimi i shekullit të XX u shoqërua me një zhvillim të vrullshëm ekonomik dhe shoqëror dhe kjo solli një lëvizje masive të njerëzve nga njëri vend në tjetrin. Në këto kushte ishte tepër evident fakti, se po përgatitej një terren i volitshëm për rritjen e kriminalitetit. Tashmë individët, që kryenin vepra penale duke përfituar nga parimi i sovranitetit dhe juridiksionit territorial mund të largoheshin nga shteti ku e kishin kryer veprën penale për në një shtet tjetër me të cilin shteti i tyre ose shteti ku kishin ndërmarrë sjelljen kriminale nuk kishin një marrëveshje ekstradimi. Në këtë mënyrë, këta individë arrinin të shmangnin përgjegjësinë penale.

Megjithatë disa shtete evropiane kishin marrë masa qysh në shekullin XIX duke nënshkruar traktate të ndihmës së ndërsjelltë juridike në fushën penale dhe veçanërisht traktate ekstradimi. Në këtë kontekst na rezulton, se traktati më i hershëm është ai i ekstradimit dhe ndihmës së ndërsjelltë juridike në fushën penale mes Italisë dhe Monakos, që daton më 19.05.1866. Ndërsa, traktati¹, mes Italisë dhe Salvadorit i datës 21.09.1872 parashikonte një rregullim specifik për çështjet e ekstradimit të personave.

¹Traktati mes Italisë dhe Salvadorit i datës 21.09.1872.

E veçanta e këtyre traktateve qëndron në faktin, se udhëhiqeshin nga parimi i reciprocitetit. Por, problemi lindte kur shteti kërkues nuk ishte në gjëndje të përmbushte parimin e reciprocitetit. Evidentojmë këtu, se Belgjika është vendi i parë, që me ligjin mbi ekstradimet të vitit 1833 parashikonte klauzolën e reciprocitetit, si kusht për lejimin e ekstradimit në mungesë të marrëveshjes. Ky parim parasheh rëndësinë e tij, që Evropa pikërisht mbi besimin reciprok kërkon të ndërtojë një hapësirë lirie, sigurie dhe drejtësie.

Lufta e Dytë Botërore kishte marrë fund dhe përpara shteteve viheshin detyra të rëndësishme për zgjidhje, sigurisht kujdes i veçantë i duhej kushtuar edhe luftës kundër krimit. Në këto kushte nisi të merrte jetë një formë më e sofistikuar bashkëpunimi ndërmjet shteteve, u krijuan organizata të rëndësishme veprimtaria e të cilave i shtriu efektet e veta edhe në adaptimin e zgjidhjeve efikase në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar për çështjet penale. OKB e krijuar fill pas Luftës së Dytë Botërore për të ruajtur paqen dhe sigurinë në botë, nxori një sërë aktesh të rëndësishme edhe në lidhje me bashkëpunimin ndërmjet shteteve në fushën penale.

Përmendim këtu një sërë aktesh, të cilat specifikonin në përmbajtjen e tyre një sërë rregullash të rëndësishme në lidhje me bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën penale si: Traktati model² për ekstradimet i miratuar me rezolutën 40/32 më 29.11.1985 nga Asambleja e Përgjithshme, kujtojmë këtu se përpara këtij traktati të rëndësishëm OKB miratoi dhe një sërë konventash në fushën penale³: "Konventa për parandalimin e krimit të genocidit" 1948, Konventa miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së me rezolutën 23/91 në vitin 1968 "Mbi mosparashikimin e krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit", "Parimet e bashkëpunimit ndërkombëtar lidhur me zbulimin, arrestimin, ekstradimin dhe ndëshkimin e individëve fajtor për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit", etj.

Krijimi i Këshillit të Evropës më 05.05.1949 shënoi një hap të rëndësishëm në përforcimin e bashkëpunimit ndërmjet shteteve evropiane. Këshilli i Evropës i dha një shtysë të fuqishme bashkëpunimit në fushën penale ndërmjet shteteve evropiane nëpërmjet miratimit të dokumenteve të rëndësishme në këtë fushë, përmendim këtu: Konventën "Për ekstradimet" të vitit 1957 dhe dy protokollet e saj shtesë përkatësisht të vitit 1957 dhe 1978, Konventën "Për transferimin e procedimeve në fushën penale", Konventën Evropiane "Për shtypjen e terrorizmit", etj.

Në lidhje me legjislacionin shqiptar, mund të themi se në etapa të ndryshme ka mbajtur një qëndrim pro bashkëpunimit ndërkombëtar dhe sidomos në fushën penale, ku ky bashkëpunim është i domosdoshëm. Në lidhje me ekstradimin mund të themi se, qysh në legjislacionin e Ahmet Zogut parashikohej një

²Rezoluta 40/32 me 29.11.1985 nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së.

³Konventa e OKB, e datës 09.12.1948 "Për parandalimin e krimit të genocidit".

rregullim ligjor në lidhje me aplikimin e ekstradimit. Kështu në vitin 1926 ka lidhur traktate ekstradimi me Britaninë e Madhe dhe me Kroacinë, ku këto traktate përcaktonin rregulla të detyrueshme mes Shqipërisë dhe këtyre shteteve në fushën e ekstradimeve. Në vitin 1933 Mbretëria Shqiptare lidhi një traktat ekstradimi me SHBA-në, rëndësia e të cilit u evidentua deri në ditët e sotme.

Nëpërmjet këtij traktati, vendi ynë i shtriu marrëdhëniet e bashkëpunimit përtej kontinentit evropian, që dëshmonte veç të tjerash edhe për marrëdhëniet e mira, që ekzistonin mes dy vendeve në këtë periudhë. E veçanta e këtij traktati qëndronte në faktin, se për herë të parë në historinë e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën penale parashikohej lejimi i ekstradimit të shtetasve shqiptarë në Amerikë dhe anasjelltas (pra i shtetasve amerikanë në Shqipëri). Pas Luftës së II Botërore, Republika e Shqipërisë lidhi të tjera marrëveshje në fushën penale ku përmenden; marrëveshja për ekstradimin dhe ndihmën e ndërsjelltë në fushën penale me Çekoslovakinë e vitit 1959 dhe ajo me Hungarinë e vitit 1960, por zhvillimet e mëvonshme politike bënë, që Republika e Shqipërisë të hiqte dorë nga këto marrëveshje. Shqipëria totalitariste kishte si prioritet të saj bashkëpunimin në arenën ndërkombëtare.

Miratimi i Kodit Penal dhe i Kodit të Procedurës Penale përkatësisht në vitin 1994 dhe 1995 shënuan një hap të rëndësishëm në rrugën e gjatë, që sapo kishte nisur vendi. Kështu neni 11 i Kodit Penal parashikon njohjen e ekstradimit, si formë e rëndësishme e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën penale, ndërsa K.Pr.P në një titull të veçantë parashikon format e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën penale ku ekstradimi zë një vend të veçantë (ekstradimi në K.Pr.P është parashikuar nga neni 488 deri tek neni 505).

Pas viteve '90 Republika e Shqipërisë është bërë palë kontraktuese në Konventën për Ekstradimet⁴ dhe dy protokollet e saj shtesë, ratifikuar me ligjin nr. 8322, datë 02.04.1998 duke e shndërruar këtë konventë në pjesë të pandashme të sistemit juridik të brendshëm dhe njëkohësisht duke marrë përsipër të drejtat dhe detyrimet, që kjo konventë ka parashikuar. Gjithashtu, RSH numëron një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh dypalëshe në fushën e ekstradimeve⁵. Duhet nënvizuar fakti, që vetëm në dy marrëveshje bilaterale, atë me SHBA-në (01.03.1933) dhe atë me Italinë⁶ ratifikuar me ligjin nr. 9871 (11.02.2008), Republika e Shqipërisë ka pranuar të lejoj ekstradimin pasiv të shtetasve të saj në kushtet e reciprocitetit.

⁴Kërkesa për ekstradim bëhet nga një shtet, që është anëtar i Këshillit të Evropës, por jo i Bashkimit Evropian. Mund të jetë, gjithashtu një shtet joevropian.

⁵Marrëveshje bilaterale e RSH me SHBA-në e datës 01.03.1933.

⁶Marrëveshje bilaterale e RSH me Italinë, ratifikuar me ligjin nr. 9871, datë 11.02.2008.

Aktualisht, Republika e Shqipërisë është palë kontraktuese në një numër të madh konventash të cilat rregullojnë sfera të rëndësishme në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar për çështjet penale, ku këto të fundit kanë parashikuar edhe rastet dhe mënyrat e ekstradimit për lloje të caktuara të veprave penale, përmendim këtu: Konventën "Për ndihmën e ndërsjelltë juridike në fushën penale", Konventën ndërkombëtare "Për luftën kundër financimit të terrorizmit", Konventën "Për transferimin e procedimeve në fushën penale", Konventa "Për parandalimin dhe ndjekjen e krimit të genocidit", etj. Kështu, Republika e Shqipërisë i është përgjigjur denjësisht frymës së bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën penale dhe në veçanti, për sa i përket ekstradimit.

Sipas legjislacionit shqiptar ekstradimi është një instrument i rëndësishëm dhe tradicional i bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën penale, i cili konsiston në dorëzimin e një personi nga shteti në të cilin gjendet në shtetin tjetër, që duhet ta gjykojë ose për ekzekutimin e një dënimi tashmë të dhënë. Pra, kemi në rastin e parë ekstradimin njohës, ku dorëzimi i personit bëhet me qëllim, që të vihet përpara organeve të drejtësisë të vendit, që e kërkon. Ndërsa, në rastin e dytë kemi të ashtuquajturin ekstradim ekzekutiv, ku ekstradimi konsiston në faktin, që personi që kërkohet të ekstradohet është gjykuar tashmë dhe dënimin, që rrjedh nga ky gjykim kërkohet ta vuaj në territorin e shtetit, që kërkon ekstradimin.

Llojet e ekstradimit

Legjislacioni ynë në përputhje të plotë edhe me aktet më të rëndësishme ndërkombëtare në lidhje me ekstradimin ka parashikuar dy forma ose lloje të ekstradimit:

- Ekstradimi aktiv
- Ekstradimi pasiv

Në kuadrin e ekstradimit aktiv⁷ evidentojmë, se Republika e Shqipërisë ka nisur aktualisht disa kërkesa ekstradimi shoqëruar me dosjet përkatëse, nëpërmjet të cilave kërkohen të ekstradohen kriminel të rrezikshëm, të cilët janë arrestuar në vendin në të cilin ndodhen, dhe janë në pritje të vendimit të gjykatës kompetente, e cila ka të drejtë të vendos mbi bazën e provave të paraqitura nga shteti shqiptar. Duhet thënë, se në jo pak raste ka dështuar përpjekja e autoriteteve shqiptare për ekstradimin e shtetasve të saj nga jashtë shtetit, për shkak të mangësive të dosjes së dërguar për ekstradimin e këtyre shtetasve të ndodhur jashtë kufijve të territorit shqiptar. Megjithatë, në mjaft raste autoritetet kompetente shqiptare kanë treguar vendosmëri dhe seriozitet në ndjekjen e procedurave për ekstradimin e të shumëkërkuarve nga drejtësia

⁷Neni 504-505 i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë.

shqiptare, ku ka rezultuar e suksesshme iniciativa për ekstradimin e këtyre shtetasve.

Pra, mund të ndodhë që një shtetas shqiptarë, pasi kryen një vepër penale në territorin shqiptar dhe shkon në një shtet tjetër për t'i shpëtuar ndjekjes penale. Më parë nuk ka pasur asnjë rregullim ligjor procedural për zgjidhjen e këtij problemi, një situatë e tillë sot zgjidhet nëpërmjet rrugës së ekstradimit nga jashtë shtetit, pra nëpërmjet kërkesës, që i bëhet shtetit të huaj ku ndodhet personi, që ka kryer një vepër penale brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe që duhet të përgjigjet për të sipas ligjit shqiptar. Është Ministria e Drejtësisë, e cila autorizohet sipas ligjit t'i drejtojë një kërkesë për ekstradim autoritetit kompetent të shtetit të huaj ku ndodhet personi i kërkuar. Ajo e bën këtë kur ka një kërkesë paraprake nga prokurori pranë gjykatës në të cilën kërkohet të procedohet ose është dhënë vendimi.

Kërkesës duhet t'i bashkëngjitet tërë dokumentacioni, që nevojitet për një kërkesë ekstradimi për jashtë shtetit, si dhe dokumentacioni shtesë që mund të kërkohet nga autoritetet e huaja. Kështu, autoritetet kompetente të huaja mund të vendosin pro ose kundër dhënies së ekstradimit të kërkuar nga autoritetet kompetente shqiptare. Mund të ndodhë, që shteti i huaj pranon të ekstradojë personin e kërkuar, por për këtë vendos disa kushte, në një rast të tillë është Ministria e Drejtësisë, ajo që i pranon ose jo ato.

Nëse pranon ekstradimin me kushtet e vëna atëherë prokuroria dhe gjykata janë të detyruara të respektojnë kushtin e pranuar. Në praktikën tonë gjyqësore të bashkëpunimit në fushën penale me autoritetet e huaja janë mjaft raste kur, me kërkesë të Ministrisë së Drejtësisë është bërë i mundur dorëzimi me anë ekstradimi të shtetasve shqiptar të cilët, pasi kanë kryer vepra penale në Shqipëri janë larguar në vende të tjera duke qënë se qëllimi i bashkëpunimit penal është vënia përpara përgjegjësisë të personave, që kryejnë vepra penale kudo që ata ndodhen, nëpërmjet ekstradimeve është bërë e mundur, që këta persona të procedohen penalisht apo të vuajnë një dënim me burgim të formës së prerë të dhënë nga gjykatat shqiptare. Kështu, legjislacioni ynë në përputhje me dokumentet e rëndësishme ndërkombëtare ka parashikuar mënyrën e rregullimit të ekstradimit duke pasur, si qëllim avancimin e mëtejshëm të bashkëpunimit në këtë fushë.

Ndërsa, ekstradimi pasiv⁸ ka të bëjë me dorëzimin e personit të kërkuar nga shteti shqiptar në territorin e të cilit ndodhet, drejt shtetit të huaj në territorin e të cilit personi i kërkuar ka kryer veprën penale. Ky dorëzim përbën edhe objektin e kërkesës për ekstradim të bërë nga shteti i huaj drejt shtetit shqiptar. K.P. dhe K.Pr.P kanë rregulluar në mënyrë të hollësishme ekstradimin pasiv.

Aspekte procedurale në lidhje me ekstradimin pasiv

⁸Neni 488-503 i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë.

Në lidhje me procedurat, që duhen ndjekur legjislativoni në fuqi është përshtatur më së miri me ndryshimet për shkak, se RSH ka nënshkruar Konventën për Ekstradim dhe dy Protokollet e saj shtesë dhe disa marrëveshje bashkëpunimi në fushën penale dhe veçanërisht në lidhje me ekstradimet. Kështu, Kodi i Procedurës Penale ka parashikuar një tërësi rregullash, që janë të domosdoshme të respektohen në çdo rast kur një shtet tjetër mbi bazën e një marrëveshjeje i kërkon shtetit shqiptar ekstradimin e një personi, që ndodhet në territorin e RSH. Në vijim, po paraqesim aspektet procedurale të parashikuara nga K.Pr.P në kuadrin e ekstradimit pasiv.

Në kontekstin e lartpërmendur neni 489 parashikon⁹:

1. Ekstradimi lejohet vetëm mbi bazën e një kërkesë drejtuar Ministrisë së Drejtësisë.
2. Kërkesës për ekstradim i bashkëngjiten:
 - a) Kopja e vendimit të dënimit me burgim ose e aktit të procedimit;
 - b) Një relacion mbi veprën penale, që i ngarkohet personit për të cilin kërkohet ekstradimi duke kërkuar kohën dhe vendin e kryerjes së veprës penale dhe cilësimin ligjor të saj;
 - c) Teksti i dispozitave ligjore, që do të zbatohen duke treguar nëse për veprën për të cilën kërkohet ekstradimi është parashikuar nga ligji i shtetit të huaj dënimi me vdekje;
 - d) Të dhënat individuale dhe çdo informacion tjetër të mundshëm, që shërben për të përcaktuar identitetin dhe shtetësinë e personit, për të cilin kërkohet ekstradimi.

3. Kur konkurrojnë disa kërkesa ekstradimi, Ministria e Drejtësisë cakton radhën e shqyrtimit. Për këtë qëllim, ajo mban parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe veçanërisht datën e marrjes së kërkesës, rëndësinë dhe vendin e kryerjes së veprës penale ose shtetësinë dhe vendbanimin e personit të kërkuar, si dhe mundësinë e riekstradimit nga shteti kërkuar.

4. Në qoftë se për një shkelje të vetme, ekstradimi kërkohet në të njëjtën kohë nga shumë shtete ai i jepet shtetit ndaj të cilit është drejtuar vepra penale ose atij shteti mbi territorin e të cilit është kryer vepra. Në paragrafin 1 parashikohet shprehimisht, se kërkesa duhet t'i drejtohet autoritetit kompetent që në përputhje me Konventën për Ekstradim¹⁰ është Ministria e Drejtësisë.

Paragrafi 2 parashikon, se çfarë duhet të përmbajë kërkesa për ekstradim ku përfshihen: kopja e vendimit, relacioni shpjegues, teksti i dispozitës, që do të zbatohet. Këtu, vlen të theksohet fakti nëse legjislativoni i shtetit kërkuar parashikon, si dënim për veprën penale për të cilën kërkohet ekstradimi

⁹Neni 489 i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë.

¹⁰Përveç rasteve, kur mendon se kushtet e ekstradimit nuk janë plotësuar, shteti i kërkuar duhet ta dorëzojë individin.

dënimin me vdekje. Në një rast të tillë, ekstradimi nuk mund të lejohet, pasi legjislacioni ynë nuk e njeh aktualisht dënimin me vdekje dhe për faktin, se kjo do të binte në kundërshtim me nenin 2 të KEDNJ-së, duke qenë se Shqipëria e ka ratifikuar këtë konventë. Lejimi i ekstradimit në kushtet kur personi i ekstraduar mund të dënohet me vdekje do të përbënte shkelje të nenit 2 të KEDNJ, e drejta për jetën dhe e Protokollit nr. 6 të kësaj Konvente.¹¹

Shqipëria e ka ratifikuar protokollin nr. 6 duke hequr përfundimisht dënimin me vdekje, prandaj dhënia e ekstradimit për një vepër penale, që mund të dënohet me vdekje në shtetin kërkues do të ishte e pajustificueshme dhe sigurisht në kundërshtim me detyrimet e marra përsipër nga ratifikimi i KEDNJ-së. Kërkesa duhet të përmbajë, gjithashtu të dhënat individuale dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm në lidhje me personin, për të cilin kërkohet ekstradimi. Në paragrafin 3 është parashikuar, se si veprohet kur konkurrojnë disa kërkesa ekstradimi, cila është radha e shqyrtimit, duke i njohur kompetencën Ministrisë së Drejtësisë të vendosë mbi bazën e vlerësimit të rrethanave. Në paragrafin 4, ky nen shprehet në lidhje me kërkesat e njëkohshme nga shumë shtete dhe specifikon, se në një rast të tillë ka dy mënyra zgjidhjeje, ekstradimi i jepet shtetit ndaj të cilit është drejtuar vepra penale ose shtetit mbi territorin e të cilit është kryer vepra penale.

Kjo mënyrë zgjidhjeje e problemit, mendoj se është mjaft e drejtë pasi është krejt normale, që ekstradimi t'i jepet shtetit, që ka qenë më tepër i ekspozuar ndaj rrezikshmërisë së veprës penale për të cilën kërkohet ekstradimi. Ky dokumentacion është i nevojshëm për efekt procedural, pa të cilin nuk mund të lejohet ekstradimi, por sigurisht edhe për të verifikuar në mënyrë të qartë nëse ekzistojnë ose jo kushtet, që parashikon legjislacioni shqiptar për lejimin e ekstradimit. Në lidhje me aspektet procedurale mund të themi, se përveç plotësimit të të gjitha kriterëve, që parashikon legjislacioni ynë duhen ndjekur edhe të gjitha procedurat e domosdoshme në lidhje me lejimin ose jo të ekstradimit të një shtetasi të huaj në territorin e RSH.

Kushtet e ekstradimit, ose rregulla të specialitetit

Kushtet e ekstradimit ose rregullat e specialitetit, si citohen nga Konventa Evropiane për Ekstradim janë parashikuar në nenet 490 e 491 të K.Pr.P dhe renditen, si më poshtë:

1.Në rastin e një kërkesë për ekstradim shteti kërkues duhet të garantoj

¹¹Neni 1, Protokollin nr. 6, Konventa Evropiane "Për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut", ka hyrë në fuqi 03.09.1953. Neni 1 i protokollit nr. 6 parashikon heqjen e dënimit me vdekje dhe neni 1 parashikon dënimin me vdekje vetëm në kohë lufte.

kushtin, se personi i ekstraduar nuk do të procedohet, nuk do të dënohet me qëllim për ekzekutimin e një vendimi dënimi ose mase sigurimi dhe as nuk do t'u nënshtrohet kufizimeve të tjera individuale për një vepër tjetër tej asaj për të cilën jepet ekstradimi.

Megjithatë, nga kushti i lartpërmendur janë parashikuar dy përjashtime¹²:

a. Kur pala dorëzuese jep pëlqim të shprehur, që i ekstraduari të ndiqet edhe për një vepër penale tjetër dhe i ekstraduari nuk ka kundërshtim. Kujtojmë këtu, se jo vetëm pala dorëzuese duhet të jap pëlqimin e shprehur, por edhe marrja e pëlqimit të të ekstraduarit është e domosdoshme, pasi në rast se ky i fundit nuk është dakord atëherë ekstradimi vlen vetëm për atë vepër penale për të cilën është dhënë ekstradimi, që në fillim.

b. Kur i ekstraduari edhe pse ka patur mundësi, nuk ka lënë territorin e shtetit të cilit i është dorëzuar, pasi kanë kaluar 45 ditë nga lirimi i tij, ose pasi e ka lënë atë është kthyer vullnetarisht. Pra, personi është liruar dhe pas lirimit të tij ka vazhduar të qëndrojë në territorin e shtetit ku ka vuajtur dënimin pasi është ekstraduar, duke patur mundësi reale të lërë territorin e shtetit të cilit i është dorëzuar, ose në rastin tjetër personi është larguar nga territori i shtetit të cilit i ishte dorëzuar, por në një moment të dytë ai është rikthyer.

2. Neni 2 i Konventës "Për ekstradimin", që sigurisht është në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar parashikon, se ekstradimi nuk jepet kur vepra penale për të cilën personi kërkohet të ekstradohet nuk parashikohet, si e tillë nga legjislacioni i shtetit të kërkuar.

3. Ekstradimi nuk mund të lejohet për një vepër penale me karakter politik ose kur rezulton, se ai kërkohet për qëllime politike.

4. Ekstradimi nuk mund të kërkohet kur ka arsye të mendohet se personi që kërkohet, do t'i nënshtrohet persekutimeve ose diskriminimeve për shkak të racës, fesë, seksit, shtetësisë, gjuhës, bindjeve politike, gjendjes personale apo shoqërore ose dënimeve a trajtimeve çnjerëzore, a poshtëruese ose veprime, që përbëjnë shkelje të një të drejte themelore të njeriut.

5. Ekstradimi nuk mund të lejohet, kur personi që kërkohet ka kryer një vepër penale në Shqipëri.

6. Ekstradimi nuk mund të lejohet, kur ka filluar procedimi ose është gjykuar në Shqipëri edhe pse vepra është kryer jashtë shtetit.

7. Ekstradimi nuk mund të lejohet, kur për veprën penale është dhënë amnisti nga shteti shqiptar.

Dhënia e amnistisë konsiston në faljen e dënimit për kryerësit e një kategorie

¹²Neni 490/2 i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë.

të caktuar veprash penale, kjo kategori veprash specifikohet në çdo rast në ligjin, nëpërmjet të cilit jepet amnistia. Ndaj do ishte krejt e papranueshme lejimi i ekstradimit për një vepër penale, për të cilën është dhënë amnisti nga autoritetet vendase.

8. Ekstradimi nuk lejohet kur është parashkruar ndjekja penale ose dënimi sipas shtetit, që e kërkon.

Ky ndalim është në përputhje të plotë me kushtin bazë për aplikimin e ekstradimit, që është dënueshmëria e dyfishtë e veprës penale. Pasi, parashtruam tërësinë e atyre rregullave, që duhen respektuar në çdo procedurë ekstradimi, mund të themi se respektimi me rigorozitet i tyre është kusht i domosdoshëm, që ekstradimi si një instrument i veçantë i bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën penale t'i shërbej me efektivitet luftës kundër kriminalitetit.

Marrëveshjet multilaterale në të cilat RSH është palë

Në kuadrin e dokumenteve të rëndësishëm, në të cilën RSH është palë mund të përmendim Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, e cila ka si qëllim të saj mbrojtjen ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Por, duke qenë se ekstradimi duhet të realizohet në respekt të plotë të të drejtave të njeriut të parashikuara në këtë konventë mund të themi, se rëndësia e kësaj konvente është tepër e madhe. Përveç kësaj konventa ka parashikuar në nenin 3 ndalimin e torturës ku thuhet: *"Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, as dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese"*.

Kështu, nga interpretimi i zgjeruar i këtij neni rezulton, se në rastin kur personi, që kërkohet të ekstradohet rrezikohet realisht, që në vendin në të cilin kërkohet të ekstradohet t'i nënshtrohet torturës dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese. Pra, thjesht ekzistenca e rrezikut për një trajtim të tillë ndaj personit, që kërkohet të ekstradohet, i jep këtij të fundit të drejtën t'i drejtohet Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut duke e mbështetur pretendimin e tij pikërisht në parashikimin, që bën neni i lartpërmendur. Kështu, çdo shtet në momentin kur i paraqitet një kërkesë ekstradimi përpara lejimit të ekstradimit duhet, jo vetëm të respektojë të gjitha rregullat e parashikuara nga legjislacioni i tij në lidhje me ekstradimet, por duhet gjithashtu të evidentojë nëse ka vend të diskutohet për shkelje të nenit 3 të KEDNJ-së. Pa harruar, sigurisht, se ndjekja e procedurave të ekstradimit duhet të zhvillohet në përmbushje dhe në respekt të plotë me të drejtat e njeriut.

Një konventë shumë e rëndësishme e ratifikuar nga RSH është Konventa e Këshillit të Evropës "Për shtypjen e terrorizmit". Kjo konventë merr një rëndësi të veçantë në ditët e sotme duke patur parasysht, se terrorizmi po shndërrohet dita ditës në një armik potencial kundër njerëzimit. Nëse, botës iu desh të përballonte dy luftëra botërore, tashmë nevojitet bashkimi i forcave në

luftë kundër një armiku të përbashkët terrorizmit. Ndaj në ditët e sotme luftës ndaj terrorizmit, po i kushtohet rëndësi gjithnjë e më e madhe. Vendi ynë i vetëdijshëm, se terrorizmi po bëhet gjithnjë e më tepër një e keqe e madhe për mbarë njerëzimin është bërë tashmë pjesë e nismave ndërkombëtare për të luftuar me efikasitet çdo shfaqje të tij, duke ratifikuar me ligj Konventën Evropiane "Për shtypjen e terrorizmit".¹³

Marrëveshjet bilaterale në të cilat RSH është palë

Për vetë rëndësinë që marrin këto marrëveshje do të bëjmë një pasqyrim të detajuar dhe analitik të tyre. Kështu, për vite të tëra e vetmja marrëveshje nëpërmjet së cilës Republika e Shqipërisë pranonte ekstradimin e shtetasve të vet për jashtë shtetit ka qenë traktati i ekstradimit me SH.B.A-në, e ratifikuar me 1 mars të vitit 1933. Për vetë kohën kur u nënshkrua ky traktat ishte një arritje e madhe, pasi realizimi i një marrëveshje të tillë dëshmonte pikësëpari për marrëdhëniet shumë të mira, që ekzistonin midis dy vendeve, nga njëra anë Shqipëria një shtet i vogël e nga ana tjetër një nga superfuqitë e botës SHBA. Për të evidentuar rëndësinë e kësaj marrëveshje mjafton të përmendësh faktin, se kanë kaluar shumë vjet nga ratifikimi i saj dhe vazhdon t'i shërbej ende qëllimit për të cilin u nënshkrua vite më parë.¹⁴

Ekziston një mendim i përgjithshëm, se ky traktat duhet modifikuar. Personalisht mendoj, se ky traktat duhet të modifikohet për shkak, se rrethanat tashmë kanë ndryshuar në përmasa tepër të mëdha në krahasim me kohën e ratifikimit të tij, por ky ndryshim nuk duhet të cenoj thelbin e traktatit. Mendoj se, është koha ndoshta më tepër për modernizimin e këtij instrumenti kaq të rëndësishëm, që ka vazhduar të jetë efektiv për një kohë të gjatë. Hyrja e traktatit ka parashikuar, se RSH dhe SHBA janë të gatshme të bashkëpunojnë ndërmjet tyre në fushën e ekstradimeve. Po pasqyroj disa nga artikujt më të rëndësishëm të kësaj marrëveshje:

Artikulli 3 ka parashikuar, se dispozitat e këtij traktati nuk japin të drejtë të kërkohet ekstradimi për ndonjë çështje me karakter politik.

Ky artikull parashikon gjithashtu se:

" Shteti prej të cilit kërkohet ekstradimi ose gjykatat e këtij shteti, do të vendosin nëse çështja ka karakter politik".

Artikulli 4 ka parashikuar se:

¹³Ligji nr. 8642, datë 13. 07. 2000 për ratifikimin e Konventës Evropiane "Për shtypjen e terrorizmit".

¹⁴Halim Hasalami, Artan Hoxha, Ilir Panda: "Procedura Penale", Shtëpia Botuese "MORAVA", Tiranë 2006, faqe 661-662.

"...Askush nuk do të gjykohet për ndonjë delikt të kryer përpara ekstradimit të tij, veçse për deliktin për të cilin është dorëzuar, ose rastit kur ky ka qenë i lirë për një muaj rresht të dalë jashtë shtetit pasi të ketë qenë gjykuar, ose në rast dënimi, të ketë vuajtur dënimin ose të jetë falur".

Parashikimi i bërë në këtë artikull lidhet drejtpërdrejt me njërin nga principet më të rëndësishëm të ekstradimit sipas të cilit personi i ekstraduar nuk duhet të gjykohet apo të dënohet për një vepër tjetër penale, përveç asaj për të cilën është dhënë ekstradimi.

Artikulli 7 parashikon se:

"...Kur një kriminel i arratisur, që reklamohet prej njëres nga dy palët e kësaj marrëveshjeje kërkohet edhe më shumë, se nga dy shtete në bazë të dispozitave të traktateve për delikte të kryer përbrenda juridiksioneve të tyre, ky kriminel do ti dorëzohet atij shteti, kërkesa e të cilit ka mbërritur e para, veç kur hiqet dorë nga kërkesa".

Ky artikull nuk do të cenojë traktatet, që janë lidhur qysh më parë prej njëres ose tjetres nga palët kontraktuese me shtetet e tjera. Sipas parashikimit, që bën ky artikull në rastin kur janë paraqitur disa kërkesa për ekstradimin e një kriminelit të arratisur, duhet të favorizohet kërkesa që është paraqitur më përpara në kohë, duke përjashtuar rastin kur hiqet dorë nga kërkesa. Mendoj se, ky artikull i ka dhënë një zgjidhje mjaft të drejtë situatës kur janë paraqitur disa kërkesa për ekstradimin e të njëjtit person, duke marrë parasysh faktin se të dyja shtetet palë në këtë traktat janë palë edhe në dokumente të tjera të rëndësishme në fushën e ekstradimeve, çka nënkupton se nuk mund të veprohet nëpërmjet preferencës në një rast të tillë.

Artikulli 12-të, në paragrafin e tij të parë parashikon *shtrirjen territoriale të këtij traktati*, duke nënvizuar, se ky traktat është njësoj i vlefshëm për tërë territorin mbi të cilin secili nga shtetet ka pushtet efektiv.

Në paragrafin e dytë ka parashikuar titullarin kompetent për të ngritur kërkesën për ekstradim kur personi, që kërkohet të ekstradohet ka statusin e të arratisurit nga drejtësia. Në një rast të tillë sipas parashikimit që bën ky artikull, ky titullar është një agjent diplomatik për secilin shtet, dhe në mungesë të tij kjo kërkesë mund të bëhet nga zyrtarët epror konsullor.

Në paragrafin e tretë të këtij artikulli është parashtruar, se arrestimi dhe dorëzimi i personit, që kërkohet të ekstradohet duhet të bëhet konform ligjit në fuqi në të dy vendet.

Paragrafi i katërt i po këtij artikulli parashikon si më poshtë:

"...Çdo i arrestuar përkohësisht do të lirohet, veç në rastin kur brenda dy muajve

nga data e arrestimit në Shqipëri ose në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kërkesa formale për dorëzim së bashku me dokumentet provuese të parashikuar këtu poshtë do të jenë paraqitur, sikundër përmendet këtu sipër prej agjentit diplomatik të qeverisë kërkuese ose në mungesë të tij, prej një nëpunësi konsullor të asaj qeverie".

Pra, siç shikohet në rastin e arrestimit të përkohshëm, secila palë e ndodhur në pozicionin e palës kërkuese duhet që brenda dy muajve t'i drejtoj shtetit të kërkuar kërkesën për ekstradim së bashku me dokumentet provuese, në të kundërt shteti i kërkuar liron personin e arrestuar përkohësisht.

Në paragrafin e pestë është parashikuar, se kur kriminelin i arratisur është dënuar për veprën penale për të cilën kërkohet ekstradimi duhet të paraqitet kopja autentike e vendimit të gjykatës, që ka caktuar këtë dënim, dhe në rastin kur personi, që kërkohet të ekstradohet është vetëm i akuzuar për një vepër penale, duhet të paraqitet një kopje autentike e mandatit të arrestit të shtetit, ku është kryer delikti së bashku me provat, që provojnë fajësinë e të arratisurit.

Artikulli 13-të, parashikon si më poshtë:

"...Ky traktat do të mbetet në fuqi për një periudhë prej pesë vjetësh dhe në rast se asnjëra nga palët e nalta kontraktuese nuk do të ketë njoftuar një vit përpara mbarimit t' kësaj periudhe qëllimin e vet për ti dhënë fund traktatit, ky do të vazhdojë të mbesë në fuqi deri në mbarimin e një viti prej datës në të cilën të jetë dhënë një njoftim i tillë prej njëres ose tjetrës nga palët e nalta kontraktuese.¹⁵

Ky artikull i fundit ka përcaktuar mënyrën e marrjes fund të këtij traktati. Kështu, ky artikull parashikon një afat pesë vjeçar brenda të cilit (një vit përpara mbarimit të kësaj periudhe) palët kontraktuese kanë të drejtë të parashitrojnë qëllimin e vet për t'i dhënë fund këtij traktati, nëse nuk e bëjnë një gjë të tillë ky traktat do të vazhdojë të mbetet në fuqi deri në mbarimin e një viti prej datës nga, e cila është dhënë njoftimi për dhënien fund të ekstradimit.

Realisht, siç parashtruar që në fillim një kërkesë e tillë (pra për dhënien fund të këtij traktati) nuk është bërë ende, ndaj ky traktat vazhdon të mbetet në fuqi midis shteteve kontraktuese. Personalisht, mendoj se nënshkrimi i këtij traktati ka qenë një hap tepër i rëndësishëm për kohën dhe këtë rëndësi e dëshmon shumë mirë jetëgjatësia e këtij traktati, por në të njëjtën kohë jam me idenë e pasurimit të këtij traktati me elementë të rinj.

¹⁵ Artikulli 2-13, Traktati i ekstradimit midis SH.B.A dhe R.SH, nënshkruar me 1 mars 1939

Marrëveshja për ekstradim me Republikën e Italisë

Marrëveshja për ekstradim me Italinë është marrëveshja e dytë nëpërmjet të cilës RSH pranon ekstradimin e shtetasve të saj mbi baza reciprociteti.¹⁶

Në preambulën e kësaj marrëveshje është shprehur qëllimi, që kanë palët dhe ky qëllim lidhet së pari, me lehtësimin e zbatimit dhe me plotësimin e konventës për ekstradimet.

Të dy shtetet kanë, si qëllim që të heqin dorë nga e drejta për të refuzuar dorëzimin e shtetasve respektivë siç parashikohet në nenin 6 paragrafi i "1" i Konventës Evropiane "Për ekstradimin".

Kështu në nenin 18 të kësaj marrëveshje me titull ekstradimet e shtetasve është parashikuar:

"...Palët kontraktuese marrin përsipër, në mënyrë të ndërsjellë, të dorëzojnë shtetasit e tyre që ndodhen në ndjekje penale nga njëra prej tyre për kryerjen e veprave penale ose që janë shpallur në kërkim për vuajtjen e dënimit apo të një mase shtrënguese, në përputhje me normat apo kërkesat e Konventës Evropiane "Për ekstradimin". Palët kontraktuese nuk mund të ngrenë shtetësinë si arsye për refuzimin e dorëzimit.¹⁷

Kërkesat për ekstradim bëhen drejtpërdrejt midis autoriteteve qëndrore. Për Republikën e Italisë nga Drejtoria e Përgjithshme e Drejtësisë Penale, zyra pranë Ministrisë së Drejtësisë; Për Republikën e Shqipërisë nga Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve të Drejtësisë.

Pra, në një dispozitë të vetme RSH dhe Republika e Italisë kanë parashikuar ekstradimin mbi baza reciprociteti të shtetasve të tyre, në përputhje me normat dhe kërkesat e Konventës Evropiane "Për Ekstradimet" duke specifikuar gjithashtu edhe organet kompetente për ndjekjen e procedurave. Kjo marrëveshje e ratifikuar kohët e fundit përbën mendoj një hap të rëndësishëm në funksion të luftës kundër krimit. Mendoj, se një marrëveshje e tillë ka qenë e nevojshme nisur nga fakti, se Shqipëria dhe Italia janë dy vende fqinjë dhe lufta kundër krimit, si një armik i përbashkët kërkon avancim të formave të bashkëpunimit dhe ky avancim mund të gjej shprehje në lejin e

¹⁶ Kjo marrëveshje është ratifikuar me **ligjin** nr. 9872, datë 11.02.2008, "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë, si shtesë e Konventës Evropiane për Ekstradimin, të 13 dhjetorit 1957, dhe Konventës Evropiane për Ndihmë Juridike për Çështjet Penale, 1959 dhe ka, si qëllim të lehtësojë zbatimin e tyre.

¹⁷Neni 6/1 i Konventës Evropiane "Për ekstradimin" ka parashikuar se shtetet ratifikuese kanë të drejtë të heqin dorë nga ekstradimi i shtetasve të tyre, duke iu lënë mundësi, që shtetet të mund të disponojnë mbi bazë reciprociteti.

ekstradimit reciprok të shtetasve të të dy vendeve midis të cilave ka patur dhe vazhdon të ketë raporte shumë të mira. Më vonë RSH ka nënshkruar një tjetër marrëveshje dypalëshe nëpërmjet të cilës pranon ekstradimin e shtetasve të saj mbi baza reciprociteti, kjo është marrëveshja e ekstradimit që është lidhur me Britaninë e Madhe.

Konkluzione

Si përfundim mund të themi, se ekstradimi si një nga format e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën penale gjen sot një rregullim ligjor të gjithanshëm dhe të detajuar dhe ky fakt i dedikohet më së shumti përpjekjeve ndërkombëtare për të luftuar me efikasitet krimin kudo. I parë, si një instrument efikas, ekstradimi nisi të shfaqej qysh në shekullin e XIX dhe procedurat e aplikimit të tij nisën të evoluonin së bashku me zhvillimin e shoqërisë duke iu përshtatur gjithnjë e më tepër nevojave adekuate të realitetit. Rol të madh e të pazëvendësueshëm në këtë drejtim kanë luajtur organizata të ndryshme ndërkombëtare duke filluar nga OKB, Këshilli i Evropës, BE etj.

Nismat e këtyre organizatave nuk do të mund të linin mënjane sistemin e drejtësisë penale, duke qënë se ky sistem ka lidhje të drejtpërdrejtë me të drejtat dhe liritë themelore. Ekstradimi u pa në këtë kontekst, si një instrument efikas me qëllim, që çdo fajtor të vihet përpara përgjegjësisë penale. Siç, parashtruam edhe gjatë punimit ekstradimi parashikohet, si një instrument efikas i bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën penale midis shteteve dhe ku këto të fundit janë treguar kurdoherë të gatshme t'i përgjigjen frymës së bashkëpunimit në funksion të mbrojtjes së interesave më të larta, të cilat mund të vihen në rrezik në çdo moment, nga çdo shfaqje e pakontrolluar e krimit.

Miratimi i konventës "Për ekstradimin" dhe i dy protokolleve të saj shtesë shënon një hap të rëndësishëm në rrugën pa kthim për avancimin e përpjekjeve për të luftuar krimin në funksion të mbrojtjes së vlerave më të larta të shoqërisë. Shtetet evropiane janë treguar të gatshme ta bëjnë pjesë të sistemit të tyre të brendshëm këtë konventë duke marrë përsipër të drejtat dhe detyrimet e saj. Bashkimi Evropian gjithashtu në kuadër të kolonës së tretë të traktatit mbi themelimin e tij ka paraparë rëndësinë e konventës së lartpërmendur për rregullimin e ekstradimit midis shteteve anëtare të BE ku është parë e arsyeshme të miratohet një konventë, si shtesë e konventës së Këshillit të Evropës dhe që ka për qëllim thjeshtëzimin dhe modernizimin e kësaj të fundit. Shtete të ndryshme të botës, përveç angazhimit shumëpalësh janë angazhuar edhe nëpërmjet marrëveshjeve dypalëshe të adaptojnë zgjidhje sa me të efektshme në lidhje me aplikimin e ekstradimit në praktikë.

Bibliografia

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
 - Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, miratuar me Ligjin nr. 7895, datë 27. 01.1995, i ndryshuar me Ligjin nr. 9188, datë 12. 02. 2004, dhe shtuar me Ligjin nr. 10023, datë 27. 11.2008.
 - Kodi i Procedurës Penale, të Republikës së Shqipërisë, miratuar me Ligjin nr. 7905, datë 21. 03. 1995, i ndryshuar me ligjin nr. 9276, datë 16. 09. 2004.
 - Konventa Evropiane "Për ekstradimin" dhe dy protokollet e saj shtesë. Këshilli i Evropës, viti 1957, ratifikuar me Ligjin nr. 8322, datë 02. 04. 1998.
 - Ligji nr. 8427, datë 14. 12. 1998 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Organizatën Ndërkombëtare të Policisë Kriminale – INTERPOL."
 - Dokumentet themelore të Interpolit:
 - Rregullorja e Përgjithshme,
 - Standardet e funksionimit të zyrave qendrore kombëtare.
 - Rregullorja "Mbi bashkëpunimin ndërkombëtar dhe kontrollin e arkivave të Interpolit."
 - Ligji nr. 10193, datë 03. 12. 2009 "Për marrëdhëniet juridikionale me autoritetet e huaja në çështjet penale".
 - Dr. Hasan Shkëmbi, "Bashkëpunimi ndërkombëtar", Tiranë, 2006.
 - Konventa Evropiane "Për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut" dhe protokollet e saj shtesë, Këshilli i Evropës, nënshkruar në vitin 1950 dhe hyrë në fuqi në vitin 1953.
- Konventa Evropiane "Për shtypjen e terrorizmit", Këshilli i Evropës, Strasburg 27.01.1997.
- Konventa "Mbi mosparashkrimin e krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit", Asambleja e Përgjithshme, Rezoluta 34/19, viti 1968.
- Traktati i Ekstradimit ndërmjet SHBA-së dhe RSH, 01.03.1939.
- Marrëveshja e ekstradimit mes Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë, Tiranë 11.02.2008.
- Rezoluta 30/74, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, 03.12.1973.
- Halim Hasalami, Artan Hoxhaj, Ilir Panda, "E Drejta Procedurale Penale", komentar, Shtëpia Botuese "Morava", Tiranë 2006.

VLERESIMI POTENCIALEVE NATYRORO-GJEOTURISTIKE: GJEOPARQET DHE GJEOMONUMENTET GJEOLGJIKE TE RAJONIT TE VLORES

Msc. Ing. Ana QORRI¹

Prof.Dr. Çerçis DURMISHI²

Dr. Shkelqim DAJA³

¹ Fakulteti Gjeologjise dhe Minierave, Tirane, Shqiperi, ana.qorri@fgjm.edu .al

² Fakulteti Gjeologjise dhe Minierave, Tirane, Shqipe, cecodurmishi@yahoo.com

³ Fakulteti Gjeologjise dhe Minierave, Tirane, Shqiperi, daja_s@yahoo.com

Abstrakt

Fiziko-gjeografia, gjeomorfologjia dhe larmia e ekosistemeve aktuale te rajonit te Vlores, jane rezultat i evolucionit gjeologo-tektonike dhe neotektonike, qe prej 300 milion vjetesh e deri ne ditet e sotme. Historia gjeologjike e rajonit eshte e "stampuar" ne formacionet "shkembenjte", qe ndertojne relievin e ekosistemet natyrore te zones bregdetare te rajonit e me gjere. Keto "Gjurme te stampuara" perfaqesojne Gjeoparqet dhe Gjeomonumentet Natyrore Gjeologjike, qe bashkejetojne me potencialet e tjera natyrore dhe kane rendesi dhe vlera te shumefishta lokale, rajonale, regionale, kombetare dhe nderkombetare. Ne mbare boten, aktualisht egzistojne nje sere konventash, organizmash dhe legjislacione, per identifikimin, vleresimin, ruajtjen, konservimin dhe menazhimin e tyre, duke u konsideruar si pasuri natyrore "asete" te pa perseritshme me vlera per brezat e sotem te njerzimit dhe brezave qe do te vine nder shekuj (p.sh. sipas informacioneve gojore, nje nga Gjeomonumentet kombetare me vlera historike, arkeologjike, Gjeologjik ai i "Gjirit te Shkronjave (Grames), po shkaterohet, grabitet dhe "Guret e Shkruar" po shiten ne rruge klandestine jashte shtetit!!!). Gjeoparqet dhe Gjeomonumentet Natyrore Gjeologjike, keta deshmimtare te histories gjeologjike te nje rajoni, kane rendesi te spektrit strikt shkencor, shkencor, didaktike (nxenes, student), peizazhor dhe turistik. Gjeoparkun dhe

gjeomonumentet Gjeomorfolo-gjeologjike te formacionit molasik shkembore "Katastrofa Natyrore para 15-10 milion vjetesh" te rajonit te Vlores dhe "Perplasja" e dy zonave tektonike: Zona Jonike dhe Zona e Sazanit ne Qafen e Llogarase, e kane vizituar dhe hulmutuar (keto 20-30 vjetet e fundit) mbi 400-500 shkencetar, specialist dhe student te fushave te Gjeoshkencave nga Universitetet dhe institucionet shkencore te Europes dhe Botes. Ne kete artikull parqitet nje rivleresim i ri i vlerave te Gjeoparqeve dhe gjeomonumenteve me te rendesishem natyrore gjeologjik te rajonit te Vlores, te cilat duhet te terheqin vemendjen e pushtetit lokal dhe atij qendror, per ti inkuadruar ne propozime konkrete per vendim marrje dhe menazhim te integruar, konform eksperjencave te vendeve Europiane dhe Boterore.

Fjale Kyçe: Potencialeve natyrore - gjeoturistike, Gjeoparqet dhe Gjeomonumentet Natyrore Gjeologjike, Klasifikimi zonave te mbrojtura.


Hyrje

Vleresimi potencialeve natyrore-gjeoturistike te vendit tone, keto tre dekadat e fundit ka mare nje zhvillim te madh, nepermjet angazhimit te nje sere institucioneve shkencore dhe administrative ne rang lokal, rajonal, kombetar dhe nderkombetar. Ne baze te vleresimit te pasurive natyrore te Shqiperise, nje vend te rendesishem ne kete kuader zene gjeoparqet dhe gjeomonumentet gjeologjike, si deshmimtar te "Kujteses se Tokes" dhe formimit te "trojeve" te vendit tone me moshe gjeologjike nga 500milion vjet, deri ne ditet e soteme. Potenciali i pasurive natyrore te Shqiperise, i konturuar me fiziko-gjeografine dhe morfologjine aktuale, ne fakt eshte rezultat i evolucionit gjeologo-tektono-gjeomorfolo-gjeologjik i Albanideve per nje kohe 500milion vjeçare, evolucion i cili eshte edhe sot ne process, nepermjet levizjeve aktive neotektonike, proceseve te ngrohjes globale, ngritjes relative te nivelit te detit, proceseve sizmologjike (termeteve), etj.. "Deshmimtar", apo "gjurmimet" e histories se formimit te trojeve Shqiptare, ne sot (gjeologet) i gjejme te "stampuara" ne formacionet gjeologjike me karakter specifik dhe si pasuri natyrore, ato jane te paperseritshme. Gjeoparqet dhe gjeomonumentet gjeologjik te Shqiperise, si rezultat i nje sere studimesh, monografish, raportesh te kryera (per nje perjudhe gati 100vjeçare) nga potenciali i specialisteve Shqiptar dhe te huaj, jane te arshivuara ne arshiven e Sherbimit Gjeologjik Shqitar dhe ne nje sere botimesh kapitale te revistave te vendit dhe te huaja. Ne kete kuader edhe rajoni i Vlores, si rezultat i ndertimit te tij gjeologo-tektono-gjeomorfolo-gjeologjik me nje histori gjeologjike me moshe 300 milion vjeçare dhe fiziko-gjeografise aktuale, permban nje sere gjeoparqe dhe gjeomonumente gjeologjike me rendesi lokale, rajonale, kombetare dhe pse jo nderkombetare. Pavarsisht evidentimit dhe vlerave natyrore te gjeoparqeve dhe gjeomonumenteve gjeologjike nga ana e specialisteve te gjeoshkencave, aktualisht nga ana e institucioneve qendrore,


rajonale dhe lokale (duke patur parasysh eksperjencen Europiane dhe boterore), ngelet shume per tu bere ne drejtim te aspektit legjislativ, administrative, ruajtjes dhe menaxhimit, sensibilizimin, mediatizimit, si dhe krijimit te nje kulture te re tek brezat e komuniteteve njerzore.

I.Trashëgimia Gjeologjike dhe Gjeokonservimi.

Trashëgimia gjeologjike është një pjesë thelbësore e trashëgimisë botërore, sepse ajo përfaqëson një dosje unike të të gjithë historisë së evolucionit të planetit tonë, që nga krijimi i saj deri në ditët e sotme (Fig.1.). Evolucioni Tokës është e regjistruar në një numër të madh pjesëzash të shpërndara në të gjithë ruzullin tokësor. Ashtu si një mister, këto pjesëza vetëm formojnë një pamje koherente kur ato shihen të lidhura njëra me tjetrën. Vetëm një numër shumë i kufizuar i këtyre pjesëzave janë të arritshme për tu vëzhguar nga njeriu. Trashëgimia gjeologjike përfshin karakteristika të rëndësishme gjeologjike, relieve dhe peisazhet karakteristike që janë ruajtur për gamën e plotë të vlerave, duke përfshirë vlerat e tyre shkencore, estetike, vlerave kulturore, biodiversitetit të ekosistemeve, edukative , rekreative, turizmi, etj..



Zonat e Trashëgimisë gjeologjike ruhen në mënyrë që vlerat e tyre dhe bukurite perkatese do të mbetet si një trashëgimi për brezat e ardhshëm. Zona të tilla në përgjithësi kanë një potencial të madh për studime shkencore, per tu përdorur si auditore për studentët dhe nxënësit, në ajër të pastër në natyrë, si dhe rritjen e të kuptuarit publik dhe kënaqësive perkatese te komuniteteve dhe vlerave turistike qe ato permbajne. Zonat e trashëgimisë gjeologjike janë themelore për të kuptuar sistemet e dinamikës së tokës, vazhdimësisë dhe diversitetit të jetës, ndryshimeve klimaterike per nje kohe te gjate, evolucionin e peisazheve dhe origjinen e pasurive minerale.



Veprimtaria njerëzore në sipërfaqen e Tokës ka çuar në "shkatërrimin" e përshpejtuar të shumë pjesëve kyçe të të dhënave gjeologjike, në shumë vende Evropiane

dhe në botë. Ruajtja e pjesëve shkëmbore që ndodhen rreth nesh dhe nën "këmbët" tona është i nevojshëm për shkencat e tokës, për edukimin, c'lodhjen dhe zhvillimet gjeoturistike, kjo është një pjesë jetike e ruajtjes së natyrës. Disa vende kanë një histori mjaft të gjatë në ruajtjen e trashëgimisë Tokës (SHBA, Britania e Madhe, Franca, Gjermania, Australia, etj.), por ka shumë vende të tjerë ku idetë dhe gjeokonservimi, politikat e përpiluara dhe të zbatuara ende duhet të zhvillohen dhe të zbatohen. Ndonëse trashëgimia gjeologjike është përfshirë zakonisht në legjislacione dhe rregulloret perkatëse që kanë të bëjnë me hapësirat natyrore, kjo nuk është gjithmonë strategjia më e përshtatshme. Për shkak të natyrës së saj dhe faktit se ajo shpesh mishëron të dhënat e historisë gjeologjike, trashëgimia gjeologjike ka disa ngjashmëri ose mund të jetë e lidhur fort me trashëgiminë historiko-kulturore të një vendi. Trashëgimia gjeologjike, me shpesh është identifikuar me zbulimet dhe shfrytëzimin e pasurive minerale (p.sh. shfrytëzimet nentokesore dhe sipërfaqesore të venburimeve minerale), por nuk është vetëm kjo. Një ilustrim cilësor, duke përdorur një diagram tre këndor (Fig.2.) zbulon se trashëgimia gjeologjike nuk është e lidhur vetëm me aspektet natyrore dhe të virgjera, por që në të shumën e rasteve zonat me interesa gjeologjike mund të jenë të lidhur ngushtë me elemente historiko-kulturore dhe biodiversitetin e vendit ku ato ndodhen. Në sistemin e Parkut Kombëtar të Amerikës, një vend të rëndësishëm zënë edhe Zonat e trashëgimisë gjeologjike. Sistemi Parkut Kombëtar përmban 237 parqe me burimet fosile, 81 parqe me 3600 shpella të njohura, dhe 40 parqeve me sistemet ekosistemesive karstike të njohura, 97 parqe të mbrojtura dhe 7.500 kilometra të zonës bregdetare, 52 parqe që përmbajnë sistemet gjeotermale, 38

parqe kane vullkanet si një tipar kryesor, dhe 37 kanë karakteristika te akullnajave aktive. Parqet gjithashtu përmbajnë një shumëllojshmëri të madhe të relieveve, përfshirë dunat, harqet ishullor, kanione, gjire, dhe skarpta. Koleksionet muzeale të parqeve kanë më shumë se 35.000 mostra gjeologjike dhe gati 416.000 modeleve paleontologjike. Përveç këtyre burimeve gjeologjike, Shërbimi i Parkut është përgjegjës për administrimin e programit Kombëtar të Monumenteve Natyrore dhe Regjistrin Kombëtar të vendeve Historike, dhe siguron mbështetje për pjesëmarrjen amerikane në Konventën e Trashëgimisë Botërore. Secili prej këtyre programeve kontribuojë në ruajtjen e trashëgimisë gjeologjike amerikane.

I.1. Ruajtja e Natyres, kategorizimi dhe menaxhimi nderkombetar i zonave te mbrojtura.

Unioni nderkombetar i ruajtjes se Natyres (IUCN—International Union for the Conservation of Nature) ka klasifikuar kategorit e zonave te mbrojtura mbi bazen e objektivave te menaxhimit te tyre. Kategoritë janë të njohura nga organet ndërkombëtare si Kombet e Bashkuara, Inisiativa e UNESCO-se: Trashegimia boterore e zonave me interes gjeologjik (Unesco initiatives: World Heritage Sites of Geological Interest), Shoqata Europiane per ruajtjen e trashegimise gjeologjike (The European Association for the Conservation of Geological Heritage-PROGEO) dhe nga shumë vende jane hartuar legjislacione bazuar ne standartet boterore për përcaktimin dhe evidentimin e zonave të mbrojtura. Ne saj te Komisionit Botëror mbi zonat e mbrojtura (CMAP), IUCN ka dhënë udhëzimet ndërkombëtare për kategorizimin e Zonave të Mbrojtura për gati një çerek shekulli. Këto kategori janë të njohura ndërkombëtarisht dhe lehtësojë perdorimin e një sistem global për përcaktimin, klasifikimin dhe regjistrimin e zonave të mbrojtura dhe shumë llojshmërisë së gjerë të qëllimeve specifike qe ato mund të permbajne.


1.1. Kategorizimi i Rrjetit te Zonave te Mbrojtura sipas IUCN-se: *Kategoria I-Rezervat Strikt Natyror, KategoriaII-Park Kombetar, KategoriaIII-Monument Natyre, KategoriaIV-Rezervat Natyror i Menaxhuar, KategoriaV-Peizazh i Mbrojtur, KategoriaVI-Zone e Mbrojtur e Burimeve te Menaxhuara.* Bazuar ne kategorizimin e zonave te mbrojtura, gjeoparqet dhe gjeomonumentet natyrore gjeologjike futen kryesisht ne kategorine e III-te dhe te V-te sipas IUCN-se, por per disa, bazuar ne vlerat specifike dhe rendesine shkencore qe ato perfaqesojne mund te ikuadrohen ne kategorine e I-re dhe te II-te, ndersa gjeomonumentet natyrore gjeologjike te aspektit gjeomorfolog-peisazhor duhet te ikuadrohen ne Kategorit e V-te. ***Ne zonat e mbrojtura te kategorise se III-te (sipas IUCN-se) - Monumentet natyrore, ose te veçant - futet nje monument natyror specifik, i cili mund te perfaqesoj nje forme te relievit,***

shpellat nen ujore, fenomene gjeologjike, ose nje bimesi qe jeton dhe paraqet vlera antike. Keto monumente ne pergjithesi kane nje sipërfaqe te vogel per tu mbrojtur, por ato kane nje vlere te madhe per vizitoret. Objektivi kryesor i kesaj kategorije eshte mbrojtja e karakteristikave specifike te veçanta natyrore dhe biodiversitetin e tyre dhe habitateve shoqeruese. Fakti qe nje zone përmban një monument natyrore madhor nuk do të thotë se do të neglizhohet si nje monument i kategorise se III-te, p.sh. Grand Kanyon në Arizona është menaxhuar si i kategorisë se II-te, pavarësisht se eshte një nga monumentet më të famshëm në botën natyrore, sepse ajo është një zonë e madhe dhe aktivitetet e ndryshme argëtuese që lidhen me te i bënë ato të përshtatshme për një model të kategorise se II-te. Fakti qe kategoria e III-te ka karakter unik, eshte se ajo kërkon të mbrojtë një karakteristikë të veçantë dhe është pa dyshim më me ndikim ndaj të gjitha kategorive nga perceptimi njerëzor i asaj që është vlera e një peizazhi tokësor, ose peizazhi detar sesa një vlerësim më sasior i vlerave.

Ne zonat e mbrojtura te kategorise se V-te, futen- Zona qe mbulojne nje sipërfaqe te tokës apo detit. Ndryshe nga kategoritë e tjera, Kategoria e V-te, qe perfshin peisazhe të mbrojtura dhe peisazhe detar, lejojnë një nivel më të lartë të ndërveprimit me komunitetet përreth të cilët janë në gjendje për të kontribuar në zonat e menaxhimit dhe të angazhohen me trashëgiminë natyrore dhe kulturore. Peisazhet tokësore dhe detare që hyne në këtë kategori duhet të paraqesin një ekuilibër kryesor midis njerëzve dhe natyrës, dhe mund të mbështesin aktivitetet e tilla si sistemet tradicionale të bujqësisë dhe pylltarisë, te kushtezuara per sigurimin e mbrojtjes dhe restaurimin e vazhdueshem te ekologjise në rajon. Edhe ne vendin tone, keto dy-tre dekadat e fundit jane nenshkruar disa Konventa nderkombetare, si dhe jane hartuar nje sere ligjesh dhe vendime te qeverive Shqiptare (V.K.M.) per mbrojtjen dhe menaxhimin e Natures Shqiptare. Në preambulën e ligjit të Zonave të Mbrojtura (Nr. 8906, datë 06.06.2002) thuhet: *Ky ligj ka për objekt ruajtjen, administrimin, menaxhimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të Zonave të Mbrojtura dhe të burimeve natyrore e biologjike të tyre; lehtësimin e kushteve për zhvillimin e turizmit mjedisor; për informimin dhe edukimin e publikut dhe për përfitime ekonomike, të drejtpërdrejta dhe të tërthorta, nga popullsia vendore, nga sektori publik dhe privat.* Deri në Qershor 2011, zonat e mbrojtura mbulojnë 13.17% të sipërfaqes së përgjithshme të vendit tone, ndersa është planifikuar që, brenda vitit 2013, të arrihet në rreth 17% të sipërfaqes.

II. Gjeoparqet dhe Gjeomonumentet Gjeologjike te rajonit te Vlores.


Ne figuren 3 jepet harta e Rrjetit te zonave te mbrojtura te vendit tone (Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.2012) dhe kategorit e zonat e mbrojtura per rajonin e Vlores. Po keshtu, me Vendim te Keshillit te Ministratve Nr. 676, date 20.12.2002, jane miratuar per Rrethin e Vlores 28 Gjeomonumente Natyrore, nga te cilat 15 jane Gjeomonumente Natyrore Gjeologjike dhe perkatesisht: Mbihipja e Çikes, Mbihipja aktive e Dukatit, Shkeputje e re aktive e Llogarase, Tarraca detare e Kusbabait, Tarraca detare e ish shtepise se pushimit te punetoreve , Gjiri dhe shpellat e Grames, Bariera Koralore e grykes se Diallit, Falezat e Sazanit, Shpella e Shengjergjit ose e Bletes, Shpella e Ramices, Shpella e Velçes , Shpellat e Boderit (Smokthine), Shpella e Haxhi Alise (Iliriane), Shpella e shkruar, Shpella e Bilbilenjeve. Po keshtu, nga ana e Sherbimit Gjeologjik Shqiptar dhe Shoqata ProGEO-Albania jane realizuar studime dhe botime per gjeoparqet dhe gjeomonumentet natyrore gjeologjike te Shqiperise. Aktualisht per gjeoparqet dhe gjeomonumentet natyrore gjeologjike te evidentuara nuk eshte bere asgje per menaxhimin, identifikimin e me tejshem dhe dhe ruajtjen e tyre, si ne rang kombetar dhe rajonal, por ne shume raste ato po i nenshtrohen prishjes dhe shkaterimit. Pavarsisht se ne rang kombetar jane realizuar nje sere studimesh dhe projektesh per rrjetin kombetar te zonave te mbrojtura, gjeomonumentet dhe gjeoparqet gjeologjik nuk jane perfshire ne planet e identifikimit dhe menaxhimit te tyre, ose ne disa raste dentifikimi tyre eshte bere nga specialist jo te fushave te gjeoshkencave dhe institucioneve perkatese te keture fushave.



II.1. Tiparet kryesore gjeologo-Tektoniko-Gjeomorfologjike te rajonit te Vlores.

Hapesira fiziko-gjeografike e rajonit te Vlores permbledh ate pjesë te Sterese që fillon me ekosistemin detar, vijën bregore e deri me zonen e ekosistemeve kontinentale. Ne kete hapësire futen Vargmalet e Karaburunit- Rreza e Malit te Kanalit, lugina e Dukatit deri ne Qafe Llogara dhe Shpati i permendur i Vargut malor Lungare-Çike me ne lindje te saj. Nga pikpamja gjeologjike (fig.4) ne kete hapësire marrin pjese 2 zona tektonike, ajo e Sazanit, zona Jonike dhe Ultesira Pranadriatike. Nga pikpamja litologjike formacionet dominuese me masen mbi 85% jane ato karbonatore me moshe nga Triasi i siperm e deri ne Paleogjen kurse formacionet terrigjene qe kane nje perhapje te kufizuar jane ato flishore me moshe Oligoceno - Akuitaniane dhe flishoidale ose mollasike me moshe Neogjenike. Ne zonat e uleta, luginat e lumenjeve dhe pergjat vijes bregoret kane nje perhapje depozitimet e Kuarternarit dhe te soteme .

Nga pikepamja tektonike (fig.4) ne kete rajon mbizoterojne strukturat e rurdhosura te komplikuar me krahet e tyre, ne shumicen e rasteve me



shkeputje mbihypes (thrust)dhe te prera nga thyerje shtytese (strike-slip fault).

Figure 4. Gjeoparqet dhe Gjeomonumentet Natyrore Gjeologjike te rajonit te Vlores.


Ne fazen Pliocen-Kuaternare ky rajon eshte i komplikuar edhe nga shume shkeputje rreshqitese, normale (normal fault), qe e coptojne bregdetin ne blloqe shpesh ne trajten e strukturave te karakterit horst- grabenor. Ne aspektin gjeomorfologjik dominon reliev malor, kurse ai kodrinor ze kryesisht zonen e ulet bregdetare. Relievi i ulur pasqyron strukturat negative dhe formacionet terrigjene me pak rezistence ndaj erozionit. Faktoret ekzogjene luajne nje rol te rendesishem ne karakteristikat gjeomorfologjike, ku rolin kryesor e luajne proceset e erozionit dhe te abrazionit, proceset e shpatit dhe ato karstike. Levizjet e diferencuara neotektonike dhe zhvillimi me hope i tyre kane formuar rieleve me siperfaqe te sheshta, me shkalle ndarese qe formojne lartesi te ndryshme, m.gj.s. nje pjese e tyre jane edhe rezultat nga coptimet shkeputese te reja. Strukturat gjeologjike, perberja , çarjet dhe coptimet e reja tektonike kane bere qe se bashku me proceset abrasive e te erozionit te kemi ne buze te te zones bregdetare shkembore gjire te vogla, me ose pa plazhe, faleza, kanione, shpate te thepisur dhe kepe gjeomorfologjike si dhe zona te pastasbilizuara nga rreshqitjet.

II.2. Identifikimi i Gjeoparqeve dhe Gjeomonumenteve me vlera kombetare dhe nderkombetare (Fig.4).

Bazuar ne te dhenat e tipareve kryesore Gjeologo-Tektoniko-Gjeomorfologjike, rajoni i Vlores karakterizohet nga nje pasuri e larmisheme te Gjeoparqeve dhe gjeomonumenteve natyrore gjeologji me vlera lokale, rajonale, kombetare, dhe pse jo nderkombetare!. Rajoni i Vlores, ne saj te pozicionit aktual fiziko-gjeografik, permban nje potencial teper te larte te pasurive natyrore, persa i perket pranise se hapësirës spektakulare te zonave bregdetare te konturuar nga prania e ekosistemeit detar (deti Jon dhe Adriatik) dhe gjeomorfologjise se ekosistemeve kontinentale (malor, kodrinor, deltaik, litoral, lagunor, zonave te ulta fushore,etj.). Aktualisht per kete zone bregdetare (Fig.3) eshte shpallur zone e mbrojtur detare e kategorise se II-te Parku Kombetar Detar “Karaburun-Sazani”.

Ne kete artikull trajtohen vetem ato me vlera kombetare te ketij rajoni, por nje studim i detajuar dhe integrimi i tyre me zonat e mbrojtura te ketij rajoni do te shtoj vlerat gjeoturistike te ketij rajoni.

1. Gjeoparku dhe Gjeomonumenti Natyror Gjeologjik (Tektoniko-Neotektonike): "Balli Orogjenik-Perplasja e Pllakave tektonike te Zones se Sazanit (Apulja) dhe Zones Jonike" (Fig.5.1,2.). Vend ndodhja: Qafa e Llogarase, 45km. ne jug te Qytetit te Vlores, ne krahun e majte te rruges nacionale Vlore-Dhermi. Dimesionet e zones: 1300m x150-200m, Kordinatat: 40°11'49.22"N, 19°35'42.74"E; 41°11'49.35"N, 19°35'52.20"E; 40°11'48.61"N, 19°36' 24.66"E. Disiplinat karakterizuese: Fizika e Globit, Tektonika regionale, Gjeologjia e Shqiperise, Neotektonika, Stratigrafia, Paleontologjia. **Karakteristikat specifike:** Kjo zone perbehet nga formacione shkembore dhe struktura gjeologjike qe u perkasin dy zonave me kryesore tektonike te Shqiperise: asaj Jonike dhe zones Sazani. Formimi dhe strukturat e ketyre zonave ka lidhje me hapjen dhe mbylljen e oqeanit Tetis midis pllakave te Euroazise dhe Afrikes te cilat shpune ne formimin e brezit te rrudhosur Alpin gjate nje perudhe kohe



250 milion vjetesh qe i takon ererave Mesozoike dhe Kenozoike, ku perfshihen me rradhe perudhat gjeologjike Triasike, Jurasike, Kretake, Paleogjenike, Neogjenike dhe Kuaternare. Ne Qafen e Llogarase mbihipja e zones Jonike, e shprehur nepermjet ballit mbihipes te brezit te Çikes (qe eshte teper i coptuar dhe brekçezuar tektonikisht) dhe me renie per ne lindje vendoset shume prane kundrahijes se gelqeroreve te Kretakut te Rrezes se Kanalit te zones Sazani me ne perendim. Gjate ketij balli orogjenik, karbonatet e Kretakut te zones se Sazanit u kane kundrahipur dolomiteve te Triasikut te siperm te antiklinalit te Cikes se zones Jonike, duke formuar nje zone trekendore ne thellesi.

Propozimi: Gjeoparku dhe Gjeomonumenti gjeologjik te kategorizohet si zone e mbrojtur e kategorise se I-re- Rezervat Strikt Natyror gjeologjik me vlera strikt shkencore kombetare dhe ndrekombetare. Zona e ketij gjeoparku gjeologjik duhet te bashkengjitet siperfaqes se Parkut kombetar te "Llogarase".


2. Gjeoparku dhe Gjeomonumenti Natyror Gjeologjik (Sedimentologjiko-Gjeomorfologjike) "Katastrofa natyrore para 15-10 milion vjeteshne rajonin e Vlores"(Fig.6.) -sistemi i kodrave molasike me orgjine nga pulsacionet e rrymave turbulente dhe flukseve gravitativ (Kepi Triportit-Kepi Dalanit). Vend ndodhja: 5-20km. ne veri-perndim te qytetit te Vlores, ne Perndim te fshatit te Zvernecit. Dimesionet e zones: 5.2km.x600-800m, Kordinatat: Kepi Triportit (40°29'55.51"N 19°24'20.52"E), Kepi i Dalanit (40°32'24.24"N19°22'37.59"E). Disiplinat karakterizuese: Sedimentologji, gjeomorfologji, Stratigrafia sizmike. **Karakteristikat specifike:** Kjo zone perbehet nga formacione shkembore molasike te Epokes Miocenike te kohes se Seravalianit dhe strukturat gjeologjike i perkasin Ulteires Pranadriatike.

Prerja siperfaqesore e Zvernecit ne rajonin e Vlores gjithmon ka terhequr vemendjen e gjeologeve Shqiptar dhe te huaj. Modeli sedimentologji i depozitimeve silico-klastike te Serravalianit (rajonin e Zvernecit) është një mjedis sedimentimi Turbitidik "hibrid" i detit të thellë. Ky model "hibrid" përmban element si te sistemeve moderne, ashtu dhe sistemeve te depozitimeve te vjetra qe jane propozuar nga autor sedimentolog te shume vendeve te botes. Modeli i depozitimeve te Seravalianit, ne rajonin e Zvernecit paraqet disa karakteristika unike, spektakulare, peisazhore (vendodhja ne nje zone bregdetare te detit Adriatik), "abstaksioniste" dhe gjeomorfologjike të cilat janë identifikuar si në aksin vertikal, ashtu dhe ne aksin horizontal te evolucionit sedimentologjik te basenit. Faktoret kryesor qe kane kontrolluar depozitimet: Tektonika lokale dhe regionale, ndryshimet e nivelit te detit, katastrofat natyrore , tipi dhe volume i sedimenteve, frekuenca, volumi dhe intesiteti i fluksit gravitativ, paleogeografia e basenit, intesiteti i flukseve turbitide. Trashesia totale e ketyre depozitimeve eshte rreth 1800metra dhe perfaqesohet nga prania e tre Megasekuencave depozituese nga poshte prerjes deri ne pjesen e siperme: Megasekuenca I- Depozitime te mjedisit te shpatit te basenit, Megasekuenca II- Depozitime te faneve(freskoreve, pulsacioneve) te mesem dhe te faneve komplek, Megasekuenca III- Depozitime te mjedisit te shpatit te basenit. Kater facie kryesore diferencohen ne prerjen siperfaqesore: Facia A- Shtresa ranoresh masiv turbitid, me trashesi 0.5-10m; Facia B- Shtresa te holla ranoresh turbitid, me trashesi 0.5m-15m; Facia C- Shtresa argjilore turbitide, me trashesi 0.5-6m; Facia D- Shtresa mergelore gjysem pelagjike me trashesi 0.2-20cm. Gjithashtu morfologjia e kodrave aktuale perfaqeson gjeometrin spektakulare te pulsacioneve dhe depozitimeve te faneve dopzitues turbitid gjate kohes se Seravalianit, 15 deri 10milion vjete me pare ne nje mjedis detar te thelle (rreth 800metra). Tipet e facieve turbitidike perbejne, nje spekter te

gjere tipesh te sedimenteve, per te cilet eshte e pamundur te klasifikohen keto sedimente ne nje skeme te veçant pershkruese. Dy proçese te transportit te sedimenteve ne basenin e Seravalianit ne rajonin e studjuar jane konstatuar :

- prania e rrymave turbididike me densitet te larte (high-density turbidity current=HDTC)
- prania e rrymave turbididike me densitet te ulet (low-density turbidity current =LDTC)

Elementet kryesor qe perbejne Fanet kompleks turbididik jane : kanalet kryesor, kanalet e lobeve kalimtar, kanalet kryesor dhe faciet anesore te kanaleve (overbank). Ne prerjen siperfaqesore te depozitimeve te Seravalianit jane identifikuar dhe gjeometrizuar 9 Fane komplekse Turbididike(Fig. 6) Ne kete prerje siperfaqesore jane te pranishme gjurmet e nje game te plote te figurave dhe teksturave sedimentare te stampuara ne dyshemet, tavanet dhe ne brendesi te facieve ranorike, qe evidentojne pranine e nje mjedisi unik turbidid per



depozitimet silico-klastike. Nje fenomen teper i vacant, eshte dhe prania e larmise se konfiguracioneve paisazhike te konkretioneve diagjenetike. Propozimi:Gjeomonumenti te kategorizohet si zone e mbrojtur e kategorise se I-re- Rezervat Strikt Natyror gjeologjik me vlera strikt shkencore kombetare dhe ndrekombetare.

3. Gjeomonumenti Natyror Gjeologjik: *Paleogjeografik-sedimentologjik-Stratigrafik i "Trasgresioni i detit te Mesinian-Kalaja e Kanines, 5.5miljon vjet me pare"*. Vend ndodhja: Fshati Kanine (nen themelet e Kalase se Kanines, krahu Jugor), 4-5km. Ne jug-Lindje te Qytetit te Vlores. Dimesionet e zones: 50mX 20m. Kordinatat: 40°26'36.69"N 19°31'15.68"E. Disiplinat karakterizuese: Paleogjografi, Stratigrafi, Sedimentologji. **Karakteristikat specifike:** Ky trasgresion i detit te Mesinianit perfaqeson buzen Jugore te depozitimeve te ultesires PranAdriatike. Depozitimet e Mesinianit vendosen transgesivisht dhe me diskordance kendore mbi depozitimet flishore te Oligocenit. Facia transgresive karakterizohet nga konglomerat dhe ranor te mjedisit te detit te ceket: litoralo-lagunor. Ky gjeomonument "bashkejeton" me monumentin historiko-kulturor te kalase se Kanines e ndertuar ne gjysmen e pare te mijejekarit te fundit para eres ton. **Propozimi:** Gjeomonumenti gjeologjik te kategorizohet si zone e mbrojtur e kategorise se I-re- Rezervat Strikt Natyror gjeologjik me vlere strikt shkencore kombetare".

4. Gjeomonument Natyror Gjeologjik: *"Facia gipsore Mesiniane-deshmi e krizes Mesiniane te tharjes se detit Mesedhe"*. Vend ndodhja: zona ne perndim te Fshatit Bestrove, 4km nga qyteti Vlores, kodra ne krahe te djathte te autostrates Vlore-Novosele dhe zona ne Qafen e Babices, ne krahun e djathte te rruges Vlore-Qafa e Babices(2.5km). Dimesionet e zones: çveshje gipsore ne bordin e rrugeve. Kordinatat: Bestrove-40°30'48.15"N 19°27'38.06"E; Qafe e Babices-40°28'59.06"N 19°30'34.78"E.

Disiplinat karakterizuese: Stratigrafi, Sedimentologji, Mieralogji, Gjeokimi.

Karakteristikat specifike: Facie kripore, Gipsore, si deshmi e Krizes Mesiniane e kripshmerise, nje ngjarje gjeologjike qe korespondon me tharjen e detit te Mesdheut ("kriza e Mesdheut") gjate Epokes se Mesinianit, 5.96 milion vjete deri 5.33 milion vjete me pare. Tharja e Detit Mesdhe ka qene me orgjine tektonike, si rezultat i saj kemi patur mbylljen progresive te ngushtices se Gjibratarit. Kjo u shoqerua me uljen e nivelit te detit deri ne 1500-2500m. Kjo tharje u realizua ne menyre progresive dhe u shoqerua me formimin e depozitimeve masive te kriprave (Halit, Gipse, Anhidrit, etj.). Gjeomonumenti shoqerohet me kristale spektakulare gipsi te binjakezuar dhe ne forme bisht dallandyshe. Propozimi: Gjeomonumenti gjeologjik te kategorizohet si zone e mbrojtur e kategorise se III-re- Gjeomonument Natyror gjeologjik me vlere kombetare dhe rajonale".

5. Gjeomonument Natyror Gjeologjik: *"Prerja perfaqesuese e depozitimeve platmorfike te Kretakut te Siperme te zones tektonike te Sazanit"*. Vend ndodhja: zonat ne rrugen Nacionale: Qafa e Llogarase-Perroi i Palases. 40-50km nga qyteti Vlores. Dimesionet e zones: çveshjet e formacioneve karbonatike bordin

e rruges Nacionale ne zbritje drejt Palases. Disiplinat karakterizuese: Paleontologji, Stratigrafi, Petrografi Sedimentare Sedimentologji. **Karakteristikat specifike:** Në sipërfaqe këto depozitime takohen në Malin e Kanalit, Karaburun dhe ishullin e Sazanit. Këto depozitime përfaqësohen nga dolomite, gëlqerorë dolomitikë mikrokokrrizorë, që hera-herës kalojnë deri gëlqerorë shkumësor. Ndërmjet tyre takohen dhe gëlqerorë biomikritikë. Kështu gjate kreshtës së malit të Kanalit takohen dy shtresa gëlqerorësh masivë të pasur me rudistë me trashësi 1-3m, që shërbejnë si reper, mbasi kanë vazhdimësi në shtrirje. Keto depozitime pëfaqesojnë një platforme tipike neritike (deti i ceket), në kohën e formimit të tyre. Facia mbizotëruese është ajo e gëlqerorëve tipike neritike, shpesh herë me karakter rifor, shumë të pasura me rudiste, gastropode e porfire koloniale në Kretak të sipërm. Rudistet në mjaftë raste kanë karakter biostromash, por nuk mungojnë dhe biogermat. Në sipërfaqe, struktura e Malit të Kanalit, që përfaqëson një monoklinal me rënie perëndimore me kënde nga 20°-30° e deri 50°. Ky monoklinal bie në kontakt tektonik me depozitimet karbonatike Triasiko-Jurasike të antiklinalit të Çikes të zonës Jonike. **Stopi 1.** 40°11'41.95"N, 19°35'59.51"E: përfaqëson depozitime të formacioneve karbonatike platformike të kufirit midis Kretakut të Poshtëm (Albian) dhe Kretakut të Sipërm (Cenomanian); **Stopi 2.** 40°11'03.74"N 19°35'42.69"E dhe **Stopi 3.** 40°10'44.76"N 19°35'40.99"E përfaqësojnë depozitime karbonatike platformike të detit të ceket (Senonianit). **Propozimi:** Gjeomonumenti gjeologjik të kategorizohet si zonë e mbrojtur e kategorisë së III-re- Gjeomonumenti Natyror gjeologjik me vlerë shkencore kombëtare dhe rajonale".

6. Gjeomonumenti Natyror Gjeologjik: "*Thyerjet tektonike aktive*" (Fig.5.2.) në buzët kufizuese të graben-sinklinalit miocenik të Dukatit në kontakt me morfostrukturat e ngritura të gëlqerorëve të Malit të Çikës në lindje dhe të Malit të Kanalit në perëndim. Vend ndodhja: zonat në të dy krahet e rruges Nacionale: Dukat i ri-Dukat-Qafa e Llogarase. Dimensionet e zonës: Rruga Nacionale Dukat-Llogara. Disiplinat karakterizuese: Tektonike, Neotektonike, Gjeologji Strukturore. **Karakteristikat specifike:** Një prej shkeputjeve aktive me permaza të mëdha, konsiderohet ajo që kufizon rrezen lindore të Malit të Kanalit (zona e Sazanit) me sinklinalin e Dukatit. Ajo është mbushur me sedimente miocenike e pliocenike tepër të rrudhosura, që ndajnë zonën e Sazanit nga balli karbonatik dhe i mbihypur i Çike-Tragjasit me i avancuar i zonës Jonike. Shkeputja është thuhet vertikale, me rënie për në lindje-verilindje, me kënd 80°- 90°, ngrihet si mur në reliev nga 2-3 deri në 10m, ka sipërfaqe të lemuar e të paprekur nga erozioni dhe pasqyron planin e shkeputjes të formuar vone nga levizjet kontraste ngritese dhe ulëse. Shkeputja ndiqet nga Orikumi deri në Qafën e Llogarase, ku sinklinali ngushtohet në disa dhjetra metra, që ndan zonën e Sazanit me ballin e zonës Jonike (Çiken). Rrafshi tektonik në balle të antiklinalit të Çikes ka një rënie për në veri- lindje me kënd

mesatar rreth 40°. Bazuar ne vijat diagonale te gervishtjes mbi pasqyrat e rreshqitjes (me spostimet me te vonshme), ato kane qene te orientuara siper drejt perendimit, çka tregojne se fusha fillestare e sforcimeve ne shtypje ka pesuar me vone nje rrotullim ne kahun orar per rreth 30° bazuar kjo ne orientimin e shtrirjes se ballit te mbihypjes dhe te struktures se Çikes qe eshte V-P rreth 330°, e formuar nga forcat shtypese prepndikulare me te, me orientim VL-JP. **Stopi 1.** (devijimi rruges Nacionale per ne fshatin Dukat), 40°14'53.35"N 19°32'44.76"E: Balli i rrafshit tektonik te zones Jonike (struktura karbonatike e Tragjasit, nen/zona e Çikes) dhe mardheniet me depozitimet miocenike te sinklinalit te Dukatit. **Stopi 2.** (fshat Dukat) 40°14'59.72"N 19°33'46.94"E, : Mardheniet dhe elementet e rrafshit tektonik me depozitimet miocenike dhe Kuaternarit ne sinklinalin e Dukatit. **Stopi 3.** 40°14'08.83"N 19°33'17.80"E :Shkeputja aktive qe kufizon formacionet karbonatike te Malit te Kanalit(zona e Sazanit) me depozitimet miocenike te sinklinalit te Dukatit. Propozimi: Gjeomonumenti gjeologjik te kategorizohet si zone e mbrojtur e kategorise se III-re- Gjeomonument Natyror gjeologjik me vlera shkencore kombetare dhe rajonale ”.

7. Gjeomonument Natyror Gjeologjik: *“Prerja gjeologjike e Dukatit: formacionet gjeologjike karbonatike te Zones Jonike- nen/zona e Çikes (Triasiku siperm-Jurasik-Kretak-Paleocen-Eocen”.*

Vend ndodhja: Perroi i Dukatit. Trashesia e depozitimeve:1800m. Kordinatat: fillimi prerjes 40°14'52.50"N 19°33'29.25"E, mbarimi 40°15'57.95"N 19°34'23.76"E. Disiplinat karakterizuese: Gjeologji, paleontologji, Stratigrafi, petrografi sedimentare, Sedimentologji, Gjeokimi. **Karakteristikat specifike:** deshifrimi gjeologjik, karakterizimi facieve karbonatike, sekuencat dhe ciklet e sedimentimit, mjediset e sedimentimit, figurat dhe teksturat sedimentare, kufijt moshor, nivelet e shkembinjve “meme” te naftes, karakteristikat e rezervuarit karbonatik, sekuencat stratigrafike, etj,. Ky gjeomonument natyror gjeologjik siperfaqesor afron nje panorame shume te mire mbi ballin e rrafshit tektonike te struktures se Tragjasit drejt Perndimit dhe perbehet nga sekuencat depozituese Mesozoike te basenit te zones Jonike. Prerja e Dukatit perfaqeson nje prerje stratigrafike te plote , e cila ekspozohet ne lindje te Perroit te Dukatit dhe nderohet nga depozitimet me moshe me te vjeter deri me te rejat:

1. Depozitimet Evaporitike te Triasit, qe vendosen direkt ne kontaktin tektonik mbi depozitimet molasike te Seravalianit. **2.** Depozitimet Dolomitike te Triasit, qe permbajne lokalisht dhe nderthurje te lendes bituminoze me nje potencial te larte te shkembinjve “meme” te naftes(Niveli i pare, TOC=3.8%, Tmax=420, HI=576). **3.** Depozitimet e Dolomiteve bituminoze te Jurasikut te poshtem (Lias) me nje potencial te larte te shkembinjve “meme” te naftes(Niveli i dyte, TOC=20 - 30%, Tmax=416, HI=500-600). **4.** Depozitimet Silicore te Jurasikut

te mesem (intervali poshtem silicor), mbulohen me diskordanc nga depozitimet silicore te intervalit te siperme, me moshe te Jurasikut te siperme dhe te depozitimeve karbonatike pelagjike te Kretakut. Afer pjeses se siperme te prerjes kemi pranine e nivelit fosfatik, i cili ne siperfaqe shoqerohet me pranine e bimesise se gjelber. **Propozimi:** Gjeomonumenti gjeologjik te kategorizohet si zone e mbrojtur e kategorise se III-re- Gjeomonument Natyror gjeologjik me vlera shkencore kombetare dhe rajonale ”.

8.Gjeoparqet dhe Gjeomonumentet Natyror Gjeologo-Gjeomorfologjike te Zones bregdetare shkembore te rajonit te Gadishullit te Karaburun-Sazanit(Fig. 4).

Fiziko-gjeomorfologjia aktuale e zones bregdetare Karaburun-Sazan, eshte rezultat i evolucionit ne kohe dhe hapësire i nderimit gjeologo-tektoniko-gjeomorfologjik qe ka pesuar kjo zone. Ajo zbulohet ne ishullin e Sazanit dhe vazhdon ne jug me malin e gadishullit te Karaburunit, dhe ate te Rrezes se kanalit deri ne juge te Palases me nje zgjatje rreth 50 km. Ne zonen bregdetare shkembore te rajonit te Gadishullit te Karaburunit dhe ishullit te Sazanit jane identifikuar nje sere gjeoparqesh dhe gjeomonumentesh natyrore gjeologjike te cilet kane nevojë per nje eksplorim me te plote, si ne aspektin e identifikimit, ashtu dhe ne aspektin e vleresimit per kategorizimit dhe menaxhimit te zonave te mbrojtura. Kjo zone bregdetare per potencialin e larte te pasurive natyrore dhe gjeoturistike qe ajo permban, perben nje nga zonat me atraktive te vendit tone, e cila mund te emertohet si "Riviera Vlonjate".

A. Nen/zona e strukture gjeologo-tektonike te Rrezes se Malit te Kanalit.

Struktura gjeologjike e Rrezes se Kanalit perfaqesohet vetem me krahun perendimor te strukture. Formacionet e moshave Paleogjenike te tij zhyten ne det me kend rreth 30 grade, kurse pjesa e poshtme e krahut ndertohet ne pjesen lindore nga formacionet e Kretakut te Poshtem me te cilin sipas nje shkeputje tektonike vertikale eshte bere dhe zhytur krahu lindor, i cili eshte i maskuar nen terrigjenet e Miocenit qe mbushin luginen siklinale te Dukatit. Kjo shkeputje tektonike ndiqet deri ne Qafen e Llogarase duke ndare formacionet karbonatike te strukture se Rrezes se Malit te Kanalit me ato terrigjene te sinklinalit te Dukatit. Struktura monoklinale e Rrezes se Malit te Kanalit ka mbihapur drejt veri-lindjes (ne trajte te kundrahedhje) deri mbi depozitimet dolomitore te Triasit te Siperme te strukture antiklinale te Cikes (zona Jonike) ne Qafen e Llogaras.Kjo strukture kufizohet ne veri te saj nga terthorja tektonike e tipit shtytje Dhermi-Ishulli Othon (Greqi) dhe ne jug nga terthorja tektonike e Gjirit te Ariut-Dukat. Ne kete nen/zona identifikohen gjeoparqet dhe gjeomonumentet e me poshteme:

8.1. Gjeoparqet dhe gjeomonumentet natyrore gjeologjike te zones bregdetare te ndertuara nga formacionet karbonatike te moshes se Kretakut te siperm. Zona bregdetare ka nje shtrirje prej 5.8-6km. ne drejtimin LJL-PVP me kordinata: **Pika 1.** 40°10'19.24"N 19°34'48.86"E; **Pika.2.** 40°11'40.39"N 19°31'00.10"E. Vija bregore shkembore e kesaj zone ka nje gjatesia 7km. dhe karakterizohet nga gjeomorfologji teper karakteristike, ku vija bregore kryesisht e ndertuar nga shtresa karbonatike me renie rreth 30° ne drejtim te veriperndimit, ka krijuar ne disa segmente gjire dhe zikzake karakteristike. Teper karakteresitke ne aspektin gjeomorfologjik dhe peisazhor eshte zona bregdetare nga faqja e Langadhes deri te Perroi teper karakteristik i Rushnjes, me nje gjatesi te vijes bregore rreth 3km.,Ne kete segment spikat dhe kanioni spektakular i perroit ne veri te faqes se Langadhes(401050.38N 193315.66E).

8.2. Gjeoparqet dhe gjeomonumentet natyrore gjeologjike te zones bregdetare te ndertuara nga formacionet karbonatike te moshes se Paleogjenit (Eocen). Zona bregdetare ka nje shtrirje prej 18km ne drejtim VP-JL me kordinata: **Pika.2.** 40°11'40.39"N 19°31'00.10"E; **Pika 3.** 40°18'53.49"N 19°22' 19.29"E (kepi jugor i Gjrit te Ariut). Konfiguracioni, gjeomorfologjia e kesaj zone eshte shume atraktive ne aspektin peisazhor dhe e pasur me shume monumente natyrore, ku me te spikatur jane prania e gjireve te vegjel, kanioneve te derdhjeve te prenjeve karakteristik, shpellave karstike (te identifikuara dhe te pa identifikuara) te shoqeruara me burrime ujore te embel dhe burime nen-detare (sub marine). Per kete zone bregdetare mund te vecojme tre nga gjeomonumentet me te rendesishme natyror gjeologjik, por dhe me vlera historiko-kulturore:

8.2.1. Gjeomonumenti i minieres historike siperfaqesore (kariere, gurores) te shfrytezimit te blloqeve gelqerore ne perjudhen e shekullit te XIV-te(9?). Bazuar ne perberjen karakteristike petrografike te shkembinjeve karbonatik, te cilet kane nje perperje deri ne 90-95% CaCO₃ dhe gati teksture shkumesore, te punueshem me mjete te forta, shfrytezimi i tyre ka gjetur perdorim qe ne kohet me te lashta. Blloqet e gureve shkembor me dimensione te konsiderueshme te nxjerra nga kjo miniere siperfaqesore, jane perdorur nga skulptore europian(!) te kohes dhe sot shume vepra arti monumentale neper Europe e kane orgjinen e lendes se pare nga kjo miniere.

8.2.2. Gjeomonumenti i Gjirit te Shkronjave (Grames)- "Galerine e artit" natyrore te alfabeteve nderkombetare, te ekspozuara ne faqen shkembore veriore te minieres siperfaqesore. Ky gjeomonument natyror gjeologjik dhe me vlera historiko-arkeologjike ndodhet ne gjirin e shkronjave (...te vizituar nga pirate apo udhetare te vendeve te huaja, te cilet kane lene gjurmet e mbishkrimeve te tyre, te cilat i perkasin perjudhes se shekullit te VI p.e.s., ne alfabetet e greqishtes se vjeter, latinishtes apo gjuhen bizantine.). Gjiri i Shkronjave (Grames), perfaqesohet nga nje plazhe guarecash dhe zajesh me nje gjatesi rreth100m. dhe gjeresi te plazhit qe varjon nga 17m deri 28m. Kordinatat e plazhit:

40°12'58.91"N 19° 28' 26.01"E, ndersa distance midis dy kepeve te gjirit rreth 220-230m.

8.2.3. Gjeomonumenti natyror gjeologjik i Shpelles dhe burimit uhor karstik i gjirit te Shendreut. Gjiri i Shendreut ndodhet ne jug te gjirit te Shkronjave me kordinata: 40°11'50.88"N 19°30'25.09"E. ne zonen e ketij gjiri ndodhet shpella karstike nga ku buron dhe nje burrim uji i embel teper karakteristik. Ne brendesi te kesaj shpelle, ne faqet e brendshme shkembore gelqerore te saj dhe mbi nivelin e ujit gjenden basorelieve te gedhendura dhe shkrime historike (te korelueshme me stilin e atyre qe gjenden ne gjirin e Shkronjave), fakt ky qe keto gjeomonumente, pervec vlerave natyrore marin dhe vlera historiko-kulturore dhe eksplorimet e metejshe ne kete drejtim jane me se te domosdoshme.

B. Nen/zona e strukture gjeologo-tektonike grabenore te kodrave te Ravenes.Kjo nen/zone ndodhet midis strukture gjeologo-tektonike te Karaburunit dhe Rrezes se Kanalit, ku evidentohet Qafa e Rovenes dhe perfaqeson nje structure tektonike grabenore. Shkeputja tektonike e kufirit jugor te tij tregon jo vetem per ulje te grabenit (normal-slips) ne raport me strukturen e Rrezes se Malit te Kanalit por edhe per nje komponente te fuqishme shtytese te majte (sinistral, strike - slip) e dokumentuar gjeologjikisht nga renia e gelqeroreve ne lindje, (krahu lindor i strukture antiklinale) ne veri te shkeputjes dhe ne perendim (krahu perendimor i strukture antiklinale) ne jube te shkeputjes. Kjo shkeputje perkon me terthoren tektonike te Gjirit te Ariut-Dukat me shtrirje lindore-juglindore e cila kufizon ne jug kundrahypjen e Malit te Kanalit. Ne kete nen/zone identifikohen gjeoparqet dhe gjeomonumentet e me poshteme:

8.3.Gjeoparqet dhe gjeomonumentet natyrore gjeologjike te zones bregdetare perndimore te ndertuara nga formacionet karbonatike te Gjirit te Ariut (Bristanit) te moshes se Kretakut te siperm. Si rezultat i efekteve te tektonikes grabenore dhe ndikimit te terthores tektonike Gjiri Ariut-Dukat, konfiguracioni i vijes bregore paraqitet me nje gjeomorfologji karakteristike me dalje dhe hyrje te shpejta formes dhe gjeometrise se saj. Kordinatat: **Pika 3.** 40°18'53.49"N 19°22'19.29"E (kepi jugor i Gjirit te Ariut), **Pika 4.** 40°20'07.24"N, 19°22'07.71"E, gjatesia e vijes bregore 3.970km. Gjiri Ariut ka ne shtrirje rreth 650m dhe distance midis kepeve 1.570km dhe plazhin perkates me dimensione 70x25m (40°18'53.12"N, 19°22'44.35"E.).

8.4. Gjeoparqet dhe gjeomonumentet natyrore gjeologjike te zones bregdetare lindore te ndertuara nga formacionet karbonatike te moshes se Kretakut te Siperme te structures grabenore te kodrave te Ravenes. Kjo zone eshte pjese e zones bregdetare te Gjirit te Vlores. Konfiguracioni i kesaj zone bregdetare paraqet nje gjeomorfologji teper specifike dhe peisazhore, me gjire dhe kepe ne forme te "gishtezuara", gjeomorfologji qe eshte kushtezuar nga faktori dinamik i dy linjave tektonike specifike qe kane krijuar strukturen grabenore. Kjo zone bregore kufizohet nga **Pika 7**, Kepi Pullit: 40°21' 47.34"N 19°24'32.86"E deri ne

Piken 8, Kepin e gjirit te Pashalimanit: 40°19'37.84"N 19°25'13.31"E. Vija bregore ka nje gjatesi prej 6.3km., ku vecohet Kepi, gjiri dhe plazhi I Rogozhes(40° 21' 23.11"N 19°24'24.58"E), Kei I Kallogjerit(40°20'42.34"N, 19°24' 31.98"E).

8.5. Gjeoparku dhe gjeomonumentet natyrore gjeologjiko-arkeologjike te zones Pasha limanit-Orikum. Kjo zone eshte pjese e zones bregdetare te Gjirit te Vlores dhe perbehet nga formacionet karbonatike te strukture grabenore te kodrave te ravenes dhe depozitimeve ultesires Kuaternare, ku spikat vija bregore dhe laguna e Orikumit. Kjo zone kufizohet nga **Piken 8**, Kepin e gjirit te Pashalimanit: 40°19'37.84"N 19°25'13.31"E dhe **Pika 9** me kordinata 40°19'30.36"N, 19°27'05.99"E, me nje vije bregore me gjatesi 3.7km. *Gjetjet arkeologjike deshmojne per nje qyteterim te lashte, per nje port tregetar te rendesishem ne rajon: **Oriku** (Orikumi i sotem) i cili daton shek.VI.p.e.s. Laguna e Valltos (Orikum) ruan ende sot brenda tij rrenojat e vjetra te ketij qyteti. Oriku, ky liman i rendesishem ekonomik, i forcuar me mure luajti nje rol te rendesishem ne luften mes Cezarit dhe Pompeut. Si fillim ate e mbante Pompeu si stacion per floten e tij ushtarake, me pas me 6 janar te vitit 48 para Krishtit, u pushtua nga Cezari pa lufte, i cili vendosi aty legjionin e vet. Me pas Oriku u shfrytezua nga romaket, ne lufterat kunder ilireve, dhe nga maqedonasit. Flota maqedonase e Aleksandrit te Madh te Maqedonise e pushtoi ate ne vitin 214. Ne shekullin III para Krishtit, Oriku preu monedhat e para ne emer te bashkesive qytetare. Ne periudhen bizantine dhe ne mesjete Oriku del me emrin Jeriko. Ne kohet e pushtimit osman te Arberise, turqit e quajten Pashaliman.Oriku vazhdoi te luajti rol paresor deri ne shekullin I pas Krishtit*

C. Nen/zona e strukture gjeologo-tektonike antiklinale te Karaburunit. Nga pikpamja tektonike gadishulli i Karaburunit ka ne siperfaqe pamjen e nje antiklinale te qete e pjeserisht te zhytur ne det, me nje kende renie 30°. Kjo structure antiklinale nderton nje pjese te zones bregdetare shkembore si ne perndim(krahu perndimor) dhe ne lindje(krahu lindor), por me karakteristika gjeomorfologjike te vecanta per sejcili krah te strukture.

8.6. Gjeoparqet dhe gjeomonumentet natyrore gjeologjike te zones bregdetare perndimore te ndertuara nga formacionet karbonatike te moshes se Kretakut te Poshtem. Kjo zone perfaqeson nje nga zonat bregdetare me atraktive dhe karakteristika te larmishme gjeomorfologjike: faqe shkembore me renie gati vertiale me nje lartesi 100-150m. te shoqeruara me larmine e ndertimit te shtresave gelqerore te cilat bien me nje kend rreth 30° ne drejtim te detit, gjire te vegjel piktoresk (p.sh. gjiri i Dafines: 40°21' 03.69"N 19°21'49.78"E:), kepe, faleza, shpella karstike, etj. Kjo zone bregdetare ka nje shtrirje prej 9.5km VP-JL. Kordinatat: **Pika 4.** 40°20'07.24"N 19°22'07.71"E dhe **Pika 5.** 40°24'27.84"N 19°18' 28.09"E me nje gjatesi te vijes bregore 12.300km..

8.7. Gjeoparqet dhe gjeomonumentet natyrore gjeologjike te zones bregdetare lindore te ndertuara nga formacionet karbonatike te moshes se Kretakut te Siperme (krahu lindor i strukture antiklinale te Karaburunit. Kjo zone perfaqeson nje vije bregore me shtrirje VP-JL dhe gjatesi rreth 12km. Kordinatat kufizuese: **Pika 6, 40°25'54.26"N 19°18' 20.22"E dhe **Pika 7**, Kepi Pullit: 40°21'47.34"N 19°24'32.86"E Vija bregore me nje gjatesi rreth 15km. paraqet nje konfiguracion me te qete se krahu perndimor i saj, por edhe ketu jane te pranishme karakteristikat e pranise se gjireve te vegjel me plazhet zhavoror, kepet dhe zik-zaket e vijes shkembore bregore te perfaqesuara nga formacionet karbonatike te Kretakut te Siperme. Kjo zone perben krahun perndimor peisazhor te Gjirit te Vlores. Ne pjesen Veri-Perndimore te tij, qe perfaqeson dhe zonen perballë Ishullit te Sazanit kemi pranine e Gjirit te Shen Janit, i konturuar nga Kepi i Gallovecit (40°26' 19.19"N 19° 19'15.25"E) dhe Kepi i Shen Janit(40° 26' 00.96"N 19° 20' 14.94"E), plazhin dhe Kepin e Shen Vasilit(40°24'50.46"N 19°22'00.39"E).**

D. Nen/zona e strukture gjeologo-tektonike te Kepit te Gjuhezes. Kjo nen/zona veçohet sidomos ne aspektin gjeomorfologjik, ku kemi pranine e nje shkallezimi ne kuotat 30-50-100m dhe nje ngritje te menjehershme deri ne kuotat 300-400m. Si rezultat i ketij diferencimi, ne Kepin e Gjuhezes mund te kemi pranine e taracave abrasive detare deri ne kuoten 100m. Ne kete nen/zona, pervec formacioneve karbonatike te Kretakut te siperme, qe perhapen ne pjesen me te ulet morfologjike kemi dhe pranine e depozitimeve flishore te moshes Akujtaniane dhe Burdigaliane te kufizuara nga dy linja tektonike.

8.8. Gjeoparqet dhe gjeomonumentet natyrore gjeologjike te zones bregdetare te ndertuara nga formacionet karbonatike te moshes se Kretakut te Siperme dhe formacionet flishore te moshes se Akujtanianit dhe Burdigalianit. Kjo zone eshte pjese perberse e strukture antiklinale te Karaburunit, por me karakteristika gjeologo-gjeomorfologjike specifike. Nga ana gjeomorfologjike siperfaqja e Kepit te Gjuhezes perfaqeson nje zone te sheshte me kuota 40-50m, e cila ngrihet ne drejtim lindjes ne kuotat 400-500m. Ne kete zone, pervec depozitimeve gelqerore karakteristike te moshes se Kretakut te Siperme, kemi pranine ne siperfaqe te depozitimeve flishore te moshes se Akujtanianit dhe Burdigalianit, te cilat kufizohen nga prania e dy linjave tektonike me orjentim afersisht V-J. Zone e sheshte e Kepit te Gjuhezes perfaqeson nje tarace detare abrasive. Kjo zone ka nje gjatesi te vijes bregore prej 6.2km dhe kordinatat kufizuese: **Pika 5.** 40°24'27.84"N, 19°18'28.09"E dhe **Pika 6.** 40°25'54.26"N, 19°18'20.22"E. Ne kete zone gjendet nje gjeomonument natyror gjeologjik teper spektakular i ekosistemit karstik :

8.7.1. Gjeomonumenti natyror gjeologjik i shpelles kastike te Haxhi Alise: Kordinatat: 40°25'48.04"N 19°18'24.43"E (Kjo shpelle e mori emrin nga kapedani i njohur i detit Haxhi Ali Ulqinaku. Ai u vendos bashke me te birin me dy tartana ne shek e VXIII. Shpellen e perdori per nje periudhe kohe si baze qendrimi

ne luftimet kunder anijeve luftarake te Anglise, Venedikut, Frances per te mbrojtur brigjet shqiptare). Kjo eshte shpella me e madhe detare ne vendin tone. Gjatesia e saj arrin 30m., lartesia 10-15 m. dhe gjeresia 9,5 m..

E. Nen/zona e strukture gjeologo-tektonike unike te Ishullit te Sazanit.



Ne veri te gadishullit te Karaburunit veçohet ishulli i Sazanit qe eshte nje ngritje strukturore ne trajte horsti e mbetur nga zhytjet grabenore, qe kane coptuar veriun e zones se Sazanit. Ne veri te Ishullit te Sazanit, nje thyerje me amplitude zhytесе disa kilometra sipas interpretimit me hartën e re gjeologjike 1:200000 kufizon kete zone me basenin e Adriatikut jugor. Vleresimet paraprake deshmojne se kjo zone perban nje pasuri te madhe persa u perket gjeoparqeve dhe gjeomonumenteve natyror gjeologjik, te cilat e bejne te domozdoshme vleresimin e tyre ne potencialet komplekse unikale natyrore te zones, si dhe inkuadrimit dhe perbashket te ekosistemeve detare dhe atyre kontinentale.

9. Gjeoparqet dhe gjeomonumentet natyrore gjeologjike te zones bregdetare te Ishullit te Sazanit. Kjo zone ne formën e nje horsti, i kane dhene karakteristika te vecanta natyres dhe konfiguracionit shkembore te vijes se saj bregore. Vija bregore e Ishullit ne total ka nje gjatesi prej 13.2 km., e cila paraqet dy tablo ne aspektin e perberjes shkembore te saj: vija bregore lindore lindohet nga formacione flishore te moshes se Burdigalianit (nderthurje te shtresave ranorike, alevrolitore, argjilore dhe mergelore, me gjatesi prej 4.4km.; ndersa vija bregore perndimore dhe te dy ekstremeve (jugor dhe verior), ndertohen nga formacione karbonatike te moshes se Kretakut te Siperim, me gjatesi prej 8.8km.. Konfiguracioni dhe gjeomorfologjia e zones bregdetare te Ishullit te Sazanit(Fig. 7) karakterizohet nga prania e nje sere gjiresh, kepush, repirash shkembore me thepise gati vertikale (sidomos ne bregun perndimor te Ishullit). **Propozim:** Bazuar ne faktin se per kete zone eshte shpallur zone e mbrojtur e kategorise se II-te Parku Kombetar Detar “Karaburun-Sazani”. Gjeoparqet dhe Gjeomonumentet Natyror Gjeologo-Gjeomorfologjike te Zones bregdetare shkembore te rajonit te Gadishullit te Karaburun-Sazanit te

ikuadrohen ne kete Park, duke u trajtuar si zona te mbrojtura peisazhore te kategorise se V-te (morfologjia kontinentale) dhe si zona te mbrojtura te kategorise se III-te, gjeomonumentet natyrore gjeologjike te identifikuar duke u integruar ne planet perkatese te ruajtjes dhe menaxhimit.

Perfundime.

Potenciali i pasurive natyrore te rajonit te Vlores, si rezultat i nje ndertimi specifik gjeologo-tektono-gjeomorfologjik, permban nje pasuri te madhe te gjeotrashegimnise gjeologjike te identifikuara me vlera lokale, rajonale, kombetare dhe nderkombetare. Vleresimi, ruajtja dhe menaxhimi i gjeoparqeve dhe gjeomonumenteve natyrore gjeologjike te ketij rajoni, si pasuri natyrore te pa perseritshme, do te rise se tepermi zhvillimet social ekonomike dhe gjeoturistike.

Institucionet lokale, rajonale dhe kombetare, bazuar edhe ne eksperjencen Europiane dhe boterore duhet te kushtojne me shume vemendje ne drejtim te identifikimi, vleresimit, ruajtjes, menaxhimit, sensibilizimit te komuniteteve, ndaj gjeotrashegimnise gjeologjike, duke e integruar ate me trashegimnit historike, kulturore dhe biodiversitetin e rajonit.

LITERATURA

1. A. Savini, C. Corselli, Ç. Durmishi, S.Marku (2011). "Geomorfology of Vlora Gulf Seafloor: Results from multibeam and High-Resolution Seismic data". 6-16. Journal of Coastal Research. Special Issue, 58.
2. C.I.S.M.-(2006-2008). Progeto Di Assistenza Tecnica Alla Realizzaione Ed Alla Gestione Di Un Centro Internazionale Di Scienza Del Mare In Albania
- 3.Ç. Durmishi, Melo.V.etj, (1999-2001)-Identifikimi dhe Vleresimi i Potencialeve Unikale te Gjeotrashegimnise Dhe Menaxhimi i Vlerave te tyre Gjeoturistike Lokale, Kombetare dhe Nderkombetare te Shqiperise - *Studim, Programi Kombetar, Ministria e Arsimit dhe Shkences, Tirane.*
- 4.Ç Durmishi, Beshku, H etj, (2002-2005)-Studimi Gjeologo Sedimentologjik dhe Monitorimi i Hapesires Bregdetare te Shqiperise.Impaktet ne zhvillimin mjedisor, infrastrukturor ,urban dhe turistik. *Fondi Sherbimit gjeologjik Shqipetar, Tirane.*
- 5.Ç. Durmishi (1997) Sequence stratigraphic and reservoir characterization of deep-water-Serrevalian silicolastic of the Vlora region-Albania O.M.V. (Albania) exploration Ges.m.b.lt

6. Ç Durmishi, et.al. (2008) Sedimentological and geophysical study of quaternary deposits (holocen-pleistocen) of albanian coastal area. *Oral, a changing coast: 9th International Conference Littoral 2008, Venice Italy.*
7. Ç. Durmishi Sh. Daja (2010). "Spectacular evidence of sedimentary structures of the Serravalian deposits in the Zverneci outcrops" Poster, ILP task force on sedimentary basins, 2010 International Workshop, November 7-12, 2010, Tirana (Albania).
8. F. Loiacono, A. De Marco, G. Dicoladonato, Ç, Durmishi (2011). "Recent sedimentation in the Vlora Gulf: Size and Mineralogical from some cores in aE-W transect". 17-25. *Journal of Coastal Research. Special Issue*, 58
9. M. Van Geet, R. Swennen, Ç. Durmishi, et.al. (2002) Paragenesis of Cretaceous to Eocene carbonate to reservoirs in the Ionian fold and thrust belt (Albania): relation between tectonic and fluid flow. *Sedimentology* (2002) 49, 697-718.

Gjeoparku dhe gjeomonumenti i Qafes së Llogarase
 "Perplasja e zones tektonike te Sazanit me zonen Jonike"
 Foto 1




Gjeoparku dhe gjeomonumenti natyror gjeologjik:
 "Gjurmët" Katakstrofes natyrore gjeologjike 5-10 milion vjet me pare - Zvernoc




Gjeomonumenti Natyror Gjeomorfologjik



Gjeomonument Natyror Gjeologjik



Prerja Sedimentologjike Miocenike-Zvernoc, Vlora.



DISA METODA EKSTRAKTIMI PËR PËRCAKTIMIN E DISA NDOTËSVE ORGANIKË NË MATRICA MJEDISORE NDJEKUR NGA TEKNIKA GAZ KROMATOGRAFIKE

Anida Duka¹, Bilal Shkurtaj², Aurel Nuro³

¹Tirana University, Faculty of Natural Sciences, Physics Department

²University of Vlora "Ismail Qemali", Faculty of Education, Department of of Natural Sciences

³University of Tirana, Faculty of Natural Sciences, Department of Chemistry

E-mail: anidaduka@hotmail.com

Përmbledhje

Në këtë punim janë paraqitur disa teknika ekstraktimi dhe trajtimi të matricave mjedisore për përcaktimin e BTEX, PAH, PCB dhe pesticideve klor-organike. Head-Space Solid Phase Microextraction u përdor për BTEX në mostrat e ujit dhe sedimentit. Ekstraktimi Lëng-Lëng u përdor për ekstraktimin e PAH, pesticideve klor-organike dhe PCB-ve nga mostart e ujit. Ekstraktimi me ultratinguj u përdor për ekstraktimin e ndotësve organikë nga mostrat e ngurta. Procedura e pastrimit të ekstraktit u realizua në një kollonë të hapur florisili. Aparati Varian 450 GC, i pajisur me dedektor me jonizim në flakë (FID) dhe me injektor split/splitless u përdor për përcaktimin e BTEX dhe PAH. Ndarja e tyre u krye me kolonën kapilare VF-1ms (30m gjatësi x 0.33mm diametër të brëndshëm x 0.25µm film), e përshtatshme për ndarjen e hidrokarbureve. Për ndarjen dhe izolimin e pesticideve klor-organike dhe PCB-ve u përdor kollona Rtx-5 (30m x 0.32mm x 0.25µm). Ana ne matrica mjedisoreliza u realizua në aparatin HP 6890 Series II, të pajisur me dedektor µECD. Pesticidet klor-organike të dedektuara ishin: HCHs (izomerët a-, b-, γ- dhe d-), DDT dhe metabolitët e saj (o,p-DDE, p,p-DDE, p,p-DDD, p,p-DDT), Heptakloret, Aldrinat dhe Mireksi. Analiza e PCB-ve u pazua në përcaktimin e shtatë konxhenierëve markues. Metodot e përdorura janë të thjeshta, me kosto relativisht të lirë dhe mund të përdoren gjerësisht si metoda rutinë në përcaktimin e ndotësve BTEX, PAH, PCB dhe pesticideve klororganike ne matrica të ndryshme mjedisore.

Abstract

In this paper are presented some extraction techniques and treatment for determination of BTEX, PAH, PCB and organochlorinated pesticides in environmental matrices. HS-SPME was used for determination of BTEX from water and sediment samples. Liquid-Liquid extraction was used for extraction of PAH, organochlorinated pesticides and PCBs from water samples. Ultrasonic extraction were used for PAH, PCB and pesticides in solid samples. Clean-up

procedure was performed in an "open" florasil column. Varian 450 GC were used for determination of BTEX and PAH. Their separation was performed using VF-1ms (30m length x 0.33mm internal diameter x 0.25µm film). Analysis was realized in HP 6890 Series II, gas chromatograph equipped with µECD detector. For separation of organochlorinated pesticides and PCB markers was used Rtx-5 capillary column (30m x 0.32mm x 0.25µm). The organochlorine pesticides as: HCHs (α-, β-, γ- and δ-isomers) and the DDT-related chemicals (o,p-DDE, p,p-DDE, p,p-DDD, p,p-DDT), Heptachlors, Aldrines and Mirex, were detected. Analyzes of PCBs was based on the determination of the seven PCB markers. Used methods are simple, low cost and can be used in routine mode for determination of BTEX, PAH, PCB and organochlorinated pesticides in environmental samples.

HYRJE

Pesticidet klor-organike, PCB, PAH dhe BTEX janë ndotës organikë të cilët janë të përhapur në shumë ekosisteme në mbarë botën. Arsyet kryesore janë aplikimet e tyre, depozitimet atmosferike, industrinë e ndryshme, transportin urban, etj. Qëndrueshmëria e lartë e tyre në mjedis dhe toksiciteti që këta ndotës paraqesin e bëjnë të domosdoshme monitorimin e vazhdueshëm të tyre në mjedis. Analiza e ndotësve organikë të mësipërm në literaturë dhe normativa të ndryshme ndërkombatare (EPA, EN, ASTM, etj) rekomandohet që të realizohen me anë të teknikave kromatografike (HPLC, GC, etj). Këto teknika bëjnë të mundur analizimin e këtyre ndotësve në nivele gjurme deri në nivelet ppb. Kromatografia e gazte me dedektor FID është e përshtatshme për analizën e PAH dhe BTEX, ndërsa GC/ECD i përshtatshëm për analizën e pesticideve klor-organike dhe PCB.

Për të arritur deri tek injektimi i mostrës në aparat dhe analizimi i tyre me metodën gazkromatografike janë të domosdoshëm një sërë hapash për të sjellë mostrën në trajtë të tillë që të bëhet e mundur analiza nga matrica të ndryshme mjedisore. Rrallë mostra mund të injektohet në aparat e patrajtuar paraprakisht. Në varësi të natyrës së mostrës që merret për t'u analizuar, metodikës së zgjedhur apo faktorëve të tjerë zgjidhen hapa të ndryshëm trajtimi të saj. Hapat që ndiqen zakonisht janë:

- Marrja, transportimi dhe ruajtja e mostrës
- Trajtimi fizik i mostrës (homogjenizimi, bluarja, filtrimi, sitja, etj.,)
- Ekstraktimi i analitit
- Pastrojë e mostrës nga komponime që pengojnë analizën (Clean-up i mostrës)
- Ndarja e komponimeve që do të analizohen në fraksione (Fraksionimi)

Mostra duhet të zgjidhet e tillë që të përfaqësojë sa më realisht gjëndjen e sistemit që duam të përcaktojmë sepse shpesh herë ajo është një burim gabimi që do të cconte në një rezultat jo të besueshëm. Qëllimi i studimit që do të kryhet do të përcaktonte dhe objektivat që duhet të ndjekim p.sh., objektivat që duhet të ndjekim për një monitorim dhe një studim njohje apo krahasimi janë të ndryshëm. Secili do të përcaktonte një numër mostrash të ndryshëm, vendmarrje të mostrave të njëjtë ose të ndryshëm, marrje në periudha të ndryshme, kosto e ndryshme, etj. Për një rezultat të besueshëm merren nga 10-20 mostrata të marra në mënyrë të tillë që informacioni që mund të merret nga ato të jetë sa më real. Për të marrë një mostër sa më homogjene tregohen mënyra të ndryshme të marrjes së mostrës përfaqësuese kjo në varësi nga sasia e mostrave që do të analizohen.

Transporti dhe ruajtja e mostrave është një procedurë e cila do ndjekur me korrektësi pasi gjatë kësaj procedure mund të shkaktohen gabime të ndryshme zakonisht të interferencave apo gabimieve të rastit. Kjo do të sillte për pasojë një rezultat të gabuar në vlerat e raportuara. Transporti i tyre do kryer sa më shpejt dhe për komponimet volatile ato transportohen të ruajtura në të ftohtë. Mostrat duhet të shoqërohen me dokument identifikimi që të tregojë kohën dhe vendin e marrjes së mostrës. Ato mbahen të mbyllura në enë (qelqi, tefloni, PET, etj) ose të mbështjella me letër alumini. Ruajtja e mostrave bëhet zakonisht në frigoriferator në -20°C.

Për rezultate sa më të besueshme është e nevojshme që të analizohet disa herë e njëjta mostër, pra lind nevoja për një mostrë sa më homogjene në mënyrë që nënmostrat e marra nga kjo e fundit të japin një rezultat të afert me njëra-tjetrën duke marrë parasysh dhe gabimet që mund të ketë secila analizë. Për homogjenizimin e mostrave përdoret bluarja e tyre duke përdorur havanë porcelani, mullinj etj. Mostrat e biotës dhe të sedimenteve përpara se të ekstrahohen është e nevojshme t'u largohet uji i cili zë një përqindje të madhe tek këto mostra. Uji pengon analizën gazkromatografike pasi shkakton shtresën e filmit të fazës së palëvizshme në kollonën kapilare të aparatit. Uji largohet me anë të liofilizatoreve, aparat që shërben për largimin e ujit në presione të ulta nga mostrat e sedimenteve apo te biotës. Për mostrat e biotës zakonisht përdoret dhe trajtimi me sulfat natriumi anhidër sepse veç largimit të ujit ai shërben dhe për prishjen e qelizave dhe "nxjerr jashtë analitin" prej tyre duke marrë një rezultat sa më real.

Kalimi i analitit nga mostra (faza ku ai gjendet) në një fazë tjetër të përshatshme për analizën gazkromatografike zakonisht ka të bëjë me procesin e ekstraktimit. Ekstraktimi është një proces shumë i rëndësishëm në analizën gazkromatografike. Përdorimi i mjetit ekstraktues është në varësi të natyrës së mostrës që analizohet, në varësi të analitit, kostos së analizës, etj. Disa teknika ekstraktimi të përdorura më shpesh në analizën e ndotësve organikë janë: ekstraktimi me Soxhlet, me banjo me ultratinguj, lëng-lëng, SPE, SPME, Din-Stark, etj.

Para viteve 90' pesticidet klor-organike janë përdorur gjerësisht për qëllime bujqësore në Shqipëri. Pjesa perëndimore e vendit ku janë fushat kryesore bujqësore (Shkodra, Durrësi, Tirana, Fieri, Lushnja, Vlora) dhe në përgjithësi në të gjithë vendin në drejtime të ndryshme bujqësore (fruta, drithëra, perime, etj) ka pasur një zhvillim të bujqësisë dhe në gjithashtu përdorime të plehërave kimike dhe pesticideve.

MATERIALE DHE METODA

1. Trajtimi i mostrave të ujit

a. Për përcaktimin e **BTEX** u marrën 5 ml mostër uji (ujë i distiluar në të cilin është shtuar 10 ul tretësirë BTEX me përqëndrim 10 ug/ml) në një shishe SPME me vëllim 10 ml. Shishet janë të pajisura me tapë tefloni të përshatshme për analizën e tyre me anë të teknikës Head-space. Shiringa manuale e SPME e pajisur me fibër PDMS (Polydimethyl siloxane) 100 um futet nëpërmjet tapës të teflonit në pjesën e sipërme të mostrës. Shishja vendoset në një Banjo Mari në temperaturë 50°C për 90 minuta. Pas procesit të adsorbimit shiringa transferohet në aparatit e gaz kromatografit Varian 450 të pajisur me dedektor FID ku realizohet injektimi i tyre (procesit i desorbimit në 280°C për 10 sekonda). Ndarja e BTEX u realizua në kollonën VF-1ms me përmasa 30m x 0.33mm x 0.25um.

b. Për përcaktimin e **PAH** u morrën 1L mostër uji (ujë i distiluar në të cilin është shtuar 10 ul tretësirë PAH me përqëndrim 10 ug/ml) dhe u hodh në një hinkë ndarëse ku u shtuan 40 ml n-Hekzan si solvent ekstraktues. Pas ndarjes të fazës organike nga faza ujore duke përdorur hinkën ndarëse n-Hekzanit iu shtuan 10g sulfat natriumi anhidër për largimin e gjurmëve të ujit. Solventi u avullua duke përdorur Kuderna-Danish deri në 2 ml dhe u injektua në aparatën e gaz kromatografit Varian 450 të pajisur me dedektor FID. Ndarja e PAH u realizua në kollonën VF-1ms me përmasa 30m x 0.33mm x 0.25um.

c. Për përcaktimin e **pesticideve klor-organike** dhe PCB u morrën 1L mostër uji (ujë i distiluar në të cilin është shtuar 10 ul tretësirë e pesticideve klororganike dhe PCB me përqëndrim 10 ug/ml) dhe u kalua në kollonat SPE me C18 të përshtatshme për adsorbimin e tyre nga mostrat e ujit. Kollonat u aktivizuan paraprakisht me 10 ml n-Hekzan. 20 ml n-Hekzan/Diklormetan në raport 4:1 u përdorën si solvent eluimi për të kaluar pesticidet klor-organike në fazë të lëngët të përshtatshme për analizën e mëtejshme. Eluati u avullua duke përdorur Kuderna-Danish deri në 2 ml dhe u injektua në aparatën e gaz kromatografit HP 6890 Series II të pajisur me dedektor ECD. Ndarja e pesticideve klor-organike u realizua në kollonën Rtx-5 me përmasa 30m x 0.25mm x 0.25um.

2. Trajtimi i mostrave të sedimenteve

Tek mostrat e sedimenteve u përcaktuan BTEX, PAH, pesticidet klor-organike dhe poliklorbifenilet. Sedimentet u thanë në ajër në temperaturë ambiente dhe më pas ato u bluajtën në havan porcelani. Pas kësaj ato duhet të siten. Në analizë merren vetëm fraksionet 63 mikron.

a. Për përcaktimin e **BTEX** u morrën 5g mostër sedimenti (sediment i pre-ekstraktuar në të cilin është shtuar 10 ul tretësirë BTEX me përqëndrim 10 ug/ml) në një shishe SPME me vëllim 10 ml të pajisura me tapë tefloni të përshtatshme për analizën e tyre me anë të teknikës Head-space. Shiringa manuale e SPME e pajisur me fibër PDMS (Polydimethyl siloxane) 100 um futet nëpërmjet tapës të teflonit në pjesën e sipërme të mostrës. Shishja vendoset në një Banjo Mari në temperaturë 50°C për 90 minuta. Pas procesit të adsorbimit shiringa transferohet në aparatën e gaz kromatografit Varian 450 të pajisur me dedektor FID ku realizohet injektimi i tyre (procesi i desorbimit në 280°C për 10 sekonda). Ndarja e BTEX u realizua në kollonën VF-1ms me përmasa 30m x 0.33mm x 0.25um.

b. Për përcaktimin e **PAH** u morrën 5 g mostër sedimenti (sediment i pre-ekstraktuar në të cilin është shtuar 10 ul tretësirë PAH me përqëndrim 10 ug/ml) dhe u hodhën në një elenmajer me vëllim 100 ml ku u shtuan 40 ml n-Hekzan si solvent ekstraktues. Ekstraktimi i tyre u realizua në banjo me ultratinguj për 60 minuta në 30°C. Pas ndarjes të fazës organike u shtua 2g sulfat natriumi anhidër për largimin e gjurmëve të ujit. Solventi u avullua duke përdorur Kuderna-Danish deri në 5 ml dhe u injektua në aparatën e gaz kromatografit Varian 450 të pajisur me dedektor FID. Ndarja e PAH u realizua në kollonën VF-1ms me përmasa 30m x 0.33mm x 0.25um.

c. Për përcaktimin e **pesticideve klor-organike** dhe PCB u morrën 10 g mostër sedimenti (sediment i pre-ekstraktuar në të cilin është shtuar 10 ul tretësirë e pesticideve klororganike dhe PCB me përqëndrim 10 ug/ml) dhe u hodhën në një elenmajer me vëllim 100 ml ku u shtuan 40 ml n-Hekzan/Diklormetan (3:1) si solvent ekstraktues. Ekstraktimi i tyre u realizua

në banjo me ultratinguj për 60 minuta në 30°C. Pas ndarjes të fazës organike u shtua 2g sulfat natriumi anhidër për largimin e gjurmëve të ujit. Solventi u avullua duke përdorur Kuderna-Danish deri në 10 ml. Në epruvetë u shtua merkur metalik deri në largimin e plotë të komponimeve me sqfur të cilat gjenden zakonisht në mostrat e sedimenteve dhe që pengojnë analizën gaz kromatografike (Figura 10). Ekstrakti transferohet me kujdes në një kollonë të hapur qelqi (10cm x 0.8 cm) me mbushës florisil. Florisili është aktivizuar paraprakisht për 8 orë në 250°C dhe është deaktivizuar me 4% ujë. Eluimi u realizua me 20 ml n-Hekzan/Diklormetan (4:1) dhe u grumbullua në Kuderna-Danish (Figura 11) ku u avullua deri në bllokterm deri në 2 ml. Ekstrakti u injektua në aparatën e gaz kromatografit HP 6890 Series II të pajisur me dedektor ECD. Ndarja e pesticideve klor-organike u realizua në kollonën Rtx-5 me përmasa 30m x 0.25mm x 0.25um.

3. Trajtimi i mostrave të biotës

Mostrat e peshqve qëndrojnë në refigjerator në -10°C. Ato u lanë në temperaturë ambiente për 2 orë. U përcaktua fillimisht lloji, gjatësia dhe pesha e tyre. Me anën e një thike metalike u prenë me kujdes indet muskulore të secilit prej individëve të zgjedhur për analizë. Indi u peshua dhe në 5-fishin e peshës të tij u shtua sulfat natriumi anhidër dhe u përzier në bashku në një havan porcelani deri në homogjenizimin e masës. Homogjenizati u grumbullua në enë qelqi të pajisura me tapë zmerile për ruajtjen e mostrave për përcaktimet e pesticideve klor-organike dhe poliklorbifenileve.

a. Për përcaktimin e **pesticideve klor-organike** dhe PCB u morrën 5 g homogjenizat (1 g ind peshë e njomë i pre-ekstraktuar në të cilin është shtuar 10 ul tretësirë e pesticideve klororganike dhe PCB me përqëndrim 10 ug/ml) dhe u hodhën në një elenmajer me vëllim 100 ml ku u shtuan 40 ml n-Hekzan/Diklormetan (3:1) si solvent ekstraktues. Ekstraktimi i tyre u realizua në banjo me ultratinguj për 60 minuta në 30°C. Pas ndarjes të fazës organike u shtua 10 g silikagel të trajtuar 45% në masë me acid sulfurik të përqëndruar. Silikageli është aktivizuar paraprakisht për 8 orë në 250°C Hidroliza acide e yndyrave dhe makromolekulave u realizua sepse këto komponime pengojnë analizën gaz kromatografike. Ekstrakti transferohet me kujdes në një kollonë të hapur qelqi (10cm x 0.8 cm) me mbushës florisil si hap i dytë i pastrimit të mostrave të peshqve. Florisili është aktivizuar paraprakisht për 8 orë në 250°C dhe është deaktivizuar me 4% ujë. Eluimi u realizua me 10 ml n-Hekzan/Diklormetan (4:1) dhe u grumbullua në Kuderna-Danish ku u përqëndrua në bllokterm deri në 2 ml. Ekstrakti u injektua në aparatën e gaz kromatografit HP 6890 Series II të pajisur me dedektor ECD. Ndarja e pesticideve klor-organike u realizua në kollonën Rtx-5 me përmasa 30m x 0.25mm x 0.25um.

4. Aparati i gaz kromatografit Varian 450 GC (GC/FID - për përcaktimin e BTEX dhe PAH)

Përdorëm aparatën Varian 450 GC, i pajisur me dedektor me jonizim në flakë (FID) dhe me injektor split/splitless. Ndarja e BTEX dhe PAH u krye me kolonën kapilare VF-1ms (30m gjatësi x 0.33mm diametër të brëndshëm x 0.25µm film), e përshtatshme për ndarjen e hidrokarbureve. Temperatura e injektorit dhe e dedektorit u vendosën respektivisht në 280°C dhe 280°C. Mënyra e injektimit u zgjodh splitless. Si gaz mbartës dhe gaz ndihmës u përdor azoti me prurje totale respektivisht 1ml/min dhe 24ml/min. Temperatura fillestare e furrës u mbajt 50°C për 2min pastaj u rrit në 150°C me 4°C/min. Pas kësaj në 280°C me 8°C/min dhe së fundi në 300°C me 10°C/min. Në këtë temperaturë u mbajt për

2 minuta. U injektua për çdo mostër një vëllim prej 2µl. BTEX me përzierje standarte për përcaktimin e tyre me HS-SPME/GC/FID në mostra uji dhe sedimentesh. PAH me përzierje standarte EPA 525 për përcaktimin e tyre me GC/FID në mostra uji dhe sedimentesh.

5. Aparati i gaz kromatografit HP 6890 (GC/ECD - për përcaktimin e pesticideve klor-organike dhe PCB)

Përdorëm aparatit HP 6890 Series II, i pajisur me dedektor me kapje elektronesh (ECD) me bërthamë ⁶³Ni dhe me injektor split/splitless. Ndarja e pesticideve klororganike dhe PCB-ve u krye me kolonën kapilare Rtx-5 (30m gjatësi x 0.33mm diametër të brëndshëm x 0.25µm film), e përshtatshme për ndarjen e ndotësve klororganike. Temperatura e injektorit dhe e dedektorit u vendosën respektivisht në 280°C dhe 300°C. Mënyra e injektimit u zgjodh splitless. Si gaz mbartës dhe gaz ndihmës u përdor azoti me prurje totale respektivisht 1ml/min dhe 24ml/min. Temperatura fillestare e furrës u mbajt 60°C për 4min pastaj u rrit në 200°C me 20°C/min. Pas kësaj në 280°C me 4°C/min dhe së fundi në 300°C me 3°C/min. U injektua për çdo mostër një vëllim prej 2µl. Pesticidet klor-organike të dedektuar ishin Hekzaklor cikloheksani - HCH (izomerët a-, b-, γ-dhe d-HCH), DDT-të (o, p-DDE, p,p-DDE, p,p-DDD, p,p-DDT), Metoksiklori, Hekzaklorbenzeni (HCB), Heptaklori, Heptaklorepoxid, Aldrina, Dieldrina dhe Endrina. Analiza e PCB-ve është bazuar në përcaktimin e shtatë PCB-ve markuese (IUPAC Nr. 28, 52, 101, 118, 138, 153 dhe 180). Për vlerësimin sasior u përdor si standart i brendshëm TCB (triklor-2,4,5-bifenili).

REZULTATE DHE DISKUTIME

Tek aparatit Varian 450 GC parametrat e punës të injektorit, furrës dhe dedektorit u zgjodhën të përshtatshme për përcaktimin e BTEX dhe PAH me të njëjtën metodë të aparatit. Analiza e BTEX dhe e PAH realizohet e veçantë në lidhje me mënyrën e trajtimit të mostrës por me dy injektime të ndryshme. Analiza sasiore e BTEX dhe PAH u realizua me ESTD me një pikë kalibruese. Lista e plotë e hidrokarbureve të analizuar në mostrat e sedimenteve dhe ujit nga Laguna e Patokut është dhënë më poshtë. Kalibrimi i aparatit të gaz kromatografit Varian 450 GC, për përcaktimin e BTEX, PAH u realizua në periudhën Tetor-Nëntor 2013. U përdor përzierje standarte e BTEX për përcaktimin e tyre me HS-SPME/GC/FID në mostra uji dhe sedimentesh. Përzierja standarte e PAH të EPA 525 u përdor për kalibrimin e aparatit për përcaktimin e këtyre komponimeve në mostra uji dhe sedimenti.

Kalibrimi i aparatit të gaz kromatografit të modelit HP 6890 i pajisur me dedektor ECD u përdor për përcaktimin e pesticideve klor-organike dhe PCB. Kalibrimi u realizua me përzierjen standarte EPA 8081 të pesticideve klor-organike (Figura 1). Kalibrimi me tre pika kalibruese 0.05, 0.1 dhe 0.25 ppm u realizua për këto komponime (Figura 2 dhe 3). PCB me përzierje standarte të shtatë markuesve u përdor për kalibrim me tre pika kalibruese 0.05, 0.1 dhe 0.25 ppm. Parametrat e punës të injektorit, furrës dhe dedektorit u optimizuan në mënyrë të tillë që të mund të realizohet e plotë ndarja dhe përcaktimi së bashku i pesticideve klor-organike dhe PCB. Lista e plotë e pesticideve klor-organike dhe PCB është dhënë më poshtë. Analiza sasiore e tyre u zgjodh me standart të jashtëm me tre pika kalibrimi.

Tretësirat standarte të BTEX, PAH, PCB dhe pesticideve klororganike u përdorën si për kalibrimin e aparteve GC/FID dhe GC/ECD dhe për të vlerësuar procedurat e paratrajtimit të mostrave mjedisore. Këto tretësira standarte u

shtuan në ujë dhe distiluar, sediment dhe mostër peshku të pre-ekstraktuar. Mbi këto matrica mjedisore u aplikuan teknikat e ekstraktimit dhe clean-up. Nga përcaktimi i rikuperimit u vërejtën rezultate që përfshijnë $70 \pm 10\%$ të analitit të shtuar. Këto rezultate janë të përshkruara dhe në literaturë. Metodrat e përdorura janë të thjeshta, me kosto relativisht të lirë dhe mund të përdoren gjerësisht si metoda rutinë në përcaktimin e ndotësve BTEX, PAH, PCB dhe pesticideve klororganike ne matrica të ndryshme mjedisore. Në tabelat dhe figurat e mëposhtme jepet një pjesë e punës e realizuar për vendosjen e vlefshmërisë të metodave analitike për përcaktimet e ndotësve mjedisorë në matrica të ndryshme me anë të teknikave kromatografike.




Figura 1. Kromatograme e standartit të pesticideve klor-organike dhe PCB




Figura 2. Kurba e kalibrimit për pesticidin Aldrinë




Figura 3. Kurba e kalibrimit për pesticidin Lindane

BTEX	Riprodhueshmëria për standartin me përqëndrim 25 ug/L					Mesatare	STDV
	I	II	III	IV	V		
Benzen	20.86	24.00	24.00	20.49	18.64	21.598	2.101
Toluen	26.08	27.54	20.34	22.61	21.15	23.544	2.802
Etil Benzen	22.55	20.52	17.25	16.60	18.27	19.038	2.203
m-Ksilen	22.38	20.26	18.41	24.21	20.68	21.188	1.969
o- Ksilen	18.08	23.09	21.83	21.33	19.75	20.816	1.737
p- Ksilen	26.18	18.34	21.04	24.39	28.69	23.728	3.670

Tabela 1. Riprodhueshmëria për tretësirën standarte të BTEX me përqëndrim 25 ug/L




Figura 4. Nivelet e BTEX për tretësirat standarte me përqëndrime 25, 50 dhe 100 ug/L.

PAH	Riprodhueshmëria për standartin me përqëndrim 50 ug/L					Mesatare	STDV
	I	II	III	IV	V		
Acenaphtalene	51.24	48.35	41.25	45.32	47.88	46.808	3.355
Fluorene	42.31	45.58	47.71	50.21	42.55	45.672	3.027
Phenanthrene	52.31	48.66	54.02	51.32	56.57	52.576	2.647
Antharcene	47.52	50.76	51.80	54.21	58.33	52.524	3.612
Pyrene	48.25	47.25	46.81	53.86	59.05	51.044	4.736
Benzo [a] anthracene	52.34	43.65	42.38	40.28	48.37	45.404	4.368
Cryzene	50.21	52.60	65.20	58.30	62.48	54.808	4.568
Skualane	47.54	50.34	58.30	66.25	56.32	51,231	8.43
Benzo [b] fluoranthrene	50.52	63.17	65.38	59.24	52.11	55.228	5.51
Benzo [k] fluoranthrene	40.26	58.41	66.54	54.32	48.01	53.431	6.43
Benzo [a] pyrene	53.09	51.83	65.20	58.30	62.48	61.908	8.787
Dibenzo [a,h] anthracene	55.82	54.62	58.30	66.25	56.32	58.262	4.167
Indeo [1,2,3,-cd] pyrene	50.27	53.34	65.38	59.24	52.11	56.068	5.541
Benzo [g,h,i] perilene	45.40	54.26	43.07	45.40	48.68	48.761	5.409

Tabela 2. Riprodhueshmëria për tretësirën standarte të PAH me përqëndrim 50 ug/L




Figura 5. Nivelet e PAH për tretësirat standarte me përqëndrime 25, 50 dhe 100 ug/L.

Name	Riprodhueshmëria për standartin me përqëndrim 50 ng/L concentration						
Name	I	II	III	IV	V	Mesatare	STDV
PCB 28	50.86	44.24	47.24	40.49	48.64	46.294	3.610
PCB 52	46.08	47.54	50.34	42.61	61.15	49.544	6.316
PCB 101	52.55	50.52	63.17	46.60	73.18	57.204	9.691
PCB 118	52.38	40.26	58.41	44.21	60.68	51.188	7.897
PCB 153	58.08	53.09	51.83	61.33	49.70	54.806	4.270
PCB 138	46.18	53.34	60.04	44.30	58.69	52.510	6.373
PCB 180	63.24	54.23	64.49	55.86	47.67	57.098	6.181

Tabela 3. Riprodhueshmëria për tretësirën standarte të PCB me përqëndrim 50 ug/L




Figura 6. Nivelet e PCB për tretësirat standarte me përqëndrime 25, 50 dhe 100 ng/L.

Name	Riprodhueshmëria për standartin me përqëndrim 50 ng/L concentration					Mesatare	STDV
	I	II	III	IV	V		
alfa-HCH	51.24	48.35	41.25	45.32	47.88	46.808	3.355
Lindane	42.31	45.58	47.71	50.21	42.55	45.672	3.027
beta-HCH	52.31	48.66	54.02	51.32	56.57	52.576	2.647
delta-HCH	47.52	50.76	51.80	54.21	58.33	52.524	3.612
Heptachlor	48.25	47.25	46.81	53.86	59.05	51.044	4.736
Aldrine	52.34	43.65	42.38	40.28	48.37	45.404	4.368
Heptachlorepoide	48.33	75.23	65.20	58.30	62.48	61.908	8.787
4,4-DDE	65.20	58.30	62.48	52.55	50.52	57.175	6.432
Dieldrine	58.30	66.25	56.32	52.38	40.26	58.413	6.542
Endrine	65.38	59.24	65.20	58.30	62.48	51.831	4.167
4,4-DDD	50.27	46.18	58.30	66.25	56.32	56.041	5.541
4,4-DDT	44.81	68.43	65.20	58.30	62.48	57.762	7.531
Endosulphane I	48.92	55.31	58.30	66.25	56.32	54.362	6.742
Endosulphansulphate	55.82	54.62	65.38	59.24	52.11	58.262	4.167

Endrine aldehyd	50.27	53.34	65.38	59.24	52.11	56.068	5.541
Methoxychlor	50.21	52.60	57.64	51.21	62.38	54.808	4.568
Mirex	48.33	75.23	65.20	58.30	62.48	61.908	8.787

Tabela 4. Riprodhueshmëria për tretësirën standarte e pesticideve klororganike 50 ug/L




Figura 6. Nivelet e pesticideve klororganike për tretësirat standarte me përqëndrime 25, 50 dhe 100 ng/L.

PËRFUNDIME

U përdor përzjerje standarte e BTEX për përcaktimin e tyre me HS-SPME/GC/FID në mostra uji dhe sedimentesh. Përzjerja standarte e PAH të EPA 525 u përdor për kalibrimin e aparatit për përcaktimin e këtyre komponimeve në mostra uji dhe sedimenti. Kalibrimi i aparatit GC/ECD u realizua me përzjerjen standarte EPA 8081 të pesticideve klor-organike. PCB markuese u zgjodhën në këtë studim. Analiza sasiore e tyre u zgjodh me standart të jashtëm me tre pika kalibrimi.

Tretësirat standarte të BTEX, PAH, PCB dhe pesticideve klororganike u përdorën si për kalibrimin e aparteve GC/FID dhe GC/ECD dhe për të vlerësuar procedurat e paratrazimit të mostrave mjedisore. Këto tretësira standarte u shtuan në ujin e distiluar, sediment dhe mostër peshku të pre-ekstraktuar. Mbi këto matrica mjedisore u aplikuan teknikat e ekstraktimit dhe clean-up. Nga përcaktimi i rikuperimit u vërejtën rezultate që përfshijnë $70\pm 10\%$ të analitit të shtuar. Këto rezultate janë të përshkruara dhe në literaturë. Metodrat e përdorura janë të thjeshta, me kosto relativisht të lirë dhe mund të përdoren gjerësisht si metoda rutinë në përcaktimin e ndotësve BTEX, PAH, PCB dhe pesticideve klororganike ne matrica të ndryshme mjedisore.

Literatura

Nuro A., Marku E., Topi D., Beqiraj S., Neziri A. (2011): A comparison of levels for some chlorinated pollutants in fishes from freshwaters and marine waters of Albania. Proceedings of "International Conference on Carstic Water Bodies – Albalakes'2", ISBN: 978-99956-16-60-1, 87-95, Elbasan, Albania

Petrick G., Schulz D.E. and Duinker J.C. (1988): Clean-up of environmental samples for analysis of Organochlorine compounds by gas chromatography with electron-capture detection. *J. of Chromatography*, 435, 241-248.

Safe S., (1994): Polychlorinated biphenyls (PCBs): environmental impact, biochemical and toxic responses, and implications for risk assessment. *Rev. Toxicol.* 24(2):87-149.

Schantz M., Parris M., Kurz, J., Ballschmiter K. and Wise A. (1993): Comparison of methods for the gas-chromatographic determination of PCB congeners and chlorinated pesticides in marine reference materials. *Fresenius Journal of Analytical Chemistry* 346. 766-778.

Erickson D., (2001) Introduction: PCB properties, uses, occurrence, and regulatory history. In: Robertson, Hansen L.W., Edison L.G., PCBs: Recent Advances in Environmental Toxicology and Health Effects. The University Press of Kentucky, Lexington, Kentucky, pp. 131-152.

Fernández A., Alonso C., González J., Hernández M., (1998) Occurrence of organochlorine insecticides, PCBs and PCB congeners in waters and sediments of the Ebro River (Spain). *Chemosphere* 38, 33-43.

Nuro A., Marku E., Bishyti D., Haxhiaj B., Bregasi I., Koni B., (2009) "Organochlorine pesticides and polychlorinated biphenyls levels in biota and sediment samples of Vlora Bay". "Journal of Environmental Protection and Ecology". Nr, Vol. 4, pp 986-998

Villeneuve, J-P., Carvalho, F.P., Horvat, M., Cattini, C. (2004) Worldwide intercomparison on the determination of chlorinated pesticides, PCBs and petroleum hydrocarbons in a mussel tissue homogenate, IAEA-142. *Intern. J. Environ. Studies*, 64/1, pp. 437-452

AFTËSIA E TË MITURIT NË PËRBALLIMIN E SITUATAVE STRESANTE NË KUSHTET E MJEDISIT TË DETYRUAR

Ardita Prendi

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale

arditaprendi@gmail.com

ABSTRAKT

Duke qenë se vendi ynë është në zhvillim të vazhdueshëm prej disa vitesh, ne përballemi jo vetëm me fenomene sociale por dhe me elementët që mbart me vete ndryshimi. Një popullatë e prekur thellë prej ndryshimeve është dhe grupi i të miturve në konflikt me ligjin. Këta individë kalojnë në faza ekstreme stresuese, të cilat influencojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë zhvillimin e tyre psiko-social.

Ky studim ka për qëllim që të shqyrtojë dhe analizojë dinamikën mes mirëqënies psikologjike dhe strategjive të përballimit në mjedisin e detyruar.

Metoda kërkimore : Intervistimi i të 118 të miturve është kryer në një shtrirje kohore prej 16 muajsh dhe është ndarë në 4 faza intervistimi për të patur mundësi rishikimin e ndryshimit të gjendjes së tyre ose rirënies në një sjellje delinkuente. Për këtë janë përdorur një sërë instrumentash, si ai i Strategjive të Përballimit dhe ai i Mirëqënies psikologjike.

Rezultatet: Bazuar në rezultatet tona statistikore mund të themi se kemi një lidhje të drejtpërdrejtë të mënyrës sesi këta individë operojnë me krimin e kryer dhe sesi zhvillohet gjendja e tyre psikologjike në mënyrë që ata të ngelen funksional dhe në shumë raste të ripërsërisin krimin edhe pasi kanë mbaruar dënimin.

Konkluzionet: Minorenët të cilët janë në konflikt me ligjin dhe përjetojnë një sërë stresesh të lidhura me ambjentin në të cilin gjenden, zhvillojnë një aftësi psikologjike adaptuese në përshtatje me stilin e tyre të jetesës brenda mjedisit të detyruar pra burgut.

Fjalë kyçe: të mitur në konflikt me ligjin, përballim, mirëqënia psikologjike, stres psikologjik.

ABSTRACT

Background: Because our country is in continuous development for several years, we face not only with social phenomena about also with elements that are part of the change. A deeply affected population by the changes is the group of minors in conflict with law. These individuals go to extreme stressful phases, which directly influence their psycho-social development.

Objective: This study aims to examine and analyze the dynamics between psychological wellbeing and coping strategies in forced environment, prison.

Methodology: Such interviewing of 118 minors is conducted during 16 months and is divided into 4 phases of interview to have the opportunity to review the change of the circumstances or re-drop in delinquent behavior. For this are used a variety of instruments like Coping and the Psychological Wellbeing.

Results: Based on our statistical results we can say that we have a direct relation to how these people operate with the crime committed and how they develop their psychological condition so that they remain functional and in many cases re-enact the crime committed and after they have finished the sentence.

Conclusions: Minors who are in conflict with the law and experience in the state of detention or imprisonment a stress related to the environment in which they find themselves, develop adaptive psychological skills in appropriate to their style of living within the required environment.

Keywords: coping, the minor in conflict with the law, psychological wellbeing, psychological stres.

HYRJE

Statistikat zyrtare në Shqipëri, tregojnë se kriminaliteti është rritur shumë vitet e fundit, jo vetëm për shkak të rritjes së kriminalitetit në tërësi por sepse të miturit po bëhen gjithnjë e më shpesh viktimë të veprimtarive kriminale (Vjetari Statistikor 2012). Kriminaliteti i të miturve ka njohur zhvillime gjatë periudhës 1990-2014 qoftë në vëllim, strukturë, dinamikë, ashtu edhe në

nivelin e rrezikshmërisë dhe të mënyrës së kryerjes së veprave penale (Hysi, V. 2010).

Për rrjedhojë, nevojitet një studim jo vetëm në aspektin kriminologjik por edhe aspektin psiko-social, të cilit i është kushtuar shumë pak vëmendje nga ekspertët e fushave përkatëse. Të kuptuarit e veçorive të personalitetit tek të miturit në konflikt me ligjin bën të mundur, lehtëson perceptimin ose identifikimin e të miturve delinkuentë, por ajo që është më e rëndësishme është trajtimi i tyre me programe specifike rehabilitimi jo vetëm gjatë kohës së shlyerjes së dënimit por edhe pas saj.

Ky grup, pavarësisht llojit të aktit delinkuent që kanë kryer, në ambientet e paraburgimit pësojnë një lloj shoku apo transformimi psikologjik, i cili mund të ketë ndikim në zhvillimin e mëtejshëm të tyre jo vetëm në planin emocional por edhe atë konjitiv.

Operacionalizimi i terminologjisë

I mitur në konflikt me ligjin nënkupton personin që nuk ka mbushur ende moshën tetëmbëdhjetë vjeç (sipas Konventës së të Drejtave të Fëmijës), por që kanë mbushur moshën e përgjegjësisë penale (sipas Kodit Penal).

Përballimi: nënkupton “mendime dhe veprime realiste dhe fleksibile që i zgjidhin problemet, në mënyrë që të reduktohet stresi”.

Mirëqënie psikologjike: Sipas Wooldredge (1999) mirëqënia psikologjike është konceptuar si “reflektim i perceptimeve të shkelësve të ligjit, stresi, depresioni, zemërimi, vetëvlerësimi i ulët dhe ndjenja e vetmisë gjatë burgimit.

Stres psikologjik: “Një marrëdhënie midis personit dhe mjedisit që është vlerësuar nga ana e personit si taksative ose që tejkalon burimet e tij / të saj dhe që rrezikon mirëqënien e tij ose të saj” (Lazarus & Folkman 1984).

Qëllimi i studimit

Ky studim ka për qëllim që të shqyrtojë dhe analizojë psikologjinë e të miturit në konflikt me ligjin, dinamikën mes mirëqënies psikologjike dhe strategjive të përballimit në mjedisin e detyruar.

Objektivat e studimit:

Në mbështetje të realizimit të qëllimit kryesor u identifikuan një sërë objektivash specifike:

- Analizimi i mirëqënies psikologjike.
- Matja e strategjive të përballimit me mjediset e burgut dhe analizimi i tyre.
- Identifikimin e aftësisë për t'u përshtatur (sindromën e përshtatjes, adaptimit) me situatat stresuese.
- Të japë propozime dhe rekomandime për të përmirësuar mënyrën e trajtimit psikologjik të këtij kontigjenti në mjediset e detyruara dhe rolin që mund të kenë aktorët në këtë process.

Shqyrtimi i literatures

Për të analizuar mirëqënien psikologjike dhe strategjitë e përballimit është realizuar një shqyrtim i detajuar i literaturës bashkëkohore të fushës së psikologjisë së ligjit dhe psikologjisë. Në shkencën e psikologjisë për procesin e përballimit janë shpenzuar përpjekje të mëdha për të zgjidhur problemet personale dhe ndërpersonale duke kërkuar që të minimizohet ose tolerohet stresi apo konflikti. Efektiviteti i përpjekjeve të përballimit varet nga lloji i stresit ose i konfliktit të individit, si dhe rrethanat në të cilat ndodh ai.

Termi *përballim*, në përgjithësi i referohet strategjive përballuese adaptive ose konstruktive për të zvogëluar nivelin e stresit. Megjithatë, disa strategji përballuese mund të konsiderohen maladaptive dmth që rritin nivelin e stresit. Për më tepër termi përballim në përgjithësi i referohet përballimit riaktiv, dmth përgjigja përballuese ndjek stresorin në kontrast me përballimin proaktiv në të cilin një përgjigje përballuese synon të parandalojë një stresor në të ardhmen. Përgjigjet përballuese janë pjesërisht të kontrolluara nga personaliteti (tipare të përhershme) por edhe pjesërisht nga mjedisi shoqëror, veçanërisht nga natyra e ambientit stresues (Weiten, W; dhe Lloyd, M.A. 2008).

Një model tjetër i madh i dalë nga kjo fushë e hulumtimit është teoria e transaksionit të përballimit, e propozuar nga Lazarus dhe Folkman (1984). Ky model mënjanon asocimet mes përgjigjeve përballuese dhe efektivitetit të tyre në lidhje me zgjerimin e fushëveprimit të përfshirjes së mundshme (të përgjigjeve të përballimit) brenda kufijve të stresit psikologjik. Ky model është i bazuar në vlerësimin njohës (konjitiv) dhe rivlerësimin e ngjarjeve stresuese dhe zbatimin e një sërë strategjive përballuese në përgjigje të kërcënimit potencial apo situatave të dëmshme.

Sipas Wooldredge (1999) mirëqënia psikologjike është konceptuar si “reflektim i perceptimeve të shkelësve të ligjit, stresi, depresioni, zemërimi, vetëvlerësimi i

ulët dhe ndjenja e vetmisë gjatë burgimit. Literatura e gjerë synon përcaktimin e funksionimit psikologjik pozitiv duke përfshirë perspektiva të tilla si Maslow (1968) me konceptin e vetë-aktualizimit, Rogers (1961) me pikëpamjen e funksionimit të plotë të personit, Jung (1933, Von Franz, 1964) me formimin e individualitetit dhe Allport (1961) me konceptin e pjekurisë. Një domen i mëtejshëm i teorisë për përcaktimin e mirëqënies psikologjike vijon nga perspektivat zhvillimore të jetës, të cilat theksojnë se sfidat e ndryshme konfrontohen në faza të ndryshme të ciklit të jetës. Përmendim Erikson (1959) me modelin psikosocial, tendencat jetësore themelore të Buhler që punojnë drejt përbushjes së jetës (Buhler, 1935; Buhler & Massarik, 1968), dhe Neugarten (1968, 1973) me përshkrimet e personalitetit që ndryshojë në moshën e rritur dhe moshën e vjetër. Kriteret pozitive Jahoda-s (1958) të shëndetit mendor, të krijuara për të zëvendësuar përkufizime të mirëqënies si mungesë të sëmundjes, gjithashtu ofrojnë përshkrime të gjera se çfarë do të thotë të jesh me shëndet të mirë psikologjik.

Për të kuptuar më shumë rreth mirëqënies psikologjike le të vijojmë më poshtë. Ryff (1989) eksploroj kuptimin e mirëqënies psikologjike, dimensionet e mirëqënies psikologjike, në të cilat u fokusua janë vetëpranimi, marrëdhëniet positive me të tjerët, autonomia, zotërimi i mjedisit, qëllimi në jetë dhe rritja personale. Ryff e shpjegon *vetëpranimin* si aftësi të njerëzve për tu vetëaktualizuar, të jenë optimal në funksionimin e tyre, të jenë të maturuar dhe të kenë një qëndrim pozitiv karshi vetes së tyre dhe të kaluarës së tyre. Ndërsa *marrëdhëniet positive me të tjerët* i shpjegon si aftësi të njerëzve për të patur marrëdhënie ndërpersonale besimi dhe ngrohtësie, të jenë në gjendje të identifikohen me të tjerët dhe të kenë edhe aftësinë të lidhen me të tjerët dhe të mësojnë prej të tjerëve. Ajo e shpjegon *autonominë* si aftësinë e njerëzve për të qënë vetëpërcaktues, të pavarur, të jenë në gjendje të rregullojnë sjelljet e tyre edhe brenda vetes së tyre. Ryff shpjegon *zotërimin e mjedisit* si aftësinë për të zgjidhur dhe për të parë mjediset që janë të përshtatshme për ta si persona, ashtu si dhe aftësinë për të qënë fleksibël në mjedise të ndryshme. Ndërsa *qëllimin e jetës* e shpjegon si aftësi të njerëzve që kanë drejtim dhe qëllim në jetët e tyre aq sa ata kuptojnë. Së fundmi, ajo e shpjegon *rritjen personale* si aftësinë e njerëzve për të vazhduar zhvillimin potencial të tyre, rritjen dhe shpalosjen e potencialit të tyre. Të gjithë këta faktorë mund të konsiderohen si komponentë çelës që nxjerrin në pah konceptin e *mirëqënies psikologjike*. Si rrjedhojë, adoleshentë të cilët shfaqen të fuqishëm në secilën nga këto zona do të jenë në një gjendje të mirë të mirëqënies psikologjike, ndërsa adoleshentët të cilët luftojnë në këto zona do të jenë në gjendje të ulët të mirëqënies psikologjike.

Metodologjia

Kampioni

Pjesëmarrësit në këtë studim janë të mitur që kanë kryer vepra penale dhe i përkasin moshës nga 14 gjer në 18 vjeç. Të miturit i përkasin dy grupeve të marra në studim, grupit të parë atij të paraburgimit, që do të thotë që ata ende nuk kanë marrë dënimin dhe grupi i dytë janë të miturit e dënuar, pra që janë dënuar me burgim dhe janë duke e vuajtur atë. Të gjithë të miturit që janë pjesëmarrës në këtë studim janë të gjinisë mashkullore (meshkuj), pra nuk ka asnjë të mitur femër, specifike kjo për vendin tonë krahasuar me studime të ngjashme bashkohore të kryera në vende të tjera ku të miturit i përkasin të dyja gjinive.

Procedura e përfshirjes së kampionit në plotësimin e instrumentave

Së pari të miturit u ftuan të marrin pjesë në studim me anë të një ftese bashkëpunimi e cila përmbante shkurtimisht këto çështje:

- Përshkrimin e qëllimit të studimit
- Lejen e tyre për t'i përfshirë në studim

Së dyti, me të miturit të cilët plotësuan pyetësorin, u kontaktuan nën asistencën e psikologut dhe punonjësit social. Pjesëmarrësit që ndodheshin në IMK u informuan për vendin në të cilin do të plotësoheshin pyetësorët dhe kodin e tyre. Pjesëmarrësit u siguruan se do të ruhej konfidencialiteti dhe anonimat si parime bazë të etikës, si dhe u siguruan se të dhënat e tyre do përdoren vetëm për qëllime shkencore dhe kjo gjë u arrit duke marrë edhe lejen e tyre.

Matjet

Instrumentat kërkimorë të studimit.

Të dhënat e mbledhura janë klasifikuar sipas të dy instrumentave kërkimorë që do të prezantohen më poshtë.

- Pyetësori për matjen e mirëqënies psikologjike
- Inventari i Strategjive të Përballimit në situata stresante

Pyetësori për matjen e mirëqënies psikologjike.

Instrumenti i parë që u përdor gjatë këtij studimi ishte pyetësori për matjen e mirëqënies psikologjike. Ky pyetësor përmban 6 shkallë me nga 14 pyetje, ndërtoar për të matur dimensionet e autonomisë, zotërimin e mjedisit, rritjen personale, marrëdhëniet pozitive me të tjerët, qëllimin në jetë, dhe vetë-pranimin.

Pjesëmarrësit përgjigjen duke përdorur një format me gjashtë pika si më poshtë:

- | | | |
|-----------------------------|----------------------|-----------------|
| 1. Nuk pajtohem kurrësi pak | 2. Nuk pajtohem disi | 3. Nuk pajtohem |
| 4. Pajtohem pak fuqimisht | 5. Pajtohem disi | 6. Pajtohem |

Inventari i Strategjive të Përballimit në situata stresante

Inventari i Strategjive të Përballimit (ISP) është një pyetësor vetë-raportues i përbërë nga 72 pyetje në një format prej 5 shkallë Likert. Përgjigjet e treguara për secilën shkallë shtrirjeje, janë paraqitur si përgjigje përballuese në lidhje me situatat e përshkruara më poshtë.

- a. Aspak b. Pak c. Disi d. Shumë e. Shumë më tepër

Rezultate dhe diskutime

Kampioni i marrë në konsideratë në këtë studim përmbush kriteret e një kampioni kualitativ, prej të cilit janë nxjerrë rezultate mjaft interesante.

Të dhënat cilësore të të gjitha fazave ndihmojnë për të çuar më tej të kuptuarit tonë rreth përvojave të të miturve në konflikt me ligjin, të shumë elementëve të tjerë qofshin këto brenda mjedisit të burgut apo jashtë, të cilët mund të kenë impakt në mirëqënien psikologjike dhe mënyrën sesi përballen të miturit me jetën brenda Institucionit ku kryejnë masën e dënimit ose janë në proces gjyqësor.

Sipas Siddique dhe D'Arcy (1984) stresi në familje ka impakt të fortë negativ në mirëqënien psikologjike të adoleshentit. Nëse i referohemi të dhënave të fazës së parë rezulton se 22,2 % (6 persona nga 27 të intervistuar) e të miturve i përkasin familjeve me varfëri ekstreme (Figura 1). Ndërkohë që 55, 6 % (15 persona nga 27 të intervistuar) e kampionit i përkasin familjeve me të ardhura

minimale ndërsa pjesa tjetër prej 22, 2% (6 persona nga 27 të intervistuar) i përkasin familjeve me të ardhura në normë.

Një tjetër element risku, që ka impakt tek të miturit është gjendja familjare e tyre. Disa studime kanë treguar se, cilësia e marrëdhënies brenda familjeve, veçanërisht prindërve është një faktor përcaktues i mirëqënies psikologjike tek adoleshentët (psh, Shek, 1997; Sastre & Ferriere, 2000; van Well, Linssen & Ruud, 2000). Gjetjet sugjerojnë një "lidhje të ngushtë ndërmjet funksionit të familjes dhe përshtatjes psikologjike, veçanërisht shëndetit mendor pozitiv të adoleshentëve". Nëse i referohemi të dhënave të raportuara nga të miturit, rezultojnë se pikërisht tek ata të mitur që vijnë nga familje me funksionim normal (jo të divorcuara, me të dy prindërit në marrëdhënie pune, kontakte të vazhdueshme me familjarët etj.) vërehen nivele më të larta të mirëqënies psikologjike brenda mjedisit të detyruar dhe më pak shfaqje të sjelljeve problematike ose aggressive, ndryshe nga të miturit që vijnë nga familje të divorcuara apo me një prind.

Stresi i burgosjes sfidon këdo, madje edhe ato që janë më të aftë në përballimin e fatkeqësive. Megjithatë, shkelësit adoleshentë përballen me këtë situatë me disavantazhin e të qenit ende të papjekur. Nga vëzhgimet e kryera vërehet se shëndeti psikologjik është i varfër por që përmirësohet pas disa muajsh të të qenit në burg. Tek të dënuarit shfaqen devijanca specifike, të cilat përfshijnë problemet emocionale (apati, ngurtësim emocional, tërheqje sociale, etj.), probleme në lidhje me të tjerët, ka raste që shfaqin dhe shenja të depresionit e të tërheqjes emocionale. Përveç kësaj, ata shfaqin zemërim dhe demoralizim nga ambjentet e burgut, shqetësime të gjumit, humbje të oreksit, të cilat janë më shumë evidente tek ata individë, të cilët kanë pak kohë që ndodhen në të tilla mjedise (Zamble & Porporino, 1988).

Burgimi i ndan të rinjtë nga rrjetet e tyre sociale në një kohë kur mirëqënia e të rinjve (Helsen, Vollebergh, dhe Meeus, 2000) dhe përvetësimi i aftësive përballuese (Patterson & McCubbin, 1987) janë të ndikuar ende shumë nga familja. Në të njëjtën kohë adoleshentët i perceptojnë marrëdhëniet e tyre me miqtë si gjithnjë e më të rëndësishme (Helsen et al., 2000). Tërheqja dhe izolimi social është shkalla e lartë e çrregullimit psikologjik në mesin e shkelësve të adoleshentëve (Teplin et al., 2002), të cilat mund ti bëjnë të miturit veçanërisht të prekshëm nga streset e burgosjes.

Ky studim konstaton se shkelësit adoleshentë angazhohen në përpjekjet për të përballuar dhe se ata favorizojnë strategjitë me fokus -orientimin, të tilla si kërkimi social, mbështetje dhe teknikat aktive përballuese, si dhe pranimi. Megjithatë, përpjekjet e mbijetesës tek këta të rinj kanë vetëm efekte modeste në përshtatjen brenda muajit të parë të burgosjes.

Një gjetje që mund të shikohet si e habitshme është rënia mesatare e simptomave të psikopatologjive gjatë rrjedhës së muajve të parë të burgosjes. Megjithatë, ky model është në përputhje me hulumtimet e tjera ekzaminuese të

përshtatjes psikosociale në fazat e para të burgosjes së adoleshentëve (Brown & Irlandws, 2006). Kurba ka të ngjarë se rezulton nga stresi i rritur dhe lidhet me tranzicionet dhe përshtatjen me një mjedis të ri.

Gjetjet e këtij studimi nuk mund të jenë përgjithësuese për popullata të gjera, ato kufizohen vetëm tek ky kontigjent. Ato ofrojnë një panoramë të faktorëve që mbështesin përbalimin. Është e qartë se pjesëmarrësit në këtë studim përshtaten dhe përballojnë jetën brenda institucionit përkatës në varësi të disa faktorëve të mëposhtëm: personalitetit, predispozitës të tyre në lidhje me shpresën dhe optimizmin, aftësisë së tyre për tu bërë pjesë e rutinës që u jep të kuptuarit dhe qëllimi në jetë; aftësia e tyre për t'iu nënshtruar regjimit të burgut e cila ende mbetet një ndjenjë (sens) e autonomisë dhe kontrollit mbi jetën e tyre, cilësia e kontakteve familjare dhe mundësia për arsimim apo kurse profesionale.

Konkluzione

Ajo çfarë është e dukshme nga ky studim lidhet me faktin se të miturit mësojnë të jetojnë brenda kufizimeve të izolimit, përshtaten dhe zhvillojnë një rutinë për veten e tyre. Ajo çfarë sugjerohet të studiohet në të ardhmen është të kuptuarit e marrjes së vendimeve dhe procedurat e procesit gjyqësor nga ana e të miturve, të drejtat për t'u informuar rreth të drejtave dhe detyrimeve të tyre ligjore.

Një formë për të demonstruar disi këtë lidhje të drejtpërdrejtë midis faktorëve të ndryshëm është dhe tabela e mëposhtëme, e cila tregon një korrelacion të lartë të statusit social të individëve të marrë në studim dhe suporit social të ofruar ndaj tyre.




Figura 1: Statusi Social i parë nga niveli ekonomik.

		Statusi social	Supporti Social Shuma
Statusi social	Pearson-Korrelation	1	,525**
	Sig. (2-part)		,005
	N	27	27
Supporti Social Shuma	Pearson-Korrelation	,525**	1
	Sig. (2-part)	,005	
	N	27	27

** . Korrelacioni është sinjifikant në nivelin 0,01.

Tabela 1: Korrelacion midis Statusit Social dhe Mbeshtetjes sociale.

Referenca

Allport, G. W. (1961). *Pattern and growth in personality*. New York: Holt, Rinehart & Winston.

Brown SL, Ireland CA. 2006. Coping style and distress in newly incarcerated male adolescents. *Journal of Adolescent Health*, 38, 656-661.

Buhler, C, dhe Massarik, F. (Eds. 1968. *The course of human life*. New York: Springer.

Buhler, C. 1935. The curve of life as studied in biographies. *Journal of Applied Psychology*, 19, 405-409.

Erikson, E. 1959. Identity and the life cycle. *Psychological Issues*, 1, 18-164.

Folkman, S., & Lazarus, R. S. 1984. Coping as a mediator of emotion. *Journal of personality and social psychology*, 54(3), 466-75.

Helsen M, Vollebergh W, Meeus W. Social support from parents and friends and emotional problems in adolescence. *Journal of Youth and Adolescence*. 2000; 29:319-335.

Hysi, V. 2010. *Kriminologjia*. Tirana: 142-143.

Jahoda, M. 1958. *Current concepts of positive mental health*. New York: Basic Books

Jung, C. G. 1933. *Modern man in search of a soul* (W. S. Dell & C. F. Baynes, Trans.). New York: Harcourt, Brace, & World.

Maslow, A. H. 1968. *Toward a psychology of being* (2nd ed). New York: Van Nostrand.

Ministria e Drejtësisë. Vjetari Statistikor 2012; Tiranë 2013).

Neugarten, B. L., Havighurst, R., & Tobin, S. 1961. The measurement of life satisfaction. *Journal of Gerontology*, 16, 134-143.

Patterson JM, McCubbin HI. 1987. Adolescent coping style and behaviors: Conceptualization and measurement. *Journal of Adolescence*. 10:163-186.

Ryff, C. D. 1989. Happiness is every thing, or is it? Explorations on the meaning of psychological well-being. *Journal of Personality and Social Psychology*, 57, 1069-1081.

Siddique, C., & D'Arcy, C. 1984. Adolescents, stress and psychological well-being. *Journal of Youth and Adolescence*, 13, 459-473

Shek, D. 1997. The relation of family functioning to adolescent psychological well-being, school adjustment, and problem behavior. *The Journal of Genetic Psychology*, 158, 467-479.

Sastre, M., & Ferriere, G. (2000). Family decline and the subjective well-being of adolescents.

Social Indicators Research, 49, 69-82

Teplin LA, Abram KM, McClelland GM, Dulcan MK. 2002. Psychiatric disorders in youth in juvenile detention. *Archives of General Psychiatry*. ; 59:1133-1143.

Von Franz. M.L. 1964. The process of individuation. In C. G. Jung (Ed.), *Man and his symbols* (pp. 158-229). New York: Doubleday.

VanWel, F., Linssen, H., & Abma, R. 2000 . The parental bond and the well-being of adolescents and young adults. *Journal of Youth and Adolescence*, 29, 307-318.

Weiten, W. & Lloyd, M.A. 2008. *Psychology Applied to Modern Life (9th ed)*. Wadsworth Cengage Learning.

ARE ROUTINE PREOPERATIVE MEDICAL TESTS NEEDED WITH CATARACT SURGERY?

Arjeta Grezda, Ermal Simaku, Mirela Hoxha

"Art" Eye Clinic, Tirana, Albania

Abstract

Purpose:

The aim of this prospective randomized clinical study was to investigate whether routine medical testing before cataract surgery reduced the rate of ocular surgical complications.

Key words:

Cataract surgery, EKG, Hipertension, Intraoperativ complication, premedication.

Methods:

The study was carried out in "ART" Eye Private Clinic in Tirana. 200 patients having cataract and scheduled for cataract surgery were randomly assigned to one of two groups: 1) to be preceded by routine medical testing (the "routine-testing group") or 2) not to be preceded by routine medical testing (the "selective-testing group"). If the patient was assigned to the selective-testing group, it was requested that no preoperative testing be performed unless the patient presented with a new or worsening medical problem that would warrant medical evaluation with testing. In the case of patients assigned to the routine-testing group, the following tests were requested: an electrocardiogram, a complete blood count, measurements of serum glucose and systemic blood pressure and also history of systemic medication mainly the use of anticoagulant (although discontinued before surgery) or antiplatelet medication and the use of acetylsalicylic acid. Ocular surgical intraoperative and postoperative complications were recorded involving: bleeding into the anterior chamber during the surgery, uveal effusion syndrome without or with vitreous loss, signs of fibrinous reaction postoperatively.

Results:

The sample of 200 patients scheduled to undergo cataract surgery was comprised of 87 assigned to the routine-testing group and 113 assigned to the selective-testing group. The cumulative rate of ocular surgical complications was similar in the two groups. Most of the complications were related to systemic hypertension. Bleeding into the anterior chamber during the operation was recorded in almost all the patients taking anticoagulant medication, even after discontinuation of the medication, but no sight-threatening bleeding occurred. Uveal effusion syndrome was recorded in both groups, but mostly with the patients having systemic hypertension and sclerotic vessels. 2 cases were associated with vitreous loss. The use of acetylsalicylic acid was associated with an increased risk of postoperative fibrinous reaction observed in 8 patients.

Conclusions:

The results of this study suggest that routine medical testing before cataract surgery did not reduce the rate of ocular surgical complications, but strongly suggest the importance of the medical history of the patient and systemic diseases in order to prepare the plan of handling the complications.

Introduction

Cataract surgery is the most common operation performed in the population having eye problems. It is a proven highly effective and safe procedure, offering notable improvements in visual function and quality of life. In the past, the traditional approach for patients scheduled for cataract surgery included a comprehensive medical evaluation with laboratory testing, i.e., complete blood counts (CBC), serum electrolytes, and electrocardiograms. The saving cost programs need of studies referring whether the preoperative lab tests are necessary to improve outcome of cataract surgery.

Background

In 1994, the Agency for Health Policy and Research initiated the Study of Medical Testing for Cataract Surgery¹ to assess whether routine medical testing prior to cataract surgery reduces the rate of complications in the perioperative interval. There is evidence from at least three randomized clinical trials that suggests preoperative medical testing for cataract surgery does not protect against medical adverse events.^{1,2,3} These studies were the focus of a Cochrane review in 2009, which was updated in 2012.^{4,5} and demonstrate that routine preoperative laboratory testing in patients scheduled to undergo cataract surgery is not necessary. The overall rate of medical complications following cataract surgery was low, and generally not serious or life-threatening. Adverse events developed at the time of surgery or within seven days of surgery is very low.

Methods

Our study included 200 patients scheduled for cataract surgeries, where 87 patients were assigned to routine-testing group and 113 patients were assigned to selective-testing group.

In the routine -testing group age of the patients was 71-92years old with the average age of 79.68 year from which 47 patients were male and 40 patients were female.

In the selective-testing group the age of the patients was 73-84 years old with the average age of 78.5 year, from which 54 patients were male and 59 patients were female. The two groups of patients studied were comparable in age, sex,

A preoperative history and physical examination was performed, and patients were randomized to routine testing (CBC, EKG, electrolytes, blood glucose) versus testing only when a finding on the history or physical would have led to a lab test even without planned cataract surgery. Specific tests were conducted in the "control" group as per the direction of the attending physician. Patients in both groups had a finger-stick blood sugar test if they were diabetic.

Follow-up data were 100% complete on the day of surgery and one week after surgery. The study demonstrates that routine preoperative laboratory testing in patients scheduled to undergo cataract surgery is not necessary but still questionable in certain cases. The overall rate of medical complications following cataract surgery was low, and generally not serious or life-threatening.

Bleeding into the anterior chamber during the operation was recorded in almost all the patients taking anticoagulant medication, even after discontinuation of the medication, but no sight-threatening bleeding occurred.

Uveal effusion syndrome was recorded in both groups, but mostly with the patients having systemic hypertension and sclerotic vessels. It was recorded that the preoperative treatment of these patient by anesthesiologist with medication to lower the blood pressure would greatly facilitate the success of cataract procedure.

2 cases were associated with capsular and vitreous loss due to increased blood pressure during the initiation of cataract extraction procedure.

The use of acetylsalicylic acid was associated with an increased risk of postoperative fibrinous reaction observed in 8 patients.(Tab 1.)

Conclusion:

Routine medical tests performed on patients before cataract surgery do not seem necessary because they do not increase the safety of the procedure. While medical adverse events are higher in patients with medical comorbidities, there is no benefit in providing routine testing to groups of patients with co-existing illnesses.Preoperative medical tests can be ordered when a finding on a history or physical examination indicates a need, even if surgery is not scheduled.

The results of this study suggest that routine medical testing before cataract surgery did not reduce the rate of ocular surgical complications, but strongly suggest the importance of the medical history of the patient and systemic diseases in order to prepare the plan of handling the complications.

References

1. Schein OD, Katz J, Bass EB, et al: The value of routine preoperative medical testing before cataract surgery. *NEJM* 2000;342(3):168-75.
2. Lira RP, Nascimento MA, Moreira-Filho DC, Kara-Jose N, Arieta CE. Are routine preoperative medical tests needed with cataract surgery? *Pan American Journal of Public Health* 2001;10(1):13-7.
3. Cavallini GM, Saccarola P, D'Amico R, Gasparin A, Campi L. Impact of preoperative testing on ophthalmologic and systemic outcomes in cataract surgery. *European Journal of Ophthalmol*2004;14(5):369-74.
4. Keay L, Lindsley K, Tielsch J, Katz J, Schein O. Routine preoperative medical testing for cataract surgery. *Cochrane Database of Systematic Reviews* 2009, Issue 2. Art. No.: CD007293. DOI: 10.1002/14651858.CD007293.pub2.
5. Keay L, Lindsley K, Tielsch J, Katz J, Schein O. Routine preoperative medical testing for cataract surgery. *Cochrane Database of Systematic Reviews* 2012, Issue 3. Art. No.: CD007293. DOI: 10.1002/14651858.CD007293.pub3.

	Bleeding in AC	Uveal effusion	Viteous loss	Fibrinous reaction
Routine-testing group (1)	31.7%	9.1%	1.1%	3.44%
Selective-testing group (2)	30.6%	11.5%	0.8%	3.53%

Tab 1: Complications in % faced in the two different groups.

DE RADA DHE VEPRA E TIJ “PARIMET E ESTETIKËS”

Prof. Dr. Bardhosh Gaçe

Universiteti “Ismail Qemali” – Vlorë

Abstrakt

De Rada është njëri nga shkrimtarët emblematic shqiptar, i cili krijoi dhe solli kontribute të veçanta dhe në fushat e tjera të dijes, që vërtiteshin apo rridhnin nga marrëdhënia shumë e ngushtë që autori kishte me letërsinë dhe estetikën. De Rada, në prerjen historike të zhvillimeve letrare të kohës, veçmas në përthyerjet e mendimeve teorike dhe çështjeve estetike në Evropë, zë një vend të vetin. Pavarësisht zhvillimit të madh mendor në filozofi dhe në estetikë, për shkakun e zhvillimeve të mëdha në dije, kulturë, rendet shoqërore, ato të shkollës, të krijimtarisë, De Rada e gjeti veten të përfshirë në këtë debat, duke lënë në historinë e mendimit dhe të dijes, traktate teorike dhe të debatueshme, falë një kulture të gjerë dhe të qëndrueshme, që ai kishte në shumë fusha të dijes.

Që në antikitetin e hershëm, kur doktrinat e dijes filluan të kërkonin shpjegimin dhe kodifikimin e dukurive dhe fenomeneve sociale, psikologjike, ato të prodhimit shpirtëror, ka pasur një bashkëpërkim specifikash në një lloj interpretimi filozofik. Për shkakun e njohur dhe gjendjen dyshuese, që kanë dukuritë dhe fenomenet, përmes filozofisë dhe çështje të tjera të dijeve, si letërsia, historia, sociologjia, psikologjia etj., u produktuan po përmes filozofisë.

Jo vetëm De Rada, por dhe shumë krijues të tjerë, njerëz të mendimit dhe të estetikës në mënyrë të veçantë filozofinë dhe estetikën, i kanë mbajtur afër njëra tjetrës. Në të vërtetë në këtë fushë dijeje, filozofia dhe estetika plotësojnë njëra- tjetrën. Në fushën e interpretimit të dukurive, fenomeneve, dijes së gjerë, që duket si një nevojë e domosdoshme për t’u sjellë me botën, De Rada është modeli i përkryer i mbajtjes afër të filozofisë dhe estetikës, aq sa hapësirën më të madhe të veprës e zënë deduksionet filozofike, problemet sociale, ato të shkollës, të utilitaritetit, të prodhimit mendor dhe material dhe çështje të tjera.

Studimi për çështje specifike të letërsisë dhe të estetikës përmes traktatit të njohur vonë dhe ndoshta jo të plotë të De Radës, nuk mund të jetë i shkëputur dhe i veçuar, pasi pjesa më e madhe, madje gati e gjitha, e çështjeve specifike në opinionin e autorit, vijnë përmes bashkëveprimit të fushave të veprimtarisë njerëzore, të dijeve të nxëna prej tij dhe këndvështrimit argumentues të tij në sintetizëm dijesh. Është e vështirë të shkëpusësh estetikën nga filozofia dhe gjendja e brendshme e njerëzve që bëjnë artin, për ata që bëhet arti dhe për ku është drejtuar arti, d.m.th është e pamundur të shkëpusësh të bukurën nga psikologjia dhe bashkëveprimtaria, aq më tepër jashtë formimit të tij të njohur panteist.

Në këtë kuptim dhe kompleks gjërash, De Rada është një autor në proces njohjeje, jo vetëm se vepra e vetme e tij për çështjet estetike është e fragmentarizuar, por siç duket ka akoma mundësi të reja njohjeje dhe hulumtimi, që për autorin duhet gjurmuar.

1.

Çështjet estetike, të cilat De Rada i vlerësonte dhe ishte i gjerësuar në dije për t'i bërë të besueshme, ashtu siç ai i kishte të besueshme për veten e tij, vijnë në një kohë kur e gjithë dija estetike evropiane ishte e përfshirë në teza dhe kundërteza, në debate hipotetike dhe të argumentuara, në referenca që ishin brenda dhe jashtë kohës së tyre. Përgjithësisht, ashtu si në mendimin estetik evropian, dhe De Rada nuk ishte i vonuar dhe as i papërfshirë në zhvillimet kohore, të cilët kishin të bënin me lëvizje të mëdha sociale, me rinde ekonomike, që prodhonin dhe liderë të mendimit filozofik, social, letrar dhe historik. Teoria dhe parimet estetike të De Radës përkojnë me zhvillimet bashkëkohore të autorit si Revolucioni Francez apo lëvizje të befta në Itali, Spanjë, Gjermani, Angli dhe ShBA, të cilët reflektojnë në mendimin e autorit. Autori është i besueshëm dhe i ndikuar vetëm përmes njohjes dhe pavarësisë që ai posedon për çështjet që shtron dhe i debaton.

Në pikëpamjen estetike, në terrenin e debatit kulturologjik dhe çështjet specifike të letërsisë, debatonin idetë dhe mbështetësit e antikitetit, romantizmit, klasicizmit dhe realizmit pothuajse. Në këtë terren kaq të gjerë dhe kaq problematik, kur shoqëria lëvizte me një shpejtësi të madhe drejt zhvillimeve të kapitalit dhe të një dimensionit tjetër për shtetin, kulturën, shoqërinë në të gjithë vertikalishtin e saj, mundësia për t'u orientuar ishte e vështirë.

Pikëpamjet estetike, mbi konceptet themelore të estetikës, llojeve, zhanreve, klasifikimet, mjetet e pasqyrit, modeli i heroit apo personazhit, nevoja për të vlerësuar artin dhe çështje të tjera, padyshim kërkonte një kulturë të nxënë mirë, kërkonin bashkëkohësi, inteligjencë dhe aftësi argumentuese.

Në këtë kohë dhe kushte, u bë e njohur dhe u botua dhe vepra e De Radës e titulluar “Principii di estetika”¹, për të cilën studiuesi Alfred Uçi mendon se vepra e botuar në katër apo pesë libra, si pjesë të “parimeve estetike” të tij, mund të mos jetë i plotë, por diçka ka humbur apo nuk është përfshirë në libër.² Studiuesi Alfred Uçi i referohet në këtë opinion dhe studim të hollë, që shoqëron botimin për herë të parë të “Parimeve te estetikës” të De Radës, një lloj fragmentarizmi që ka vepra, ndoshta dhe një disproporcioni, që kanë librat që përbëjnë veprën e madhe të çështjeve estetike të De Radës.

Më parë se të shkonim tek idetë e “pastra” estetike të De Radës, kryesisht përmes kësaj vepre, studiuesi nuk mund t’i shmanget dot shtratit dhe ngrehinës së opsioneve dhe ideve në të cilën De Rada i ka vendosur këto ide dhe gjykime të holla mbi estetikën. Vepra, gjithsesi e titulluar “Principii di estetika” është një vepër e gjerë, ku autorit i është mundësuar, të shtrojë dhe të debattojë, të mbrojë dhe të shpjegojë idetë e tij filozofike, sociologjike, politike, etike dhe estetike.

Me këtë rast është e natyrshme të konsiderohet se De Rada, në këtë lëndë të gjerë, por jo të plotë, ka gjetur mundësinë për të debatuar për çështje të tilla. Gjithashtu bëhet fjalë për një kohë relativisht të kaluar, po ta shohim nga drita e sotme e ideve estetike, është mesi i shekullit të XIX, kohë kur estetika nuk ishte e shkëputur plotësisht nga filozofia, ndikimi i saj dhe marrëdhënia e ngushtë me të.

Për ta lehtësuar konceptimin dhe çështjen studimore nga vizioni i çështjeve të ditëve të sotme, me ç’rast çështjet estetike janë të rëndësishme për të studiuar De Radën, pasi ai njihet si poet më së shumti, është e domosdoshme të arrijmë të ndajmë konceptet dhe çështjet që shtron vepra, por pa i cenuar marrëdhëniet që çështjet kanë me njëra-tjetrën, kur bëhet fjalë për t’i argumentuar ato sipas botëkuptimit dhe formimit që ka pasur vetë De Rada.

Në njërin anë do të ishte e arsyeshme të kishim një vëmendje arsyetuese të çështjeve që kishin të bënin me përcaktimin e shpirtit, intelektit, ndjenjave, ndërgjegjes së njeriut (libri i parë), rëndësinë e bujqësisë, dobinë e punës fizike, rolin e luftërave dhe armatimit në jetën e shoqërisë (libri i dytë dhe më i fragmentarizuar), të bukurën dhe problemin e të madhërisës (libri i tretë), problemet gnoseologjike, si njohja racionale e së vërtetës, raporti mes mendimit e gjuhës, shkolla etj (libri i katërt) dhe parimet estetike, kryesisht të së bukurës, rreth të cilës vërtiten shumë çështje të tjera filozofike, psikologjike, historike, folklorike, të personalitetit etj.

2.

Që në krye të herës, për De Radën duhet thënë se ai ka qenë dhe në të gjithë interpretimet e tij filozofike dhe të estetikës panteist. I tillë mbeti gjatë

¹ “Principii di estetika”, Napoli, 1861

² Jeronim De Rada”, “Parime të estetikës”, Tiranë 2003, botoi “Globus R”, fq.221,

gjithë kohës, me të cilën mbyllën dhe shënimet e tij për çështje të tilla. Vepra në fjalë, e cila është një traktat për çështjet estetike, por jo për çështje të tjera, duket e përfshin një kohë të gjerë shtrirjeje dhe absorbimi nga autori. Kjo kuptohet jo vetëm me kohështrirjen, por dhe konceptet, mënyrën se si ato trajtojnë objektin e autorit.

Panteizmi, një dukuri e hershme filozofike dhe besimi, që në antikitetin e hershëm, të cilin ne e gjejmë deri vonë tek poeti ynë rilindës Naim Frashëri, duket se e ka shmangur nga shumë ballafaqime të rëndësishme autorin, pasi vlerësimet për materien nga De Rada, vijnë nga dije jo shumë bashkëkohore të tij. Një kufizim i tillë ka kushtëzuar dhe shumë çështje të tjera që janë bashkëvepruese në çështjet e të bukurës dhe të madhërishtes.

De Rada u kushtëzua gjithashtu, madje në një mënyrë ishte i detyruar të ketë një interpretim të tillë filozofik-estetik, për shkakun e marrëdhënies së fortë që ai mbajti me vendin e të parëve të tij dhe të tij, nga pozitat e një poeti që jetonte në një vend të huaj, pavarësisht se ai e kishte gjetur veten mirë atje, për shkakun e karakterit të theksuar shpirtëror të origjinës së tij, me çfarë karakterizohen shqiptarët, me çështjet e atdhedashurisë, lidhjes së fortë që ai mbante me kujtimin e Skënderbeut dhe shumë çështje të tjera të thella, që nuk mund t'i shmangte dot.

De Rada ka një tipar karakteristik, i zgjuar dhe intelekt dhe për çështjet estetike, për të cilat është botuar dhe traktati i tij "Principii di estetika", sepse i sheh gjërat në bashkëveprim dhe marrëdhënie, të cilat duket se sipas tij e kanë burimin tek shpirti. Në këtë përjasje autori fut dhe natyrën. "Burimi i përsosjes së natyrës së shpirtit dhe e mira e tij qëndrojnë në përvetësimin (*bashkëveprim shën. B.G*) e virtyeteve, kulmi i jetës së shpirtit është bukuria³", thotë autori, duke e hyjnizuar dhe absolutizuar si të pavarur⁴. Krijimtaria e tij, e cila zë pjesën më të madhe të jetës së tij si krijues, kryesisht poet, është absolutisht referente e kujtimit të vendit të tij me "Milosau", "Serafina Topia", "Fjamuri i Arbërit" (Revistë), "Rapsodi të një poeme shqiptare..." (përmbledhje këngësh shqiptare në Napoli), në të cilat gjenden më së shumti të mishëruara dhe konceptet e tij estetike dhe gjithë lënda referenciale adekuate e tij për t'i motivuar idetë e tij.

Një nga çështjet e debatuar, për të cilën De Rada është përpjekur të sjellë mjaft lëndë referenciale është shpirti dhe mendja, në një dialektikë të vazhdueshme me njëra-tjetrën. Duke konsideruar madhësinë një tipar të së bukurës, autori e karakterizon madhësinë si burim të shpirtit, e cila gjendet më shumë se kudo "*në qetësinë dhe qëndresën*"⁵ dhe që shfaqet zakonisht në "*bëmat jetëgjatë*"⁶. Ndërsa për mendjen, duke e konsideruar epiqendrën e

³ Jeronim De Rada", "Parime të estetikës", Tiranë 2003, fq.50

⁴ Po aty, fq.35,

⁵ Po aty, fq.104,

⁶ Po aty, fq.107,

njeriut e vlerëson për “shpejtësi të veprimit⁷”, e cila përbën urtësinë si “doktrina mbi natyrën e njeriut dhe ligjet morale⁸”, të cilën (mendjen), e “ndriçojnë shembulli dhe virtytet e njerëzve të mirë⁹”.

Në të vërtetë e gjithë lënda referenciale nga filozofia, sociologjia, estetika, historia dhe fushat e tjera të veprimtarisë njerëzore, njëkohësisht dhe sinteza e punës së poetit vërtitet rreth këtyre attributeve dhe koncepteve që ka poeti. Nëse gjithë ky “rregull” moral dhe i mendjes nuk ka këto “parametra”, De Rada, nënproduktin (sendin), që prodhon kjo veprimtari, na kumton, se nuk i hyn njeriut në punë si “mjet¹⁰”.

Në të gjithë këtë “betejë” rreth të cilës vërtitet De Rada dhe idetë e tij, në fund të fundit është një çështje intelektit dhe aftësie për t’u orientuar në hapësirë. Mëndja njerëzore e reflekton këtë në veprimtarinë njerëzore, qoftë e mirë ose jo, qoftë e dobishme ose jo.

Me të drejtë studiuesi Alfred Uçi, përveçse e konsideron një vepër të rëndësishme “Parimet estetike” të De Radës, ai e vlerëson gjithashtu dhe si pjesë e botëkuptimit të tij filozofik. “Lidhja e estetikës me filozofinë nuk është një gjë e sipërfaqshme, por, me sa kuptohet, vjen nga pranimi prej De Radës si vlera qenësore të njeriut që përbëhen nga dy forca, nga substanca trupore dhe nga substanca shpirtërore¹¹”, gjë e cila duket në të gjithë shtrirjen e koncepteve të poetit, qoftë për “detyrat sociale” dhe ato të poezisë, si një nga artet më të larta të shoqërisë njerëzore.

3.

Siç u tha dhe më lartë, parimet estetike të De Radës ishin produkt i gjithanshëm i dijes, formimit, kulturës, vëzhgimit, përvojës, shqisës, intelektit, besimit dhe raportit që ai kishte me njeriun, natyrën dhe zhvillimet socio-historike. Prej animizmit të natyrës, tek shpirti njerëzor, tek mendja njerëzore dhe tek dukuritë e natyrës, nga kujtesa tek virtualiteti,- përgjithësisht është hapësira që zë mendimi deradian.

Nëse në të gjithë hapësirën e veprimtarisë krijuese dhe filozofike-estetike De Rada qe një animist dhe një panteist, po ashtu ai qe dhe poet me një vokacion të lartë atdhetar dhe patriotik, të lidhur ngushtë me historinë e vendit të tij. Kjo lidhje e ngushtë, kryesisht me Skënderbeun, një figurë e mitizuar, afër hyjnore ka ndikuar shumë në përtej- pamjen e nevojshme, nëse do të kemi parasysh idetë dhe traktatet filozofike- estetike të kohës, që lindnin në vendet e mëdha të Evropës.

⁷ Po aty, fq 113

⁸ Po aty, fq114

⁹ Po aty, fq.115

¹⁰ Jeronim De Rada”, “Parime të estetikës”, Tiranë 2003, fq.116

¹¹ Alfred Uçi, në librin “Parime të estetikës” Tiranë 2003, fq 235,

De Rada, në argumentet e tij në çështjet estetike të kohës, pati rastin dhe solli përjasje të rëndësishme estetike- filozofike të kohës, në të cilat gëlonin idetë, mbështetjet pro dhe kundër debatit që nga antikiteti, Dante, Kanti, Vikelmani, Lesingu, Bekoni, Shlegeli, De Stali, La Martini, Shileri e Bajroni. E gjithë kjo plejadë mendimtarësh të filozofisë dhe të estetikës, të shkrimit dhe të poezisë, e bën të rëndësishëm mendimin e De Radës për çështjet estetike, marrëdhëniet që dukuritë estetike prodhojnë veten, mjetet e pasqyrit të realitetit njerëzorë, social, historik, të mjedisit dhe natyrës, të psikologjisë apo predikimit, klasifikimi dhe llojet estetik dhe shumë çështje të tjera të kohës, të cilat kishin marrëdhënie të mëdha, madje të kushtëzuara me filozofinë.

Por ndryshe shumë modeleve të tjera teorike, De Rada na solli një model të përkryer, ndoshta unik dhe për kohën e tij dhe për kohët e vonshme, pasi siç kërkon ta përkufizojë prof. Uçi, ai *"veprimtarinë krijuese e reduktoi në një proces shpirtëror dhe kryesisht në krijimtarinë artistike. Ideali social- estetik i De Radës mbetet... një thirrje drejt së bukurës, drejt artit dhe përsosmërisë shpirtërore."*¹²

De Rada në asnjë moment dhe në asnjë interpretim të vështirë të çështjeve të tij teorike- estetike, nuk u lëkund nga teoria e së bukurës, pasi thelbi i teorisë estetike të tij vërtetë rreth kësaj çështjeje. Të vendosur në kohën kur solli argumentet e tij De Rada, problemet teorike për të bukurën qoftë teoritë estetike, qoftë ideali estetik, kishte të hapur debatin mes ithtarëve të neoklasicismit dhe ato të realizmit. Në skenën e debatit kishin dalë dy emra të mëdhenj si Lesingu dhe Vinkelmani.

Konkretisht Vinkelmani mendonte se dekadencia e artit kishte të bënte me mos përfilljen e parimeve estetike, që nisnin që në kohët antike, të cilat konsideronin ideal estetik të bukurën duke e përjashtuar të shëmtuarën. Skulptura e Laokoontit me gjarpërinjtë rreth trupit është çështje e idealit estetik antik. Ndryshe Vinkelmanit, Lesingu mendonte se vetëm në këtë koncept, arti kufizohet vetëm me të bukurën, d.m.th ngushtohet. Në të vërtetë Lesingu i afrohet realizmit me këtë koncept, që nuk përjashton në dukuritë estetike të artit as të shëmtuarën dhe as të ultën.

De Rada është përfshirë gjerësisht dhe me argumentet e tij në këtë çështje estetike. Ai në një lloj mënyre e absolutizon të bukurën, të cilën përpiqet ta përlligjë në të gjitha gjykimet e tij dhe të gjitha marrëdhëniet që arti krijon me shpirtin, mendjen, natyrën dhe fenomenet natyrore. Në këtë çështje ai mban anën e Vinkelmanit, i cili njihet si një ithtar i flaktë i estetikës dhe artit antik. De Rada citohet të ketë shkruar: *"Bukuria e shpirtit zbulohet në shkëlqimin, veprimin, fizionominë, të cilat shprehin virtytet. Për ta kuptuar këtë më mirë mund t'u drejtohem gjykimeve të atyre njerëzve, që e dinë se ku qëndron bukuria*

¹² Po aty, fq 247,

e një statuje ose e një pikturë të shquar...Si shembull i qartë i kësaj mund të na shërbejnë mendimet e Vinkelmanit mbi kryeveprat e lashtësisë.¹³

Lidhur me këtë qëndrim, i cili sipas tij është dhe thelbi i të bukurës, ai i kundërvihet hapur Lesingut, duke gjykuar se dukuritë dhe fenomenet e shëmtuara nuk duhet t'i shërbejnë si objekt i drejtpërdrejtë artit, por asesi nuk arrin të minimizojë dhe argumentojë, se arti në përgjithësi, falë dhe popullaritetit të tij, nuk mund të jetë i mbyllur vetëm kufijve të së bukurës, pra nuk mund të përjashtohet as e shëmtuara dhe as e ulta, pavarësisht e pohon apo jo autori.

Përmes shembujve të shumtë, qofshin vepra arti apo shembuj të marrë nga natyra njerëzore apo e dukurive dhe fenomeneve të tjera, qoftë dhe e kafshëve, De Rada i kushtoi një analizë të gjerë të bukurës. Ndër tiparin karakteristik të saj ai konsideron forcën e jashtëzakonshme dhe afektive mbi ndjenjat. E bukura, thotë autori, tërheq njeriun, pushton shpirtin, transformon qenien dhe përsos vazhdimisht. Po ashtu ai konstaton një nga cilësitë tipike, e cila ka një vazhdimësi të njohur historike dhe që ka një bazë afër të vërtetë për shkak të traditës që në antikitet, e bukura me cilësitë e saj kapet përmes syrit dhe veshit.

De Rada ishte ihtar i antikitetit dhe modelin e të bukurës e kërkon tek poetët antik që nga Homeri e deri tek Sofokliu me Edipin dhe siç dihet, arti dramatik-poetik antik, u promovua dhe e përcolli mesazhin e tij estetik përmes skenës, ku aktori shihej dhe zëri i tij dëgjohej. Syri dhe veshi mendon De Rada, janë shqisat e specializuara (*e lindura. Shën. B.G*) për përvetësimin estetik.

Kuptohet qartë se De Rada ka pasur një njohje të mirë për konceptet e lashta mbi të bukurën që nga Platoni, i cili ka shënuar mbi të bukurën: *"... e bukura është diçka që lind e nuk asgjësohet, diçka që nuk është njëherë e bukur e herën tjetër e shëmtuar; sot e bukur, nesër jo"*, d.m.th sipas Platonit e bukura vepron jashtë artit, përkatësisht ajo shkëput çdo lidhje me përvojën artistike. De Rada nuk është kaq filozofik dhe dialektik me këtë koncept, por ai e konsideron atë një *"strukturë"* të fortë dhe të pazhbëshme.

Në një perceptim të çuditshëm, De Rada gjendet dhe me mendimin e Aristotelit, i cili mendon pak a shumë kështu për thelbi e të bukurës, se nuk është e bukur ideja, por objekti, d.m.th arti që prodhon të bukurën, me ç'rast ai idealizon në një farë mënyrë strehën e kësaj kategorie, siç, De Rada mendon për kundërvënien ndaj konceptit të Lesingut dhe pro Laokoontit. Por Aristoteli e kufizon vendin e të bukurës, atë ai e gjen vetëm në art (vepra), ku shfaqet dhe realizohet e bukura. Në këtë pikëpamje De Rada ka një përjasje të tij me formalistët, por që shpjegon dhe çështjen që ai e quan "njësia në larminë". Konkretisht Alfred Uçi citon për këtë çështje: *"Njësia në larminë" është një kusht*

¹³ Jeronim De Rada", "Parime të estetikës", Tiranë 2003, fq.43

i domosdoshëm për formimin e gjithë koncepteve njerëzore, prandaj, sipas tij, po të qëndronte bukuria në unitetin, do të quanim të bukur pa përjashtim çdo send...¹⁴

De Rada largohet dhe afrohet me teoricienët e të bukurës, të cilët janë marrë me këtë koncept estetik. Kështu me Baumgarteni, i cili është autori i parë në historinë mendimit shkencorë, i cili të bukurën e kategoritë mbi artin i përdori me termin "Estetikë" (1750), i cili të bukurën e karakterizon lëndë të ndjenjës dhe jo të mendjes." Emanuel Kanti nuk e pranon estetikën si shkencë, ai thotë: "Nuk ekziston shkenca mbi të bukurën, as ndonjë shkencë e bukur, por vetëm kritika e së bukurës, arti i bukur..." që i lë jo pak hapësirë mendimit të Lesingut.

De Rada është kundër rregullsisë formale të së bukurës, ai mendon se e bukura lidhet dhe me thelbin e brendshëm të objekteve, vlerësim të cilin e shtrin dhe në veprat njerëzore, me ç'rast flitet për harmoninë. Ai iu kundërvihet "substancialistëve" me të cilët nënkupton materjen. Lidhur me këtë ai konkludon se e bukura nuk është cilësi e materies, duke mbrojtur pozitat idealiste të së bukurës. S'ka bukuri trupore pa bukuri shpirtërore sipas De Radës, pra ai e zhvesh të bukurën nga çdo element trupor, duke shtuar se e bukura gjithmonë është morale.

Tragjedia e Sofokliut është një model i mirë për De Radën, në të cilën ai konkretizon konceptin deradjan mbi të bukurën. Në të ai zbulon bukurinë tipike njerëzore. Në klasifikimin e të bukurës De Rada i lë vend të konsiderueshëm bukurisë morale, përmes të cilës ai gjen rastin të flasë për elementët e kësaj bukurie morale si atë të ndjenjës së drejtësisë, të bamirësisë, të dashurisë dhe të mëshirës. Këto katër cilësi, të cilave autori u gjen vend dhe me shembuj, me meditime dhe argumente, përbëjnë përsosmërinë morale të njeriut për ta konsideruar atë të bukur, nëpër kohë të ndryshme dhe në artin klasik.

Një kategori estetike, për të cilën nuk mendonte se ishte në nivelin e së bukurës, por që ekzistonte ishte e madhërishmja. Të madhërishmen De Rada e gjen tek vullneti, dëshira e madhe që e shtyn njeriun për vepra të mira dhe fisnike. De Rada, për shkak të formimit të tij dhe marrëdhënies që ai ka me estetikën duke qenë poet, me një specifikë dhe metaforë kombëtare njerëzore, priret ta shoh të madhërishmen si një dukuri estetike dhe ta gjejë të gjithë brenda njeriut. Dhe pse ai e kategorizon në dy trajta të mëdha të madhërishmen, si dinamike, që ka të bëjë me forcën dhe matematikën, që ka të bëjë me vëllimin dhe madhësinë, por ai nuk është i mendimit se e madhërishmja manifestohet dhe në fenomenet e natyrës, me ç'rast kemi të bëjmë me hapësirën.

Specifikisht autori është i qartë se ku mund të gjendet e madhërishmja; së pari në të gjithë qenien, ku merr shkas të argumentojë për trupat në hapësirë,

¹⁴ Jeronim De Rada", "Parime të estetikës", Tiranë 2003, fq.251

malet e lartë, rrufetë dhe dukuria apo fenomene të tjera. Pastaj e madhërishmja ekziston në botën e gjallë, e cila ka të bëjë me hapësirën, me guximin e kafshëve etj. Ndërsa manifestimi i të madhërishmes tek njerëzit ka më shumë deduksione, duke iu kundërvënë utilitarizmit, dëshirave të tepërta dhe lavdëruar plotësimin e detyrave morale, d.m.th veprimin.

Tek njeriu, si shprehje të dukshme të së madhërishmes, De Rada vlerëson trimërinë. Por De Rada nuk arrin ta konsiderojë të madhërishmen si një kategori më vete dhe të pavarur. Ai ia nënshtron të madhërishmen të bukurës, me ç'rast ai i afrohet konceptit të madhërishmes me Kantin dhe Shilerin. Pavarësisht një lloj konkludimi *"se madhështia morale qëndron më lart se fenomenet e madhërishme të natyrës"*¹⁵, studiuesi Alfred Uçi mendon se *"De Rada pranon se fenomenet e madhërishme, pavarësisht nga dallimet midis tyre, ndikojnë pozitivisht në përsosjen morale të njeriut"*¹⁶, çështje me të cilën është marrë në të gjithë traktatin teorik-estetik De Rada.

Në këtë qëndrim estetik, ashtu dhe është shpjeguar në fillimin e këtij qëmtimi mbi parimet estetike të De Radës, kur kuptohet qartë se idetë estetike të kohës kishin një presion të madh që nga antikitetit, nga mesjeta, nga klasicizmi, nga romantizmi dhe idetë e reja që po lindnin nga zhvillimet socio-shpirtërore në Evropë, autori është nën ndikimet e estetikës së klasicizmit të antikitetit grek, që të madhërishmen ua atribuonte vetëm "heronjve", "fisnikëve", njerëzve të "zgjedhur", të cilët në krijimtarinë poetike¹⁷ të De Radës fillojnë që me Skënderbeun dhe disa të tjerë. Autori është përpjekur ta "materializojë" konceptin e tij për këtë çështje.

4.

Një çështje e rëndësishme, e cila ka një vend të dukshëm dhe një kujdes të veçantë trajtimi nga De Rada, është ajo që autori e quan mision të artit, një mision shoqëror, pasi ai është i prirë që artin ta shohë si pjesë aktive të jetës së shoqërisë, sepse ai duhet t'i shërbejë shoqërisë.

Në perceptimet dhe idetë e tij, De Rada përfshin të gjithë llojet e artit, pavarësisht se etalon kishte tragjedinë apo dramën greke. Lidhur me renditjen që ai bën për artin, bie në sy klasifikimi njëlinear sipas të cilës poezia është në majë, pastaj vijnë historia, romani, komedia, loja e aktorëve, arti komik, muzika, piktura, skulptura dhe arkitektura. Në këtë konceptim, i mishëruar në një klasifikim të tillë, ndikimi i klasicizmit është i dukshëm, pasi bie në sy nivelizimi si: arte "të larta", arte "të bukura" dhe arte "të ulta". Poezia është gjithmonë në majë, e cila ndërtohet nga figuracioni simbolik dhe ai alegorik, si në lashtësi.

¹⁵ Jeronim De Rada, "Parime të estetikës", Tiranë 2003, botoi "Globus R", fq.267

¹⁶ Po aty, fq.267

¹⁷ Shih, "Milosao", Serafina Topia", etj

De Rada ka vlerësim sublimniteti mbi fjalën. Në induksionet e tij të traktatit estetik "Principi di estetika", flitet dhe për gjuhën në mënyrë të veçantë dhe të drejtpërdrejtë.

De Rada ndoshta është dhe folkloristi i parë i mirëfilltë shqiptar dhe i përvojës tonë të mirë. Vepra "Rapsodi të një poeme shqiptare..." është një përmbledhje këngësh shqiptare në Napoli, me ç'rast atij iu krijua mundësia të flasë për ngjarje, heronj, për dashurinë, lirizmin, vargun, vendin e tij, zakonet dhe një thesar të madh që mbartin në vetvete këto krijime shpirtërore dhe të muzikuara në mënyrë popullore.

Lidhur me qëndrimin mbi romanin De Rada ka kufizimet e veta. E konsideron shumë larg poezinë me romanin, duke lënë të kuptohet se romani afron me historinë. Plutarku sipas tij është një shembull i mirë për këtë çështje. Ai shpesh këmbëngul se heronjtë ideal krijojnë vepra të pavdekshme, prandaj dhe prirja pas bukurisë shpirtërore të heronjve nga ana e tij është një tipar i dukshëm.

De Rada nuk ka lënë pa marrë në vlerësim Shekspirin, duke e quajtur "plaku" Shekspir, ndoshta për shkakun e mendjes së ftohtë në tablotë dhe perceptimin që i bëri kohës, me dukuritë, fenomenet, personazhet dhe kritikën që ai i bëri realitetit.

Duke mos arritur të shkëputet nga antikiteti, në të cilin ka gjetur modelin e të bukurës, si një përkryerje të shpirtit të Edipi, të heroit tek Hektori, dhe dramaturgjinë në përgjithësi për syrin dhe veshin dhe tre njësitë e klasiçizmit në kohë, vend dhe hapësirë, ai i kërkon sipas modelit antik.

Po ashtu De Rada e kërkon përsosmërinë e artit përmes tri kushteve të rëndësishme dhe të pazhbëshme si: -çdo vepër duhet të jetë natyrale, -çdo vepër duhet të kultivojë virtyte të larta njerëzore -në veprat e artit duhet të manifestohen rregullat dhe ndjenja e bukurisë.

Kuptohet, autori ka pasur kufizimet e tij, por ai afroi një vlerë të madhe jo vetëm për estetikën shqiptare si mendim dhe arritje të kohës. "Parime të estetikës" të De Radës është një vepër, e cila për jo pak çështje i ka qëndruar kohës, duke kapur thelbin e artit, natyrën universale të tij, që i kapërcen kohët dhe kufizimet nëpër rryma dhe drejtime të ndryshme. Për shumë gjëra, si kufizime të tij, ishte i qartë, e i bindur dhe vetë De Rada.

VOCATIONAL EDUCATION: CHALLENGE OR A NECESSITY FOR OUR COUNTRY?

MSc: Belinda HALILAJ

The Justice Department, University "Ismail Qemali"Vlora
belinda2012halilaj@gmail.com

Abstract

The right to education is a fundamental right enjoyed by all individuals regardless of religion race, belief, ect... Education of the population is one of the key factors for the development of society and increase the standard of living in our country. When you treat the right to be educated, a special importance must give also to vocational education. Vocational education in our country has undergone successive changes, changes that had started after the liberation of the country until nowadays. If we stopped, we consider that the most important changes have been made after the 90s in our country. There is a positive and strong relationship between level of education, skills of individuals and labor market outcomes. Over recent years, there has been progress in increasing the quality of education of the population, but noted that vocational education has been a tendency in decline. During recent years, the data show that mainly men follow vocational education, having a stated interest decline by women for this type of education. However, such a thing should be fully consistent with the increase of quality and more importantly, with the relationship of educational outcomes towards labor market needs, and as a result, women feel themselves insecure with this type of education.

Keywords: vocational education, labor market, finance ect..

1. Introduction.

The right to education is a fundamental human right. Every individual, regardless of race, gender, nationality, ethnic or social origin, political or religious preference, age, or disability, has the right to education. Education is one of the key priorities in a democratic society, the basis for the development of society.

Republic of Albania Constitution in Article 57 and 59 of it guarantees the right to education for all children and young people without distinction. Republic of Albania Parliament has ratified the Convention on the Rights of Children, the provisions of which have been implemented in the laws adopted after the ratification of this convention. Concretely Law No.7952, dated 21.06.1995 (*On Secondary Education*) Article 3 guarantees "Citizens of the Republic of Albania enjoy equal rights to education at all levels of education that determines the present law, regardless of their social status , nationality, language, gender, religion, race, political beliefs, health and economic level".

According to the Law on Education, in Albania it is public having a secular character (not religious). At public educational institutions, the ideological and religious indoctrination is prohibited. The education in the Republic of Albania implemented in public and private educational institutions in accordance with the legal provisions in force¹. Study cycles in the educational system in our country are: pre- university system and University Education institutions. With pre- university education means the education system 9 (nine years) and secondary educational system (which may be general or vocational). Part of the public pre- university system in Albania is the "public special education" guaranteed by the Law No.7952, dated 21.06.1995 "On Secondary Education". Public Special Education aims through the use of specific forms and methods to ensure the fullest possible development of opportunities to persons who present physical, mental or emotional incapacities, in accordance with their needs and requirements for a dignified life.

Material and methods

Vocational education today is an important topic. To realize this paper the authors have used Albanian literature. For the development of this paper I have given several research methods, as descriptive, comparative and explanatory.

2. Types of vocational education.

Professional education consists of:

- vocational education;
- Technical secondary education;
- vocational training;
- or other forms of education and vocational training that are determined case by case in the law.

¹ http://www.adrf.org.al/images/drejta_per_arsim.pdf

When the students aged 6 to 16 years, who includes the obligatory schooling, they miss school without reason or abandon it, their parents punished for administrative infraction from 5000 to 50 000 ALL.

In Albania, more attention is being given this month to vocational education. Supersaturate of the market and the lack of qualified people, as a necessity, increased attention, to give a great importance in vocational education. Naturally, the question arises: what are the institutions that provide education and vocational training in our country? According to the Law No.8872, dated 29.3.2002 "On education and professional training in the Republic of Albania". Institutions, of education and vocational training are:

a) Public and non- public (private) vocational schools of the first and second level, which provide technical education to the students after compulsory education. These schools implement professional training with practical character and provide students with basic vocational education, as well as knowledge and skills necessary for a qualified professional activity at the level of skilled employee for a given specialty.

b) Public and non- public technical schools, which provide technical education to the students after compulsory education. These schools give students a broad base of Professional education, as well as knowledge and skills necessary for a qualified professional activity at the level of qualified technician for a given specialty.

c) Centres and vocational training courses, which organize training, retraining and vocational rehabilitation to gain the necessary professional skills to fit the requirements in the labor market.

d) Specialized institutions of education and vocational training for particular groups.

e) Enterprises.

f) Other public and non- public institutions, whose activity is regulated by acts of a special legislation.

The purpose of this law is to support the development of a common system of education and vocational training in the Republic of Albania, which can be adapted to the social, economic and technological changes, needs of the labor market, and enable an optimal exploitation of financial, human and infrastructural resources.

As the education system, the public and professional education is non-public. In this way, this service can also be provided by state structures as well as non-public or non-profit structures.

3. Beneficiary categories of vocational education.

Professional education can be followed from the following categories;

- all students who have completed the compulsory education;
- persons who have attained the age of 18 years, who are demanding jobs and / or want professionally to be trained;
- specific groups who want professional rehabilitation, such as persons with disabilities, mothers with many children, people under 18 years,
- long-term unemployed, people from families below the poverty level.

In vocational schools and in public & non-public technical secondary schools are accepted all individuals who have completed compulsory education and have taken leaving certificate. In various courses of *accredited public & non-public vocational formation, reformation and rehabilitation*, participate the youth and adults, who receive appropriate programs approved by the Ministry of Labour and Social Affairs.

4. Financing of vocational education system.

Public vocational education, is financed from the state budget, local government budget, national and international programs for education and professional contributions of associations of employers and employees, donor contributions, sponsorships and other sources allowed by law.

Public institutions that offer vocational education can be self-financing in these cases²:

1. They can also perform economic activities with financial benefits in areas related to the implementation of programs and teaching practices. The forms and ways of organizing economic activities are defined by the Council of Ministers.
2. When they act as economical entities with separate accounts. For the realization of production and service activities, they contract physical and juridical, on condition that these activities be consistent with the intention of institutions to realize education and vocational training programs.

5. The challenges of vocational education.

Vocational education in our country has undergone successive changes that have started since the liberation of the country until nowadays. If we stopped, we consider that the biggest changes have been made after the 90s in our country. In the vocational education system have passed laws, have been undertaken various initiatives and harmonization of our legislation in this field with that of the EU. The labor market in Albania is segmented and less involved in the labor market are women, youth and persons with low qualification, rural

² Article 30, Law no. 8872, dated 29.3.2002 FOR EDUCATION AND VOCATIONAL TRAINING IN THE REPUBLIC OF ALBANIA.

residents, the poor, and other vulnerable categories³. In this context, there have been some active policies for the inclusion of workforce in the labor market. Vocational Education curricula was reformed in 2009 both in terms of duration, where the maximum cycle studies in a direction would be four years, and in the direction of structures. At the end of each level, the student equipped with a certificate, which theoretically and in principle creates conditions in horizontal and vertical level in the vocational education system and the labor market. A challenge in terms of inclusion and social cohesion constitutes also increase of participation in the labor market of vulnerable groups⁴, in particular those with disabilities as well as equal opportunities for participation in the labor market in rural areas, especially mountainous compared with those urban⁵. These categories are treated by passive policies of the labor market through invalidity pension. Women's participation in vocational education continues to be low even after the numerous measures undertaken these last months. For inclusion and social cohesion, it is prepared the draft Strategy for the Social Protection and Inclusion 2013-2020; in focus the disadvantaged groups and low participation in the labor market. The educational level of a society is a powerful determinant of labor market performance, as well as its poverty. However, such a thing should be fully consistent with the increase of quality and more importantly, to link educational outcomes towards labor market needs.⁶ The mismatch of skills in Albania appears in two forms:

1. Over-qualification, ie individuals working in occupations for which they are over-qualified or in fields not related to their field of study; and
2. The sub-skills that stem from skill deficiencies, which cause employers to hire workers who are not the most appropriate for offered work.

There is a mismatch between the needs for skills from businesses and the field of study from the graduates. On the other side, there is a large number of graduates in such branches as educational studies, business administration, finance, law, English language, history and geography. This result leads to distortion of the labor market, the lack of labor supply, while there is a demand for labor and the over-supply of labor in other areas for which there is less demand. In addition, the latter consists of fields of study, in which orient young girls, creating sustainable gender stereotypes in education, which can result in deficiency of skilled labor force, occupational segregation and the gender gap in

³http://idmalbania.org/sites/default/files/publications/dokument_politikash_per_punesimin_dhe_afp-final.pdf

⁴ Trafficked women, the young mother, Roma people, persons with disabilities, the returned immigrants..

⁵ ibidem.

⁶http://www.sociale.gov.al/files/documents_files/Strategjia_per_Punesim_dhe_Aftesim_2014-2020.pdf

relation to wages. The system of vocational education and training continues to be affected by the limited involvement of the social partners; from a highly centralized system with low complement of local needs; the division between vocational education and vocational training; and inappropriate approaches of monitoring and evaluation to measure both the quality as well as quantity of education, vocational training and lifelong learning.⁷ These issues remain to be resolved with priority. The system continues to be underfunded, with weak incentives for the participation of employers, and with limited resources invested to improve the quality of infrastructure and the training of teachers and instructors. Until now, several concepts are introduced in relation to entrepreneurship, there is yet to make serious trainings on entrepreneurship, both in terms of self-employment, as well as in terms of the opening of new businesses, while such a thing it is crucial considering the fact that more than 96% of businesses in Albania are small and medium enterprises. Even the attractiveness capacity of vocational education is still weak, because it is conceived as a second best way to tertiary education, and not as a way to enter into the labor market. The processing of standards and professional programs, oriented toward the acquisition of competencies, and the introduction of practices in the enterprise are lagging behind. Currently most of the Albanian population still lives in rural areas, and educational attainment of the rural population are lower than in urban areas for all age groups. Young people are not interested in pursuing long-term studies in the field of agriculture, but are more interested in short-term and medium-term courses, which can help them to enter into labor market.

The Government is committed to the orientation of vocational education in a completely new direction, which would satisfy the real demands of the labor market and would turn the state into the main backer of professional qualification. The combination of theoretical education with the practice will be key to this reform. Deficiencies of VET in the system of skills will be addressed and be chosen by improving coherence of the national qualifications system; submission of the certification system, which includes formal and informal learning throughout life; and establishing qualitative career orientation with reliable information and updates on the labor market. National Strategy for employment and skills intends the use of a comprehensive and sensitive approach to gender issues, by developing programs which ensure that the benefits of reform to be equal for different categories of women and men, girls and boys in Albania. This analysis highlights a number of gender issues that should be handled by appropriate policies and measures in three dimensions.

⁷http://www.sociale.gov.al/files/documents_files/Strategjia_per_Punesim_dhe_Aftesim_2014-2020.pdf

First, we must make the determination of specific vulnerable groups and of barriers, they face in terms of access to opportunities, participation, services and benefits in order to create conditions in which women and other disadvantaged groups can actively contribute to the economic growth of Albania.

Secondly, proactive special measures should be taken, and the results of economic empowerment of women must be made clear, because sustainable economic growth can not be achieved without the participation of women as equal economic factors as wage labor, but also as self-employed and entrepreneurs.

Thirdly, to establish appropriate mechanisms, which ensure that the benefits associated with economic reform have equal consequences for women and men, girls and boys.

In line with the Convention on the Elimination of all forms of discrimination against women in 2010 as well as standards and norms 48 of the EU and the Council of Europe, the National Strategy for employment and skills spells to have special contribution for the economic empowerment of women and for bridging the gender gap when it comes to the possibility of access to productive assets and markets, pursuing the following interventions:

- (i) removing barriers for women and girls when referring to, access opportunities in training and employment, particularly in sectors that will be the key instigators for the the Albanian economic growth;
- (ii) creating opportunities for women and especially for women in rural areas to participate in the formal labor market;
- (iii) treatment and finding the root causes associated with low participation of women in the labor market and Gender Segregation correction;
- (iv) Strengthening the national capacity to integrate the objectives related to gender equality in policies drafted in services that take into account gender factors, as well as their monitoring.

6. The focus on vocational education.

Vocational Education and Training in Albania is taking the proper attention not only from the partners involved in it, but also by providers and recipients of VET. To give VET deserved importance, since 1 March 2007 the National Agency of Education and Vocational Training (NVETA) has started its activities. Its establishment was based on 273 Decision of the Council of Ministers in 2006. The agency charged with leading institutional tasks dealing with VET, eg curricula, list of professions, teacher training standards, assessment and

certification of students, accreditation of VET providers, etc... Through the activities of this National Agency is aimed to give VET a further development in our country, especially in terms of institutionalization and increasing the quality of education and provided training. The Agency will also grappling with the problems facing vocational education in Albania, dealing with poor relations between VET and the labor market or even the effective absence of partnership in this field⁸. The development of VET in Albania in accordance with the required European standards, is a big responsibility, simultaneously and professional challenge.

7. Conclusions

Vocational education in our country has undergone consecutive changes. If we stopped in education, will see that in our country the biggest changes has been made after '90. In the vocational education system have passed laws, various initiatives have been undertaken and is harmonized our legislation in this field with that of the EU. Currently the labor market in Albania is segmented and less involved in it are women, youth, and persons with low qualification, rural residents, the poor and other vulnerable categories.

The system of vocational education and training has necessitated the increase of the participation and influence of the social partners, to have a further development. It is noted that the discrepancy between the needs for skills from the business and the field of study selected by the graduates. This result leads us to distortion of the labor market and the lack of offer in certain areas.

Vocational Education and Training in Albania is taking the role and proper attention not only from the partners involved in it, but also by the providers and recipients of VET. The Government is committed to the orientation of vocational education in a completely new direction, which would satisfy the real demands of the labor market and would turn the state into the main backer of professional qualification. The combination between theoretical and practical education will be key to this reform.

Bibliography

- [1] Law No.8872, dated 29.3.2002 "On education and professional training in the Republic of Albania"
- [2] "Higher skills and better jobs for all women and men", Ministry of Social Welfare and Youth.
- [3] Llubani. M., "Women representation in the security sector in Albania", Albanian Institute for International Studies, October, 2014.

⁸ <http://akafp-al.org/>

- [5] Cela.A., Mazniku.A., Fshazi.T., .Albanian Youth 2011: "Between faith and doubt about the future for the present", "Friedrich Ebert" Foundation, 2013.
- [6] http://www.adrf.org.al/images/drejta_per_arsim.pdf
- [7] http://idmalbania.org/sites/default/files/publications/dokument_politikash_per_punesimin_dhe_afp-final.pdf
- [8] http://www.sociale.gov.al/files/documents_files/Strategjia_per_Punesim_dhe_Aftesim_2014-2020.pdf
- [9] <http://akafp-al.org/>
- [10] <http://www.vet.al/>
- [11] <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/10894.pdf>

SHKRIMI UNIVERSITAR DHE ROLI I TIJ NE FORMIMIN E STUDENTEVE

Dafina Nazaj Ph.D student
Mcs.Suela Fakaj

Abstract

Language as the most important mean of communication plays a special role in the life of human society. Coexisting together it is in the same time a very necessary condition for its existence and development. The language exists in both forms: oral and written forms.

The writing indeed is considered as the most important mean for the educational proces toward students which helps learning and thinking abilities for new writing techniques.

Its role becomes crucial in nowadays conditions, in a moment where the Albanian universities as the centre of knowledge and science have a lot of tasks and challenges to afford.

“Writing” in its broad connotations invalves all the “written works” that are the practice essentials of university life and a very important mean for the exchange and spreading of knowledge and information.

Learning the writing techniques helps clarifying and systeming your thinking in order to support students academic gait.

As a conclusion we may say that the role of the university writing like a creative process is decisive for the student back ground. It serves as a practical measurer of his general background, expressive abilities and in the same time for opportunities in order to face his challenges in the future.

Abstrakt

Gjuha si mjet më të rëndësishme të komunikimit luan një rol të veçantë në jetën e shoqërisë njerëzore. Coexisting së bashku ajo është në të njëjtën kohë një kusht shumë i domosdoshëm për ekzistencën dhe zhvillimin e saj. Gjuha ekziston në dy forma: forma me gojë dhe me shkrim.

Shkrimi me të vërtetë konsiderohet si mjeti më i rëndësishëm për proces arsimore ndaj nxënësve, që ndihmon të mësuarit dhe të menduarit si edhe aftësitë për teknikat e reja të shkruarit.

Roli i tij bëhet i rëndësishëm në ditët e sotme, në një moment ku universitetet shqiptare duhet të përballojnë si qendër e dijes dhe shkencës, shumë detyra dhe sfida.

"Me shkrim" do të përfshihen të gjitha "veprat e shkruara" që janë bazat e praktikave të jetës universitare dhe një mjet shumë i rëndësishëm për shkëmbimin dhe përhapjen e njohurive dhe informacionit.

Mësimi i teknikave të shkrimit ndihmon sgarimin dhe sistemimin e të menduarit.

Si përfundim mund të themi se roli i shkrimit universitar si një proces krijues është vendimtar për tokë të studentëve prapa. Ajo shërben si një matës praktik të sfond përgjithësi, aftësitë e tij shprehëse dhe në të njëjtën kohë për mundësitë për të përballuar sfidat e tij në të ardhmen.

Hyrje

Megjithëse gjuha është dukuri shoqërore dhe mjet i pazëvendësueshëm i komunikimit në të dy format e saj: në formën e folur dhe të shkruar, në vijim të kumtesës sonë kemi bërë objekt trajtimi rëndësishëm që kanë punët me shkrim dhe veçanërisht shkrimi në universitet midis disiplinave të ndryshme shkollore, duke e vlerësuar atë si gur themeli që luan një rol vendimtar në formimin e studentit. Shkrimi me të drejtë konsiderohet si një mjet i rëndësishëm për mbarëvajtjen mësimore të studentëve që nxit të menduarin dhe ngulit shprehitë në përvetësimin e teknikave të të shkruarit. Roli i tij bëhet vendimtar në kushtet e sotme në një kohë kur universitetet shqiptare si qendra të dijes e të shkencës janë përballë detyrash e sfidash të mëdha, ku sfida kryesore është pikërisht ajo që lidhet me përgatitjen shkencore të studentëve. Po ta vështrojmë çështjen historikisht do të vëmë re mënyra të ndryshme përcaktimi të të shkruarit. P.sh. Barti e përkufizon shkrimin si "...një veprimtari historikisht dyfarëshe: në njërin anë ai është objekt i tregtueshëm, mjet i pushtetit dhe i të epërme, i ngjizur prej lëndës më të ashpër të shoqërisë, në anën tjetër, ai është një praktikë e kënaqësisë, i lidhur me thellësitë gjalluese të trupit njerëzor e të veprave më të brishta e lumturisht më të arritura, të artit..." (Barnet, Bellanca, Stubbs 2000) Pra, Barti e ndien thelbin e dyzuar të shkrimit si mjeshtëri e shtetarisë dhe nga ana tjetër si praktikë e kënaqësisë që ndien njeriu përpara krijimit. Shkrimi përfshin ligjërimin e shkruar, i cili në veprimtarinë bashkëkohore të njeriut modern mbetet forma më autoritare e ligjëritimit.

Te shkruarit akademik dhe format me të njohura të tij

Të shkruarit si proces krijues është konceptuar gjithmonë si punë e lidhur me detyra të mërzitshme: të shkruash njoftime, raporte, protokolle dhe shënime të ndryshme. Në traditën universitare perëndimore, shkrimtari universitar është një mendimtar, një përdorues i arsyes. Për ne shkrimi në kuptimin e gjerë të fjalës përfshin gjithë punët me shkrim, të cilat përbëjnë thelbin praktik të jetës universitare dhe një mjet shumë të rëndësishëm për shkëmbimin dhe

përhapjen e dijes. Të shkruash do të thotë të zotërosh mënyrën e të shprehurit normativ, të zbatosh gjithmonë normën drejtshkrimore, gramatikore, pikësimore, etj. Të shkruash do të thotë gjithashtu të lësh gjurmët e ideve, mendimeve dhe kulturës tënde, si dhe të komunikosh dyfish me veten dhe të tjerët. Të mësuarit e teknikave të të shkruarit ndihmon për të sistemuar e qartësuar të menduarin, për t'i dhënë siguri e drejtpeshim zhvillimit të çdo student dhe për të mbështetur ecurinë e tij akademike. Tradita akademike universitare të ne ka qenë pa tekste cilësore, pa udhëzues që t'i drejtonin studentët në procesin e të nxënies dhe në procesin e të shkruarit profesional. Në traditën e shkrimeve nga studentët në Shqipëri njihen si ashtuquajtur "shkrim i asistuar" (Shkurtaç 2008), një version i punës kërkimore i kryer nga një student nën drejtimin e afërt të një pedagogu.

Hartimi ose të shprehurit rreth një teme të caktuar, qoftë një arsytim a koment i disa vargjeve poetike, qoftë një temë e lirë, që trajtohet brenda klasës dhe në një kohë të caktuar, p.sh prej 2 orësh bashkë me korrigjimin në një orë të veçantë është një lloj i shkrimit të asistuar, i cili përdoret në shkollë e mesme. Ky lloj shkrimi vlerësohet nga mësuesi mbi bazën e disa treguesve normativë: drejtshkrimi ose të shkruarit pa gabime, norma gjuhësore; aftësia krijuese, aftësia parashtruese dhe organizuese e temës, përfundimi dhe qëllimi, etj. Prandaj shkrimi i asistuar duhet të mbetet edhe në praktikën e mësimit dhe të shkrimeve në universitet.

Punimi shkencor është prodhim i veprimtarisë mendore të një njeriu a grupi që synon të paraqesë me gojë ose me shkrim përfundimet e kërkimeve dhe hulumtimeve në një fushë të caktuar, për një çështje të veçantë, duke synuar të sjellë një ndihmesë të re në atë fushë studimi (Shkurtaç e Çiraku 2004). Kërkimi shkencor, hartimi i një disertacioni është i lidhur ngushtë me një studim këmbëngulës të literaturës që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me temën. Llojet e shkrimeve në universitet janë të ndryshme. Në funksion të tematikës që kemi zgjedhur në këtë kumtesë ne po rendisim disa.

Studimi për të mbrojtur diplomën në çdo universitet përbën edhe ritin e kalimit në botën shkencore (Robins 2007). Ka universitete të cilët e kanë sanksionuar në rregullore se "provimi i diplomës është paraqitja dhe shqyrtimi i një disertacioni të shkruar, që shtjellohet nën drejtimin e një mentori, por në mënyrë origjinale dhe në italishte të mirë."

Tema e diplomës mund të zgjidhet nga studentët në listen e temave të ofruara nga pedagogët e departamentit mbi bazën e detyrave të kursit dhe student duhet të marrë atë temë që është i aftë ta kryejë. Për ata që i përkushtohen shkencës dhe nisin rrugën e saj me temën e diplomës e vazhdojnë atë duke u futur në shkallën tjetër të kualifikimit Master, si formë kryesore e shkrimit përdoret mikroteza. Ajo konsiderohet si punë me shkrim ku objekti i zgjedhur shqyrtohet më ngushtë.

Kurse doktorata është punë me shkrim e kuptuar në tërësi si ndihmesë e veçantë në një fushë të dijes, për zbulime të reja, formulimit të teorive, etj.

Në kushtet e sotme kur universitetet po bëjnë ndryshime rrënjësore në programet me synimin që ato t'u përgjigjen më mirë nevojave të sotme dhe

atyre të perspektivës, kur kërkohen studentë të formuar e të përgatitur për jetën, në programet e tyre po zë vend gjithnjë e më shumë një lëndë e re: Shkrimi akademik.

Por duhet theksuar se me gjithë përpjekjet e vlerësueshme nga shumë autorë tekstesh akoma nuk është krijuar një traditë e shëndoshë dhe e qëndrueshme që të shërbej si model në këtë drejtim. Kjo gjen shprehje në mënyrë të qartë te mungesa e një program unik që t'u shërbente të gjithëve dhe te shumëllojshmëria e teksteve që janë në përdorim. Sot ende nuk ka akoma në përdorim një tekst të përshtatshëm të nivelit universitar që t'i përgjigjet realitetit shqiptar. Tekstet në përdorim janë akoma larg këtij realiteti, të cilët në shumicën e rasteve janë përkthim nga ndonjë gjuhë e huaj që edhe pse u mësojnë studentëve parimet e përgjithshme të të shkruarit, te ata mungojnë rrugët konkrete të realizimit. Përgjithësisht ata nuk e kalojnë pragun e të shërbyerit vetëm për studentët e një degë të caktuar.

Prandaj, megjithëse lënda "Shkrim akademik" po futet në cdo degë, si nevojë urgjente del hartimi i një teksti që realisht do të përconte te studentët krahas dhënies së parimeve të përgjithshme të të shkruarit si process krijues edhe specifikat për çdo degë duke sjellë me vete modele konkrete.

Problematikat ne shkrimin akademik dhe rezultate te studimit

Me të drejtë lind pyetja: cilat janë këto mangësi që pengojnë tekstet në përdorim të jenë të pranueshëm e të përshtatshëm për të shërbyer për gjithë degët?

Sipas mendimit tonë janë shumë faktorë ku midis të tjerëve ne mund të rendisnim:

Së pari, si faktor kryesor pengues është mosmbajtja parasysh e specifikave të veçanta që ka çdo fushë apo specialitet i caktuar. Dihet që të shkruarit si proces krijues është i pranishëm në të gjitha sferat. Atë e përdorim jo vetëm në shkencat filologjike ku dhe shpeshherë e barazojnë me krijimtarinë artistike, por edhe në shkencat e tjera si dhe në të gjitha veprimtaritë. Natyrisht krijimtaria artistike me të cilën do të merren ata që kanë talent përbën një fushë të rëndësishme, por nuk duhet vënë shenja e barazimit.

Së dyti, nuk mbahet parasysh gjendja reale e studentit, sasia e njohurive dhe aftësive të fituara në arsimin parauniversitar, me të cilat ata vijnë në universitet. Asnjë tekst nuk merr parasysh këtë sasi njohurish. Nisur nga fakti se të shkruarit kalon në shumë faza duhen marrë parasysh edhe faktorët socialpsikologjikë me gjithë rolin dhe rëndësinë e tyre. Të diturit e sasisë së njohurive që zotrojnë studentët do të bënte të mundur dhe përcaktimin e saktë të vëllimit të njohurive që do të përfshihen në tekst. Punët me shkrim kanë filluar herët në shkollë. Ato kanë qenë të llojeve të ndryshme duke filluar që me detyrat e shtëpisë, detyrat e tjera krijuese, hartimet, diktimet, esetë, detyrat me shkrim, etj. Po sa kanë qenë efikase ato dhe sa kanë ndikuar në formimin e nxënësit duhet të mbahen parasysh.

Së treti, mosmbajtja parasysh e boshllëqeve të studentëve, që në gjendjen e sotme pothuajse janë uniforme, i ka bërë tekstet e deritanishme të mos jenë

shumë efikas. Lëndët gjuhë shqipe dhe lexim letrar të zhvilluara në arsimin parauniversitar synojnë të mësuarit e nxënësve për një të shprehur të qartë sipas normave të shqipes letrare si dhe pajisja e tyre me shprehitë e punës së pavarur. Po a arrihet gjithmonë ky synim? Nisur nga gjendja në të cilën ndodhet arsimi shqiptar në kushtet kur deri para disa vitesh gjendja e kuadrit nëpër shkolla sidomos në fshat vliente për të dëshiruar, ku një pjesë e mësuesve ishin pa arsim përkatës, këto synime nuk mund të realizoheshin kënaqshëm. Kësaj gjendje po t'i shtojmë dhe moszbatimin e konkurseve nga drejtoritë arsimore në përzgjedhjen e kuadrit për shkak të aferave korruptive, shoqëruar kjo me humbjen e interesit për mësimin nga ana e nxënësve, përbëjnë shkakun që studentët vijnë në universitet me boshllëqe. Realisht studentët tanë nuk dinë të shprehen qartë, domethënë nuk dinë që mendimeve të tyre t'u japin një formë shprehje koherente e në vijueshmëri. Mungesa e një boshti logjik në shprehje është treguesi më i qartë i një mendimi të mjegulltë. Kjo gjendje është shprehje e një pune të pamjaftueshme dhe pa efikasitet të kryer në arsimin parauniversitar.

Së katërti, mangësi të theksuara në formimin gjuhësor sidomos në zbatimin e normës drejtshkrimore e pikësimore. Kjo është nga mangësitë më të theksuara e më të dukshme dhe që evidentohet mjaft lehtë nga pedagogu sapo vë re një shkrim të studentit. Nga përvoja jonë e punës me studentët gjatë zhvillimit të lëndëve të ndryshme, por sidomos gjatë zhvillimit të lëndës Shkrim akademik, studentët kanë mangësi shumë të mëdha në zbatimin e normave të shqipes letrare aq sa në ndonjë rast nuk mund të kuptosh se në ç'gjuhë është shkruar. Prandaj i del detyrë tekstit universitar që të përfshijë krahas njohurive të tjera edhe njohuri nga fusha e drejtshkrimit.

Teksti krahas njohurive teorike duhet të japë dhe udhëzime praktike mbi shkrimin në universitet. Ai duhet ta paraqesë të shkruarin si një proces krijues që nis me lindjen e idesë fillestare e deri në përgatitjen përfundimtare të dorëshkrimit. Gjithashtu ai duhet të përshkruaj me hollësi teknikat, hapat si dhe veprimet që duhen ndërmarrë në procesin e përgatitjes së një pune studimore apo eseje duke respektuar rregullat drejtshkrimore e gramatikore të gjuhës shqipe, si dhe praktikat e ligjërimit interesant.

Procesi i shkrimit ftillohet me caktimin e temës, në formulimin e tezës, në diskutimin e punës së përfunduar nga audienca shoqërore. Rëndësi e veçantë i jepet punës me paragrafin si njësi themelore e shkrimit. Më tej paraqitet e analizohet ndërtimi i brendshëm, përshkruhen teknikat më të përshtatshme për organizimin e paragrafëve funksionalë në situata të ndryshme retorike. Paragrafët duhet të kenë unitet, të jenë të organizuar e koherent. Nuk duhet të pëlqehen paragrafët e gjatë ku duhet të eliminohen fjalët e tepërta e boshe. Shkurtësia dhe qartësia si dhe përdorimi i fjalëve me kuptim të saktë e shumë koncize janë veçori të një shkrimi universitar me nivel.

Po kështu teksti duhet të synojë të shpjegojë llojet e ndryshme të shkrimit në universitet, sipas metodologjisë që kushtëzohet rrethana të ndryshme në disiplina të ndryshme, të drejtojnë shfrytëzimin e përdorimin e kujdesshëm të burimeve të ndryshme.

Realizimi i këtyre synimeve kërkon nga hartuesit e tekstit edhe ndërtimin e një programi të saktë që do të transmetonte te studentët një vëllim të caktuar njohurish dhe do të ishte i përshtatshëm për përdorimin e tij nga studentët e të gjitha degëve ose hartimi i dy teksteve: një për degët shoqërore dhe një për degët natyrore. Për çdo rast teksti duhet të japë modele praktike sipas degëve përkatëse. Punim shkencor do të bëjnë gjithë studentët pavarësisht nga dega që ndjek. Studenti që ndjek inxhinierin ose ekonomikun në këtë tekst duhet të gjej modele për specialitetin e tij, prandaj del e domosdoshme hartimi i tekstit me grup autorësh.

Më poshtë po japim një model të sylabusit të lëndës Shkrim akademik, i cili sipas mendimit tonë ky program duhet të përfshijë këto tema:

Nr	Temat për çdo orë mësimi
1	Arsimi i lartë i mbështetur në punën kërkimore shkencore. Psikologjia e të shkruarit
2	Të shkruarit si praktikë shoqërore. Të qenit në kontakt me të shkruarit
3	Procesi i të shkruarit. Gjymtyrët kryesore të shkrimit.
4	Shkrimi i paragrafit. Forma dhe lënda e paragrafit. Njësia e paragrafit.
5	Fantazia dhe ortografia ose nga ideja te realizimi i shprehjes me shkrim. Nga të folurit te shkrimi.
6	Shkrimi akademik ose si hartohet punimi shkencor. Punimi shkencor. Koncepti, llojet. Punimi monografik dhe panoramik
7	Zgjedhja e temës. Parimet. Pikat e mbështetjes
8	Karakter i shkencor. Kufizimi i fushës së studimit. Pasaportizimi i materialit, konkretizimi dhe siguria.
9	Punimi me karakter historik apo teorik?
10	Etapat në procesin e kërkimit shkencor. Taktika dhe strategjia.
11	Modele dhe rrugë për të realizuar një temë studimore.
12	Struktura formale e një punimi shkencor. Diskutimi i pjesëve përbërëse.
13	Praktikum i një punimi. Përgatitja e punimit në dorë të parë (drafti).
14	Kërkimi i materialit. Burimet. Kërkimi në bibliotekë.
15	Si punohet me bibliografinë. Skedari
16	Burimet dytësore në temën kërkimore. Mbajtja e shënimeve mbi burimet dytësore.
17	Shfytëzimi i burimeve. Udhëzim për skedimin. Shmangia e plagjiaturës përmes dokumentimit të përshtatshëm.
18	Rëndësia e zgjedhjes së metodës. Metoda e vrojtimit, e anketimit dhe e eksperimentimit

19	Rregullat e citimeve. Kur dhe si bëhen?
20	Treguesi i lëndës i vështruar si plan pune
21	Praktikum për plotësimin e skedave dhe shënimet.
22	Rregullat për mbajtjen e shënimeve
23	Shkrimi i një teme diplome. Struktura e shkrimit të një teme diplome.
24	Si prodhohen shkrimet profesionale?
25	Studimi akademik (tezë doktorati, artikull, libër monografik). Treguesi ose indeksi.
26	Drejtskrimi i disa formave gramatikore më të përdorshme.
27	Disa pika të “kodit” shkrimor të shqipes. Theksi.
28	Zanorja ë e patheksuar
29	Shenjat e pikësimit. Përdorimi i shkronjave të mëdha në gjuhën shqipe. Pastrimi dhe pasurimi i gjuhës shqipe.

Këto mendojmë se do të jenë disa tema orientuese ku do të zbërthehen parimet e përgjithshme të të shkruarit, të cilat hartuesit e tekstit mund t'i shtojnë e t'i përshtasin sipas degëve përkatëse.

Perfundime

Nga sa trajtuam në këtë kumtesë mund të themi se roli i shkrimit universitar si proces krijues është vendimtar në formimin e studentit. Ai shërben si matës praktik i formimit të tij të gjithanshëm, i aftësive e shprehive të fituara dhe i mundësisë a pamundësisë së studentit për të përballuar sfidat e ardhshme që e presin. Kërkimi shkencor, i cili zë një vend të veçantë gjatë viteve të shkollimit dhe që e vazhdon atë gjatë jetës i hedh themelet pikërisht në vitet e shkollimit e veçanërisht në universitet. Sa më të forta të jenë këto themele aq më në gjendje është studentit të përballojë me kompetencë detyrat kërkimore të çdo specialiteti.

Referime bibliografike

- 1.Barnet, S& Bellanca, P,&Stubbs, M, Shkrimi akademik, Tiranë, 2000
- 2.Shkurtaç, Gj, Si të shkruajmë shqip, Tiranë, 2008, f.27

- 3.Shkurtaç, Gj & Çiraku, Y, Hyrje në metodikën e punës shkencore, Tiranë, 2004, f. 29
- 4.Robins, R, Historia e gjuhësisë, Tiranë, 2007
- 5.Hudson,R.A, Sociolingustika, Tiranë, 2004
- 6.Eko, U, Si të bëhet një temë diploma, Përpjekja, Tiranë, 1997
- 7.Rrokaj, Sh, Gjuhësia e përgjithshme, Tiranë, 2005
- 8.Memushaj, R, Hyrje në gjuhësi, Tiranë, 2004
- 9.Memushaj, R, Shqipja standarde, sit a flasim e ta shkruajmë, Tiranë, 2004
- 10.Shkurtaç, Gj, Sociolingustika, Tiranë, 2009
- 11.Shkurtaç, Gj, Etnografi e të folurit të shqipes, Tiranë, 2004
- 12.Nishku, M, Si të shkruajmë, procesi dhe shkrimet funksionale, CDE, Tiranë, 2004
- 13.Musai, B, Si të shkruajmë ese, CDE, Tiranë, 2004
- 14.Boçe, E, Si të shkruajmë një punim shkencor, CDE, Tiranë, 200

MËSUESI DHE ROLI I TIJ PARËSOR NË PROÇESIN E MËSIMDHËNIES

Phd.Candidate Eliona Naqo

Departamenti i Gjuhëve të Huaja

Fakulteti i Shkencave Humane

Universiteti "Ismail Qemali"

Vlorë, Shqipëri

eliona.naqo@gmail.com

Abstrakt

Proçesi i mësimdhënies është konsideruar gjithmonë si art më vehte duke u bazuar konkretisht në disa aspekte themelore si komunikimi, perceptimi, bashkëpunimi në klasë dhe kujdesi për vlerësimin. Në këtë fillim shekull, po përhapet gjerësisht një metodë e re e konceptimit të mësimdhënies në klasë, e cila është e orientuar drejt nxënësit duke e vendosur atë në qendër të këtij proçesi e duke kërkuar më shumë si nga ai vetë ashtu edhe nga mësuesi. Nxënësi patjetër duhet të bëhet një element hulumtues më aktiv në klasë, ndërsa roli i mësuesit është që ta orientojë nxënësin duke mos i ofruar atij informacione të gatshme. Mësimdhënia e suksesshme e mësuesit me nxënësit në kuptimin e gjerë pedagogjik matet jo vetëm në aftësitë e tij shkencore dhe metodike për të dhënë lëndën, që kjo e fundit të bëhet e dashur dhe e lehtë për t'u përvetësuar nga nxënësit, por edhe në aftësitë që tregon mësuesi për ta edukuar nxënësin me norma të tilla, që të reflektojnë në kontaktet me të tjerët në çdo mjedis ku ndodhet, se është vërtet nxënës që ka marrë një edukim të shëndoshë në shkollë. Është kjo pra arsyeja që detyra e mësuesit për mësimdhënien dhe edukimin është një detyrë me shumë përgjegjësi. Natyrisht për ta kryer suksesshëm këtë detyrë nuk është e lehtë, pasi te mësuesi kërkohen jo vetëm aftësi profesionale, por që ai të jetë edhe njeri human, zemërgjerë dhe i durueshëm, e këtë duhet ta vlerësojë ç'do mësues pasi e tillë është natyra e profesionit që ushtron, por ama jo e pamundur për t'u realizuar. Që i gjithë proçesi i mësimdhënies të bëhet sa më i suksesshëm, kemi nevojë për mësues të aftë dhe të kualifikuar, ndaj kontrolli dhe përgjegjësia e tij për mësimdhënien që zhvillon duhet vlerësuar si një problem parësor në shkollat tona.

Fjalë kyç: mësimdhënie, mësues, nxënës, kualifikim, bashkëpunim, vlerësim

Abstract

Since the very beginning education, teachers have played one of the main roles, or even the main one in the educational process, as those who can help students to achieve what each society defines important to be learned by the youngest. Even when teachers' role has change through history and societies

according to the particular context of each period and place, its importance has remained as the cornerstone of the educational process. Nevertheless, this role has dramatically changed in the last decades and nowadays it has been pushed to the limit and demanded to be rethought and redefined in order to respond to the actual social requirements and changes. Teachers are no longer the owners of knowledge and the idea of transmitting what they know is considered old-fashioned. So, what does this role need to be like? Which are those changes and how are teachers supposed to face them? Moreover, if this role is expected to be redefined in traditional learning environments, it is obviously expected to be thoroughly defined when technology is to be incorporated to educational processes. Since the entire teaching process becomes more successful, we need qualified teachers, and for this reason, his control and responsibility for teaching process that develops should be evaluated as a primary problem in our schools.

Key words: teaching process, teachers, students, educational process, knowledge, evaluation

Hyrje

Mësuesi, figura më e rëndësishme e edukimit, ka për detyrë t'i ndihmojë nxënësit të mësojnë, t'i shikojnë gjërat në këndvështrime të ndryshme dhe t'i aftësojë ata në jetën sociale. Megjithatë, në zakonisht e përdorim termin mësues për ata njerëz, detyra kryesore, funksionale apo profesionale e të cilëve është t'i ndihmojë të tjerët të mësojnë dhe të përvetësojnë shprehi e mënyra të reja të sjelljes. Mësuesit ndikojnë në jetën e nxënësit me anë të vendimeve që marrin duke filluar që nga mënyra e vendosjes së bankave në klasë e deri tek mënyra e zhvillimit të veprimtarive brenda saj si dhe kohëzgjatja e tyre. Didaktika moderne me aplikimin e metodave të reja kërkimore ka ndryshuar rolin tradicional të mësuesit si dhënësi i informacionit dhe i leksionit në klasë në favor të rolit të ri të regjisorit dhe koordinatorit që propozon studimin e problemit, që sugjeron drejtimet e kërkimit, stimulon e nxit interesin e nxënësit, të menduarit krijues të tyre. Në vend që të zhvillojë një histori të mërzitshme, të mbushur me emra dhe data pa fund, ai nxit të kërkuarit. Roli i mësuesit në didaktikën moderne mund të krahasohet, siç shprehen Gino De Vecchis dhe Giusepe S. Staluppi : “ Me atë të një dirigjenti të mirë orkestre, ku ai vetë nuk i bie instrumentave, por bën që të dalë një muzikë e këndshme”. Roli i mësuesit në mësimdhënie është i lidhur me pyetjet, detyrat dhe reagimet që ka, u mëson nxënësve se si duhet ta organizojnë punën në klasë, si t'i ndajnë detyrat, si të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin, si të sillen, si t'i përcaktojnë detyrat, si t'i nxjerrin pikat apo çështjet kryesore dhe problematikat apo si të nxjerrin përfundimet. Mësuesi i realizon këto për të nxitur *ndërveprimin në mjedisin mësimor*, element ky tepër i rëndësishëm në funksion të të nxënësve si dhe të suksesit në klasë. Në vazhdim do të paraqesim disa nga detyrat dhe rolin konkret të mësuesit në procesin e mësimdhënies.

1. Ndhmon nxënësit për të shprehur idetë e tyre dhe për të thjeshtuar shumë koncepte

Kur nxënësit vijnë në shkollë, ata tashmë kanë ide, nocione dhe mënyra të arsyetuar, ose siç i referohemi ndryshe me termin koncepte. Këto koncepte janë shpesh në përputhje me teoritë shkencore, por ndonjëherë edhe të papajtueshme. Roli i një mësuesi është të nxjerrë në pah këto ide, t'i mbështes ato me qëllim për të zhvilluar dhe fituar njohuri shkencore. Konceptet që nxënësit kanë ndërtuar për të organizuar botën në të cilën jetojnë, shpesh janë koncepte të ndryshme shkencore. Ato vazhdojnë të mbesin edhe pas mësimit, pasi janë të rrënjësura shumë herët në zhvillimin e fëmijës, duke u bërë pjesë e një regjistri emocional të magjisë, ritualit, si edhe të një sistemi shpjegues, që edhe pse mund të jenë të gabuara nga një pikëpamje rreptësisht shkencore, këto koncepte rezultojnë efikase për fëmijën në jetën e tij të përditshme. Konceptet përbëjnë shpesh një pengesë ndaj procesit të mësimit. Njohja e tyre e lejon mësuesin të përshtas orët e mësimit për t'i kuptuar më mirë. Shpesh është më mirë të punohet "me" konceptet duke u përjekur për t'i zhvilluar ato, sesa duke u përjekur me çdo kusht për të shkuar "kundër" tyre.

2. Thjeshton diskutimet, organizon një debat të vërtet shkencor në klasë

Përvoja, interpretimi i fenomeneve, përpunimi konceptual, çdo klasifikim i propozuar nga një studjues apo nxënës, është në mënyrë të pashmangshme debat i diskutueshëm shkencor që lejon ballafaqimin e ideve dhe argumente. Është e rëndësishme për të bërë të tjerët të kuptojnë se ku bazohemi për të bërë këtë propozim, mënyrën sesi organizojmë këto vëzhgime, sesi ne përfshijmë këtë propozimin në një tërësi dijesh tashmë të vendosura dhe të pranuar. Çdo rezultat i përvojës çon drejt diskutimeve mbi vetë përvojën e cila ka lejuar krijimin e tyre, mbi kushtet, rëndësinë dhe vlefshmërinë e saj. Çdo lidhje midis vëzhgimeve të ndryshme është pjesë e një botëkuptimi që nuk është e ndarë domosdoshmërisht.

3. Ndhmon nxënësit në mësimit në klasë

Qasjet shkencore janë të ndryshme. Modeli "*vëzhgim, hipotezë, eksperimentim, rezultat, konkluzion*" është përdorur shpesh në klasa dhe sigurisht që ne gjejmë gjurmë të tij në fletoret e shënimeve. Megjithatë, kjo sigurisht që rezultojnë më e rëndësishme si një kuadër i përgjithshëm për raportimin mbi vëzhgimet, sesa për të programuar kronologjinë e seancave mësimore. Përveç kësaj, ajo ç'ka rezultojnë dyfish e dënueshme është:

- **së pari**, sepse ideja që vëzhgimi vjen i pari - është shumë i diskutueshëm, pasi ai udhëhiqet gjithmonë nga një kornizë e të menduarit që e bën këtë apo atë fakt të merret parasysh, të konsiderohet rilevant atëherë kur një fakt tjetër nuk "shihet". Shkenca didaktike, në përjekjet e saj, nisat nga probleme dhe pyetje të ngritura kryesisht nga mësuesit, si edhe nga supozimet për ti zgjidhur ato dhe jo vetëm për të qëndruar vëzhgues kundrejt tyre.
- **së dyti**, sepse eksperimenti nuk është e vetmja mënyrë për të siguruar një shprehje/formulim shkencor. Eksperimentimi supozon se mund të përziejdhim në mënyrë selektive faktorët që mund të gjenerojnë një efekt të vëzhgueshëm. Për shembull, në astronomi nuk mund të ndryshojmë

vendin e yjeve apo emetimin e dritës, por ne mund t'i vëzhgojmë pa problem ata.

4. Favorizon punën individuale dhe atë në grup

Grupi i punës nuk formohet spontanisht në klasë. Puna në grup lejon ballafaqimin e ideve, por ndonjëherë e bën menaxhimin e klasës më të vështirë për mësuesin. Kjo bëhet për të lehtësuar kontrollin, shkëmbimet verbale dhe procedurale mes nxënësve, duke i ndihmuar ata që të ngrejne hipoteza, për t'i testuar dhe vëzhguar ato, si edhe për t'i shpjeguar duke argumentuar e duke bërë kërkime. Shumica e mësuesve sipas *Didaktikes Moderne*, procedojnë si më poshtë: Nxënësit ndahen në grupe prej tri ose katër vetësh, secili i ngarkuar me një rol specifik (përgjegjës për pajisje, sekretar/e, raportues/e i grupit, ...).

Puna në grup është e alternuar në punë individuale dhe punë kolektive. Kontrollat, shkëmbimet verbale, ngritjet e hipotezave, eksperimentet, vëzhgimet, shpjegimet, argumentet, kërkimet janë zhvilluar gjithmonë në dy nivele: së pari, në nivel grupi dhe së dyti në nivel klase, me një kthim të mundshëm në nivel grupi pas ballafaqimit dhe përkufizimit të përbashkët të orientimeve të reja kërkimore. Ky alternim midis punës individuale dhe asaj në grup favorizon ndërtimin gradual të njohurive shkencore nga ana e nxënësve, ndërsa të gjitha këto kontribuojnë tërthorazi në qëllimin e arsimit, atë të dijes e të qytetarisë.

5. Drejton procesin mësimor në klasë

Të drejtosh procesin mësimor në klasë nuk do të thotë thjesht "të sugjerosh përgjigjen e duhur" dhe t'u tregoni nxënësve se ç'farë të bëjnë, por duhet të siguroheni që aktivitetet e tyre të jenë të mirë organizuara, të monitoruara, produktive dhe të orientuara drejt një qëllimi të arritshëm në mënyrë sistematike. Të drejtosh procesin mësimor në klasë do të thotë :

- të propozosh situata eksplorimi
- të ndërtosh pyetje
- të bësh të mundur që pyetja e një nxënësi të jetë e vlefshme për të gjithë klasën.
- të organizosh ushtrime me shkrim duke nxitur komunikimin mbi mësimin,
- të bëhet e mundur që puna të kryhet në klasë dhe të krahasohen me përgjigjet e sakta,
- të sigurohet që ka një plan mësimor dhe rezultatet të mbahen shënim.

Kjo është për të bërë të qartë atë që është bërë dhe arsyen për të cilën është kryer kjo punë, në mënyrë që kujtesa të zhvillohet në aspektin e arsytimit dhe të njohurive, dhe jo vetëm në drejtim të veprimeve të njëpasnjëshme të transmetimit. Mësuesi duhet të ndërveprojë me të gjithë nxënësit. Ai duhet t'u drejtohet nxënësve të veçantë dhe të lejojë dhe nxisë edhe ndërveprimin ndërmjet tyre. Duhet të nxisë nxënësin për një këndvështrim kritik, duke argumentuar mendimet dhe përgjigjet e tyre, dhe t'i shikojë përgjigjet e shokëve apo të grupeve të tjera në mënyrë kritike. Rolet dhe detyrat e mësuesit mund të shihen si një përshkrim i punës së tij, i cili tregon qartë se sa kompleks, delikat, serioz dhe i lodhshëm është ai. Mësimdhënia e suksesshme e mësuesit me nxënësit në kuptimin e gjerë pedagogjik matet jo vetëm në aftësitë e tij shkencore dhe metodike për të dhënë lëndën, që kjo e fundit të bëhet e dashur dhe e lehtë për tu përvetësuar nga nxënësit, por edhe

në aftësitë që tregon mësuesi për ta edukuar nxënësin me norma të shëndosha qytetarie edhe pse brenda ambjenteve shkollore. Shkolla si institucion i specializuar, kërkon vazhdimisht mësues e drejtues me autoritet e profesionalizëm. Sado e modernizuar që të bëhet shkolla, ajo nuk mund të spostoj në asnjë rast rolin thelbësor e tepër të rëndësishëm të mësuesit në këtë proces. Pozicioni i mësuesit, vendosja graduale e tij në qendër të mësimit dhe edukimit, është i lidhur me rolin, misionin dhe detyrën e veçantë që ai ka në procesin e mësimit dhe të shkollës. Mësuesi pa autoritet ose me autoritet të kufizuar e frenon shkollën në rrugën e saj të shpejtë të progresit. Njohja me nxënësin është hapi i parë që çdo mësues duhet të bëjë. Pra, në qendër është nxënësi, pikënisja është nxënësi dhe qëllimi final është përsëri nxënësi, ai bëhet aktiv në këte proces. Mësimdhënia përfshin profesionalizmin dhe kujdesin e pandërprerë të nxënësve dhe të qenit i përgjegjshëm për zhvillimin e tyre në një shoqëri komplekse demokratike. Me fjalë të tjera, mësuesit duhet të mendojnë jo vetëm për 'mjetet' që përdorin në procesin mësimor, por edhe për qëllimin e mësimdhënies. Kjo në vetvehte rrit obligimet e mësuesve të përfshirë në këtë proces, duke i parë e konsideruar ata jo vetëm si mësues, por edhe edukatorë, që marrin çdo ditë vendime të cilat mbartin ngarkesa të mëdha morale e psikologjike për vet nxënësit. Njësia matëse themelore e një mësuesi të mirë është sigurisht përparimi akademik i fëmijëve. Nuk është qëllimi të gjykos mësuesit, por të hapësh biseda të shumëllojshme me ta në gjetjen e rrugëve më të mira të të mësuarit në klasë. Prandaj, çdo ndihmë e kontroll kërkohet të ngjallë një bashkëbisedim reflektues, ku drejtuesi të flasë e të diskutojë për ato që ka parë e dëgjuar në orët e mësimit. Mënyra se si i vlerëson mësuesi nxënësit, si vlerësohen ata me notë etj., tregon profesionalizmin dhe ndjenjën e lartë të përgjegjësisë që mban dhe që shfaqet dukshëm, nëse është i suksesshëm, në arritjen e treguesve dhe në përgatitjen e nxënësve. Në fund të fundit, detyra e drejtuesit është t'u shërbejë mësuesve në fushën e kërkimit shkencor, që këta të fundit t'u shërbejnë fëmijëve në klasë. Ka ardhur koha për mësues të suksesshëm që të jenë në gjendje të realizojnë qëllimet dhe objektivat e programit, që vërtetojnë aftësitë e tyre për rezultatet e planifikuara. Në jetën tonë të përditshme ne shpesh përdorim termin "*mësues i suksesshëm*". Dhe një mësues i tillë e merr këtë emërtim kur është në gjendje të realizojë qëllimet dhe objektivat e programit dhe mbi të gjitha aftësinë e tij për të realizuar rezultatet që ai i ka planifikuar vetes. Një mësues me autoritet e profesionalizëm e shoqëron gjithnjë përkushtimi për nxënësit, të qenët i përgjegjshëm për profesionin, i drejtë, i kuptueshëm në shpjegim, i matur dhe mbi të gjitha me besim në vetvete. Ka mësues që u mungon autoriteti e profesionalizmi, i shoqërojnë gjithnjë rezultatet e dobëta, shprehin ashpërsi, paraqiten të ngurtë dhe të mërzitshëm me nxënësit, janë të shpërndarë e të pasigurt, shprehin veprime inatçore dhe gabime shkencore në orët e mësimit. Ka mësues që nuk e kanë zgjidhur mirë destinacionin e tyre profesional edhe pse punojnë e lodhen nuk kanë efektivitet në punë. Ndaj roli i mësuesit të sotëm është të drejtojë dhe kuptojë mendimin e të dëgjojë me kujdes idetë e nxënësve. Duke vepruar kështu, klasa bëhet një komunitet i fuqishëm i të nxënësve.

Komunikimi midis mësuesit e nxënësit për të qënë në parametra normale kërkon marrjen parasysh edhe të disa elementeve të tjerë që ndikojnë në procesin e komunikimit. **Këta elementë janë:**

1-Mësuesi duhet të ruhet nga gjendje emocionale të pakontrolluara në orën e mësimit

2-Mësuesi duhet të zbatojë të gjitha rregullat e orës së mësimit në të kundërt do të iniciohen situata kaotike nga ana e nxënësve duke shfaqur tension dhe sjellje negative në klasë.

3-Aplikimi i saktë i pyetjeve në klasë nga mësuesi gjatë orës së mësimit ndikon për një sjellje positive në orën e mësimit në të kundërt do krijojë një klimë të papërshtatshme nga ana e nxënësve në ambientin e klasës.

4-Komunikimi i lirshëm nga ana e mësuesit krijon pozitivitet në marrëdhëniet e tij me nxënësit gjatë procesit mësimor.

5-Dhënia e informacionit nga mësuesi.

N.q.s informacioni është i saktë ,interesant,i kohës,tërheqës për vëmendjen e nxënësit,jepet në mënyrë interesante,lejon shkëmbimin e ideve dhe është i prekshëm në klasë,atëherë kemi të bëjmë me një situatë interesante gjatë orës së mësimit.Në tërësinë e saj figura e mësuesit shpreh imazhe të pëlqyeshme për nxënësit dhe shpesh herë ajo shihet nga ata si një model i përkryer sjelljeje.Ai,mësuesi, nga njëra anë paraqet një autoritet shkollor me një personalitet të spikatur që kërkon në komunikimin me nxënësit të mbajë një distancë në bazë të hierarkisë shkollore dhe nga ana tjetër ai duhet të ushtrojë edhe pozicionin e tij si një këshilltar për nxënësin.

Mësimdhënia është shkencë edhe art, është profesion dhe zanat,Nëse është art, atëherë mësimdhënia kërkon frymëzim, intuitë, talent e kreativitet. Nëse është shkencë, atëherë mësimdhënia kërkon njohuri dhe aftësi, që me të vërtetë mund të mësohet.Mësimdhënia së pari bazohet në shkencat paradigmatiche dhe në përvojat e shumta, të cilat është vështirë të gjitha të kualifikohen si profesionale. Gjithashtu duhet të shihet edhe si një karakteristikë që rrallë ndonjë mësues i referohet – ajo është edhe një pavarësi e kufizuar. Me të kërkohet që ç’do herë të vendoset një baraspeshë ndërmjet të gjitha elementeve që e kushtëzojnë pavarësinë, si p. sh. pushteti nëpërmjet planprogrameve, teksteve shkollore, administratorëve dhe udhëheqësve të shkollave. Mësuesi duhet të jetë përgjegjës i shumëfishtë jo vetëm për njohuritë, por edhe për atë që ndodh në punën e tij.Mësuesi është dhe duhet të jetë një menaxher shumë i mirë në klasë. Bashkëpunimi është thelbësor për procesin e të nxënësit, pra njerëzve u nevojitet që të punojnë me njëri- tjetrin në mënyrë që të nxënë sa më efektivisht. Nxënësit, më shumë se mësuesit duan një menaxhim të mirë , sepse ky u jep atyre sigurinë e duhur në klasë e cila kështu është e qëndrueshme. Qëndrueshmëria vjen nga zbatimi i procedurave dhe rutina.Mësuesi efektiv mund të nxjerrë nxënës më të përparuar nga pikëpamja akademike, krahasuar me shembuj të tjerë.

Përfundime

Shkolla dhe mësuesi në veçanti ka si mision zhvillimin e gjithanshëm të personalitetit të fëmijëve. Mësuesi duhet t’i njohë fëmijët, të njohë familjet e tyre me gjithë ndryshueshmërinë që ato kanë. Kjo e vendos mësuesin përpara një detyre shumë të vështirë dhe me shumë probleme. Në ditët e sotme ,kjo situatë është edhe më komplekse, sepse ka një përzierje kulturash në çdo

shkollë. Pavarësisht nga ky fakt, të gjithë kanë nevojë t'u shërbehet me anë të një arsimi që i ndihmon për të përballur sfidat e ditëve të sotme. Mësuesi i shërben nxënësit, por ai i shërben edhe prindit që është i interesuar për edukimin e tij. Roli i mësuesit në mësimdhënie është i lidhur me pyetjet, detyrat dhe reagimet që ka, u mëson nxënësve se si duhet ta organizojnë punën në klasë, si t'i ndajnë detyrat, si të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin, si të sillen, si t'i përcaktojnë detyrat, si t'i nxjerrin pikat apo çështjet kryesore dhe problematikat apo si të nxjerrin përfundimet. Mësuesi i realizon këto për të nxitur ndërveprimin në mjedisin mësimor, element ky tepër i rëndësishëm në funksion të të nxënësve si dhe të suksesit në klasë. Pozicioni i mësuesit, vendosja graduale e tij në qendër të mësimin dhe edukimit, është i lidhur me rolin, misionin dhe detyrën e veçantë që ai ka në procesin e mësimin dhe të shkollës. Mësuesi pa autoritet ose me autoritet të kufizuar e frenon shkollën në rrugën e saj të shpejtë të progresit. Njohja me nxënësin është hapi i parë që çdo mësues duhet të bëjë. Pra, në qendër është nxënësi, pikënisja është nxënësi dhe qëllimi final është përsëri nxënësi, ai bëhet aktiv në këte proces. Ka ardhur koha për mësues të suksesshëm që të jenë në gjendje të realizojnë qëllimet dhe objektivat e programit, që vërtetojnë aftësitë e tyre për rezultatet e planifikuara. Ndaj roli i mësuesit të sotëm është të drejtojë dhe kuptojë mendimin e të dëgjojë me kujdes idetë e nxënësve. Duke vepruar kështu, klasa bëhet një komunitet i fuqishëm i të nxënësve.

Literatura

- Driscoll, M. (2005). Psychology of learning for instruction. USA: Allyn and Bacon.
- Reigeluth, C. (1999). Instructional design theories and models. Vol. II. USA: Lawrence Erlbaum Associates.
- Pratt, D. and Collins, J. (2007). Five perspectives on teaching. Presented at the International PBL Symposium. Pratt, D., Collins, J. and Jarvis, S. (2001). Development and use of the Teaching Perspectives Inventory (TPI).
- Musai, Bardhyl (2003): Metodologjia e Mësimdhënies.(2003).fq.198
- Richards, J.C., (1990): The Language Teaching Matrix, Cambridge University Press.
- Richards, J.C. & Rodgers, T.S. (1999): Approaches and Methods in Language Teaching. Cambridge: Cambridge University Press. fq. 17-71
- Savignon, S. (1997): Communicative Competence: Theory and Classroom Practice (2nd editin. Sydney: Mc Graw Hill Companies. Language Teaching fq.105-181
- Balboni, P. E., 20082, Le sfide di Babele. Insegnare le lingue nelle società complesse, Torino, UTET Università (edizione ampliata e modificata rispetto al 2002).
- Baur, S, Mezzalana, G, Pichler, W, 2008, La lingua degli altri. Aspetti della politica linguistica e scolastica in Alto Adige-Südtirol dal 1945 a oggi, Milano, Angeli.
- Berrettini, L, 2008, I materiali per la didattica dell'italiano L2 nel mondo: una ricognizione, Perugia, Guerra.
- Brighetti, C., Minuz, F. 2008, Abilità del parlato, Perugia, Guerra.
- Caon, F., 2008, Educazione linguistica e differenziazione: gestire eccellenza e difficoltà, Torino, UTET Università.

VËZHIM MBI DISA RASTE HUAZIMESH LEKSIKORE NGA GREQISHJA TË FJALORIT TEKNIK TË SHQIPES

Eljana Mosko

Evanthia Baruta

Katerina Vasili

Universiteti "Eqrem Çabej" i Gjirokastrës
emosko@uoj.edu.al

Abstract

The last social and economic changes have affected deeply the lexical system of Albanian language; we will bring into attention the new words in the technical and professional vocabulary of our language. The aim of this article is to give the results from observation made to lexical changes occurred by the influence of another linguistic system (the Greek language); these words have filled the gap of Albanian lexical system after the 90' with regard to new words used in the technical vocabulary.

The study is based in the region of Gjirokastra taking into consideration the vocabulary used by many Albanian emigrants who have recently returned from Greece where they have worked for several years as electricians, carpenters, plumbers, welders, mechanics etc. There are taken interviews with around 200 workers in order to receive the necessary information – the professionalisms – the language they use in their everyday routine.

The results are analyzed and separated based in the techniques and the respective lexical setting. This study serves as a first step to further attention that must be paid to the supplying of Albanian technical vocabulary with the necessary words.

Key words: borrowing, techniques, Greek, professionalisms

Abstrakt

Ndryshimet sociale e ekonomike të viteve të fundit kanë ndikuar thellë në rrafshin e leksikut të gjuhës shqipe; veçanërisht mund të sjellim në vëmendje prurjet e reja në fjalorin teknik e profesional të gjuhës. Qëllimi i këtij studimi është evidentimi dhe vëzhgimi i ndryshimeve gjuhësore që kanë ardhur si pasojë e ndikimit të një sistemi tjetër gjuhësor (të gjuhës greke) dhe që plotësojnë një mungesë të leksikut në shqipen e pas viteve 90, duke u fokusuar në prurjet e reja të leksikut teknik. Studimi në fjalë është përqendruar në qarkun e Gjirokastrës duke marrë shkas nga gjuha e përdorur nga shumë emigrantë shqiptarë që janë kthyer dhe ushtrojnë profesionin që kanë patur në Greqi.

Për të vjelë fjalorin përkatës teknik – profesionalizmat – janë ndërmarrë intervista me rreth 200 punëtorë që ushtrojnë profesionin e tyre në teknika të ndryshme në Qarkun e Gjirokastrës. Ndër ta mund të përmendim pllakashtrues, elektrikistë, hidraulikë, mekanikë, marangozë, saldatorë etj. Rezultatet e përfutuara nga këto intervista janë analizuar dhe ndarë sipas teknikave dhe leksikut përkatës. Gjykojmë se është i nevojshëm evidentimi dhe vendosja në vëmendjen e duhur të këtyre prurjeve.

Fjalët kyçe: huazime, teknikë, greke, profesionalizma

Hyrje

Huazim quhet ndryshimi gjuhësor i një njësie të caktuar që vjen si pasojë e ndikimit gjuhësor të një sistemi në një sistem tjetër. Huazimi tregon se popujt që kanë qenë kufitarë ose kanë pasur marrëdhënie historike, ekonomike a kulturore ndërmjet tyre kanë shkëmbyer dhe pasuruar gjuhën e njëri tjetrit me fjalë e shprehje për të plotësuar nevojat e tyre gjuhësore.

Huazimi i fjalëve nga gjuhë të tjera në gjuhën shqipe është një proces normal dhe i vazhdueshëm i cili është bërë ndonjëherë edhe kur për të njëjtat koncepte kemi pasur fjalë të tjera në përdorim. Gjithsesi, huazimi leksikor ndodh në rrethana historike e gjuhësore të caktuara, edhe kur në gjuhën shqipe ka emërtim për të njëjtën fjalë a për të njëjtin koncept. Kur fjalët e huazuara nuk hyjnë në një gjuhë bashkë me sendet e me konceptet e reja, po bashkëpërdoren si sinonime me fjalët e vendit, kemi huazime gjuhësore (Thomai, 2011).

Në këtë punim do të përqëndrohemi në disa raste huazimesh të ardhura nga greqishja që i përkasin fjalorit të përditshëm teknik të shqipes. Ky studim është bazuar në gjuhën teknike të specialistëve të fushave të ndryshme që ushtrojnë aktivitetin e tyre në jug të vendit. Profesionalizmat e përdorura në punën e tyre

të përditshme janë fjalë të huaja të marra hua nga gjuha greke për të plotësuar nevojat e tyre profesionale.

Pra, nevoja e ngutshme kulturore, njohja e pamjaftueshme e leksikut popullor ka huazuar një varg fjalësh nga disa gjuhë. Kuptimisht, këto fjalë, që janë quajtur me të drejtë fjalë të huaja për t'i dalluar nga huazimet e përvetësuara mirë në sistemin leksikor të gjuhës, paraqiten jo vetëm si fjalë – terma, por edhe si fjalë të leksikut të përgjithshëm dhe kjo dëshmon deri diku edhe për përhapjen e tyre. Këto fjalë të reja, për ata që nuk i njohin a i njohin fare pak, ose i njohin jashtë marrëdhënieve të zëvendësimit me fjalët e huaja dhe që, nga ana tjetër, janë mësuar të përdorin në mënyrë të qëndrueshme fjalët e huaja përkatëse, paraqiten për njëfarë kohe e në një farë mënyre si neologjizma të ligjërimit (Vehbiu, 1986) (Në këtë pikëpamje ato dallojnë nga neologjizmat e mirëfilltë të gjuhës, që janë “fjalë ose shprehje” që kanë hyrë së fundmi në gjuhë për të shënuar një send a një dukuri të re që ende ndihet si e tillë dhe që ndërtohen me lëndën e gjuhës amtare). Huazimi përbën rastin e fenomenit të përgjithshëm të neologjizmit dhe për më tepër të ndryshimit gjuhësor. Ai përbën një nga mjetet të cilën gjuhët e përdorin për t'u rifreskuar. Duhet gjithashtu theksuar kemi konkretisht lënien disi pas dore të kërkimeve lidhur me dukuri të rëndësishme, siç është p.sh. ajo e riprodhimit të funksioneve semantike të njëjta, krijimit të raporteve të caktuara leksiko – semantike mes njërive leksikore “autoktone” dhe huazimeve që depërtojnë në sistemin e gjuhës shqipe.

Në fushat e veprimtarisë njerëzore, sipas mjeshtërive, ndeshim shtresa fjalësh që njihen e përdoren vetëm nga grupe të veçanta njerëzish, nga punonjës e specialistë që merren me një punë të caktuar (Thomai, 2011). Një vend të veçantë në gjuhë, sidomos në ligjërimin e thjeshtë dhe më pak në atë bisedor, zënë shprehjet me prejardhje nga të folmet profesionale, për të cilat do të flasim në vazhdim. Ne kemi për qëllim të nxjerrim në pah një raport që ekziston mes këtyre profesionalizmave të huazuara nga gjuha greke dhe njërive leksikore të tjera të sistemit të shqipes që është ai i sinonimisë pak a shumë të plotë. Kjo do të thotë se kuptimet leksikore të këtyre njërive përputhen si nga denotacioni, ashtu dhe nga vlera konotative e përdorimi (distribucioni) (Jorgaqi, 1998). Madje, po të shtyheshim më tej, do të thoshim se ekziston një simetri e plotë edhe ndërmjet strukturave kuptimore të shumë prej këtyre njërive.

Huazimi nga greqishtja

Sipas burimit në leksikon e gjuhës shqipe dallojmë dy shtresa: shtresën vetjake dhe shtresën e huazuar.

Fjalët me burim nga greqishja e vjetër në gjuhën shqipe janë huazimet më të hershme. Huazime të tilla për shkaqe gjeografike ka pasur që në kohë më të lashtë, po shumë fjalë greke hynë në shqipe që nga shekulli VIII para epokës sonë. Në përgjithësi fjalët nga greqishtja e vjetër u përkasin fushave shoqërore,

bimësisë etj. Huazime leksikore nga greqishja, të kohës bizantine dhe të kohës së re, kanë hyrë sidomos në jetën shoqërore, në artizanat, në botën shtëpiake, në kopshtari etj.

Gjuhëtari Jani Thomai shprehet se një pjesë e madhe e huazimeve leksikore nga greqishja ka mbetur në të folme anësore si krahinorizma (Thomai, 2011). Ne mendojmë se në kuadrin e krahinorizmave po zhvillohen, përgjithësisht në një rrafsh të sigurt, një sërë fjalësh e shprehjesh të fjalorit teknik.

Kjo dukuri është zhvilluar kryesisht pas rënies së komunizmit kur ndryshimet sociale, ekonomike dhe politike ishin rrënjësore. Shqipëria vuajti një tranzicion të vështirë për shkak se doli nga regjimi komunist e varfër në infrastrukturë, teknologji dhe prodhim; por Shqipëria ishte gjithashtu e varfër në fjalorin përkatës teknik. Ishte thuajse e pamundur për fjalorin e përdorur para viteve '90 të mbulonte të gjitha fenomenet, aktivitetet e urbanizimit që lulëzoi pas 1990. Si rrjedhim fjala e re hyri në gjuhën shqipe si një proces natyral dhe i paevitueshëm. Shumë fjalë të huaja pasuruan fjalorin e gjuhës shqipe me huazime por gjithashtu dhe me fjalë të tjera, ekuivalenti i të cilave mund të gjendej me lehtësi në gjuhën shqipe.

Emigrimi në perëndim ishte një nga faktorët kryesorë që ndikuan në prurjet e fjalëve të huaja në shqip. Shumica e shqiptarëve që udhëtuan kryesisht në Greqi përveç ndihmës ekonomike, sollën në Shqipëri shumë fjalë e shprehje nga vendet ku punonin e jetonin duke i kthyer këto fjalë e shprehje në pjesë të përditshme të fjalorit të tyre.

Profesionalizmat e jetës së përditshme të huazuara nga greqishja

Sferat e leksikut të hapura ndaj ndikimit grek në gjuhën shqipe kanë qenë të shumta. Por, një sferë që është ndikuar dukshëm, siç përmendëm dhe më lart, është ajo teknike. Vetë përdorimi i fjalëve teknike ose profesionalizmave të jetës së përditshme dëshmon për një jetë aktive të këtyre elementeve brenda sistemit të shqipes. Ne do të mbështetemi në kuadrin e fjalorit teknik të përdorur kryesisht në jug të Shqipërisë (Qarku Gjirokastrë), ku kemi kryer vëzhgime dhe marrë intervista me punëtorë që ushtrojnë profesionin e tyre në teknika të ndryshme në Qarkun e Gjirokastrës. Ndër ta mund të përmendim pllakashtrues, suvatues, elektriciistë, hidraulikë, mekanikë, drugdhendës, marangozë, saldatorë etj. Gjithashtu kemi intervistuar shitës të pajisjeve elektrike, hidraulike, të fushës së ndërtimit etj. të cilët kanë pohuar terminologjinë e huazuar nga greqishja të specialistëve të fushave të ndryshme, të cilët kërkojnë mjetet e tyre të punës në greqishte, kryesisht janë ata specialistë që e kanë ushtruar profesionin e tyre në Greqi. Kështu, në fjalorin teknik, veçanërisht të Qarkut të Gjirokastrës do të gjejmë fjalë të tilla të huaja si:

Në fushën e pllakashtruesit kemi veçuar këto terma:

Përdorimi në shqip	Përdorimi në greqisht	Përdorimi ekuivalent në shqip
Kolis	Κολλάω	Ngjit
Pllakaqe	Πλακάκια	Pllaka
Pllakë	Πλάκα	Dërrasë guri
Zuba	Ζουμπάς	Turjel
Variopulla	Βαριοπούλα	Matraka
Skafë	Σκάφη	Magje
Sufatopi	Σοφατεπί	-
Murello	Μορέλο	-
Armo	Αρμός	-
Meremete	Μερεμέτια	Meremetim
Rihtis	Ρίχτης	-

Pllakashtrues

Në fjalorin e Gjuhës Shqipe (2006) mund të gjejmë ekuivalentin e shumë prej këtyre fjalëve e termave që përdoren në gjuhën greke, por disa prej këtyre huazimeve kanë hyrë në shqipe bashkë me mjetet e punës dhe aktivitetin përkatës.

Nga intervistat e marra nga dyqanet e pajisjeve të punës, shitësit pohojnë gjithashtu se shpesh hasen me termat ekuivalente të këtyre fjalëve edhe në gjuhën italiane, pra në varësi të vendit ku këta specialistë kanë ushtruar profesionin e tyre.

Në fushën e drugdhendësit dhe marangozit kemi veçuar këto terma:

Përdorimi në shqip	Përdorimi në greqisht	Përdorimi ekuivalent në shqip
Skalis	σκαλίζω	Gdhend
Sqepar	σκεπάρνι	Sqepar
Trapezari	τραπεζαρία	Tavolinë dhe karrige
Trivio	τριβείο	-
Ikonostase	Εικονοστάσιο	Ikonostas
Gonjastër	γωνιάστρα	Gone

Drugdhendës, Marangozë

Për fushën e saldatorit dhe të mekanikut kemi veçuar këto terma:

Përdorimi në shqip	Përdorimi në greqisht	Përdorimi ekuivalent në shqip
Qillodhoko	Κιλοδοκό	Profil hekuri
Llamë	Λάμα	-
Kofti	Κόπτης	Prerës
Ura	Ούπα	-
Karavola	Καράβολα	Lule
Pundo	Πούντα	-
Troho	Τροχός	Sharrë disk
Kollauzo	Κολαούζο	Masio filetimi

Mekanikë

Për fushën e elektricistëve dhe të hidraulikëve kemi veçuar këto terma:

Përdorimi në shqip	Përdorimi në greqisht	Përdorimi ekuivalent në shqip
Kacavidhë	κατσαβίδι	Kaçavidhë
Pinaka	Ηλεκτρικός πίνακας	Kasetë elektrike
Priza suko	Πριζα σούκο	Prizë
Termosifon	Θερμοσίφοντας	-
Tanala	Τανάλια	Darë
Tripan krustiko	Κρουστικό τρυπάνι	Trapano
Asfalie	Ασφάλεια	Automat
Gonia	Γωνία	Bërryl
Taf	Ταφ	-
Mufa	Μούφα	Manikota
Valvidha	Βαλβίδα	Kondravalvola
Solina spiral	Σωλήνας σπιράλ	Tubo spiral
Banierë	Μπανιέρα	Vaskë
Lekan	Λεκάνη	VC
Kavuras	Κάβουρας	Papagall
(trupa) Kalorifer	Σώματα καλοριφέρ	Radiator

Kanavi	Κανάβη	-
Kolla pvs	Κόλα pvs	Ngjitës
Bateri	μπαταρία	Grup

Elektricihtë, Hidraulikë

Rezultate

Arsyet e riprodhimit relativisht besnik të funksioneve semantike të modeleve greke të mësipërme duhen kërkuar së pari te fakti se kjo kategori fjalësh, duke përfaqësuar në pjesën më të madhe të ashtuquajturat “huazime për nevojë”, zë “vendet bosh” në sistemin e gjuhës marrëse duke (Jorgaqi, 1998); së dyti, tek fakti se termat që përbëjnë një pjesë të madhe të kësaj kategorie fjalësh, duke qenë të zhveshur nga disa elementë që përbëjnë zakonisht vlerën e fjalëve, (siç janë p.sh. tiparet konotative), kushtëzohen edhe më pak prej sistemeve leksikore, përbërës të të cilëve ato janë. Pikërisht tek të gjitha këto e ka zanafillën “besnikëria” semantike e huazimeve ndaj modeleve.

Konkluzione

Dihet që depërtimi i huazimeve në një gjuhë është me pasoja për sistemin leksikosemantik të saj. Madje, sa më i thellë të jetë ky depërtim, aq më të mëdha janë pasojat. Me këtë kemi parasysh kryesisht atë mori procesesh si rrjedhojë e të cilave huazimet p.sh. u zenë vendin fjalëve ekzistuese të sistemit marrës, shënojnë objekte a koncepte të paemërtuara më parë në atë sistem apo ndikojnë në redistribucionin e funksioneve semantike të elementeve leksikore ekzistues të sistemit.

Për këto profesionalizma (pavarësisht se mbeten në kuadrin e ngushtë të një zone të caktuar) është mirë të analizohen jo vetëm mjetet dhe rrugët fjalëformuese që janë shtënë në punë për krijimin e tyre, por edhe jeta e tyre në ligjërim, sepse zëvendësimi është një proces i ndërlikuar e i ngadalshëm, në të cilin ndikojnë një varg faktorësh shoqërorë, si shkalla e shtrirjes së gjuhës letrare kombëtare në shtresa të ndryshme të popullsisë e në nivele të ndryshme të ligjërimit, shkalla e arsimimit të popullsisë, sasia e cilësia e shtypit etj.

Literatura

- Beci, B., 1997. *Marrëdhëniet e shqipes me greqishten në dritën e të dhënave të dialektologjisë shqiptare*. Studime filologjike Nr. 1-4, Tiranë
- Jazexhiu, V., Duro, A., 2006. *Motivimi në Terminologjinë e Agronomisë në rrafshin e Termformimit*. Studime Filologjike Nr. 1 – 2, Tiranë
- Jorgaqi, K., 1998. *Mbi Integrimin leksiko-semantik të italianizmave në shqipen standarde*. Studime Filologjike Nr. 1 – 2, Tiranë

- Ikonomu, K., 1997. *Η αλβανική γλωσσική επίδραση στα Ηπειρωτικά ιδιώματα*. Ιωάννινα
- Krimbas, G. P., 2007. *Επιδράσεις της νεότερης ελληνικής στις βαλκανικές γλώσσες*. Αθηνά
- Qirjazi, Dh., 1989. *Emrat vetjakë me prejardhje nga greqishtja e re*, Gjuha jonë Nr.2, Tiranë
- Simeonidhi, A. A., 1994. *Νεολογικός δανεισμός της νεοελληνικής*. Θεσσαλονική
- Tobaidhis, Dh., 1998. *Λεξιλογικά της νέας ελληνικής*. Αθηνά
- Vehbiu, A., 1986. *Fjalët e Huaja, Neologjizmat dhe ligjërimi*. Gjuha dhe Shkolla Nr. 1, Tiranë
- Thomai, J., 2011. *Leksikologjia e Gjuhës Shqipe*. Botimet Toena, Tiranë

EFEKTI SOCIAL I EDUKIMIT GJINOR

Dr.Elvira DODE

University "A. Xhuvani" Elbasan
Faculty of Education Sciences
Social Sciences Department
dode01@hotmail.com

Abstract

Gender equality education prepares civics who takes responsibilities for social , politic , economic issues and even for democratization processes. Its social effect , if it is not treated carefully may lead into the discrimination of some individual's categories according to gender basis.

The consciousness and the commitment for achieving gender equality is reflected even in the policies and strategies for education development. Including gender perspective in schools is a prerequisite inalienable of human development, instead insuring gender equality it is considered as respecting human rights. School environment , community and other actors have their influence into the creation of a perfect climate for realizing the education process in the most effective way. Attitudes , parents and teachers behaviors are seen as a role model and affect the civic education of pupils. From the other side, they help into solving the gender problems of pupils. Comparing the ratio of gender stereotypes exposure between attitudes and stands in the education system we conclude that there is a need for increasing the care that must be shown for integrating the gender education in the civic education framework of pupils.

The purpose of the undertaken study is to perform a systematic research in order to show the scale and shape in which gender stereotypes are portrayed and shown in social life and their affect in the education for a democratic society.

Only with democratic comprehensive curriculums , which fulfill the needs and values of the society , we can be sure that we are educating open mind people who are able to face differences around them in order to accept and live with them.

Keywords: civic formation , gender education , social effect , role model , sensitivity.

Abstrakt

Edukimi për barazinë gjinore përgatit qytetarë që mbajnë mbi supë përgjegjësi shoqërore , politike , ekonomike dhe procese të demokratizimit të vendit. Efekti social i tij , nëse nuk trajtohet me kujdes mund të çojë në diskriminimin e disa kategorive të individëve mbi bazë gjinie.

Vetëdija dhe përkushtimi për arritjen e barazisë gjinore është reflektuar edhe në politikat dhe strategjitë e zhvillimit të arsimit. Përfshirja e perspektivës gjinore në shkollë është parakusht i patjetërsueshëm i zhvillimit njerëzor , ndërsa sigurimi i barazisë gjinore është çështje e respektimit të të drejtave të njeriut. Mjedisi shkollor , komuniteti dhe akorë të tjerë pjesëmarrës , ndikojnë ndjeshëm në krijimin e një klime të përshtatshme për realizimin efektiv të procesit të edukimit. Qëndrimet , sjelljet e prindërve dhe mësuesve shërbejnë si rol model dhe ndikojnë në edukimin qytetar të nxënësve. Nga ana tjetër ndihmojnë për zgjidhjen e problemeve me bazë gjinore të nxënësve. Krahasimi i raporteve të shfaqjes së stereotipave gjinorë ndërmjet sjelljeve dhe qëndrimeve në sistemin e arsimit dëshmon për nevojën e rritjes së kujdesit që duhet treguar për integrimin e edukimit gjinor në kuadër të edukimit qytetar demokratik të nxënësve.

Studimi i ndërmarrë ka për qëllim të kryejë një hulumtim sistematik për të treguar shkallën dhe formën në të cilën stereotipat gjinorë janë portretizuar dhe shfaqen në jetën sociale dhe ndikojnë në edukimin për një shoqëri demokratike.

Vetëm përmes kurrikulës demokratike gjithëpërfshirëse , që i përgjigjet nevojave dhe vlerave të shoqërisë , mund të jemi të sigurt se edukojmë individë me mendje të hapur , të aftë për t'u përballur me dallimet rreth tyre , për të pranuar dhe jetuar me këto dallime.

Fjalë kyçe: formim qytetar , edukim gjinor , efekt social , rol model, ndjeshmëri.

HYRJE

Ndjeshmëria gjinore është një dimension i rëndësishëm i ngritjes së kapaciteteve që ka si synim promovimin e barazisë dhe shanceve të barabarta në shkolla , familje dhe komunitete rreth roleve gjinore , duke ndikuar në shoqëri. Qëllimet e sistemit edukativ reflektojnë vlerat e komunitetit (David, 1984).

Nëpërmjet arsimit mund të minimizohen pabarazitë midis burrave dhe grave , si dhe midis grupeve të tjera shoqërore (UNDP, 2005, fq. 21, 26). Politika Kombëtare e Arsimit e ndjekur nga reformat në sektorin e arsimit dhe

Plani Kombëtar i Veprimit synojnë arritjen e barazisë gjinore në arsim deri në vitin 2015. Strategjia kombëtare e arsimit parauniversitar 2004-2015 synon të influencojë në politikat arsimore: që nga formulimi , implementimi e deri tek llogaridhënia për efektet e monitoruara mbi të cilat ngrihet shërbimi i edukimit. SKBGJ-DHGDHF (2011-2015) ka referencë të qartë për arritjen e barazisë gjinore nëpërmjet eliminimit të stereotipeve gjinore.

Në fushën e arsimit ekzistojnë pabarazi gjinore që bazohen në tregues të matshëm. Përmbajtja e kurrikulës , programeve dhe teksteve mësimore , marrëdhëniet ndërvepruese mësues-nxënës , mjedisi institucional etj, nëpërmjet mesazheve që japin , luajnë një rol të rëndësishëm në ruajtjen dhe transmetimin e stereotipave dhe pabarazisë gjinore.

Vlerësimi dhe marrja në konsideratë e studimit në lidhje me ekzistencën dhe efektet e ndryshme të formave të diskriminimeve gjinore dhe disponueshmëria e institucioneve të arsimit për të rregulluar programet e tyre akademike bën të mundur rritjen e ndjeshmërisë ndaj problemeve gjinore.

Qëllimi i studimit

Studimi thekson nevojën e bashkëveprimit dhe trajtimit në të njëjtën kohë mes faktorëve të rëndësishëm të edukimit: nxënësve , familjes , mësuesve dhe shoqërisë e më gjerë për të krijuar mjete efektive për shmangien deri në eliminim të stereotipave gjinorë. Studimi i ndërmarrë ka për qëllim të kryejë një hulumtim sistematik për të treguar shkallën dhe formën në të cilën stereotipat gjinorë formëzohen dhe portretizohen përmes ndikimit dhe ndërveprimit të aktorëve në procesin e edukimit.

ASPEKTI TEORIK

Ekzistojnë tri qasje kryesore në lidhje me zhvillimin e gjinisë te fëmijët: perspektiva psikoanalitike (Freud, 1925) , proceset e të mësuarit social (Bandura, 1986) dhe proceset njohëse (Mischel, 1970). Proceset njohëse përfshijnë tri teori: teoria e të mësuarit social , teoria e zhvillimit konjitiv dhe teoria e skemave gjinore.

Sipas teorisë së roleve gjinore e përfaqësuar nga Talcott Parsons , shoqëria cakton role specifike stereotipike ndaj anëtarëve të secilës gjini. Këto stereotipa janë përvetësuar nga vajzat/gratë përmes socializimit dhe janë mbrojtur edhe nga djemtë/burrat. Connell argumenton se prirjet stereotipe janë shkaku i disavantazheve të grave (Connell, 1987, fq. 267). Për këtë arsye , sipas këtij qëndrimi , pabarazia gjinore mund të eliminohet përfundimisht nëpërmjet masave të veçanta të tilla si: eliminimi i modeleve stereotipe , programe veprimi afirmative , arsim më të mirë (duke përfshirë edhe programe antidiskriminuese) dhe trajtim të barabartë të vajzave nëpërmjet legjislacionit në tërësi , etj. (Risman, 2004, fq. 436).

Grupet e ndryshme të socializimit të tilla si: familja , shkolla , anëtarët e grupit dhe mass-media duhet të bëjnë punën e tyre për ndërtimin e një sërë modelesh të ndryshme të sjelljes për secilën prej gjinive. Në këtë mënyrë është ndërtuar socializimi gjinor (Connell, 1987, fq. 191). Faktorët socializues: prindërit , familjarët , moshatarët , mësuesit dhe përvojat e fituara nga kultura përreth dhe komuniteti kanë ndikim në formësimin e stereotipave gjinorë. Mënyra se si mësuesit dhe shkolla përcjellin indirekt stereotipa gjinorë njihet si “kurrikula e fshehtë”. Në përgjithësi , djemtë marrin më shumë vëmendje nga mësuesit se vajzat (Golombok, 1994, fq. 135). Nuk është provuar ende nëse djemtë , në të vërtetë janë më krijues se vajzat , por mesazhi i fshehur që përcillet nga mësuesi është i qartë: ka veprimtari që djemtë mund t’i bëjnë , ndërsa vajzat nuk mund t’i bëjnë (Berns, 1994, fq. 373).

METODOLOGJIA

Shumica e studiuesve të kërkimit cilësor të bazuar në intervista dhe pyetësorë , sugjerojnë kampion të qëllimshëm. Kampioni i qëllimshëm i përzgjedhur për studim është i lidhur me kërkesa të tilla si: ruajtja e barazisë gjinore , përfshirja në kampion e përfaqësuesve të tre cikleve të sistemit arsimor parauniversitar: arsimit fillor (klasa IV, V) , arsimit mesëm i ulët (klasa VI – IX) dhe arsimit mesëm i lartë (klasa X – XII).


Është analizuar opinioni i aktorëve të ndryshëm mbi ndikimin e problemeve gjinore në procesin e edukimit në arsim. Llojet dhe numri i aktorëve të kontaktuar:

1. Grupet e interesit nga 15 shkolla të përzgjedhura në qytete të ndryshme të Shqipërisë , Elbasan ,Tiranë , Shkodër , Pogradec , Korçë duke përfshirë 5 shkolla fillore , 5 shkolla të arsimit të mesëm të ulët , 5 shkolla në arsimin e mesëm të lartë , të shpërndarë në mënyrë të barabartë në zonat urbane.
 - a. Intervista me drejtues shkollash 28
 - b. Pyetësorë me prindër 80
 - c. Pyetësorë me mësues 120
 - d. Pyetësorë me nxënës 246

Strategjitë dhe mjetet e përdorura për grumbullimin e të dhënave parësore që janë përdorur:

1. Analiza e përmbajtjes , sasiore dhe cilësore të intervistave.
2. Intervista me drejtues shkollash.
3. Pyetësorë me mësuesit , nxënësit dhe prindërit.

REZULTATET E STUDIMIT



Grafiku 1: Mendime mbi mjediset ku shfaqet më shpesh dallimi gjinor

Pjesëmarrësitë e tre kategorive të kampionimit ndajnë mendime të njëjta mbi mjediset ku shfaqet më shpesh dallimi gjinor, por ndryshon përqindja për secilin mjedis. Prindërit shprehen se diskriminimi ndodh më shpesh në shkollë me 30% dhe në shoqëri me 20%-30%. Nxënësit medojnë se ndodh më shumë në shoqëri, me 42%. Kurse drejtuesit ndahen: gra me 35.71% shprehen se shfaqet më shumë në shkollë dhe burrat me 65.29% shprehen se shfaqen më shumë në shoqëri.




Grafiku 2: Raportet e nxënësve për mjedisin ku kanë mësuar për rolet gjinore

Nxënësit, pa dallim gjinor, përzgjedhin shkollën si mjedisin ku flitet më shumë rreth edukimit gjinor me një përqindje që shkon 39.00% për vajzat dhe 45.50% për djemtë. Ata e kanë më të lehtë që të flasim rreth roleve gjinore në shoqëri dhe në shkollë, kurse në shtëpi përqindja është e ulët 8.94% për vajzat dhe 5.73% për djemtë.



Grafiku 3: Raportet gjinore të nxënësve për personin që komunikojnë më lirshëm

Komunikimi me nënën përzgjidhet prej të dy gjinive si më i shpeshti dhe më i lirshmi, tek vajzat me 40.65% dhe tek djemtë me 31.15%. Djemtë ndikohen më pak se vajzat nga gjinia e personit me të cilin ata komunikojnë: 12.30% shprehen se komunikojnë me motrën, kurse 8.13% e vajzave komunikojnë me vëllain, 8.20% e djemëve komunikojnë me shoqen, kurse vajzat nuk komunikojnë me shokun.



Grafiku 4: Mendimet e prindërve dhe mësuesve për rolin përkujdesës të prindërve ndaj fëmijëve

Kujdesi i nënave për edukimin e fëmijës pranohet me 71.50% nga prindërit dhe mësuesit pa dallim gjinor. 19% e tyre shprehen se kujdesen të dy prindërit dhe vetëm 5% shprehen për babain. Kujdesi i nënës për fëmijët është 14.3 herë më shumë se kujdesi i babait.




Grafiku 5: Preferencat gjinore të nxënësve për shokun/shoqen më të afërt

Në arsimin fillor djemtë që zgjedhin vajza si shoqe janë 5 herë më shumë se vajzat që zgjedhin djemtë si shok. Në arsimin e mesëm të ulët ky dallimi ulët në 2.7 herë, sepse rritet përqindja e vajzave që zgjedhin djalë si shok. Dallimi midis gjinive rritet në arsimin e mesëm të lartë. Janë djemtë 4 herë më shumë ata që zgjedhin vajzat si shoqe.




Grafiku 6: Preferencat gjinore të nxënësve për shokun/shoqen më të afërt

Prindërit ndajnë mendime të ndryshme për ndikimin e gjinisë në zgjedhjen e shokut/shoqes nga fëmijët e tyre. Nënata 1.5 herë më shumë se baballarët mendojnë se gjinia nuk ndikon. Baballarët me 2.50% më shumë se nënat, shprehen se nuk kanë informacion mbi ndikimin e gjinisë në zgjedhjen e shoqërisë nga fëmijët e tyre.




Grafiku 7: Mendimet e prindërve dhe nxënësve mbi mundësitë për zgjedhjen e profesionit

Mundësia për të gjetur punë renditet ndër faktorët kryesor për përzgjedhjen e profesionit nga prindërit 55.00% -70.00% dhe nga nxënësit 26.83% - 28.46%. Tek nxënësit, vajzat me 5.00% më shumë se djemtë renditet si faktorin kryesor të ardhurat. Kjo përqindje rritet po të shtojmë përzgjidhen njëkohësisht të mundësisë për punë dhe të ardhurat.




Grafiku 8: Preferencat e nxënësve për profesionin që dëshirojnë të kenë në të ardhmen

Profesioni më i preferuar për të dy gjinitë është mjekësia 46.34% - 29.27%. Vajzat preferojnë mjekësinë 1.6 herë më shumë se djemtë. Në vend të dytë renditet inxhinjia me 27.64% për djemtë dhe 13.01% për vajzat , djemtë preferojnë inxhinierinë 2 herë më shumë se vajzat. Në vend të tretë , djemtë renditin sportet me 13.01% , kurse vajzat drejtësinë me 9.67%.




Grafiku 9: Mendimet e prindërve dhe nxënësve mbi vendimmarrjen në familje

Nga të dy kategoritë e pjesëmarrësve, të dy gjinitë, raportohet se më së shumti janë baballarët ata që vendosin në familje. Vetë baballarët shprehen 1.5 herë më shumë se nënat, kurse djemtë 3 herë më shumë se vajzat për rolin vendimtar të babait në familje. Prindërit, kryesisht grate, më shumë se fëmijët shprehen se nënat të vetme nuk kanë rol vendimmarrës.



Grafiku 10: Mendimet e prindërve dhe nxënësve për administrimin e të ardhurave

Roli i prindërve në vendimmarrje lidhet dhe me ndikimin që ata kanë në administrimin e të ardhurave financiare të familjes. $\frac{1}{2}$ e pjesëmarrësve në studim mendojnë se administrimi realizohet nga të dy prindërit, kjo më së shumti raportohet nga nxënëset/vajza me 52.66%. $\frac{1}{3}$ e pjesëmarrësve mendojnë se kjo kryhet nga babai, më shumë raportohet nga baballarët me 47.50% dhe nga djemtë me 36.59%.



Grafiku 11: Raportet mbi lëndët që ofrojnë mundësi për integrimin e edukimit gjinor

Pjesëmarrësit shprehen se mundësi për integrimin gjinor ofrojnë më shumë lëndët shoqërore. Edukata shoqërore përzgjidhet nga drejtueset me 35.70% dhe mësueset me 34.00% si lënda që ofron më shumë mundësi për integrimin, kurse qytetaria dhe sociologjia përzgjidhen si lëndë me 40.00% nga djemtë/burrat mësues dhe 21.40% nga drejtuesit.

Diskutimet

Studimi identifikon faktorët që motivojnë edukimin gjinor në sistemin arsimor, vlerëson ndikimin e kurrikulës mësimore për integrimin e edukimit gjinor, perceptimin dhe ndikimin e aktorëve të ndryshëm për çështjet gjinore. Ndikimet e stereotipave gjinorë në qëndrimet dhe preferencat e pjesëmarrësve në studim u shfaqën gjatë realizimit të pyetësorëve dhe intervistave.

Familja është mjedisi ku çdo individ mëson modelet e para të sjelljes, përfshirë dhe sjelljet me bazë gjinore përmes imitimit të rolit model. Shpesh në familje nuk flitet rreth edukimit gjinor vetëm ofrohen modele. Prandaj shkolla përzgjidhet nga nxënësit si mjedisi ku flitet rreth edukimit gjinor, duket theksuar kujdesin që duhet treguar për vlerësimin e të gjitha formave të këtij edukimi në këtë mjedis, pa harruar ndikimin e kurrikulës së fshehur (sjelljet e ofruara nga roli model i mësues/es-it). Shkolla bëhet institucioni kryesor i rëndësishëm krahas institucionit të familjes për integrimin gjinor të fëmijëve. Këtë rol ajo mund ta luajë përmes realizimit të objektivave specifike për integrimin e edukimit gjinor të sugjeruar nga politikat arsimore kombëtare.

Nënat nuk ankohen kurrë për kujdesin ndaj fëmijëve dhe punët që ato bëjnë. Kujdesi që tregon nëna për edukimin e fëmijës dhe shpesh herë butësia që ato shfaqin në krahasim me babain, bën që fëmijët të jenë të lidhur dhe të shprehen më lirshëm me nënën. Komunikimi me nënën pranohet se është më i lehtë, duke u përzgjedhur më shumë nga nxënësit e të dy gjinive. Vajzat ndikohen më shumë se djemtë nga gjinia e personit me të cilin komunikojnë. Ato komunikojnë më lehtë me persona që kanë të njëjtën gjini me to: nënën,

motrën , shoqen. Komunikimi vetëm me babain nuk është i lehtë për t'u realizuar dhe ka përqindjen më të ulët në zgjidhen prej vajzave , ndonëse e pranojnë atë kur komunikojnë me të dy prindërit.

Gjinia e shokut/shoqes më të afërt është e rëndësishme për secilën prej gjinive të nxënësve në të tre nivelet e shkollimit , por më shumë tek vajzat. Djemtë , më shumë se vajzat , preferojnë që të kenë shoqe , kurse vajzat që zgjedhin të kenë djalë si shokë më të afërt , janë më të pakta. Gjinia e shokut/shoqes më të afërt është e rëndësishme për secilën prej gjinive të nxënësve në të tre nivelet e shkollimit , por më shumë tek vajzat. Me rritjen e moshës , dallimet gjinore ulen , duke vlerësuar tek të tjerët cilësitë e mira. Prindërit ndajnë mendime të ndryshme për ndikimin e gjinisë në zgjedhjen e shokut/shoqes nga fëmijët e tyre. Nënata mendojnë 1.5 herë më shumë se baballarët se gjinia nuk ndikon në përzgjedhjen e shokut/shoqes më të afërt.

Ndikim i moshës dhe një mënyre e re e të menduarit rreth mundësive në zgjedhjen e profesionit sjell dallime midis fëmijëve dhe prindërve. Prindërit , të dy gjinitë , renditin si faktorin më kryesor mundësinë për të gjetur punë. Tek nxënësit , djemtë ndajnë përqindje të njëjtë midis mundësisë për të gjetur punë dhe të ardhurave , jo vetëm një punë e paguar , por dhe një profesioni i kërkuar në treg. Të ardhurat renditen si faktori kryesor nga vajzat nxënëse , duke menduar se pavarësia ekonomike do të ofroj mundësi në realizimin e tyre. Mundësia për të gjetur punë dhe të ardhurat , të dy faktorët së bashku , ndikojnë në zgjedhjen e profesionit nga nxënësit për të dy gjinitë. Ndikimi i gjinisë në zgjedhjen e profesionit shfaqet në përqindje më të madhe tek nxënësit , se sa tek prindërit. Përqindja për të dy gjinitë është e njëjtë.

Kemi thyerje të stereotipeve gjinore lidhur me preferencat e nxënësve mbi profesionin që dëshirojnë të kenë në të ardhmen. Profesionet më të preferuara prej nxënësve , për të dy gjinitë , janë mjekësia dhe inxhinieria. Në vend të tretë vajzat renditin drejtësinë , kurse djemtë preferojnë të jenë sportist. Ajo që tërheq vëmendje tek djemtë është se drejtësia dhe mësuesia renditen në vend të katërt. Profesionet e mësuesisë dhe parukaria janë parë si më të preferuara për vajzat , kurse studimi vëren një rritje të përqindjes së djemëve që zgjedhin këto dy profesione më shumë se vajzat. Profesionin e punonjësit të rendit , polic , ruan të njëjta përqindje me profesionin e parukierit. Vajzat tërheqin vëmendje kur barazojnë degën e ekonomikut me policinë , e cila është parë si profesion për djemtë. Përqindja e perceptimit nga nxënësit nuk është e njëjtë me atë të prindërve. Kjo për arsye të ndikimit të moshës dhe të një mënyre të re të të menduarit rreth zgjedhjes së profesionit.

Zhvillimet social-ekonomike kanë sjellë modele të reja për ndarjen e përgjegjësisë dhe kryerjen e detyrave ndërmjet pjesëtarëve të familjes. Vendimet në shumë familje merren nga të dy prindërit. Mendimet midis nxënësve dhe prindërve janë të ndryshme për rolin e babait në vendimmarrje , i cili ndikon dhe raportohet më shumë nga vetë baballarët dhe djemtë , duke

ndikuar mbi këta të fundit si model rol. Roli i prindërve në vendimmarrje lidhet dhe me ndikimin që ata kanë në administrimin e të ardhurave financiare të familjes. Vihet re një ndarje gjinore kur argumentojnë mendimet e tyre mbi rolin e babait për administrimin e të ardhurave. Nënata dhe vajzat shprehen se të ardhurat administrohen nga të dy prindërit. Kurse djemtë e baballarët shprehen se të ardhurat i administrojnë babai. Administrimi i të ardhurave në familje më shumë kryhet nga babai se sa nga nëna, e cila zë një përqindje më të ulët se babai dhe të dy prindërit së bashku.

Lëndët në të cilat ofron mundësi kurrikula për integrimin e edukimit gjinor janë të ndryshme midis drejtuesve dhe mësuesve, por dhe sipas gjinisë së tyre. Drejtuesit pavarësisht gjinisë shprehen se lëndët shoqërore, qytetaria dhe sociologjia ofrojnë më shumë mundësi për integrimin gjinor. Gratë mësuese dhe drejtuese shprehen se lënda e edukatës shoqërore ofron më shumë mundësi për integrimin e edukimit gjinor. Burrat mësues japin mësim më shumë në arsimin e mesëm të lartë dhe shprehen se lënda e qytetarisë, sociologjia dhe edukimi për karrierën ofrojnë këtë mundësi.

KONKLUZIONE

Realiteti tregon se në fushën e arsimit ekzistojnë pabarazi gjinore.

- Potenciali i zhvillimit të fëmijëve preket kur portretizimi gjinor lidhet me qëndrimet negative ndaj saj/tij.
- Fëmijët formojnë koncepte të gabuara për përgjegjësitë e prindërve në edukimin e tyre, duke e konsideruar atë si përgjegjësi të nënave dhe jo i baballarëve.

REKOMANDIME

- Realizimi i qëllimit të politikave dhe strategjive në arsim për eliminimin e stereotipeve gjinore, ende nuk është arritur në mënyrë të suksesshme. Për këtë është e nevojshme bashkërendimi i punës së të gjithë aktorëve përmes një plani konkret veprimi në arritjen e barazisë gjinore në arsim dhe më gjerë.
- Studimi i realiteteve të reja në familjen dhe shoqërinë shqiptare nxjerr në pah ridimensionimin e roleve dhe modeleve gjinore në përputhje me standartet e shoqërisë demokratike.
- Trajtimi i koncepteve specifike në arsim: politika, kurrikul dhe tekstet mësimore, duhet të zhvillohet nga ekspertë të problemeve gjinore, të cilët janë të ndjeshëm për gjendjen dhe vlerat e barazisë gjinore në arsim.

REFERENCA

1. Bandura, A. (1986), *Social foundations of thought and action: A social cognitive theory*. Englewood Cliffs NJ: Prentice-Hall
2. Berns, R. (1994), *Topical child development*; New York: Delmar Publisher, Inc.
3. Connell, R. (1987), *Gender and Power: Society, the Person and Sexual Politics*. Sydney: Cambridge, Polity Press
4. David, FQ. (1984), *The Social Role of School Textbooks in Canada*, McGill-Queen's University Press
5. Freud, S. (1925), *Some psychological consequences of the anatomical distinction between the sexes*, Condon: Hogarth Press, 1961
6. Golombok, S. & al. (1994), *Gender development*, New York: Cambridge University Press
7. Mischel, W. (1970), *Sex-typing and socialization* (Vol. 3rd), New York: Wiley
8. Risman, B. J. (2004), *Gender as a social structure: theory wrestling with activism* (4 ed., Vol. 18). Gender and Society
9. *Strategjia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar 2004-2015*. Retrieved 2014, from shkollaqedua.org/wp-content/uploads/2013/05/STRATEGJIA-KOMB%25C3%258BTARE-E-ARSIMIT-2004-%25E2%2580%2593-2015.docx

FAKTORËT QË NDIKOJNË NË KOHËZGJATJEN E USHQYERJES EKSKLUZIVE ME GJI

¹Emirjona Kiçaj, ¹Rudina Çerçizaj, ¹Ela Peto, ²Emiljana Coraj

emirjona.kicaj@univlora.edu.al

¹Fakulteti i Shëndetit Publik, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë

²Drejtoria e Shëndetit Publik, Vlorë

Abstract

Hyrje: Ushqyerja ekskluzive me gji gjatë 6 muajve të parë të jetës së infantit përbën një nga qëllimet kryesore të programeve të kujdesjeve shëndetësore kudo në botë

Qëllimi i studimit: Të vlerësohet kohëzgjatja e ushqyerjes ekskluzive me gji me qëllim që të identifikohen faktorët të cilët ndikojnë negativisht në këtë metodë ushqyerjeje.

Objektivat specifike:

- Të përcaktohet metodat e ushqyerjes së fëmijëve.
- Të përcaktohet përdorimi i ushqyerjes ekskluzive me gji tek këta fëmijë.
- Të përcaktohen cilët janë faktorët të cilët ndikojnë pozitivisht apo dhe negativisht në kohëzgjatjen e ushqyerjes ekskluzive me gji.

Metodologjia e studimit: Ky është një studim deskriptiv cros sectional. Në këtë studim janë përfshirë 68 nëna. Të dhënat e këtij studimi u morën nëpërmjet një pyetësoi të vet – administruar.

Rezultatet: Vetëm 25.9% e nënave kanë realizuar ushqyerjen ekskluzive me gji për 5 – 6 muaj. Në studimin tonë shikojmë se nënat e grupmoshës 26 – 35 vjec janë më të prirura drejt ushqyerjes ekskluzive me gji. faktori kryesor te të dy grupet e nënave që kanë bërë ndërprerjen e ushqyerjes ekskluzive me shpejt

është “Mendimi se nuk e ngopnin fëmijën, pasi ato shihnin se fëmija e tyre ishte i grinder” dhe faktori i dytë po prapë në të dy këto grupe nënash është: Ndikimi i familjarëve për të filluar ushqyerjen shtesë të fëmijës”. Tek nënat që kanë realizuar ushqyerjen ekskluzive me gji për një periudhë 5 – 6 muaj vëmë re se 45% e nënave referojnë mbështetjen nga personeli shëndetësor.

Konkluzion: Numri më i madh i nënave kishte realizuar ushqyerje ekskluzive me gji për 3 – 4 muaj 48.5% e nënave: Ushqyerja ekskluzive me gji për një kohë të gjatë shikohet tek: Nënmat me moshë mbi 26 vjeç, ato me arsim të lartë, shtëpiake dhe me status jo të lartë social, Nënmat të cilat kishin ushqyer fëmijën e tyre brenda 2 orëve të para të lindjes, nënat sekondipare, nënat të cilat kishin patur informim prej personelit shëndetësor në periudhën prenatale dhe postnatale në lidhje me rëndësinë e ushqyerjes me gji.

Fjalët kyçe: Ushqyerje ekskluzive me gji, infant, faktorët kontribues, kohëzgjatja

Hyrje: Ushqyerja me gji shikohet si **standarti i artë** i ushqyerjes së infantëve. Ushqyerja ekskluzive me gji është metoda më e mirë e ushqyerjes së fëmijëve gjatë 6 muajve të parë të jetës. Komiteti Amerikan i ushqyerjes me gji dhe Akademia e Pediatërve Amerakinë e ka përkufizuar ushqyerjen ekskluzive me gji si **një nga metodat fiziologjike të ushqyerjes së infantëve** [1], [2], [3], [4]. Ushqyerja ekskluzive me gji gjatë 6 muajve të parë të jetës së infantit përbën një nga qëllimet kryesore të programeve të kujdesjeve shëndetësore kudo në botë. Infermieri është ai personel shëndetësor i cili shikohet si një person i rëndësishëm i personelit shëndetësor që ka një rol të madh në inkurajimin dhe mbështetjen e praktikave të mira në drejtim të ushqyerjes me gji gjatë 6 muajve të parë të jetës së infantit [5], [6], [7], [8], [9], [10], [11], [12], [13], [14], [15], [16].

Faktorët të cilët kanë një ndikim pozitiv në drejtim të ushqyerjes me gji janë ndarë në këto grupe faktorësh si faktorët socio demografik: moshë e nënës, statusi civil, niveli i edukimit [5], [7], [10]; faktorët biofizik: eksperiencat e mëparshme, fillimi i hershëm i ushqyerjes me gji dhe perceptimimi i nënave në lidhje me sasinë e qumështit [16], [17], [18], [19], [20], [21], [22], [23]; faktorët psikosocial, faktorët këta të cilët mund të modifikohen dhe duhet të vendosen në qëndër të vëmendjes të personelit shëndetësor: pikësynimi për ushqyerjen me gji, mbështetja e nënës nga partneri dhe familja dhe niveli i besimit të nënës në drejtim të ushqyerjes me gji [22], [23], [11], [12], [16], [26]; faktorët që lidhen me ndërhyrjet infermierore: edukimi i nënave; mbështetja e nënave; përmirësimi i praktikave spitalore si roomin - ing, kontakti i shpjetë lëkurë –

lëkurë, staf i trajnuar, politikat mbështetëse të ushqyerjes me gji [24], [25], [26], [27]

Qëllimi i studimit: Të vlerësohet kohëzgjatja e ushqyerjes ekskluzive me gji me qëllim që të identifikohen faktorët të cilët ndikojnë negativisht në këtë metodë ushqyerjeje.

Objektivat specifike:

- Të përcaktohet metodat e ushqyerjes së fëmijëve.
- Të përcaktohet përdorimi i ushqyerjes ekskluzive me gji tek këta fëmijë.
- Të përcaktohen cilët janë faktorët të cilët ndikojnë pozitivisht apo dhe negativisht në kohëzgjatjen e ushqyerjes ekskluzive me gji.

Metodologjia e studimit: Ky është një studim deskriptiv cros sectional. Në këtë studim janë përfshirë 68 nga 98 nëna të cilat kanë lindur gjatë periudhës Janar 2013 – Korrik 2014. Të dhënat e këtij studimi u morën nëpërmjet një pyetësi të vet – administruar, i cili përmbante pyetje mbi:


- *Të dhënat personale të nënave:* moshë, statusi civil, niveli arsimor, statusi i punësimit, statusi socio ekonomik.
- *Vlerësimi i ushqyerjes me gji:* ushqyerja me gji gjatë dy orëve të para të jetës, ushqyerja e neonatit në momentin e daljes nga materniteti, kohëzgjatja e ushqyerjes ekskluzive me gji.
- *Faktorët biofizik:* pariteti, lloji i lindjes, problemet gjatë ushqyerjes, arsytet e ndërprerjes së ushqyerjes së ekskluzive me gji.
- *Faktorët psikosocial:* momentin i vendosjes së mënyrës sesi do ta ushqenin fëmijën, personit i cili ka ofruar mbështetjen më të madhe.
- *Faktorët që lidhet me ndërhyrjet mbështetëse:* informimi i nënave në lidhje me rëndësinë e ushqyerjes me gji në periudhën antenatale dhe postnatale, dhe personi i cili ka realizuar këtë informim

Rezultatet: Në këtë studim janë përfshirë 68 nga 98 nëna të cilat kanë lindur gjatë periudhës Janar 2013 – Korrik 2014, 36 fëmijë (52.9%) ishin femra dhe 32 fëmijë (47.1%) ishin meshkuj.

Tabela 1. Paraqitja tabelare e shpërndarjes së nënave të përfshira në studim sipas të dhënave socio demografike.


Variablat	Numri	%
Mosha		
Më e vogël se 18 vjeç	8	11.8%
18 – 25 vjeç	22	32.4%
26 – 35 vjeç	34	50%
Mbi 35 vjeç	4	5.8%
Niveli arsimor		
Arsim 8 vjecar	3	4.4%
Arsim i mesëm	18	26.5%
Arsim i lartë	47	69.1%
Statusi I punësimit		
Punëtore e thjeshtë	5	7.4%
Në administratë	19	27.9%
Në edukim	6	8.8%
Në biznes vetjak	11	16.2%
Shtëpiake	27	39.7%
Statusi socio ekonomik		
Status i ulët social	29	42.6%
Status i mesëm social	30	44.1%
Status i lartë social	9	13.3%

Grafiku 1




Vetëm 4.4% referuan se nuk e kishin ushqyer aspak fëmijën me gji, 5 – 6 muaj e kishin realizuar 29.5% e nënave, 3 – 4 muaj

Grafiku 22




Në shumë studime është vërejtur se nënat e reja janë shumë më të prirura drejt përdorimit të ushqyerjes së përzier. Në studimin tonë shikojmë se nënat e grupmoshës 26 – 35 vjeç janë më të prirura drejt ushqyerjes ekskluzive me gji. Nënata e moshave më të reja janë më të prirura kundrejt ushqyerjes së përzier.

Grafiku 3



Në këtë rast vëmë re niveli arsimor i nënave luan një rol në realizimin e ushqyerjes ekskluzive me gji. Nënmat me arsim të lartë shikojmë se kanë tendencë për të realizuar ushqyerje ekskluzive me gji për 3 – 4 muaj 81.8% e tyre dhe për 5 – 6 muaj 90% e nënave.


Grafiku 4



Shikojmë që nënat të cilat punojnë në administratë janë më të prirura kundrejt ushqyerjes ekskluzive me gji për një kohë të shkurtër. Ushqyerje ekskluzive me

gji për një periudhë 5 – 6 muaj e shohim që ndiqet shumë më tepër prej nënave të cilat nuk janë të punësuar (shtëpiake).


Grafiku 5



Këtu shohim se nënat të cilat vijnë prej familjeve me status të ulët social realizojnë ushqyerjen ekskluzive me gji për një kohë më të gjatë 5- 6 muaj (65% e tyre).


Përsa i përket nënave të cilat janë me status të lartë social janë më të prirura drejt fillimit të përdorimit të ushqimit shtesë që në muajt 3 – 4 të jetës së fëmijës.

Grafiku 6




Ndër faktorët të cilët kanë ndikim në mënyrën e ushqyerjes së fëmijëve është dhe mënyra e ushqyerjes që kanë ndjekur nënat që në momentet e para të lindjes së fëmijëve. Tek nënat të cilat kanë realizuar ushqyerje ekskluzive me gji për një periudhë kohore më të gjatë 3 – 4 muaj dhe 5 – 6 muaj përqindja e nënave të cilat kanë realizuar ushqyerjen me gji brenda 2 orëve të para të jetës së bebit është më e lartë përkatësisht 69.7% dhe 75%.

Grafiku 8




Nënat primipare janë më të prirura kundrejt ushqyerjes ekskluzive me gji për një periudhë tepër të shkurtër kohore 1- 2 muaj. 75% e nënave të cilat kanë ushqyer fëmijën e tyre ekskluzivisht me gji për 5 – 6 muaj e kanë qënë nënat e fëmijëve të dytë.

Grafiku 9




Nënat të cilat kanë realizuar lindje vaginale janë më të prirura drejt përdorimit të ushqyerjes ekskluzive me gji 3 – 4 muaj 90.9%, 5 – 6 muaj 95%. Nënat të cilat kanë realizuar lindje me sexio cezare janë më të prirura drejt përdorimit të ushqyerjes ekskluzive me gji për një periudhë më të shkurtër kohore 1 – 2 muaj.

Grafiku 10




Një nga problemet më të shpeshta që është hasur nga nënat të përfshira në studim është dhimbja e thithave gjatë ushqyerjes. Një problem i tillë është hasur dhe 75% e nënave që kanë realizuar ushqyerje ekskluzive me gji 5 – 6 muaj. Por shihet se ky faktor nuk ka ndikuar në vazhdimësinë e kësaj metode të ushqyerjes së infantit.

Grafiku 11




Nënave iu drejtua pyetja se cili mund të ishte shtysa që i kishte çuar ato drejt ndërprerjes së ushqyerjes ekskluzive me gji përpara muajit të gjashtë. Shikojmë se faktori kryesor të të dy grupet e nënave që kanë bërë ndërprerjen e ushqyerjes ekskluzive më shpejt është “Mendimi se nuk e ngopnin fëmijën, pasi ato shihnin se fëmija e tyre ishte i grinder” dhe faktori i dytë po prapë në të dy këto grupe nënash është :Ndikimi I familjarëve për të filluar ushqyerjen shtesë të fëmijës”

Grafiku 12




Nënat të cilat nuk i kishin ushqyer aspak me gji fëmijët e tyre e kishin vendosur atë paraprakisht. Nënat të cilat kishin ushqyer ekskluzivisht me gji 5 – 6 muaj, dhe 3 – 4 muaj, fëmijët e tyre në 90% dhe 75.8% të rasteve, e kishin vendosur ushqyerjen me gji paraprakisht.

Grafiku 13




Përsa i përket mbështetjes që kanë ndjerë nënat gjatë ushqyerjes së fëmijëve të tyre shikojmë se mbështetja e bashkëshortit nuk është aspak e madhe, edhe pse në literaturë shikohet si një faktor i rëndësishëm që ndikon në kohëzgjatjen e ushqyerjes ekskluzive me gji. Tek nënat që kanë realizuar ushqyerjen ekskluzive me gji për një periudhë 5 – 6 muaj vëmë re se 45% e nënave referojnë mbështetjen nga personeli shëndetësor, 20% e tyre referojnë se kishin lexuar mjaftueshëm për ushqyerjen me gji.

Grafiku 14




Grafiku 15




Tek nënat të cilat kishin realizuar ushqyerje ekskluzive me gji 5 - 6 muaj shikojmë se kemi rritje të rolit të infermierit të konsultorit të gruas. Përkatësisht nga 33.3% e tyre referuan se informacionin e kishin marrë nga mjeku i konsultorit dhe infermieri i konsultorit, 20% e tyre refruan se ishin informuar nga nënat dhe shikojmë një ulje të rolit ndikues të mikeshave me 13.4% të nënave.

Grafiku 16



Grafiku 17



Një periudhë e rëndësishme përsa i përket informimit në lidhje me rëndësinë e ushqyerjes me gji është periudha postpartum. Tek nënat të cilat kanë realizuar ushqyerje ekskluzive me gji 5 - 6 muaj informimi është realizuar në 80% të tyre.

Përsa i përket personit i cili e kishte ofruar këtë informacion shikojmë:

Tek nënat të cilat kishin realizuar ushqyerje ekskluzive me gji 5 - 6 muaj shikojmë se roli i infermierit të konsultorit të fëmijës është i madh 31.3% e tyre e referojnë këtë, 25% e tyre referojnë informimin nga mjeku i konsultorit të fëmijës, dhe nga 12.5% e tyre referojnë informimin nga mjeku neonat dhe infermieri neonat. 18.7% e tyre referuan informimin nga nënat dhe sërish roli i mikeshave është i padukshëm në këtë periudhë tek ky grup nënash.

Konkluzion

Numri më i madh i nënave kishte realizuar ushqyerje ekskluzive me gji për 3 - 4 muaj 48.5% e nënave. Ushqyerje ekskluzive me gji për 5 - 6 muaj ishte realizuar vetëm prej 29.5% të nënave.

Përsa i përket faktorëve të cilët ndikojnë në kohëzgjatjen e ushqyerjes ekskluzive me gji shikojmë:

- **Në grupin e faktorëve sociodemografik:** Ushqyerja ekskluzive me gji për një kohë të gjatë shikohet tek: Nënate me moshë mbi 26 vjeç, ato me arsim të lartë, shtëpiake dhe me status jo të lartë social.

- **Në grupin e faktorëve që lidhen me ushqyerjen e hershme që në maternitet:** Ushqyerja ekskluzive me gji për një kohë më të gjatë shikohet tek: Nënata të cilat kishin ushqyer fëmijën e tyre brenda 2 orëve të para të lindjes
- **Në grupin e faktorëve biofizik:** Ushqyerja ekskluzive me gji për një kohë më të gjatë shikohet tek: Nënata sekondipare, nënata të cilat kanë realizuar lindje normale vaginale.
- Dhimbja e thithave nuk kish shërbyer si faktor i cili mund të ndikonte në ndërprerjen e ushqyerjes ekskluzive pasi 75% e nënave që kishin ushqyer ekskluzivisht me gji kishin përjetuar dhimbje të thithave të gjirit.
- Si faktor kryesor i ndërprerjes së ushqyerjes ekskluzive me gji shikohet të jetë mendimi që kanë nënata se nuk arrijnë të ngopin fëmijët e tyre me gji.
- **Grupi i faktorëve psikosocial:** Ushqyerja ekskluzive me gji për një kohë më të gjatë shikohet tek: Nënata të cilat kishin vendosur paraprakisht të realizonin ushqyerje ekskluzive me gji ato të cilat kishin patur mbështetjen e personelit shëndetësor.
- **Grupi i faktorëve që lidhen me ndërhyrjet:** Ushqyerja ekskluzive me gji për një kohë më të gjatë shikohet tek: Nënata të cilat kishin patur informim prej personelit shëndetësor në periudhën prenatale dhe postnatale në lidhje me rëndësinë e ushqyerjes me gji.

Falenderime: Falenderojmë personelin shëndetësor të konsultorit të fëmijëve si dhe gjithë pjesëmarrësit për bashkëpunimin në këtë studim.

Referencat

1. Rezarta Lalo, Rudina Cercizaj 2012 "Kujdesi për nënën dhe fëmijën" fq. 410 – 417 ISBN 978 99956 91 99 8.
2. American Academy of Family Physicians Breastfeeding Advisory Committee. (2008). Breastfeeding, family physicians supporting (Position Statement). Retrieved on March 12, 2011 from: <http://www.aafp.org/online/en/home/policy/policies/b/breastfeedingpositionpaper.html>
3. American Academy of Pediatrics. (2012). Breastfeeding and the use of human milk. *Pediatrics*, 129 (3), e827-e841.
4. Bartick, M. & Reinhold, A. (2010). The burden of suboptimal breastfeeding in the United States: A pediatric cost analysis. *Pediatrics*, 125 (5), e1048-1056.
5. Health Promotion. (2012). *Breastfeeding Report Card- United States, 2012*. Retrieved on June 2, 2013, from:

<http://www.cdc.gov/breastfeeding/pdf/2012BreastfeedingReportCard.pdf>

6. Chantry, C.J., Howard, C.R., Auinger, P. (2006). Full breastfeeding duration and associated decrease in respiratory tract infection in US children. *Pediatrics*, 117 (2), 425-432.
7. Hamilton, B.E., Martin, J.A., & Ventura, S.J. (2010). Births: Preliminary Data for 2009. *National Vital Statistics Reports*, 59 (3), 1-29. Retrieved on June 2, 2011 from: http://www.cdc.gov/nchs/data/nvsr/nvsr59/nvsr59_03.pdf
8. Labbok, M. & Taylor, E. (2008). Achieving Exclusive Breastfeeding in the United States: Findings and Recommendations. Washington, DC: United States Breastfeeding Committee. Retrieved on May 17, 2013 from: <http://www.usbreastfeeding.org/LinkClick.aspx?link=Publications%2fBarriers-EBF-2008-USBC.pdf&tabid=70&mid=388>
9. Murtagh, L., & Moulton, A. (2011). Working mothers, breastfeeding and the law. *American Journal of Public Health*, 101 (2), 217-223.
10. United States Breastfeeding Committee. (2009). Strategic Plan: 2009-2013. Retrieved on December 10, 2012 from: <http://www.usbreastfeeding.org/Portals/0/USBC-Strategic-Plan-2009-2013.pdf>
11. United States Department of Health and Human Services. (2011). *The Surgeon General's Call to Action to Support Breastfeeding*. Washington, DC: U.S. Department of Health and Human Services, Office of the Surgeon General. Retrieved on May 30, 2011 from: <http://www.surgeongeneral.gov/topics/breastfeeding/calltoactiontosupportbreastfeeding.pdf>
12. World Health Organization. (2008). *Indicators for assessing infant and young child feeding practices: Part 1 definitions*. Geneva, Switzerland: World Health Organization References: Chapter Two
13. American Academy of Family Physicians Breastfeeding Advisory Committee. (2008). Breastfeeding, family physicians supporting (Position Statement). Retrieved on March 12, 2011 from: <http://www.aafp.org/online/en/home/policy/policies/b/breastfeedingpositionpaper.html>
14. American Academy of Pediatrics. (2012). Breastfeeding and the use of human milk. *Pediatrics*, 129 (3), e827-e841.
15. Antoniou, E., Daglas, M., Iatrakis, G., Kourounis, G., & Greatsas, G. (2005). Factors associated with initiation and duration of breastfeeding in Greece. *Clinical & Experimental Obstetrics & Gynecology*, 32 (1), 37-40.

16. Azulay-Chertok, I.R., Luo, J., Culp, S., & Mullett, M. (2011) Intent to breastfeed: A population-based perspective. *Breastfeeding Medicine, 6* (3), 125-129.
17. Baghurst, P., Pincombe, J., Peat, B., Henderson, A., Reddin, E., & Antoniou, G. (2007). Breastfeeding self-efficacy and other determinants of the duration of breast feeding in a cohort of first-time mothers in Adelaide, Australia. *Midwifery, 23*, 382-391.
18. Bai, Y., Middlestadt, S.E., Peng, J., & Fly, A.D. (2010). Predictors of continuation of exclusive breastfeeding for the first six months of life. *Journal of Human Lactation, 26*(1), 26-34.
19. Bai, Y. & Wunderlich. (2011). Predicting intentions to continue exclusive breastfeeding for 6 months: A comparison among racial/ethnic groups. *Maternal Child Health Journal, 15*, 1257-1264.
20. Bakoula, C., Veltsista, A., Prezerakou, A., Moustaki, M., Fretzayas, A. & Nicolaidou, P. (2007). Working mothers breastfeed babies more than housewives. *Acta Pædiatrica, 96*, 510-515.
21. Colaizy, T.T., Saftlas, A.F., & Morriss, F.H. (2012). Maternal intention to breastfeed and breast-feeding outcomes in term and preterm infants: Pregnancy Risk Assessment Monitoring System (PRAMS), 2000-2003. *Public Health Nutrition, 15* (4), 702-710.
22. Declercq, E., Lobbok, M., Sakata, C., & O' Hara, M. (2009). Hospital practices and women's likelihood of fulfilling their intention to exclusively breastfeed. *American Journal of Public Health, 99* (5), 929-935.
23. DiGirolamo, A., Thompson, N., Martorell, R., Fein, S., & Grummer-Strawn, L. (2005). Intention or experience? Predictors of continued breastfeeding. *Health Education & Behavior, 32*(2), 208-226.
24. Hill, G.J., Arnett, D.B., & Mauk, E. (2008). Breastfeeding intentions among low-income pregnant and lactating women. *American Journal of Health Behavior, 32*(2), 125-136.
25. Kuo, S., Hsu, C., Li, C., Chen, C., Gau, M., Chou, Y. (2008). Community-based epidemiological study on breastfeeding and associated factors with respect to postpartum periods in Taiwan. *Journal of Clinical Nursing, 17*, 967-975.
26. Lawton, R. Ashley, L. Dawson, S., Waiblinger, D. & Conner, M. (2012). Employing an extended Theory of Planned Behavior to predict breastfeeding intention, initiation, and maintenance in White British and South-Asian mothers living in Bradford. *British Journal of Health Psychology, 17*, 854-871.
27. McKee, M.D., Zayas, L.H., Jankowski, K.R.B. (2004). Breastfeeding intention and practice in an urban minority population: Relationship to

maternal depressive symptoms and mother-infant closeness. *Journal of Reproductive and Infant Psychology*, 22(3), 167-181.

PROBLEMATIKA TË PËRVETËSIMIT TË TRAJTAVE TË SHKURTRA TË PËREMËRIT VETOR GJATË MËSIMDHËNIES SË GJUHËS ITALIANE NGA STUDENTËT SHQIPTARË

Msc. Entela MUSTAFARAJ

Departamenti i Gjuhëve të Huaja, Dega Italisht
Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë
E-mail: entela.mustafaraj@gmail.com

Abstrakt

Përemrat vetor, veçanërisht trajtat e shkurta, përbëjnë në vetvete një vështirësi për folësin e gjuhës së huaj. Fakti që këto trajta nuk kanë një theks të vetin, paraqesin një raport aspak transparentë midis formës dhe funksionit. Ky artikull bazohet mbi disa vëzhgime të përdorimit të trajtave të shkurtra të përemrit vetor, të spikatura gjatë punës me studentët e seksionit të italishtes, duke nxjerr në pah problemet me të cilat përballen studentet shqiptar në procesin e mësimdhënies së gjuhës italiane. Gjithashtu, do të paraqesim një vështrim të përgjithshëm rreth karakteristikave dhe funksioneve të tyre morfosintaksore. Në veçanti, vëmendja do të përqëndrohet tek përshkrimi i disa tipologjive të zakonshme të gabimeve, në mënyrë që të mund të parashikohen dhe të parandalohen.

Fjalë kyç: *trajtat e shkurtra të përemrit vetor, vështirësi të përvetësimit, studentë shqiptar, analiza e gabimeve, italisht.*

Abstrakt

Subject pronouns and especially object pronouns are a difficult task for a foreign language speaker. The fact that these forms do not have a stress of their own, make them have not a transparent relation between form and

function. This paper is focused on some empirical observations of object pronouns, which have taken place during Italian language classes. These observations throw light on the problems of acquisition of these object pronouns forms, faced by the Albanian students when learning Italian. Additionally, this paper will treat a general overview of their morpho-syntax functions and characteristics. A special focus will be given to the description of some of the most common types of mistakes in order to foresee and to prevent them in the future.

Key words: *object pronouns, difficulty in acquisition, Albanian students, mistakes analysis, Italian*

1. Hyrje

Në këtë artikull do të analizohen gabimet më tipike dhe të shpeshta të trajtave të shkurtra të theksuara dhe të patheksuara të përemrit vetor në gjuhën italiane. Një vëmendje të veçantë do t'i kushtojmë edhe përemrave vetor të mirësjelljes, pasi janë pjesë e rëndësishme e jetës sonë sociale dhe kulturore. Ideja lindi nga vëzhgimi i drejtpërdrejt i vështirësive me të cilat përballen studentët gjatë studimit të gjuhës italiane dhe përpjekjet e tyre për të arritur nivele të kënaqshme të kompetencave gjuhësore.

Përemrat vetor janë elementë shumë të rëndësishëm gjatë komunikimit, duke qenë se kanë funksion tregues e jo emërtues (*Gramatika e gjuhës shqipe* 1995:215). Sistemi përemëror në italishten bashkëkohore është sa i pasur aq edhe i ndërlikuar. Është një nga pjesët e gramatikës që ka pësuar ndryshime të mëdha gjatë evoluimit diakronik dhe për këtë arsye ato kanë një larmishmëri formash.

Kategoria gjuhësore e përemrit vetor është mjaft heterogjene si në aspektin morfologjik ashtu edhe në aspektin sintaksor. Kështu, në aspektin morfologjik, shprehin tre aspekte të rëndësishëm si: vetën (I^{rë}, II^{të}, III^{të}), numrin (njëjës ose shumë) dhe gjininë¹. Në aspektin sintaksor, këto trajta zakonisht nuk mund të qëndrojnë vetëm, por të “mbështeten” tek një fjalë tjetër. Pra, tipari i tyre kryesor është të kapen pas kësaj fjale, pasi nuk janë në gjendje të mbartin theksin dhe për këtë i duhet një fjalë tjetër ku të mbështeten. Gjithashtu, ato nuk mund të modifikohen, të bashkërenditen apo t'u vendoset një theks dallues. Në këto raste, është i detyrueshëm përdorimi i përemrave të plotë, ose i emrave.

¹ Gjinia e përemrit vetor i përket vetës së tret (lui/lei), meqënëse bashkë biseduesit janë të pranishëm, veta e parë dhe e dytë nuk e ka të nevojshme shprehjen e gjinisë. (*Gramatika e gjuhës shqipe* 1995:221)

Veç kësaj, trajtat e shkurtra nuk mund të izoloohen nga pjesa tjetër e fjalisë si përemrat vetor në funksion të kryefjalës (Cardinaletti 1999: 34).

2. Veçoritë morfosintaksore të përemrave vetor në gjuhën italiane

Përemri është një kategori gramatikore e pranishme pothuajse në të gjitha gjuhët e botës. Në gjuhën italiane, përemrat vetor² paraqesin forma të ndryshme sipas vetës dhe funksionit. Në fakt, sipas Sensinit (1997:192) përemrat vetor nga pikpamja sintaksore kryejnë dy funksione: të kryefjalës dhe të kundrinorit. Në gjuhën italiane, ashtu si dhe në gjuhën shqipe³, përdorimi i përemrave në funksionin e kryefjalës nuk është i domosdoshëm, pasi mbaresat e foljeve tregojnë gjithmonë subjektin të cilit i referohet (Serianni1989:239; Dardano&Trifone 1995:263; Renzi 1988: 537; D’Achille 2009:116). Për këtë arsye, përdorimi i tyre është i kufizuar vetëm në ato situata kur duam të vëmë në pah subjektin:

- (1) a. *Ho chiamato il medico, non Mario.
b. Ho chiamato **io** il medico, non Mario.

Megjithatë, nëse në disa raste shprehja e kryefjalës është fakultative (2), në disa të tjera është e pamundur (3) dhe në të tjera akoma e detyrueshme (4):

- (2) **Noi /∅** andiamo al cinema stasera.
(3) i.***Esso** nevica tutto il giorno.
ii. **∅** Nevica tutto il giorno.
(4) Se esci **tu**, esco pure **io**.

² Sipas Gramatik s tradizionale së gjuh s italiane, përemri vetor (nga latinishtja *ponomen*) përkufizohet si një element që zëvendëson një emër duke e përfaqësuar me të njëjtat vlera gramatikore të gjinisë dhe numrit (Serianni 1989:237; Patota1997:227).

³ Përemrat vetorë të vetës së parë e të dytë të rasës emërore, në funksion të kryefjalës zakonisht nuk shprehen. (*Gramatika e gjuhës shqipe* 1995:223).

Përse i përket funksionit të kundrinorit, përemrat ndahen në dy kategori, të cilat dallojnë nga njëra-tjetra: trajtat e shkurtra të theksuara ose siç quhen ndryshe trajtat e plota dhe trajtat e shkurtra të patheksuara. Kundërvenia midis dy kategorive bazohet tek pozicioni i ndryshëm që ato zënë në fjali. Kështu, format e theksuara kanë një vendosje të ngjashme me emrin ose grupin emëror, pra ato ndjekin foljen (5) ndërsa format e patheksuara janë të kufizuara në pozicione të caktuara brenda fjalisë (6):

(5) Io parlo con **te/Federico/*ti**.

(6) i. **Gli** ho comunicato il mio arrivo.
ii. Comunicag**li** il mio arrivo, per favore.

Sipas Dardano&Trifone (1995:269) dhe Scalise (1990:290) trajtat e shkurtra të patheksuara, në aspektin gramatikor nuk janë autonome. Ato, domosdoshmërisht duhet t'i bashkohen një forme foljore, me të cilën formojnë një njësi të vetme. Siç u përmend pak më lart, në italishten standarde, nga pikpamja sintaksore format e patheksuara kanë normalisht një vendosje proklitike, nëse forma e foljes është e zgjedhurar (7), në këtë aspekt Gerlach (2002:189) shprehet se çdo vendosje tjetër me foljet e zgjedhuara është jo gramatikore (8) dhe vendosje enklitike nëse forma e foljes është e pazgjedhurar⁴ (9):

(7) i. Conosco **Gianni**.

ii. **Lo** conosco.

(8) *Conosco **lo**.

(9) Vado subito a prendert**i** il libro.

Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se trajtat e shkurtra të patheksuara përfshihen në kategorinë e rasës dhanore dhe kallëzore për të tre vetat e njëjësit dhe shumësit (Vedovato 2009:136). Tabela e mëposhtme na paraqet format e ndryshme të përemrit vetor⁵ sipas vetës dhe funksionit:

⁴ Tek format e pazgjedhuara të foljes futen mënyrat e pashtjelluara dhe mënyra urdh rore (*comprarli, avendone, fermatosi, ditelo*) (D'Achille 2009:119).

⁵ Nëse vëzhgojmë me kujdes tabelën, do të vëmë re se në sistemin përemror italian nuk janë përfshirë disa përemra të vetës së tretë njëjës dhe shumës si *egli, ella, esso, essa, essi, esse*, të cilat sot janë më pak të përdorshme (D'Achille, *L'italiano contemporaneo*, 2009:117).

Tabela 1. Sistemi përemëror në Italishten Standarde (SPI)

	Kryefjalë	Trajtë e plotë	
I njëjës	io	me	a me
II njëjës	tu	te	a te
III njëjës	lui M, lei F	lui M, lei F	a lui M, a lei F
I shumës	noi	noi	a noi
II shumës	voi	voi	a voi
III shumës	loro M, F	loro M,F	a loro M, F

Tabela 2. Trajtat e shkurtra në (SPI)

	Kundrinor	
	i drejtë (kallëzore)	i zhdrejtë (dhanore)
I njëjës	mi	mi
II njëjës	ti	ti
III njëjës	lo M, la F	gli M, le F
I shumës	ci	ci
II shumës	vi	vi
III shumës	li M, le F	gli/loro M,F

Siç vihet re në tabelën 1 dhe 2, në gjuhën italiane ekziston një formë e vetme e përemrit vetor në funksion të kryefjalës (*io, tu, lui, lei*), kurse si kundrinor ekzistojnë forma të ndryshme (*me/mi, te/ti, lui/lo/gli, lei/la/le*) si në (10). Ato janë të strukturuar sipas numrit (njëjës, shumës), vetës (veta e parë, e dytë dhe e tretë) dhe rasës (dhanore dhe kallëzore). Kështu, veta e I^{rë} dhe II^{të} njëjës dhe shumës paraqesin një formë të vetme për të dyja trajtat (11a,b) dhe përdoren vetëm për njerëz. Ndërsa, veta e III^{të} njëjës dhe shumës paraqet forma të ndryshme në gjini dhe në numër (11c,d) dhe përveç se përdoren për njerëz, përdoren edhe për frymor të tjerë:

- (10) a. [**Lui**]_{KRYEF} ha telefonato [**me**]_{KUNDRIN}, non Angela.
 b. ??*[**me**] ha telefonato *[**lui**], non Angela.
- (11) a. [**Mi**]_{KALL} hai offeso profondamente, ma [**ti**]_{KALL} scuso.
 b. [**Ti**]_{DHAN} restituisco i soldi che [**mi**]_{DHAN} avevi prestato ieri.

- c. **Le** ho detto che non potevo andare a trovar**la**.
 d. **Gli** ho mostrato il mio nuovo appartamento.

Tabela 3. Përemra të tjerë të SPI

Vendore	Vetvetore	Pjestore
<i>ci, vi</i>	<i>si (sé)</i>	<i>ne</i>

Me tabelën 3 plotësohet gjithë paradigma e sistemit përemëror italian⁶ dhe konkretisht nga format e patheksuara **ci** e **vi** në funksionin e një ndajfoljeje vendi, përdoren me vlerë përemërore, por edhe si kundrinor i drejtë dhe i zhdrejtë referuar objekteve, ndërsa përemri **ne** përdoret me vlerë pjestore, si ndajfolje vendi dhe përemri **si** me vlerën e një vetvetori:

(12) Vendore

- a. Vai
 all'università? Sì, **ci** vado.
 b. Mi piace il
mare e **vi** andrò spesso.

(13) Vetvetore

- c. Marco **si**
 mette la cravatta.
 d. Franco **si**
 alza presto la mattina.

(14) Pjestore

- e. Hai visto
 mio figlio? Perché non me **ne** parli.
 f. Quanta
pasta vuoi?- **Ne** voglio poca.

3. Problematikat lidhur me përvetësimin e përemrit vetor gjatë

⁶ D'Achille, *L'italiano contemporaneo*, 2009, f.119

mësimdhënies së gjuhës italiane si GjH

Ashtu siç u theksua dhe më lartë, sistemi përemëror italian është shumë i larmishëm dhe përdorimi korrekt i tyre përbën një nga zgjedhjet më të vështira për studentë, të cilët studjojnë gjuhën italiane për herë të parë. Me njohjen dhe përdorimin korrekt të tyre na vijnë në ndihmë rregullat gramatikore, pa të cilat dhe mësimdhënësi nuk do të mundte të organizonte një orë mësimi efikas dhe produktiv. Në vazhdim do të mundohemi të bëjmë një analizë të problematikave që shfaqen gjatë nxënies së përemrit vetor, si dhe vështirësitë që hasin studentët gjatë përdorimit të tyre.

3.1. Trajtat e shkurtra të përemrit vetor

Vështirësitë kryesore që hasin studentët shqiptar në përvetësimin e përemrit vetor lidhen përgjithësisht me përdorimin jo korrekt të formave të patheksuara, kryesisht veta e III^{të} njëjës dhe shumës: *lo, la, li, le*. Gabimet vihen re sidomos tek përshtatja e tyre me pjesoren e foljes gjatë zgjedhimit me foljen ndihmëse **avere** "kam". Në këto raste, pjesorja e foljes detyrimisht duhet të përshtatet me trajtat e shkurtra:

(15) a. Ho regalato **la borsa** a Paola.

i. **L'**ho regalat-**a** a Paola.
(**la** = borsa)

ii. ***L'**ho regalat-**o** a Paola.

b. Monica ha prenotato **le vacanze**.

i. Monica **le** ha prenotat-**e**.
(**le** = vacanze)

ii. *Monica **le** ha prenotat-**o**.

Vihet re se këto forma janë shumë të ngjashme me nyjat shquese dhe sillen njësoj përsa i përket elidimit. Është e nevojshme shmangia e elidimit të tyre para fjalëve që fillojnë me zanore, vetëm në ato raste kur apostrofimi i tyre mund të shkaktojë keqkuptime mbi gjininë mashkullore ose femërore *lo invito/la invito* në vend të *l'invito*:

(16) a. Giorgio invita **Claudia** per il suo compleanno.

Giorgio **la** invita per il suo compleanno.

*Giorgio **l'**invita per il suo compleanno.

Një tjetër problem i dukshëm është përsëritja bashkë me trajtën e shkurtër dhe trajta e plotë e përemrit, kur sipas rregullit gramatikor të italishtes kjo quhet pleonastik. Pra, në italisht shprehjet *a me mi, a te ti, a lei le* konsiderohen si forma të gabuara nga gjuhëtarët pasi trajtat e shkurtra *mi, ti, le* janë forma pleonastike. Ky përdorim paraqet vështirësi të mëdha te studentët sepse ata duke u bazuar në gjuhën shqipe, përdorin të dyja format, edhe trajtën e plotë edhe trajtën e shkurtër (psh. **Mua më** erdhi një letër nga motra; **Atij i** dhanë fletë lavdërimi.):

(17) a. Maria **mi** ha dato un libro.

b. **A me** Maria ha dato un libro.

c. ***A me** Maria **mi** ha dato un libro.

Përsa i përket përdorimit të trajtës së shkurtër në të njëjtin funksion me emrin që është i pranishëm në fjali, problematika shfaqet pikërisht tek përdorimi i të dy elementeve, si emri ashtu dhe trajta e shkurtër. Në këtë rast duhet ose të vendosim vetëm emrin (18a) ose ta zëvendësojmë atë (18b) dhe asnjëherë të dyja si tek (18c). Një tjetër interferencë e GjA bën që studentët të përdorin qoftë emrin qoftë trajtën e shkurtër brenda së njëjtës fjali (Blerta **i** dërgoi **Anës** një kartolinë për ditëlindje.):

(18) a. Il nonno ha spedito una lettera **al nipote**.

b. Il nonno **gli** ha spedito una lettera.
(**gli** = al nipote)

c. *Il nonno **gli** ha spedito una lettera **al nipote**.

Është interesante përdorimi i ngatërruar i trajtës së shkurtër me trajtën e plotë të përemrit vetor të vetës së parë dhe të dytë, i cili është shumë i përsëritur në fazën e parë të përvetësimit të përemrit vetor si në fjalinë (19b). Por, ndodh gjithashtu, që studentët të përdorin trajtën e plotë në vend të trajtës së patheksuar si në (19c):

(19) a. Chiamo **te** e tu non mi rispondi.

- b. *Chiamo **tu** e tu non mi rispondi.
- c. Ho scritto una lettera allo zio, ma lui non **me*/mi** ha risposto.

Një gabim gramatikor tipik dhe i shpeshtë është kur një përemër vetor përdoret në vend të një përemri tjetër të së njëjtës kategori. Është rasti i trajtës së shkurtër **gli** (që në njëjës i referohet **a lui**, gjinia mashkullore) referuar një emri të gjinisë femërore (20a,b). Po kështu, kemi raste të përdorimit të trajtës së patheksuar në vend të një tjetër trajte të patheksuar të gjinisë mashkullore, por që u përkasin kategorive të ndryshme (kundrinori i zhdrejtë **gli** në vend të kundrinorit të drejtë **li** dhe anasjelltas) si në (20c,d):

- (20) a. Ho incontrato Luisa e **le** ho parlato.
(**le** = a Luisa)
- b. *Ho incontrato Luisa e **gli** ho parlato.
- c. Ho visto Paolo e **li*/gli** ho detto di venire.
- d. I Rossi hanno una bambina che **gli*/li** rende felici.

Një tjetër vështirësi që studentet shqipfolës hasin gjatë procesit të përvetësimit të gjuhës italiane i përket pjesëzave përemërore **ci** dhe **ne**, të cilat nuk i gjejmë në gjuhën shqipe. Ato shpeshherë zëvendësohen nga trajtat e shkurtra të patheksuara, por që në këtë rast nuk mund të kryejnë funksionin e vërtetë të një përemri pjestor:

- (21) a. Sono veramente interessato a questo lavoro, **ci** tengo molto.
*Sono veramente interessato a questo lavoro, **lo** tengo molto.
- b. Avete discusso del problema? – Sì, **ne** abbiamo discusso.
*Avete discusso del problema? – Sì, **(lo)** l'abbiamo discusso.

3.2. Përemrat vetor të mirësjelljes

Disa nga problematika të përdorimit të përemrit vetor shfaqet edhe në rastin e përemrave vetor të mirësjelljes. Një ndër arsyt kryesore qëndron në faktin se

italishtja, në dallim nga shqipja⁷, ka një sistem më kompleks të përemrave vetor të mirësjelljes. Në gjuhën italiane, përemrat e mirësjelljes në funksion të kryefjalës janë: *ella / lei* për njëjësin dhe *loro / voi* për shumësin (Serianni 1989: 261), ndërsa në funksion të kundrinorit janë: *la, le* (për *lei*), *li, le, loro* (për *loro*) dhe *vi* (për *voi*). Këto përemra “përdoren kur i drejtohem dikujt të cilin nuk e njohim ose me të cilin nuk kemi konfidenca ose i përket një niveli shoqëror ose profesional më të lartë” (Dardano&Trifone 1995:271; Serianni 1989:261)⁸.

Pikërisht, një nga aspektet e problematikave që haset sot gjatë përdorimit të përemrave vetore është emërtimi i personit të cilit i drejtohem, pra përdorimi i përemrave të mirësjelljes **tu** ose **Lei** dhe të titujve lidhur me profesionin dhe pozitën sociale:

(22) a. Sign. Rossi, **Lei** quando è uscita stamattina?

*Sign. Rossi, **tu** quando sei uscita stamattina?

Për këtë arsye, përemrat vetor të mirësjelljes përbëjnë një nga nënsistemet më pak transparente në gjithë sistemin e eptimit italian. Kështu, trajtat e shkurtra të përemrave vetor të mirësjelljes **La, Le** të vetës së tretë njëjës janë gjithmonë të gjinisë femërore edhe në prani të një referenti të gjinisë mashkullore. Këto trajta paraqesin një tjetër problematikë në përdorimin e tyre, pasi studentët në vend të tyre mund të përdorin trajtën e gjinisë mashkullore (23a), përemrin e vetës së dytë shumës (23b) ose përemrin e vetës së dytë njëjës (23c):

(23) a. Dottore, **La** ringrazio per la sua pazienza.

*Dottore, **lo** ringrazio per la sua pazienza.

b. Signora, **La** invito volentieri a cena a casa mia.

Signora, **vi** invito volentieri a cena a casa mia.

⁷ Në gjuhën shqipe, në vend të vetës së dytë njëjës (*ti*) përdoret shpesh forma e shumës (*ju*) për të shprehur një person të vetëm, për nderim e mirësjellje. (Gramatika e Gjuhës shqipe 1995:221)

⁸ “I pronomi di cortesia si usano nel rivolgersi a qualcuno che non si conosce o con cui non si è in confidenza o che appartiene a un livello sociale o professionale più elevato”.

c. Professore, **Le** chiedo scusa del mio comportamento.

*Professore, **ti** chiedo scusa del mio comportamento.

Nga pikpamja kulturore, shumë shpesh studentet shqiptarë përdorin **Voi**, sot më pak e përdorshme se në të shkuarën, në vend të përemrin vetor të mirësjelljes **Lei**, kjo falë interferencës që gjuha shqipe ka mbi gjuhën e huaj:

(24) a. Che cosa vuole **Lei**, signore?

b. Che cosa volete **Voi**, signore?

4. Propozime didaktike për përvetësimin e përemrit vetor

Pasi shqyrtuam problematikat kryesore lidhur me përvetësimin dhe përdorimin korrekt të përemrave vetor, do të paraqesim në këtë paragraf disa sugjerime rreth praktikës didaktike të kësaj kategorie, për të parandaluar disa gabime të cilat rezultojnë se janë të pashmangshme. Kemi të bëjmë me një kategori, e cila nuk mund të përvetësohet plotësisht në pak orë dhe me një numër të kufizuar leksionesh apo ushtrimesh, por vetëm duke punuar në mënyrë sistematike, mund të arrijmë nivele të kënaqshme asimilimi të formës dhe funksioneve të tyre. Prandaj, në fazat e para të nxënies, nëse kemi si objektiv që studentët të përqëndrohen tek funksionet e përemrit, do të ishte e domosdoshme zgjedhja e një leksiku më të thjeshtë për t'u zëvendësuar, pra duke përdorur emra, gjinia apo numri i të cilëve është lehtësisht i dallueshëm. Vetëm në këtë mënyrë, pasi të kenë përvetësuar funksionin e përemrit sipas kontekstit të caktuar, mund të kalojmë tek pozicioni i trajtave të shkurtra para dhe pas foljes, tek përshtatja e pjesores së foljes me përemrin, tek përdorimi pjesëzave përemërore **ci** dhe **ne**, të vetvetorit **si** apo të përdorimi i formave të mirësjelljes.

Nga analiza e gabimeve që kryem pak më lartë, doli qartë se përdorimi i përemrit vetor dhe trajtave të shkurtra në gjuhën italiane është i ndryshëm nga ai i gjuhës shqipe, megjithatë studentët të ndikuar nga modele gramatikore të gjuhës amtare, në shumë raste, bëjnë zgjedhje të gabuara të kësaj kategorie. Personalisht, mendoj se për të arritur rezultate produktive do të ishte e dobishme për mësimdhënësin që të bëjë një përshkrim krahasues dhe dallues të çështjeve gjuhësore ose gramatikore të gjuhës amtare dhe asaj të huaj. Gjithashtu, në lidhje me aktivitetet dhe tipologjinë e ushtrimeve që zhvillohen në klasë, mendoj se duhet të zgjidhen ato ushtrime ku ende bëhen gabime derisa ato të zotërohen plotësisht.

Përfundime

Në përfundim të kësaj analize mundëm të nxjerrim në pah problematikat të përdorimit të përemrave vetor me të cilat studentët shqipfolës përballen gjatë përvetësimit të gjuhës italiane si GjH. Në përgjithësi, përemrat vetor paraqesin vështirësi të madhe të studentët shqiptar sepse ata janë të shumtë dhe të ndryshueshëm. Nga vëzhgimet e bëra gjatë procesit të mësimdhënies së kësaj kategorie vumë re disa tipologji gabimesh:

- A. përdorimi i trajtës së plotë dhe trajtës së shkurtër në të njëjtën fjali (është rasti i formave *a me mi*);
- B. përdorimi i një trajte të shkurtër në vend të një tjetre, e cila i përket së njëjtës klasë (është rasti i përdorimit të *gli* për *le*);
- C. përdorimi i trajtës së shkurtër në të njëjtin funksion me emrin që është i pranishëm në fjali, pra përdorimi i të dy elementeve si emri ashtu dhe trajta e shkurtër (është rasti i përdorimit së bashku të *gli* / *il nonno*);
- D. përdorimi i përemrit *Voi*, sot më pak e përdorshme se në të shkuarën, në vend të përemrin vetor të mirësjelljes *Lei*;
- E. përdorimi i përemrit i vetës së dytë njëjës *tu* në vend të përemrin vetor të mirësjelljes *Lei*.

Ky kontribut mbyllet me disa sugjerime didaktike të vlefshme për të lehtësuar studimin e mëtejshëm të gjuhës italiane si dhe për t'u shërbyer studentëve të kapërcejnë me shpejtësi dhe efektshmëri problematikat lidhur me përvetësimin e përemrit vetor.

Bibliografia

Cardinaletti A., (1999) *The Typology of Structural Deficiency: A Case of Study of the Three Classes of Pronouns* in van Riemsdijk H. (1999) *Clitics in the languages of Europe*, Berlin, Germany, f. 145-233.

Cardinaletti A., (1999) *Pronouns in Germanic and Romance languages: An overview*, in van Riemsdijk H. (1999) *Clitics in the languages of Europe*, Berlin, Germany, f. 33-82.

Dardano M., Trifone P.(1995) *Grammatica italiana con nozioni di linguistica*. Bologna.

D'Achille P., (2009) *L'italiano contemporaneo*. Bologna, f. 116-123.

Gelderen van E., (2009) *Cyclical Change*. John Benjamins Publishing Company. Amsterdam / Philadelphia.

Gerlach B., (2002) *Clitics between syntax and lexicon*. John Benjamins Publishing Company. Amsterdam / Philadelphia.

Gramatika e Gjuhës shqipe (1995) Vëllimi I, Tiranë, Morfologjia, 115-227.

Patota G., (1997) *Grammatica di riferimento della lingua italiana per stranieri*. Milano, Le Monnier, Società Dante Alighieri.

Renzi L., Salvi G. e Cardinaletti A. (a c. di), (2001) *Grande grammatica italiana di consultazione*, Bologna, Il Mulino.

Russi C., (2008) *Italian clitics. An Empirical Study*, Berlin-New York: Mouton de Gruyter.

Scalise S., (1990) *Morfologia e lessico: una proposta generativista*. Il Mulino, Bologna.

Serianni L., (1989) *Grammatica italiana Italiano comune e lingua letteraria*, Bologna, UTET Libreria, Torino.

Sensini M.,(1997) *La grammatica della lingua italiana*, OscarGuide,Mondadori, Milano.

Sula A., (2009) *Gabime të nxënësve dhe studentëve shqiptar në përvetësimin e gjuhës italiane*, Botime Maluka, Tiranë.

STUDIM KRAHASUES MBI GJENERATAT CELULARE 1G-5G, AVANTAZHET E RRJETIT 5G

Msc.Ing.Eriselda MALAJ

Departamenti i Shkencave Kompjuterike, Fakulteti i Shkencave Teknike,
Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë
eriselda.malaj@hotmail.com

Abstrakti

Studimi i punimit do të bazohet në krahasimin e gjeneratave ekzistuese për të vënë në dukje avantazhet dhe performancën e gjeneratës 5G. Në përgjithësi gjeneratat ndryshojnë nga njëra tjetra në katër aspekte kryesore: radio access, shkalla e të dhënave, gjerësia e brezit dhe skemat switching. Qëllimi i këtij punimi është qartësimi i kuptimit teknologjike i gjeneratës "5G", duke diskutuar implikimet e mundshme për operatorët në drejtim të infrastrukturës së rrjetit dhe mundësive komerciale. Qëllimi i rrjetit 5G është të ndërtojë një sistem telekomunikacioni më të sofistikuar se ato që janë arritur deri tani, 5G do të sigurojë akses pa limit në internet, shpejtësi më të lartë, aftësi për të ndarë të dhënat kudo, në çdo kohë, përfitimet e njerëzve, bizneseve dhe rrjeteve sociale. Ky punim kërkimorë do të jetë i dobishëm për hartimin e strategjive të reja në zhvillimin e komunikimeve celulare në gjeneratat e ardhshme.

ABSTRACT

Study of the paper will be based on a comparison with various existing generations of mobile wireless technology in terms of their portals, performance, advantages and disadvantages. These technologies (mainly cellular generations) differ from each other based on four main aspects: radio access, data rates, bandwidth and switching schemes. The purpose of this paper is to clarify the meaning of generation technology "5G", discussing possible implications for operators in terms of network infrastructure and commercial opportunities. 5G network goal is to build a telecommunications system more sophisticated than what has been achieved, 5G will provide unlimited internet access, high speed, the ability to share data anywhere, any time, the benefits people, businesses and social networks. This research paper will be useful for designing new strategies in the development of mobile communications in future generations.

Fjalëkyçe: 1G, 2G, 3G, 4G, 5G, radio access, skemat switching.

I. HYRJE

Ne jemi duke jetuar në shkencën moderne, nuk mund të mendojmë për një moment të vetëm pa shkencë. Shkenca e bën jetën tonë të lehtë dhe të rehatshme. Bota moderne është duke u ngjeshur për shkak të zhvillimit të

shkencës dhe teknologjive të saj. Gjatë dekadave të fundit bota ka parë ndryshime të mëdha në industrinë e telekomunikacionit për shkak të shkencës dhe teknologjisë. Në gjeneratën e parë (1G) telefonat celular kishin vetëm strukturën e zërit. Kjo gjeneratë u zëvendësua nga gjenerata e dytë (2G) ku telefonat analog u zëvendësuan nga telefonat dixhital me shtimin, e faksit, të të dhënave dhe shërbimeve të mesazheve. Teknologjia e gjeneratës së tretë (3G) ka shtuar struktura multimediale të telefonave 2G. Në 4G (gjenerata e katërt) sistemet celulare, normat e të dhënave filluanë në 100 Mbps dhe mendohej për të arritur renditjen e më shumë se 1 Gbps në downlink [1]. Aktualisht 5G nuk është një term i përdorur zyrtarisht për ndonjë specifikim të veçantë ose në ndonjë dokument zyrtar të bëra publike nga kompanitë e telekomunikacionit apo organeve të standardizimit të tilla si 3GPP, WiMAX Forum, ose të ITU-R [2]. Pjesa tjetër e punimit është organizuar si më poshtë: Seksioni 2 përshkruainë evolucionin e sistemeve wireless dhe celulare fokusuar në katër factor kryesor:

II. KRAHASIMI I TEKNOLOGJIVE

Gjenerata	1G	2G	2.5G	3G	4G	5G
Fillimi i dizanjit	1970	1980	1985	1990	2000	2012-13
Zbatimi	1984	1991	1999	2002	2010-deri tani	Pritet në 2020
Shërbimi	Sistemi i zërit analog, 9.6Kbps	Sistemi i zërit dixhital, mesazhe të shkurtra.	Kapacitet më të lartë të të dhënave.	Kapacitet më të lartë, cilësi më të lartë: audio, video dhe data, të dhënat deri 2Mbps	Kapacitet më të lartë, të dhënat deri në disa qindra Mbps	Imazhe 3D, Inteligjenc artificiale, aftësi rezolucioni të lartë, dhe teknologji holographik.
Standard	AMPS.TA CS, NTM , Etc.	TDMA, CDMA, GSM, PDC	GPRS, EDGE, 1xRTT	WCDMA, CDMA2000	Single Standard	Single Standard
Teknologjia	Sistemi Analog	Sistemi Dixhital	GPRS, EDGE, 1xRTT	CDMA 2000 (1xRTT, EVDO) UMTS, EDGE	WiMax LTE Wi-Fi	WWW
Gjerësia e brezit	2 Kbps	64 Kbps	384Kbps	2Mbps	1 Gbps	10 Gbps-100 Mbps
Multipleksimi	FDMA	TDMA CDMA	TDMA CDMA	CDMA	OFDMA	MIMO
Rrjeti kryesorë	PSTN	PSTN	PSTN Packet network	Packet network	internet	Fixed (fibe networks

Tabela 1 tregon krahasimin e pesë gjeneratave (1G, 2G, 3G, 4G, 5G) në drejtim të shërbimeve të ofruara aktualisht dhe në ato çfarë do të ofrojnë në vitet në vijim. Krahasimi është realizuar në bazë të teknologjive, gjerësisë së brezit, multipleksimit, avantazhet dhe disavantazhet ndërmjet pesë gjeneratave. Gjenerata 5G është një teknologji e re që do të sigurojë të gjitha aplikimet e mundshme, duke përdorur një paisje të vetme universal, duke ndërlidhur shumicën e infrastrukturave ekzistuese të komunikimit [3].

2.2 Krahasimi i gjeneratës 5G në krahasim me gjeneratat ekzistuese

➤ Krahasimi ndërmjet gjeneratës 1G&5G.

Ky krahasim tregon se gjenerata 1G është shumë më e vjetër se gjenerata 5G. 5G siguron një zonë shumë më të gjerë të rrjetit të mbulimit, ofron mjetet më të sigurta dhe më të shpejta të komunikimit. Cilësia e lëvizshmërisë është një mijë herë më e mirë se teknologjia e vjetër 1G. Gjenerata 1G ofron vetëm komunikimin me zë, nga ana tjetër gjenerata 5G siguron komunikim më të shpejtë të internetit.

➤ Krahasimi ndërmjet gjeneratës 2G&5G.

Si pasardhëse e gjeneratës 1G, gjenerata 2G ishte shumë më e mirë se 1G, por nuk mund të konkuroj me gjeneratën 5G. Gjenerata 2G ofron transferimin e të dhënave, por shpejtësia e internetit në gjeneratën 2G ishte shumë më e ngadaltë në krahasim me 5G. 2G nuk ka lejuar norma të larta të transferimit të të dhënave për streaming multimedia, ndërsa 5G ofron streaming video HD.

➤ Krahasimi ndërmjet gjeneratës 3G&5G.

Gjenerata 3G është pasardhësi i gjeneratës 2G. 3G lejon video-calling dhe disa karakteristika të tjera që nuk janë të pranishëm në 2G, gjithashtu shpejtësia e transferimit të të dhënave është më e lartë se 2G, por në krahasim me 5G ajo është shumë e ulët, 5G ofron shpejtësi të internetit deri në Gbps.

➤ Krahasimi ndërmjet gjeneratës 4G&5G.

4G është gjenerata e katërt e komunikimeve celulare, por 5G është një revolucion për 4G. Gjenerata 5G ofron një botë reale pa tel ose të quajtur worldwide wireless web. Kjo i lejon transferim të të dhënave deri në Gbps dhe shpejtësia e upload është shumë më e lartë se 4G. 5G është një teknologji e pa imagjinueshme.

III. GEJENERATA 5G

3.1 Pse është i nevojshëm rrjeti 5G?

Ky punim kryesisht fokusohet në mënyrën se si një rrjet 5G mund të siguroj më shumë objektiva njerëzimit, për të shfrytëzuar pasurinë e tij duke e bërë atë të ndihet më mirë. Ndryshimet më të mëdha ndërmjet gjeneratave aktuale dhe 5G përfshijnë [4]:

- 5G mund të sjell të ardhura më të mira për operatorët global, si dhe ndërveprimi do të bëhet më i mundshëm.
- Për të bërë praktike gjeneratën 5G për të gjitha llojet e teknologjive duhet të ketë një platform unike të përbashkët për të gjitha teknologjitë.
- Konsumi më i ulët i baterisë.
- Probabiliteti i ndërprerjeve më i ulët.
- Mbulim më të mirë në dispozicion dhe norma e të dhënave më të larta.
- Norma më të larta të të dhënave në lëvizshmëri deri në 1Gbps.
- Efikasitet më të lartë të nivelit spektral.
- World Wide Wireless Web (WWWW), aplikacione web me bazë wireless që përfshijnë aftësi multimediale të plotë përtej shpejtësisë 4G.
- Më shumë aplikacione të kombinuara me Artificial Intelligent (AI), si jeta e njeriut do të jetë i rrethuar nga sensorë artificial të cilat do të mund të komunikojnë me telefonat celulare.
- Jo të dëmshme për shëndetin e njeriut.
- Tarifat më të lira të trafikut për shkak të kostove të ulëta të zhvillimit të infrastrukturës.
- Sistemi i antenave smart.

5G është një teknologji e re që do të sigurojë të gjitha aplikimet e mundshme, duke përdorur vetëm një pajisje universal, duke ndërlidhur infrastrukturat ekzistuese të komunikimit. Rrjetet celulare 5G do të fokusohet në zhvillimin e terminaleve të përdoruesit ku терминаlet do të kenë akses në teknologjitë e ndryshme wireless në të njëjtën kohë.

3.2 Avantazhet e teknologjisë MasterCore në rrjetin 5G.

Teknologjia MasterCore është projektuar për shërbimin pakufi wireless; në mënyrë që kompjuteri, pajisjet argëtuese dhe telefonat celulare të gjithë mund të ndajnë të njëjtin rrjet wireless dhe mund të jenë të lidhur me internet në çdo kohë, kudo. Është projektuar për sistemin e komunikimit 5G për të përmbushur objektivin e pafund deri në dy shekujt e ardhshëm, karakteristikat e teknologjisë MasterCore janë si në vijm:

- Mund të shkarkohen file (edhe filma) brenda sekondave.
- Faqet do të ngrakohen (upload) pothuajse menjëherë.
- Mund të luajnë lojëra lehtësisht online.
- Pajisjet e gjeneratës 5G janë relativisht më pak të shtrenjtë se pajisjet e gjeneratës 3G dhe 4G.
- Finest Quality of Service (QoS).
- Të gjithë rrjetet mund të grumbullohen në një platform.
- Mbështet lehtësisht gjeneratat e mëparshme.

- Vendosjet e reja të 5G mund të jenë të lidhura direct me Mastercore nga 5G-IU(5G Interfacing Unit) pa konceptin All IP.
- Nuk ka kufizime në kërkesat e përdoruesit.
- Aftësia për të mbështetur shërbimet e reja.
- Janë në gjendje për të plotësuar kërkesën e përdoruesit deri në shekullin e ardhshëm.
- Abonenti mund ti ruaj të dhënat në njësin qëndrore.
- Kompjuterët e largët mund të kontrollohen nga pajisjet e dorës.
- Abonenti mund të përdorë aplikacionet e software pa instalim në pajisjet e veta së ofruar nga MasterCore.
- Sigurimi është shpërndarë në disa shtresa.
- MasterCore mund të menaxhojë sigurinë e PSTN, MSC, BTS etj.
- Shërbimet me cilësi të lartë të teknologjisë 5G bazohen në politikën për të shmangur gabimet.

3.2.1 Cilësia e shërbimit (Quality of service QoS)

Rrjeti i gjeneratës së ardhshme (Next Generation Networks NGN) përbëhet prej funksioneve për mbështetjen e transportit të të dhënave dhe kontrollin e transportit të tyre, si dhe funksionin për mbështetjen e shërbimeve dhe aplikacioneve. Matja e trafikut është një aktivitet themelor i kontrollit në mënyrë që të sigurojë cilësinë e shërbimit. Përveç sistemit të komunikimit, 5G është projektuar dhe finest Quality of Service (QoS). Cilësia e shërbimit (QoS) i referohet aftësisë së një rrjeti për të arritur gjerësinë e brezit maksimale dhe të merret me elementet e tjerë të performancës së rrjetit si jitter, latency, shkalla e gabimit dhe uptime. Gjithashtu cilësia e shërbimit përfshin kontrollin dhe menaxhimin e burimeve të rrjetit duke përcaktuar prioritetet për lloje të veçanta të të dhënave (video, audio, foto) në rrjet. Qëllimi kryesor i cilësisë së shërbimit është që të sigurojë përparësi rrjeteve, duke përfshirë gjerësi brezi të dedikuar, jitter të kontrolluar, latency të ulët dhe karakteristikat e humbjeve të përmirësuar. Ka tri komponente kryesore për zbatimin e QoS:

- Identifikimi i teknikave për koordinimin e QoS nga end-to-end ndërmjet elementeve të rrjetit.
- QoS brenda një elementi të vetëm të rrjetit.
- Politikat QoS, menaxhimin, funksionet e kontrollit dhe adminstrimit të trafikut end-to-end nëpër një rrjet.

3.3 Aplikacione të jashtëzakonshme.

MasterCore 5G ka disa aplikacione të jashtëzakonshme me karakteristika të përbashkëta si:

- Mund të informoheni mbi motin, temperaturën, vendodhjen etj.. e njëri-tjetrit në momentin kur po ndodh biseda.
- Studentët mund të marrin pjesë në çdo klasë të çdo institute të botës pa shkuar atje.
- Një mjek mund të trajtoj pacientët nga vende të ndryshme.
- Bën të mundur monitorimin çdo vend të botës nga kudo.

- Bateritë mund të karikohen duke përdorur rrjetin pa nevojën e karikimit.
- Bën të mundur përfundimin e punëve të tij/saj pa shkuar në zyrë.
- Mund të jenë në gjendje për të gjetur fëmijën e tij/saj kur është i humbur për fat të keq.
- Mund të jenë në gjendje të parashikojnë cunami/tërmet përpara se ai të paraqitet.

3.4 Çfarë ofron teknologjia 5G?

Gjenerata 5G do të jetë një revolucion i ri në tregun celular. Nëpërmjet gjeneratës 5G ju mund të përdorni telefonat celulare në të gjithë botën. Teknologjia 5G ka kapacitet të lartë të të dhënave dhe ka aftësi për të lidhur së bashku një numër të pakufizuar të thirrjeve. Gjenerata 5G ka një të ardhme të ndritur për shkak se ajo mund të trajtojë teknologjitë më të mira dhe të ofrojë një cilësi të lartë në telefonat celulare për klientët e tyre [5].




Figura 1. Arkitektura e rrjetit heterogjene.

Ruterat dhe switchet e përdorur në rrjetin 5G siguron një lidhje më të mirë. Teknologjia 5G shpërndan internet në nyjet brenda ndërtesës dhe mund të vendoset në bashkimin e Wired ose lidhjet e rrjetit wireless. Figura 1 më poshtë tregon një shembull të një HetNet në një rrjeti LTE- avancuar.

3.5 Konceptet për rrjetet celulare 5G

Terminalet e 5G që do të duhen për skemat e modulimit si dhe skemat e reja për kontrollin e gabimit të cilat do të shkarkohen nga internet. Si një fokus të rrjeteve celulare 5G është parë drejt zhvillimit të terminaleve të përdoruesit [6]. Terminalët në të njëjtën kohë do të kenë akses në teknologjitë e ndryshme wireless dhe terminalët duhet të jenë në gjendje për të kombinuar flukse të ndryshme nga teknologji të ndryshme. Handoveret vertikale duhet të shmanget sepse ata nuk janë të realizueshme në rast kur ka shumë teknologji, shumë operatorë dhe ofruesit e shërbimeve. Në 5G, çdo rrjet do të jetë në përgjegjësi për trajtimin e përdoruesit, ndërsa terminali do të bëjë zgjedhjen përfundimtare për një shërbim të caktuar ndërmjet ofruesit të ndryshme të rrjeti wireless/mobile.

1. SHTRESA FIZIKE

Shtresa fizike dhe shtresa e mesme e kontrollit si: shtresa1 dhe shtresa 2 e modelit OSI, përcaktojnë teknologjinë wireless. Për këto dy shtresa, rrjetet celulare 5G mendohen të jenë të bazuar në arkitekturën e hapur Wireless.

2. SHTRESA E RRJETIT

Shtresa e rrjetit do të jetë IP (Internet Protocol) sepse sot nuk ka konkurrencë në këtë nivel. IPv4 (version 4) është përhapur në mbarë botën dhe ajo ka disa problem të tilla si hapësirë të kufizuar të adresave dhe nuk ka asnjë mundësi reale për mbështetjen e cilësisë së shërbimit për rrjedhjen e informacionit. Këto çështje janë zgjidhur me IPv6. Lëvizshmëria ende mbetet një problem. Në 5G të gjitha rrjetet mobile do të përdorin Mobile IP dhe çdo terminal mobile do të jetë FA (Foreign Agent), duke hartuar CoA (Care of Address) ndërmjet adresës së saj fikse IPv6 dhe adresës CoA për rrjetin aktual wireless. Në rast se, një celular në të njëjtën kohë mund të jetë bashkëngjitur në disa rrjete celulare ose wireless, ajo do të mbajë adresën e ndryshme IP për secilin nga ndërfaqet radio, ndërsa secili prej këtyre adresave IP do të jetë adresë CoA për të vendosur FA në telefonin celular. IPv6 fikse do të implementohet në telefonin celular nga prodhuesi i telefonave 5G. Për këtë qëllim duhet të ketë ndarje të shtresës së rrjetit në dy nënshtresa në telefonat celulare 5G d.m.th shtresa e ulët e rrjetit (për çdo ndërfaqe) dhe shtresa e sipërme e rrjetit (për terminalin e lëvizshme). Ndërmjet shtresës së sipërme dhe shtresës së ulët do të mbajë një përkthim të adresave nga adresë e rrjetit të sipërme (IPv6) të adresës më të ulët IP të rrjeteve të ndryshme (IPv4 ose IPv6) dhe anasjelltas.

3. SHTRESA Open Transport Protocol (OTA)

Rrjetet celulare dhe wireless ndryshojnë nga rrjetet Wired në shtresën e transportit. Në të gjitha versionet TCP, supozimi është se segmentet e humbura janë për shkak të mbingarkesës së rrjetit, ndërsa në rrjetet wireless humbjet mund të ndodhë për shkak të shkallës më të lartë të gabimit të biteve në ndërfaqen radio. Prandaj modifikimi dhe përshtatja e TCP për rrjetet mobile dhe wireless, të cilat rriten segmentet TCP të humbura apo të dëmtuara vetëm gjatë lidhjes wireless. Për terminalin celular 5G do të jetë i përshtatshëm që të ketë shtresë të transportit e cila mundëson shkarkimin (download) dhe instalimin. Këta celularë do të kenë mundësinë për të shkarkuar (p.sh., TCP, RTP etj apo protokoll të ri transporti) versioni i cili është përcaktuar në një teknologji të veçantë wireless, instaluar në stacionet bazë. Ky është quajtur Open Transport Protocol - OTP.

4. SHTRESA E APLIKACIONEVE

Kërkesa e fundit nga terminali mobile 5G është të sigurojë menaxhimin e QoS mbi shumëllojshmërinë e rrjeteve. Sot në telefonat mobile përdoruesit zgjedhin manualisht ndërfaqen wireless për shërbim të caktuar të internetit pa pasur mundësinë për të zgjedhur lidhjen më të mirë wireless për një shërbim të caktuar. Telefonat mobile 5G do të ofrojnë mundësi për testimin e cilësisë së shërbimit dhe ruajtjen e matjes së informacionit në data base e informacionit në terminalin mobile. Parametrat QoS, të tilla si vonesa, humbjet, gjerësia e brezit, besueshmërinë do të ruhet në një bazë të dhënash në telefonin celular 5G me qëllim për t'u përdorur nga algoritmet inteligjente që konkurrojnë në terminalin e lëvizshme si proceset e sistemit, i cili në fund do të sigurojë lidhjen më të mirë wireless mbi kufizimet e kërkuara QoS dhe kostos personale.

IV. KONKLuzionet dhe Punimet e Ardhshme

Në këtë punim ne kemi propozuar konceptin e teknologjisë 5G, i cili është kontributi kryesor i punimit. Teknologjia 5G është projektuar si një platformë e hapur në shtresa të ndryshme, nga shtresa fizike deri në shtresën e aplikimit. Aktualisht puna e vazhdueshme është në modulet që do të ofrojnë QoS më të mirë dhe kosto më të ulët për një shërbim të caktuar duke përdorur një ose më shumë se një teknologji wireless në të njëjtën kohë nga telefonat celularë 5G. Në botën e telekomunikacioneve teknologjia 5G ka sjell shumë përmirësime nga 1G, 2G, 3G dhe 4G. Teknologjia e re 5G sjell në treg norma të përballueshme dhe shumë besueshmëri sesa teknologjitë e saj të mëparshme. Teknologjia e rrjetit 5G do të hapë një mjedis të ri në teknologjinë e komunikimit celular. Telefonat mobile 5G do të kenë akses në teknologjitë e ndryshme wireless në të njëjtën kohë dhe терминаlet duhet të jetë në gjendje për të kombinuar flukse të ndryshme nga teknologji të ndryshme. Teknologjia 5G ofrojnë zgjidhje të lartë për përdoruesit celular. Ne mund të shikojmë kanale televizive në HD në telefonat tanë mobile pa asnjë ndërprerje. Telefonat celularë 5G do të jetë një tablet PC. Fushat e studimit në të ardhmen duhet të jetë mbi përballimin e rritjes drastike të trafikut të të dhënave, ka një nevojë për të integruar teknologjitë ekzistuese të rrjetit në mënyrë që gjerësia e brezit të shfrytëzohet në mënyrë më efikase.

REFERENCAT

- [1] Dr. Anwar M. Mousa, –Prospective of Fifth Generation Mobile Communications|| *International Journal of Next-Generation Networks (IJNGN) Vol.4, No.3, September 2012*
- [2] Sapana Singh & Pratap Singh, –Key Concepts and Network Architecture for 5G Mobile Technology|| *International Journal of Scientific Research Engineering & Technology (IJSRET) Volume 1 Issue 5 pp 165-170 August 2012*
- [3] T. Janevski, –Traffic Analysis and Design of Wireless IP Network Artech House Inc., Boston, USA, 2003.
- [4] Sapana Singh & Pratap Singh, –Key Concepts and Network Architecture for 5G Mobile Technology|| *International Journal of Scientific Research Engineering & Technology (IJSRET) Volume 1 Issue 5 pp 165-170 August 2012*
- [5] Willie W. Lu, An Open Baseband Processing Architecture for Future Mobile Terminals Design, IEEE Wireless Communications, April 2008.
- [6] Asvin Gohil, Hardik Modi, Shobhit K Patel, "5G Technology of Mobile Communication: A Survey", International Conference on Intelligent Systems and Signal Processing (ISSP), 2013.

PËRGJEGJËSIA PENALE E PERSONAVE JURIDIKË NË SHQIPËRI

MsC. Erti MEÇAJ

Universiteti "Ismail Qemali" Vlore
Fakulteti i Shkencave Humane
Departamenti i Drejtësisë
ertilmecaj@gmail.com

Abstrakti

Ky punim ka si qëllim të analizojë evolucionin në kohë të konceptit të përgjegjësisë penale të personave juridikë në legjislacionin shqiptar. Në Shqipëri, përgjegjësia penale e personit juridik u parashikua për herë të parë pas viteve 90. Kjo ka ndodhur për arsye se, doktrina mbi të cilën funksiononte shteti shqiptar i asaj kohe, parashikonte vetëm persona juridikë shtetërorë, kurse personat juridikë privatë nuk ekzistonin. Sot mund të themi se legjislacioni penal shqiptar garanton marrjen në përgjegjësi penale të personave juridikë. Në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, në nenin 45 të tij u parashikua për herë të parë përgjegjësia penale e personave juridikë. Kjo dispozitë nuk ishte e mjaftueshme për të marrë në përgjegjësi penale personin juridik në mënyrë efektive, sepse në të parashikohej vetëm parimi i marrjes në përgjegjësi penale të personit juridik, duke mos parashikuar procedurat e ushtrimit të ndjekjes penale dhe masat e dënimit ndaj tij. Vetëm pas miratimit të ligjit nr. 9754 "Për përgjegjësinë penale të personave juridikë", u hap rruga drejtë marrjes në mënyrë efektive të personit juridik në përgjegjësi penale. Pavarësisht se legjislacioni penal shqiptar ka rregulluar përgjegjësinë penale të personave juridikë, mund të themi se ai ka nevojë për përmirësime të mëtejshme.

Fjalët kyçe: Përgjegjësi Penale, Kodi Penal, Person Juridik.

Abstract

The purpose of this paper is to analyze the evolution in time of criminal liability of legal persons concept according to Albanian legislation. Criminal liability of a legal person in Albania was sanctioned for the first time after the 90s. That was consequence of the fact that the doctrine on which Albanian state functioned at that time, had predicted the existence of state legal persons, excluding private

legal persons. Currently we can ascertain that Albanian criminal legislation guarantees obtaining legal entities on criminal liability. Criminal Code of the Republic of Albania sanctioned criminal liability of legal persons in its 45th article. This provision was insufficient to establish criminal liability of legal entities effectively, because it was sanctioned just the principle of punishment against legal entity, not foreseeing procedures for exercising the prosecution and punishment measures against him. After being approved Law no. 9754 "On the criminal liability of legal persons" it was opened a way to effectively making legal person in criminal liability. Despite Albanian criminal legislation has regulated the criminal liability of legal persons, should be stressed that it needs further improvements.

Keywords: Criminal Liability, Criminal Code, Legal Person.

1. Hyrje

Në një shoqëri gjithmonë e më industrializuar personat juridikë kanë një pozicion qëndor pasi përbëjnë motorin kryesor jo vetëm në kuadrin e zhvillimit ekonomik, por edhe në atë social dhe kulturor dhe kjo për faktin se korporatat, firmat, ndërmarrjet, shoqëritë tregëtare janë sot protagonistët kryesorë në zhvillimin ekonomiko-financiar të një shteti. Si subjekte ligjore ato janë burim të drejtash por dhe detyrimesh, çka bën të nevojshme përgjegjësimin e tyre në të gjitha aspektet si civile, fiskale, administrative ashtu dhe në ato penale¹.

Në të drejtën romake ekzistonte parimi: "societas delinquere non potest" ². Duhet thënë se koncepti përgjegjësia penale e personit juridik u pranua vonë në legjislacionet penale të shteteve të ndryshme, duke përfshirë dhe Shqipërinë. Në legjislacionin penal zakonor dhe më vonë gjatë periudhës së sistemit komunist, koncepti i përgjegjësia penale të personit juridik nuk parashikohej. Sipas normave penale që përmban Kanuni i Lekë Dukagjinit parashikohej se, *kishin përgjegjësi penale personat fizik, të përgjegjshëm, që kishin arritur një moshë të caktuar, por nuk përcaktohet me saktësi se prej cilës moshë personi mund të merrej në përgjegjësi penale*. Zakonisht, kjo moshë ishte në 14-15 vjeç dhe ishte kushtëzuar me aftësinë e personit për të mbajtur armë ³.

Legjislacioni penal dhe doktrina e të drejtës penale gjatë sistemit komunist parashikonte si subjekt aktiv të veprave penale, vetëm personin fizik. Teoria e

¹ Bozheku E., dhe Elezi I., (2012), *Përgjegjësia penale e personave juridikë*, Tiranë, Toena, fq 31.

² Përkthim i saktë i këtij termi do të ishte: *Personat juridikë nuk mund të jenë subjekte të veprave penale*.

³ Elezi I., (1983), *E drejta Zakonore Penale e Shqiptarëve*, Tiranë, 8 Nëntori, fq 107.

të drejtës penale dhe legjislacioni penal i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë nisen nga parimi se një ndër elementët e domosdoshëm të figurës së veprës penale është edhe subjekt i saj. *Me subjekt të figurës së veprës penale kuptohet personi fizik (njeriu), i cili ka mbushur moshën e caktuar në ligj për përgjegjësi penale dhe është i përgjegjshëm* ⁴. Pra subjekt të veprës penale janë personat fizik (njeriu) që plotësojnë dy kriteret :

1. Ka mbushur moshën për përgjegjësi penale e përcaktuar në legjislacionin e brendshëm penal (mosha për përgjegjësi penale sipas Kodit Penal të vitit 1948 dhe të 1952 është 14 vjeç);
2. Të jetë i përgjegjshëm (aftësia psikike e personit për të kuptuar sjelljen e kryer).

Me rënien e sistemit komunist dhe me vendosjen e një sistemi qeverisës demokratik, në Shqipëri ndodhën ndryshime të rëndësishme në jetën politike, ekonomike dhe sociale, të cilat duhet të rregulloheshin nga një legjislacion i përshtatshëm. Legjislacioni penal në kuadrin e përmirimit të tij, parashikoi për herë të parë përgjegjësinë penale të personave juridikë⁵. Por nuk zgjati shumë sepse në vitin 2001 ky parashikim në Kodin Penal u shfuqizua, kjo ndoshta ndodhi për faktin, sepse teoria e përgjegjësisë penale të personave juridikë ishte inovatore për legjislacionin penal të Republikës së Shqipërisë, duke parë qëndrimin e mëparshëm. Si dhe ishte i nevojshëm miratimi i një ligji të veçantë, i cili do të rregullonte marrjen në përgjegjësi penale të personit juridik. Pavarësisht shfuqizimit të dispozitës së Kodit Penal, debati brenda ekspertëve të drejtës penale vazhdonte, sepse saksionimi i përgjegjësisë penale të personit juridik në Kodin Penal ishte domosdoshmëri. Qëndrimi se vetëm personat fizik mund të jetë subjekt i kryerjes së veprave penale ishte i prapambetur dhe largonte legjislacionin penal nga përafrimi me legjislacionin e vendeve

⁴ Çela A., dhe Peza N., dhe Elezi I., dhe Gjika, G., (1982), *E Drejta Penale e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë*, Tiranë, 8 Nëntori, fq 131.

⁵Neni 45 i Kodit Penal (1995), i shfuqizuar me ligjin nr. 8733 të datës 24.01.2001 parashikonte: *Gjykata, kur gjatë shqyrtimit gjyqësor provon se një person juridik ushtron veprimtari që përbëjnë vepra penale, mund të urdhërojë, mbylljen tërësisht apo pjesërisht të veprimtarisë dhe konfiskimin e të ardhurave, mjeteve dhe të çdo pasurie të siguruar nga kjo veprimtari.*

perëndimore. Në këtë kuadër, në Kodin Penal⁶ u saksionua përsëri përgjegjësia penale e personit juridik në vitin 2004

Pavarësisht se në nenin 45 të Kodin Penal u parashikua përgjegjësia penale e personit juridik, kjo nuk ishte e mjaftueshme për të proceduar penalisht një person juridik. Ishte i nevojshëm miratimi i një ligji të veçantë, i cili do të rregullonte procedimin, llojet dhe masat e denimit penal për personat juridikë. Për këtë arsye u miratua ligji nr. 9754 i datës 14.06.2007 “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë”, i cili parashikon bazat e marrjes në përgjegjësi penale të personave juridikë, dispozitat procedurale të shqyrtimit të çështjeve në ngarkim të tyre si dhe sanksionet penale që mund të aplikohen ndaj tij. Ky ligj i hapi rrugën procedimit efektiv të personave juridikë për veprat penale të kryera prej tyre.

2. Legjislacioni penal shqiptar dhe përgjegjësia penale e personave juridikë

Përpara se të analizojmë përgjegjësinë penale të personave juridikë duhet së pari të japim një përkufizim, se çfarë kuptojmë me person juridik. Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë nuk jep një përkufizim, se çdo të kuptojmë me person juridik. Në të parashikohet mënyra e ndarjes së personave juridikë⁷. Dhënia e

⁶Neni 45 i Kodit Penal, i shtuar me ligjin nr. 9275 i datës 16.09.2004: *Personat juridikë, me përjashtim të institucioneve shtetërore, përgjigjen penalisht për veprat penale, të kryera në emër ose në dobi të tyre nga organet dhe përfaqësuesit e tyre. Njësitë e qeverisjes vendore përgjigjen penalisht vetëm për veprimet e kryera gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, të cilat mund të ushtrohen nëpërmjet delegimit të shërbimeve publike.*

Përgjegjësia penale e personave juridikë nuk përjashton atë të personave fizike, të cilët kanë kryer ose janë bashkëpunëtore në kryerjen e të njëjtave veprave penale. Veprat penale dhe masat ndëshkuese përkatëse, që zbatohen ndaj personave juridikë që kryejnë vepra penale, si dhe procedura për vendosjen dhe ekzekutimin e tyre rregullohen me ligj të veçantë.

⁷ Neni 24 i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë i ndanë personat juridikë në dy grupe: *Personat juridikë janë publikë dhe privatë.*

Neni 25 i Kodit Civil: *Personat juridikë publikë janë institucionet e ndërrmarjet shtetërore, që financohen vetë ose nga buxheti i shtetit, si dhe entet e tjera publike të njohura nga ligji si person juridik...*

përkufizimit mbi personin juridik ka ngelur në diskrecion të doktrinës...Sipas *Galganos* personat juridikë nuk janë gjë tjetër veçse një specie e veçantë e të njëjtit lloj, ku lloji është personi, ndërsa specia është personi fizik dhe personi juridik. Këta të fundit sipas tij, janë një qendër referimi i marrëdhënieve juridike që e drejta i korrespondon në vend të një qenie humane, një organizim kolektiv njerëzish. Ndërsa sipas *Kelzenit* personat juridikë janë një personifikim i përmbajtjes së normave juridike, duke mos pasur një ekzistencë të veçantë nga të drejtat dhe detyrimet e tyre. Kelzen thekson faktin se ndërmjet personave juridikë nga njëra anë dhe të drejtat dhe detyrimet nga ana tjetër ekziston e njëjta lidhje që gjendet midis substancës dhe cilësisë, ku në këtë rast personat juridikë është substancë juridike, ndërsa të drejtat dhe detyrimet e tij janë cilësia juridike⁸.

Gjithësesi, personat juridikë mund të kuptohet si organizma kolektive që e drejta i ka njohur si subjekte të veçanta të saj, duke ju dhënë zotësinë për të pasur të drejta dhe detyrime juridike, zotësi kjo e veçantë nga zotësia juridike e personave fizik që e përbëjnë atë. Personi juridik përveç zotësisë juridike gëzon dhe zotësi për të vepruar, pra zotësi që me anë të veprimeve juridike të lejuara nga akti themelimit, ligji apo statute, të fitojë të drejta dhe të marrë përsipër detyrime juridike. Këto veprime personi juridik i kryen në emër dhe për llogari të tij dhe përgjigjet personalisht me pasurinë që ka në zotërim⁹.

Por çfarë kuptojmë me përgjegjësi penale? Përsëri do ti referohemi doktrinës për të dhënë një përgjigje. Përgjegjësia penale nuk është gjë tjetër veç detyrimi i autorit të veprës penale, që tu nënshtrohet kërkesave ligjore dhe dënimit të caktuar ndaj tij për veprën penale të kryer. Ajo lidhet me përgjegjshmërinë e personit, me aftësinë e personit për të kuptuar rëndësinë e veprës penale dhe aftësia për të kontrolluar sjelljet e veta¹⁰.

Deri më sot evidentohen tre sisteme, nëpërmjet të cilave përcaktohet përgjegjësia penale e personave juridikë. Sipas sistemit të parë, të njohur si sistemi i përgjegjësisë së përgjithëshme, përgjegjësia penale e personave juridikë është e ngjashme me atë të individit. Personat juridikë mund të jenë formalisht përgjegjës për kryerjen e çdo vepre penale që mund të kryhet nga individët. Sipas sistemit të dytë kërkohet që legjislatori të përmendë për çdo vepër penale të saksionuar nëse personat juridikë do të mbajnë përgjegjësi penale për kryerjen e saj. Sistemi i tretë konsiston, me renditjen në ligj, të të gjitha veprave penale për të cilat entiteti mund të jetë përgjegjës. Nëse i

Neni 26 i Kodit Civil: *Persona juridikë privatë janë shoqëritë, shoqatat, fondacionet dhe entet e tjera me karakter privat, të cilat e fitojnë personalitetin juridik në mënyrën e caktuar nga ligji.*

⁸ Nuni A., (2006), *Hyrje në të drejtën civile (Cikël leksionesh)*, Tiranë, fq 144.

⁹ Po aty

¹⁰ Muci Sh., (2007), *E Drejta Penale (Pjesa e Përgjithshme)*, Tiranë, Dudaj, fq 93

referohemi kuadrit normativ penal, në bazë të të cilit aplikohet përgjegjësia penale ndaj personave juridikë në vendin tonë, vërejmë se në Kodin Penal nuk parashikohet në mënyrë të veçantë rasti kur vepra penale kryhet nga persona juridikë. Gjithashtu, nuk ka asnjë ligj në të cilin të jenë parashikuar veprat penale për të cilat do të mbajë përgjegjësi personi juridik. Për këto arsye shprehim se ligji ynë penal i përshtatet sistemit të përgjegjësive penale të përgjithshme të personave juridikë, sipas të cilit ndaj personit juridik mund të aplikohet përgjegjësia penale për kryerjen e çdo vepre penale¹¹. Pavarësisht se në legjislacionin penal shqiptar nuk është bërë një ndarje midis veprat penale që mund të kryhen nga një person fizik dhe person juridik, ka disa vepra penale që mund të kryhen vetëm nga një person fizik¹².

Neni 45¹³ i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë përbën dispozitën bazë e marrjes në përgjegjësi penale të personave juridikë. Ky nen përcakton qartë se kush persona juridikë mund të jenë subjekt të përgjegjësive penale. Vetëm institucionet shtetërore përjashtohen nga përgjegjësia penale, ndërkohë që për personat e tjerë juridikë publikë (ndërmarrjet shtetërore dhe entet publike) dhe personat juridikë privatë, pranohet përgjegjësia penale. Pra tërësia e personave juridikë si subjekte të të drejtës penale është më i ngushtë nga rrethi i personave juridikë si subjekte të së drejtës, të parashikuar nga Kodi Civil. Pavarësisht se neni 45/1 i Kodit Penal përjashton nga përgjegjësia penale institucionet shtetërore, paragrafi i dytë bën një përjashtim, sepse ai parashikon që njësitë e qeverisjes vendore¹⁴ mbajnë përgjegjësi penale. Lind pyetje, a kanë

¹¹ Malltezi A., (2011), *E Drejta Shqiptare e Shoqërive Tregtare*, Tiranë, Mediaprint, fq. 326-327

¹² Psh. veprat penale të rrahjes, përdhunimit etj

¹³ Zbatimi i ligjit penal ndaj personave juridikë:

-Personat juridikë, me përjashtim të institucioneve shtetërore, përgjigjen penalisht për veprat penale, të kryera në emër ose në dodi të tyre nga organet dhe përfaqësuesit e tyre.

-Njësitë e qeverisjes vendore përgjigjen penalisht vetëm për veprime të kryera gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, të cilat mund të ushtrohen nëpërmjet delegimit të shërbimeve publike.

Përgjegjësia penale e personave juridikë nuk përjashton përgjegjësinë penale të personave fizikë, të cilët kanë kryer ose janë bashkëpuntorë në kryerjen e të njëjtës vepër penale.

Veprat penale dhe masat ndëshkuese përkatëse, që zbatohen ndaj personave juridikë, si dhe procedura për vendosjen dhe ekzekutimin e tyre rregullohen me ligj të veçantë .

¹⁴ Në nenin 108/1 të Kushtetutës parashikohen se cilat janë njësitë e qeverisjes vendore: *Njësitë e qeverisjes vendore janë komunat ose bashkitë dhe qarqet. Njësitë e tjera të qeverisjes vendore rregullohen me ligj.*

njësitë e qeverisjes vendore statusin e institucioneve shtetërore? Përgjigja është sigurisht që po, por ato do të mbajnë përgjegjësi penale, vetëm për veprime që kanë të bëjnë me delegimin e shërbimeve publike te një person i tretë. Përgjegjësia penale e personave juridikë nuk përjashton përgjegjësinë penale dhe të personave fizikë. Nuk kemi një përjashtim të përgjegjësive penale të personave fizikë me personat juridikë por një bashkëekzistencë. Përveç procedimit penal të personit juridikë, mund të procedohen penalish edhe personat fizikë të cilët kanë kryer apo janë bashkëpunorë në kryerjen e të njëjtës vepër penale. Nënkuptohej që termi bashkëpunim përdoret në rastin kur dy ose më shumë persona fizikë, me marrëveshje midis tyre duan të kryejnë një vepër penale, sepse nuk mund të kemi bashkëpunim me një person juridik. Parlamenti ishte i vetëdijshëm që vetëm neni 45 i Kodit Penal nuk mund të rregullojë përgjegjësinë penale të personave juridikë. Në të përcaktohen elementët bazë, por rregullimi i plotë do të duhet të bëhet nga nga një ligj i veçantë. Kjo parashikohet në paragrafin e katërt të nenit 45¹⁵ të Kodit Penal. Pasi ky nen do të ishte thjesht formal dhe i pamundur për tu zbatuar në praktikë. Në vitin 2007 u miratua ligji nr. 9754 “ Për përgjegjësinë penale të personave juridikë” i cili i hapte rrugë marrjes efektive në përgjegjësi penale të personit juridik. Objekti i këtij ligji¹⁶ është të rregullojë kushtet që duhen plotësuar për të marrë në përgjegjësi penale personin juridik, rregullat që do të aplikohen për procedimin penal të personave juridikë dhe llojet dhe masat e dënimit, kur personi juridik, shpallet fajtor për kryerjen e një veprë penale. Në ligj¹⁷ është saksionuar se baza ligjore që do të aplikohet për të përcaktuar përgjegjësinë penale të personave juridikë, do të jetë ligji “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë”, me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe në Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale dhe dispozitat e tjera penale. Pra shohim se ligji do të aplikohet në atë masë, që nuk bie në kundërshtim me Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale dhe dispozitat e tjera penale që kanë fuqi më të lartë juridike se ligji në bazë të hierarkisë të burimeve të së drejtës.

¹⁵ Neni 45/4 i Kodit Penal: *Veprat penale dhe masat ndëshkuese përkatëse, që zbatohen ndaj personave juridikë, si dhe procedura për vendosjen dhe ekzekutimin e tyre rregullohet me ligj të veçantë.*

¹⁶ Neni 1 i ligjit, “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë”: *Ky ligj përcakton rregullat për përgjegjësisë, procedimin penale dhe llojet e masave ndëshkuese, që merren ndaj personave juridikë, për kryerjen e veprës penale*

¹⁷ Neni 2/1 i ligjit, “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë”. *Dispozitat e këtij ligji zbatohen ndaj personave juridikë për atë që nuk është parashikuar ndryshe në kodin penal, në kodin e procedurës penale dhe në dispozitat e tjera penale. Në rast se nuk është parashikuar ndryshe në këtë ligj, ndaj personave juridike zbatohen, gjithashtu, dispozitat e legjislacionit civilo-tregtar.*

Në ligj¹⁸ përcaktohen kriteret për të marrë në përgjegjësi penale një person juridik:

- Kriteri i subjekteve - Personi juridik do të mbajë përgjegjësi për veprën penale në rast se ajo kryhet nga organet apo përfaqësuesit e tij të cilët kanë fuqi vendimarrëse, këtu përfshihen funksionarët e lartë të personit juridik. Ose nga një person, që është nën autoritetin e personit që përfaqëson, drejton dhe administron personin juridik. Në kategorinë e dytë përfshihen punëmarrsit të cilët kryejnë funksione ekzekutive.

- Kriteri i personit juridik - Personi juridik do të mbajë përgjegjësi për veprën penale, kur ajo është kryer në emër ose në llogari të tij. Pra është personi juridik që përfiton nga pasojat që do të sjellë vepra penale. Vepra penale të kryera nga personi juridik mund të kryhen me anë të veprimeve ose të mos veprimeve kjo del nga paragrafi i tret i nenit 3. Subjektet¹⁹ të cilëve u referohet ky ligj janë:

- a. Personave juridikë shqiptar dhe;
- b. Personave juridikë të huaj që kanë fituar personalitetin juridik sipas legjislacionit shqiptar.

Një pyetje që lind natyrshëm nga parashikimi i nenit 2/2 i ligjit, a do të merret në përgjegjësi penale një person juridik i huaj i cili e ka fituar personalitetin juridik në një vend tjetër, dhe kryen veprë penale në Shqipëri? Po marrim një shembull : Nëse një person juridik që ka fituar personalitet juridik sipas legjislacionit italian, do të ishte i interesuar për të fituar një tender për ndërtimin e një rruge në Shqipëri. Për të realizuar këtë administratori i saj arrin të korruptoi një zyrtar të lartë. Në këtë mënyrë ai arrin të fitoi tenderin. Më pas hap një filjalin e tij në Shqipëri për të vazhduar punimet për ndërtimin e rrugës. Nëse do të bënim një interpretim të ngushtuar të nenit 2 të ligjit, do të thoshim që personi juridik që ka fituar personalitet juridik sipas legjislacionit italian nuk mund të merret në përgjegjësi, aq më pak filjali (sepse është krijuar pas kryerjes

¹⁸Neni 3 i ligjit "Për përgjegjësinë penale të personave juridikë": *Personi juridik ka përgjegjësi për veprat penale të kryera:*

- a) *në emër ose në dobi të tij, nga organet dhe përfaqësuesit e tij;*
- b) *në emër ose në dobi të tij, nga një person, që është nën autoritetin e personit që përfaqëson, drejton dhe administron personin juridik;*
- c) *në emër ose në dobi të tij, për shkak të mungesës së kontrollit apo të mbikëqyrjes nga personi që drejton, përfaqëson dhe administron personin juridik.*

¹⁹Neni 2/2 i ligjit, "Për përgjegjësinë penale të personave juridikë". *Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe ndaj personave juridikë të huaj,që kanë fituar personalitetin juridik, sipas legjislacionit shqipëtar.*

së veprës penale). Për të zgjidhur këtë problem duhet ti referohemi Kodit Penal, i cili në nenin 7/1²⁰ parshikon përgjegjësinë penale të shtetasve të huaj që kanë kryer veprë penale në Shqipëri. Në këtë rast nuk do të aplikohet ligji, por Kodi Penal si një normë me fuqi më të lartë juridike siç e parashikon neni 2/1 i ligjit “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë”, për të marrë në përgjegjësi penale personin juridik të huaj, që ka fituar personalitetin juridik sipas një legjislacioni të një vendi tjetër. Gjithsesi ligjvënësi duhet të jetë më i qartë në nenin 2/2 të ligjit.

Trajtimi i dispozitave procedurale është i domosdoshëm në mënyrë të tillë që të sigurohet një proces i rregullt ligjor edhe për personin juridik në përputhje me Kushtetutën dhe Kodin e Procedurës Penal me qëllim të garantohet respektimi i parimit të ligjshmërisë. Ligji “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë”, parashikon, se të gjitha garacitë procedurale që aplikohen për personat fizikë kur ai është marrë si person në hetim apo si i pandehur, do të aplikohen edhe për personat juridikë për aq sa është e mundur. Kjo nënkupton se dispozitat kushtetuese dhe të Kodit të Procedurës Penale do të aplikohen edhe për personin juridik. Ne mendojmë që do të ishte më e përshtatshme që normat juridike penale të procedimit penal të personit juridik të rregullohej nga një kudër ligjor i veçantë.

Në ligjin “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë” janë parashikuar llojet e dënimeve penale që do të jepen nëse një person juridik shpallet fajtor nga gjykata, për kryerjen një vepre penale. Dënimet penale për personat juridikë i ndajme në dy grupe :

- Dënimet kryesore²¹, ku përfshihen dënimi me gjobë dhe mbarimi i personit juridik. Mbarimi i personit juridik nuk mund të jepet ndaj njësisve të qeverisjes vendore, personave juridikë publikë dhe për partitë politike dhe sindikatat. Bashkë me dënimin kryesor mund të jepen një ose më shumë dënime plotësuese.
- Në dënimet plotësuese përfshihen, mbyllja e një ose më shumë veprimtarive apo strukturave të personit juridik; vendosja e personit juridik në administrim

²⁰ Neni 7 i Kodit Penal: “Shtetasi i huaj, që kanë kryer veprë penale në territorin e Republikës së Shqipërisë, përgjigjet në bazë të ligjit penal të Republikës së Shqipërisë”

²¹ Neni 9 i ligjit “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë”: *Ndaj personave juridikë, që kanë përgjegjësi për kryerjen e veprës penale, jepen këto dënime kryesore:*

- a) gjobë
- b) mbarim i personit juridik...

të kontrolluar; ndalimi për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit të fondeve publike; heqja e së drejtës së marrjes ose përdorimit të licencave, autorizimeve, konçesioneve ose subvencioneve; ndalimi për të kërkuar publikisht fonde dhe burime financiare; heqja e së drejtës së ushtrimit të një apo më shumë veprimtarive ose operacioneve dhe detyrimi për publikimin e vendimit gjyqësor.

Dënimet e parashikuar në këtë ligj dallojnë disi nga dënimet penale të parashikuar në Kodin Penal, për shkak të natyrës së veçantë që kanë personat juridikë (Psh. një personi juridik nuk mund ti jepet si masë dënimi, burgimi sepse është e pamundur për tu ekzekutuar, për shkak të natyrës së tij).

Pavarësisht se doktrina ka qëndrime të ndryshme për përgjegjësinë penale të personave juridikë, nëse këta të fundit mund të jenë subjekt aktiv të veprës penale, parashikimi i përgjegjësisë penale të këtyre subjekteve është bërë një domosdoshmëri në legjislacionin e brendshëm të shteteve. Pothuajse të gjithë shtetet kanë disiplinuar përgjegjësinë penale të personave juridikë, në legjislacionin e brendshëm penal të tyre. Disa vende kanë shkuar më tej, duke përcaktua dhe veprat penale për të cilat personi juridik mund të merret në përgjegjësi penale. E drejta është produkt i nevojave shoqërore, politike dhe ekonomike. Ky zhvillim ka diktuar nevojën, në përcaktimin si të domosdoshëm, marrjen e personit juridik në përgjegjësi penale. Shqipëria përfshihet në ato vende që kanë saksionuar në legjislacionin e saj penal përgjegjësinë penale të personave juridikë që prej vitit 1995 në Kodin Penal, si nevojë e realitetit të ri të krijuar pas rënies së sistemit komunist.

3. Konkluzione

Në Shqipëri, doktrina dhe legjislacioni penal gjatë sistemit komunist, parashikonte si të vetmin subjekt që mund të kryej një vepër penale, personin fizik. Koncepti i përgjegjësisë penale të personave juridikë është i ri në legjislacionin penal shqiptar, pasi u parashikua për herë të parë në Kodin Penal të vitit 1995, si nevojë e ndryshimeve politike, ekonomike dhe shoqërore që pësoi Shqipëria. Sot përgjegjësia penale e personave juridikë rregullohet nga neni 45 i Kodit Penal dhe nga ligji nr. 9754 “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë” i vitit 2007, por nuk duhen lënë mënjanë dhe një sërë aktesh ndërkombëtarë të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, të cilët kanë luajtur një rol të rëndësishëm për të përmirësuar legjislacionin penal, por që nuk janë objekt trajtimi i këtij punimi. Pavarësisht se legjislacioni shqiptar, për përgjegjësinë penale të personave juridikë është i mirë, ai ka nevojë për disa përmirësime. Së pari, në Kodin e Procedurës Penale dhe në ligjin “ Për përgjegjësinë penale të personave juridikë” nuk kemi dispozita procedurale penale të posaçme vetëm për personin juridik. Do të aplikohen dispozitat e procedimit penal të personit në hetim apo të marrë si të pandehur (personi

fizik) për aq sa është e mundur. Do të ishte e udhës që në ligj, të parashikoheshin dispozita të posaçme për procedimin penal të personit juridik, për shkak të karakterit të veçantë që ka personi juridik (subjekt abstrakt). Së dyti, është e nevojshme që edhe legjislacioni penal shqiptar të sanksionojë në ligj të veçantë dhe jo ti referohet Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, për masat e sigurisë që mund të aplikohen ndaj personit juridik dhe të parashikojë rastet kur përjashtohet nga përgjegjësia penale personi juridik, kjo praktikë ndiqet edhe nga vendet perëndimore dhe ato të rajonit (P.sh. Kosova). Së treti, nëse i referohemi ligjit, që rregullon përgjegjësinë penale të personave juridikë, ai nuk saksionon veprat penale, të cilat pesoni juridik mund të merret në përgjegjësi penale. Për këto vepra penale duhet ti referohemi Kodit Penal, i cili nuk ka një kapitull të veçantë, që trajton veprat penale të cilat mund të kryhen nga personat juridikë. Do të ishte më mirë që në ligj, të përcaktohen posaçërisht veprat penale që mund të kryhen nga personat juridikë. Së katërti, një nga problematikat e të gjithë legjislacionit në tërësi në Shqipëri, është zbatimi efektiv i legjislacionit penal në tërësi dhe në veçanti për përgjegjësinë penale të personit juridikë.

Bibliografia

- Bozheku E., dhe Elezi I., (2012), *Përgjegjësia penale e personave juridikë*, Tiranë, Toena, fq 31.
- Çela A., dhe Peza N., dhe Elezi I., dhe Gjika G., (1982), *E drejta penale e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë*, Tiranë, 8 Nëntori.
- Elezi I., (1983), *E drejta Zakonore Penale e Shqiptarëve*, Tiranë, 8 Nëntori.
- Malltezi A., (2011), *E Drejta Shqiptare e Shoqërive Tregtare*, Tiranë, Mediaprint.
- Muci Sh., (2007), *E Drejta Penale (Pjesa e Përgjithshme)*, Tiranë, Dudaj.
- Nuni A., (2006), *Hyrje në të drejtën civile*, Tiranë.
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.
- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë.
- Ligji nr. 9754 i datës 14.06.2007 : *“Për përgjegjësinë penale të personave juridikë”*.

ZHVILLIMET E FUNDIT NË DISIPLINËN E QARKULLIMIT TË SHTETASVE TË VENDEVE TË TRETA NË BE. RIKTHIMI I KONTROLLEVE NË KUFIJTË E BRENDSHËM

Ervis Moçka

Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë
ervis.mocka@univlora.edu.al

Abstract

Me Traktatin e Amsterdimit *acquis* Schengen do të integrohet në të drejtën e Be në kuadër të një objektivi më të madh, atë të realizimit të një hapësire lirie, sigurie dhe drejtësie. Si rrjedhojë e integritimit të *acquis* Schengen në të drejtën komunitare, midis Shteteve anëtare do të krijohet një regjim juridik i përbashkët në lidhje me qarkullimin e personave, i bazuar në disiplinën e kalimit të kufijve të brendshëm dhe të jashtëm të zonës Schengen.

Përcaktimi i kufijve të brendshëm dhe heqja e kontrolleve bëhet në funksion të realizimit të tregut të përbashkët, objektiv ky i parashikuar nga neni 14 TKE. Heqja e kontrolleve në kufijtë e brendshëm lidhet ngushtë me lirinë e qarkullimit e cila sipas parashikimit të nenit 62.1 TKE (77 TFBE) i përket çdo personi pavarësisht nga shtetësia, pra edhe shtetasve të vendeve të treta. Hyrja në territorin komunitar i një shtetasve të vendeve të treta edhe të drejtën e qarkullimit të lirë, e cila nga ana e saj është e lidhur me heqjen e kufijve të brendshëm si masë thelbësore për realizimin e tregut të përbashkët.

Në këtë punim analizohen masat e fundit të miratuara në kuadrin komunitar në lidhje me qarkullimin e shtetasve të vendeve të treta në territorin komunitar, duke u fokusuar në ndryshimet që ka pësuar mekanizmi i rikthimit të përkohshëm të kontrolleve në kufijtë e brendshëm nga ana e Rregullores (BE) nr. 1051/2013 e Parlamentit europian dhe Këshillit e 22 tetorit 2013.

Key words: Schengen Border Code, third-country nationals, immigration, EU legislation.

Qarkulimi i lirë shtetasve të vendeve të treta

Qarkullimi i shtetasve të vendeve të treta nuk disiplinohet nga Rregullorja nr. 562/2006¹ e Parlamentit dhe Këshillit. Kjo rregullore disiplinon vetëm heqjen e kontrolleve në kufijtë e brendshëm, kushtet e hyrjes në hapësirën Schengen dhe kontrollet në kufijtë jashtëm.

Në pritje të një reforme në disiplinë, qarkullimi i shtetasve të vendeve të treta në hapësirën Schengen disiplinohet nga nenet 19 – 25 të Konventës së zbatimit të Marrveshjes Schengen.

Pas integritimit të *acquis* Schengen në të drejtën e Bashkimit evropian nga ana e Traktatit të Amsterdimit, vendimi 1999/436² i Këshillit përcaktoi neni 62.3 TKE si bazë juridike të këtyre dispozitave, i cili parashikon miratimin e masave të cilat përcaktojnë kushtet për qarkullimin e shtetasve të vendeve të treta në territorin e Shteteve anëtare për periudha që nuk tejkalojnë tre muaj. Këto masa janë të ndryshme nga masat e parashikuara nga neni 62.2 dhe nuk paragjykojnë këto të fundit. Në këtë mënyrë kushtet e qarkullimit duhet të përmbushen si nga personat të cilët janë të detyruar të posedojnë një vizë në momentin e kalimit të kufijve, ashtu dhe personat të cilat përjashtohen nga detyrimi posedimit të vizës.

Në bazë të nenin 19 të Konventës, “të huajt” në posedim të një vizë uniforme dhe që plotësojnë kushtet e hyrjes të parashikuara në nenin 5, paragrafin 1, shkronjat a), c), d) dhe e) dhe kanë hyrë në mënyrë të rregullt në territorin e një prej Shteteve anëtare, “mund të qarkullojnë lirisht në territorin e të gjithë palëve nënshkruesë për peirudhën e vlefshmërisë së vizës”.

Neni 20 parashikon se në të njëjtat kushte mund të qarkullojnë lirisht dhe “të huajt” të cilët nuk kanë detyrimin e posedimit të një vize në momentin e kalimit të kufijve. Këta persona me përmbushjen e kushteve të nenit 5 mund të qarkullojnë për një periudhë maksimale tre mujore brënda një peirudhe gjashtë mujore nga data e hyrjes së parë. Për këtë kategori të huajsh, dispozita në fjalë parashikon dhe mundësinë e një shtyrje përtej tre muajve të afatit të qëndrimit në territorin e vet, nga ana e një prej Palëve nënshkruese.

Liria e qarkullimit për një periudhë jo më të gjatë se tre muaj i lejohet edhe të huajve që posedojnë një leje qëndrimi, një autorizim provizor qëndrimi dhe një dokument udhëtimi të lëshuar nga një Palë nënshkruese, nëse plotëson kushtet e parashikuara në shkronjat a), c) dhe e) të nenit 5 paragrafi 1 i Rregullores 562/2006 dhe nuk figuron në listën kombëtare të personave të sinjalizuar nga ana e Shtetit anëtar të interesuar³. Parashikim ky konform me Kartën e të drejtave themelore të Bashkimit evropian e cila në nenin 45.2 përcakton se

¹ REGULATION (EC) No 562/2006 OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 15 March 2006 establishing a Community Code on the rules governing the movement of persons across borders (Schengen Borders Code) in Official Journal of the European Union L 105/1 date 13.04.2006.

² Vendimi 1999/436/KE i Këshillit në 20 maj 1999, i cili përcakton, në përputhje me dispozitat e Traktatit që themelon Komunitetin evropian dhe traktatit mbi Bashkimin evropian, bazën juridike për secilën nga dispozitat apo vendimet të cilat formojnë *acquis* Schengen, në Gazetën Zyrtare L 176 të 10 korrikut 1999.

³ Neni 21, paragrafi 1 i Konventës së zbatimit të Marrëveshjes Schengen.

“liria e lëvizjes dhe e qëndrimit mund t’u jepet, në përputhje me Traktatet, shtetasve të vendeve të treta me vendbanim të ligjshëm në territorin e një Shteti Anëtar”.

Për sa i përket kushteve që duhet të plotësohen vihet re se janë hequr kushtet e parashikuara nga shkronja b) dhe d) e paragrafit 1 të nenit 5 të cilat përcaktojnë detyrimin e posedimit të një vize apo një leje qëndrimi dhe mos të jetë i sinjalizuar në sistemin SIS me qëllim mospranimin. Në fakt parashikimi i shkronjës b) nuk ka arsye të qëndrojë pasi do të ishte thjesht një kopje e parashikimit të vetë nenit 21.1. Për sa i përket parashikimit të shkronjës d), ky është përjashtuar pasi është preferuar një sistem vlersimi që u lë një liri veprimi Shteteve anëtare.

Neni 21.1 përjashtimin e parashikimit të shkronjës d), e cila përcakton si kusht mos sinjalizimin në sistemin SIS, e ka kompesuar duke përcaktuar shprehimisht se i huaj nuk duhet të jetë në listën e personave të sinjalizuar nga Shteti i interesuar dhe duhet të përmbushë kushtet e shkronjës e). Pra i huaj mjafton të mos jetë në listën e personave të sinjalizuar nga Shteti në territorin e të cilit kërkon të qarkullojë lirisht, që ndryshon nga sinjalizimi në sistemin SIS, në të cilin sinjalizimi nga çdo Shtet anëtar pengon qarkullimin e lirë. Nga ana tjetër është rimarrë parashikimi shkronjës e) sipas të cilës i huaj nuk duhet të konsiderohet rrezik për rendin publik, sigurinë e brendshme, shëndetin publik apo marrdhëniet ndërkombëtare të një prej Shteteve anëtare. Parashikim ky që lë një liri veprimi në dorën e Shteteve anëtare, pasi janë këto të fundit të cilët vlersojnë rrezikun.

Neni 21 i Konventës pas ndryshimit të pësuar nga Rregullorja (UE) nr. 265/2010⁴ e Parlamentit evropian dhe Këshillit e 25 marsit 2010, i është shtuar paragrafi 2-*bis* i cili parashikon se liria e qarkullimit e parashikuar në paragrafin 1, u aplikohet edhe të huajve titullar të një vize për qëndrime afatgjata e lëshuar nga një Shtet anëtar konform parashikimit të nenit 18 të Konventës. Ishte pikërisht neni 18 i Konventës i cili pas ndryshimit nga ana e Rregullores (KE) nr. 1091/2001⁵ e Këshillit e 28 maj 2001, për një periudhë tre mujore u njihte vizave me afat mbi tre mujor (të ashtuquajtura viza kombëtare) të njëjtën vlerë me vizat uniforme për qëndrime afatshkurtra, duke u njohur titullarëve të këtyre vizave mundësinë e qarkullimit në territorin e Shteteve anëtare nëse plotëson kushtet e nenit 5, paragrafi 1, shkronjat a), c), d) dhe e).

Rregullorja nr. 265/2010 ka ndryshuar dhe nenin 18. Ky i fundit tashmë parashikon se vizat me afat mbi tre muaj (viza afatgjata) janë viza kombëtare dhe lëshohen në bazë të modelit uniform të vizave përcaktuar nga Rregullorja

⁴ Rregullorja (UE) nr. 265/2010 e Parlamentit evropian dhe Këshillit e 25 marsit 2010 e cila ndryshon Konventën e zbatimit të Marrëveshjes Schengen dhe Rregulloren (KE) nr. 562/2006 për sa i përket qarkullimit të titullarëve të vizave për qëndrime afatgjata, në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit evropian* L 85/1 datë 31.3.2010.

⁵ Rregullorja (KE) nr. 1091/2001 e Këshillit e 28 maj 2001 në lidhje me qarkullimin e titullarëve të një vize për qëndrime afatgjata, në *Gazetën Zyrtare të Komunitetit evropian* L 150/4 datë 6.6.2001.

(KE) nr. 1683/1995 dhe plotësohen konformë dispozitave të Rregullores (KE) nr. 810/2009 (*Visa code*).

Në çdo rast, pavarësisht titullit me të cilin hyjnë në territorin e një Shteti anëtar, shtetasit e huaj janë të detyruar të deklarojnë prezencën e tyre te autoritetet kompetente në momentin e hyrjes ose brenda tre ditëve nëse Shtetet anëtare zgjedhin kështu (neni 22 i Konventës). Me heqjen e kontrolleve në kufijtë e brendshëm bëhet i pamundur kontrolli i kushteve të sipër përmendur për shtetasin e huaj i cili vjen nga territori një Shteti anëtar për të hyrë në territorin e një tjetër Shteti anëtar. Vetë deklarimi prezencës nga i huaj ka si qëllim shmangien e favorizimit të formave të imigracionit të jashtëligjshëm, pasi në këtë mënyrë përpiqet të evitohet që liria e qarkullimit të përdoret për qëndrime në territorin e Shteteve anëtare për periudha që tejkalojnë tre muaj brenda një periudhë gjashtë mujore⁶. Vetë deklarimi i prezencës është kritikuar si jo i pajtueshëm me heqjen e kontrolleve në kufijtë e brendshëm⁷, pasi efekti do të ishte limitimi i qarkullimit të shtetasve të huaj. Në propozimin e tërhequr të Direktivës, Komisioni e kishte hequr këtë parashikim duke argumentuar se përveç problemeve praktike të zbatimit ishte dhe i pa pajtueshëm me heqjen e kontrolleve në kufijtë e brendshëm⁸.

Megjithatë është e rëndësishme të përmendet se nën garancitë e duhura, detyrimi i deklarimit të prezencës mund të vendoset dhe për qytetarët e Bashkimit evropian të cilët ushtrojnë të drejtën e lirisë së qarkullimit. Ky detyrim në asnjë mënyrë nuk duhet të ndryshojë parimet themelore të sistemit komunitar dhe nuk mund të ketë asnjë efekt kufizues kundrejt lirisë së lëvizjes së lirë e njohur për qytetarët e Bashkimit evropian⁹.

Rikthim i përkohshëm i kontrolleve në kufijtë e brendshëm

Rregullorja nr. 562/2006 në nenin 20 përcakton se kufijtë e brendshëm mund të kalohen në çdo pikë dhe në mungesë të çdo lloj kontrolli mbi personat, pavarësisht shtetësisë së tyre duke risjell në këtë mënyrë tekstualisht parashikimin që bëhet nga neni 2 i Konventës së zbatimit të Marrveshjes Schengen. Vihet re se jo vetëm që hiqen kontrollet mbi personat po norma në fjalë nuk përcakton as pikë kalime apo orare fikse për kalimin e kufijve siç përcakton neni 4 për kalimin e kufijve të jashtëm.

Neni 2 i Konventës në paragrafin 2 parashikon që për ruajtjen e rendit publik apo të sigurisë kombëtare, një Shtet palë i Konventës munt të rikthejë kontrollet në kufijtë e brendshëm, për një periudhë të limituar, pas konsultimit paraprak me Shtetet e tjerë palë, ndërkoh që parashikon dhe mundësinë e rikthimit të kontrolleve dhe pa konsultimin paraprak të Shteteve të tjerë kur nevojat e ruajtjes së rendit publik apo sigurisë kombëtare kërkojnë marrjen e masave të

⁶ HAILBRONNER K., *“Immigration and Asylum Law and Policy of the European Union”*, The Hague, London, Boston, 2000, fq. 155.

⁷ *Ibid.*, fq. 156.

⁸ Shih, *Observimet e Komisionit në COM (2001) 388 definitiv*, fq. 18

⁹ Shih. LANFRANCHI M.P., *“Droit communautaire et travailleurs migrants des Etats tiers”*, Paris, 1994, fq. 81.

menjëhershme. Detyrimi në këtë rast është vetëm ai i informimit të menjëhershëm të Shteteve të tjerë palë të Konventës.

Neni 23 i kodit të kufijve Schengen (Rregullorja nr. 562/2006) ka rimarrë parashikimin e nenit 2 të Konventës së zbatimit me ndryshimin se parashikohet një limit maksimal prej 30 ditësh i rikthimit të kontrolleve në kufij i cili nëse situata vazhdon mund të zgjatet në 30 ditë të tjera ose për sa kohë rreziku vazhdon.

Në ndryshim nga dispozita e Konventës së zbatimit e cila parashikon rivendosjen e kontrolleve në raste nevojë për ruajtjen e rendit publik apo sigurisë kombëtare¹⁰, Rregullorja parashikon se rivendosja e kontrolleve mund të bëhet vetëm në rastin e një “kërcënimi serioz” për rendin publik dhe sigurinë kombëtare¹¹. Megjithëse dispozitat në fjalë ndryshojnë në termat e përdorur, praktikisht në zbatimin e tyre duket e pamundur të dallohet një diferencë, pasi është gjithmonë Shteti palë që kërkon të rivendosë kontrollet i cili vleron kur është e nevojshme apo kur është përballë një kërcënimi serioz për rregullin publik apo sigurinë e tij kombëtare.

Procedurat e rivendosjes së kontrolleve në kufijtë e brendshëm diferencohen në bazë të parashikimit (neni 24) ose jo (neni 25) të ngjarjeve të cilat shtynë Shtetin anëtar që të ndërmarrë një masë të tillë. Shteti që rivendos kontrollet në kufij duhet të informojë Parlamentin europian dhe Shtetet e tjerë anëtare në lidhje me shtrirjen dhe kohëzgjatjen e rikthimit të kontrolleve. Komisioni mund të nxjerrë një opinion mbi këtë njoftim i cili mund të çojë në konsultime midis Shteteve anëtare dhe Komisionit. Duke ndjekur kriteret e transparencës duhet të informohet dhe publiku përveç rasteve kur për arsye sigurie ky lloj informimi është i pamundur.

Procedurat e rivendosjes së kontrollit në kufijtë e brendshëm, informimit dhe zgjatjes së afatit të këtyre kontrolleve të parashikuar në nenet nga 24 në 31 të Rregullores 562/2006 do të pësojnë një ndryshim nga ana e Rregullores (BE) nr. 1051/2013 e Parlamentit europian dhe Këshillit e 22 tetorit 2013¹².

¹⁰ Article 2.2 of Convention Applying the Schengen Agreement ff 14 June 1985 “Where public policy or national security so require, however, a Contracting Party may, after consulting the other Contracting Parties, decide that for a limited period national border checks appropriate to the situation will be carried out at internal borders. If public policy or national security require immediate action, the Contracting Party concerned shall take the necessary measures and shall inform the other Contracting Parties thereof at the earliest opportunity”.

¹¹ Article 23 of Regulation 562/2006 “Where there is a serious threat to public policy or internal security, a Member State may exceptionally reintroduce border control at its internal borders for a limited period of no more than 30 days or for the foreseeable duration of the serious threat if its duration exceeds the period of 30 days...”

¹² Regulation (Eu) No 1051/2013 of the European Parliament and of the Council of 22 October 2013 amending Regulation (EC) No 562/2006 in order to provide for common rules on the temporary reintroduction of border control at internal

Rregullorja është pjesë e një pakete masash që Komisioni propozoi me qëllim forcimin e hapësirës Schengen¹³, nevojë kjo që lindi pas disa problemeve në administrimin në nivel komunitar të flukseve migratore të shkakturara si pasojë e situatës së krijuar nga ngjarjet e viteve 2010 – 2011 në Afrikën e veriut¹⁴. Në Komunikimin “Governance Schengen – Përforcimi i hapësirës pa kontrolle në kufijtë e brendshëm” COM(2011) 562, Komisioni sqaronte se qëllimi i kësaj pakete masash ishte krijimi i një strategjie të koordinuar në nivel të Bashkimit europian, në gjëndje të sigurote parimet themelore të së drejtës së BE dhe në veçanti të mos çënohej e drejta e qarkullimit të lirë. Duke krijuar një hapësirë Schengen më të sigurt, këto masa do të merrnin parasysh interesat europian por nga ana tjetër do të vendosin limite për iniciativat e njëanshme kombëtare të cilat të vetme nuk mund të jenë një përgjigje efikase për rreziqet e përbashkëta. Qëllimi kryesor i Komisionit ishte të sigurote që rikthimi i kontrolleve në kufijtë e brendshëm të vendosej sipas mënyrës komunitare¹⁵. Vendimi do të merrej nga Komisioni pas një konsultimi me Shtetet anëtare. Neni 23 sipas propozimit të Komisionit nuk do të përmbante më asnjë referim në lidhje me një mundësi vendimi të njëanshëm nga ana e Shteteve anëtare. Këta të fundit i paraqesin Komisionit një kërkesë mbi pezullimin e lirisë së qarkullimit në disa kufij të përcaktuar, të paktën 6 javë para periudhës të parashikuar për rikthimin e kontrolleve.

Neni 23 *-bis* përcakton se është Komisioni që merr vendimin në lidhje me rikthimin e kontrolleve në kufijtë e brendshëm në bazë të informacioneve që Shtetet anëtare janë të detyruar të trasmetojnë. Siç vihet re situata ndryshon rrënjësisht, pasi sipas dispozitave në fuqi, është Shteti anëtar ai që vendos të rikthejë kontrollet dhe ka vetëm një detyrim komunikimi ndaj Komisionit, ndërsa me ndryshimet që parashikon propozimi i Komisionit, do të jetë

borders in exceptional circumstances, in *Official Journal of the European Union L 295/1, datë 6.11.2013*.

¹³ Në 16 shtator 2011 Komisioni evropian prezanton një paketë propozimesh e cila përfaqëson përgjigjen legislative për problemin emergjent të imigracionit ndeshur në gjysmën e parë të 2011. Kjo paketë formohet nga tre dokumente, ndër të cilët dy janë propozime Rregulloresh: a) një Komunikatë e titulluar “Governance Schengen – Përforcimi i hapësirës pa kontrolle në kufijtë e brendshëm COM(2011) 562; b) Propozim për Rregullore i cili ndryshon një propozim të mëparshëm të 2010 COM(2010) 624 e cila krijon një mekanizëm vlersimi dhe monitorimi për verifikimin e aplikimit të *acquis* Schengen COM(2011) 559; c) Propozim për Rregullore COM(2011) 560 e cila modifikon Kodin e kufijve Schengen.

¹⁴ Në veçanti një mungesa e koordinimit në nivel komunitar u vu re në pamundësinë për të zgjidhur problemin dhe polemikat që lindën midis Francës dhe Italisë, pas mbërritjes në brigjet italiane të shumë shtetasve tunizian në fillim të 2011 dhe lëshimit nga ana e Italisë të një leje qëndrimi që i lejonte të qarkullonin në hapësirën Schengen. Shumë prej tyre për shkak të lidhjeve familjare dhe kulturore u drejtuan drejt Francës, autoritetet e së cilës reagon duke rivendosur kontrollet në kufijtë e brendshëm dhe duke i kthyer drejt Italisë.

¹⁵ Shih., COM(2011) 562 definitiv, pika 1.

Komisioni ai që merr vendimin pas kërkesës nga Shteti i interesuar. Ky i fundit në kërkesën e vet i ofron Komisionit gjithë informacionin e nevojshëm mbi kërcënimin për rendin publik dhe sigurinë. Pas ndryshimit të propozuar nga Komisioni, neni 26 do të përcaktoj mundësinë që një rikthim i kufijve mund të vendoset dhe nga vetë Komisioni pa pasur një kërkesë nga një prej Shteteve anëtare, në rastin se, Komisioni konstaton mungesa të rënda dhe të vazhdueshme në kontrollet e kufijve të jashtëm të Unionit apo në procedurat e riatdhesimit, nga ana e një Shteti anëtar. Ndërkohë që nuk ndryshon në mënyrë thelbësore procedura e parashikuar nga neni 25, sipas të cilës në situata të paparashikueshme dhe urgjente që kërkojnë një ndërhyrje të menjëhershme është Shteti anëtar që vendos për rivendosjen e kontrolleve në kufijtë e brendshëm, përveç faktit se vendimi njëanshëm i Shteti anëtar vlen vetëm për pesë ditë dhe një shtyrje e këtij afati mund të vendoset vetëm nga Komisioni.

Ky propozim modifikimi i kodit Schengen i paraqitur nga Komisioni do të hasi në kundërshtimin e shumë prej parlamenteve kombëtare të Shteteve anëtare të BE të cilët shihnin në këtë propozim si të cënuar parimin e subsidiaritetit¹⁶ si dhe nga ana e Shteteve që bëjnë pjesë në hapësirën Schengen po jo anëtare të Bashkimit europian¹⁷.

Për shkak të kundërshtive të Shteteve anëtare Rregullorja (BE) nr. 1051/2013 e Parlamentit europian dhe e Këshillit e 22 tetorit 2013 e cila modifikon kodin e kufijve Schengen, do të ndryshojë shumë nga propozimi Komisionit. Vendimi për rivendosjen e kontrolleve në kufijtë e brendshëm u mbetet Shteteve anëtare dhe jo Komisionit siç ishte parashikuar në propozimin e tij. Neni 23 i cili disiplinon kuadrin e përgjithshëm të rivendosjes së kontrolleve në kufijtë e brendshëm përcakton si kusht për rivendosjen e këtyre kontrolleve nga ana e Shtetit anëtar ekzistencën e një kërcënimi serioz për rendin publik dhe sigurinë e tij. Ky vendim konsiderohet si një masë e jashtëzakonshme, mjet i fundit në mungesë të alternativave të tjera¹⁸ dhe për këtë arsye limitohet në 30 ditë, apo për gjithë periudhën në të cilën rreziku vazhdon kur ky i tejkalon 30 ditët. Megjithatë shtrirja dhe kohëzgjatja e rikthimit të kontrolleve nuk duhet të

¹⁶ Asambleja kombëtare Franceze në një mendim të motivuar të 27 shtatorit 2011 ngrinte dyshimet mbi respektimin e parimit të subsidiaritetit. Sipas saj, vetëm Shtetet anëtare janë në gjendje të vlerësojnë seriozitetin e kërcënimit të rendit publik apo sigurisë së brendshme, ndaj vetëm këta mund të marrin vendimin e pezullimit momental të qarkullimit të lirë. Për më shumë shih. FIORILLO V., *“Il pacchetto di proposta della Commissione europea per la modifica del sistema Schengen”*, në Osservatorio sulla normativa, Anno II, nr. 1, 2012.

¹⁷ Rasti i Zvicrës e cila prezanton qëndrimin e saj brënda grupeve kompetente të punës, sipas të cilit kompetenca e vendimarrjes duhet ti ngelet Shteteve anëtare të hapësirës Schengen dhe nuk duhet ti kalojë Komisionit apo Këshillit. Shih., Raportin sqarues *“Recepimento e trasposizione del regolamento (UE) nr. 1051/2013 che modifica il codice frontiere Schengen al fine di introdurre norme comuni sul ripristino temporaneo del controllo di frontiera alle frontiere interne”*, Zyra federale e migrimit, BERNË, nëntor 2013.

¹⁸ Paragrafi 2 neni 23 përdor termin *“extrema ratio”*

tejkalojë atë që është e domosdoshme për t'iu përgjigjur kërcënimit serioz. Pavarësisht kohës së zgjatjes së kërcënimit rivendosja e kontrolleve në kufijtë e brendshëm kompleksivisht nuk duhet të tejkalojë periudhën 6 mujore dhe vetëm në rastin e ekzistencës së rrethanave të jashtëzakonshme të cilat rrezikojnë funksionimin global të hapësirës pa kontrolle në kufijtë e brendshëm, parashikuar nga neni 26, kjo periudhë mund të shtrihet deri në 2 vjet.

Për kohëzgjatjen e rivendosjes së kontrolleve në kufijtë e brendshëm neni 23-*bis* përcakton se duhet të merren parasysh: impakti i mundshëm i kërcënimit mbi rendin publik dhe sigurinë e brendshme të Shtetit si dhe impaktin e mundshëm që kjo masë mund të shkaktojë mbi lirinë e qarkullimit të personave brënda hapësirës pa kontroll në kufijtë e brendshëm.

Procedura e përcaktuar në nenin 24 parashikon se Shteti anëtar i cili ka si qëllim rivendosjen e kontrolleve në kufij duhet të njoftojë katër javë para datës së parashikuar për rivendosjen e kontrolleve Komisionin, Parlamentin dhe Shtetet e tjerë anëtare, duke ofruar informacion mbi arsyen e këtij vendimi, datën dhe kohëzgjatjen si dhe pjesën e kufirit të interesuar. Nëse në bazë të informacionit të transmetuar Komisioni ka shqetësime mbi domosdoshmërinë apo proporcionalitetin e rivendosjes së kontrolleve në kufijtë e brendshëm, shpreh një opinion i cili përbën objekt konsultimi midis Shtetit anëtar që synon rivendosjen e kontrolleve, Shteteve anëtare të interesuar dhe Komisionit. Ky konsultim ka si qëllim organizimin e bashkëpunimit midis Shteteve anëtare, nëse kjo është e nevojshme dhe shqyrtimin e proporcionalitetit të masave në lidhje me ngjarjet që janë në bazë të rikthimit të kontrolleve në kufij. Në ndryshim nga propozimi i Komisionit, në versionin e miratuar dhe në fuqi, roli i këtij të fundit kufizohet në mënyrë të dukshme. Nuk është Komisioni ai që vendos mbi rivendosjen e kontrolleve në kufijtë e brendshëm, por i lihet vetëm mundësia e organizimit të konsultimeve dhe e nxjerrjes së një opinioni i cili në asnjë mënyrë nuk mund të paragjykojë përgjegjësinë e Shteteve anëtare në lidhje me ruajtjen e rendit dhe garantimin e sigurisë së brendshme¹⁹. Në këtë mënyrë dështon qëllimi kryesor i Komisionit që synonte vendosjen sipas mënyrës komunitare të rikthimit të kontrolleve në kufijtë e brendshëm.

Në këtë drejtim vazhdon dhe procedura specifike e parashikuar nga neni 25 në rastet kur kërkohet një aksion i menjëhershëm për të përballuar një kërcënim serioz për rendin publik dhe sigurinë e brendshme. Është gjithmonë Shteti anëtar që vendos rikthimin e kontrolleve në kufijtë e brendshëm për një periudhë 10 ditore e rinovueshme për periudha 20 ditore por kompleksivisht jo më shumë se dy muaj. Shteti anëtar i cili rivendos kontrollet ka detyrimin të informojë Komisionin dhe Shtetet e tjerë anëtare. Përveç detyrimit të informimit të menjëhershëm, Shteti palë ka dhe detyrimin e paraqitjes së një relacioni të detajuar mbi funksionimin e verifikimeve dhe efikasitetin e rivendosjes së

¹⁹ Paragrafi 4 i nenit 24 përcakton se opinioni i shprehur nga Komisioni apo një Shtet tjetër anëtar nuk paragjykon nenin 72 TFBE, i cili nga ana e tij përcakton se i gjithë Titulli V mbi hapësirën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë nuk prek ushtrimin e përgjegjësisë që u takojnë Shteteve anëtare në lidhje me ruajtjen e rendit publik si dhe sigurisë së brendshme.

kontrolleve, i cili duhet ti trasmetohet Parlamentit europian, Komisionit dhe Këshillit.

Procedura e tretë e rivendosjes së kontrollit në kufijtë e brendshëm është ajo e parashikuar nga neni 26 në rastin e ngjarjeve të jashtëzakonshme të cilat rrezikojnë funksionimin global të hapësirës pa kontrolle në kufijtë e brendshëm. Neni 26 përcakton qartë se kur një mungesë e theksuar e kontrolleve në kufijtë e jashtëm krijon rrethana të cilat përbëjnë një rrezik për rendin publik apo sigurinë e brendshme të hapësirës pa kontrolle në kufijtë e brendshëm apo në pjesë të veçanta të saj, mund të rivendoset kontrolli në kufijtë e brendshëm për një periudhë 6 mujore e cila mund të rinovohet jo më shumë se tre herë për periudha 6 mujore. Në ndryshim nga propozimi Komisionit, në të cilin do të ishte vetë Komisioni me iniciativën e vet që do të vendoste rikthimin e kontrolleve në rast se do të konstatonte mungesa të rënda dhe të vazhdueshme në kontrollet e kufijve të jashtëm të Unionit apo në procedurat e riatdhesimit nga ana e një Shteti anëtar, tashmë janë Shtetet anëtare të cilat do të rikthejnë kontrollet në kufijtë e brendshëm por në këtë rast në bazë të një rekomandimi të Këshillit. Rekomandimi i Këshillit bazohet në një propozim të Komisionit, i cili nga ana e tij mund të nxitet dhe nga një kërkesë e Shteteve anëtare për paraqitjen e një propozimi të tillë. Kjo procedurë ka si qëllim mbrojtjen e interesave të përbashkët në hapësirën pa kufij të brendshëm dhe si e tillë vlersimi i cënimit të këtyre interesave dhe i propozimit të masave u lihet organeve komunitare.

Në konkluzion, pavarishtë kërkesave substanciale të nenit 23 apo kërkesat procedurale tepër strikte të përcaktuara nga nenet 24, 25 dhe 26 është e qartë se nocioni “ekzistencë e kërcënimit për rendin publik dhe sigurinë e brendshme”, lë një liri të madhe veprimi për Shtetet anëtare, të vetmit të cilët mund të bëjnë vlersimin e ekzistencës së një kërcënimi serioz për rendin dhe sigurinë publike. Dështon në këtë mënyrë qëllimi kryesor i Komisionit mbi përdorimin e mënyrës komunitare për marrjen e vendimit mbi rikthimin e kontrolleve në kufijtë e brendshëm, duke e lënë këtë vendimarrje në dorën e Shteteve anëtare.

Konkluzione

Nga momenti hyrjes në fuqi i Kodit Schengen në 2006 e deri në 2010 mundësia e rikthimit të kontrolleve në kufijtë e brendshëm është përdorur 22 herë²⁰. Në pjesën më të madhe të rasteve ky rikthim kontrollesh është bërë për të mundësuar administrimin e sigurisë në rast veprimtarish sportive, manifestimesh politike apo Samite politike të nivelit të lartë.

Gjatë periudhës 1 nëntor 2011 – 30 prill 2013 kontrollet në kufijtë e brendshëm janë rivendosur dy herë. Herën e parë në 4 tetor 2011 kur Franca njofton Komisionin se për shkak të mbajtjes së Samitit G 20 të kryetarëve të Shteteve

²⁰ Komisioni Europian, “Raport i Komisionin për Parlamentit europian dhe Këshillin mbi aplikimin e Titullit III (kufijtë e brendshëm) të Rregullores (KE) nr. 562/2006 që krijon një kod komunitar në lidhje me regjimin e kufijve nga ana e personave (kodi kufijve Schengen)”, COM(2010) 554 definitiv, Bruksel 13.10.2010.

dhe qeverive në Kanë, do të rivendoste kontrollet në kufirin e saj me Italinë për periudhën midis 24 tetorit dhe 5 nëntorit 2011²¹. Në rastin e dytë ishte Spanja që në 20 prill 2012 njofton Komisionin se duke marrë parasysh mbajtjen e mbledhjes së Bankës qendrore europiane e cila zhvillohej në Barcelonë, do të rikthente kontrollet në kufirin e brendshëm tokësor me Francën dhe në aeroportet e Barcelonës dhe Geronës në datat nga 28 prill në 4 maj 2002²².

Gjatë periudhës 1 nëntor 2013 – 30 prill 2014 janë verifikuar dy raste të rikthimit të kontrolleve në kufijtë e brendshëm: rasti parë nga ana e Polonisë në datat nga 8 në 23 nëntor me rastin e mbajtjes së Konferencës së Shteteve palë të Konventës kuadër për mbrojtjen e ndryshimeve klimatike, dhe rasti dytë nga ana e Hollandës për Samitin mbi sigurinë bërthamore zhvilluar në Hagë nga datat 14 deri 28 mars²³.

Si dhe vihet re nga praktika e përdorur rikthimi i kontrolleve në kufijtë e brendshëm është bërë sa herë që Shtetet anëtare kanë vlerësuar ekzistencën e një kërcënimi serioz për rendin dhe sigurinë publike të tyre. Pavarësisht tentativës së Komisionit që vendimi për rikthimin në kufijtë e brendshëm të merrej në nivel komunitar, Rregullorja (BE) nr. 1051/2013 e Parlamentit europian dhe e Këshillit e 22 tetorit 2013 e cila modifikon kodin e kufijve Schengen, nuk do ta ndryshojë situatën. Kjo Rregullore do të përforcoj procedurën që duhet të ndiqet për rikthimin e kontrolleve në kufijtë e brendshëm si dhe afatet e vlefshmërisë së kësaj mase, por la përsëri në dorë të Shteteve vendimin për rikthimin e kontrolleve në kufijtë e brendshëm, duke përjashtaur në këtë mënyrë institucionet komunitare nga çdo mundësi vendimarrje. Këto të fundit duhet vetëm të njoftohen dhe mundësinë e fillimit të një konsultimi të përgjithshëm.

Në fund, fakti që Shtetet anëtare janë të vetmit të cilët mund të bëjnë vlersimin e ekzistencës së një “kërcënimi serioz për rendin dhe sigurinë publike”, kusht ky për rivendosjen e kontrolleve, lë një liri të madhe veprimi për Shtetet anëtare.

References

NASCIMBENE B., (1995). *Libertá di circolazione delle persone, diritti dei cittadini dell'Unione europea e dei Paesi terzi, in Da Schengen a Maastricht*, Milano.

²¹ Shih., “Raporti dyvjeçar mbi funksionimin e hapësirës Schengen 1° nëntor 2011 – 30 prill 2012”, Komunikat e Komisionit për Parlamentin europian dhe Këshillin, COM(2012) 230 final., Bruxelles, 16.5.2012.

²² Ibid., pika 3

²³ Shih., “Raporti pestë semestral mbi funksionimin e hapësirës Schengen 1° nëntor 2013 – 30 prill 2014”, Raport i Komisionit për Parlamentin europian dhe Këshillin, COM(2014) 292 final, Bruxelles, 26.5.2014

BLEJER, M., Mauro Mecagni., Ratna Sahay., Richard Hides., Barry Johnston., Piroska Nagy., and Roy Pepper (1992) 'Albania: From Isolation Towards Reform', Occasional Paper No. 98, Washington: International Monetary Fund.

CE. (2013). *Le politiche dell'Unione europea. Migrazione e Asilo.* . Bruxelles, : Comissione Europea.

FIORILLO V., "Il pacchetto di proposta della Commissione europea per la modifica del sistema Schengen", në Osservatorio sulla normativa, Anno II, nr. 1, 2012.

HAILBRONNER K., "Immigration and Asylum Law and Policy of the European Union", The Hague, London, Boston, 2000.

LANFRANCHI M.P., "Droit communautaire et travailleurs migrants des Etats tiers", Paris, 1994

LANG A., (2003, p. 698). *La politica comunitaria in materia di immigrazione*", in *Diritto Pubblico Comparato ed Europeo*, . Milano: Milano.

Zyra federale e migrimit, "Recepimento e trasposizione del regolamento (UE) nr. 1051/2013 che modifica il codice frontiere Schengen al fine di introdurre norme comuni sul ripristino temporaneo del controllo di frontiera alle frontiere interne", BERNË, nëntor 2013.

REGULATION (EC) No 562/2006 of the European Parliament and of the Council of 15 March 2006 in *Official Journal of the European Union L 105/1 date 13.04.2006*.

REGULATION (EU) No 1051/2013 of the European Parliament and of the Council of 22 October 2013 in *Official Journal of the European Union L 295/1, date 6.11.2013*.

COM(2011) 562 definitiv

COUNCIL REGULATION (EC) No 1683/95 of 29 May 1995 , "Laying down a uniform format for visas", *Official Journal L 164 , 14/07/1995 P. 0001 – 0004*.

COUNCIL REGULATION (EC) No 2317/95 of 25 September 1995 determining the third countries whose nationals must be in possession of visas when crossing the external borders of the Member States in *Official Journal L 234 , 03/10/1995 P. 0001 – 000*.

REGULATION (EC) NO 810/2009 of the European Parliament and of the Council of 13 July 2009 establishing a Community Code on Visas (Visa Code), *Official Journal L. 243, 15.9.2009, p. 1–58*.

COM(2010) 554 definitiv, “Raport i Komisionit për Parlamentit europian dhe Këshillin mbi aplikimin e Titullit III (kufijtë e brendshëm) të Rregullores (KE) nr. 562/2006 që krijon një kod komunitar në lidhje me regjimin e kufijve nga ana e personave (kodi kufijve Schengen”, Bruksel 13.10.2010.

COM(2012) 230 final, “Raporti dyvjeçar mbi funksionimin e hapësirës Schengen 1° nëntor 2011 – 30 prill 2012”, Komunikat e Komisionit për Parlamentin europian dhe Këshillin, Bruxelles, 16.5.2012.

COM(2014) 292 final, “Raporti pestë semestral mbi funksionimin e hapësirës Schengen 1° nëntor 2013 – 30 prill 2014”, Raport i Komisionit për Parlamentin europian dhe Këshillin, Bruxelles, 26.5.2014

LEXICOGRAPHIC REFLECTION OF PHRASEOLOGICAL ASSET IN THE DICTIONARIES OF ALBANIAN AND ENGLISH LANGUAGE

EVIS ÇELO (Ph.D)

University of Vlora "Ismail Qemali"
Faculty of Humanities
Department of foreign Languages
eviscelo@yahoo.com

Abstract

The breadth of this problem may depend on the individual's previous horizon and understanding of these relationships with the word. Based on this research, it can be seen that "Frozen-expressions (phraseology - idiom)" are very difficult elements to be considered.

A. Jashari in a voluminous vocabulary with such phraseological constructions stated that Albanian has taken the prestige language or cultural history, especially from Greek, from Latin, from Italian, from French or English. We see thus that the elements of ethno-linguistics (which means studying the connection of an ethnic culture with language that he uses as a means of communication). By dredged easily we see as the wording of the Albanian language, also in the English elements of material and spiritual culture of the peoples concerned, their features and historical development of the multiple relationships they have established with different people etc. For this and for their possession by foreigners (Albanians) could it be related to the identification of these changes, primarily because relationships tend to be semantic-lexical and generally problematic in their nature.

Key words: phrasal-unit; material; frozen structure; culture;

HYRJE

Gjuha shqipe është gjuhë me shkallë të lartë figurshmërie. Madje në popull gjallon një thënie shumë domethënëse se *gjuha kocka s'ka, por kocka thyen*. Kjo do të thotë se aftësitë emërtuese, por edhe ato vlerësuese etj. të saj janë shumë të fuqishme. Shprehëse e këtyre aftësive bëhen edhe njësitë frazeologjike. Ato ne i gjejmë të pasqyruara në të gjithë fjalorët e shqipes. Që nga Fjalori latinisht – shqip i F. Bardhit (1635) (deri tani është i pari fjalor i i mirëfilltë (dygjuhësh) dhe bëhet tregues i fillimeve të leksikografisë shqipe) ne do të gjejmë frazeologji me burime të ndryshme në faqet e dhjetëra a qindra fjalorëve. A. Jashari¹ ka botuar një fjalor të vëllimshëm me ndërtime të tilla që shqipja i ka marrë nga gjuhët me prestigj historik a kulturor, sidomos nga greqishtja, nga latinishtja, nga italishtja, nga frëngjishtja apo nga anglishtja. Madje ai ka edhe një monografi që merret mirëfilli me këtë çështje në shqipe².

Ne shohim kështu në këtë këtë prerje edhe elemente të etnolingustikës (çka nënkupton studimin e lidhjes së kulturës së një etnie me gjuhën që ai përdor si mjet komunikim). Duke qëmtuar lehtësisht ne shohim si në frazeologjinë e shqipes, ashtu edhe në atë të anglishtes elemente të kulturës materiale e shpirtërore të popujve përkatës, veçori të zhvillimit të tyre historikë, marrëdhëniet e shumëfishta që kanë vendosur me popuj të ndryshëm etj.

Për karakterin popullor të frazeologjisë, si do të shihet gjerësisht në sythet emeposhtme, flasin edhe gjymtyrët përbërëse të njësisë. Shumë prej tyre janë ndërtuar me fjalë që shënojnë sende, objekte, kafshë, shpendë, bimë, pjesë të trupit të njeriut etj. që lidhen drejtpërdrejt me jetën e njeriut dhe me mjedisin ku shqiptari shfaqet materialisht, mendërisht, shpirtërisht a estetikisht.

VEÇORI TË PASQYRIMIT LEKSIKOGRAFIK TË PASURISË FRAZELOGJIKE

Nisur nga lloji i fjalorëve, nga strukturat e përmasat vëllimore të tyre, nga profili shkencor i hartuesve (amatorë a specialistë), nga stadi kohor apo nga përvoja në leksikografi, ne frazeologjinë e shqipes e gjejmë³

a. Në fjalorët e shpjegues

b. Në fjalorët dy- e shumëgjuhësh.

Në **fjalorët njëgjuhësh** do të dallojmë Fjalorët shpjegues (Fjalorin e gjuhës shqipe, 1954, që ka qindra njësi të tilla; Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe, 1980, që ka rreth 8000 njësi frazeologjike; Fjalorin e shqipes së sotme, 1984 /

¹ A. Jashari, *Fjalor i njësive frazeologjike të huazuara*, Korçë, 2003

² A. Jashari, *Rreth përdorimit të frazeologjisë në ligjërimin e shkruar*, Korçë, 2000

³ Shih më gjerë Z. Gjocaj

2002, që ka rreth 500 njësi frazeologjike dhe Fjalorin e gjuhës shqipe të 2006 me rreth 8000 njësi frazeologjike) si dhe Fjalorët frazeologjikë (këtu vendin e parë dhe vlera të mirëfillta shkencore e leksikografike e zë Fjalori frazeologjik i J. Thomait, 1999, që ka mbi 12000 njësi frazeologjike, dhe shumë fjalorë të tjerë kombëtarë a dialëktorë, që pasqyrojnë disa dhjetëra mijëra njësi frazeologjike). Nuk po i mëshojmë shumë këtij çasti, sepse për këta fjalorë janë vlerësime e analiza të shumta e cilësore⁴. Po ndalemi te kjo pasuri e jashtëzakonshme që jo vetëm tregon pasurinë e shqipes, por e përball atë lehtësisht me çdo gjuhë të huaj, qoftë kjo edhe e nivelit të anglishtes, si gjuhë më shkallë shumë të lartë përpunimi, por edhe me një pasuri leksikore frazeologjike të jashtëzakonshme. Ne kemi folur për këtë taninë kapituajt e mëparshëm.

Në **fjalorët dy e shumëgjuhësh** ne po ndalemi në fjalorët shqip – anglisht, edhe pse deri tani janë botuar me qindra fjalorë ku shqipja përballlet me gjuhët ballkanike a evropiane.

Në **fjalorët anglisht - shqip** dallojmë dy grupe autorësh:

a. **Autorë anglezë**, ndër të cilët do të veçonim An English – Albanian Dictionary⁵ (Fjalor anglisht – shqip), Cambridge, University Press, London, 1957 të S. Mann, që ka 28.000 fjalë por edhe 10.000 idioma të anglishtes, që vinë me profesionalizëm në shqipe. Botimi i këtij fjalori vuri themelet e një shkolle moderne të hartimit të fjalorëve, kur ne nuk kishim as katedra të gjuhës angleze dhe as gjuhë letrare (standarde)⁶.

b. **Autorë shqiptarë**, ndër të cilët do të përmendnim ata që janë marrë mirëfilli me frazeologjinë si , Fjalorin frazeologjik anglisht – shqip, 1998⁷, të hartuar nga I. Stefanllari, Fjalorin Frazeologjik anglisht – shqip, 1990⁸, të hartuar prej Vejsel Nuhiut (Prishtinë). Por duhet të pranojmë se kemi shumë fjalorë cilësorë të hartuar nga R. Hyka, V. Kokona, F. Toçi, I Stefanllari, P. Qesku, H. Burniku (Shkup) e të tjerë që sjellin frazeologjinë e idiomat e anglishtes me barasvlerësit e tyre në shqip. Pavli Qesku ka botuar Fjalorin anglisht-shqip, 2002 me rreth 120.000 fjalë dhe me rreth 600.000 shembuj dhe idioma. Duhet të themi se idioma mund të gjejmë mbi 50.000 njësi. E rëndësishme është se këto idioma kanë ardhur në shqip pa probleme të përmbajtjes, pavarësisht se ato, si emi phuar edhe mw parw, nuk përkthehen fjalë për fjalë.

Edhe në **fjalorët shqip – anglisht** dallojmë dy grupe autorësh

⁴ J. Thomai, *Leksikogjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 305 -348

⁵ S. Mann, *An English – Albanian Dictionary*, Cambridge, University Press, London, 1957

⁶ Sh. Gërmizaj, *Fjalorët anglisht - shqip dhe shqip – anglisht, arritje dhe sfida*, në "Leksikografia shqipe, trashëgimi dhe perspektivë", Tiranë, 2005, f. 274

⁷ I. Stefanllari, *Fjalor frazeologjik anglisht – shqip*, Tiranë, 1998

⁸ V. Nuhiut, *Fjalor frazeologjik anglisht – shqip*, Prishtinë, 1990

a. Autorë shqiptarë, ndër të cilët do të veçonim I. Stefanllarin dhe R. Hysën me Fjalorin shqip – anglisht⁹ me rreth 20.000 fjalë e qindra njësi frazeologjike etj.; P. Qeskun me Fjalorin shqip – anglisht me rreth 45.000 fjalë e me 200.000 ilustrime e njësi frazeologjike (idioma) etj.

b. Autorë të huaj, si Oxford Albanian – English Dictionary, 2000¹⁰ apo Albanian – English Dictionary të Newmark-ut me rreth 50.000 fjalë dhe që është një nga fjalorët më të mirë të botuar nga të huajt për shqipen dhe pasurinë e saj leksikore e frazeologjike.

Lënda gjuhësore frazeologjike dhe idiomatike që është në duart e atyreve që duan të mësojnë anglishten a për qëllime studimore etj. është shumë e madhe.

Të kuptuarit e marrëdhënieve të “shprehje të ngurtësuara (frazeologji - idioma)”

Të kuptuarit e marrëdhënieve leksikore dhe gramatikore japin një problem të madh dhe akoma edhe më të madh në lidhje me studentët. Mc Intosh (1961) i konsideron marrëdhëniet leksikore me të njëjtën rëndësi me ato gramatikore¹¹.

Ai u referohet këtyre modeleve leksikore siç shkallëzohen. Nga kjo ai besonte se fjalët kanë afri (pajtueshmëri) me një tolerancë të caktuar. Për studentët njohuritë e shkallës së tolerancës mbi një fjalë, janë të vështira. Një zgjidhje e mundshme është ajo se kur studentët hasin “shprehje të ngurtësuara (frazeologji - idioma)” të reja ose të pazakonta, duhet t’i karakterizojnë fjalët sipas shkallëve të përhapjes. Kjo të jep të drejtën e tërheqjes mbi grupe paradigmatiske të reja fjalësh, në lidhje me listën e fillimit. Një shembull mund të jetë klasifikimi i fjalëve në Software, në përhapjen e rrjeteve kompjuterik të Computer Hardware. Në kërkimet e tij Mc. Intosh nxjerr në pah se si studentët procedojnë me këto “shprehje të ngurtësuara (frazeologji - idioma)” dhe shumë fjalë të tjera të përbëra.

Gjithsesi të dy Halliday & Hasan (1966) besonin se për sa kohë këto shoqërimi fjalësh ishin kaq të vështira për t’u përcaktuar duhen lënë të pandara¹².

Halliday shkoi një hap më tej dhe vendosi të fokusonte kërkimet e tij në atë se si “Shprehje të ngurtësuara (frazeologji - idioma)” janë përdorur në zhvillimin e fushës leksikore. Këto sete (grupe paradigmatiske) u themeluan nga statistika formale pa iu referuar kuptimit apo nocioneve në fushën semantike.

Sipas tij dhe Sinclair pranohet se

⁹ I. Stefanllari - R. Hysa Fjalor shqip – anglisht, Tiranë, 1988

¹⁰ Oxford Albanian – English Dictionary, Tiranë, 2000

¹¹ Mc Intosh (1961)

¹² Halliday & Hasan (1966)

1) së pari, midis fjalëve mund të jetë e pranishme një hapësirë.

2) së dyti, “shprehje të ngurtësuara (frazologji - idioma)” duket se janë gramatikusht të pavarura në tip. Ata të dy bie dakort që këto përkufizime gramatikore janë të rëndësishme, por ishte Halliday i cili paralelizoi **strukturën sintagmatike** me **sistemin paradigmatic** dhe i ndau ato nga setet e “shprehje të ngurtësuara (frazologji - idioma)” në leksik. Këto sete mund të përdoren si homonime. Sinclair bie dakort në një pikë, por ai lejoi ndodhjen e një çifti polisemik, n.q.s. grupet e “shprehje të ngurtësuara (frazologji - idioma)” mund të të japin mundësinë për të bërë dallimin midis setit leksikor të vërtetë, d.m.th **soccer field** (fushë futbollit) dhe **baseball field** (fushë beisbollit) dhe një seri leksikore siç janë **table top** (sipërfaqe e tryezës) dhe **desk top** (sipërfaqe e bankës), e cila na çon te “shprehje të ngurtësuara (frazologji - idioma)” *sipërfaqe për tastierën e kompjuterike*¹³.

Gjithsesi ata të dy bien dakort që për të përshkruar fjalorin e një gjuhe është vërtetë një punë e vështirë. Duke u bazuar në këtë kërkim, mund të shihet që “shprehje të ngurtësuara (frazologji - idioma)” kanë shumë elemente të vështira për t’u marrë në consideratë. Këto elemente mund të shkaktojnë probleme për studentët e huaj që mësojnë gjuhën angleze. të cilët përpiqen që të kuptojnë sa më qartë dhe të mësojnë marrëdhëniet e shprehjeve frazeologjike me standardin dhe komunikimin gjuhësor.

1. Kjo u referohet njohurive ordinere të përshtatshmërisë së të folurit sipas gjuhës standarde si pjesë e kompetencës së folësve vendas. Në rastin kur anglishtja mësohet si gjuhë e huaj, si një gjuhë specifike, kjo përshtatshmëri mund të mos jetë e vendosur patjetër si detyrim universal.

2. Një tjetër faktor për t’u marrë në konsideratë është mosha. Aitchson (1987) gjeti se fëmijët e së njëjtës moshe ishin në gjendje të pranëvendosnin fjalët sipas valencave leksikore semantike e sintaksore. Kjo kompetencë rritet me rritjen e fëmijës anglishtfolës. Kjo kushtëzohet edhe nga faktorë të tjerë shkencorë, etnikë, sociolinguistikë etj. Në kërkimet dhe eksperimentet u zbulua se fëmijët e kishin më të mundshme të shoqëronin fjalët në mënyrë paradigmatiche kur ishin të vegjël dhe në mënyrë sintagmatike kur rriten.

3. Një tjetër gjetje sinjifikative mund të jetë një plus në efikasitetin e mjeshtërive të përtëritjes. Gjithsesi, argumenti qëndron në faktin se si fëmijët zhvillojnë nevojën për të proceduar dhe për të përmirësuar fjalët teksa fjalori i grupeve paradigmatiche bëhet akoma më i madh.

Në kërkimet e tij Alexander¹⁴ (1984) gjithashtu i ka gjetur këto probleme në mësimdhënien për studentë ku anglishtja është L2.

1. Duhet kontekste dhe informacione të nevojshme lidhur me shpëstësinë dhe qarkullimin e modeleve të veçantë foljore.

¹³ Halliday & Hasan (1966)

¹⁴ Alexander (1984)

2. Duhet rinjohje kur grupet foljore janë ose të ngurtësuara ose qartësisht të të ngurtësuara, çka janë shumë të vështira për t'u ndërtuar nga studentët.

3. Grupi i idiomave të vështira siç janë go = shko / give = jap / break = thyej / hit = godas / take = marr dhe read = lexoj, kanë zgjerim valencash por nuk tërësisht të hapura.

Ruhl (1979) argumenton që problemi i shtrirjes së idiomave duhet të zgjidhet nga leksikografët. Ai beson që shtirja e idiomave dhe polisemia janë duke atribuar faktorë dhe pika më kryesore bindëse në këtë çështje mbetet e njëjtë. Le të marrim një shembull: **cut away** duhet të hiqet mënjanë; **cut some corners** t'i shkurtosh ca vogëlsira; **cut to the chase** të presësh kërkimet). Të gjitha këto përmbajnë fjalën cut, por ato variojnë intesivisht në kuptim dhe në kontekst.

Për folësit vendas keto janë shprehje idiomatike shumë ordinere, por për studentët e gjuhës së huaj, ato sjellin shumë lehtësisht një multikonfuzion literal.

PERFUNDIME

Në shqipe përmes përdorimit të frazeologjisë nga njëri a nga tjetri folës realizohemi si mbartës të kësaj etnografie. Frazeologjia është shprehëse e shpërfaqëse e mirëfilltë e saj. Pjesa dërrmuese e këtij thesari vjen nga goja e popullit, nga aftësia krijuese e tij, dhe aty lehtësisht duken gjurmët e etnosit shqiptar. Të njëjtën dukuri e vërejmë edhe në anglishte, edhe pse një numër shumë i madh idiomash e frazeologjish të kësaj gjuhe janë ngurtësime sintagmash që vijnë nga regjistra të lartë komunikimi, a më saktë nga ligjërimet librorë e nga anglishtja e Mesjetës dhe e kohëve moderne, sidomos e kohëve moderne e cila ndikon dukshëm gjuhën shqipe jo vetëm kohë pas kohe, por çdo orë dhe minutë në të gjitha parametrat e saj.

Si njësi gjuhësore, frazeologjia ka vlera të pallogaritshme për gjuhën e ligjërimin, duke u dhënë atyre një pasuri dhe një ngjyrim të rrallë. Ajo e bën gjuhën më të plotë, kurse ligjërimin më të zhdërvjelltë, më të këndshëm. Ato shfaqen me vlera të fuqishme stilistikore dhe janë karakteristike e të gjitha ligjërimeve dhe stileve funksionale të shqipes¹⁵. Më të spikaturit këtu janë ligjërimi i shkujdesur dhe ai bisedor.

Frazeologjia shqipe ka karakter të theksuar popullor dhe mbartja e kësaj vlerë me studentët tanë mbetet ende i vështirë. Gjuha e folur popullore ose varieteti i të folurit popullor¹⁶ është shumë e pasur me njësi të tilla. Gjuha e

¹⁵ Xh. Lloshi, *Stilistika e pragmatika*, Tiranë, 1999

¹⁶ Gj. Shkurtaç, *Sociolinguistikë*, Tiranë, 1996, f. 106

folur është më e pasur me frazeologji dhe një pjesë e qenësishme e tyre duhet pashmangshmerisht të thithen fuqishëm nga gjuha e shkruar dhe njekohesisht te standardizohen sa më shpejt si në sistemet parauniversitar dhe në ato unversitar,për të mbajtur gjallë shqipen, të pamanipulueshme nga anglishtja,të pasur e me ngjyrime sa të rralla aq edhe bashkëkohore.

DEMOKRACIA SI PRODUKT I ZHVILLIMIT TË SHOQËRISË

Dr. Ferit BAÇA

Departamenti i Filozofisë, Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës

Abstrakt

Teoritë dhe ëndrra mbi demokracinë kanë qenë dhe do të mbeten tryeza e begatë e dijeve filozofike që do të kërkojnë një angazhim të përhershëm të filozofëve dhe studiuesve me masat e thjeshta njerëzore për të hartuar perspektivën e tyre. Kjo është edhe arsyeja pse demokracia ka fituar në epokën tonë moderne rolin e diellit jetëdhënës. Sistemet dhe epokat jashtë principeve demokratike janë sinonime të shoqërive obskurantiste e skllavëruese. Shqyrtim ynë teoriko-filozofik mbi demokracinë ndalet në periudhën e antikitetit në Greqi, kur u hodhën dhe bazat e demokracisë dhe vijon me thellin e përpjekjeve të shoqërisë njerëzore për realizimin e një ëndrre sa të vjetër aq edhe të re. Qysh atëherë, horizonti i demokracisë ka zgjuar tek studiuesit, filozofët, deri tek njeriu më i thjeshtë i globit, idenë e shndërrimit të saj nga një ëndërr dhe prespektivë, në një realitet që ngrihet mbi qeverisjen e një sistemi të harmonizuar. Askush më shumë se nocioni i demokracisë nuk zotëron një burim të pashtershëm idesh dhe nuk i siguron popullit një vizion dhe realitet që buron nga roli i masave në histori për përparimin e shoqërisë njerëzore. Teoritë ekzistuese dhe ato të së ardhmes rreth problemeve të demokracisë do të mishërojnë në vetvete thelbin e zhvillimeve politiko-filozofike në kohë dhe në hapësirë. Si shfaqja ashtu edhe thelbi i teorive dhe ndërtimit të demokracisë, do të kërkojnë t'i përgjigjen rrjedhës së kohës, duke u përsosur e harmonizuar hap pas hapi, pa njohur kthim pas.

Punimi vijues përmbledh disa prej teorive të autorëve më të njohur mbi nocionet e "Demokracisë". Metodologjia e trajtimit ndjek një shqyrtim dialektik të raporteve midis tyre, jo vetëm si unitete, por edhe në lëvizje e ndryshim të pandërprerë.

Fjalët çelës: Demokracia, përfaqësimi, liria, qeverisja, zgjedhje, etj.

DEMOCRACY AS A PRODUCT OF SOCIAL DEVELOPMENT

Abstract

Theories and desires about democracy have been and still remain the prosperous around table of philosophical knowledge that still require a permanent commitment of philosophers and scholars discussing with the majority of the people about new perspectives of democracy. This is the reason why democracy is considered as the best governance system in our modern era same as the sun's life-giving role. The implementations of different political systems without applying democratic principles are synonymous with slave societies. The theoretical and philosophical explanation about democracy begins with the ancient era of Greece, which laid down the bases of democracy and continues to deepen human society efforts for the achievement of good and stable democracy. Thus, since then, the horizon of democracy has taken the attention of the researchers, philosophers and all the people of the globe, the idea considering it as a perspective dream in a reality that builds on the governance of a harmonized system. No one then the notion of democracy possess an inexhaustible source of ideas and does not provide people a vision and reality that stems from the role of the masses in the history of the progress of human society. Present theories and those of the future about the problems of democracy itself still embody the essence of developments philosophical and Political one in time and space. The essence of theories and building democracy, still seek to respond course of time, by perfecting and harmonizing it.

The following paper summarizes some of the views of distinguished authors about the concepts of "democracy". The methodology follows a dialectical explanation on their relationship, not only as a unity, but also as a continuous movement and change.

Keywords: Democracy, representation, freedom, governance, voting, etc.

Hyrje

Botkuptimi teorik i demokracisë është e lidhur ngushtë me problemet e qeverisjes së popullit, me ndarjen dhe kategorizimet e saj. Përmbajtja e demokracisë mishëron rolin dhe kuptimin që i ka dhënë Abraham Linkoln: *"Një qeverisje e popullit, nga populli dhe për popullin"*, e cila ka si parakusht qeverisjen e popullit, vlerat e të cilës përcaktojnë edhe sistemet politiko – shoqërore. Në thelb demokracia është një formë qeverisjeje, regjim apo sistem politik, ku pushteti ushtrohet nga populli drejtpërdrejt nëpërmjet organeve të zgjedhura me votën e lirë, ku shtetasit gëzojnë liri të plotë dhe të drejta të barabarta. Demokracia nënkupton një formë të caktuar drejtimi apo qeverisjeje që realizohet në emër dhe në interes të shumicës. Forma më e pjekur e saj zbatohet në vendet ku zhvillohet një shoqëri pluraliste dhe pushtetet ekzekutivi,

legjislativi dhe gjyqësori në veprimtaritë e tyre, janë të ndara dhe të pavarura, me qëllim që askush nga drejtuesit e shtetit të mos ketë një pushtet të pakufizuar dhe të pa kontrolluar.

Ndonëse gjatë epokave të ndryshme historike format e qeverisjes kanë evoluar; nga demokracia e drejtpërdrejt, në demokracinë përfaqësuese, roli i pjesëmarrjes së qytetarit mbetet përcaktues, madje nga ky këndvështrim, pjesëmarrja e tij në hartimin dhe zbatimin e ligjeve për qeverisjen e shoqërisë përbëjnë thelbin e demokracisë moderne. Sado ndryshime që do të ushtrojnë kushtet e zvillemeve në shoqërinë moderne, ato nuk mund të shkatërrojnë gjenezën e sistemit të demokracisë e cila mbetet pjesëmarrja dhe qeverisja e drejtpërdrejt e qytetarëve. Kështu edhe vetë demokracia e përfaqësuar, është një formë përshtatjeje e saj, dhe jo “një armike” e demokracisë së drejtpërdrejtë. Edhe parimet e demokracisë së përfaqësuar kërkojnë praninë e qytetarit të lirë për të zgjedhur formën e qeverisjes. Kushtet e një shoqërie moderne kanë “prodhuar” e pranuar formën e demokracisë përfaqësuese duke ia shtuar vlerat asaj në kushtet e një shoqërie globale.

Sikurse çdo fenomen tjetër jetik demokracia përballet me “armiqtë” e saj të përjetshëm; së pari dhe mbi të gjitha me “demokracinë e shumicës” që në këtë kuadër shndërrohet në një “diktaturë të shumicës” për pakicën, kur njerëzit e zgjedhur nga populli, në emër të popullit, nxjerrin ligje që favorizojnë vetëm përfaqësuesit e zgjedhur nga populli, me etjen për sundim, me pabarazitë sociale, me ndryshimet dhe diferencat kulturore, ekonomike dhe pabarazi të tjera të cilat do t’i vinte në dukje Rusoi në veprën e tij “Origjina e pabarazisë mes njerëzve”: *“I tillë ishte fillimi i shoqërisë dhe i ligjeve, që i dhanë shtrëngesa të reja të dobët dhe fuqi të reja të pasurit, rrënuan njëherë e përgjithmonë lirinë natyrore, ngulitën në mënyrë të përhershme ligjin e pronësisë dhe të pabarazisë, prej një përvetësimi të dhunshëm dhe të guximshëm, nxorrën një të drejtë të pakthyeshme dhe, për hir të përfitimit të ndonjë ambiciozi, ja nënshtruan më në fund të gjithë gjininë njerëzore punës, robërisë dhe mjerimit.”*¹

Niveli dhe ekzistenca e shkallës së lirisë dhe e demokracisë nuk janë atribut i një individi të vetëm, qoftë edhe kur ai luan një rol të shquar dhe të rëndësishëm në historinë e një populli, por janë vepër e pjesëmarrjes së qytetarëve të cilët luajnë një rol të pazëvendësueshëm në ndërtimin dhe në mbrojtjen e vlerave themelore të tyre. Me pak fjalë, demokracia mbetet zbatimi dhe mishërimi i lirisë në jetën demokratike të një populli. Mbi bazën e këtyre dy shtyllave themelore të shoqërisë ngrihen sistemet politike të pushteteve, përkatësisht: të ekzekutivit, të legjislativit dhe të gjyqësorit.

¹ Ruso Zhan Zhak. “Origjina e Pabarazisë mes Njerëzve” Botimet “Almera” Tiranë 2008. F.109-110

Demokracia lulëzon atëherë kur në roje të fatit të saj janë vetë qytetarët të cilët janë të gatshëm të marrin pjesë në jetën shoqërore duke shprehur mendimet e tyre në debate; duke zgjedhur përfaqësues që e kanë treguar veten të denjë me veprimet e tyre; dhe duke pranuar nevojën e tolerancës dhe të kompromisit në jetën shtetërore.

Vizione filozofike mbi demokracinë

Ndonëse në thelb praktika dhe përmbajtja e termit “Demokraci” ka të bëjë me vlerat, virtytet dhe praktikën e zbatimit të saj, etimologjia e fjalës demokraci vjen nga fjala demos - popull, dhe nga fjala tjetër, kratos - forcë, pushtet. Pra, qeverisje e popullit. Demokracia si “pushtet i popullit” është një ideal i lashtë dhe me kohështrirje të gjatë historike. Formulimet dhe nocionet e mendimtarëve të antikitetit përcjellin tek ne jo vetëm kuptimet e tyre mbi demokracinë dhe lirinë, por edhe procesin dinamik e dialektik, që iu desh të përshkojë nëpër kohë. Kështu përshembull, Perikliu e lidhte kuptimin e demokracisë me tolerancën, por jo me sundimin e shumicës.

Interes të veçantë paraqesin konceptet e Platonit mbi demokracinë që i frikësohej kontrollit të qeverisjes nga demagogët populist. Ndërsa Aristoteli i trembej qeverisjes nga populli, koncept që sipas tij nënkuptonte qeverisjen nga të varfërit, nga të cilët mund të pritej edhe shpronësimi i të pasurve. Edhe filozofët Hobbes-i dhe Lock, me nocionin demokraci nënkuptojnë barazinë politike të qytetarëve, por asnjëri prej tyre nuk nxjerr shprehimisht konkluzione në favor të demokracisë. Përkufizimi i Lincolnit, “Një qeverisje e popullit, nga populli dhe për popullin” e trajton demokracinë më shumë si një kauzë dhe aspiratë udhëheqëse të popullit se sa një mundësi reale. Dhe, me të vërtetë, historia dhe rruga që ka ndjekur zhvillimi i demokracisë nëpër kohë, është rruga e kalimit dhe realizimit nga ëndrra, si një aspiratë frymëzuese e popujve për një shoqëri demokratike, në shndërrimin e saj në një realitet.

Ndërkohë, parimet dhe vlerat që përbëjnë themelet e institucioneve moderne pa të cilat nuk ka demokraci, si liria politike, votimi i përgjithshëm, pluralizmi politik dhe asambleja përfaqësuese kanë pak shikuj që janë krijuar. Trashëgimia e vyer mbi demokracinë, si dhe konceptet e mendimtarëve e studiuesve të sotëm bashkëkohorë, nxjerrin në pah si elementët kryesorë teorikë me përmbajtje filozofike, politike dhe juridike, ashtu dhe vlerat jetësore si një sistem real e funksional.

Gjatë gjithë historisë njerëzore pushtetarë të ndryshëm kanë luajtur me kuptimin që i kanë dhënë demokracisë për të mbuluar me një petk të rrejshëm regjimet e tyre totalitare dhe diktaturat si dhe për të mashtruar dhe fituar mbështetjen e popullit, në një kohë kur ata vetë kontrollonin me mjetet e dhunës çdo qelizë të jetës së përditshme të vendit të tyre duke shkelur në mënyrën më abuzive parimet e saj themelore. Një veçanësi në lëmin e

pikëpamjeve mbi demokracinë paraqesin ato të filozofit italian, Makiavelit. Ai ishte për vendosjen e një republike ku autoriteti i sovranit t'u përkiste disa nëpunësve e gjykatësve, disa njerëzve me talent dhe kurajo që nuk e kishin as të trashëguar, as të përfituar me intriga apo me dhunë, por këtë autoritet e kishin fituar nga zgjedhjet e lira të bashkëqytetarëve të tyre.

Një sistem politik quhet demokratik kur njerëzit që e përbëjnë atë gëzojnë liritë njerëzore dhe të drejtën e votës. Ndonëse fjalët liri dhe demokraci të kujtojnë parimin e punës së enëve komunikuese dhe kanë një lidhje organike midis tyre, ato nuk janë sinonime të njëra - tjetrës. Dhe kjo, për shkak se struktura e demokracisë përbëhet jo vetëm nga sistemi i ideve dhe koncepteve të trashëguara teorike që pasurohen në laboratorin e gjallë të jetës së popujve, por edhe nga mënyra e vënies së tyre në jetë. Historia e shoqërisë njerëzore njih dy tipe demokracish:

Demokracia e drejtpërdrejtë: që bazohet në parimin e “qeverisjes nga populli”, që do të thotë se, populli vetëqeveriset dhe merr vendime të rëndësishme për jetën e tij dhe fatin e shoqërisë ku jeton. Kjo lloj demokracie e konsideruar si demokraci e pastër ka ndikuar shumë në teoritë dhe formulimet e pikëpamjeve të Rusoit dhe të Marksit. Gjithashtu, demokracia e drejtpërdrejtë mishiron anët e saj pozitive, sepse i jep sistemit demokratik vlerën e një demokracie që ushtrohet dhe zbatohet drejtpërdrejtë nga populli duke pasqyruar vetë thelbin filozofik të demokracisë; “si një demokraci e popullit dhe për popullin”, gjatë zbatimit të së cilës pushteti politik i shpërndahet atij në mënyrë sa më të barabartë. Model i demokracisë së drejtpërdrejtë vazhdon të jetë i efektshëm edhe sot në disa vende të botës, si në Amerikë e Zvicër dhe shërben si bazë e zhvillimit të referendumeve.

Demokracia përfaqësues: e cila paraqet formën e demokracisë më të përhapur në ditët tona ku qytetarët, zgjedhin drejtuesit e jetës politike, që hartojnë ligjet dhe zbatojnë programet social - ekonomike të vendit. Duke qenë se përfaqësimi dhe zbatimi i programeve të partive të ndryshme politike kërkojnë njerëz të kualifikuar dhe me nivel të lartë intelektual, në shumicën dërrmuese të zgjedhjeve, janë ata që zgjidhen si përfaqësues të popullit.

Në kushtet e një shoqërie moderne demokracia mishëron tipare të ndryshme nga ajo që u realizua në shoqërinë e Athinës, duke ruajtur karakteristikat e një demokracie përfaqësuese, pluraliste dhe që bazohet mbi konceptin e shtetësisë. Ndryshimi themelor me demokracinë e drejtpërdrejtë qëndron në faktin se, vendimet politike ndërmerren nga organet përfaqësuese dhe vetëm në disa raste të veçanta nga populli, siç është rasti i referendumeve. Por, me gjith nevojën për ndryshime dhe përsosje të demokracisë, nuk mund të mos vëmë në dukje se, themeli bazë i saj mbetet kërkesa për të realizuar përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të popullit edhe në kushtet kur të zgjedhurit ushtrojnë pushtetin në emër të tij. Demokracia është sistemi që garanton dhe harmonizon detyrat dhe të drejtat e

individit me ato të shoqërisë. Të drejtat përbëjnë elementet më themelor dhe ndërtues të një qeverisjeje demokratike.

Në zbatimin e demokracisë përfaqësuese shtetasit që votojnë, nuk marrin vendime për organizimin e jetës së tyre, por ua delegojnë këto të drejta përfaqësuesve të tyre. Megjithë avantazhet e mëdha që paraqet demokracia përfaqësuese, ajo nuk i ka shpëtuar vërtetjëve të Rusoit, që vinte në dukje me dëshpërim: *“Sido që të jetë, nga ai çast kur një popull i dorëzohet përfaqësuesve nuk është më i lirë”*.¹

Liria - premisë themelor i demokracisë

Në çdo epokë historike, marrëdhëniet e njerëzve me lirinë kanë qenë dhe mbeten objekt i studimeve filozofike, për të cilat janë shfaqur mendime të ndryshme. Liria, si e drejtë natyrore është thelbi i të menduarit sipas bindjeve individuale dhe vullnetit të lirë. Koncepti i lirisë përbën treguesin thelbësor të zhvillimit të një shoqërie dhe të qytetarëve të saj në raport me kufizimet përballë të gjitha pushteteve; atij ligjëvënës, ekzekutivit dhe gjyqësorit. Koncepti i lirisë sipas filozofit gjerman, Niçe, i pasuron, thëllon dhe i zgjeron kufijtë e saj: *“Liria është vullneti që të bën përgjegjës ndaj vetvetes, që ka për veti të të distancojë dhe të të veçojë nga ndikimet e të tjerëve për një pavarësi mendimi unik mbi ekzistencën”*.²

Në një kuptim më praktik, liria nuk është gjë tjetër veçse dëshira për të përmbushur apo realizuar nevojat dhe dëshirat tona, në raport me mundësitë dhe realitetin në të cilin jetojmë. Në veprën “Traktat teologjik politik” botur në 1670, filozofi hollandez Spinoza, pohon se: *“Një popull, apo një trup publik qytetarësh, është një shumicë njerëzish, që përmes një pakti social vepron sikur të ishte e drejtuar nga një mendje e vetme.”*

Ideja e mësipërme e Spinozës shpreh hapur pikëpamjen se, sovraniteti i një shteti rrjedh nga populli. Individët i binden pa kushte shtetit të tyre, ndonëse e drejta e mendimit nuk mund të kufizohet, sepse ata gëzojnë të drejtën e arsytimit dhe të gjykimit sipas mendjes së tyre. Spinoza do të paralajmëronte se *“kur një qeveri kërkon t’u kufizojë lirinë e të menduarit dhe të fjalës qytetarëve të saj edhe kur ata i respektojnë ligjet, vepron në mënyrë të paarsyeshme dhe vë në rrezik ekzistencën e saj”*. Duke parashtruar pikëpamjet të tilla mbi vlerat dhe rreziqet që kërcënojnë lirinë, ai do të nxirrte përfundimin se: *“Sa më shumë një popull pranon dhe merr pjesë në ushtrimin e pushtetit politik, aq më shumë i fuqishëm është ai shtet”*. Këtu e ka burimin pranimit të parimit të

¹ Ruso Zhan Zhak. “Origjina e Pabarazisë mes Njerëzve” Botimet “Almera” Tiranë 2008. F. 313

² Nietzsche, Friedrich. *Vullneti për pushtet*. Përk. Gazmend A. Bakiu. Tiranë: Shtëpia Botuese “Marin Barleti”. 1999. F. 28

opozitarizmit dhe i mendimti të kundërt si shprehje e demokracisë për të gjithë anëtarët e një shoqërie, pavarësisht përkatësisë partiake, për të triumfuar arsyeja mbi pasionet, në mbrojtje të interesave të përbashkëta. Për Spinozën, demokracia do të ishte regjimi më natyral, sepse garanton lirinë që natyra i ka dhënë çdo njeriu dhe realizon më së miri qëllimet e shtetit, sepse, përmes kuvendeve të lirshme, populli i jep vetes ligjet që do ta qeverisë dhe më pak arbitrare.

Rusoi besonte se një qeverisje e mirë duhet të ketë si objektiv themelor lirinë e qytetarëve të saj. Ndaj sipas tij, forma më e mirë e qeverisjes në një shoqëri moderne është ajo që afirmon lirinë individuale të të gjithë qytetarëve, me kufizimet e natyrshme në një shoqëri civile. Por Rusoi arriti gjithashtu në përfundimin se: *"Për aq kohë sa e drejta e pronës dhe ligjet ekzistojnë, njerëzit kurrë nuk mund të jenë tërësisht të lirë në shoqërinë moderne."*¹ Megjithatë, ai besonte fuqimisht në ekzistencën e disa parimeve të qeverisjes që, nëse vihen në jetë, mund të sigurojnë për anëtarët e shoqërisë një nivel të lirisë që së paku përafron lirinë që gëzohet në shtetin e gjendjes natyrore të njeriut.

Në veprat e tij filozofike, Rusoi përshekruan parimet e nevojshme që duhet të zbatojnë institucionet shoqërore, në krye të të cilave ai përcakton ruajtjen e lirisë "natyrore". Ndaj theksonte: *"Të hiqet dorë prej lirisë vetjake do të thotë të hiqet dorë prej cilësisë vetjake si njeri, prej të drejtave të natyrës njerëzore, deri dhe prej detyrave të tij."*² Por ndërkaq konceptet e tij mbi lirinë dhe demokracinë ai i lidhi pazgjidhmërisht me vendosjen e një shteti ligjor, pra të ligjit, i cili, mbi të gjitha, është rezultat i vullnetit të përgjithshëm, ku vullneti i përgjithshëm është edhe dëshira e sovranit, e popullit. Duke dëshmuar një vlerësim për ligjin si një vlerë të shenjtë, Rusoi do ta shtrinte këtë vlerësim në tërësi për të gjithë pushtetin e ligjeve, ndalimin e veprimtimit të të cilit ai e justifikon vetëm atëherë kur bëhet fjalë për të shpëtuar atdheun.

Rusoi konstaton se shumë prej ideve të tilla; si prona, ligji dhe pabarazia morale, që i janë imponuar njeriut, në të vërtetë nuk e kanë bazën në natyrën e tij. Karakteristika më e rëndësishme e shtetit në gjendjen e natyrës së lirë është se njerëzit e gëzojnë lirinë e plotë fizike dhe janë të lirë për të bërë në thelb atë që dëshirojnë. Rusoi alternon të mirat dhe mangësitë e shtetit në gjendjen e natyrës së lirë, por në përgjithësi ai e vlerëson atë për lirinë fizike që i garanton njerëzve, duke i lejuar ata të jenë të pangarkuar nga ndikimi detyrues i shtetit dhe i shoqërisë. Përfytyrimin e tij për një shoqëri demokratike Rusoi e kushtëzoi në kërkesën: *"Të gjendet një formë shoqërizimi e cila mbron dhe ruan, duke shfrytëzuar të gjithë forcën e përbashkët, personin dhe pasuritë e çdo"*

¹ Nga interneti : <http://www.sparknotes.com/philosophy/rousseau/section1.rhtml>

² Ruso Zhan Zhak. "Origjina e Pabarazisë mes Njerëzve" Botimet "Almera" Tiranë 2008. F.195

anëtari; shoqëri në të cilën, secili, dhe duke iu bashkuar të gjithë të tjerëve, t'i bindet me gjithatë veçse vetvetes, dhe të mbetet i lirë njëlloj si më parë.”¹

Të drejtat e të gjithë individëve garantohen prej faktit që ata janë pjesë e vendimmarrjes, por mbi të gjitha prej ekzistencës së vullnetit të përgjithshëm, i cili duke synuar të mirën e përbashkët domosdoshmërisht synon edhe lirinë e gjithsecilit që është kushti themelor i së mirës së përbashkët. Megjithatë, koncepti i lirisë në një vend demokratik përkufizohet si një e drejtë që lejon atë që të lejojë ligjet e miratuara nga shoqëria dhe organet e zgjedhura nga populli. Në këtë kuptim, mbërrijmë në përfundimin se një popull është i lirë, kur qeveriset nga ligjet që vetë ai ka përcaktuar.

Përfundime

Edhe pse demokracia ka pësuar ndryshime thelbësore, ruan ende vlerësimin se, ajo përfaqëson nevojën e popullit për t'u qeverisur, meqenëse ai nuk i ka aftësitë qeverisëse, ndaj zgjedh përfaqësuesit e partive dhe grupimeve politike në organet drejtuese legislative. Duke i hedhur një vështrim të shpejtë koncepteve të hershme mbi demokracinë dhe regjimeve të aplikuara në qytetet - shtete të greqisë së lashtë, vëren me lehtësi ndryshimet thelbësore që ka pësuar në formë dhe përmbajtje ajo.

Në vizionin e filozofëve dhe mendimtarëve të të gjitha kohërave demokracia e mirëfilltë paraqitet në formën e një spiraleje pa fund. Ajo, as ka ekzistuar dhe as nuk do të ekzistojë ndonjëherë, siç nënvizon Zh.Zh.Ruso: *“Në se do të ekzistonte një popull perëndish, ai do të qeverisej demokratikisht. Një qeverisje kaq e përkryer nuk i shkon përshtat natyrës së njerëzve”*². Ndonëse iluzioniste, njësoj si horizonti optik apo nocioni i lumturisë, të cilat, nuk mbërrihen asnjëherë, ato shndërrohen në një qëllim dhe objektiv progresiv drejt së ardhmes për një shoqëri më të drejtë dhe më të mirë.

Sot Demokracia është pasuruar, rishikuar dhe përpunuar në përputhje me kërkesat e kohës dhe të vetë popujve. Termi demokraci përdoret sot jo vetëm për të karakterizuar marrëdhëniet politike në një shoqëri të caktuar, por edhe për të gjykuar e përcaktuar formën e qeverisjes, karakteristikat e sistemit politik, etj. Sidoqoftë, eksperiencat botërore dëshmojnë se demokracia mbetet sistemi më i mirë qeverisës që buron nga populli dhe i shërben atij.

Bibliografia

¹ Po aty. F.202

² Ruso Zhan Zhak. “Kontrata Sociale”. Luarasi “University Press” Tiranë 2007. F.92

- Giovanni Sartori. 1998 *“Edhe një herë për teorinë e demokracisë”*, Shtëpia Botuese “Dituria”, Tiranë.
- Nietzsche, Friedrich. 1999. *“Vullneti për pushtet”*. Përk. Gazmend A. Bakiu. Tiranë. Shtëpia Botuese “Marin Barleti”.
- Ruso, Zhan Zhak. 2007 . *“Kontrata Sociale”*. Botimi i IV. Përk. Lazan Koldashi. Tiranë: Luarasi University Press.
- Ruso, Zhan Zhak. 2008. *“Origjina e Pabarazisë Sociale mes Njerëzve”*. Përk. Qemal Velia. Tiranë: Botimet “Almera”.
- Nietzsche, Friedrich. 1999. *“Vullneti për pushtet”*. Përk. Gazmend A. Bakiu. Tiranë. Shtëpia Botuese “Marin Barleti”.
- Toqueville Alexis. 2002 *“Demokracia ne Amerike”*, Fondacioni Soros, Tiranë

A MANIFESTOJNË SJELLJE TË KONTROLLUARA NDAJ RISKUT, NË JETËN E TYRE TË PËRDITSHME, QYTETARËT DHE FAMILJARËT NË VENDIN TONË?

Fjona Zeneli

Student Doktrature FEUT, Tiranë

Lektor në FE, Universiteti „Ismail Qemali“ Vlorë

fjona.zeneli@gmail.com

Abstrakt

Ka disa faktorë që përcaktojnë dhe formëzojnë të shfaqurit e një sjellje të veçantë. Ato klasifikohen si faktorë të brendshëm (si përshembull njohuritë) dhe si të jashtëm (mbështetja sociale), të cilët janë instrumentat e të kuptuarit të sjelljeve të manifestuara (Cole et al.,1992). Punimi është ndërtuar me qëllimin kryesor të identifikimit të sjelljeve mbrojtëse ndaj risqeve të qytetarëve shqiptarë. A e kanë ata përcëptimin e të siguarit të jetës, pasurisë në funksion të një të ardhme më të parashikueshme e të mbrojtur? A manifestojnë ata sjellje të kontrrolluara ndaj riskut, në çdo aspekt të jetës? Metodologjia e përdorur përqëndrohet në analizën përshkruese dhe krahasimore të statistikave të grumbulluara, por edhe në lidhje regresive mes variablave të përzgjedhura si shpjegues të sjelljeve të caktuara në lidhje me risqet, në çdo formë të shfaqjes së tyre.

Fjalë kyçe: sjellje risikoze, faktorë përcaktues, mbrojtje ndaj riskut.

Abstract

There are several factors that define and reshape the manifestation of a particular behavior. They are classified as internal factors (i.e knowledges) and external (i.e social support), which are instruments of understanding manifested behavior (Cole et al., 1992). The article is designed to identify risks protective behavior of Albanian citizens. Does have they the perception of an insured life, property for a more predictable and protected future? Does they manifest controlled risk behavior in every aspect of life?

The methodology used in the analysis is focused on comparative descriptive statistics collected, but also on regression/correlation analysis between the explanatory variables selected related to risks in any form of occurrence.

Keywords: riskier behavior, determining factors, risk protection.

1 Hyrje

Jeta është plot me risqe. Secili nga ne çdo ditë merr vendime për përfitime të caktuara, kur kushtet rrethuese të mjedisit janë gjithnjë e më shumë të pasigurta. Duke u përballur me këto rrethana njerëzit kanë zhvilluar sjellje dhe strategji që e lejojnë jetën „të rrjedhë“ për sa më shumë kohë. Vetëm në prani të riskut jo të zakonshëm njerëzit ndërjegjësohen për domosdoshmërinë e bërjes së një zgjedhje.

Ka disa faktorë që përcaktojnë dhe formëzojnë të shfaqurit e një sjellje të veçantë (Cole et al.,1992). Sa më të identifikueshëm të jenë këta faktorë, sa më shumë informacion të ketë për ta, aq më e lehtë është për individin të kontrryollojë efektet ndikues të tyre në (mos)shfaqjen e një sjellje të caktuar rriske. Punimi nis me një rishikim kritik të literaturës që ka trajtuar teorikisht dhe empirikisht faktorët ndikues në një sjellje të individit. Këta faktorë ndahen në dy kategori të mëdha dhe qëllimi i këtij seksioni është njohja sa më me imtësi e tyre (edhe nga këndvështrimi psikologjik; sjellja është produkt edhe i këtij të fundit). Seksioni i rradhës trajton koncepte teorike mbi temën e trajtuar. Seksioni pasues përmbledh gjithë analizën grafikore, korrelative dhe regresive të treguesve të disa sjelljeve rriske të qytetarëve shqiptarë. Seksioni është ndarë në tre nënçështje, ajo e shëndetit dhe moshës së shoqërisë, edukimit dhe kulturës së sigurimit të qytetarëve. Në fund jepen përfundimet e përmbledhura të punimit.

2 Kuadri teorik, konceptet

Të ndërmarrësh përsipër riskun është tendenca për të përqaftuar sjellje me potenciale dëmtuese apo të rrezikshme po në të njëjtën kohë sigurojnë oportunitete për përfitime që perceptohen të jenë pozitive. Të ngasësh me shpejtësi, të konsumosh substanca të ndaluara apo të luash bixhoz janë shembuj të sjelljeve që ndërmarrin risk. Ato mund të sjellin ndjesi të mira në fillim, por ndërkohë e vendosin individin në situata të rrezikshme. Shmangia e riskut është një koncept i ekonomiksit dhe financës, bazuar në sjelljet e individëve që ekspozohen ndaj pasigurisë dhe tentojnë t'a reduktojnë atë. Individët janë shmangës të riskut kur e evitojnë atë, preferojnë më shumë siguri dhe janë të gatshëm të paguajnë më shumë vetëm për të patur sigurinë se risqet e padëshirueshme nuk do të jenë pjesë e jetës së tyre. Një kërkues risku, është personi që jo vetëm kërkon të maksimizojë vlerën për çdo veprim por si një „lojtar bixhozi“ do të luajë me veprimet e tij sikundër një lojë pokeri,

për sa kohë një kthim afatgjatë pozitiv parash është i mundshëm. Një individ është risk neutral, kur preferencat dhe qëndrimet e tij ndaj riskut janë mes dy tipeve të mësipërme. Ky individ nuk është i gatshëm të paguajë para shtesë për të transferuar riskun, as do të veprojnë ashtu sikundër në një lojë pokeri ku mundësia për të fituar shuma të mëdha është e lartë.

3.1 Optimizimi në marrjen përsipër të riskut

Duke folur për riskun perceptohen vetëm kërcënimet, pasiguritë që mund të ndodhin ngjarje që kanë rezultat të padëshiruar. Teoritë moderne mbi riskun, e trajtojnë këtë koncept në mënyrë më të balancuar. Një tërësi rrethanash të pasigurta mund të gjenerojnë situata e rezultate pozitive, të tilla që në përkufizimin e riskut të përfshihen edhe oportunitetet. Kjo anë e dyfishtë e të konceptuarit të riskut, është ndihmuese në procesin e një vendimarrje efektive. Figura më poshtë shpreh pikërisht këtë teori:




Figura 2.1 : Teoria moderne e dyanshme e riskut
Burimi: Hillson Book, 2008

Ndërkohë që tipet e qëndrimeve të individëve ndaj riskut, të cituara qysh në krye të këtij seksioni, nuk tregojnë gjë tjetër veçse pozicionet alternative të inividëve kur përballen me pasigurinë.




Figura 2.2 : Spektri i qëndrimeve ndaj riskut
Burimi: Hillson- M.Webster, 2007

Sipas figurës mësipër, tregohen pozitat e individëve në raport me situatat e përballjes me pasigurinë. Nga kjo kristalizohen 4 profilet e qëndrimit ndaj riskut.

3 Rishikimi i literaturës

Ka disa faktorë që përcaktojnë dhe formëzojnë të shfaqurit e një sjellje të veçantë. Ato klasifikohen si faktorë të brendshëm (si përshtetja sociale) dhe si të jashtëm (mbështetja sociale), të cilët janë instrumentat e të kuptuarit të sjelljeve të manifestuara. Disa faktorë të brendshëm të konsideruar të rëndësishëm për të sjellurin janë: (1) njohuritë rreth faktorëve të riskut dhe minimizimit të riskut, (2) sjelljet, besimet dhe vlerat (attitudes, beliefs, core values - ABCs), (3) aftësitë sociale dhe të përshtatjes, (4) predispozitat psikologjike dhe (5) psikologjia. Disa faktorë të jashtëm janë: (1) mbështetja sociale, (2) media (public service announcements - PSAs), (3) faktorët socio-kulturorë, ekonomikë e politikë, (4) faktorë biologjikë, (5) sistemi i kujdesit shëndetësor, (6) „stresantët“ mjedisorë dhe (7) rregullimet dhe ligjet e shoqërisë (Cole et al., 1992). Prania ose mungesa e këtyre faktorëve çon në nisjen apo kufizimin e një sjellje të shëndetshme. Tabela jep një përmbledhje të mendimeve të disa autorëve për faktorët që ndikojnë në sjelljen e individit:

Tabela 3.1: Autorë që kanë studiuar tematikën

Studiuesit	Faktori	Përfundimet
Bandura, 1990	njohuritë	„Njerëzit duhet të kenë mjaftueshëm njohuri për riskun potencial të një sjellje“.
Darrow, 1989		„Rritja e njohurive nuk kapërcen domosdoshmërisht barrierat që parandalojnë një sjellje“.
Bandura, 1990	sjelljet, besimet dhe vlerat	„Suksesi, nuk kërkon vetëm aftësi, por edhe vetbesim të fortë në të ushtruarit e kontrollit të vetes“.
Becker, 1988		Njohuritë dhe qëndrimet janë mbështetës të sjelljeve që minimizojnë riskun.
Bandura, 1990	aftësitë sociale dhe të përshtatjes	„Aftësitë sociale të negociimit janë të lidhura me praktikën me risk të ulët“
Ewart, 1991		„Aftësia për të gjeneruar strategji efektive për të përballuar problemet është e lidhur me rregullimet sociale dhe emocionale“.
Becker, 1990	predispozitat	„Njeriu i depresuar ka pak interes në praktikën e kujdesit të shëndetit“.

Ewart, 1991	psikologjike	„Shprehja e emocioneve apo fshehja e tyre mund të ndikojë në kontrollin e sjelljes“.
Ewart, 1991	psikologjia	“Niveli i energjisë së individit mund të përshpejtojë zbatimin e skemave të veprimit”.
Eraker, 1985		“Pacientët me sëmundje të rëndë, motivohen për sjellje të caktuara ndaj shëndetit”.
Catania, 1990	mbështetja sociale	„Vetmia dhe mungesa e mbështetjes sociale çojnë në sjellje me risk të lartë“.
Coates, 1988		„Suporti informal social ka treguar se është i lidhur me sjellje ndaj shëndetit“.
Lau, 1980	media	„Media nuk ndikon direkt në sjellje, por indirekt në besime dhe qëndrime“.
O’Keeffe, 1990		„Burime informacioni me besueshmëri të lartë çojnë në ndryshime të sjelljes“.
Catania, 1990	faktorët socio-kulturorë, ekonomikë e politikë	„Normat sociale që rregullojnë sjelljet me risk të lartë, funksionojnë edhe si manual për ndryshimet në sjellje“.
Ewart, 1991		„Sjellja individuale është në funksion të pritshmërive nga normat sociale“.
Ewart, 1991	faktorë biologjikë	„Gjendja biologjike dhe ajo e humorit lehtësojnë zbatimin e skemave të ndërveprimit“.
Stokols, 1992		„Mjedisi mund të operojë si stresant“.
Ewart, 1991	sistemi i kujdesit shëndetësor	„Ndryshimet në sjellje vijnë nga mundësitë e aksesit në burimet e komunitetit“.
Stokols, 1992		„Mjedisi të shihet si mundësues i sjelljes ndaj shëndetit, psh afërsia gjeografike me qendrat mjekësore“.
Stokols, 1992	„stresantët“ mjedisorë	„Ekspozimi ndaj kushteve mjedisore çon në stres apo në mirëqënie emocionale“
		„Ka një lidhje pozitive mes dimensioneve të klimës sociale dhe kushteve të shëndetit mendor të individëve“.
Stokols, 1992	rregullimet dhe ligjet e shoqërisë	„ Impakti mjedisor i rregullimeve sjell mbrojtjen e shëndetit të individëve dhe barazi mjedisore“.
		„Sistemet e prodhimit,shpërndarjes,

Ewart, 1991		promovimit, së bashku me mjedisin rregullator të qeverisë influencojnë zgjedhjet mbi shëndetin“,
-------------	--	--

Burimi: Rishikim kritik i literaturës nga autori

4 Tregues për sjellje risikoze në shoqërinë shqiptare

Në këtë seksion do të shihen disa tregues që në mënyrë indirekte reflektojnë sjellje të individëve me risk të niveleve të ndryshme. Të dhënat janë siguruar nga INSTAT , Indexmundi.com ndër vite.

4.1 Risku i plakjes së popullsisë

Dy figurat mëposhtë tregojnë ecurinë ndër vite të numrit të lindjeve, aborteve,dhe raportit lindje/aborte. U zgjodh variabli abort (ai jospontan) si një veprim që është rrjedhojë e një sjellje që mund të shmanget nga individit dhe (mos)shmangia sjell pasoja jo vetëm për individin por edhe për tërë shoqërinë dhe ecurinë e saj demografike.




Figura 4.1: Ecuria e raportit Lindje/Aborte

Burimi: INSTAT

Edhe pse raporti lindje/abort ka ardhur në rritje (figura 4.1), ecuria e dy treguesve (figura 4.2) jep evidenca për të tjera fenomene. Është ulur numri i aborteve (jospontane) sepse tashme familjet shqiptare planifikojnë madhësinë e familjes së tyre (femrat shmangin-minimizojnë riskun e shtatëzanive të padëshiruara). Ndërkohë që shqetësuese është rënia drastike e numrit të lindjeve, flitet për ndryshim mentaliteti për madhësinë e familjes shqiptare, shifra këto që në një të ardhme jo fort të largët do jenë shqetësues për shumë arsye: rritja e moshës mesatare të popullsisë, efekte të padëshiruara në tregun e punës dhe forcën aktive punëtore etj.




Figura 4.2: Ecuria e numrit të lindjeve dhe aborteve
Burimi: INSTAT




Figura 4.3: Ecuria e përqindjes së lindshmërisë, fertilitetit
Burimi: Indexmundi.com, llogaritje të autorit

Kjo plakje e popullsisë vjen edhe për arsyen se variablat lindshmëri dhe fertilitet, janë të korreluar pozitivisht mes tyre. Ky korrelim është edhe i rëndësishëm statistikiisht për 5% siguri (shih tab.4.1)

Tabela 4.1: Lidhja mes fertilitetit dhe lindshmërisë

Correlations			
		Fertility	Birth rate
Fertility	Pearson Correlation	1	.660*
	Sig. (1-tailed)		.029
	N	12	12
Birth rate	Pearson Correlation	.660*	1
	Sig. (1-tailed)	.029	
	N	12	13

*. Correlation is significant at the 0.05 level (1-tailed).

Burimi: llogaritje të autorit

Një ulje e fertilitetit të individëve femra, sjell pashmangshmëri normë lindshmërie të ulët dhe kontribuon në plakje të popullsisë me gjithë pasojat negative që ky fenomen sjell.

4.2 Investimi në kapitalin human (edukimi)




Figura 4.4: Ecuria e përqindjeve në të gjitha ciklet e studimeve
Burimi: Indexmundi. com, llogaritje të autorit

Shihet një rënie të normave të përfshirjes së individëve në ciklet e studimeve (parashkollor, 8-9 vjeçar, shkollë e mesme, universitet) pas vitit 2004 në vazhdim normat e rritjes janë të ulta. Ky veprim i diktuar nga kushtet ekonomike, emigrimi, mendësia të rinjve, është veprim që mbart risk për nivelin e kualifikimit të forcës së ardhshme punëtore. Lidhja mes kësaj tendence shihet me ecurinë e papunësisë të të rinjve ndër vite (fig.4.5):




Figura 4.4: Ecuria e përqindjes së papunësisë
Burimi: Indexmundi. com, llogaritje të autorit

Individi që merr ndjek vetëm arsimin fillor (pa diskutuar arsyet dhe faktorët që e çojnë në këtë veprim riskoz), prodhon një individ të pakualifikuar për forcën punëtore dhe prej kësaj kategorie gjenerohet norma e lartë e papunësisë ndër vite (tabela 4.2). Zgjedhja e ndjekjes së niveleve të ndryshme të edukimit, nuk është një zgjedhje vetëm individuale, ndikon në cilësinë e forcës punëtore të ardhme në një ekonomi

Tabela 4.2: Lidhja e rëndësishme mes arsimit më të ulët dhe papunësisë

Correlations		
	Sec.	Unemploy.
Sec.	Pearson Correlation	1
	Sig. (1-tailed)	.016
	N	7
Unemploy.	Pearson Correlation	-.794 [*]
	Sig. (1-tailed)	.016
	N	7

Burimi: llogaritje të autorit

4.3 Kultura e sigurimit të qytetarëve shqiptarë

Ky nënseksion do të trajtojë kulturën e sigurimit vullnetar të individëve shqiptarë. A e përceptojnë ata riskun e pasigurisë së të ardhmes dhe nëqoftëse kjo ndodh, sa është shkalla e përqaimit të kulturës së sigurimit? Përsëri kjo zgjedhje (të siguruarit e jetës dhe pasurisë) nuk është vetëm vullnetare, ka evidenca teorike dhe empirike që kjo ka ndikim direkt në rritjen ekonomike të vendit (Beck and Levine, 2004). Me evidenca nga Shqipëria është provuar lidhja empirike e rëndësishme mes volumit të primeve për produktet e sigurimit të jetës dhe jo-jetës dhe rritjes ekonomike.

Tabela 4.3: Regresioni i ndikimit të sektorit të sigurimeve në rritjen ekonomike

Regressi on Model	Independent Variables	Dependent Variables	Stand . S	Model Sig.	Adjusted R^2	F Value
1	ECO_GROWTH	LIFE_INS	- ,114**	,05	,686	11,905
		NON_LIFE_INS	+ ,012**			

Burimi: llogaritje të autorit

ku: **ECO_GROWTH** - variabli që përfaqëson rritjen ekonomike, matur si ndryshim në

përqindje i GDP/ frymë ndër vite, shprehur në % .

LIFE_INS – përfaqëson totalin e primeve të produkteve të sigurimit të jetës, matur në mln \$.

NON_LIFE_INS - përfaqëson totalin e primeve të produkteve të sigurimit të jo-jetës, matur në mln \$.

4.3.1 Faktorët ndikues në kërkesën për produkte të sigurimit të jetës

Por a është çështje mentaliteti apo ka edhe faktorë të tjerë ndikues në kërkesën e qytetarëve shqiptarë për të blerë produkte të sigurimit të (jo)jetës e për rrjedhojë të manifestojnë një sjellje për të kontrolluar riskun e pasigurisë së jetës? Me anë të metodës regresive, janë zbuluar disa faktorë demografikë dhe ekonomikë, përcaktues për kërkesën e individëve shqiptarë për produkte sigurimi jete (tabela 4.4):

Tabela 4.4: Faktorët përcaktues të kërkesës për produkte sigurimi jete

Regressi on Model	Independent Variables	Dependent Variables	Stand . S	Model Sig.	Adjusted R^2	F Value
		BIRTH_RAT	-144**			

1	LIFE_INS	E		,05	,803	14,5 7
		G_POP	- 454.7* *			
		ECO_GROWTH	- 9.29**			

Burimi: llogaritje të autorit

ku: **LIFE_INS** – përfaqëson totalin e primeve të produkteve të sigurimit të jetës, matur në mln \$.

ECO_GROWTH - variabli që përfaqëson rritjen ekonomike, matur si ndryshim në përqindje i GDP/ frymë ndër vite, shprehur në % .

BIRTH_RATE- norma e lindshmërisë, e shprehur në % (për 1000 banorë).

G_POP- norma e rritjes së popullsisë, e shprehur në %.

Siç shihet, nga tabela mësipër qytetarët shqiptarë sillen në mënyrë të kontrolluar ndaj riskut të jetës, jo vetëm nga çështje mendësie dhe mungese kulture sigurimi por edhe brenda kornizës së tyre ekonomike dhe karakteristikave demografike të shoqërisë shqiptare.

4.3.2 Aksidentet rrugore, sigurimi i mjeteve motorike, alkoli

Shifrat tregojnë për një rritje të vazhdueshme të aksidenteve, kjo si pasojë e problemeve me sinjalistikën, mungesën e kujdesit të shoferëve dhe të këmbësorëve. Historikisht, viti me numrin më të ulët të aksidenteve rezultoi viti 2002, ku ka pasur 328 aksidente rrugore. Edhe pse infrastruktura rrugore ka ardhur në përmirësim gjatë viteve, viti 2010 mbetet viti me numrin më të madh të aksidenteve dhe personave të lënduar në to (INSTAT, 2010).




Figura 4.5: Ecuria e aksidenteve rrugore
Burimi: INSTAT, 2010

Ndërkohë, shkak u më fortë i gjykuar i këtyre aksidenteve rrugore me pasojë fatale për individin, ka qënë alkoli.




Figura 4.6: Ecuria e aksidenteve rrugore
Burimi: Ministria e Drejtësisë, 2012

Shifrat tregojnë lidhje të frikshme mes numrit të aksidenteve rrugore dhe një nga shkaqet kryesore të tyre, alkolit.

Siç shihet edhe empirikisht mes dy variablove egziston një lidhje e fortë korrelative, e rëndësishme statistikisht, për nivel rëndësie 5%. Është rasti kur një sjellje rrisht (ngarja e automjetit në gjendje të dehur), është e lidhur me një nga faktorët e jashtëm të sjelljes, “rregullimet dhe ligjet e shoqërisë” (Ewart, 1991).

Tabela 4.5: Lidhja mes të dënuarve për ngarje në gjendje të dehur dhe nr. të aksidenteve

Correlations			
		Convicted	Accidents
Convicted	Pearson Correlation	1	.766*
	Sig. (2-tailed)		.045
	N	9	7
Accidents	Pearson Correlation	.766*	1
	Sig. (2-tailed)	.045	
	N	7	7

*. Correlation is significant at the 0.05 level (2-tailed).

Burimi: Të dhënat, Ministria e Drejtësisë, 2012, llogaritje të autorit
Gjithashtu tabela 4.6 tregon për një lidhje të fortë të rëndësishme statistikore edhe mes numrit të aksidenteve ndër vite dhe primeve për sigurimin e detyruar të mjeteve motorike.

Tabela 4.6: Lidhja mes primeve motorike dhe aksidenteve rrugore, 2004-2012

		Prime motor	Accidents
Prime motor	Pearson Correlation	1	.891**
	Sig. (2-tailed)		.007
	N	8	7
Accidents	Pearson Correlation	.891**	1
	Sig. (2-tailed)	.007	
	N	7	7

** Correlation is significant at the 0.01 level (2-tailed).

Burimi: AMF, 2012, llogaritje të autorit

Kjo flet për tendencë për të rrezikuar në kushtet e një sigurimi të detyruar nga individët, sjelljet rrishtose manifestohen më shumë kur ke sigurinë e mbrojtjes nga pasojat e tyre (Eraker, 1985).

5 Përfundimet

Sjelljet janë produkt i faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm, manifestojnë qëndrime ndaj situatave rrishtose dhe atyre që sigurojnë oportuniteteve. Identifikimi i situatave rrishtose të ndihmon në sjelljen që duhet të përshtatësh, e kështu të zbulosh profilin personal ndaj rrishtit. Me evidencat e Shqipërisë, u soll një tërësi e sjelljeve rrishtose të qytetarëve shqiptarë, dhe disa nga qëndrimet e tyre për të minimizuar pasojat negative të këtyre veprimeve. U pa aspekti i fenomenit të plakjes së popullsisë e lidhur me sjelljen e abortit jospontan, e me qëndrimet dhe mendësitë e familjeve shqiptare për madhësinë e familjes dhe përbërjen e saj, u pa zgjedhja e individit për t'u edukuar dhe ciklet e edukimit si ndikues në cilësinë e forcës punëtore që ata do ishin pjesë në të ardhmen, si dhe në normën e papunësisë së vendit. Së fundmi u pa kultura e sigurimit të qytetarëve shqiptarë. Punimi përmban kufizimin e të analizuarit vetëm të disa prej sjelljeve rrishtose, dhe përgjithësimi për shoqërinë shqiptare bazohet vetëm në këto sjellje.

Referencat

- Caves, R., and Johnes, R. (1981) World trade and payments, 3rd edition, Little Brown, Boston.
- Bandura A. Social Cognitive Theory of Self-Regulation. Human Decision Processes. Vol. 50: 248-287, 1991.
- Becker MH. Theoretical Models of Adherence and Strategies for Improving Adherence. In: Shumaker SA (ed.) The Handbook of Health Behavior Change. New York, NY: Springer Publishing Company 1990:
- Coates TJ, Catania JA, Kegeles SM. Behavioral Factors in the Spread of HIV Infection. Vol. 2, 1988.
- Ewart CK. Social Action Theory for a Public Health Psychology. American Psychologist. Vol. 46: 1991.
- INSTAT Raports
- Rose SR. Working with Groups--Social Skills Training in Middle Childhood: A Structured Group Approach. Journal for Specialists in Group Work. November: 144-149, 1987.

www.amf.gov.al, www.indexmundi.com, www.instat.gov.al

KONCEPTI I VEPRËS PENALE TË PASURIMIT TË PALIGJSHËM DHE MUNDËSITË E ZBATIMIT TË TIJ NË LEGJISLACIONIN SHQIPTAR

Phd (cand). Fjorida BALLAURI (KALLÇO)

fballauri@pp.gov.al

Abstrakt

Ky punim synon të bëjë një analizë të legjislacionit shqiptar për çështje që lidhen me pasurimin e paligjshëm të zyrtarëve publikë, si pasojë e korrupsionit, abuzimit me detyrën apo veprimeve të tjera në shkelje të ligjit nisur nga interesa të ngushta personale ose të të tretëve. Në vendin tonë janë ngritur dhe funksionojnë një sërë mekanizmesh parandalues dhe ndëshkues të fenomenit të korrupsionit në rradhët e zyrtarëve publikë. Por a janë të mjaftueshëm këto mekanizma për një luftë të suksesshme kundër këtij fenomeni. A do të ishte goditja ndaj pasurisë së paligjshme, një instrument efektiv parandalues dhe frenues i korrupsionit? Në këtë punim është trajtuar gjërësisht koncepti i pasurimit të paligjshëm, siç është sot i rregulluar në legjislacionin tonë të brendshëm dhe e parë në një këndvështrim më të gjërë nisur nga i njëjti koncept i trajtuar në Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit. Së fundmi, punimi del në disa përfundime mbi disa instrumenta të sukseshëm në luftën kundër korrupsionit dhe vlerësime për ndryshime të mundshme ligjore, të cilat më së shumti duhet të iniciohen nga nevoja se si një shtet duhet ti përgjigjet formave të shfaqjes së korrupsionit në momente të caktuara të zhvillimit social ekonomik të vendit.

Fjalëkyçe: pasurim i paligjshëm, korrupsion, zyrtar publik, konfiskim, veprë penale

Abstract

This paper aims to make an analysis of the Albanian legislation on issues related to illicit enrichment of public officials, as a result of corruption, abuse of office or other actions in violation of the law initiated by narrow personal interests or those of third parties. In our country are set up and operate a range of preventive and punitive mechanisms for the phenomenon of corruption among public officials. But are these mechanisms sufficient for a successful fight against this phenomenon? Could crackdown against illegal property, be an effective instrument of preventive and deterrent to corruption? In this paper has been treated extensively the concept of illicit enrichment, as regulated today in our domestic legislation and in a broader view based on the same concept addressed in the United Nations Convention against Corruption. Finally, the paper comes to some conclusions on several successful instruments in the fight against corruption and assessments for possible legal changes, which mostly have to be initiated by the necessity on how a state should respond to forms of corruption.

Keywords: illegal enrichment, corruption, public official, seizure, criminal offence

Hyrje

Problemi i korrupsionit në rradhët e administratës publike përveç faktit që zë një vend të gjërë në debatin e sotëm publik, është bërë një pengesë serioze për ecurinë dhe procesin e anëtarësimit të vendit tonë në BE. Lufta kundër korrupsionit me rezultate konkrete shihet tashmë si një parakusht që mund të afrojë vendin tonë me fillimin e negociatave për anëtarësim. Ndërkohë, përpjekjet e vazhdueshme të institucioneve për të luftuar këtë fenomen duket se synojnë dhe kërkojnë vazhdimisht ngritjen dhe përsosjen e instrumentave ligjorë në këtë drejtim.

Në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, aktualisht ekzistojnë një sërë dispozitash penale, që parashikojnë si të dënueshëm penalisht shkeljet dhe abuzimin me detyrën të zyrtarëve nisur nga interesa të ngushta personale ose të të tretëve. Ajo që është e përbashkët në të gjitha rastet e veprave penale korruptive¹ është shprehja "përfitim i parregullt". Koncepti përfitim i parregullt përfshin përfitime materiale dhe përfitime jomateriale (premtim punësimi në të ardhmen, privilegje, trajtime preferenciale, etj).

Pasurimi i paligjshëm duke abuzuar me funksionin publik si dhe problemet e korrupsionit në rradhët e zyrtarëve publikë, janë një ndër çështjet më të diskutuara edhe në legjislacionin ndërkombëtar. Kjo ka bërë që dhe në disa konventa ndërkombëtare të parashikohen rregulla dhe standarte që shtetet palë duhet të ndjekin në kuadrin e luftës kundër korrupsionit, ku ndër me kryesoret mund të veçojmë Konventën për të Drejtën Penale mbi Korrupsionin, ratifikuar me ligjin nr.8778, date 26.4.2005 dhe Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, që Shqipëria e ka ratifikuar me ligjin nr.9492, datë 13.03.2006. Kuadri ligjor shqiptar për dënimin e korrupsionit përputhet² në shkallë të gjerë me kërkesat e Konventave mbi korrupsionin dhe instrumentave kryesorë të Këshillit të Evropës³. Me ndryshimet e Kodit Penal të miratuara në vitin 2004, u realizuan amendime të dispozitave ekzistuese

¹ Termi "vepra korruptive" është përdorur në një concept më të gjërë, për të cilësuar të gjitha ato vepra penale të kryera nga nënpunësit publikë dhe kundër veprimtarisë shtetërore të lidhura me një përfitim të parregullt, dhe konkretisht: Neni 244; Neni 244/a; Neni 245/1; Neni 248; Neni 256; Neni 259; Neni 259/a; Neni 257; Neni 257/a; Neni 245; 258, Neni 260; Neni 312; Neni 319; Neni 319/a; Neni 319/b; Neni 319/c; Neni 319/ç; Neni 319/d; Neni 319/dh; Neni 319/e i Kodit Penal.

² Legjislacioni penal shqiptar në fushën e korrupsionit ka qënë objekt i vleresimit të GRECO-s (Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit) në vitin 2009, Raundi i dyte i Vleresimit.

Me ndryshimet e fundit që janë bërë në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë miratuar me ligjin nr.23/2012 datë 01.03.2012 dhe ligjit nr.144/2013 datë 02.05.2013 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895 datë 27.01.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë" janë shtuar veprat penale "Korrupsioni aktiv i nëpunësve të huaj publikë" parashikuar në nenin 244/a të Kodit Penal ; "Korrupsioni pasiv i nëpunësve të huaj publikë" parashikuar në nenin 259/a të Kodit Penal, si dhe vepra penale e "Korrupsionit aktiv/pasiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare" parashikuar në nenet 319/a dhe 319/d të Kodit Penal, duke përbushur në këtë mënyrë rekomandimet e dhëna në raportin e GRECO.

³ Rezoluta (97) 24 " Mbi Njëzet parimet themelore në luftën kundër korrupsionit" dhe Rekomandimi i Këshillit të Evropës No.R (2000) 10 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi "kodet e sjelljes për zyrtarët publikë"

lidhur me korrupsionin në sektorin publik, por u shtuan edhe dispozita krejt të reja për korrupsionin në sektorin privat dhe ushtrimin e ndikimit të paligjshëm. Legjislacioni penal shqiptar me ndryshimet e vitit 2004 dhe 2012 në Kodin Penal, ka arritur që të vendosë standardet e miratuara nga Konventa për të Drejtën Penale mbi Korrupsionin dhe Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit.

Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (MSA) në 12 qershor 2006, përafrimi i legjislacionit shqiptar me *acquis communautaire* dhe zbatimi i saj, përbënte një proces shumë të ndërlikuar dhe shumë kërkues. Kjo kërkonte që Shqipëria jo vetëm të ndërtonte kuadrin e saj rregullator sipas kërkesave të tij, por edhe që të siguroheshin strukturat administrative dhe kushtet e tjera të nevojshme për zbatimin e *acquis*.

Një ndër këto ka qenë dhe ligji që rregullonte çështje të integritetit dhe pastërtisë së figurës së funksionarëve publikë nëpërmjet futjes së formave për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të tyre.

Kjo bëri që në vitin 2003, të miratohej ligji nr.9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” dhe më pas një ligj i posaçëm ligji nr.9367 datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, me qëllim kryesor përcaktimin e rregullave, mjeteve, procedurave për identifikimin, trajtimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesave.

Pjesë e këtyre rregullimeve ligjore kanë qënë dhe sanksionet e vëna në Kodin Penal, duke u shtuar nenin 257/a me titull “Refuzimi për deklarim, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë”⁴.

Kontrolli i legjitimitetit të pasurive të zyrtarëve dhe burimeve të krijimit të tyre

Sistemi i deklarimit dhe kontrollit të pasurive të zyrtarëve publikë konsiderohet tashmë si një ndër instrumentat kryesorë në luftën kundër korrupsionit. Në objektin⁵ e ligjit të deklarimit të pasurive është verifikimi dhe kontrolli i pasurisë, legjitimitetit të burimeve të krijimit të saj, të detyrimeve financiare për zyrtarët dhe zgjedhurit publikë, për familjarët e tyre dhe personat e lidhur me ta. Subjekti⁶ që mbart detyrimin për deklarim, ka barrën e

⁴ Shtuar me ligjin nr.9030, date 13.3.2003 neni 1, ndryshuar paragrafi i pare me ligjin nr.9686, date 26.2.2007 neni 22 dhe ndryshuar me ligjin nr.23/2012 neni 33.

⁵ Neni 1 dhe 2 ligjit nr.9049, date 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të nëpunësve publikë” I ndryshuar

⁶ Mbartin detyrimin për deklarim të pasurive dhe interesave private, zyrtarë dhe funksionarë të lartë si më poshtë:

a) Presidenti i Republikës, deputetët e Kuvendit, Kryeministri, Zëvendëskryeministri, ministrat e zëvendësministrat;

b) Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese, gjyqtari i Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Avokati i Popullit, anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive;

c) zyrtarët e nivelit të lartë dhe të mesëm drejtues, sipas legjislacionit në fuqi për nëpunësin civil⁶;

ç) prefektët, nenprefektet, kryetarët e këshillave të qarqeve, kryetarët e bashkive, të njëjse bashkiake dhe të komunave;

proves që në procesin administrativ të kontrollit, të provojë ligjshmërinë e pasurive dhe të ardhurave të krijuara gjatë vitit të deklarimit.

E veçanta e këtij ligji, është fakti që krahas zyrtarit, mbartin detyrimin për deklarim të pasurisë dhe interesave private edhe familjarët e zyrtarit⁷ (bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët madhorë). Gjithashtu, ligji parashikon të drejtën e organit përgjegjës⁸ me kontrollin e pasurisë së zyrtarit, të kërkojë deklarimin me kërkesë të personave fizike e juridikë⁹, kur nga

d) drejtorët e drejtorive dhe komandantët e Forcave të Armatosura në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Shërbimin Informativ Shtetëror;

dh) prokurorët, gjyqtarët dhe përmbauesit e të gjitha niveleve;

e) drejtuesit e institucioneve të pavarura publike dhe anëtarët e enteve rregullatore;

ë) drejtorët e përgjithshëm, drejtorët e drejtorive dhe shefat e sektorëve, (komisariateve) në qendër, rrethe e rajone, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe asaj të Doganave dhe nivelet drejtuese në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave;

f) zyrtari i administratës doganore dhe tatimore, që merret me mbledhjen e të ardhurave doganore ose tatimore, me përjashtim⁶ të zyrtarëve tatimorë të njëjësive të qeverisjes vendore;

g) drejtuesit e të gjitha niveleve të strukturave të kthimit e kompensimit të pronave, të privatizimit dhe regjistrimit të pasurisë,

gj) zyrtarët, që zgjidhen dhe emërohen nga Kuvendi, Presidenti i Republikës, Kryeministri, ministrat ose personat e barazuar me ta;

h) Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, zëvendësguvernatori dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të saj.

i) drejtuesit e institucioneve publike në varësi të institucioneve qendrore në nivel qarku;

j) drejtuesit e shoqërive anonime me pjesëmarrje të kapitalit shtetëror mbi 50 për qind dhe me më shumë se 50 punëtorë.

⁷ Neni 21 “Deklarimi” ligji nr.9049, date 10.04.2003 i ndryshuar

“Deklarimi i pasurive, i burimeve të tyre, i detyrimeve financiare bëhet sipas kërkesave të përcaktuara në këtë ligj dhe në formën e përcaktuar nga Inspektori i Përgjithshëm. Deklarimi përfshin pasurinë e subjektit dhe të familjes së tij (bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es dhe fëmijëve në moshë madhore), burimet e krijimit dhe detyrimet financiare të subjektit. Deklarimi duhet të përmbajë edhe faktin nëse deklaruesi/ja ka ose jo persona të tjerë të lidhur”.

Në nenin 22 të ligjit të deklarimit të pasurive, parashikohet se:

“Kur pasuria e pjesëtarëve të familjes është e ndarë dhe e regjistruar si e tillë në organet e administratës shtetërore ose gjyqësore, deklarimi paraqitet veçmas nga çdo anëtar i familjes, me pasuri të regjistruar në emër të vet dhe i bashkëlidhet deklaratës së personit që ka detyrimin për deklarim.

Anëtar i familjes dhe personi i lidhur me subjektin deklarues mban përgjegjësi ligjore për vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave të deklaruara”.

⁸ Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave

⁹ në nenin 7 të ligjit Nr.9049, datë 10.04.2003, “Deklarimi me kërkesë”, thuhet se:

“Inspektori i Përgjithshëm ka të drejtë të kërkojë deklarimin e pasurive dhe burimet e krijimit të tyre, sipas kërkesave të këtij ligji, si dhe të urdhërojë kontrollin për saktësinë e këtyre deklarimeve edhe për personat fizikë e juridikë, kur, nga verifikimet e kryera, rezulton se këta të fundit janë persona të lidhur me subjektet që mbartin detyrimin për deklarim”.

kontrolli që i kryhet deklaramëve të zyrtarit, rezulton se këta persona janë të lidhur me interesa pasurore apo marrëdhënie të tjera juridiko civile.

Pavarësisht rolit aktiv që ka organi administrativ në mbledhjen e të dhënave, informacioneve, dokumentave, është vet zyrtari që duhet të argumentojë dhe justifikojë me dokumenta ligjorë që pasuria e deklaruar prej tij është krijuar me burime të ligjshme.

Fshehja e pasurisë ose deklarimi i rremë¹⁰, përbën vepër penale dhe dënohet sipas legjislacionit penal shqiptar me gjobë dhe burgim deri në tre vjet. “

Konkretisht, neni 257/a i Kodit Penal, para ndryshimeve të vitit 2012, parashikonte:

“Refuzimi për deklarim, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publike”.

- *Refuzimi për deklarimin ose mosdeklarimi i pasurisë së personave të zgjedhur ose nëpunësve publike sipas ligjit, kur më parë janë marrë masa administrative, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në 6 muaj.*
- *Fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publike dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.*

Kjo dispozitë në Kodin Penal nuk i jepte zgjidhje rastit kur ndodhemi para një refuzimi nga ana e personit të lidhur me subjektin deklarues sepse, subjekt i figurës së veprës penale të “Refuzimit për deklarim, mosdeklarimi...” është subjekt i posaçëm. Personat e lidhur me zyrtarin, edhe pse ishin subjekt i ligjit të deklarimit të pasurive, mungonin instrumentat shtrëngues (krahas masave administrative të parashikuara në nenin 40 të ligjit) me qëllim përmbyshjen e detyrimit për deklarim të tyre.

Ndodhur para këtij fakti dhe pengesave ligjore të kontatuara gjatë procedurave të kontrollit të pasurive të zyrtarëve, me ndryshimet e fundit ligjore të Kodit Penal, është zgjeruar rrethi i subjektit të veprës penale të parashikuar nga neni 257/a.

Me miratimin e ligjit Nr. 23/2012, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, janë shtuar si subjekte të posaçëm të kësaj dispozite edhe personat e lidhur me zyrtarin. Dispozita 257/a e Kodit Penal është një normë e bardhë dhe si e tillë kategoritë e subjekteve të posaçëm të kësaj figure veprës penale i gjejmë tek ligji i deklarimit të pasurive nr.9049, datë 10.04.2003 i ndryshuar. Me këtë ndryshim të fundit ligjor, institucioni i ngarkuar me kontrollin e pasurive të zyrtarëve, ka një instrument të rëndësishëm ligjor dhe efektiv, së pari në drejtim të parandalimit të rasteve të pasurimit të paligjshëm të zyrtarëve nëpërmjet personave të lidhur, por edhe një mjet ndëshkim për rastet abuzive.

Pavarësisht hapave që janë ndërmarrë në këtë drejtim duke krijuar instrumenta të rinj apo forcim të mekanizmave ekzistues, mendojmë se për aq kohë sa në vendin tonë nuk do të jenë të gjithë shtetasit subjekt deklarues (lidhur me të ardhurat, detyrimet, asetet dhe burimet e tyre), problemi i fshehjes së pasurisë dhe kalimit të pasurive të paligjshme në emrat e personave të tretë, do të mbetet i pazgjidhur plotësisht.

Përpyekja që u bë me ligjin për tatimin mbi të ardhurat¹¹, për deklarimin e të ardhurave personale, nuk ndihmoi në këtë drejtim, jo vetëm për shkak të pazbatueshmërisë së plotë të tij, por edhe për shkak të dyshemesë së vendosur për deklarim, sipas së cilës deklarojnë personat që kanë të ardhura mbi 200.000 leke.

¹⁰ Neni 257/a i Kodit Penal

¹¹ Ligji nr.8438, datë 28.12.1998, “Per tatimin mbi te ardhurat” i ndryshuar

Vetëm kur në vendin tonë të ketë një regjistër të të gjithë shtetasve, të cilët të jenë subjekt i deklarimit të të ardhurave dhe kontrollit pranë organeve tatimore, mund të kemi sukses në shmangien e fenomenit të kalimit të pasurive në emrin e personave të tretë (jo familjarë dhe jo subjekt deklarues) apo përdorimit të tyre si burim apo justifikim të pasurive të krijuara.

Çfarë ndodh me pasuritë e pajustificuara të zyrtarëve publikë?

Ashtu siç e trajtuam edhe më lart, në vendin tonë ashtu si dhe në shumë vende të tjera të rajonit e më gjerë, është ngritur dhe funksionon sistemi i deklarimit dhe kontrollit të pasurive të zyrtarëve. Pasuritë e pajustificuara, përgjithsisht tentojnë të mosdeklarohen apo të fshihen nga zyrtarët. Kjo sepse burimin dhe origjinën e tyre potencialisht e kanë të lidhur me veprime ose mosveprime që mund të përbëjnë elementët e një vepre penale, të korrupsionit, shpërdorimit të detyrës, shkeljes së barazisë në tendera etj. Ndërkohë, qëllimi kryesor i tyre në këto raste, mbetet futja e këtyre pasurive të fitura në mënyrë të rregullt, në sistemin e rregullt fiskal dhe pasqyrimi në formularët e deklarimit të interesave private duke përdorur forma të ndryshme justifikimi, si dhurimi nga personave të afërm, me anë të huamarrjeve apo huadhënueve fiktive, shitjes se padeklaruar në organet kompetentë ose shitjeve fiktive, me anë të kryerjes se veprimeve të tjera financiare ose transaksioneve të copëzuar etj. Organi përgjegjës, në rastet kur gjatë hetimit administrativ konstaton se zyrtari ka pasuri që nuk justifikohen me burimet e tij të ligjshme, ka fshehje apo deklarim të rremë të pasurisë, sipas ligjit paraqet kallzim penal pranë organit të prokurorisë.

Ndërkohë një çështje që nuk ka gjetur rregullim dhe zgjidhje në praktikë, është fakti se si do veprohet në rastin, kur provohet se subjekti që mbart detyrim për deklarim ka pasuri të pajustificuar? A përben kjo pasuri e pajustificuar produkt të veprës penale? Në nenin 36 të Kodit Penal me titull "Konfiskimi i mjeteve të kryerjes së veprës penale dhe produkteve të veprës penale", jepen rastet kur gjykata bën konfiskimet. Por në ligjet specifike nr.9049, datë 10.4.2003 "*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë*" i ndryshuar dhe nr.9367, datë 7.4.2005 "*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*" i ndryshuar, të cilave iu referohet dispozita e nenit 257/a të K.Penal nuk jepet zgjidhje se çfarë do të bëhet me pasuritë e pajustificuara të subjekteve që mbartin detyrim për deklarim. Mbetet vetëm neni 32 "Pasuritë e fituara nga fshehja e detyrimeve fiskale" e ligjit nr.9040, datë 10.4.2003 i cili thotë se: "*Kur pasuritë e fituara gjykohet se janë rrjedhojë e fshehjes së detyrimeve fiskale, Inspektori i Përgjithshëm njofton organet tatimore*".

Siç shihet në këtë drejtim është bërë prapa, krahasuar me ligjin nr.7903, datë 8.3.1995 "*Për deklarimin e pasurive të të zgjedhurve dhe të disa drejtuesve e punonjësve të shërbimit publik*". Në këtë ligj dhe konkretisht në nenin 9 të tij thuhej: "*Organet e ngarkuara me gjykimin e kundërvajtjeve administrative sipas këtij ligji, krahas dënimit me gjobë vendosin dhe për pasurinë e fituar nga burime të paligjshme prej personave të përcaktuar në pikën 1 dhe 4 të këtij ligji. Kjo pasuri konfiskohet nga policia financiare dhe kalon në dobi të shtetit*." Me akte nënligjore si, vendime të Këshillit të Ministrave apo udhëzime të Ministrisë së Financave, jepeshin format e kontrollit dhe investigimit, që duhet të bënin organet e ngarkuara me zbatimin e këtij ligji, si dhe mënyrën se si do të bëhej konfiskimi i pasurisë të fituar nga burime të paligjshme. Ndërkohë, sot që kemi edhe dispozitë konkrete penale (neni 257/a i Kodit Penal) nuk bëhet fjalë për konfiskim.

Në një interpretim të zgjeruar të nenit 39 dhe 257/a të Kodit Penal mund të konkludojmë se në çdo rast kur do të provohet në gjykatë se subjekti që mbart

detyrimin për deklaram, ka pasuri të pajustificuara, qoftë dhe pasuri që e ka kaluar tek persona të tretë apo e kundërta, kur mban pasuri të pajustificuar nga persona të tretë, dhe rezultojnë se janë produkte të kësaj veprë penale, duhet të konfiskohen dhe të kalojnë në favor të shtetit.

Në qoftë se, mundësia e konfiskimit nuk del qartë nga dispozitat në fuqi, një zgjidhje efektive për këtë çështje do të ishte, parashikimi i saj dhe plotësimi me një paragraf më vete, në nenin 257/a të K.Penal. Por, nisur nga rëndësia do të duhej të beheshin shtesat e nevojshme edhe në nenin 248, 258, 259, 260 etj.

Pra, i njëjti problem qëndron edhe kur jemi para përfitimeve të paligjshme të cilat kanë ardhur si rrjedhojë e një shpërdorimi detyre (neni 248), shkelje të barazisë në tendera dhe ankande (neni 258), përfitimi i paligjshëm i interesave (neni 257), korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike (neni 259) etj. Praktika gjyqësore e viteve të fundit ka treguar se ka patur pak ose thujse aspak konfiskime të produkteve të veprave penale të lartpërmendura.

Në kuadër të luftës kundër korrupsionit, me ndryshimet¹² ligjore të vitit 2014, tashmë janë përfshirë në fushën e veprimit të ligjit nr.10192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” (i ashtuquajtur i ligji antimafia), një numër i konsiderueshëm veprash penale korruptive¹³. Me përfshirjen e këtyre dispozitave në fushëveprimin e ligjit nr.10192, datë 3.12.2009, ofrohet një mekanizëm i rëndësishëm për hetimin pasuror dhe goditjen e pasurisë së personave/ zyrtarëve të cilët kanë një nivel të pajustificuar ekonomik, si rezultat i veprimtarisë së dyshuar kriminale korruptive.

E veçanta e këtij ligji është fakti që dispozitat e tij, zbatohen edhe ndaj pasurive të:

- a) personave të afërm (bashkëshorti, fëmijët, të paralindurit, të paslindurit, vëllezërit, motrat, ungjërit, emta, nipërit, mbesat, fëmijët e vëllezërve dhe të motrave, vjehrrit, vjehrra, dhëndri, nusja, kunata, kunati, bashkëjetuesi, thjeshtri, thjeshtra, njerku dhe njerka) të subjekteve të pikës 1 të këtij neni;
- b) personave fizikë ose juridikë, për të cilët ka të dhëna të mjaftueshme se pasuritë ose veprimtaritë e tyre zotërohen, pjesërisht ose plotësisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, a janë përdorur, kanë lehtësuar apo në një formë kanë ndikuar në kryerjen e veprimtarive të jashtëligjshme nga personat e parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

Një tjetër element i rëndësishëm është parashikimi në ligj i barrës së provës¹⁴ tek personi/zyrtari (kundër pasurive të të cilit kërkohet konfiskimi) për të vërtetuar se pasuritë janë fituar në mënyrë të ligjshme.

¹² Ligji nr.24/2014, datë 20.03.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10192, datë 03.12.2009...”

¹³ **Neni 164/a** “Korrupsioni aktiv në sektorin privat”, **neni 244** “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, **neni 244/a** “Korrupsioni aktiv i nëpunësve të huaj publikë”, **neni 245** “Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendor”, **neni 260** “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendor”, **neni 312** “Korrupsioni aktiv i dëshmoitarit, i ekspertit ose përkthyesit”, **neni 319** “Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, **neni 319/ç** “Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”

¹⁴ Neni 21 “Kërkesa për konfiskimin e pasurisë dhe barra e provës”

“1. Masa e konfiskimit vendoset me kërkesën e prokurorit, i cili i paraqet gjykatës arsyet ku bazohet kërkesa.

Nisur nga fakti se ndryshimet ligjore kanë pak muaj që ka hyrë në fuqi, nuk mund të flasim dot për rezultate dhe praktikë gjyqësore në këtë fushë.

Duke vlerësuar rëndësinë e përfshirjes në fushën e veprimit të këtij ligji të disa veprave penale të lartpërmendura, mund të themi se aktualisht kanë mbetur jashtë fushës së veprimit të këtij ligji një numër i konsiderueshëm veprash penale që potencialisht janë të lidhura me përfitime të paligjshme, si neni 248 “Shpërdorimi i detyrës”, neni 258 “Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera”, neni 257 “Përfitimi i paligjshëm i interesave” neni 245/1 “Ushtimi i ndikimit të paligjshëm” dhe 259 “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”

Mospërfshirja e tyre në ligjin e posaçëm, e bën të vështirë konfiskimin e produkteve të veprave penale të lartpërmendura, sipas nenit 39 të Kodit Penal, për disa arsye:

1. Pa një hetim pasuror, prokurori dhe më pas gjyqtari e ka të vështirë të disponojë për konfiskimin.
2. Në zbatim të nenit 39 të Kodit Penal, është e vështirë aplikimi ndaj personave të afërm të zyrtarit.
3. Konfiskimi sipas nenit 39 behet vetem pasi kemi një vendim dënimi, ndërkohë sipas ligjit antimafia, konfiskimi bëhet edhe kur procedimi penal mund të pushohet për shkaqe të tjera ligjore.

Në nenin 24 “Pranimi i kërkesës për konfiskim” të ligjit nr.10192, datë 03.12.2009, i ndryshuar parashikohet se:

“1. Gjykata vendos konfiskimin e pasurive kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- a) kur ka dyshime të arsyeshme, bazuar në indicie, për pjesëmarrjen e personit në veprimtari kriminale të parashikuara në nenin 3 të këtij ligji;*
- b) kur nuk provohet se pasuria ka prejardhje të ligjshme, apo personi nuk justifikon zotërimin e pasurive ose të të ardhurave, që nuk i përgjigjen dukshëm nivelit të të ardhurave, fitimeve apo veprimtarive të ligjshme, të deklaruara dhe as nuk justifikohen prej tyre; dhe*
- c) kur rezulton se pasuria është drejtpërdrejt ose tërthorazi në zotërim të pjesshëm apo të plotë personit.*

2. Gjykata mund të vendosë pranimin e kërkesës për konfiskimin e pasurisë edhe kur:

a) procedimi penal i filluar ndaj personit pushohet nga organi procedues për shkak:

- i) të pamjaftueshmërisë së provave;*
- ii) të vdekjes së personit;*
- iii) se personi nuk mund të merret si i pandehur dhe nuk mund të dënohet;*

b) personi deklarohet i pafajshëm penalisht për shkak:

- i) të pamjaftueshmërisë së provave;*
- ii) se vepra penale është kryer nga një person, që nuk mund të akuzohet ose dënohet;*

c) personi është proceduar për një vepër penale, që përfshihet në fushën e zbatimit të këtij ligji, por gjatë procedimit penal ndryshohet cilësimi juridik i veprës dhe vepra e re është jashtë fushës së zbatimit të këtij ligji”.

2. Konfiskimi i pasurisë kërkohet dhe vendoset edhe në raste kur ndaj pasurive nuk është kërkuar dhe vendosur masa e sekuestrimit.

3. Barra e provës, për të vërtetuar se pasuritë janë fituar në mënyrë të ligjshme, i përket personit, kundër pasurive të të cilit kërkohet konfiskimi”.

Rezerva që shtrohet në këtë rast, është fakti që nëse e zgjerojmë më shumë fushën e veprimit të ligjit nr.10192, datë 03.12.2009, i ndryshuar, atëherë rrezikojmë që ai të humbasë thelbin e qëllimit për të cilin është miratuar dhe duke riskuar zbatimin efektiv të tij.

Për këtë arsye, një variant tjetër me i arsyeshëm do të ishte parashikimi në ligjin penal shqiptar, si vepër penale të veçantë atë të pasurimit të paligjshëm, sipas të njëjtit koncept të përdorur dhe sugjeruar në Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (më tej Konventa) duke e saktësuar shprehimisht të drejtën për konfiskim nga ana e organeve përgjegjëse.

Në nenin 20 "Pasurimi i paligjshëm" të Konventës parashikohet se:

Në përputhje me Kushtetutën dhe principet themelore të sistemit të tij ligjor, secili shtet palë shqyrton marrjen e masave legjislative dhe të tjera që mund të jenë të nevojshme për të parashikuar si vepër penale, kur kryhet me qëllim pasurimin e paligjshëm, që është një rritje e madhe e pasurisë së një nëpunësi publik që ai ose ajo nuk mund ta justifikojë me të ardhurat e tij ose të saj të ligjshme.

Ndërkohë në Udhëzuesin Legjislativ¹⁵ për zbatimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, hartuar nga UNODC (Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin), janë dhënë disa orientime për aplikimin nga shtetet anëtare të nenit 20 të Konventës, lidhur me pasurimin e paligjshëm të zyrtarëve dhe konkretisht në këtë udhëzuar është argumentuar se:

"Krijimi i pasurimit të paligjshëm, si një vepër penale është gjetur e dobishme në një numër të konsiderueshëm jurisdiktikSIONESH. Kjo dispozitë adreson vështirësitë me të cilat përballët prokuroria kur duhet të provojë se një zyrtar publik ka kërkuar ose pranuar rryshfet, në raste kur pasurimi i tij është aq në disproporcion me të ardhurat e ligjshme, sa ne pamje të parë duket se korrupsioni është evident se ka ndodhur. Krijimi si vepër penale e pasurimit të paligjshëm është gjetur e dobishme, si një pengesë me efekt parandalues ndaj korrupsionit në mesin e zyrtarëve publikë.

Detyrimi për palët të marrin në konsideratë krijimin e një veprë të tillë është gjithsesi subjekt i kushtetutshmërisë të secilit shtet palë dhe parimet themelore të sistemit të tyre ligjor. Kjo si pasojë tregon se vepra penale e pasurimit të paligjshëm, për të cilën i pandehuri duhet të japë një shpjegim të arsyeshëm për rritje të konsiderueshme të pasurisë së tij, në disa juridiksione mund të konsiderohet si në kundërshtim me e drejtën e prezumimit të pafajësisë. Megjithatë, është bërë gjithashtu e qartë se nuk ka asnjë prezumim të fajësisë dhe që barra e provës mbetet mbi prokurorinë, pasi është ajo që ka për të provuar se pasurimi është përtej mundësisë së krijimit të të ardhurat të ligjshme. Pasi është bërë një gjë e tillë, atëherë i pandehuri mund të ofrojë një shpjegim të arsyeshëm ose të besueshëm"¹⁶.

Vepra penale e pasurimit të paligjshëm penalizon zyrtarin publik nga disponimi i pasurisë kur ajo është në disproporcion me të ardhurat e tij, dhe që nuk justifikohet dot me burimet e tij të të ardhurave. Parashikimi me ligj si një veprë penale e pasurimit të paligjshëm, mund të lehtësojë punën e organit të prokurorisë, për sa kohë ajo shmang kërkesat për të lidhur fajësinë për një vepër penale me rritjen e pasurisë dhe asetëve.

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSCE) e ka konsideruar ekzistencën e një veprë të tillë si një nga praktikat më të mira për të luftuar

¹⁵ Legislative Guide for the implementation of the UNCAC, UNODC, New York 2009

¹⁶ Paragrafi 296 dhe 297 i Udhëzuesit Teknik të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit

korrupsionin (OSCE 2004). Nisur nga vështirësia e të provuarit të veprës penal që ka sjellë përfitime të pajustificuara, juridiksione¹⁷ të ndryshme e kanë kualifikuar si vepër penale faktin që një zyrtar të disponojë pasuri të pajustificuara. Në Hong Kong, ku kjo vepër penale ka ekzistuar për gati 40 vjet, Gjykata e Apelit ka konstatuar se: "Kjo dispozitë ka provuar efektivitetin e saj në luftën kundër korrupsionit"¹⁸. Një studim i fundit nga Banka Botërore¹⁹ në kuadër të iniciativës së përbashkët me UNODC, ka vërejtur se disa juridiksione kanë arritur të kthenin dhe konfiskonin shuma të mëdha parash pasojë e veprime të ndryshme korruptive të zyrtarëve publikë, në sajë të aplikimit të veprës penale të pasurimit të paligjshëm. Ndërkohë nuk kemi ende një rast praktik të trajtuar në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Nga ana tjetër, një çështje që do të kërkojë t'i jepet kujdesi i duhur në praktikë është fakti që, zyrtari duke u përpjekur të justifikojë pasurinë e tij, mund të rrezikojë vet-inkriminimin, sepse ndërkohë që ai mbrohet për veprën penale të pasurimit të paligjshëm, mund të ekspozojë veten përballë sanksioneve të tjera administrative, fiskale (psh mospagimi ose mosdeklarimi i të ardhurave tek tatimet) etj.

Si konkluzion, në analizë të të gjithë elementëve të lidhur me pasuritë e zyrtarëve, problemeve të korrupsionit dhe abuzimit me detyrën, në vlerësimin tonë, përfshirja si vepër penale e "pasurimit të paligjshëm" në legjislacionin tonë penal, duke e shoqëruar me masa të tjera siç është konfiskimi nga shteti të pasurive të pajustificuara me burime të ligjshme, do të ishte një tjetër instrument i rëndësishëm ligjor për parandalimin e rasteve të korrupsionit, abuzimit me detyrën apo pastrimin e parave.

LITERATURA

1. Kodi Penal.
2. Kodi i Procedurës Penale
3. Ligj nr.8778, datë 26.4.2001 "Për ratifikimin e "Konventës Penale për Korrupsionin"
4. Ligj nr. 9492, datë 13.3.2006 "Për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit"
5. Udhëzuesit Teknik te Konventes se OKB, UNODC 2009
6. Rezoluta (97) 24 " Mbi njëzet parimet themelore në luftën kundër korrupsionit"
7. Rekomandimi i Këshillit të Evropës No.R (2000) 10 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi "Kodet e sjelljes për zyrtarët publikë"
8. Ligj nr.7903 datë 8.3.1995, "Për deklarimin e pasurive të të zgjedhurve dhe të disa drejtuesve e punonjësve të shërbimit publik", Fletore Zyrtare nr.4 viti 1995, faqe 115.
9. Ligj nr.9049, datë 10.4.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publike", i ndryshuar
10. Ligj nr.85/2012 date 18.9.2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9049, datë 10.4.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publike" të ndryshuar

¹⁷ Kina, Argjentina, Botsvana, Ekuador, El Salvador, India, Paraguaj, Peru, Venezuela, dhe Zambia

¹⁸ Prokurori i Përgjithshëm v. Hui Kin-hong, 1995

¹⁹ UNODC's StAR Initiative, <http://star.worldbank.org/star/>

11. Ligj nr.9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar
12. Ligj nr.9529 datë 11.5.2006, "Për disa ndryshime e shtesa në ligjin 9367 datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike",
13. Ligj nr.86/2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9367, datë 7.4.2005,"Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike"i ndryshuar.
14. Ligj nr.9475, datë 9.2.2006,"Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 9367 datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike".
15. Ligji nr.9917, datë 19.5.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit".
16. Ligj nr.9530, datë 11.5.2006 "Për një shtesë në ligjin 9049 datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë", Fletore Zyrtare nr.56 viti 2006 faqe 1604.
17. Ligj nr.98/2014 date 24.4.2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9049, datë 10.4.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publike" të ndryshuar
18. Ligji nr.8438, datë 28.12.1998, "Per tatimin mbi te ardhurat" i ndryshuar
19. Ligj nr.10192, datë 3.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë" i ndryshuar.

KOSTOT E TRANSAKSIONIT DHE EKONOMIKSI I RI INSTITUCIONAL

Autor i parë: **Florian Miti**
Autore te dytë: **Ilira Pulaj**
Dr. Ramadan Ismaili

Abstract

A good economic performance of a firm depends also on low *transaction costs*. But, what are transaction costs? Even though a wide-accepted theoretical definition of transaction costs does not exist, transaction costs can be identified initially in Coase's (1937) early formulation as "*the cost involved in the carrying out the transaction in the open market*". In this article I present different theoretical and empirical approaches of transaction costs and their role in the New Institutional Economics. Identifying the costs of exchange can serve to measure the effects of reforms over time, find bottlenecks, know which are the real costs of starting a new business, reduce bureaucracy and helps implementing better legal frameworks.

Key Words: Transaction costs, Institutional Economics, market, firms, efficiency.

HYRJE

Një performancë e mirë ekonomike e një firme varet edhe nga kosto të ulëta të transaksionit. Por, cilat janë kostot e transaksionit? Edhe pse një përkufizim teorik gjerësisht i pranuar i kostove të transaksionit nuk ekziston, kostot e transaksionit mund të identifikohen fillimisht në formulim e herët të Coase (1937, f. 9) si "kostot të përfshira në kryerjen e transaksioneve në tregun e hapur". Sipas Williamson (1981, f 552), "Analiza e kostove të transaksionit interesohet rreth kostove krahasuese të planifikimit, përshtatjes, dhe monitorimit sipas strukturave alternative qeverisëse" Ai propozon idenë se kostot e transaksionit janë të përcaktuara nga elementet e mëposhtme: pasiguria, frekuenca, specifika, racionaliteti i kufizuar dhe sjellja oportuniste nga agjentët.

Një formulim më i vonë i kostove të transaksionit mund të adoptohet nga përkufizimi i përdorur nga Furubotn dhe Richter (1997, f. 40) ku "kostot e transaksionit përfshijnë kostot e burimeve të përdorura për krijimin, mirëmbajtjen, përdorimin, ndryshimin, etj të institucioneve dhe organizatave",

ndërsa në rastin e ekzistencës së pronës dhe të drejtave të kontratës, autorët përfshijë në kostot e transaksionit -" shpenzimet e përcaktimit dhe matjes burime apo pretendimet, plus kostot e përdorimit dhe zbatimin e të drejtave të specifikuar ".

Ndërsa Coase siguron një lidhje midis kostove të transaksionit dhe të drejtave të pronësisë me anë të "teoremës Coase", Furubotn dhe Richter, në një situatë të transferimit të të drejtave ekzistuese të pronësisë dhe në vendosjen apo transferimin e të drejtave të kontratave midis individëve, përfshinë në kostot e transaksionit dhe kostot e informacionit, negocimit, dhe të zbatimit. Në vijim do të paraqiten format e ndryshme që kostot e transaksionit shfaqen, identifikimi dhe metodat e ndryshme të matjes empirike të tyre si dhe lidhja e tyre me *Ekonomiksin Institucional*.

1.1 NATYRA E KOSTOVE TE TRANSAKSIONIT

Natyra e kostove të transaksionit është e shumëfishtë: Ndërsa Coase paraqet një lidhje midis kostove të transaksionit dhe të drejtave të pronës nëpërmjet "teoremës Coase", duke deklaruar se: "në mungesë të kostove të transaksionit, alokimi i burimeve është i pavarur nga shpërndarja e të drejtave të pronësisë", Furubotn dhe Richter, gjatë transferimit të të drejtave të pronësisë dhe në vendosjen apo transferimin e të drejtave kontraktuale midis individëve, përfshihen në kostot e transaksionit dhe kostot e informacionit, negocimit, dhe të zbatimit të forcuar të tyre.

Në parim, ne mund të identifikojmë tre rryma për të analizuar kostot e transaksionit:

- i) Kostoja e pjesëmarrjes në treg;
- ii) Kostot e brendshme të menaxhimit të qeverisjes korporative;
- iii) Kostot e ndërveprimit me institucionet publike.

i) Kostoja e pjesëmarrjes në treg, është diskutuar fillimisht në artikullin origjinal të Coase (1937), ku "mekanizmi i çmimit" luan një rol në vendimet e firmave për të *bërë ose blerë*: "Kostot e negocimit dhe përfundimit të një kontrate të veçantë për çdo transaksion shkëmbimi i cili zhvillohet në një treg, duhen gjithashtu të merren në konsideratë" (Coase, 1937, f. 390), duke nënkuptuar se firma bëhet më e madhe me rritjen e transaksioneve shtesë që kryhen nga sipërmarrësi dhe bëhet më e vogël kur ai braktis transaksione të tilla.

Shembuj të kostove që një firmë përballet ndërsa bashkëvepron me agjentë të jashtëm në treg janë të tipologjive të mëposhtme:

- Kostot e hedhjes së mallrave të prodhuara në treg (duke përfshirë këtu aktivitetet e reklamimit, marketingut dhe kontaktet me konsumatorët);
- Kostoja e gjetjes së një ofruesi të duhur në aspektin e çmimeve dhe cilësisë;

- Kostoja e negocimit të kontratës dhe formulimin e kontratës me klientët dhe furnizuesit;
- Kostot e punësimit të asistencës profesionale;
- Huluntimi dhe studim i tregut;
- Kostot e zbatimit të kontratave ose të mosmarrëveshjeve ligjore me organizata të tjera, dhe kështu me radhë.

Këto kosto janë të ndikuara nga racionaliteti i kufizuar i agjentëve ekonomikë, informacionit asimetrik, oportunitizmi post-kontraktual dhe nga asetet specifike¹. Prania e këtyre elementeve rrit kostot e transaksionit si pjesë e totalit të kostove që çojnë në ineficienca dhe në konflikte kontraktuale.

ii) Kostot e brendshme të menaxhimit të qeverisjes korporatave. Sipas Coase (1937), madhësia e firmës është e përcaktuar nga ekuilibri i brendshëm midis kostove për të koordinuar produktin në treg² (autori i konsideron shpenzimet e marketingut si kosto të përdorimit të mekanizmit të çmimit) dhe kostove të organizimit të prodhimit brenda firmës (kostot e menaxhimit), duke paraqitur këtë problem si një çështje vendimmarrjeje për të blerë apo bërë.

Kjo tipologji kostosh është e theksuar më mirë në kontekstin e korporatës moderne, e karakterizuar nga ndarja e pronësisë dhe të kontrollit për shkak se, përveç në rastin e pronarit-menaxher, të gjitha strukturat e ndërmarrjeve janë subjekt i disa formave të problemit kryesor - agjent³.

Jensen dhe Meckling (1976), argumentojnë se për shkak të kësaj papajtueshmërie në objektiva, investimet potencialisht fitimprurëse janë thjesht të lëna mënjanë. Autorët i referohen këtij fenomeni si "humbje të mbetura nga agjencia". Me qenë se është e kushtueshme për kryesorin që të monitorojë veprimtarinë e agjentit, shumica e kostove të monitorimit nga ana e aksionarit, kostot e lidhjes me menaxherët dhe kostot e mbetura njihen si kosto të agjencisë jashtë pronësisë së kapitalit (Johnsen 1993, f. 12). Këtu kostot e transaksionit janë të lidhura me menaxhimin dhe koordinimin e shumëllojshmërisë së kontratave që rregullojnë veprimtarinë brenda firmës. Këto kosto zakonisht janë të mishëruara në aktivitetet e burimeve njerëzore, në koston e monitorimit, kostot e informacionit dhe koordinimin, aktivitetet e kontabilitetit dhe kështu me radhë. Prania e këtyre kostove të brendshme implikon një mbështetje të logjikës se pse firma nuk mund të rritet pa asnjë kufi, d.m.th se, pse ekonomia nuk është menaxhuar vetëm nga një firmë e madhe. "Në përgjithësi, një firmë do të zgjerohet deri në pikën ku përfitimi marginal në formën e kostove të reduktuara të transaksionit është e kompensuar nga kostoja marginale e organizimit të brendshëm" (Bulter, 1989, f. 104).

¹ Vëreni këu problemin *hold-up*.

² Kostot e transaksionit

³ Shiko Jensen M.C. & Meckling W.H. (1976) dhe Fama E. F. & Jensen M. C. (1983).

Në anën tjetër, qasja e “*të drejtës së pronës*”⁴ i konsideron kostot e transaksionit si kostot e krijimit dhe ruajtjes së të drejtave të pronësisë⁵ pasi që, sipas kësaj qasjeje, tregtia është transferimi i të drejtave të pronësisë në mënyrë që nuk mund të ketë tregti në mungesë të të drejtave të pronësisë (Allen, 1999-2000 f. 898).

Kontributi i Alchian dhe Demsetz (1972), mbi teorinë moderne të firmës, paraqesin një tjetër qasje në lidhje me formën e organizimit të firmës. Sipas autorëve, krijimi i firmës është një pasojë e benefiteve së prodhimit në grup apo *team*. Nga kjo pikëpamje, termat e kontratave krijojnë bazën që firmat të ekzistojnë. Organizimi i firmës karakterizohet kështu nga veprimtaria e *monitorimit* dhe *kontrollit* të ushtruar nga menaxher në lidhje me veprimtarinë e prodhimit në grup.

Duke u bazuar tek mendimi origjinal i Coase, kontributi i Williamson tek Ekonomiksi Kostove të Transaksionit (me tej TCE⁶) përbën shtyllat kryesore të kësaj literature.

Në thelb, TCE fokusohet në marrëdhëniet e vazhdueshme kontraktuale (Williamson, 2007). Williamson jep një nocion të qartë për kostot e transaksionit, duke qenë ato të përcaktuara nga pasiguria, frekuenca, veçantia, racionaliteti të kufizuar dhe sjellja oportuniste e agentëve⁷. Williamson (1971, f. 114) vë në dukje rolin që investimet specifike e asetëve mund kenë duke shkaktuar mosmarrëveshje kontraktuale dhe në këtë mënyrë lind nevoja për tu integruar vertikalisht. Pikëpamja tjetër e Williamson (1985, f. 20) e cila është paraqitja e TCE si një problem kontraktual në përgjigje për problemin e organizimit ekonomik duke paraqitur kostot e transaksionit të ndara në llojin *ex ante* dhe *ex post*, është e trajtuar në një moment të dytë.

iii) Kostot e ndërveprimit me institucionet publike janë shpenzimet që firma duhet të kryej për të përmbushur detyrimet e institucioneve publike.

Shembuj të kostove që hyjnë në këtë kategori janë:

- kostot administrative të krijuar një firmë të re;
- tarifatat dhe pagesat për marrjen e licencave dhe lejeve për zbatimin e një projekti të ri;
- kostot në pjesëmarrjen në ankande dhe të ofertave;
- shpenzimet e përmbushjes së detyrimeve tatimore dhe të kontributeve shoqërore;
- shpenzimet që dalin nga sektorë të rregulluar dhe ente rregullatore;
- kostot e zbatimit të kontratave dhe kostot e tjera të shkaktuara nga divergjencat dhe penalitetet kontraktuale dhe kështu me radhë.

⁴ E drejta e pronësisë: aftësia për të ushtruar lirisht një zgjedhje mbi një të mirë ose shërbim. (Allen W. D. 2000, f. 898)

⁵ Allen (1991).

⁶ Transaction Cost Economics

⁷ Shiko Williamson (1979), dhe (1985).

Ky rast i veçantë i kostove të transaksionit, të cilat lindin për shkak të ndërveprimit me institucionet publike, ndikohet në mënyrë dramatike nga fenomeni i korrupsionit brenda sistemit social. Kjo pasi një sistem ekonomik i prekur nga korrupsioni rrit kostot e transaksionit dhe ndikon në vendimmarrjen e investimeve. Prania e korrupsionit rrit kostot për të bërë një transaksion, kështu që në total, ai sjell ineffiçenca të mëtejshme në sistem dhe zhvendosje të mëtejshme të shpërndarjes së pasurisë (Clerico *et al*, 2007).

1.2 KOSTOT E TRANSAKSIONIT DHE EKONOMIKSI I RI INSTITUCIONAL⁸

Ekonomiksi i Kostove të Transaksionit- TCE, mund të konsiderohen si një pjesë e të ashtuquajturës Ekonomiksi i Ri Institucional -NIE, një term i përdorur nga Williamson (1975), në lidhje me studimin e institucioneve.

Klein (2000, p. 456), e përshkruan Ekonomiksin e Ri Institucional si “një ndërmarrje ndërdisiplinore duke kombinuar ekonomiksin, drejtësinë, teorinë organizative, shkencat politike, sociologjinë dhe antropologjinë për të kuptuar institucionet e jetës shoqërore, politike dhe tregtare. [...] Qëllimi i saj është të shpjegojë se çfarë janë institucionet, si lindin ato, për çfarë qëllimesh ato shërbejnë, si ato të ndryshojnë dhe si duhet të reformohen”

Ekonomiksi Institucional mbulon dy fusha studimi:

- Një fokusohet në të drejtat e pronësisë dhe në rolin e firmave dhe organizatave të tjera në uljen e kostove së transaksioneve, sipas punës origjinale të Ronald Coase dhe të kontributit të mëvonshëm të Oliver Williamson.
- Rryma tjetër (e zhvilluar nga puna e Douglass North) thekson rolin e shtetit dhe institucioneve të tij në krijimin e rendit dhe kontrollin e dhunës, shpronësimin e pronës dhe shfrytëzimin e individëve.

Ekonomiksi institucional, si ekonomia neoklasike, mëshon rëndësinë e mungesës së burimeve, tregjet, dhe të konkurrencës, por gjithashtu supozon se individët kanë informacion të papërsosur dhe racionalitet të kufizuar dhe përballen me pasiguri dhe rreziqe në transaksionet e tyre me njëri-tjetrin.

Për të zvogëluar rreziqet dhe kostot e tyre, individët vendosin rregulla, lidhin kontrata, dhe norma për të kushtëzuar sjelljet dhe për të bërë transaksione më të parashikueshme. Këto mekanizma të ndikojnë dukshëm në performancën e tregut. Në kontrast me këndvështrimin neoklasik i cili supozon se performanca e tregut në masë të madhe varet nga sasia e burimeve në dispozicion, politikat makroekonomike, si dhe ndryshimet teknologjike, ekonomiksi institucional

⁸ Kjo pjesë bazohet tek shpjegimi i dhënë nga A. Bentham *et al*, tek “*Institutional Economics: A Crucial Tool for Understanding Economic Development*” Ekonomický časopis, 57, 2009, č. 6, s. 603 – 607.

argumenton se stimujt dhe kostot e transaksionit të krijuara nga institucionet ndikojë gjerësisht në mënyrën se si burimet janë përdorur, cilat politika janë zgjedhur, dhe në qoftë se risitë teknologjike janë shfrytëzuar.

Klein (2010), paraqet një tjetër veçori të ekonomiksi të ri institucional duke konsideruar faktin se analizat politike udhëhiqen nga e ashtuquajtura “analiza krahasuese institucionale”.

Në analizën e mirëqenies, rezultatet e botës reale zakonisht krahasohen me një pikë referimi hipotetike të ekuilibrit të përgjithshëm të konkurrencës së përkryer, duke dalë me rezultate befasisht të pangjashme me të tregut. Coase (. 1964, f 195) shpjegon se si një alternativë më të mirë dhe me e matshme mund të hartohet:

“Vëzhgimi i një sistemi optimal mund të ofrojë teknika të analizës që në të kundërt mund të kishin humbur dhe, në disa raste të veçanta, mund të shkojë larg dhënies së një zgjidhjeje. Por në përgjithësi ndikimi i saj ka qenë i dëmshëm. Ajo e ka drejtuar vëmendjen e ekonomistëve larg nga çështja kryesore, e cila është se si rregullimet alternative aktualisht do të punojnë në praktikë. Ajo i ka çuar ekonomistët që të nxjerrin konkluzione për politikën ekonomike nga studimi i një situatë abstrakte të tregut. Nuk është rastësi që në literaturë. . . ne gjejmë një kategori “dështim i tregut” por jo një kategori “dështim qeverisës”. Derisa ne të kuptojmë se po zgjedhin midis marrëveshjeve sociale të cilat janë të gjitha ku më pak apo ku shumë më dështime, ne kemi pak gjasa për të bërë shumë përparim.”

Edhe pse institucionet janë paraqitur si drejtuesit kryesor ekonomik, ato janë ende të pa-kuptuara mirë dhe është e nevojshme që më shumë hulumtime duhen bërë për të kuptuar se si funksionojnë institucionet në shoqëritë specifike, dhe se si shmangiet nga sjellja racionale ndikojnë në performancë. Në këtë pikë, duket se me një kuptim më të mirë të institucioneve, ne mund të përpiqemi ti përgjigjemi pyetjes se përse disa vende janë të pasura dhe disa vende të tjera janë të varfra.

Ekonomiksi institucional mund të japi disa njohuri kyçe në lidhje me këtë pyetje. Benham *et al* (2009), theksojnë një përfundim të rëndësishëm lidhur me faktin se vendet, në mënyrë që të zhvillohen dhe të progresojnë, kanë nevojë për institucione që nxisin dhe mbështesin kosto të ulëta të transaksionit, - *atje ku institucionet të tilla mungojnë, kostot e transaksionit janë shumë më të larta dhe ndonjëherë aq të larta sa për të krijuar dështime të tregut, siç edhe citohet nga Coase në “Strukturën Ekonomike të Prodhimit” (AER, 1992): “Në qoftë se kostot e kryerjes së një shkëmbimi janë më të mëdha sesa fitimet që vetë shkëmbimi do të sjellë, ky shkëmbim nuk do të bëhet.”*

Është e qartë pra se funksionimi i mirë i tregjeve varet domosdoshmërisht nga institucione efçente që do të mbajnë kosto të ulët të transaksionit. Këto përfshijnë kodet joformale të sjelljes, besimit, reputacionit, si dhe të ligjeve formale, zbatimin e kontratave nga shteti, ku shteti luan një rol të rëndësishëm. Megjithatë kjo mund të jetë edhe problematike pasi, siç vë në dukje Douglass North, ndërsa ekzistenca e një tregu ndodh vullnetarisht, tregu ka nevojë për një shtet me fuqi të mjaftueshme për të zbatuar rregullat.

1.3 ANALIZAT EMPIRIKE

Në analizën empirike të kostove të transaksionit, një kontribut të veçantë jepet nga studimi i Shelanski dhe Klein (1995). Autorët, mbi bazën e dallimit të bërë nga Williamson (1983) midis katër llojeve të ndryshme të aseteve specifike⁹, kërkojnë të gjejnë empirikisht strukturën organizative më të përshtatshme duke marrë në konsideratë vendimmarrjen “bëj apo blej” dhe strukturën e kontratave afatgjata, brenda një kuadri institucional të dhënë¹⁰.

Në rastin e firmave të integruara vertikalisht, autorët gjejnë se asetet specifike nën pasiguri kanë një efekt të rëndësishëm në strukturën e prodhimit. Në rastet kur integrimi i plotë nuk i justifikon kostot, adoptohen forma organizative “hibride”. Këto mund të kenë formën e kontratave afat-gjata, kontrata komplekse me marrëveshje reciproke, kontrata ekskluziviteti, kontrata të realizimit të investimeve specifike e kështu me radhë (1995, p.345).

Në rastin e kontratave afatgjata, autorët trajtojnë rastet e studimit të Joskow (1985,1987,1988b dhe 1990); Crocker dhe Masten (1988); Goldberg dhe Ericson (1987); De Canio dhe Frech (1993); Pirrong (1993). Një karakteristikë e kontratave afatgjata është fakti se ato janë *jo-komplete* me qenë se konsiderojnë kontrata komplekse. Autorët gjejnë rezultate të rëndësishme si në rastin kur kontratat janë vërejtur të jetë më të plota kur kontraktuesi ka një histori të mosmarrëveshjeve me blerësit dhe më pak të plota kur ekziston një shkallë e lartë e pasigurie e llojit intertemporal apo teknologjik.

Studimet empirike të Palay 1984 dhe 1985, Wilson 1980, Acheson 1985, Brinig 1990, mbështesin arsyetim e kostove të transaksionit pasi ata, jo vetëm gjejnë se marrëveshjet e vëzhguara mund të shpjegohen në terma të aseteve specifike dhe të pasigurisë, por edhe sepse ato vënë theksin tek urdhëresat private mbi rolin e gjykatës (Shelanski dhe Klein, 1995, f. 349).

Studimet empirike të Joskow (1985 dhe 1987) në industrinë e qymyrit, sigurojnë një mbështetje të fuqishme të hipotezës se “sa më e rëndësishme të bëhet marrëdhënia e investimeve specifike, aq me shume palët do ta gjejnë të dobishme të mbështeten në kontratat afatgjata që specifikojnë *ex ante* termat dhe kushtet të transaksioneve të përsëritura, sesa të mbështeten në marrëveshjet e përsëritura (1985, f. 183)”. Autori sugjeron se kontratat afatgjate mund të jenë një alternativë e mundshme e integritit vertikal, kur asetet specifike janë të moderuara.

Crocker dhe Reynolds (1993), marrin në shqyrtim stimujt e palëve për të hartuar kontrata të lëna qëllimisht të paplota. Autorët përpiqen të gjejnë shkallën optimale të pa-plotësisë kontraktuale. Në fakt, marrëveshjet rezultojë

⁹ Williamson (1983), dallon midis katër llojeve të ndryshme të aseteve specifike: vendndodhje specifike; asete fizike specifike; asete njerëzore specifike; dhe asete te dedikuara.

¹⁰ Shelanski (1995, f. 341), konsideron pesë kategori të mëdha të fenomenit empirik të shpjeguar nga ekonomiksi i kostove të transaksionit: integrimi vertikal, modele kontratash “hibride”, kontrata biznesi afatgjata, marrëveshje joformale dhe kontrata franchising.

të jetë më të plota në ato raste në të cilat palët kanë pasur disa mosmarrëveshje në të kaluarën dhe janë më të paplota në rast të një shkallë më të lartë pasigurie. Benham dhe Benham (1998 e 2001), përcaktojnë koston e shkëmbimit (ndërmjet individëve të ndryshme dhe shteteve), si *koston oportune* që ndesh një individ për të përfutur një të mirë apo produkt specifik duke përdorur një formë të caktuar të shkëmbimit brenda një mjedisi institucional të caktuar.

Tek Williamson (1976), analiza përqendrohet në efikasitetin e skemave të tenderimit për franchising si një alternativë e rregullimit sektorial në ofrimin e shërbimeve publike. Ndërkohë që kërkon alternativa tek shërbimet të ofruara nga monopoli natyror, Williamson merr në konsideratë faktin se nuk ka alternativa pa pengesa¹¹, por megjithatë, një zgjedhje midis alternativave duhet të bëhet. Ndër faktorët relevantë që konsiderohen në vlerësimin e formave alternative të organizimit të monopolit natyror, ai paraqet:

“(1) shpenzimet e konstatimit dhe përmbledhjes së preferencave të konsumatorit përmes kërkesës së drejtpërdrejtë; (2) efikasiteti i ofertave të shkallëzuara; (3) shkalla në të cilën teknologjia është zhvilluar mirë; (4) pasiguria e kërkesës; (5) shkalla në të cilën furnitorët dominues fitojnë aftësi idiosinkratike; (6) madhësia e përfshirjes së pajisje jetëgjata të specializuara; dhe (7) ndjeshmëria e procesit politik ndaj oportunitizmit të përfaqësuesve dhe diferencimi i prirjes, midis modaliteteve, për t'i bërë ato” (Williamson 1976, f. 75).

Autori vë në dukje faktin se, - sa më shumë besueshmëri të ketë mbi kontraktimin dhe në efikasitetin e konkurrencës, aq më e madhe është tendenca për të favorizuar modalitete të tregut. Kjo çon në konkluzionin se, “rregullimi, në disa forma, është relativisht i preferuar kur kemi dyshime se kontraktimi i paplotë do të japë rezultatet e dëshiruara dhe kur proceset konkurruese janë të prirura të kolapsojnë” (f.75).

Studimet empirike të paraqitura më lart, japin një ide se si literatura është e përbërë nga aspekte dhe forma të ndryshme analizash dhe metodologjish të përdorura në matjen dhe kategorizimin e kostove të transaksionit duke provuar kështu impaktin e pamohueshëm të ndikimit që këto kosto kanë gjatë procesit të shkëmbimit, në marrëveshjet kontraktuale, në format e ndryshme organizative të firmave, proceset vendimmarrëse e kështu me radhë.

1.4 KONKLuzionET

Literatura e kostove të transaksionit, për shkak të veçorive dhe modaliteteve të shumëfishta që këto kosto shfaqen, është shumë e gjerë dhe e larmishme, si nga analiza metodologjike e konceptuale ashtu edhe në qasjet empirike në praktikë. Megjithatë, ekzistenca e këtyre kostove, të cilat janë në fokusin e ekonomiksit të kostove të transaksionit (TCE), japin një evidencë të qartë të ndikimit që këto kosto kanë gjatë procesit të shkëmbimit, në lidhje me format e

¹¹ Terminologjia e përdorur në këtë kontekst është “friction-free”.

ndryshme të marrëveshjeve kontraktuale, në format e ndryshme organizative të firmave, ne proceset vendimmarrëse e kështu me radhë.

Autoret e ekonomiksi të kostove të transaksionit sqarojnë se specifikimi i kostove të shkëmbimit në praktikë, mund të shërbejë si një mjet informues për të matur efektet e reformave me kalimin e kohës, për të identifikuar pengesat, për të ndihmuar sipërmarrësit e rinj të dinë se cilat janë kostot reale për të filluar një biznes të ri, për të ulur burokracinë dhe për inkurajon reformat më efektive e korniza më të mira ligjore e kështu me radhë.

Një konsideratë finale vjen nga Benham and Benham të cilët specifikojnë se kostot e shkëmbimit ndryshojnë ndërmjet individëve, grupeve, dhe vendeve me qenë se janë të prekur nga faktorë si: tarifat, taksat, kontrollet e çmimeve, monopolet, diskriminimi i çmimeve, asimetritë e informacionit, specifikat e aseteve, sjellja strategjike, dhe oportunitizmi. Për më tepër, tarifat, taksat, dhe kontrollet e çmimeve kërkojnë rregullatorë, monitorime, dhe një proces burokratik të cilët mund të ndryshojnë vetë kostot e transaksionit.

Autorët shpjegojnë se atje ku kostot e transaksionit janë shumë të larta, shumë transaksione nuk do të zhvillohen fare. Prandaj vetëm një pjesë e vogël nga të gjitha transaksionet potenciale ndodhin në të vërtetë, dhe nga këto të fundit, vetëm një nën-bashkësi e vogël si transaksione të tregut. Sipas tyre, duke ditur kostot oportune të zgjedhjeve alternative shërben në gjetjen e arsyeve se përse një individ i veçantë ndërmerr një transaksion të veçantë.

REFERENCAT

ALCHIAN A. AND DEMSETZ H. (1972), "Production, Information Costs, and Economic Organization", *The American Economic Review*, vol. 62, pp. 777-795.

ALLEN D. W. (2000), "Transaction Costs ", in Boudewijn Bouckaert and Gerrit De Geest, eds., *The Encyclopedia of Law and Economics*, Cheltenham, Edward Elgar, pp. 893-926.

BENHAM A. AND BENHAM L. (2001), "The cost of Exchange", *Roland Coase Institute Working Papers*, No. 1.

BENHAM A. - BENHAM L. - KOVÁČ U. - NYE J. - SERVÁTKA M. - SHIRLEY Mary M., "Institutional Economics: A Crucial Tool for Understanding Economic Development", *Ekonomický časopis*, 57, 2009, č. 6, s. 603 - 607.

BULTER H. (1989), "The Contractual Theory of the Corporation", *George Mason Law Review*, vol. 11 No. 4, pp. 99-123.

CHEN P. (2007), "Complexity of Transaction Costs and Evolution of Corporate Governance", *The Kyoto Economic Review*, vol. 76, No 2, pp. 139-153.

CLERICO G., NOVARESE M., RIZZELLO S. (2007), "I Costi di Transazione: Analisi Teorica ed Indagine Empirica", *Giuffrè Editore*, Milano.

- COASE R. H. (1937), "The Nature of the Firm", *Economica*, vol. 4, pp. 386-405.
- COASE R. H. (1960), "The Problem of Social Cost", *Journal of Law and Economics*, vol. 3, pp. 1-44.
- COASE R. H. (1998), "The New Institutional Economics", *American Economic Review*, vol. 88, No.2, pp. 72-74.
- COASE R. H. & WILLIAMS E. (1964), "Discussion", *American Economic Association*, vol. 54, No 3, pp. 192-197.
- CROCKER K. J. AND RAYNOLDS K. J. (1993), "The Efficiency of Incomplete Contracts: An Empirical Analysis of Air Force Engine Procurement", *The RAND Journal of Economics*, vol. 24, No. 1, pp. 126-146.
- FAMA E. F. AND JENSEN M.C. (1983), "Agency Problems and Residual Claims", *Journal of Law & Economics*, vol. 26, No. 2, pp. 327-349.
- FURUBOTN G. E. AND RICHTER R. (1997), "Institutions and economic theory: The contribution of the new institutional economics", *Ann Arbor: University of Michigan Press*.
- GOEL K. R. (2008) "Regulatory bottlenecks, transaction costs and corruption: A cross-country investigation ", *Bank of Finland (BOFIT) Discussion papers*.
- JENSEN M. C. AND MECKLING W.H. (1976) "Theory of the Firm: Managerial Behavior, Agency Costs and Ownership Structure", *The Journal Of Financial Economics*, vol. 3, No 4, pp. 305-360.
- JOSKOW P. (1985), "Vertical Integration and Long-term Contracts: The Case of Coal-burning Electric Generating Plants" *Journal of Law, Economics & Organization*, vol. 1, No. 1, pp. 33-80.
- JOSKOW P. (1986), "Incentive Regulation for Electric Utilities" *Yale Journal on Regulation*, vol. 4, No. 1, pp. 1-50.
- JOSKOW P. L. (1987), "Contract Duration and Relationship-Specific Investments: Empirical Evidence from Coal Markets", *American Economic Review*, vol. 77, No. 1, pp. 168-185.
- JOSKOW P. (1991), "Role of Transaction Cost Economics in Antitrust and Public Utility Regulatory Policies" *Journal of Law, Economics & Organization*, vol. 7, Special issue, pp. 53-83.

SHELANSKI H. A. AND KLEIN P. G. (1995), "Empirical Research in Transaction Cost Economics: A Review and Assessment" *Journal of Law, Economics & Organization*, vol. 11, No. 2, pp. 335-361.

MARQUEZ M. (1990), "The Other Path by Hernando De Soto" *Boston College Third World Journal*, vol. 10, No. 1, pp. 204-213.

MÉNARD C. (ed) (2000), "Institutions, Contracts and Organizations: Perspectives from New Institutional Economics" *Edward Elgar Publishing Limited*, Cheltenham, UK.

POSNER, A. R. (1974), "Theories of Economic Regulation", *The Bell Journal of Economics and Management Science*, vol. 5, No. 2, pp. 335-358.

WANG N. (2003), "Measuring Transaction Costs: An Incomplete Survey" *The Roland Coase Institute Working Papers*, No 2.

WILLIAMSON, O. E. (1971), "The Vertical Integration of Production: Market Failure Considerations", *American Economic Review*, vol. 61, No. 2, pp. 112-123.

WILLIAMSON O. E. (1976), "Franchise Bidding for Natural Monopolies-In General and with respect to CATV", *Bell Journal of Economics*, vol. 7, No. 1, pp. 73-104.

WILLIAMSON O. E. (1979), "Transaction Cost Economics: The Governance of Contractual Relations", *Journal of Law and Economics*, vol. 22, No. 2, pp. 233-261.

WILLIAMSON, O. E. (1983), "Credible Commitments: Using Hostages to Support Exchange", *American Economic Review*, vol. 73, No. 4, pp. 519-540.

WILLIAMSON O. E. (1985), "The Economic Institutions of Capitalism", *New York Free Press*, Collier Macmillan Publishers, London.

WILLIAMSON O. E. (1998), "Transaction Cost Economics: How It Works; Where It Is Headed", *De Economist*, vol. 146, No 1, pp. 23-58.

WILLIAMSON O. E. (2007), "Transaction Cost Economics: An Introduction." *Economics Discussion Papers*, No 2007-3, Kiel Institute for the World Economy.

SI NDIKOJNE PROFESIONET E NDRYSHME NE SHREHITE GJUHESORE (KRAHASIMI NDERMJET GJUHES ANGLEZE DHE GJUHES SHQIPE)

MA Gerta SHAQE

Pedagoge e Gjuhës Angleze

Universiteti i Tiranës

gertashaqeal@gmail.com

Abstrakt:

Gjuha shërben për të formësuar dhe komunikuar mendimet. Për të kryer këtë rol, ajo ka një sistem mjetesh (tinguj, morfema, fjalë, trajta) dhe rregullash për vargëzimin e tyre (për ndërtimin e fjalëve, togfjalëshave e fjalive). Megjithatë, komunikimi nuk arrihet thjesht nga vargëzimi i mjeteve sipas disa rregullave, por me ndërhyrjen e tyre në përputhje me pasqyrimin e realitetit, me vijueshmërinë logjike, me synimet e folësit në rrethanat e komunikimit.

Ky studim “*Si ndikojnë profesionet e ndryshme në shprehjet gjuhësore (krahasimi ndërmjet gjuhës angleze dhe asaj shqipe)*”, ka për qëllim të pasqyrojë ndikimin e profesioneve të ndryshme, apo grupeve të ndryshme profesionistësh në shprehjet e gjuhës. Profesionet janë element i rëndësishëm i shoqërisë. Profesionet nuk mund të ekzistojnë pa gjuhën, veçanërisht ato profesione ku një grup njerëzish punojnë së bashku dhe kanë nevojë për të shkëmbyer informacion se si janë ndarë gjërat, apo detyrat. Profesionet krijojnë elementet e tyre tipike gjuhësore dhe përdorin elementet e gjuhës në përgjithësi në mënyrë të ngjashme, ose të dallueshme. Profesionet janë burimi i ndryshimeve në gjuhë, ndërkaq qëndrimet ndaj gjuhës, nga ana tjetër mund të jenë shkak ndryshimi lidhur me funksionimin e profesioneve.

Gjatë këtij studimi janë marrë në konsideratë argumente dhe modele të ndryshme studimi të cilat kanë të bëjnë me gjuhën dhe marrëdhëniet e ngushta të saj me profesionin. Krahasimisht, është bërë një ndërthurje e gjuhës angleze të përdorur në profesione të ndryshme dhe asaj shqipe.

Abstract:

The language serves to configure and communicate ideas (thoughts). In accomplishing with this role the language has a system of tools (sounds, morphemes, words, phrases (clause)) and rules used for their formation (construction of words, phrases and sentences). However, the communication is not realised just through the ordering (ranking) of these tools in compliance with the rules, but through their intervention in reflecting the reality, on the logical continuity, focused on the speakers' aims into the communication consequences.

This research paper “*How do different professions influence at the linguistics skills (a comparative view between the English and Albanian Language)*”, aims to reflect the influence that various professions or groups of professions have at the linguistics skills. Professions are an important element of our society. But, professions shall never live without language, especially those where a group of people work together and find the necessity to exchange information regarding the tasks or

things division. Professions are able to create their typical linguistics skills elements, and also use elements of language in general similarly or differently. The professions are source of linguistic changes, while the position of professions toward the language, from the other side, may be the case of changes related to the profession functionality.

During this research paper, have been taken into consideration arguments and various study models, which are closely related to the language and the profession. Comparatively, has been a combination of the English language used and various professions with Albanian language.

Fjalët kyçe: Gjuhë, profesion, grupe sociale, gjuhë profesionale, kontekst, bisedë

Key words: Language, profession, social groups, professional language, context, conversation

FALENDERIME

Punimi i prezantuar është realizuar në kuadër të programit "Master Shkencor" të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës. Nevoja dhe dëshira për të thelluar njohuritë në një fushë të posaçme janë të mëdha dhe ekzistenca e programeve master është mundësi për të arritur një qëllim të tillë.

Kështu, së pari dëshiroj të falenderoj Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës, programin Master në Gjuhësi që më dha mundësinë të studioj pranë tij, si dhe të gjithë pedagogët e këtij programi të cilët më kanë ndihmuar gjatë këtyre dy viteve të studimeve për të marr njohuri të detajuara duke arritur deri këtu.

Një falenderim të veçantë kam për profesorin i cili më udhëhoqi gjatë kësaj pune të vështirë: Prof. Dr. Ilo Stefanllari, diskutimet dhe ndihmesa e të cilit më kanë bërë të mundur që në këtë punim të përfshijë analiza me mjaft vlera.

Gjithashtu, falenderoj për bashkëpunimin e ngushtë dhe vënien në dispozicion të të dhënave dhe studimeve të kryera kryesisht në fushën e studimit për të cilin unë kam realizuar punimin, Prof. Dr. Gjovalin Shkurtaç, Dr. Lida Tabaku, Dr. Shpresa Delia, Prof. Dr. Kloteda Dibra, Prof. Dr. Nonda Varfi etj.

Faleminderit!

RISHIKIMI I LITERATURËS

Për rëndësinë që i kushtohet gjuhës, si dhe ndikimit të madh që ka pësuar në aspektin social, ekziston një literaturë e gjerë dhe e shumanshme të autorëve/studuesve të huaj. Shumica e sociologëve, sociolinguistëve, linguistëve, antrolinguistëve, si dhe profesorëve të gjuhës, janë marr me studime dhe hulumtime të ndryshme se si ndikojnë profesionet, apo grupe profesionistësh në gjuhë. Këto studime kryesisht përqendrohen në studime të mirëfillta që janë realizuar në shkolla/ institucione të ndryshme.

METODOLOGJIA

Përsa i përket metodologjisë së përdorur, pjesa më e madhe përfaqësohet nga:

- **të dhëna dytësore**

Në këtë fushë përfshihen pjesa më e madhe e studimeve/ artikujve të cilat kanë bërë studime të mirëfillta, duke përdorur edhe metoda analitike, lidhur me

përdorimin e gjuhës në vende të ndryshme pune. Gjithashtu, janë shqyrtuar autorë të huaj të cilët janë marr kryesisht me aspektin e ndikimit social që ka gjuha (angleze dhe shqipe) në vendin e punës (workplace). Autorët e cituar/referuar në studim janë: **Karl-Heinz Pogner (Gjuha Profesionale), Mark Grundy, Caroline Graham & Freda Mishan, Prof. Dr. Gjovalin Shkurtaç,** etj.

- **të dhëna parësore,**

Për këtë studim, të dhëna parësore janë shqyrtuar nga studime të mirëfillta të kryer nga sociolinguistët/ linguistët në vendin e punës (workplace). Gjatë këtij studimi janë marr nën shqyrtim studime specifike të studiuesve:

Caroline Graham & Freda Mishan

Prezantojnë një model me katër nivele të ndryshme të integritit të gjuhës dhe profesionit, duke paraqitur nga një shembull konkret të secilit model. Krahasimi është bërë në dy plane; në njërin plan kemi përputhjen e gjuhës me profesionit, në planin tjetër krahasimi bëhet më vete, gjuha dhe profesionit.

Ann Due

Tregon sesi gjuha ndërthuret me recetat e kuzhinës, është shumë e mundur të drejtosh mësimdhënien e nxënësve të një shkolle teknike (të cilët po përgatiten për profesionet e tyre në të ardhme) drejt veprimtarive profesionale të cilat ndërmerren në kuzhinë. Duke vepruar në këtë mënyrë, krijohet *orientimi ndërdisiplinor* i mësimdhënies.

Kent Andersen

I cili punon në një shkollë teknike, ka qëllime të përcaktuar qartë të marrëdhënieve ndërmjet gjuhës dhe profesionit. Me anë të një kursi mbi bazë “detyrash” ai mundohet të integrojë mësimdhënien e gjuhës angleze me mësimdhënien e TI-së.

Karl-Heinz Pogner

Thekson se si trajnimet e personave të kualifikuar në detyra të ndryshme mund të përdorin njohuritë e tyre profesionale si burim dhe pikë nisje. Ai paraqet një numër idesh konkrete për aktivitetet në të cilën mësimi i gjuhës ndodh në vendin e punës, drejtpërdrejt e lidhur me profesionet e tyre specifike.

Për hartimin e këtij studimit janë marr në konsideratë edhe studime të kryera nga studiuesit të Gjuhës shqipe të cilët, kanë kryer studime në fushën sociolinguistike, Prof. Dr. Gjovalin Shkurtaç, Prof. Dr. Xhevat Lloshi, Prof. Dr. Jani Thomai. etj.

HYRJE

Gjuha është padyshim një fenomen social: funksioni qendror i së cilës është komunikimi ndër-personal. Në të vërtetë, shumë prej përfundimeve nga kërkimet shumëvjeçare të sociolinguistikës kanë treguar së shumë prej aspekteve të ndryshimeve gjuhësore varen nga ndryshimet shoqërore. Profesionet janë një element i rëndësishëm i shoqërisë. Çdo analizë e bërë lidhur me funksionimin e shoqërisë e lidh profesionin në aspektin pak a shumë universal me shoqëritë ekonomikisht të zhvilluara gjatë gjithë historisë. Profesionet nuk mund të ekzistojnë pa gjuhën, veçanërisht ato profesione ku një grup njerëzish punojnë së bashku dhe kanë nevojë për të shkëmbyer informacionin se si janë ndarë gjërat, apo detyrat.^[1] Profesionet krijojnë elementet e tyre tipike gjuhësore dhe përdorin elementet e gjuhës në përgjithësi në mënyrë të ngjashme, ose të dallueshme. Profesionet janë burim i ndryshimeve në gjuhë, ndërkaq qëndrimet ndaj gjuhës, nga ana tjetër mund të jenë shkak ndryshimi lidhur me funksionimin e profesioneve (teksta kalojnë nga strukturat hierarkike, ose piramidale tek ato të menaxhereve të thjeshtë; duke balancuar sipërmarrjet individuale me punën në grup; apo ndryshimi i sjelljeve kundrejt grupeve sociale brenda profesionit – si gratë, të moshuarit apo punëtorët e gjymtuar).^[2]

Disa nga teknikat e mësimin të gjuhës në përgjithësi, (të paktën ato të përdorura në Perëndim) janë konsoliduar nga revolucioni i informacionit dhe teknologjitë e informacionit (ICT).^[3] ICT me efikasitet bën të mundur konkretizimin e konceptit të

komunikimit në të njëjtën kohë të mundëson akses të pakufizuar lidhur me autencitetin e teksteve që lidhen me kulturën e gjuhës mëmë (target) [4].

Tema që do të trajtohet në këtë studim ka të bëjë me ndërveprimin ndërmjet gjuhës dhe profesionit. Në të gjitha studimet, librat, artikujt të cilat janë marr në shqyrtim ndajnë idenë se ekziston një formë e mësuar e gjuhës, e cila ka për subjekt të veçantë situatat komunikuese në realitetin praktik të profesioneve.^[5] Sigurisht, që kjo është e pasqyruar më së miri në statusin që gëzon gjuha angleze si një ndër gjuhët ndërkombëtare me shtrirje të gjerë në të gjitha llojet e profesioneve në realitet. Pedagogjia që përdorin mësuesit e gjuhës ka krijuar një lidhje ndërmjet mësimit të gjuhës dhe realitetit të profesionit, duke marr në konsideratë një numër fushash ku ndryshojnë nga mësimdhënia e përgjithshme e gjuhës në tërësi. Kjo zbatohet në fusha të tilla si: a) kuadri i mësimdhënies; b) nevojat komunikative të pjesëmarrësve; c) gjuha e cila është mësuar.^[6]

Studimi përmban shembuj të gjuhës së orientuar drejt profesioneve të caktuara, të cilat janë mësuar në kontekste të ndryshme: *brenda sistemit shkollor* (gjatë shkollës), ku mësimdhënia është pjesë e kurrikulës shkollore, ku kemi marr si shembuj kolegjet teknike (*Kent Andersen, Anne Due*) dhe Kolegjin e Policisë (*Jan Shubert*) në këto kontekste gjuha mësohet për pjesëmarrësit që të kualifikohen në profesionet e tyre në të ardhmen – dhe në lidhje me profesionin e pjesëmarrësve, për shembull, një kompani (firmë) përcakton të ashtuquajturat trajnime gjuhësore in-service (për shërbimin) (*in-service language training*)^[7] i cili bën të mundur që pjesëmarrësit të kryejnë detyrat e tyre funksionale në një kontekst ndërkombëtar. Paraqitet një sfond historik mbi zhvillimin e gjuhës, si dhe merren për shqyrtim dhe analizë gjuha e përdorur në fusha të ndryshme, më konkretisht:

Media

Gazeta

Reklama

Muzikë dhe këngë

Kinematografia

ICT

Gjuha dhe shembuj nga sektorë të ndryshëm

Gjuha në kontekstin e sektorëve të ndryshme të shoqërisë

Lidhja e fjalëve të një teksti të dhënë me domethënie, që dalin jashtë kuptimit të tyre, vihet re sidomos në letërsinë artistike dhe në ligjërimin e folur të përditshëm, që ka bërë, gjatë një kohe të gjatë, që përveç tekstit të pranohet edhe nënteksti, duke kuptuar me këtë të fundit, pikërisht kuptimin e dytë apo domethënien tjetre që qëndron në “nën” tekst.

“ Fjala tekst, në kuptimin e saj të parë, shënon fjalët e fjalitë e një vepre, të një dokumenti, të shkruara apo të shtypura, përmbajtjen e shkruar ose të shtypur të një vepre, të një dokumenti apo akti, thëniet e dikujt të shkruara apo të shtypura, të një vepre, të një dokumenti ose akti, thëniet e dikujt të shkruara ose të shtypura.”¹

Nëntekst

Kuptimi i dytë, i mbuluar apo i fshehtë i një cope të shkruar, ose i fjalëve të thëna, që ndryshon nga kuptimi i drejtpërdrejtë, domethënia e brendshme apo e mbuluar.²

Me qëllim lidhjen e mësimdhënies me nevojat, pjesëmarrësit duhet të kryejnë një analizë gjuhësore të gjuhës, për të qenë në gjendje që të ndërveprojnë në aspektin lingistik me situata të veçanta komunikative.³

Në kurrikulën e sistemit shkollor (sistemit edukativ), reflektohen nevojat e përgjithshme komunikative, ose me specifikisht situatat specifike komunikative në të cilin target grupi (target group) duhet që të ndërveprojë me sukses. Në fushën e

trajnimet edukativ për të rritur (AMU –Adult educational training), si rrjedhojë, kurset mbështeten në një analizë gjithëpërfshirëse të nevojave gjuhësore që shfaqin target grupet.

Në kurse ku nuk ju duhet pjesëmarrësve që të përballen me nevojat e përcaktuara nga kurrikula, por ku forma dhe përmbajtja janë konceptuar sipas nevojave të pjesëmarrësve, një analizë paraprake duhet të ndërmerret nga specialistet e fushës – kjo nënkupton një analizë të nevojave gjuhësore të një kompanie/organizate dhe të individëve pjesëmarrës në lidhje të drejtpërdrejta me situatat e punës. ⁴

Kompania duhet të pasqyrojë nevojat që ka, ose mësuesi shpeshherë mund të krijojë një marrëveshje jo-zyrtare me pjesëmarrësit në lidhje me formën dhe përmbajtjen që duhet të ofrojë kursi. Shembujt e analizave lidhur me nevojat gjuhësore të kompanive janë paraqitur nga Mark Gundy, Caroline Graham & Freda Mishan, si dhe Jan Schubert. ⁵

Metodat e përdorura mbi analizën e nevojave për gjuhë përfshijnë më konkretisht:⁶

Intervista,

Pyetësorë,

Njerëzit “hije” teksta punojnë në të njëjtat funksione pune etj.

Megjithatë, pavarësisht çdo rrethane, nevojat gjuhësore janë shumë më larg të shprehurit në mënyrë qartë dhe me objektivitet, të një aspekti të matshëm dhe të identifikueshëm.

Si fillim, mund të bëjmë një dallim ndërmjet dy aspekteve shumë të rëndësishëm në planin sociologjik *nevojave të përdorimit* (për cilën arsye do të përdoret gjuha në marrëdhënie me funksionet e punës, p.sh. për të porositur kancelari, për të shkruar një raport, për të rregulluar një makinë, për të ndaluar një të dyshuar), *nevojat e mësimit* (cila është përmbajtja dhe metoda e përsosur me qëllim promovimin e mësimit të gjuhës tek pjesëmarrësit, si dhe *nevojat e përmirësimit* (cilat janë nevojat që shfaq pjesëmarrësi për të mësuar që të përmirësojë nivelin e saj/tij gjuhësor). ⁷

Është paksa e vështirë që të përcaktohet konkretisht se cila është nevoja e përdorimit. Nëse dikush është punësuar në një profil punë brenda kompanisë ku i duhet të kërkojë kancelari etj, nuk është shumë nevoja për një nivel lingvistik i nivelit të avancuar, me qëllim që ai të shprehet qartë për të realizuar qëllimin. ⁸

Shpeshherë nevojat e përdorimit dhe nevojat e mësimit mund të jenë të ndërsjellat. Është e pashmangshme që mësimdhënia e stimuluar dhe efikase mund të përcjellë informacionin sipas situatave të përcaktuara komunikative, por duhet që ta arrijmë këtë objektiv nëpërmjet rrugës pedagogjike. Sjellja e pjesëmarrësve, aftësia gjuhësore, stili i të mësuarit etj, mund ta bëjnë të domosdoshme fillimin e një mësimdhënie në planin e përgjithshëm të gjuhës që lidhet drejtpërdrejt me profesionin, ose kjo gjë mund të arrihet ndërmjet punës individuale dhe aftësimit gjuhësor gjatë veprimtarive gojore (oral activities).⁹

Nevojat aktuale gjithashtu varen nga nevojat të cilat duhet të merren në konsideratë. Duhet të merren parasysh nevojat e pjesëmarrësve, apo të konsumatorëve/blerësve? Shumë diskutime janë ngritur në shkollat e administrim biznesit ndërmjet studentëve, në lidhje me nivelin gjuhësor që dikush duhet të ketë për një vend të caktuar pune. Përmbajtja dhe lloji i kurseve trajnuese lidhur me gjuhë e shërbimit (*in service language training courses*) ¹⁰ përcaktohet nga një strategji e përgjithshme në vendin e punës.

Gjithashtu, ekziston pyetja se çfarë lloj gjuhe duhet të mësohet. Sa duhet të jetë niveli i mësimdhënies se gjuhës në aspektin e përgjithshëm lingvistik dhe se sa duhet të jetë niveli i gjuhës në aspektin specifik të një pozicioni të caktuar pune? Sa korrekte duhet të jetë gjuha në planin gramatikor/drejtpërdrejt që një person të arrij të ketë sukses në situata të ndryshme komunikative me partnerët dhe më organizatat/kompanitë e tyre? ¹¹

Si rrjedhojë, është e rëndësishëm përcaktimi i një numri parametrash lidhur me situatat komunikative, të cilat duhet të përfshihen në mësimdhënie: *Perfeksionimi (i të folurit/të lexuarit/ të shkruarit), partnerët e komunikimit, çështja për të cilën komunikohet, vendi i komunikimit, mediumi, qëllimi.*¹² Të gjitha këto parametra kanë një ndikim të rëndësishëm në llojin e gjuhës e cila duhet të përdoret.

Një debat që vazhdon të ndodh, lidhur me qëllimet e veçanta për mësimin e gjuhës (LSP), lidhet me konceptin, nëse gjuha për qëllime specifike ka ndryshim nga gjuha e “përgjithshme” dhe, nëse vërtetë ekziston, si ndodh? Frekuenca e karakteristikave të veçanta, përcaktohet nga aspekti pragmatik i gjuhës, p.sh. përdorimi dhe funksioni i veçantë i gjuhës në situatat kur përdoret.¹³

Gjuha teknike ka për qëllim krijimin e një perspektive teknike mbi gjerat dhe kushtet në realitet, p.sh. sesi funksionon një makinë. Është thelbësore të shpjegohet, se kjo gjuhë (gjuha teknike) i referohet aspekteve të ndryshme teknike, me përpikëri, në mënyrë sistematike dhe shumë qartë. Si rrjedhojë, karakteristikat janë përzgjedhur nga të gjitha nivelet e gjuhës – fjalori, sintaksa, biseda – të cilat të gjitha shërbejnë për t’i dhënë gjuhës një funksion teknik.

Gjuha profesionale, e cila përfshin edhe nëngrupin gjuhë teknike, shpesh përdoret kur ekspertët komunikojnë ndërmjet tyre si anëtarë të një komuniteti të caktuar bisedor, ku anëtarët e këtij grupi kanë tradita dhe norma të caktuara, dhe çështjet trajtohen në nivelin profesional. Në artikullin e saj, Ann Due, për shembull, shpjegon se si ajo punonte me nxënësit e një shkolle tekniken me një gjuhë që lidhej me një subjekt të caktuar (recetat në kuzhinë), duke bërë një paralelizëm të dukshëm të punës së studentëve me kuzhinë.¹⁴

Gjuha profesionale përdoret gjithashtu, në kontekste të tjera, p.sh. ndërmjet amatorëve të interesuar, në revistat shkencore etj. Megjithatë, gjithmonë gjuha i përshtatet konteksteve të veçanta komunikative.¹⁵

Teksa folëm për gjuhën profesionale, e cila lidhet me një fushë të caktuar dhe me një konteksti bisedor të caktuar, gjuha e biznesit nga ana tjetër, mund të thuhet se përdoret për të bërë biznes, psh. marrëdhëniet ndërmjet një shitësi dhe një klienti shihen si ato të partnerëve në një diskutim. Në këtë rast, është pikërisht pozicioni i tyre në biznes, apo në tregti i cili përcakton komunikimin, kështu që, dikush arrin të realizojë komunikim profesional dhe të flas për biznes, si dhe ti referohet gjuhës së përdorur si gjuhë biznesi.¹⁶

Gjuha teknike, LSP-ja dhe gjuha e biznesit mund të shfaqen të gjitha në të njëjtën situatë komunikimi, ose mund të ndërthuren.

Për të parë leksikun si një karakteristikë thelbësore e regjistrit që përdoret, është një metodë e mirë për të parë njoftimet e punëve. Më poshtë, paraqiten dy njoftime për punë në suplementet e gazetës Guardian. (31 maj 2000/1 qershor 2000)¹⁷

Njoftimi 1

As part of our Quality Projects plan we have established an Initial Assessment Team to provide a first point of contact service through undertaking initial assessments of need, initial child protection enquiries and providing an early response for users.

This is a new team which became operational in November 1999 and has a key role in ensuring our services meet our Quality Protects initiatives.

We need a [job title appears here] to complete the team who can demonstrate high levels of practice competence of [noun phrase which identifies job] work.

(Perk.) Si pjesë e Projekteve tonë mbi Cilësinë, kemi krijuar Ekipin për Vlerësimin Paraprak me qëllim mundësimin e kontaktit paraprak të

shërbimit nëpërmjet kryerjes së vlerësimeve fillestare sipas nevojave, pyetësorëve fillestar mbi mbrojtjen e fëmijëve si dhe të mundësojë një përgjigje paraprake për përdoruesit.

Ky është një ekip i ri i cili do të jetë funksional në nëntor 1999 dhe ka një rol kyç në sigurimin e shërbimeve të cilat përputhen me iniciativat e Mbrojtësve të Cilësive.

Kërkohej një (titulli i pozicionit shfaqet këtu) për të plotësuar ekipin i cili duhet të shfaq nivele të larta të kompetencës praktike të (një emër që identifikon pozicionin e punës) punën.

Njoftimi 2

The [job title appears here] will be responsible for the commissioning of training events and outreach services, formation of teams with the appropriate expertise to deliver these services and co-ordinating the Help Desk. Candidates must have at least three years' experience in supporting the use of [adjective identifying job] resources, including JISC-funded services, in an education environment and experience of organizing or delivering training and awareness events.

Perk. (Titulli i punës shfaqet këtu) do të jetë përgjegjës për autorizimin e eventeve të trajnimit dhe përmbushjen e shërbimeve, krijimin e ekipeve me ekspertizë të posaçme për të mundësuar këto shërbime, si dhe bashkërendimin me Help Desk-un. Kandidatët duhet të kenë së paku përvojë punë mbi 3 vjet për (mbiemri i cili identifikon llojin e punës) në përdorimin e burimeve, duke përfshirë shërbimet JISC, në një mjedis edukativ dhe me eksperience në organizimin, ose dhënien e trajnimeve dhe eventeve.

Njëri njoftim është për vendin vakant (të lirë) për “User Service Manager” (Menaxher për User Service) në një Universitet të Teknologjisë së Informacionit, ndërsa njoftimi tjetër është për vendin vakant të punonjësit social. Dy fjalët kyçe mund të evidentohen *key role (Përk. rolin kyç)* dhe *high levels of practice (Përk. praktikë e nivelit të lartë)*.¹⁸ Në njoftimin e parë, kemi leksikun e përdorur për njoftimin për punonjës social (dhe më së shumti për pozicione që kanë lidhje me edukimin). Njoftimi i dytë, i referohet gjithashtu, ekipeve, por ka fjalë të dallueshme për eventet e trajnimit dhe Help Desk (e përdorur si metoforë në shumë prej Universiteteve në MB për sistemet e IT, nga personeli dhe studentët).

Njoftimi 3

An optional machinist vise is attached for light-ëeight ëork. The vise frame is held in place by pins ëelded to the frame. Hitch pins secure the base, making for easy removal (See beloë). The loëer shelf is also 16 gauge sheet. It strengthens the frame and may hold a toolbox or heavier tools for better stability of the forge.

Teksa shohim këtë njoftim, mundohemi të identifikojmë se cilët prej fjalëve, apo shprehjeve të leksikut të cilat kanë kuptime shumë specifike¹⁹, – ose se cilat

përdoren në regjistrin e përgjithshëm, ose të ashtuquajturin bisedat e përditshme (*everyday speech*). Po e paraqesim këtë me anë të një table, ku sipas tekstit të mësipërm, mund të vendosim se fjalët e tekstit kujt kolone i përkasin. ²⁰

Tabela

Lexical term	Special form and meaning	Common form with special meaning	Common form with common meaning
machinist vise	☐	☐	☐
pins	☐	☐	☐
welded	☐	☐	☐
hitch pins	☐	☐	☐
removal	☐	☐	☐
16 gauge sheet	☐	☐	☐
frame	☐	☐	☐
forge	☐	☐	☐

Sipas të dhënave të përdorura, përgjigjet ndryshojnë sipas moshës, seksit dhe eksperiencës kulturore.

Gjuha e Reklamave

Nëse marrim në konsideratë gjuhën dhe situatat e ndryshme në të cilat ajo përdoret, fokusohemi edhe tek njoftimet (reklammat). Njoftuesit (Eng. *advisers*) e bindin publikun që të përqafojnë një lloj stili të caktuar jetese, një produkt, apo shërbim të caktuar. Është shumë e rrallë të hasim njoftime të cilat kërkojnë që të ndikojnë tek publiku në mënyrë të drejtpërdrejtë. Gjuha e reklamave ka një leksik të veçantë, i cili mund të ndryshojë me kalimin e kohës, por që kryesisht shfaq disa elemente – gjuha e përdorur e re, e përmirësuar, e vërtetuar. David Ogilvy në librin e tij *Rrëfimet e një Zotërie që bën reklama Confessions of an Advertising Man*²¹ (Grammar, Structure and Style, Oxford, 1994, p. 177), e identifikon leksikun bazë të mbiemrave të cilët zakonisht përdoren gjatë reklamave si më poshtë: *new, good, better, fresh, natural, fine, free* (Përk: *i ri, i mirë, më i mirë, i freskët, natyral, delikat, i lirë*), ndërsa foljet: *buy, give, taste, go, look, feel and use* (Përk: *blej, jap, shijoj, shkoj, dukem, ndjej dhe përdor*). Regjistra të veçantë (teknikë, shkencorë, pseudo-shkencorë) mund të përdoren në botën e reklamave me qëllim që të reklamohet produkti. ²²

Reklama merr hua dhe përshtatet struktura dhe forma nga tekstet e të gjitha llojeve. Shumë reklama janë dramatike, me një narracion i cili arrihet me anë të dialogut. Të tjera reklama mund të tregojnë një tregim vetëm me anë të imazheve, nën shoqërimin e muzikës dhe / ose një Voiceover. ²³

Lojrat e fjalëve, aliteracioni, asonanca, onomatopea, rima dhe lloje të tjera fjalësh komike apo poetike janë të zakonshme në reklama. Paqartësia, ironia dhe aluzioni (referencë) janë gjithashtu teknika të fuqishme.

Reklama shpesh përdor tekste të shkurtër – si ato të shkruara, ose transmetuese – ku çdo fjalë duhet të godasë me kuptimin e saj (në këtë aspekt është shumë e ngjashme me poezi). Është shumë e zakonshme për një reklamues të përdor fjalë të cilat i përkasin disa shtresa të tjera leksikore të veçanta, me qëllim krijimin e një lidhjeje të ngushtë me audiencën e synuar. Pra, një reklamë televizive për Bitter

John Smith (një lloj birra) shfaqet sikur të ishte transmetimi i një ngjarjeje ndërkombëtare zhytjeje (reklama u shfaq menjëherë pas Lojrave të Commonwealth të vitit 2002).²⁴

Është shumë e lehtë për të gjetur shtresa të leksikut të veçantë në çdo reklame. Por është e nevojshme të njihet se si skenaristi i reklamës (copywriter) ka përdorur një regjistër të veçantë, apo veçoritë e një stili, i cili lidhet me llojin dhe imazhin e produktit, si dhe me sjelljet dhe vlerat që përfaqëson ajo audiencë.

Më poshtë, janë dhënë disa shembuj që janë marrë nga tekste të ndryshme të reklamave që janë botuar nëpër gazeta dhe revista të ndryshme (në kllapa jepet produkti dhe shkruesi i tekstit të reklamës).²⁵

Shembuj:

The British Airways Sale. Go on. Take off. (Reduced-price flights/British Airways)

Imagine a healthier fitter you. (Tanita body fat monitor)

Move Mountains. (Sim City 4 PC/Dixons)

Not so much a price as an invitation. (Flights to Spain/Iberia Airways)

Every year 39,200 women are newly diagnosed with breast cancer. (Medical insurance/AXA PPP healthcare)

Helps reduce and overcome smoking at your own pace. (NicoBloc)

Always on call. (Day & Night Nurse)

Technology with style. (DÉF614SS dishwasher/Smeg)

Pyetja që shtrohet, në lidhje me reklamat ka të bëjë, nëse gramatika e përdorur për këtë fushë është e veçantë. Përgjigja është positive. Si fillim, reklama ashtu sikurse edhe poezia, i jep të drejtën autorit që t'i shkëputet formave standarte. Së dyti, përdoren forma të shkurtuara gramatikore, ato që sipas Profesor Crystal-it²⁶ emërtohen si fjali të vogla (minore). Ekziston një lidhje e ngushtë me pragmatikën, duke qenë se reklamuesi bën shumë supozime për t'ja përcjellë audiencës. Është e pranueshme, që audiencia të intrigohet, në mënyra të ndryshme, me qëllim që të transmetohet informacioni i duhur që përmban reklama.

Më poshtë, shembuj të marr nga gazeta të ndryshme, ku janë sloganet e reklamave në gjuhën angleze për produkte, apo shërbime të ndryshme:

Shembuj:

Happy New Rate

Deals to remember

Currys sale/Free delivery plus Buy now pay 2004

EMAIL, INTERNET & TEXT MESSAGES

winter welcome

Free servicing for 3 years

Summer seats on sale

Në MB, ekzistojnë disa organe të posaçme të shtetit, të cilat kontrollojnë reklamat, si dhe gjuhën që përdorin ato. Reklamuesit, shpesh eksplorojnë mundësitë e konotacionit (*kuptimit të sygjeruar*), ndryshe nga përdorimi i denotacionit të drejtpërdrejtë (*kuptimit të nënkuptuar*), duke shfaqur meritat/cilësitë e produktit, pa e shprehur atë drejtpërdrejt.

Reklamat e bizneseve të ndryshme në media kanë për qëllim, të vënë në dijeni për daljen e mallit të ri; për të njohur klientët me cilësinë e mallrave; për të prezantuar çmimin e mallit; për të zbukuruar qytetin me pllakat (billboard); për të ndihmuar në ngritjen e standardit të jetesës përmes shtimit të prodhimit dhe, së fundi, për të edukuar shijen dhe për kulturë të re në qëndrimin ndaj mallit të ri.²⁷

Kuptohet që reklama ka për qëllim nxitjen për konsumim, por ajo ka edhe anët

negative të saj, duke krijuar stres për personat që nuk mund të arrijnë të blejnë produktin e caktuar. Reklamata e shfaqura nëpër gazeta apo emisione radio-televizive thyejnë monotoninë e përmbajtjes dhe të dizajnit të zakonshëm. Ajo informon, edukon, argëton, apo thjesht nxit një konsum gjithnjë në rritje. Prej këtu kuptohet që do të rritet parreshtur konsumi nga muaji në muaj dhe sikurse shtohet prodhimi, bie kostoja e produktit në një njësi kohe dhe ulet çmimi i tij në treg. Nga kjo mund të themi se ka bërë një vërshim në familjet tona, duke konsumuar një produkt të caktuar. Pra, reklama ndikon jo vetëm për të thyer monotoninë nëpër shtyp dhe në televizione, por edhe për të përmirësuar standardet e jetës. Media në një farë mënyre "ushqehet" prej saj, por në anën tjetër i hap rrugë biznesit për sukses dhe shitje të produkteve. Ja, kjo është një linjë e fuqishme midis medias dhe biznesit!²⁸

Nuk është aspak e rastësishme nëse në një reklamë televizive dëgjojmë gjuhën që përdorin të rinjtë apo edhe njerëzit në moshë të shtyrë.²⁹ Është plotësisht e lejueshme sipas ekspertëve të reklamave, sepse është mënyra më e mirë për të tërhequr një grup të caktuar konsumatorësh ose për të tërhequr pikërisht ata për të cilët është bërë produkti.³⁰

Në mes gjuhës së përditshme dhe gjuhës së reklamave ekziston një bashkëveprim, i cili nuk duhet nënvlerësuar dhe që nga njëra anë mund të shprehet që gjuha e reklamave përdor tendenca të gjuhës së përditshme, ose nga ana tjetër e zgjeron gjuhën e përditshme me përdorimin dhe marrjen e teksteve të reklamave në përdorimin e gjuhës së përditshme.

Një shembull konkret për ekzistimin edhe të të dyve mundësive është fjala „ist cool man"! prejardhja e së cilës pa dyshim që ka qenë nga gjuha e përditshme (gjuha e të rinjve), por pas përdorimit të kësaj fjalie në një kompani reklamuese nxiti një valë të re kulturore dhe me këtë në gjuhën e përditshme mori një drejtim të veçantë. Me gjithë përpjekjet që t'i qëndroje sa me afër gjithë reklames asaj të përditshmes përsëri gjuha e reklamave është artificiale dhe nuk posedon një realitet të të folurit, por është formuar për të krijuar efekt. Nga ana tjetër ajo i qëndron afër gjuhës folur.³¹

Por, qëllimi kryesor që një person bënë tekstin e një reklame është koncepti i mesazhit. Mesazhi duhet patjetër të ketë një efekt bindës me qëllim që mos e humb qëllimin e tij. Është detyra e konceptimit që të gjithë argumentet, informacionet, apelet e ndryshme dhe fjalimet t'i ngushtoj në atë mënyrë që qëllimi kryesor i informacionit të dërgohet deri te grupa qëllimore (target group). Mbi grupin qëllimore duhet të kemi të gjitha informacionet e mundshme para se të fillojmë ta punojmë konceptin.³²

Një reklamë duhet të përmbajë këto pika kryesore për të qene profesionalisht e suksesshme: Headline (titulli kryesor), Teksti, Slogani .

Pra, reklama duhet të ngrejë vëmendje. Kusht për këtë është një përmbledhje e ngjeshur e përmbajtjes. Vëmendja duhet psh, nëpërmjet të surprizave ,ose tërheqjeve (ndjelljeve) të kthehet në një interesim të vërtetë, nëpërmjet të sinjalizimit të preferencave të produktit duhet të krijohet një dëshirë (kërkesë), personi i qëllimit duhet të kalojë në veprimin që pritet.

Krahasimi i termave gjuhësorë të përdorura në sfera të ndryshme (teknike, shkencore, politike, administrative, etj)

Bazat e gjuhësisë teknike moderne u hodhën me konsolidimin e shtetit të parë shqiptar në vitet '20 të shekullit të kaluar. Edhe pse gjuha shqipe asokohe që ende e

panjësuar, ngritja e një sistemi modern ekonomik-juridik kërkonte pranimin, përshtatjen dhe shqipërimin e ligjeve dhe termave të Evropës Perëndimore.

Në këtë kontekst vlejën për t'u përmendur fuqizimi i një sërë ligjeve bazë, si p.sh. Kodi Civil, Kodi Tregtar etj. (të ashtuquajturat kodet e Zogut), bazë e së cilëve vërtet qenë kodet frënge dhe italiane, por megjithatë, ligjbërësit jepnin në pasqyrën e lëndës së kodeve lidhjet, madje edhe numrat e neneve korresponduese në kodet e disa vendeve të rëndësishme perëndimore.³³

Në këtë mënyrë bëhej i mundur një komunikim më i shpejtë dhe racional i juristëve shqiptarë, të cilët kishin studiuar në vende të ndryshme evropiane apo amerikane. Themelimi i Bankës së Shqipërisë, edhe pse me kapital italian, solli nevojën e përdorimit të një gjuhe ekonomike bankare, ndërsa futja e sistemit tatimor ndikoi në futjen e terminologjisë së tatimeve, si dhe në të kontabilitetit.

Është e qartë se, duke mos pasur traditë në këtë fushë, shqipja ekonomik-juridike u ndikua shumë nga gjuhët e sipërpërmendura. Këtu ndikoi gjithashtu edhe fakti që frëngjishtja, italishtja e shqipja kanë një strukturë të ngjashme fjalëformimi, në të cilën përngjitja e fjalëve si në gjermanishte apo greqishte, është e vështirë.

Ndoshta lexuesi i sotëm do të haste vështirësi përdorimi me kodin civil të Zogut, jo vetëm për shkak të përpilimit të tij në dialektin geg, por sepse një mori fjalësh të huazuara nga ky kod e të përdorura në kodin civil të sotëm, përdoren në gjininë femërore ose gabimisht.³⁴

Në këtë kontekst po jap disa shembuj: "enfiteoza" (Kodi Civil) "enfiteusi" (italisht) "emfiteusis" (latinisht) "emfiteozi" (Kodi i Zogut), ose "testament ollograf" (Kodi Civil) "testament holograf" (Kodi i Zogut), ose "enviksioni" (Kodi Civil) "eviksioni" (Kodi i Zogut) "evictio" (latinisht).³⁵

Terma të tjerë, si p.sh.

"Gjykata e Diktimit", "diktimon" janë zëvendësuar sot respektivisht me "Gjykata e Lartë/Gjykata e Kasacionit" dhe "ankohet/ankimon" ose "ushtron rekurs në Gjykatën e Lartë".

Ende pa zënë mirë rrënjë terminologjia e monarkisë shqiptare, pas Luftës së II Botërore, gjuhësia, e sidomos ajo teknike, u përball me sfida të reja, këtë herë nga gjuhët sllave. Ristrukturimi i shoqërisë dhe ekonomisë sipas modelit socialist, solli një terminologji të re, e cila zuri vend kryesisht në fusha, deri atëherë të panjohura ose të pazhvilluara, si në ushtri, industrinë e rëndë dhe tekstile.³⁶

Në fushën ekonomike dhe juridike, duke e lënë mënjanë përmbajtjen, terminologjia nuk pësoi ndonjë ndryshim rrënjësor. Fjalë të tilla, si p.sh. "bilanci", "zërat e bilancit" (italisht "voci di bilancio"), "fatura" (italisht "fattura"), "llogaria" (greqisht "logarismos"), "konto" (italisht "conto"), "debiton", "krediton", "rakordon", "revizion", "revizor" (italisht "addebitare", "accreditare", "raccordare", "revisione", "revisore") etj.,³⁷ të cilat përdoren edhe sot si terma të kontabilitetit, mbetën të pandryshuara. Madje, njësimi i shqipes në vitin 1974, si dhe përdorimi "de jure" i një shqipeje standarde në të gjithë hapësirën shqipfolëse, solli një përparim të madh në fushat që flasim.³⁸

Në kuadrin e standardizimit gjuhësor, u bënë arritje edhe një fushën e leksikologjisë. Fjalori i Shqipes së Sotme (1981),³⁹ e më pas fjalorët disa gjuhësh teknikë, juridikë, ekonomikë, tregtarë etj., edhe pse me kufizime, e madje duke e mënjanuar anglishten, qenë megjithatë frut i një pune të madhe të Institutit të Gjuhësisë. Përdorimi i detyruar i shqipes standarde në media, ushtri nga ana e vet një ndikim të dukshëm në konsolidimin e terminologjisë së atëhershme.⁴⁰

Një kthesë rrënjësore mori jo vetëm gjithë shoqëria shqiptare në përgjithësi në periudhën paskomuniste, por bashkë me të edhe gjuha shqipe. Në vazhden e një transformimi të shpejtë të ekonomisë kombëtare nga një ekonomi e planifikuar në

ekonomi tregu, terminologjia e kësaj fushe pësoi ndryshime të ndjeshme, e fatkeqësisht shumë herë duke iu shmangur jo vetëm traditës gjuhësore të deriatëhershme, por edhe duke thyer normat më elementare sintaksore, morfologjike e drejtshkrimore.⁴¹ Marrja e sistemit të kontabilitetit frëng në fillimin e viteve '90 solli në terminologjinë dhe gjuhën ekonomiko-juridike shqipe, së paku për një kohë shkurtër, një farë puritanzimi karakteristik për gjuhën frënge. Kështu p.sh., duke iu referuar ligjit për kontabilitetit (1993), termi "mjetet kryesore të ndërmarrjes" zëvendësohet me "aktive të qëndrueshme" (të trupëzuara dhe jo të trupëzuara), në një kohë që në të folmen e qeveritarëve përdoret rëndom anglikizma "asetet fikse" (anglisht "asset").⁴² Termi i ashtuquajtur i ri "letra me vlerë të vendosjes" është krejtësisht i pakuptueshëm, e siç mësova më vonë nga specialistët e bankës, ai do të thoshte "letra me vlerë të investuara në afat të gjatë", pra një pjesë e aktiveve.⁴³

Zëri i pasivit të bilancit "shuma të parashikuara për rreziqe" përdoret edhe në formën "provigjon" apo edhe "provixhon" (anglisht "provision"). Krejtësisht absurd tingëllon termi "ekspert kontabël" (frëngjisht "expert contable") ose "audit/auditor" (anglisht "auditor"), kur në traditën e deritanishme është përdorur për të emërtimi "revizor". Duhet përmendur këtu se "auditor" në shqip do të thotë sipas Fjalorit të Shqipes së Sotme "rreth dëgjuesish" ose "sallë leksionesh" (latinisht "auditorium") dhe jo "revizor". Në emër të depolitizimit të gjuhës ekonomike u zëvendësuan plotësisht pa kriter dhe me fantazi të madhe shumë terma. Kështu p.sh., "kooperativa" u zhduk si formë juridike e ndërmarrjeve tregtare, e si rrjedhojë një kooperativë bankare apo bankë kooperativiste (gjermanisht "Genossenschaftsbank").⁴⁴

Për

shembull:

"Raiffeisenbank" në Gjermani) quhet sot juridikisht "shoqëri kursim-kredi", "mbivlera" (gjermanisht "Mehrwert") mori formën "vlerë e shtuar", prej së cilës rrjedh edhe termi "tatim i vlerës së shtuar" (anglisht "added value tax").⁴⁵

Por nuk mungojnë edhe huazimet e pashqipëruara e të pakuptimta si "karrexhata" (Kodi Rrugor italisht "carreggiata") në vend të "xhade/sipërfaqe e rrugës", "draft" (anglisht) në vend të "projekt", "grant" (anglisht) në vend të "subvencion/ ndihmë/ përkrahje/ ndihmë" etj.⁴⁶

Teksa në ligjet e Zogut përkthyesi, ose specialisti jepte për termat të rinj specifike në kllapa shënimin në gjuhën e origjinës dhe në pasqyrën e lëndës edhe nenet në kodin e origjinës, kur lexon ligjet ekonomike shqiptare të sotme, duhet shumë herë ose të hamendësosh, ose të gjesh "originalin" në gjuhë të huaj për të kuptuar se për çfarë bëhet fjalë. Përballë vërshimit pa kriter të termave të huaj në shqipe, vërehen fatkeqësisht nga njëra anë një tërheqje e plotë e shtetit shqiptar nga detyrimi i tij kushtetues për mbrojtjen e gjuhës kombëtare, një apati e institucioneve gjuhësore, e nga ana tjetër një zhvillim të gjuhësisë terminologjike për arsye profesionale.

ZHVILLIMI I GJUHES

Zhvillimi i Gjuhës në Kontekstin Profesional

Komunikimi kërkon organizimin tërësor të lëndës gjuhësore. Ky është edhe organizimi parësor gjuhësor.¹ Ai është i rëndësishëm për të arritur komunikimin dhe ai e përcakton strukturën e gjuhës e zhvillimin e saj.

Gjuha e përdorur në media është e larmishme dhe tregon epërsinë që ka situata të veçanta gjuhësore ndaj regjistrimit leksikor të posaçëm. *Kamikazë*, p.sh, është një tjetër term që përdoret në botimet gazetareske, i cili tregon se sa kompleks mund të jetë zhvillimi i një gjuhe. Fjala ka kuptimin e “era hyjnore” ose “era e qiellit” (kuptimi i fjalës kamikazë në shqip). Në mënyrë të veçantë, iu referohej tajfuneve të fuqishëm të cilët në vitet 1274 dhe 1281 shkatërruan flotat Mongole të cilat ishin nisur për të pushtuar Japoninë. Japonezët, në fund të Luftës së Dytë Botërore, e përvetësuan emrin duke iu referuar një numri sulmesh vrasjesh.²

Shumë folës të gjuhës angleze mund ta konsiderojnë fjalën me prejardhje Japoneze, por nuk mund ta njohin shpjegimin e saktë historik për hyrjen e saj në përdorimin e gjuhës angleze.³ Falë shndërrimeve gramatikore, fjala tashmë përdoret edhe si mbiemër, kështu që mund ti referohet shprehjes sulme kamikaze “*kamikaze attacks*”, ose shofera/motorciklista kamikaze “*kamikaze drivers/motorcyclists*”. Në këtë rast kuptimi është shndërruar në kuptim metaforik. Në të vërtetë, eksitojnë vetëm disa fjalë për të cilat mund të japin etimologjinë e tyre me kaq saktësi.⁴

Shtresimi funksionale dhe shoqëror

Sferat e veprimtarisë njerëzore e vështrojnë botën nga një kënd i caktuar, e trajtojnë sipas synimeve të tyre dhe, rrjedhimisht, e mishërojnë më mjete e mënyra të ndryshme.⁵ Të gjitha këto lënë gjurmët e tyre dhe, krahas leksikut e togjeve asnjëse, formohen shtresa që kanë gjurmët e përdorimit karakteristik sipas shtresës.

Profesionalizmat janë fjalë dhe shprehje të përditshme të një profesioni, mjeshtërie ose dege të caktuar, që zakonisht nuk përdoren nga njerëzit e tjerë.⁶ Ndonëse kushdo mund të dijë fjalën cimë apo litar, atë e përdorin rregullisht vetëm detarët.

*Vlerat e tyre shprehëse janë sidomos dy:*⁷

përshkrimi me përngjashmim i veprimtarisë përkatëse;
karakterizimi i të folurit.

Mënyra e të folurit sipas një fushe veprimtarie ose profesioni kthehet gjithashtu në një karakteristikë shoqërore të atij grupi, që lë gjurmë mbi leksik.

Ndryshimet Historike dhe Moderne

Media dhe teknologjia kanë krijuar forma të reja (ose janë përvetësuar në mënyrë radikale format e vjetruara) të komunikimit. Këto forma të reja gjuhësore janë objekt studimi për linguistët (janë të thjeshta për tu studiuar) dhe një subjekt i njohur për studentët për tu vëzhguar. Kështu mund të përmendim mesazhet elektronike (e-mail-in), instant messaging etj.⁸ Ndërkohë që një letër (e stilit të vjetruar) ka një strukturë të përcaktuar (fikse) nga tradita e të shkruarit (shkruhet adresa e dërguesit, emri dhe adresa e marrësit, përshëndetjet e kështu me radhë), shkruarit e një e-maili nuk janë të sigurt se si mund të hapin dhe mbyllin një mesazh. Ndërkaq ata nuk i marrin parasysh rregullat drejtshkrimore. Shenja emocionuese (“smileys” ose

“smilies”) - si p.sh. :-) janë më të zakonshme të shkruhen në një e-mail sesa nëpër letra.⁹

Teksa gjuha në shoqëri reflekton sjellje dhe ide të përgjithshme sociale, kështu që, teksta nis Shekulli 21, tendenca më e fundit është të përdoret gjuha më pak formalisht. Por ndryshimet në gjuhë nuk kanë ndodhur gjithmonë në planin nga më formale në më pak formale.¹⁰ Gjatë kohëve të shkuara kjo tendencë mund të jetë e kundërt— historia e gjuhës tregon lëvizje në të dyja drejtimet.

Në mes të Shek. 18 anglishtja letrarë përshiu format poetike të diskonit që vinin prej gjuhëve klasike dhe sintaksës preskriptive—megjithatë ende nuk e dimë sesa është ndikuar gjuha e përditshme e njerëzve të pashkolluar prej këtij ndryshimi.¹¹

Ndërsa në Shek. 19 rritja e madhe e komunikimit të sferës së biznesit kërkonte një nivel të lartë të formalitetit. Kjo sepse letrat dhe kontratat kishin nevojë për një gjatësi më të madhe duke qenë se iu referoheshin produkteve dhe shërbimeve të cilat do të shpërndaheshin vite më vonë se data e hartimit të tyre, ose sepse ishin garancia për jetëgjatësinë e produktit.

Një lloj tjetër ndryshimi i cili ndodh në çdo gjuhë por që shfaqet dukshëm në gjuhën me kontekst profesional është përdorimi i konversionit gramatikor.¹² Në momentin që një term i ri hyn në gjuhë, është e pritshme të hyjë në kategoritë të re të fjalëve. Ndryshimet më të shumta janë ndryshimet nga emra në folje, ose nga folje në emra.

Për shembull:

Hoover (*Eng. Hoover*) është emri i një pajisje të një fshesë me korrent, por është shndërruar në folje : I must hoover the car. (*Me duhet të fshij makinën me fshesë me korrent*).¹³

E njëjta gjë ka ndodhur edhe me fjalën e-mail (*emër*): ti merr një e-mail, por gjithashtu to dërgon një e-mail (*e-mail to sb*) (*verb*).

Thelbësore për këto kontekste është ekzistenca e grupeve, dhe pjesëmarrja në këto grupe e ndërtuar dhe përfaqësuar nëpërmjet të folurit është pazgjydhshmërisht e lidhur me identitetin profesional. Kjo zhvendosje vëmendje tek bashkëbisedimi profesional ndërmjet grupeve sjell mjaft çështje analitike interesante të cilat pasqyrohen gjatë zhvillimeve në këtë fushë. Ndoshta pyetja themelore është ajo e bërë nga Drew dhe Heritage (1993)¹⁴ i cili shpjegon lidhje ndërmjet bashkëbisedimit të zakonshëm dhe bashkëveprimit institucionale në mënyrë specifike.

Ato përqendrohen në orientimin e identiteteve institucionale nëpërmjet referimit të personave, leksikut të zgjedhur, formave gramatikore, konkluzioneve specifiksht institucionale.¹⁵ Si klientë, apo si përfaqësues, për shembull, e krijojmë gjuhën që përdorim me qëllim që të arrijmë qëllime të veçanta institucionale. Veçantitë e këtij krijimi gjuhësore do të ndryshojnë nga institucioni në institucion dhe nga takimi në takim, por që ka fakte se fenomene të veçanta linguistike mund të evidentohen gjatë përdorimeve, si dhe gjatë kuadrit të ndryshëm institucionale.(shikoni, Drew 2003 mbi formalizimet).

Emrat dhe Adresat

Disa gjuhë kanë forma të ndryshme që i referohen vetës së dytë të numrit njëjës/shumës. (Frëngjisht “tu/vous”, Gjermanisht “du/Sie” etj).¹⁶

Format (“vous” dhe “Sie”) janë përdorur për t’ju referuar numrit shumë, ndërsa tani nënkuptojnë edhe nivelet e formalitetit, nëse përdorim “tu” dhe “du” është formë familjare, ndërsa format “vous” dhe “Sie” më të sjellshëm. Në gjuhën angleze kjo u shfaq me anë të kontrastit historik ndërmjet “you” dhe “thou/thee”. Forma “thou” kishte mbijetuar nga disa dialekte, ndërsa format e tjera familjare të përemra janë “youse” (Liverpool) dhe “you-all”(SHBA jugore). Kur është e mundur për të bërë dallimin, kjo njihet si sistemi i adresave T/V.¹⁷

Në këtë sistem forma V është një shënjesë i politesës, ose respektit. Gjithashtu, mund të jetë një shënjesë i statusit, me anë të formës V e cila përdoret për

nivelin e lartë menaxherial. Gjithashtu, përdorim i formës T për të shprehur solidaritet, ose intimitet.¹⁸ Në gjuhën angleze, shprehim statusin, ose pozitën nëpërmjet titujve, në fillim emrin dhe më pas mbiemrin. Titujt janë si p.sh., Profesor, Dr, Zotëri, Zonjë etj (professor, Dr, Sir, Dame).

Përfshihen edhe titujt honorifik si: Madhëria juaj, Shkëlqesia juaj, Zotëria im. (your royal highness, your excellency, my lord).¹⁹ Ndoshta më afër gjuhës dhe profesioneve janë ato forma të cilat shprehin një lidhje ndërmjet folësit dhe dëgjuesit, si p.sh. Shef, bos, zotëri, zonjë etj (chief, boss, sir, ma'am). Në disa profesione ato janë fakultative ndërsa disa profesione të tjera kanë një etiketë më zyrtare.

Vihet re et re se disa prej titujve ne i shkurtojmë gjatë të shkruarit, por jo gjatë të folurit— ne shkruajmë Mr., por e themi Mister, ne shkruajmë Dr. por e themi Doktor. Zakonisht titullin e Profesorit e shkurtojmë si në të shkruar edhe në të folur, në Prof. gjatë bisedave shprehen emrat e përveçëm (Fred, Suzana etj) dhe më pas epitetet si shef, shokë etj (chief, mate).²⁰

Nëse shikojmë të dhënat gjuhësore, do të vëmë re se si folësit i përdorin këto forma gjatë bashkëbisedimit. A janë thjesht lubrifikant social, apo folësit janë duke i përdorur për të supozuar një status më të lartë ose më të ulët, apo duan të forcojnë autoritetin ose respektin.

Karakteristikat e bashkëbisedimit

Disa (ndoshta pjesa më e madhe) e profesioneve kanë lloje të veçanta lidhur me bashkëbisedimin dhe tekstet e shkruara. Mund ti analizojmë këto karakteristika, veçanërisht duke u përqendruar tek karakteristikat të cilat pasqyrojnë qëllimin profesional, kontekstin, ose origjinën e tekstit.²¹

Shembuj mund të jenë:

një predikim i priftit, një fjalim i drejtorit, folësi gjatë një konference, etj.

Teksa analizojmë bashkëbisedimet, vini re strukturat dhe mënyrat sesi realizohet kjo gjë—cilat janë elementet e strukturës (pauzat, pyetjet të cilat sjellim përgjigje, numërimi i pikave, përsëritja, shprehjet ndajfoljore, etj).

Shikoni mjetet stilistikore dhe karakteristikat pragmatike të cilat përcaktojnë llojin e bashkëbisedimit konteksti si dhe përshtypjen e folësit lidhur me audiencën.

*Profesionet për tu marr në konsideratë:*²²

Spektori privat dhe profesionet— biznesi, fushat ekonomike, financa, TI, sektori ligjor, menaxhimi, farmaceutika (business, accountancy, finance, IT, law, management, pharmacy)

Media—reklamata, transmetimet televizive, media e re p.sh. teknologjitë dhe shërbimet e Internetit, media e shkruar (advertising, broadcasting media, new media—p.sh. Internet technologies and services, print media)

Tregtia dhe sipërmarrjet—sektori ndërtimit, bujqësia, hidraulika, inxhinieria elektrike, tregtia motorike, tregtia (building, farming, plumbing, electrical engineering, the motor trade, trade)

Spektori i shitjeve—supermarketet, dyqanet, mobilieritë, dyqanet me pajisje elektronike, butikët (supermarkets, department stores, furniture shops, electrical goods shops, boutiques).

Sport, aktivitete argëtuese—teatër, artet pamore, galeri dhe muzeume, klube sportive, qendra argëtuese (theatre, performing arts, galleries and museums, sporting clubs, leisure centers)

Udhëtimet dhe Turizmi— linjat ajrore, operatorët hekurudhorë, kompanitë lundruese, operatorët e autobuzave, hotelet dhe resortet. (airlines, train operators, ferry companies, bus and coach operators, hotels and resorts).

Përfundime

Bazat e gjuhësisë teknike moderne u hodhën me konsolidimin e shtetit të parë shqiptar në vitet '20 të shekullit të kaluar. Edhe pse gjuha shqipe asokohe qe ende e panjësuar, ngritja e një sistemi modern ekonomiko-juridik kërkonte pranimin, përshtatjen dhe shqipërimin e ligjeve dhe termave të Evropës Perëndimore.

Referencat

- Wiley, G Terrence, *Communicating in the Real World: Developing Communication Skills for Business and the Professions*, 1 dhjetor 1986, f1 24-25.
- *Montgomery, Martin, An Introduction to Language and Society (Studies in Culture and Communication)* 24 qershor 2008, fq 230-235.
- ICT- Information and Communication Technology – referuar përkufizimit të wikibooks “ICT i referohet teknologjive të informacionit dhe komunikimit, të cilat, për këtë qëllim konsiderohen si një numër mjetesh dhe burimesh teknologjike të cilat përdoren për të komunikuar dhe krijuar, shpërndarë, depozituar dhe menaxhuar informacionin. Këto teknologji përfshijnë kompjuterat, Internetin, teknologjitë transmetuese (radion dhe televizionin).”
- Target Language – referohet gjithashtu si object language. “1.The language into which a text written in another language is to be translated.2. A language that a nonnative speaker is in the process of learning.3. Computer Science The computer language, often a machine language, into which a document written in another computer language is to be translated.” The American Heritage® Dictionary of the English Language, Fourth Edition copyright ©2000 nga Houghton Mifflin Company. Përditësimi 2009.
- Widdowson, H. G., 1983. *Learning Purpose and Language Use*. Oxford: Oxford University Press.
- Young, D., 1999. Linguistic simplification of SL reading material: Effective instructional practice? *The Modern Languages Journal*, 83, 3, 350-66.
- Wright, T. 1987. *Roles of Teachers and Learners*. Oxford: Oxford University Press. Yano Y., M. Long and S. Ross, 1994.
- Phillipson, R., 1992. *Linguistic Imperialism*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Picken, J., 1999. State of the ad: The role of advertisements in EFL teaching. *ELT Journal*, 53, 4, 249-55.
- Pugh, A., 1996. ‘A history of English teaching’, in: N. Mercer and J. Swann, eds *Learning English: Development and Diversity*. Routledge: London, 159-87.
- Rossner, R., 1988. Materials for communicative language teaching and learning. *Annual Review of Applied Linguistics*, 8, 140-63.
- Selinker, L., 1972. Interlanguage. *International Review of Applied Linguistics*, 10, 209-31.
- Brumfit and R. Carter, eds. *Literature and Language Teaching*. Oxford: Oxford University Press, 89-109.
- Sinclair, J., 1991. *Corpus, Concordance, Collocation*. Oxford: Oxford University Press.
- Alderson and A. Urquhart, eds. *Reading in a Foreign Language*. London: Longman, 48-61.
- Stubbs, M., 2001. Texts, corpora, and problems of interpretation: a response to Widdowson. *Applied Linguistics*, 22, 2, 149-72.
- 10. Stevens, V., 1995. Concordancing with language learners: Why? when? what? *CAELL Journal*, 6, 2, 2-10.
- 11. Swaffar, J., 1985. Reading authentic texts in a foreign language: A cognitive model. *The Modern Language Journal*, 69, 1, 16-32.

- 12. Swales, J., 1990. *Genre Analysis: English in Academic and Research Settings*. Cambridge: University of Cambridge Press.
- 13. Toh, G. and M. Raja, 1997. *ELT Materials: Some perceptions on the questions of cultural relevance*. *Guidelines*, 5, 19 part 2, 45-72.
- 14 Tomalin, B. and S. Stempleski, 1993. *Cultural Awareness*. Oxford: Oxford University Press.
- 15. Tomlinson, B. ed., 1998. *Materials Development in Language Teaching*. Cambridge: Cambridge University Press.
- 16. Walton, R. and M. Bartram, 2000. *Initiative*. Cambridge: Cambridge University Press.
- 17. *Guardian Newspaper*: 31 May 2000/ 1 June 2007.
- 17. Warschauer, M., 1998a. *Online learning in sociocultural context*. *Anthropology and Education Quarterly*, 29, 1, 68-88. Retrieved 30 July 2003 nga <http://www.gse.uci.edu/markw/online.html>
- 18. Warschauer M., and R. Kern, eds., 2000. *Network-based language teaching: Concepts and practice*. New York: Cambridge University Press.
- 19. Taylor, L., 1997. *International Express, Pre-Intermediate*. Oxford: Oxford University Press.
- 20. Taylor, L., 1997. *International Express, Intermediate*. Oxford: Oxford University Press.
- 21 Ogilvy, D *Grammar, Structure and Style*, Oxford, 1994, p. 177
- 22. Thornbury, S., 2000. *McEnglish in Australia*. Paper given at the 13th EA Educational Conference (English in Australia, Australia in English), Fremantle, Western Australia, October 2000.
- 23 Warschauer, M., 1998a. *Online learning in sociocultural context*. *Anthropology and Education Quarterly*, 29, 1, 68-88. Retrieved 30 July 2003 nga <http://www.gse.uci.edu/markw/online.html>
- 24 Widdowson, H. G., 2001. *Interpretations and correlations: A reply to Stubbs*. *Applied Linguistics*, 22, 4, 531-38.
- 25 Willis, J., 1996. *A Framework for Task-Based Learning*. Harlow: Addison Wesley Longman Ltd.
- 26 Tomlinson, B., B. Dat, H. Masuhara, R. Rubdy, 2001. *EFL Courses for adults*. *ELT Journal*, 55, 1, 80-101.
- 27. Widdowson H. G., 1979a. 'The authenticity of language data', in: H. G. Widdowson, ed. *Explorations in Applied Linguistics*. Oxford: Oxford University Press.
- 28. Wood, D., 1995. *Film communication in TEFL*. *Video Rising: Newsletter of the Japan Association for Language Teaching*, 1995, 7(1).
- 29. Sharwood Smith, M., 1994. *Second Language Learning: Theoretical Foundations*. London: Longman
- 30 Widdowson H. G., 1979a. 'The authenticity of language data', in: H. G. Widdowson, ed. *Explorations in Applied Linguistics*. Oxford: Oxford University Press.
- 31 Sharwood Smith, M., 1994. *Second Language Learning: Theoretical Foundations*. London: Longman.
- 32 Shanahan, D., 1997. *Articulating the relationship between language, literature and culture: Towards a new agenda for foreign language teaching and research*. *The Modern Language Journal*, 81, 2, 164-74.
- 33 McCarthy, M. 1998. *Spoken Language and Applied Linguistics*. Cambridge: Cambridge University Press.
- 34 McGarry, D., 1995. *Learner Autonomy 4: The Role of Authentic Texts*. Dublin: Authentik Language Learning Resources Ltd.

- 35 McKay, S., 1991. 'Literature in the ESL classroom', in: C. Brumfit and R. Carter, eds. *Literature and Language Teaching*. Oxford: Oxford University Press, 191-8.
- 36. Shkurta, Gj. 2009: Sociolinguistika e gjuhës shqipe, fq. 120-230
- 37. Shkurta, Gj. 2006: Kultura e gjuhës shqipe, fq. 35-69.
- 38. Thomai, J. 2012: Leksikologjia e gjuhës shqipe, fq. 130-240.
- 39. Shkurta, Gj. 2009: Sociolinguistika e gjuhës shqipe, fq. 120-230.
- 40. Shkurta, Gj. 2006: Kultura e gjuhës shqipe, fq. 35- 60.
- 41. Willing, K., 1988. *Learning Styles in Adult Migrant Education*. Adelaide: National Curriculum Resource Centre.
- 42. Valdes, J., 1986a. 'Culture in literature', in: J. Valdes, ed. *Culture Bound: Bridging the Gap*. Cambridge: Cambridge University Press, 137-47.
- 43. Sweet, H., 1899. *The Practical Study of Languages*. London: J.M. Dent and Co.
- 44. Swales, J., 1990. *Genre Analysis: English in Academic and Research Settings*. Cambridge: University of Cambridge Press.
- 45. Oxenden C. and C. Latham-Koenig, 2001. *English File*. Oxford: Oxford University Press.
- 46. Murison-Bowie, S., 1993. *Micro-Concord Manual: An introduction to the practices and principles of concordancing in language teaching*. Oxford: Oxford University Press.

DUKURITË GJUHËSORE PËRMES TEKSTIT LETRAR

GRETA JANI

Universiteti "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS

greta_jani@yahoo.com

Summary

This paper aims to explore some linguistic phenomena observed in literary texts of three high school levels . The text in general , and in particular literary text is the most important and necessary element object of Albanian language and literature, because through it all objectives of the program are realized . Work done with language in literary texts (narrative , poetic , dramatic) in high school is reflected in the paper by graphic presentations . Also presented some linguistic phenomena studied in literary texts in the lexicon , syntax , morphology , word formation , phonetics , spelling etc . In conclusion , note that the study of linguistic phenomena through literary texts should get the attention they deserve from teachers and pupils during the course Albanian language and literature. They should deepen their linguistic analysis of the text , as literary text analysis is not complete without a study of the language in which it is written text.

Keywords: linguistic phenomenon, literary texts, language culture, norm, graphic.

Përmbledhje

Ky punim synon të hulumtojë disa dukuri gjuhësore që evidentohen në tekstet letrare të tri niveleve të shkollës së mesme. Teksti në përgjithësi, dhe teksti letrar në veçanti, është elementi më i rëndësishëm e i domosdoshëm i lëndës gjuhë shqipe dhe letërsi, pasi nëpërmjet tij realizohen gjithë objektivat e programit. Puna që bëhet me gjuhën në tekstet letrare (tregimtare, poetike, dramatike) në shkollën e mesme është pasqyruar në punim me anë të paraqitjeve grafike. Gjithashtu janë paraqitur disa nga dukuritë gjuhësore që studiohen në tekstet letrare në leksik, sintaksë, morfologji, fjalëformim, fonetikë, drejtshkrim etj. Në përfundim, theksohet që studimi i dukurive

gjuhësore përmes teksteve letrare duhet të marrë vëmendjen e merituar nga mësuesit e nxënësit gjatë zhvillimit të lëndës gjuhë shqipe dhe letërsi. Ata duhet të thellohen në analizat gjuhësore të tekstit, pasi analiza letrare e tekstit nuk është e plotë pa studimin e gjuhës me të cilën ai tekst është shkruar.

Fjalët kyç: dukuri gjuhësore, tekst letrar, kulturë gjuhësore, normë, grafik.

- **Përparësi të studimit të lëndës “Gjuhë shqipe dhe letërsi” në gjimnaz**

Reforma kurrikulare e arsimit parauniversitar është një ndër reformat më të rëndësishme që ka ndërmarrë MAS-i për të realizuar synimin kryesor të saj, atë të edukimit cilësor të brezit të ri. Për mbarëvajtjen e këtij procesi është e domosdoshme të hartohet dhe zhvillohet një kurrikul cilësore e me standarde të përcaktuara dhe të njohura mirë.

Lënda “Gjuhë shqipe dhe letërsi” është lënda bazë e kësaj kurrikule. Ajo zhvillohet si lëndë mësimore në shkollat e mesme dhe u bën gati 10 vjet, nga viti 2003-2004, që gjuha shqipe mësohet e integruar me lëndën e letërsisë. Integrimi synon t’i aftësojë nxënësit në përdorimin e gjuhës dhe trajtimin e letërsisë si një proces aktiv për ndërtimin e domethënies së kuptimit.

Përparësi tjetër e zhvillimit të kësaj lënde është formimi më i thelluar gjuhësor i nxënësve, si edhe arritja e synimit që kultura gjuhësore në gjuhën amtare t’i përgjigjet kërkesave të sotme të komunikimit bashkëkohor në dinamikën e vet¹. Nxënësi sot është i ndërgjegjshëm për fuqinë që ka gjuha dhe letërsia në jetën e tij, ndaj e përdor gjuhën në forma të ndryshme. Gjuha shqipe dhe letërsia i japin nxënësit mundësinë të komunikojë në ligjërimin e folur dhe të shkruar, si edhe e aftësojnë për të depërtuar në analizën e veprave letraro-artistike.

Kurrikula e re e gjimnazit solli natyrshëm ndryshimim e programeve lëndore duke përfshirë këtu edhe programin e gjuhës shqipe dhe letërsisë. Programet e lëndës “Gjuhë shqipe dhe letërsi” për klasat 10, 11, 12 janë ndërtuar duke marrë parasysh rolin e gjuhës dhe të letërsisë në jetën e njeriut. Ato mbështeten në parimin që gjuha dhe letërsia përbëjnë themelet në procesin e të mësuarit, komunikimit, formimit të identitetit personal e kulturor, si dhe të lidhjeve ndërnjerëzore².

- **Teksti letrar element i rëndësishëm i lëndës së gjuhës shqipe**

¹Instituti i kurrikulave dhe standardeve, *Kurrikula dhe shkolla*, Tiranë, 2006, f. 59.

² Instituti i kurrikulës dhe trajnimit, *Programi i lëndës gjuhë shqipe dhe letërsi për klasën 10*, Tiranë, 2008, f. 2

Në programin e lëndës “Gjuhë shqipe dhe letërsi” të klasës së 10^{të}, në pjesën e parë përfshihen lloje të teksteve joletrare (35%) dhe realizimi i objektivave lidhet me përdorimin e gjuhës në përgjithësi si mjet komunikimi dhe të gjuhës shqipe në situata të ndryshme komunikimi (verbale dhe joverbale).

Në pjesën e dytë, realizimi i objektivave lidhet me tekstet letrare (45%), përdorimin e gjuhës së figurshme, komentet dhe analizat e veprave letrare dhe në përqindje më të pakët rimerren tekstet e tjera joletrare (20%).

Po kështu, në programin e kësaj lënde në klasën e 11^{të}, lloje të teksteve letrare zënë një hapësirë rreth 43% , pra, diçka më pak dhe në klasën e 12^{të}, llojet e këtyre teksteve përfshijnë 45% të lëndës.

Pra, është e qartë se në tri vitet e gjimnazit nxënësi studion lloje të teksteve letrare në masën 43%-45%, ndërsa studimi i teksteve joletrare përfshin 55%-57% të programit, pra, pjesën më të madhe, për shkak të funksionit praktik që këto tekste kanë.

O’Sullivan-i³ e shikon letërsinë si një veprimtari e cila përfshin dhe përdor gjuhën si një mjet me anë të të cilit mund të zhvillohet vlerësimi i nxënësve ndaj sistemeve të ndryshme gjuhësore. Të studiuarit e letërsisë në tërësi është një marrëdhënie ndërvepruese midis lexuesit të letërsisë e gjuhës. Të studiosh gjuhën përmes teksteve letrare është më e dobishme se ta studiosh atë përmes teksteve joletrare, sepse tekstet letrare sjellin kontekste autentike, tema të reja dhe gjuhë të pa hasur më parë.

Gjithsesi, teksti është elementi më i rëndësishëm e i domosdoshëm i lëndës së gjuhës shqipe dhe të letërsisë, pasi nëpërmjet tij realizohen gjithë objektivat e programit.

Evidentimi i dukurive gjuhësore në këto tekste është një prej këtyre objektivave të programit të lëndës “Gjuhë shqipe dhe letërsi”. Në tekstet letrare përftohen dukuri të ndryshme gjuhësore të cilat nxënësi ka për detyrë t’i zbulojë, t’i interpretojë, t’i analizojë, të sintetizojë, të vlerësojë dhe të nxjerrë përfundime rreth përdorimit dhe funksionit të tyre.

Zhvillimi i aftësisë dalluese dhe interpretuese të nxënësit në lidhje me dukuritë e ndryshme gjuhësore, si dhe inkurajimi për të paraqitur produkte krijuese ku dukuri të tilla zënë vend, janë elemente të rëndësishme të lëndës së gjuhës shqipe dhe letërsisë.

Sapo përfundon studimi i teksteve joletrare dhe fillon studimi i teksteve letrare, nxënësi shfaq një përqendrim e interes më të madh në orën e mësimit, ndoshta ndihet i motivuar edhe nga veprat letrare që ai ka lexuar dhe nga informacioni paraprak që ka marrë lidhur me to. Gjithashtu, duke studiuar

³ O’Sullivan, R. (1991). Literature in the Language Classroom. *The English Teacher*.

veprat letrare, nxënësi kupton gjithnjë e më mirë sesi krijuesit e tyre përdorin gjuhën për të krijuar efekte emocionale, estetike, si: meditimi, heroikja, e madhërishmja, patosi, humori, ankthi, etj. Ai përfshihet në një proces aktiv ku ai gjën krijon, kupton, ndërton duke zhvilluar kështu vetëdijen e tij gjuhësore.

Të zhvillosh vetëdijen gjuhësore të nxënësit do të thotë ta ndihmosh të bëhet i ndërgjegjshëm për atë që di për gjuhën dhe më pas të bëhet i ndërgjegjshëm për të ndërtuar mbi këtë dijeni. Rritja e ndërgjegjësimit gjuhësor nuk do të thotë vetëm studimi tradicional i gramatikës, i rregullave të sintaksës dhe të pikësimit, i ndërtimit të fjalive, i funksionit të fjalës në fjali etj. Analiza ka treguar se të mësuarit tradicional nuk është i mjaftueshëm për zhvillimin e rrjedhshmërisë në të shkruar dhe në të folur.

- **Njohuritë gjuhësore përmes veprimtarive praktike**

Tekstet e “Gjuhës shqipe dhe letërsisë” në arsimin parauniversitar janë ndërtuar në mënyrë të tillë që njohuritë gjuhësore të merren nëpërmjet veprimtarive praktike, zbatimit konkret të tyre në tekstet letrare. Për t’i kuptuar këto tekste, vëmendja, veç të tjerash, duhet të përqendrohet edhe tek zbulimi dhe përdorimi i dukurive gjuhësore, si: *polisemia, homonimia, sinonimia, antonimia, hiperonimia/hiponimia, fjalëshpejtat, shprehjet frazeologjike etj.*

Praktika jonë e përditshme tregon se puna me gjuhën mund të zhvillohet në të gjitha ndarjet e programit, por aspektet ku kjo punë ka më shumë efektivitet janë orët e komentit letrar, sepse në praktikën e studimit të tekstit, zbulimi i brendisë ideore realizohet përmes analizës së gjuhës. Ushtrimet gjuhësore sigurojnë përvetësimin e vetëdijshëm të materialit gjuhësor. Ato ndihmojnë mjaft për zhvillimin e të menduarit logjik e të të arsyetuarit të nxënësve, u krijojnë mundësi atyre të përqendrohen më gjatë në vëzhgimin e dukurive gjuhësore e të thellohen në studimin e tyre. Nxënësit, të drejtuar nga mësuesi, mësohen të bëjnë analizën e fakteve e të dukurive gjuhësore, të bëjnë përgjithësime të kuptojnë më mirë lidhjen mes teorisë e praktikës.

Nëse nuk do t’i mëshonim siç duhej punës me gjuhën e një vepre letrare, s’mund të themi se kemi realizuar plotësisht orën e komentit, pasi dihet që përdorimi i mjeteve të shumta e të goditura stilistike, ndikon drejtpërdrejt në përmbajtjen e veprës letrare, cilësinë, përpikmërinë, pastërtinë e saj.

Në punën për evidentimin e dukurive gjuhësore në tekstet letrare nxënësi mund të japë ndihmesë të madhe. Në detyra shtëpie apo klase nxënësit që kanë fituar njohuri të mjaftueshme gjuhësore me shumë zell e dëshirë kërkojnë të gjejnë në tekstet letrare dukuritë gjuhësore e të marrin pjesë gjallërisht në diskutimin e tyre. Kjo bëhet dhe më interesante, kur fragmentet jepen në gjuhën e tyre burimore.


Në analizën e një teksti tregimtar nxënësi kupton se autori përdor kodin-gjuhë për të rrëfyer një ngjarje. Gjatë leximit të tekstit synohet që nxënësi të kuptojë si dhe pse autori i tekstit e ka manipuluar gjuhën, si edhe i kërkohet të evidentojë dukuritë gjuhësore që krijohen e përdoren prej tij.

Më tej, nga puna e detajuar që bëhet lidhur me gjuhën e veprave letrare në përgjithësi, bëhet vlerësimi i secilit krijim letrar si në prozë, ashtu edhe në poezi.


- **Paraqitja grafike e punës me gjuhën në tekstet letrare**

Gjithë punën që bëhet me gjuhën në tekstet letrare (tregimtare, poetike, dramatikë) jemi përpjekur ta pasqyrojmë me anë të këtyre paraqitjeve grafike.

Në tekstin “Gjuhë shqipe dhe letërsi 10” të tria llojet e teksteve studiohen nga ana gjuhësore, por më tepër punë me gjuhën, për evidentimin e dukurive gjuhësore dhe funksionin e tyre stilistik, planifikohet në tekstin tregimtar dhe poetik, pothuajse në të gjitha periudhat letrare.



Në paraqitjen grafike të punës me gjuhën për klasën 11 vihet re që teksti poetik studiohet më shumë nga ana gjuhësore, pothuaj në të gjitha periudhat e më pak studiohen dy llojet e tjera teksteve, teksti tregimtar e ai dramatik.



Dhe për klasën 12, paraqitja grafike tregon qartë se evidentimi i dukurive gjuhësore bëhet në tri llojet e teksteve, por kufizohet në vepra të autorëve që i përkasin një apo dy periudhave letrare.





Tabela përmblledhëse më poshtë paraqet grafikisht dendurinë e punës me gjuhën në tri klasat e gjimnazit.



Pra, puna me gjuhën në tekstet letrare zë një hapësirë të konsiderueshme në orën e mësimit, por ka edhe tekste letrare për të cilat nuk parashikohet fare studim nga ana gjuhësore. Të tilla tekste janë: drama “Vilhelm Tel” (klasa e 10^{të}), “Tiranozauri” (klasa e 11^{të}), “Izraelitë dhe filistinë”, “Abeli” (klasa e 12^{të}). Për këto tekste është parashikuar vetëm studimi i tyre nga ana letrare.

- **Dukuri gjuhësore në tekstet letrare**

Më poshtë po paraqesim disa nga dukuritë gjuhësore që studiohen në tekstet letrare në të tri vitet e gjimnazit:

Më poshtë po paraqesim disa nga dukuritë gjuhësore që studiohen në tekstet letrare në të tri vitet e gjimnazit:

a) *në leksik*: dukuri leksikore, si sinonimet, antonimet, homonimet, lëvizja kuptimore e fjalëve dhe funksioni stilistik i tyre; p.sh.antonimet që përftohen nga përshkrimi i bukurisë së Esmeraldës dhe shëmtisë së Kuazimodos tek “Katedralja e Parisit” e V. Hygo, sinonimet që përdoren për të karakterizuar shqiptarin te poema “Çajld Harold” e Bajronit apo figurën e pelegrinit te poezia “Pelegrini” i D. Agollit, evidentimi i krahinorizmave, dialektalizmave, anakronizmave te “Don Kishoti” i Servantesit, leksiku popullor dhe frazeologjia te “Vjeshta e Xheladin Beut” e M. Kutelit etj; fjalët dialektore dhe kthimi i tyre në gjuhën standarde, si: “Tragjedi apo Komedi” e Migjenit, “Ura me tri harqe” e Kadaresë, “Korbi” e M. Camajt, “14 vjeç dhëndër” e Çajupit etj; lëvizja kuptimore e fjalëve që shkakton përftesa stilistike te “Kitara” e Lorkës, “Këngë pleqërishte” e Lasgushit etj; funksioni leksikor i fjalëve banale të

personazheve të “Duke pritur Godonë” e Beket etj.; puna me fjalorin të “Metamorfosis” e Fishtës, “Pelegri” i Agollit, etj

b) në sintaksë: ndërtimi sintaksor i fjalive psh.: Te “Historia e Skënderbeut” e M. Barletit, “Një dashuri e Suanit” e M. Prustit, “I huaji” i A. Kamysë, “Njëqind vjet vetmi” e Markezit, “Pallati e ëndrrave” i Kadaresë; sintaksa poetike të vargjet e “Iliadës”, të “Cikli i këngëve të kreshnikëve”; përsëritja e shpeshtë e fjalëve në fjali dhe funksioni sintaksor e stilistik i tyre etj.

c) në morfologji: evidentimi i mjeteve morfologjike të shprehësisë të “Katedralja e Parisit”, “Tragjedi apo komedi”, “Këngët e Milosaos”, “Prometet”, “Romeo dhe Zhuljeta”, “Vaji i bylbylit”, “ Në vend të përshëndetjes” etj; fjalët kyç, klasa leksiko-gramatikore e tyre, pothuajse në pjesën më të madhe të teksteve etj.

d) në fjalëformim: formimi i foljeve të “Një vjet” e M. Camajt, formimi i emrave të personazheve të “Gof” e Pashkut etj.

e) në fonetikë: grupi zanor *ou* të “Laudans invocabo dominum” e P. Budit, deformimi fonetik i fjalëve gas, llaftari të “Vdekja e Nositit” e Poradecit, etj.

d) në drejtshkrim: ë-ja fundore të fjalë të poezisë “Laudans invocabo dominum” e P. Budit , “Bukuria” e N. Frashërit, etj.

Siç shihet, leksiku është pjesa më e studiuar e gjuhës së këtyre teksteve dhe puna për evidentimin e dukurive leksikore zë hapësirën më të madhe gjatë orës së mësimt.

Vlera e veprës letrare, nënkupton edhe vlerën gjuhësore⁴, ndaj theksojmë se puna për evidentimin e vlerave gjuhësore të këtyre teksteve duhet të mos mungojë në orët e analizave e komenteve letrare, madje trajtimit të ushtrimeve apo pyetjeve me karakter gjuhësor u duhet lënë një hapësirë më e madhe gjatë zhvillimit të kësaj lënde. Në këtë mënyrë ora e mësimt realizohet me rendiment e cilësi të lartë dhe garanton një formim gjuhësor më të thelluar të nxënësve.

Parë nga një këndvështrim tjetër, edhe mësuesi duhet të jetë krijues dhe iniciues i ideve dhe detyrave të reja, që ai gjykon se duhen trajtuar në orën e mësimt dhe jo zbatues mekanik i tekstit. Ai duhet të kuptojë frymën dhe qëllimin e çdo mësimi, të përgatisë modele të shumta dhe të larmishme ushtrimesh duke kapërcyer ndonjëherë ngërçe që vijnë nga hartimi i tekstit apo niveli i klasës.

Duke punuar me objektiva të caktuara, mësuesi e ka të qartë se formimi gjuhësor i nxënësve është një punë e vazhdueshme, e cila shtrihet në të gjithë procesin e mësimdhënies, por kjo nuk do të thotë se çdo moment të mësimt të letërsisë duhet të merremi me gjuhën dhe aq më pak që puna me

⁴ N. Lekaj, *Gjuha shqipe dhe letërsia në shkollë*, “Gërshetimi i komentit letrar me kërkesat gjuhësore në veprat e letërsisë së traditës”, SHBLSH, Tiranë, 1986, f. 94.

gjuhën të trajtohet vend e pa vend në orën e mësimit të letërsisë. Në këto orë, gjuhës i lihet aq vend sa duhet dhe këtë e bëjnë mirë një mësues me përvojë dhe i përkushtuar.

- **Përfundim**

Në përfundim të këtij punimi theksojmë që studimi i dukurive gjuhësore përmes teksteve letrare duhet të marrë vëmendjen e merituar nga mësuesit e nxënësit gjatë zhvillimit të orës së mësimit.

Mësuesi në plan-ditarin e tij duhet të ndërtojë objektiva specifike për evidentimin e këtyre dukurive gjuhësore, mënyrën e ndërtimit e më tej për rolin apo funksionin stilistik që ato kryejnë duke qenë të ndërthurura edhe me njohuritë letrare.

Por edhe nxënësi duhet të ndërgjegjësohet përfundimisht, që studimi apo analiza e tekstit nuk përfundojnë pa studimin e gjuhës me të cilën ai tekst është shkruar, duke nxjerrë në pah të gjitha veçoritë e saj, dukuritë që përftohen në fonetikë, leksik, fjalëformim, sintaksë, etj.

BIBLIOGRAFIA

Instituti i kurrikulave dhe standardeve, *Kurrikula dhe shkolla*, Tiranë, 2006, f. 59.

Instituti i kurrikulës dhe trajnimit, *Programi i lëndës gjuhë shqipe dhe letërsi për klasën 10*, Tiranë, 2008, f. 2

O'Sullivan, R. (1991). Literature in the Language Classroom. *The English Teacher*.

N. Lekaj, *Gjuha shqipe dhe letërsia në shkollë, "Gërshetimi i komentit letrar me kërkesat gjuhësore në veprat e letërsisë së traditës"*, SHBLSH, Tiranë, 1986, f. 94.

Tekste "Gjuhë shqipe dhe letërsi 10", Shtëpia botuese "ALBAS", Tiranë.

Tekste "Gjuhë shqipe dhe letërsi 11", Shtëpia botuese "ALBAS", Tiranë.

Tekste "Gjuhë shqipe dhe letërsi 12", Shtëpia botuese "ALBAS", Tiranë.

VORBULLA E PASHMANGSHME “GOOGLE TRANSLATE”

Dr. ILDA KANANI

Lektore e Shkencave Përkthimore, Departamenti i Gjuhëve të Huaja,
Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë
kanani.ilda@gmail.com

Abstrakt

Ky artikull trajton një nga problemet më të zakonshme që has përkthimi i materialeve të ndryshme në ditët e sotme, i cili është përkthimi me anë të metodës kompjuterike “*google translate*”. Ai ndalet në faktin se shumë persona ia besojnë përkthimin e materialeve që u nevojiten pikërisht përkthimit që ofron “*google translate*”, pa u shqetësuar aspak për cilësinë shumë të dobët të variantit të përkthyer dhe gafat sintaksore, drejtshkrimore dhe mbi të gjitha kuptimore që mbart teksti i përkthyer.

Nëpërmjet analizimit të disa fragmenteve të marra nga tipologji të ndryshme tekstesh, artikulli kërkon të hedhë dritë mbi problemet reale që mbart një tekst i përkthyer me “*google translate*”, probleme që u shtohet edhe fakti tjetër, që zakonisht këto tekste nuk redaktohen aspak përpara përdorimit të tyre për arsye të ndryshme nga të interesuarit.

Artikulli ngre si shqetësim serioz përdorimin pa kriter të këtyre përkthimeve nga ana e studentëve kryesisht si detyra kursi apo tema diplomash dhe e konsideron të rëndësishme ndërgjegjësimin e përdoruesve të këtyre metodave, për të shmangur përkthimet pa nivel dhe me gafa skandaloze në të mirë të një pune serioze.

Fjalë kyç: *google translate, tekst burimor, tekst mbrritës, e pashmangshme, vorbull*

Abstract

This paper treats one of the nowadays problems the translation faces today, which is translation of different documents using the “*google translate*” method. The paper emphasises the fact that the majority of people in Albania who need translation for several purposes, usually do this by using the “*google translate*” machine on the internet, which is wrong due to the linguistic and communicative mistakes it imposes. Furthermore, such users do not worry about the very bad quality of these outputs which contain syntactical, spelling and communicative errors.

By approaching different text type analysis, this paper tries to shed light on the real translation problems found on target texts, problems which are deteriorated by the fact that these final target texts are not edited at all by their users in order to improve them and avoid the communicative blunts in the target language.

The article raises the concern about the great usage of such wrong translation materials by the university students, and not only, as a way of translating their course assignments or graduating thesis. The paper considers this concern important and legitimate to raise awareness on its users, in order to avoid such bad translations for the sake of their serious work.

Key words: *google translate, source text, target text, unavoidable, whirlpool*

Hyrje

Në ditët e sotme anglishtja është një gjuhë e domosdoshme për të gjithë, në çdo sferë të jetës. Materialet në anglisht janë të shumëllojshme dhe të kudondodhura, duke filluar që nga përdorimi i celularëve, etiketat e ushqimeve, detyrat e kursit për studentët apo artikujt shkencorë për pedagogët apo kërkuesit e ndryshëm shkencorë: Në çdo moment lind nevoja e përkthimit të tyre në gjuhën shqipe.

1. Zgjidhjet e mundshme?

Eksistojnë disa mundësi: *Mundësia e parë* është të njohësh mirë anglishten dhe ta përkthesh vetë materialin që të nevojitet. *Mundësia e dytë* nënkupton që nëse të duhet të përkthesh një dokument të shkurtër, por nuk mundesh vetë, atëherë mund t'i drejtohesh një miku apo një të njohuri që ka njohuri më të mira se ty në anglisht dhe ta përkthej materialin falas për ty. *Një mundësi e tretë*, të cilën shumë persona mundohen ta shmangin për shkak të koston, është të paguash një përkthyes profesionist, puna e të cilit është pikërisht përkthimi. Por kjo gjë, me shumë gjasa bëhet vetëm nga një përqindje shumë e ulët e të gjithë atyre që iu nevojiten përkthimet. *Mundësia e katërt*, me shumë gjasa më optimalja për këdo, është t'i referohesh "google-translate"-it, që në të gjitha rastet ofron "zgjidhje" për të gjithë, një përkthim sa hap a mbyll sytë (pavarësisht sa i gjatë është teksti) dhe mbi të gjitha falas dhe pa asnjë kosto!

A nuk është kjo zgjidhja që kërkojmë të gjithë? Përkthime të shpejta, në minutën e fundit përpara se duhet të dorëzojmë një artikull për botim, një detyrë kursi apo një dokument, aplikim për studime apo për punë? Puna bëhet sa hap e mbyll sytë dhe pas kësaj shumë pak marrin mundimin ta lexojnë materialin e përkthyer në shqip, e atëherë më pak atë në anglisht për saktësinë gjuhësore, mënyrën sintaksore të lidhjes së fjalëve në fjali, natyrshmërinë në kuptim e mbi të gjitha përcimin e mesazhit nga gjuha burim në atë mbriritëse e anasjelltas. Kjo është zgjidhja që fatkeqësisht shumë studentë të degëve të ndryshme, përfshirë edhe studentë të degës së anglishtes, përdorin për të

përkthyer materiale për detyrat e ndryshme të kursit, e më keq akoma për temat e diplomës.

Në këto materiale përveç përkthimit skandaloz në gjuhën shqipe dhe faktit që janë të kopjuara nga internet, dallohet edhe cilësia shumë e dobët e drejtshkrimit në gjuhën shqipe me mungesa të theksuar të ë-ve dhe ç-ve, pa llogaritur gabimet e shumta sintaksore dhe drejtshkimore të tekstit, apo më keq akoma mungesën totale të kuptimit dhe natyrshmërisë në gjuhën shqipe. Shumë prej këtyre materialeve u dorezohen pedagogëve për vlerësim...

Në të njëjtën kohë, një fenomen i tillë ndeshet rëndom edhe në përkthimin e materialeve që bëjnë institucione apo organizma të ndryshëm të cilëve iu nevojitet përkthimi nga gjuha angleze, për mbarëvajtjen e projekteve të ndryshme me të cilat operojnë, apo edhe në takime të rëndësishme me financuesit e këtyre projekteve. Megjithëse në këto organizma, ekziston zëri "përkthime" në listën e shpenzimeve të projektit, e vërteta është se përkthimet bëhen nga vetë personat që merren me projektin, gjithmonë me "google translate", për të shmangur pagesat që do i bëhen një përkthyesi profesionist, i cili, për hir të të së vërtetës, mund të thirret vetëm në mbledhje bordi shumë të rëndësishme, apo takime të nivelit të lartë, aty ku "google translate" nuk ofron dot ndihmën e saj.

Kjo gjë vihet re edhe në kuadër pedagogësh, për përkthimin e materialeve nga gjuha angleze që duhet t'i përdorin si leksione apo pjesë të programit të tyre akademik në auditore. Rezultati? Shpeshherë studentët ankohen se materialet e leksioneve janë shumë të paqarta në gjuhën shqipe dhe si rezultat tepër të vështira për t'i kuptuar dhe për t'i përvetësuar si dije.

2. Motori i fuqishëm "google translate"

Po çfarë është përkthimi i ofruar nga google dhe sa rekomandohet ai? Nëse i hedhim një vështrim të shpejtë Wikipedias¹, "google translate" është një shërbim që ofrohet nga motori fuqishëm i kërkimit në internet google, i cili praktikisht përkthen çdo lloj teksti të shkruar nga gjuha burim në gjuhën e synuar në një mënyrë shumë të shpejtë. Ky shërbim ofrohet për 90 gjuhë të ndryshme, përfshirë edhe gjuhën shqipe. Në vitin 2013 kompania "Google" deklaroi se ajo u shërbente më shumë se 200 milionë përdoruesve çdo ditë.

Megjithëse ekzistojnë shumë metoda kompjuterike për të ndihmuar përkthyesit në punën e tyre, metoda që në teorinë e përkthimit njihen me emrin CAT² tools, duket që padyshim më e përdorshme për masën e gjerë të përdoruesve (jo domosdoshmërisht e përkthyesve profesionistë) që duan të përkthejnë një tekst, është padyshim "google translate", si metoda më e njohur, lehtësisht e përdorshme nga çdo përdorues i internetit dhe mbi të gjitha falas dhe shumë e shpejtë. Po sa e saktë është në përkthim kjo metodë dhe a rekomandohet ajo për çdo tipologji teksti?

¹ http://en.wikipedia.org/wiki/Google_Translate

² Computer assisted techniques- teknika ndihmëse kompjuterike

Në librin e tij "A textbook of Translation" (një libër përkthimi) Peter Newmark-u thekson: "Kompjuteri dhe përkthimet kompjuterike janë të dobishme në përkthim, veçanërisht për gjuhët për qëllime specifike dhe në ditët e sotme përkthimi kompjuterik mund të përdoret deri diku në tekstet administrative dhe teknike, por edhe në këtë rast teksti ka nevojë për tu kontrolluar dhe redaktuar nga ana e përkthyesit.

.....Sa më specifike terminologjia, dhe sa më i kufizuar përdorimi i figurshëm i gjuhës aq më shumë gjasa ka që të marim një përkthim deri diku të saktë..."³

Po ç'mund të ndodhë nëse përkthejmë tekste letrare, artikuj të ndryshëm ku gjuha është përdorur në mënyrë metaforike, siç ndodh rëndom në këto lloj tekstesh dhe jo vetëm?

Në përvojën time si pedagoge e lëndës së teorisë dhe teknikave të përkthimit, apo edhe në përkthimin e materialeve të ndryshme që kam bërë për klientë të ndryshëm gjatë viteve, kam vënë re rëndom dukurinë e ardhjes në "ndihmë" nga ana e tyre me disa pjesë të materialit që më kanë besuar për ta përkthyer që i kanë përkthyer me "google translate".

Po kështu gjatë provimeve, në universitet në lëndën e përkthimit në ciklin e studimeve Bachelor kryesisht, ku krahas anës teorike, studentëve u është dashur të përkthejnë edhe fragmente të marra nga tipologji të ndryshme teksti, ka pasur përpjekje nga një numër i konsiderueshëm prej tyre, të japin versione të përkthyer të teksteve të kërkuara nga vetë ata dhe deri diku ia kanë dalë mbanë (madje disa edhe kanë dhënë versione të sakta nga ana gjuhësore dhe sintaksore).

Po fatkeqësisht, megjithëse është e ndaluar rreptësisht përdorimi i celularëve gjatë orës së mësimi, disa prej tyre nuk kanë ngurruar të shkruajnë si version përkthimi që jep "google translate", duke thyer dy rregulla në të njëjtën kohë: kopjimin me anë të celularit dhe servirjen e një versioni aspak të saktë nga ana gjuhësore dhe kuptimore. Paradoksi qëndron se studentëve u lejohej përdorimi i fjalorëve dygjuhësh, apo njëgjuhësh gjatë provimit, por një pjesë studentësh nuk denjonte fare t'i përdorte ata, duke përdorur rrugën më të shkurtër dhe plotësisht të gabuar në këtë rast, përkthimin me "google translate".

3. Përkthimi me "google translate" në kundërvënien me përkthimin njerëzor.

Për të ilustruar këto ide më poshtë po trajtojmë disa fragmente tekstesh të ndryshme të cilat janë përdorur nga ne gjatë kursit të përkthimit në nivelin Bachelor, viti i tretë në lëndën *ENG 376*. Këto fragmente u janë dhënë studentëve për t'i analizuar dhe përkthyer në seminare, apo edhe në provime. Në fragmentet që do të analizojmë do të japim dy përkthime: përkthimin që ofron "google translate" në kompjuter dhe një përkthim të bërë dhe të diskutuar nga studentët. Në këtë fazë përkthimin e kemi nga gjuha *burim* (anglishtja) në gjuhën *mbriritëse* (shqip).

³ Newmark,P. "A textbook of translation", 196

Teksti.1 Reklamë –Tekst informativ

Fragmenti i mëposhtëm është një pjesë e reklamës në internet të parfumit “**La vie Est Belle**” të kompanisë prestigjioze “Lancome”. Fragmenti jep një përshkrim të përbërjes së këtij parfumi të ri dhe si dallohet ai nga parfumet e tjerë:

La Vie Est Belle is a new Lancome fragrance, available on the market from fall 2012. The concept of this fragrance is centered on the idea of natural and simple beauty, freedom from conventions and the choice of once own vision of happiness. The fragrance is a kind of outlook on life, inspired by joy and pleasure in small things.

*This gourmand yet elegant composition is developed by perfumers **Olivier Polge, Dominique Ropion** and **Anne Flipo**. The final formula is the result achieved after three years of probation and 5000 versions. Iris is the key ingredient of the perfume, surrounded by orange blossoms and jasmine in the heart. The composition’s opening provides fruity flavors of black currant and pear, while the base is warm, gourmand and powdery due to almond-like accords of tonka bean, praline, patchouli and vanilla. The flacon is a redesigned version of the classic Lancome bottle from 1949. Actress Julia Roberts is the face of the campaign, shot by director Tarsem Singh.⁴*

Përkthimi i “google translate”

La Vie Est Belle është një aromë e re Lancome, në dispozicion në treg **nga rënia 2012**. Koncepti i kësaj aromë është përqëndruar në idenë e bukuri së natyrore dhe të thjeshtë, **lirisë nga konventat dhe zgjedhjen e vizionit dikur vet e lumturisë**. Aromë është një lloj botëkuptimi i jetës, i frymëzuar nga gëzimi dhe kënaqësi në gjëra të vogla. **Kjo llupës ende përbërja elegant** është zhvilluar nga parfumiere Olivier Polge, Dominique Ropion dhe Anne Flipo. Formula e fundit është rezultati i arritur pas tre viteve të provës dhe 5000 versione. Iris është përbërës kryesor i parfum, rrethuar me lule portokalli dhe jasemini në zemër. **Hapja e përbërjes së ofron shije me shije frute e rrush pa fara i zi dhe dardhës, ndërsa baza është e ngrohtë, llupës dhe pluhur**

Përkthim nga studentë

Drithërat përbëjnë bazën e të gjithë prodhimeve buqësore. Ato zënë një vend kryesor në ushqimin e njeriut. Pjesa më e madhe e tyre bluhen për prodhimin e miellrave, ndërsa pjesa tjetër përdoret për qëllime teknike dhe ushqim për kafshët. Në vendin tonë kultivimi i drithërave zë një pjesë të mirë të sipërfaqes së tokës së punueshme dhe prodhimi i tyre përbën një pjesë të madhe të prodhimeve buqësore. Drithërat përbëjnë bazën e dietës mesdhetare, sepse ato janë burimi kryesor i karbohidrateve, i sigurimit të fibrave, vitaminës B, kripërave minerale, si kalium, hekur, fosfor dhe kalcium. Kjo pune eksperimentale është bazuar në botimin "Mikroorganizmat e Grurërave dhe Ndikimi i tyre në Ndryshimet Fiziko-kimike dhe Teknologjike Gjatë Ruajtjes Tiranë, 1980" autori Donika Prifti. Qëllimi i këtij studimi është krijimi i një pasqyre të përgjithëshme mbi karakteristikat mikrobiologjike të drithërave të depozituara në vëndin tonë. Për studim janë marrë dhjetë mostra gruri, përkatësisht 5 mostra në zonën e Korçës dhe 5 mostra në zonën e Tiranës. Puna eksperimentale u bazua në kontrollin e ngarkesës mikrobiologjike, baktere, maja, myqe në epidermën e kokrrës së grurit dhe në kontrollin e detajuar të kulturave mykore.

MATERIALET DHE METODAT

Marrja e kampionaturës, për kryerjen e analizave mikrobiologjike, u krye në kushte rreptësisht sterile me qëllim evitimin e ndikimit të mikroorganizmave të ambientit dhe ajrit. Për këtë mostrat u ruajtën në qese sterilë dhe të mbyllura mirë për gjatë gjithë kryerjes së analizave. Meqenëse sasia e mikroorganizmave në shtresën e sipërme dhe të brendshme të sillosit është e ndryshme, kampionaturat u morën në pjesë të ndryshme për një përfaqësim më të mirë.

Zakonisht u morën nga 1kg grurë për secilën mostër me qëllim përgatitjen e mostrës mesatare. Sasia prej 1kg u zbraz në një letër sterile dhe me anën e një spatule u përzje mirë. Pastaj u bë marrja e mostrës mesatare me metodën e ndarjes me diagonale disa herë. Analizat u kryen gjatë 3-4 ditë pas marrjes së kampionit.

Përcaktimi i numrit të përgjithshëm të mikroorganizmave: Baktere, Maja, Myqe

Numri i përgjithshëm i mikroorganizmave, i baktereve dhe myqeve, u përcaktuan me metodën e kultivimit të suspensioneve në terren ushqyes të ngurtë. Terrenet që u përdorën në këtë punë eksperimentale ishin Czapek, PDA, MA dhe PCA. Pas inkubimit në 26°C (për myqet) dhe në 30°C (për bakteret), u numëruan ato pjata ku ishin rritur 50-250 koloni. Llogaritja e numrit të përgjithshëm të mikroorganizmave, bëhet duke supozuar që një koloni ka ardhur nga një qelizë.

Siç dihet përcaktimi i numrit të përgjithshëm të mikroorganizmave me këtë metodë është konvencionale, sepse jep rezultate të përafërta, por megjithatë mund të gjykohe mbi dendësinë e mikroorganizmave në ambientin e dhënë.

Përcaktimi i mikroflorës në epidermë.

-Kokrrat e grurit që mbeten në shishe pas tundjes dhe marrjes së suspensionit, u përpunuan më tej për të përcaktuar mikroflorën e epidermës.

-Kokrrat u trajtuan me nga 90ml tretësirë sterile detergjenti neutral 0.1%, duke i tundur kokrrat për një minutë në tundëse.

-Pas trajtimit me detergjent kokrrat u shpëlanë katër herë njëra pas tjetrës me nga 90 ml ujë të pijshëm steril, duke i tundur për 1 minutë në cdo shpëlarje.

-Pas kësaj në kokrrat e grurit hidhet 10 gr rërë e pastër dhe e sterilizuar si edhe 90 ml ujë i pijshëm i sterilizuar, e tundim për 10 minuta duke siguruar kështu kalimin në suspension të mikroflorës së epidermës.

Nga ky suspension u përgatiten hollimet përkatëse për përcaktimin e mikroflorës së epidermës, 10^{-1} , 10^{-2} dhe 10^{-3} .

Përcaktimi i myqeve sipas klasave dhe gjinive.

Në pjatat e petrit të kultiuara me suspension përveç përcaktimit të numrit të përgjithshëm të myqeve, u bë edhe përcaktimi i myqeve sipas klasave dhe në disa raste sipas gjinive dhe specieve. Këto përcaktime u bënë me anën e vëzhgimit të drejtpërdrejtë të kolonive të myqeve duke marrë për bazë karakteristikat kulturele si forma, ngjyra, thurja, anët e kolonive, ngjyra e

kolonive nga ana e prapme e pjatës, prania e trupave frutorë (Cleistothecium), prania e eksudateve si dhe me anën e vëzhgimeve me steriomikroskop. Meqënëse myqet e klasës së Ascomyceteve janë më të përhapura, Aspergillus dhe Penicillium, u bë identifikimi i tyre deri në specie. Për identifikimin e myqeve të gjinisë Aspergillus u morrën për bazë karakteristikat e përshkruara në librin “ The Genera of Fungi Sporulating in pure culture” i autorit Josef Adolf Von Ary, kurse për myqet e gjinisë Penicillium u morrën për bazë karakteristikat e përshkruara në librin “ A Manual of the Penicilia” i autorëve Kenneth Bryan Raper dhe Charles Thom.

REZULTATET

Si kurse u përmend në pjesën metodike, u analizuan gjithësej dhjetë mostra gruri të marra në zonën e Korçës dhe Tiranës. Në to u krye përcaktimi i mikroflorës në epidermë. Për vlerësimin mikrobiologjik u përgatitën suspensionet me metodën e hollimeve limite.

U përgatitën nga 3 paralele për secilën hollim. Rezultatet e të gjitha përcaktimeve janë paraqitur në tabelat e mëposhtme: **Tabela Nr.1** Shpërndarja e numrit të përgjithshëm të mikroorganizmave në epidermë për dhjetë mostrat e analizuar: **Figura Nr.1**.

Për të gjitha rastet e kultivimit (baktere, maja, myqe) në të dhjetë mostrat e analizuar, u vu re një ngarkesë e lartë mikrobiologjike në hollimin e parë dhe të dytë. Kështu që llogaritja e numrit të përgjithshëm të baktereve, majave dhe myqeve u bë duke u nisur nga hollimet e treta në të cilat kolonitë ishin qartësisht të lexueshme.

Nga rezultatet duket qartë se popullimi më i madh i mikroorganizmave përbëhet kryesisht nga bakteret, ku mostra me numrin më të madh të baktereve është mostra Nr.10.


Duke bërë një krahasim midis mostrave të studiuara në zonën e Korçës dhe ato të Tiranës rezultuan se mostrat e marra në zonën e Tiranës ishin më të ndotura se ato të zonës së Korçës dhe mendohet se ky ndryshim vjen nga kushtet klimaterike, ku mikroorganizmat rriten më mirë në zonat me temperaturë dhe lagështi të lartë. Numri i majave dhe myqeve të përcaktuara janë në sasi të ulët por ajo që ka më shumë rëndësi është studimi i myqeve të cilët janë dëmtuesit më të rëndësishëm të grurit.

Tabela 1 : Numri i përgjithshëm i baktereve, majave dhe myqeve në epidermën e grurit, për hollimin e tretë.

<p style="text-align: center;">Shpërndarja e mikroorganizmave Hollimi i tretë x 10³</p>
--

	Mostra	Bactere (PCA)	Maja (MA)	Myqe (Czapek)
Korçë	1	23	8.5	0
	2	18.6	12.6	1
	3	16.3	13.6	1.6
	4	5.6	8.6	1.3
	5	19.6	6	2.6
Tiranë	6	18.6	5.3	2
	7	30	0	0.3
	8	24.3	4	1.6
	9	38.3	4.6	5.3
	10	35.7	5.3	2.3

Figura 1 : Shpërndarja e numrit të përgjithshëm të mikroorganizmave në epidermë për dhjetë mostrat e analizuar.



Sikurse u përmend në pjesën teorike, në pjatat e petrit të kultuara me suspension përveç përcaktimit të numrit të përgjithshëm të myqeve, u bë edhe përcaktimi i tyre sipas klasave dhe në disa raste sipas gjinive dhe specieve.

Ndarjet e myqeve në klasa, gjini dhe specie për dhjetë mostrat e analizuar janë paraqitur në **Tabelat Nr.2 dhe Nr.3**. Shpërndarja e myqeve bazuar në gjini, në epidermën e grurit, për dhjetë mostrat e analizuar është paraqitur në **Figurën Nr.2 dhe Nr.3**.

U vu re se në epidermë mbizotërojnë kryesisht myqet e klasës së Ascomycetes dhe në përgjithësi të gjinisë *Aspergillus* (afërsisht 50-60%) dhe *Penicillium* (afërsisht 20-30%).

Nga gjinia *Aspergillus* mbizotërojnë ato të grupit *Aspergillus candidus*. Mostra me numrin më të madh të myqeve në epidermë ishte mostra 7.

Tabela 2 : Përcaktimi i myqeve sipas klasave dhe gjinive në epidermën e grurit për mostrat e studiuara në zonën e Korçës.

Mostra	Klasa	Phycomycetes		Ascomycetes		Fungi imperfecti
	Gjini	Rhizopus	Mucor	Aspergillus	Penicillium	
1	PCA	0	0	1	1	0
	Czapek	0	1	4	0	0
	PDA	0	3	6	3	0
	MA	0	2	4	0	0
2	PCA	0	3	5	3	2
	Czapek	0	1	11	2	0
	PDA	0	0	0	0	0
	MA	0	0	2	0	0
3	PCA	0	2	10	2	0
	Czapek	1	2	11	5	0
	PDA	0	1	3	2	3
	MA	0	0	9	3	0
4	PCA	0	2	4	3	0
	Czapek	1	0	12	2	1
	PDA	0	1	1	4	0
	MA	1	0	5	4	3
5	PCA	1	1	7	4	1
	Czapek	1	2	11	3	2
	PDA	0	0	4	2	1
	MA	0	1	3	2	0

Tabela 3 : Përcaktimi i myqeve sipas klasave dhe gjinive në epidermën e grurit për mostrat e studiuara në zonën e Tiranës.

Mostra	Klasa	Phycomycetes		Ascomycetes		Fungi imperfecti
	Gjini	Rhizopus	Mucor	Aspergillus	Penicillium	
6	PCA	0	0	10	4	0
	Czapek	0	2	11	3	0
	PDA	1	1	5	0	1
	MA	1	2	4	4	0
7	PCA	0	0	5	1	2
	Czapek	0	0	91	2	0
	PDA	0	1	16	37	0
	MA	0	0	5	1	2
8	PCA	0	2	7	2	2
	Czapek	1	0	14	10	0
	PDA	0	1	38	6	0
	MA	0	1	5	0	0
9	PCA	1	3	15	5	1
	Czapek	2	5	22	6	5
	PDA	1	2	19	7	2
	MA	1	1	12	4	2
10	PCA	1	1	8	6	3
	Czapek	2	2	13	8	4
	PDA	1	0	6	3	1
	MA	0	1	3	2	0

Figura 2 : Shpërndarja e myqeve bazuar në gjini, në epidermën e grurit, për pesë mostrat e analizuar në zonën e Korçës.





Figura 3 : Shpërndarja e myqeve bazuar në gjini, në epidermën e grurit, për pesë mostrat e analizuar në zonën e Tiranës.



KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME

Në përgjithësi mostrat e grurit të cilat i janë nënshtruar analizave janë brenda normave të përcaktuara për përmbajtjen e mikroorganizmave. Për sa i përket përmbajtjes së myqeve, të gjitha mostrat janë nën limitet karakteristike për grurërat të cilët konsiderohen të pastër.

Nga i gjithë ky punim eksperimental i realizuar brenda një periudhe shumë të shkurtër kohore, mund të rekomandojmë që fabrikat e përpunimit të grurit të analizuar, duhet ti kushtojnë vëmendje të veçantë proceseve përgatitore për blaje, siç janë: pastrimi, klasifikimi, larja apo kondicionimi i grurit.

LITERATURA

Berghofer, L.K., Hocking, A.D., Miskelly, D., Jansson, E., 2003. Microbiology of Wheat

and flour milling in Australia. Int. J. Food Microbiol. 85, 137–149.

John I. Pitt | Ailsa D. Hocking, (2009), Fungi and Food Spoilage, third edition.

Josef Adolf Von Ary : The Genera of Fungi Sporulating in pure culture- 1970.

King, A.D., Hocking, A.D., Pitt, J.I., (1979): Dichloran–rose bengal medium for enumeration and isolation of molds from foods. Appl. Environ. Microbiol. 37, 959–964.

Prifti, D., Mikrobiologjia Ushqimore, “Perlat Voshtina” 2007, Tiranë.

Prifti, Donika (1980): Mikroorganizmat e Grurërave dhe Ndikimi i tyre në Ndryshimet Fiziko-kimike dhe Teknologjike Gjatë Ruajtjes Tiranë, 1980

Plakolli .M.(2001) Praktikum për mikrobiologji. ETMM-Prishtinë

Kenneth Bryan Raper dhe Charles Thom : A Manual of the Penicilia-1949

ICMSF (1998), Microorganisms in Foods: 6 Microbial Ecology of Food Commodities. Blackie Academic and Professional, London, pp. 313-346

Guarro, J., and J. Gene. 1992. Fusarium infections. Criteria for the identification of the responsible species. Mycoses 35:109-114 .. May 26, 2012 – References.

Ailsa D. Hocking (2003). Microbiological facts and fictions in grain storage

Food Science Australia, PO Box 52, North Ryde, NSW 1670, . 55 -58.

H.L.Barnet, B. Hunter: Illustrated Genera of Imperfect Fungi. 3rd ed., Burgess Publishing Company, California -1972.

PINOKU I SJELLË NË GJUHËN SHQIPE MODALITETE TË NDRYSHME PËRSHTATJEJE

Manjola Sulaj

Departamenti i gjuhës italiane
Fakulteti i Edukimit dhe i Shkencave Shoqërore
Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër
e-mail: sulaj_manjola@yahoo.it

Abstrakti

Në këtë artikull synojmë të bëjmë një paraqitje të shkurtër të përkthimeve të "*Pinokut*", për të vënë në dukje ndryshimet nga njëri përkthim te tjetri përgjatë periudhave të ndryshme historiko-shoqërore të vendit tonë. Këto ndryshime nuk kanë për qëllim të përcaktojnë zotësinë shprehëse dhe teknike më të mirë, por shërbejnë vetëm për të vënë në dukje zgjedhjet individuale stilistikore të secilit përkthyes, që i kushtëzohen formimit individual të ndryshëm, edukimit dhe shkollimit në kushte të ndryshme shoqërore dhe historike. Ajo që mund të themi me bindje është fakti që romani "*Pinoku*", i shkrimtarit të shquar për fëmijë Karlo Kolodi, ka dhënë një ndihmesë të çmuar në prezantimin e modeleve të reja në sistemin e kulturës sonë kombëtare nëpërmjet përkthimeve të ndryshme që i janë bërë.

Fjalët kyçe: përkthim, zotësi shprehëse, teknikë më e mirë, zgjedhje individuale, shkollim në kushte të ndryshme shoqërore dhe historike.

Abstract

In this article we intend to make a short presentation of "Pinocchio" translations, in order to highlight the changes from one translation to another during different socio-historical periods of our country. These changes are not intended to define the better expressive and technical capacity, but serve only to highlight the individual stylistic choices of each translator, due to different individual training and education in various social and historical conditions. What we can say with certainty is that the novel "Pinocchio", of the prominent

children's literature writer Carlo Kolodi, has provided a valuable contribution to the introduction of new models in the system of our national culture through various translations made to his novel.

Keywords: translation, expressive ability, good technique, individual choice, education in different social and historical conditions.

Karlo Kolodi, autori i romanit për fëmijë "*Aventurat e Pinokut*", është pjesë e një revolucioni të vërtetë letrar, sepse në kohën e Italisë së sapobashkuar, jo vetëm kontribuoi në krijimin e një letërsie kombëtare dhe popullore, por i konsideroi fëmijët si një potencial i madh për të bërë Italinë e së ardhmes, duke u kushtuar atyre libra shkollorë dhe letrarë. Krijimtaria e Kolodit kishte elemente edukuese, por me veprat e tij ai nuk synonte të konkurronte shkollën publike, por krijimin e një kulture të re në mbështetje të asaj shkollore, metodat didaktike të së cilës ishin të pamjaftueshme dhe jozbavitëse për fëmijët. Kjo ishte një rrugë e papraktikuar më parë dhe mjaft e vështirë. Bëhej fjalë për gërshetimin e një rrëfimi të këndshëm (që para së gjithash synonte përfshirjen emocionale dhe krijimin e pasionit për leximin te publiku i vogël në moshë) me transmetimin në mënyrë zbavitëse të mesazhit pedagogjik.

Emri i Karlo Kolodit është i njohur për lexuesin e vogël shqiptar për përkthimin e dy veprave të tij "*Ndodhi gazmore*" dhe "*Aventurat e Pinokut*". I pari, i përkthyer nga Brikena Çabej, është botuar në vitin 1987, ndërsa i dyti e ka nisur rrugëtimin e tij në gjuhën shqipe në vitin 1935, me përkthimin e Cuk Simonit, duke u botuar e ribotuar 15 herë (deri në vitin 2013), si libër të plotë dhe 3 herë të përshtatur në formën e përrallave. Si libër të plotë e gjejmë të botuar përkatësisht në vitet: 1935, me përkthimin e Cuk Simonit; 1994, të përshtatur në shqipen letrare nga Zef Simoni; 2004, me dy botime, i pari me shqipërimin e Taulant dhe Eri Tafës dhe i dyti me përkthimin e D. Shurajës; 2008, me përkthimin e M. Matës; 2009, me përkthimin e Agim Doksanit; 2010, me përkthimin e Robert Anastasit dhe në vitin 2013 me përkthimin e A. Novakut. Si ribotim e gjejmë: më 1959, me përkthimin e Cuk Simonit; më 2000, të përshtatur në shqipen letrare nga Zef Simoni; më 2004, 2005, 2006, 2008, 2009, me shqipërimin e Taulant dhe Eri Tafës. Në formën e përrallave të përshtatura është botuar: më 1994 dhe më 1996, me përshtatës *anonim*, dhe në vitin 2002 i përshtatur nga Irena Toçi.

Titulli i librit në origjinal është "*Aventurat e Pinokut*"¹, ndërsa në shqip të gjitha botimet, ribotimet dhe përshtatjet e librit mbajnë titullin "*Pinoku*", të inauguruar qysh më 1935 nga përkthyesi i tij i parë.

¹ Carlo Collodi: "*Le avventure di Pinocchio*", Paggi, Firenze 1883.

Në botimin e vitit 1935, Cuk Simoni, i cili e pati përkthyer librin privatisht², nuk jep informacion për tirazhin e librit. Ai është kujdesur ta shoqëronte përkthimin e tij në shqip me ilustrime. Bëhet fjalë për 15 të tilla, të shpërndara përkatësisht në kapitujt: II, III, VIII, XIII, XVI, XVII, XIX, XX, XXIII, XXVI, XXIX, XXXI, XXXII dhe XXXVI (ku gjenden dy ilustrime). Në këtë botim mungon informacioni për ilustruesin. Nuk dimë nëse Cuk Simoni i ka marrë këto ilustrime nga ndonjë botim origjinal i librit, ndër shumë të tillë që kishin qarkulluar deri në atë kohë në Itali, apo ato i përkasin ndonjë ilustruesi shqiptar. Veç, dimë të themi me siguri se këto ilustrime nuk janë marrë nga botimi në faqet e *"Gazetës për fëmijë"*, ku libri u botua për herë të parë, dhe as nga botimi i vitit 1983 me ilustrime të Enriko Mazantit. Natyrisht, ky argument mbetet i hapur për një punë të mëtejme studimore, atë të krahasimit të ilustrimeve të të gjitha botimeve dhe ribotimeve italiane të *"Aventurave të Pinokut"* me ato të pranishme në librin në fjalë.

Përkthimin e vet Cuk Simoni e shoqëron me një parathënie ku tregohet se si rastësisht, kur përkthyesi gjendej në Itali, pasi kishte mbaruar punët e tij, duke u endur nëpër vitrinat e dyqaneve shikon *"Pinokun"*, të cilit vendos *t'i mësojë shqipen*. Kjo parathënie ka formën e një tregimi artistik të pasur me figuracion dhe imagjinatë që i përshtaten botës fëmijënore e në të njëjtën kohë është në harmoni të plotë me rrëfimtarinë që e ndjek. Përkthyesi e ka të qartë botën e ndryshme të të vegjëlve dhe këtë e vë në dukje që në parathënie, duke përdorur një gjuhë specifike dhe të thjeshtë, të rrjedhshme dhe lehtësisht të kuptueshme. Ky tregim-parathënie është i pasur me dialogë të vetë autorit të përkthimit me Pinokun, përshtypje për librin, të cilin padyshim që përkthyesi e njihte qysh më parë, dhe sigurinë se ai do të mirëpritej edhe në Shqipëri, si në shumë vende të tjera të botës ku ishte përkthyer deri në atë kohë.

Cuk Simoni ishte i ndërgjegjshëm dhe e pranon hapur faktin se *t'i mësojë shqipen* Pinokut do të ishte një ndërmarrje e vështirë, pasi ai *"nuk ishte i degës"*. Megjithatë, meqë nuk gjeti *"ndokënd tjetër që merrej me këto punë"* e meqë e kishte shumë përzemër Pinokun, nuk mund ta linte mënjanë, ndaj vendosi t'i mësonte gjuhën letrare, *"një gjuhë e punuar, e holluar"*- siç e quan ai. Por, duke parë se fëmijët nuk e kuptonin gjuhën letrare, e solli Pinokun me *"gjuhën që flitej"* në qytetin e tij (Shkodër), pra, në gegërisht.

Cuk Simoni nuk bën përkthim fjalë për fjalë. Ai është më shumë besnik i lexuesit të vogël shqiptar, sesa i tekstit origjinal. Prioriteti i tij nuk është ekuivalenca në planin formal, por këmbëngulja në ekuivalencën kuptimore dhe stilistikore, gjë që e bën tekstin e tij dinamik. Këto janë disa nga arsytet që na shtyjnë të themi me bindje se lexuesi shqiptar e ka shijuar *"Pinokun"* në të njëjtën mënyrë sikurse ai italian. Për të arritur këtë, Cuk Simoni ka reduktuar në minimum shprehjet, strukturat apo fjalët, të cilat transmetojnë kulturën e huaj.

² Koptina mbart shënimin: *"Shkodër, Botim i përkthyesit, rr. Gurakuqit, 40, 1935"* .

Megjithatë, edhe pse përkthyesi e njëj mirë gjuhën shqipe, përkthimit të tij nuk i kanë shpëtuar aty-këtu depërtime të elementeve të huaja.

Nga këndvështrimi sintaksor, vihen re disa modifikime në strukturën e fjalisë, ndonëse italishtja nuk është shumë e ndryshme strukturalisht nga shqipja. Kjo tregon qartë se Cuk Simoni ka mëtuar të ruajë ekuilibrin e vështirë midis besnikërisë së përkthimit dhe të përshtatjes. Herë-herë, vëmë re përgjatë përkthimit reduktim të disa fjalëve të tekstit origjinal, në funksion të ruajtjes së kuptimit, çka tregon edhe vështirësitë dhe pamundshmërinë e sjelljes së një kulture të huaj gjuhësore në shqip. Për ta ilustruar këtë pohim po sjellim më poshtë disa shembuj:

“...il medico le aveva ordinato una grandissima dieta, così dovè contentarsi di una semplice lepre dolce e forte con un leggerissimo contorno di pollame ingrassate e di galletti di primo canto.”³

“...mjeku e kishte pasë porositë me mbajtë perizë të madhe, i u desht me u kondëndue vetëm me një leper percjellë me pak pula të majme e gjela të ri

Vetëm në fragmentin e sjellë më sipër janë reduktuar 7 fjalë (una, così, dolce e forte, contorno di) dhe dy prapashtesa (issima/o). *Una grandissima* dieta mund të ishte përkthyer *një pehriz shumë të madh (një dietë shumë të fortë)*, por meqë *-issimo (shumë)* shërben si përforcuese e fjalës *e madhe*, përkthyesi ka preferuar ta heqë për të shmangur përsëritjen. Të njëjtën gjë mund të themi edhe në rastin e *leggerissimo (shumë pak)*. Ndërkohë, përkthimi i fjalës *contorno* (garniturë) është shmangur dhe *galletto di primo canto (gjel i këngës së parë)* është preferuar të përkthehet *gjela të ri* sepse rezulton më qartë në shqip.

Shembujt e mësipërm na tregojnë qartë se reduktimet e Cuk Simonit janë bërë ose për të mos rënë pre e përsëritjeve, ose për t'i qëndruar besnik kuptimit në shqipe, përsëritje këto që në fakt, në italisht tingëllojnë vërtet bukur.

Vështirësia e sjelljes së një tjetre kulture në tërësinë e vet, e ndryshme nga ajo e gjuhës përshtatëse, sjell pamundësinë e përkthimit të disa shprehjeve. E megjithatë, kjo vështirësi, e ka orientuar përkthyesin Cuk Simoni t'i zëvendësojë të atillat e t'i sjellë në shqipe me të tjera, me kuptim të përafërt në shumicën e herëve. Shumë shpesh përkthyesi i lejon vetes të shtojë fjalë, por dhe shprehje, kur e ai e gjykon të nevojshme në funksion të kuptimit, por edhe të hijeshisë artistike. Nuk mungon zëvendësimi i shprehjeve të italishtes, të cilat mund të përktheheshin fjalë për fjalë, me të tjera, që në shqip tingëllojnë më dinamike. Të tilla modalitete hasen dendur në tekstin e Cuk Simonit. Ja, disa shembuj:

³ Carlo Collodi: *“Le avventure di Pinocchio”*, Giunti Marzocco, Firenze 1981, fq. 54.

“... tutti lo chiamavano maestro Ciliegia, per via della punta del suo naso, che era sempre lustra e paonaza, come una cigliegia matura.”⁴

“... të gjithë e thirrshin mjeshter Qershija, për shkak të mâjes së hundës, qi e kishte gjithmonë të shndritshme e të kuqe, si një kokerr qershí e pjekun.”⁵

Cigliegia matura është përkthyer *kokerr qershí e pjekun* në vend të: *qershí e pjekur*.

“Appena maestro Ciliegia ebbe visto quel pezzo di legno, si rallegrò tutto; e dandosi una fregatina di mani per la contentezza, borbotò a mezza voce: ...”⁶

“Porsá mjeshtër Qershija pau at cope dru, i u knaq fort zêmra; e tuj ferkue duert prej gzimi tha me vedi: ...”⁷

Si rallegrò tutto është përkthyer *i u knaq fort zêmra* në vend të: *u gëzua shumë, borbotò a mezza voce* është përkthyer *tha me vedi* në vend të: *mërmëriti me gjysëm zëri*.

“Come potete immaginarvelo, la Fata lasciò che il burattino piangesse e urlasse una buona mezz’ora, a motivo di quel suo naso che non passava dalla porta di camera; e lo fece per dargli una severa lezione e perché si correggesse dal brutto vizio di dire bugie. ...”⁸

“Si mûnd të ju a mârre mëndja, Zâna e la njiherë Pinokun të kjajë e të vajtojë per nja’ i gjysë ore të mirë, për punë t’asajë hûndë qi s’mûnd të kalote per derës s’odës: pse desht me e ndeshkue e me e bâ me zânë mënd, qi mos të rrêjë mâ kurr...”⁹

“...abbracciò, a uno a uno ...”¹⁰

“...muer grykë një ká një”¹¹

Come potete immaginarvelo është përkthyer *si mûnd të ju a mârre mëndja* në vend të: *si mund ta imagjinoni*; *fjala njiherë* është shtuar nga përkthyesi, sepse nuk ndodhet në origjinal; *che non passava* është përkthyer *qi*

⁴ Carlo Collodi: “*Le avventure di Pinocchio*”, vep. e cituar, fq. 5.

⁵ Karlo Kolodi: “*Pinoku*”, përkthyer nga Cuk Simoni, Botim i përkthyesit, rr. Gurakuqit 40, Shkodër, 1935, fq. 9.

⁶ Carlo Collodi: “*Le avventure di Pinocchio*”, vep. e cituar, fq. 5.

⁷ Karlo Kolodi: “*Pinoku*”, përkthyer nga Cuk Simoni, vep. e cituar, fq. 9.

⁸ Carlo Collodi: “*Le avventure di Pinocchio*”, vep. e cituar, fq. 78.

⁹ Karlo Kolodi: “*Pinoku*”, përkthyer nga Cuk Simoni, vep. e cituar, fq. 89.

¹⁰ Carlo Collodi: “*Le avventure di Pinocchio*”, vep. e cituar, fq. 49.

¹¹ Karlo Kolodi: “*Pinoku*”, përkthyer nga Cuk Simoni, vep. e cituar, 47.

s'mûnd të kalote në vend të: që nuk kalonte; e lo fece per dargli una severa lezione e perché si correggesse dal brutto vizio di dire bugie është përkthyer pse desht me e ndeshkue e me e bâ me zânë mënd, qi mos të rrëjë mâ kurr në vend të: dhe e bëri për t'i dhënë një mësim të mirë dhe të korigjohej nga vesi i keq i të thënit gënjeshtër, ndërsa abbracciò, a uno a uno është përkthyer muer grykë një ká një në vend të: përqafoi një nga një.

Në tekstin e Cuk Simonit nuk mungojnë edhe rastet kur për një shprehje në italisht jepen dy të tilla në shqip:

"- Questo legno è capitato a tempo..."¹²

"- Shi në kohë të mirë më rá në dorë kjo dru..."¹³

Për shprehjen *è capitato a tempo* – ndodhi/erdhi në kohën e duhur, përkthyesi jep dy të tilla: *Shi në kohë të mirë* dhe *më rá në dorë kjo dru*.

Leximi i kujdesshëm i "*Pinokut*" të Cuk Simonit tregon qartë se kriteret që kanë shërbyer si udhërrëfyese gjatë përkthimit të romanit kanë qenë ato estetike, besnikëria e shpirtit, por edhe e fjalës së origjinalit. Përkthimi i tij është art, pasi nuk është një kopje e thjeshtë, por një vepër ku duket qartë delli krijues i përkthyesit, i cili e ka konvertuar tekstin në shqip në një rikrijim në të njëjtin nivel me origjinalin.

Gjatë përkthimit, Cuk Simonin e ka shoqëruar kalimi krijues nga njëra gjuhë në tjetrën dhe kjo duket qartë se ai e ka rindier këtë akt krijues, duke lënë mënjane rregullat me rëndësi gjuhësore e duke iu dedikuar çastit të rikrijimit. Edhe pse përkthyesi ka arritur t'i japë veprës një autonomi estetike në shqip, përkthimi i tij letrar mund të konsiderohet si një proces që i konsideron dy tekstet në një marrëdhënie dinamike midis tyre.

Në vitin 1994, pasi kishte qëndruar një kohë të gjatë në gegërisht, "*Pinokun*" e sjell në gjuhën e sotme letrare i biri i Cuk Simonit, Zef Simoni. Ai qysh në fëmijëri fliste disa gjuhë të huaja dhe në moshë të rritur zotëronte njëmbëdhjetë të tilla, midis të cilave përmendim italishten, frëngjishten, anglishten, gjermanishten etj.

Përshtatja e Zef Simonit, me shtëpi botuese "*Naim Frashëri*", nuk ka ilustrime, ndërsa ribotimi i vitit 2000, i së njëjtës shtëpi botuese, kësaj radhe i përfshirë në "*Serinë e Artë të librit për fëmijë*", shoqërohet nga ilustrimet e Roberto Inoçentit. Ilustrimet janë të pakta, gjenden gjashtë të tilla, përkatësisht në kapitujt III, IX, XIV, XXIV, XXVIII dhe XXXII.

"*Pinoku*" i Zef Simonit, edhe pse është bazuar në përkthimin e bërë nga i ati, mbart në vetvete shenjat e përvojës së tij si përkthyes dhe si njohës i mirë i

¹² Carlo Collodi: "*Le avventure di Pinocchio*", vep. e cituar, fq. 5.

¹³ Karlo Kolodi: "*Pinoku*", përkthyer nga Cuk Simoni, vep. e cituar, fq. 9.

shqipes letrare, duke e bërë përkthimin e të atit akoma më të admirueshëm. Kjo përsosshmëri vjen si rezultat i disa faktorëve:

1. Gjatë përshtatjes janë shmangur disa struktura fjalish, që janë nën ndikimin e gjuhës italiane, si në shembujt më poshtë:

Shembulli 1

“Come andò che maestro Cigliegia, falegname, trovò un pezzo di legno, che piangeva e rideva come un bambino.”¹⁴

“Si kje puna qi Mjeshtëri Qershija, zdruckthtar, gjet një copë drû qi kjate e qeshte si fmija.”¹⁵

“Si ndodhi që zdruckhtari mjeshtëri Qershia gjeti një copë dru që qante e qeshte si fëmijë.”¹⁶

Shembulli 2

“- Eccola qui, - disse la Fatta, tirandola fuori da una zuccheriera d'oro.”¹⁷

“- Tek e kam këtû – tha Zâna tuj e xjerrë prej një kutije sheqerit të prarueme.”¹⁸

“- Ja ku e kam, - tha Zana dhe e nxori nga një kuti e pruar mbushur me kokrra sheqeri.”¹⁹

Shembulli 3

“Arlecchino e Pulcinella da principio esitarono; ma impauriti da un'occhiataccia del loro padrone, obbedirono.”²⁰

“Arlekini e Pulçinela njiherë ngurruen; por një shikjim i rrebët i zotnís u a shtëni mneren e i bâni me ndigiuë.”²¹

¹⁴ Carlo Collodi: *“Le avventure di Pinocchio”*, vep. e cituar, fq. 5.

¹⁵ Karlo Kolodi: *“Pinoku”*, përkthyer nga Cuk Simoni, vep. e cituar, fq. 9.

¹⁶ Karlo Kolodi: *“Pinoku”*, përkthyer nga origjinali nga Cuk Simoni, përshtatur në gjuhën e sotme letrare nga Zef Simoni, shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1994, fq. 7.

¹⁷ Carlo Collodi: *“Le avventure di Pinocchio”*, vep. e cituar, fq. 71.

¹⁸ Karlo Kolodi: *“Pinoku”*, përkthyer nga Cuk Simoni, vep. e cituar, fq. 82.

¹⁹ Karlo Kolodi: *“Pinoku”*, përkthyer nga origjinali nga Cuk Simoni, përshtatur në gjuhën e sotme letrare nga Zef Simoni, vep. e cituar, fq. 52.

²⁰ Carlo Collodi: *“Le avventure di Pinocchio”*, vep. e cituar, fq. 42.

²¹ Karlo Kolodi: *“Pinoku”*, përkthyer nga Cuk Simoni, vep. e cituar, fq. 50.

“Arlekini e Pulçinela ngurruan një çast, por një vështrim i rreptë i të zotit u kalli tmerrin, ndaj u bindën sakaq.”²²

Shembulli 4

“- Shi në kohë të mirë më rá në dorë kjo dru...”²³

“- Kjo copë dru më ra në dorë tamam në kohë të mirë...”²⁴

Në shembullin e parë, *maestro Cigliëgia, falegname* është përkthyer nga Cuk Simoni *Mjeshtëri Qershija, zdruckhtar*, pra, është ruajtur struktura e italishtes e rendit të fjalëve në fjali, ndërsa Zef Simoni e ka përkthyer *zdruckhtari mjeshtëri Qershia*, duke respektuar kështu strukturën sintaksore të shqipes. Në shembullin e dytë *eccola qui* është përkthyer në shqip *tek e kam këtu (ja e kam këtu)*, ndërkohë që struktura sintaksore e shqipes është *ja, ku e kam*, sipas variantit të përkthyer nga Zef Simoni. Po kështu ndodh dhe në shembullin e tretë ku *njiherë ngurruen* është përshtatur *ngurruan një çast*. Ndërsa në shembullin e fundit, është ndërruar vendi i dy shprehjeve të shqipes *Shi në kohë të mirë më rá në dorë kjo dru*, të përdorura nga Cuk Simoni, në: *kjo copë dru më ra në dorë tamam në kohë të mirë*. Natyrisht që këto zgjedhje të Zef Simonit i kanë dhënë përshtatjes së tij në gjuhën letrare elegancë dhe finesë.

2. Zefi Simoni, një përkthyes i zoti, i talentuar dhe me përvojë në këtë fushë, e përshtati *“Pinokun”* në një kohë kur shqipja ishte pasuruar me fjalë e shprehje të reja që i lejuan atij mundësi të reja shprehëse. Leksiku i përdorur dhe shprehjet frazeologjike të sjella në përshtatje, përgjithësisht janë të barazvlershme me ato në dialekt, por nuk mungojnë edhe raste kur kanë kuptim të përafërt, të cilat e bëjnë më të pasur stilistikisht dhe estetikisht përshtatjen e tyre në gjuhën letrare. Në vijim, po sjellim disa të tilla:

iu bë zemra mal në vend të: i u knaq fort zëmra, mora vesh në vend të: kuptova, ma ha mendja në vend të: xâ besë, i kishte hyrë frika deri në palcë në vend të: i kishte pasë hî kthjelltë një frigë e madhe, përleshja në vend të: lufta, kërcirit të thatë në vend të: kambës së thát, iu errën sytë në vend të: s’dijti mâ se çka bân, mori nga shtëpia në vend të: u kthye kah shpia, vraponte si kal i hazdisur në vend të: ngitte vrap si kál, përvidej në vend të: me i kalie befas, shpirtkazmë në vend të mizuer, me hir a me pahir në vend të: perdhuni a per nderë, kishte filluar të ngrysej në vend të: kishte fillue me u errë, ta pret mendja në vend të: mërret me mënd, e kishte zgrapjen në gjak në vend të: e prirun prej natyre

²² Karlo Kolodi: *“Pinoku”*, përkthyer nga origjinali nga Cuk Simoni, përshtatur në gjuhën e sotme letrare nga Zef Simoni, vep. e cituar, fq. 31 - 32.

²³ Karlo Kolodi: *“Pinoku”*, përkthyer nga Cuk Simoni, vep. e cituar, fq. 9.

²⁴ Karlo Kolodi: *“Pinoku”*, përkthyer nga origjinali nga Cuk Simoni, përshtatur në gjuhën e sotme letrare nga Zef Simoni, vep. e cituar, fq. 7.

gjithmonë me kap, të marrim një sy gjumë në vend të: me e bâ një sy gjumë, bie ndër cuba në vend të: ndeshë nder cuba, braktisur në vend të: lânë vetun.

Edhe aty ku te Cuk Simoni mund të gjendet ndonjë fjalë e shqipes letrare, Zef Simoni e ndërron me një fjalë më të vjetër e dialektore, siç është rasti i fjalës *hotel* dhe *vajza* (te Cuk Simoni), të zëvendësuara me fjalët *bujtinë* dhe *vasha*.

Në përshtatjen e Zef Simonit, emrat e përveçëm janë rishkruar sipas grafemave të alfabetit, duke iu nënshtruar jo vetëm ligjeve të fonetikës së shqipes, por edhe ndryshimeve morfologjike, sipas fleksionit të gjinisë dhe numrit, por edhe të rasave. Në përshtatjen e tij nuk ka cenim të paragrafëve, të cilët ruhen sipas përkthimit të bërë nga i ati. Por, përsa u përket shenjave të pikësimit, vihet re se ato kanë prirje të qartë drejt ndryshimit, duke bërë kështu që përgjithësisht të mos përputhen me përkthimin e Cuk Simonit, i cili nga ana e tij, me përjashtim të disa shmangieve të pakta, i respektonte shenjat e pikësimit sipas origjinalit. Kështu, Zef Simoni, herë shton një presje, herë një pikëpresje e zëvendëson me një presje, herë një presje e zëvendëson me pikë ose vendos shenja pikësimi aty ku në origjinal dhe në përkthimin e parë nuk ka. Më poshtë po japim disa shembuj:

“Detto fatto, prese subito l’ascia arrotata per cominciare a levargli la scorza e a disgrossarlo, ma quando fu lì per lasciare andare la prima asciata, rimase col braccio in aria, perché sentì una vocina sottile sottile, che disse...”²⁵

“E pá tjetër, muer me’ i herë sakicen e prehët per me e qirue e m’e hollue: por në sá po matej me i rá, mbet me dorë perpjetë, pse ndjeu një zâ të hollë e të lehtë kah i lutej...”²⁶

“E pa e çuar më gjatë, mori menjëherë latoren e mprehtë për ta qëruar e për ta holluar. Po kur po matej t’i binte, mbeti me dorë perpjetë, se dëgjoi një zë të hollë e të lehtë që i lutej...”²⁷

“- Ho capito: - disse allora ridendo e grattandosi la parrucca – si vede che quella vocina me la sono figurata io. Rimettiamoci a lavorare. E ripresa l’ascia in mano, tirò giù un solennissimo colpo sul pezzo di legno.”²⁸

“- Kuptova: - tha at herë tuj qeshë e tuj krue kryet – duket se më kan bâ veshët. T’i vëhemi prap punës. E si muer prap në dorë sakicen, suell mbi at copë drú sá kú mujt.”²⁹

²⁵ Carlo Collodi: *“Le avventure di Pinocchio”*, vep. e cituar, fq. 5 - 6.

²⁶ Karlo Kolodi: *“Pinoku”*, përkthyer nga Cuk Simoni, vep. e cituar, fq. 10.

²⁷ Karlo Kolodi: *“Pinoku”*, përkthyer nga origjinali nga Cuk Simoni, përshtatur në gjuhën e sotme letrare nga Zef Simoni, vep. e cituar, fq. 7.

²⁸ Carlo Collodi: *“Le avventure di Pinocchio”*, vep. e cituar, fq. 5 - 6.

²⁹ Karlo Kolodi: *“Pinoku”*, përkthyer nga Cuk Simoni, vep. e cituar, fq. 10.

“- Mora vesh, - tha atëherë, duke qeshur e duke kruar kokën, - do të më kenë bërë veshët. T'i vihemi prapë punës! E, si mori prapë në dorë latoren, i ra asaj copë druje sa i punoi krahu.”³⁰

“E riscaldandosi sempre più, vennero dalle parole ai fatti, e acciuffatisi fra di loro, si graffiarono, si morsero e si sbertuciarono.”³¹

“E tuj u xé gjaku perherë e mâ tepër, prej të shameve nisen me u rrahë, u kapen per flokësh, u gerdhishten, u hangen në dhamë e u bâ puna si â mâ zî.”³²

“E duke u nxehur gjakrat përherë e më shumë, nga të sharat kaluan te të rrahurat. U kapën për flokësh dhe u gërvishën, u hëngrën me dhëmbë dhe u bënë për faqe të zezë.”³³

Pas dy botimeve të “*Pinokut*” (1994 dhe 2000), me përshtatjen në gjuhën letrare të Zef Simonit, bëhen një sërë botimesh dhe ribotimesh, ku spikat numri i madh i ribotimeve të variantit të përkthyer nga vëllezërit Taulant dhe Eri Tafa. Varianti i tyre, ai më pak besnik ndaj originalit, krahasuar me ato të përkthyesve të tjerë, është quajtur nga autorët *shqipërim*, për të nënvizuar një liri më të madhe gjatë procesit të kalimit nga italishtja në shqipe. Që në titullin e kapitullit të parë duket qartë shmangia, jo vetëm gjuhësore, por edhe kuptimore:

“Come andò che maestro Cigliegia, falegname, trovò un pezzo di legno, che piangeva e rideva come un bambino”³⁴

“Asnjë nuk e di se si ndodhi, që një zdrukthtar, Mjeshtër Qershia, gjeti një copë dru që qante dhe qeshte si fëmijë”³⁵

“Non era un legno di lusso, ma un semplice pezzo da catasta, di quelli che d’inverno si mettono nelle stufe e nei caminetti per accendere il fuoco e per riscaldare le stanze. Non so come andasse, ma il fatto gli è che un bel giorno questo pezzo di legno capitò nella bottega di un vecchio falegname, il quale aveva nome maestr’Antonio, se non che tutti lo chiamavano maestro Ciliegia, per via della

³⁰ Karlo Kolodi: “*Pinoku*”, përkthyer nga originali nga Cuk Simoni, përshtatur në gjuhën e sotme letrare nga Zef Simoni, vep. e cituar, fq. 8.

³¹ Carlo Collodi: “*Le avventure di Pinocchio*”, vep. e cituar, fq. 9.

³² Karlo Kolodi: “*Pinoku*”, përkthyer nga Cuk Simoni, vep. e cituar, fq. 15.

³³ Karlo Kolodi: “*Pinoku*”, përkthyer nga originali nga Cuk Simoni, përshtatur në gjuhën e sotme letrare nga Zef Simoni, vep. e cituar, fq. 10.

³⁴ Carlo Collodi: “*Le avventure di Pinocchio*”, vep. e cituar, fq. 5.

³⁵ Karlo Kolodi: “*Pinoku*”, shqipëruar nga Eri dhe Taulant Tafa, Botimet “Vëllezërit Tafa”, Tiranë, 2006, fq. 5.

punta del suo naso, che era sempre lustra e paonazza, come una ciliegia matura.
”³⁶

“Nuk ishte pjesë e ndonjë trangu të madh e të vjetër, por thjeshtë një shqopë që e përdorim si dru zjarri dimrit të eger, për të thyer të ftohtit e për të ngrohur sadopak dhomat e akullta. Unë nuk e di se si një ditë kjo shkopishtë u gjend në shtëpinë e zdrukthtarit plak. Emri i tij i vërtetë ishte Mjeshtëri Antonio, por të gjithë e thërrisnin Mjeshtëri Qershia, për shkak të hundës rrumbullake në ngjyrë të kuqe të shëndritshme si një kokërr qershie e pjekur”³⁷

Në shembullin e parë, grupi i fjalëve *come andò (si ndódh)*, nga vëllezërit Tafa është përkthyer: *asnjë nuk e di si ndódh*, duke shtuar kështu edhe përemrin e pacaktuar *asnjë*, edhe pjesëzën mohuese *nuk*, çka të dyja fjalët së bashku emetojnë tjetër nuancë kuptimore, atë të mohimit: se *asnjë* nuk ishte në dijeni të ngjarjes që do të tregohet në vijim, çka e gjitha kjo në fakt në variantin italisht lihet të kuptohet. Në shembullin e dytë, përveç shtimit të disa fjalëve apo grupeve të fjalëve, të bie në sy zëvendësimi i *pezzo di legno* me *një shqopë*, pra, *copën e drurit* të Kolodit, vëllezërit Tafa e kanë zëvendësuar me emrin e një prej llojeve të drurëve, *shqopë*. Ndërkohë, kritikikët italianë kur flasin për origjinën e emrit të Pinokut, thonë se rrjedh nga fjala *pino* (Pinocchio), në shqip: pishë.

Në gjithë shtrirjen e shqipërimit të vëllezërve Tafa, jo vetëm gjenden një mori fjalësh që nuk ndodhen në origjinal, por të shumta janë edhe fjalitë e shtuara nga shqipëruarit. Gjithashtu, në shqipërimin e tyre, nuk respektohet as ndarja në paragrafë sipas origjinalit. Përgjithësisht dy ose tre paragrafë bashkohen në një të vetëm, si në shembullin në vijim:

“Per l'appunto era una nottataccia d'inverno. Tuonava forte forte, lampeggiava come se il cielo pigliasse fuoco, e un ventaccio freddo e strapazzone, fischiano rabbiosamente e sollevando un immenso nuvolo di polvere, faceva stridere e cigolare tutti gli alberi della campagna.

Pinocchio aveva una gran paura dei tuoni e dei lampi: se non che la fame era più forte della paura: motivo per cui accostò l'uscio di casa, e presa la carriera, in un centinaio di salti arrivò fino al paese, colla lingua fuori e col fiato grosso, come un cane da caccia.

Ma trovò tutto buio e tutto deserto. Le botteghe erano chiuse; le porte di casa chiuse; le finestre chiuse; e nella strada nemmeno un cane. Pareva il paese dei morti.”³⁸

³⁶ Carlo Collodi: *“Le avventure di Pinocchio”*, vep. e cituar, fq. 5.

³⁷ Karlo Kolodi: *“Pinoku”*, shqipëruar nga Eri dhe Taulant Tafa, vep. e cituar, fq. 5.

³⁸ Carlo Collodi: *“Le avventure di Pinocchio”*, vep. e cituar, fq. 25.

“Pinoku u trembej rrugëve të errta. Ishte kaq i uritur saqë e kishte lënë frikën mënjane dhe vraponte tutje. Nata ishte sterrë e zezë dhe ndriçimi i vetëtimate, herë pas here, e kthente qiellin në një det të zjarrtë. Frynte ere e egër, e ftohtë dhe ngrinte re të dendura pluhuri; pemët lëkundeshin dhe zhurmonin sa të kallnin datën. Pinoku ishte llahtarisht i frikësuar nga bubullimat e vetëtimat, por uria ishte më e madhe se frika që ndjente. Vrapoi si i marrë dhe sa të hapësh e të mbyllësh sytë, u gjend në fshat. Ishte tmerrësisht i lodhur, gulçonte si një zagat me gjuhën të varur jashtë. I gjithë fshati ishte i errët dhe i shkretë. Dyert dhe dritaret ishin mbyllur. Në rrugë nuk kalonte qoftë edhe një qen sa për të thënë. Fshati dukej si i vdekur”³⁹

Tashmë është i njohur fakti se përkthimi nuk është një akt i pastër kalimi nga një kod në tjetrin. Distanca kulturore dhe gjuhësore, midis tekstit origjinal dhe tekstit të përkthyer, sjell gjatë procesit të përkthimit vështirësi dhe e detyron përkthyesin të bëjë disa zgjedhje arbitrare. Përkthimet e “Pinokut” janë më shumë se një kalim nga një gjuhë në tjetrën, janë më shumë se një strukturim i thjeshtë i fjalive dhe fjalëve bazuar besnikërisht në tekstin origjinal. Këto përkthime nuk janë të tipit normativ, por kanë një lirë në praktikën e përkthimit. Gjuha shqipe, gjithmonë në zhvillim dhe pasurim të vazhdueshëm, i ka lejuar përkthyesve të konkurrojnë me stilin e shkrimtarëve të përkthyer. Ata kanë qenë besnikë ndaj shpirtit të veprës, por jo besnikë fjalë për fjalë sipas origjinalit. Përkthimet e tyre kanë ruajtur identitetin e gjuhës së autorit, duke mos ia hequr shkëlqimin, por njëkohësisht duke i dhënë gjuhës shqipe një vlerë autonome estetike.

Burimet bibliografike

1. Bishqemi, Astrit: *“Histori e Letërsisë Shqiptare për Fëmijë dhe të Rinj”*, botues Pëllumb Zekthi, Tiranë, 2008.
2. Collodi, Carlo: *“Pinoku”*, përkthyer nga Cuk Simoni, Botim i përkthyesit, rr. Gurakuqi 40, Shkodër, 1935.
3. Collodi, Carlo: *“Pinoku”*, përshtatur në shqipen letrare nga Zef Simoni, “Naim Frashëri”, Tiranë, 2000.
4. Collodi, Carlo: *“Pinoku”*, shqipëruar nga Eri dhe Taulant Tafa, Botimet “Vëllezërit Tafa”, Tiranë, 2006.
5. Collodi, Carlo: *“Le Avventure di Pinocchio”*, Giunti Marzocco, Firenze, 1981.

³⁹ Karlo Kolodi: *“Pinoku”*, shqipëruar nga Eri dhe Taulant Tafa, vep. e cituar, 2006, fq. 20.

6. Dedja, Bedri: *"Tradita dhe probleme të letërsisë shqipe për fëmijë"*, Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", Tiranë, 1971.
7. Kodra, Klara: *"Pinoku, Piter Pani dhe Liza, tre shembuj të figurës së fëmijës në letërsinë botërore"*, shtëpia botuese "Elite", Tiranë, 1998.
8. Missali, Gjon Stefa: *"Oazi i artë i Gjuhëdolit"*, Shtëpia Botuese "Gjergj Fishta", Lezhë, 2011.
9. Prifti, Naum: *"Kolodi dhe vepra e tij"*, në *"Ndodhi gazmore"* të Karlo Kolodit, Shtëpia botuese "Naim Frashëri", Tiranë, 1987.

Janë shfrytëzuar gjithashtu periodikët:

1. *"Hylli i dritës"*, nr. 9, 1935.
2. *"Illyria"*, nr. 21, 7 shtator 1935.
3. *"Illyria"*, nr 23, 21 shtator 1935.
4. *"Illyria"*, nr. 24, 28 shtator 1935.
5. *"Leka"*, nr. 9, shtator 1935.

VARIETETET DHE VAJRAT E ULLIRIT NË DISA VENDE TË MESDHEUT

¹Marinela Muço, ²Anila Kopali

¹Universiteti i Vlorës, Fakulteti i Shkencave Teknike, Departamenti i Kimisë, Vlorë, Shqipëri

²Universiteti Bujqësor i Tiranës, Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit, Tiranë, Shqipëri

Përmbledhje

Edhe pse ekzistojnë teori të ndryshme mbi origjinën e vajit të ullirit, besohet se origjina gjeografike e bimës së ullirit gjendet saktësisht në zonën e Sirisë dhe Iranit, ose në Afrikën sub-sahariane. Për më shumë se 6000 vjet kultivimi i ullirit është zhvilluar bashkë me civilizimin Mesdhetar dhe tani prodhohet komercialisht në më shumë se 9.4 milion ha në këtë basin. Proceset e ndryshme të përzgjedhjes krijuan një numër të madh të kultivarëve të ndryshëm. Pema e ullirit ka disa kërkesa specifike për rritjen e saj, si rezultat ullinjtë janë spostuar në ato toka ku ato do të mbijetojnë. Një prej vendeve, është edhe vendi ynë i cili ka potenciale të mëdha për kultivimin dhe përpunimin e ullirit, të krahasueshme me vendet e Mesdheut për vetë kushtet klimatike të përshtatshme dhe cilësinë e kultivarëve autoktonë. Në vendin tonë ekzistojnë disa kultivarë ndër të cilët përmendim: *Kalinjot*, *Kokërrmadh i Beratit*, *Kokërrmadh i Elbasanit*, *Ulliri i bardhë i Tiranës*, *Mixan*, *Nisiot*, *Ulliri i hollë i Himarës* dhe *Frantoio*. Në këtë artikull përshkruhet historia e kultivimit të ullirit dhe vajit të ullirit në Shqipëri dhe disa vende të Mesdheut dhe rrjedhimisht të procesit të përpunimit të ullinjve deri në vajin e ullirit si dhe gjendja aktuale e ullishtarisë në vendin tonë.

Fjalë kyçe: Mesdheu, pema e ullirit, vaji i ullirit, kultivarë, përpunimi i ullirit

Abstract

The story of the origin of olive in Albania has no difference from its spreading path in the Mediterranean. Albania is a Mediterranean country where it is thought the olive tree has originated. The Albanian olive production zone covers the entire coast from Saranda (South) to Shkodra (North) and inland river valleys in the districts of Peqin/Elbasan, Berat/Skrapar, and Tepelenë/Përmet. By 1990, the

number of olive trees has increased to 5.9 million covering 45,000 hectares.

One of the main factors that affect the productivity of the olive tree is its cultivar. There are more than 28 varieties of olive cultivars grown all over Albania. Some of the most important varieties used in the olive oil industry are: *Kalinjot*, *Kokërrmadh i Beratit*, *Kokërrmadh i Elbasanit*, *Ulliri i bardhë i Tiranës*, *Mixan*, *Nisiot*, *Ulliri i hollë i Himarës* and *Frantoio*. With the exception of the *Frantoio*, which is a variety introduced from Italy, the other eight varieties are commonly native and grown ones in Albania. The two leaders are *Kalinjot*, which covers about 40% of the total plantations known for oil and table use; and *Kokërrmadh i Beratit*, representing approximately 21% of table olives. In various regions of Albania, oils with distinctive characteristics and tastes are observed, as a result of differences in olive cultivar, local environment conditions (soil, climate, altitude) and cultural practices.

Keywords- cultivar, olive tree, olive oil, Mediterranean

HYRJE

Ulliri duket se ka bashkëjetuar me njerëzit për rreth 5000 deri 6000 vjet, duke shkuar pas në fillim të periudhës së Bronzit (3150-1200 p.e.s). Bazuar në shkrime të gjetura dhe fragmente të drurit të gjetura në varret e lashta, origjina e tij mund të jetë në zonat përgjatë bregut lindor të Mesdheut, ku tani janë Turqia jugore, Siria, Libani, Palestina, dhe Izraeli. Dokumentet e lashta në Siri tregojnë se rreth 2000 vjet p.e.s vlera e vajit të ullirit ishte pesë here më e madhe se ajo e verës dhe dy herë e gjysmë më e madhe se ajo e vajit të farërave. Përhapja e pemëve të ullirit nga fara është shumë frustruese, sepse faza e mitur është aq e gjatë (10-15 vjet) dhe pasardhësit shumë shpesh nuk ngajnë me pemën origjinale amtare. Përhapja e drurit të ullirit në tregti është e dokumentuar. Megjithatë, lëvizjet kryesore ishin në perëndim. Të dhënat tregojnë futjen e ullinjve në Greqi, Egjipt, dhe Turqinë perëndimore. Në ato zona, ka shumë vende arkeologjike të lidhura me gjetjet e ullirit, të tilla si gurë mulliri, pellgje dekantimi, enët e magazinimit, afreske, dhe shkrimet e lashta. Në Pallatin e Knossos në ishullin e Kretës, tavolina e baltës tregon tregtimin e vajit të ullirit që mund të ekzistonte edhe para 1700 vjetësh para erës sonë. Në Turqi në Urla, pranë Izmirit, ka një objekt përpunimi të lashtë të vajit të ullirit i cili mendohet të ketë ekzistuar rreth 600 vjet para erës sonë. Shumë enët balte, të quajtura amfora, të cilat janë përdorur për të ruajtur dhe transportuar vajin e ullirit, mund të gjenden në gërmadha në të gjithë zonën. Ullinj të vazhduan të spostohej drejt perëndimit në Sicili, Sardenjë, Itali, Francë, Spanjë, Portugali, Algjeri, Tunizi dhe Marok. Mendohet se dhe grekët importuan pemët e ullirit nga Italia. Shkrimet agronomike të regjistruara për herë të parë mund t'i atribuohen romakëve, dhe sigurisht zgjerimi dhe prosperiteti i Perandorisë Romake ishte i rëndësishëm në përhapjen e mbjelljeve të ullirit dhe objekteve të përpunimit të vajit në gjithë pellgun e Mesdheut. Gadishulli Iberik (Spanje dhe Portugali) dhe bregdeti verior i Afrikës u

bënë zonat më të mëdha të prodhimit të vajit të ullirit që u dërgua me amfora të mëdha në Angli, Gjermani, Francë dhe Itali. Vaji i ullirit në ato kohë kishte shumë përdorime të dokumentuara. Të gjitha kulturat e përdornin ullirin kryesisht si lëndë djegëse për llambën e vajit, e cila në atë kohë ishte vlera e tij më e madhe. Shumë rituale përfshinin përdorimin e vajit të ullirit, duke përfshirë vajosjen e familjes mbretërore, luftëtarëve, dhe publikun e gjerë për qëllime fetare. " Vaji i ullirit ishte përdorur për tu bërë oferta "Zotërve", si medikament farmaceutik për të kuruar sëmundje, dhe për tu përdorur për lëkurën dhe flokët që të duken të shëndetshme. Grekët për disa rite fetare historikisht kanë përdorur vajin e ullirit. Ai gjithashtu është përdorur për prodhimin e sapunit. Vaji i ullirit ka ekzistuar shumë pak për tu përdorur për konsum njerëzor. Gjatë Mesjetës, vaji i ullirit ka vazhduar të rrisë prodhimin dhe rëndësinë e tij kryesisht në Spanjë, Itali dhe Greqi. Zgjerimi më i madh i prodhimit të vajit të ullirit erdhi pas 1700-ës, kur mbjellje të mëdha të ullinjve, u shtuan në masë të madhe edhe në toka të këqija, të cilat u bënë për të furnizuar popullsinë në rritje të qyteteve. Në fund të shekujve 19 dhe 20, zhvillimi i teknikave të ekstraktimit me solvent me kosto të ulët për vajrat e farërave dhe përdorimi i burimeve të tjera të lehta (gazi dhe energjia elektrike) rezultuan një rënie të kërkesës për vaj ulliri. Në më pak se 40 vjet më parë ka pasur një tepri të vajit të ullirit në tregun botëror. Varfëria e përhapur në Spanjë, Italinë jugore dhe Greqi frenoi për shumë njerëz përdorimin e produkteve të shtrenjta si vaji i ullirit. Për të konkuruar në çmim me vajrat e farërave, ullinjët nuk u rritën me cilësinë e menduar (Blazquez Marti'nez, 1996; Civantos, 2001; Filo della Torre, 2002, Rallo, 2005). Ullinjët u lanë në grumbuj për muaj derisa u kalbën para se të përpunoheshin, për të lehtësuar ekstraktimin më të madh të vajit. Kjo ka qenë e vërtetuar mirë se llojet e ndryshme të vajrave të farërave të tilla si pambuku, këрпи, susami, arra palme, luledielli, dhe lajthi janë përdorur për të falsifikuar vajin e ullirit dhe për ta bërë atë me kosto më konkurruese. Zhvillimi i Këshillit Ndërkombëtar të Vajit të Ullirit ishte pjesërisht një përgjigje ndaj mashtrimit të gjerë në tregtinë e vajit të ullirit që rrethon shitjen e vajit të pulpës së ullirit, i etiketuar si vaj ulliri i virgjër (Aparicio et al, 1997; Baeten dhe Aparicio, 2000; European Commission, 2001 ; Fiorino dhe Alessandro, 1996; International Olive Oil Council, 2003b; Schafer - Schuchardt dhe Wetenkamp, 2005). Meqënëse drurët e ullirit mund të jetojnë për qindra vjet dhe për të arritur prodhimin e plotë duhen shumë vite, përzgjedhja dhe përhapja e varieteteve më të mira do të kishte qenë kryesisht në zonat e mbjella rishtas. Kjo mungesë e qarkullimit të pemishteve dhe vështirësive në udhëtim për fermerët ndoshta janë arsyt pse shumë varietete të ndryshme të ullirit ende ekzistojnë në pjesë të Evropës. Në disa raste, çdo fshat apo zonë tjetër rritjeje kanë shumëllojshmërinë e tyre të panjohur, ndonjëherë me emra të ndryshëm për të njëjtin varietet, dhe nganjëherë të varieteteve të ndryshme që kanë të njëjtin emër. Ka ndodhur sigurisht përzgjedhja natyrore, por ka më shumë të ngjarë që varietetet më të mira janë sjellë nga zonat e tjera nëpërmjet tregtisë. Vetëm varietetet shumë superiore do të ishin mbjellë gjerësisht. Kjo sigurisht është sot e vërtetë; vetëm

rreth 20 varietete kryesore janë importuar nga Kalifornia, Afrika e Jugut, Australia, Zelanda e Re, Kili, dhe Argjentina (Bartolini et al, 1994; Civantos Lo'pezVillalta, 1998 ; Vossen, 2005). Sot në botë janë 9.4 milion ha ullinj, që prodhojnë 1.5 milion ton ullinj të tavolinës dhe 16 milion ton të ullinjve që përpunohen në 2.56 milion ton vaj. Spanja ka rreth një të katërtën e sipërfaqes në botë, me 5.98 milion akra (2.42 milion ha) të ullirit të kultivuar dhe 36 % të prodhimit të vajit (800.000 t / vit), e cila e renditet si prodhuesin kryesor. Në vitet 2001-2002, Spanja prodhoi 50 % të vajit në botë si rezultat i një prodhimi shumë të lartë krahasuar me prodhimin shumë të varfër në shumë vende të tjera . Italia është renditur e dyta, me 3.53 milion akra (1.43 milion ha) dhe 24 % të prodhimit të vajit në botë (520.000 t / vit). Greqia është e treta, me 17 % (400.000 t / vit) të prodhimit botëror të vajit, dhe është e katërta në sipërfaqe në akra me 2.55 milion akra ullinj (1.03 milion ha). Të tre vendet e mëdha së bashku prodhojnë 77 % të vajit të ullirit në botë (Fig. 1).




Figura 1: Prodhimi botëror i vajit të ullirit

Prodhimi parashikohet të rritet në vitet e ardhshme nga 8% deri në 10% si rezultat i pasurimit të tokës. Shumica e rritjes së prodhimit do të vijnë nga Spanja dhe plantacione të reja botërore në Australi dhe Amerikën e Jugut (International Olive Oil Council, 2003a, 2004). Tunizia, Turqia, Maroku, Siria, dhe Portugalia kanë sipërfaqe serioze në akra për vaj ulliri, por të prodhimit të ulët dhe teknologjisë së pazhvilluar të përpunimit. Për vitet e fundit, prodhimi i vajit ka qenë vazhdimisht në rritje me 1.4 % në vit. Prodhimi mesatar vjetor është 2.2 milion ton në vit. Shumica e pemishteve të ullirit në botë janë të thata, me një prodhim mesatar 0,5 ton për akër të frutit, por pemishtet e mirë ujitura mund të prodhojnë 10 herë më shumë të kësaj sasive (European Commission, 2003).

KLASIFIKIMI BOTANIK I ULLIRIT

Përsa i përket origjinës gjenetike të vërtetë të pemës së ullirit *Olea europaea* L, akoma ajo nuk dihet. Disa shkencëtarë besojnë se ulliri "European" që ka genin *Olea*, i cili ka fruta të mëdha që janë të ngrënshme, është një hibrid midis dy ose më shumë llojeve të vecanta. Shkencëtarë të tjerë e konsiderojnë genin *Olea* dhe speciet *europaea* të jenë pjesë e një grupi të gjerë bimësh të ndryshme me "ekotipe" ose "subspecie" të cilat ndodhen në rajone të ndryshme gjeografike. Në pothuajse çdo vend ku kultivohet ulliri gjithashtu ekzistojnë, pemët e ullirit të egër dhe shkurret me gjethe të ngushta të quajtura "oleaster". Këto bimë mund të jenë fidanë të varieteteve të kultivuara të përhapura nga zogjtë dhe nga kafshë të egra të tjera të ushqyera me fruta, ose ato mund të jenë forma native të subspecieve ose ekotipeve që tashmë ekzistojnë para futjes së kultivimit të ullirit. Të gjitha gjinitë *Olea* kanë numër të njëjtë të kromozomeve ($2n = 46$) dhe kryqëzimet midis shumë prej tyre kanë qenë të suksesshme. Shumica e shkencëtarëve tani përdorin nomenklaturën e *Olea europaea* L. *sativa* për ta dalluar atë nga subspecia *oleaster* e ullirit të egër me gjethe të ngushta (Lavee, 1996).

SEKTORI I ULLIRIT NË SHQIPËRI

Historia e origjinës së ullirit në zonat shqiptare nuk ka asnjë dallim nga rruga e përhapjes në gjithë Mesdheun, e cila ka ndodhur në të njëjtën kohë me përhapjen në Greqi nga grekët e lashtë dhe më pas nga romakët. Shumë zbulime arkeologjike kanë treguar që kultivimi i ullirit në Shqipëri, ashtu si në vendet e Mesdheut, është shumë i vjetër. Të dhëna arkeologjike vërtetojnë shkallën e zhvillimit të bujqësisë në periudhën ilirike me figura simbolike si kalliri i grurit, bistaku i rrushit, dega e ullirit etj, të paraqitura në monedha.

Ulliri është përqëndruar në Ultësirat Perëndimore duke depërtuar në pjesën kontinentale nëpërmjet luginave të lumenjve duke shfrytëzuar mikro-klimat në shpatet e maleve dhe kodrave.

Paraardhësit tanë e cuan ullirin edhe në zona marginale si Përmet, Tepelenë, malësitë e Elbasanit, Krujës, dhe Tiranës. Vatrë e vjetra të ullirit në Shqipëri janë dhe vatrë të civilizimit. Rreth kështjellave mesjetare dhe në ish qytetërimet mijëvjeçare ka një larmi popullatash dhe varietetesh për vaj dhe për tryezë me përhapje të lokalizuar dhe shumë mirë të përshtatur në kushtet pedoklimatike.



Ekzistojnë ekzemplarë ulliri me moshë 1500 deri 2000 vjeçare në zonën e Tiranës (Petrelë), Vlorës etj. Ulliri shtrihet në zonën Klimatike Mesdhetare, që përfaqëson 36.2% të sipërfaqes territoriale të Shqipërisë. Në sipërfaqen bujqësore ullishtja zë rreth 5.9% të tokës së punueshme në shkallë vendi. Ky tregues është më i lartë në qarkun e Vlorës me 23,3% dhe të Beratit me 12,6%, të cilat kanë dhe sipërfaqet më të mëdha , ndjekur nga qarku i Fierit dhe Tiranës. Në këto katër qarqe janë përqëndruar 84,7% e ullishteve. Ndërsa pjesa i përket ndarjes gjeografike rreth 3.3% e ulinjve janë kultivuar në zonën e ulët dhe 96,7% në zonën kodrinore. Në 77 % të fermave ullinjtë janë kultivuar në plantacione të organizuara kurse pjesa e mbetur 23 %, është gjetur në një formë jo të organizuar.

Përqëndrimi i ullirit në plantacione jep mundësinë për shërbime më të kujdesshme dhe për përdorimin e teknologjive të përshtatshme. Në Figurën 2, sipas të dhënave të marra nga INSTAT (Instituti i Statistikave, 2008) tregohet sipërfaqja dhe numri i ulinjve gjatë viteve.



Figura 2. Zona e kultivimit të ullinjve në Shqipëri (USAID 2011)

Para vitit 1990 ulliri ka zënë rreth 6% të tokës së punueshme. Karakteristikë e asaj periudhe janë rendimentet mjaft të ulëta me 10-12 kv/ha ulli. Me ndërrimin e sistemit ekonomik një pjesë e ullishteve u abandonua sepse nuk ishte rentabël, si rezultat rreth 10.000 ha ullishte ose 22% u shkatërruan ose u abandonuan. Pas viteve 1990 është periudha e kërkimit të rrugëve të rentabilitetit me tendencë në rritje të prodhimit, interesim për efikasitet, interesim për vaj cilësor. Nga viti 2000 deri në vitin 2008 janë mbjellë 1,4 milion rrënjë ulli, me mesatare vjetore 175.000 rrënjë ulli.

Një faktor që ndikon në potencialet prodhuese është mosha e ullishtës. Ullishtja shekullore përbën rreth 30% të ullishtës totale, ullishtet me moshë 40-50 vjecare përbëjnë rreth 51% të ullishteve në shkallë vendi dhe ullishtet e mbjella pas viteve '90 përbëjnë rreth 19% të kësaj sasive. Në vendin tonë si ullishtet shekullore, dhe ato të mbjella në vitet 1960-1970, ndodhen në blloqe masive me sipërfaqe të mëdha. Kjo është pozitive, për të reduktuar efektet e mëdha negative të fragmentizimit të fermave. Pas viteve 1990, me mbjelljet e ullishteve të reja, shihet fenomeni i parcelizimit, secili fermerë ka mbjellë ullishte në pronën e vet, në mënyrë të pavarur, dhe ky është një tjetër element negativ që i shtohet negativitetit të pronës së vogël. Panorama e këtyre ullishteve, edhe pse të financuara nga skemat mbështetëse, është ajo e njollave të vogla të shpërndara në gjithë territorin e vendit.

Një nga faktorët më të rëndësishëm që ndikojnë në produktivitetin e drurit të ullirit është kultivari i tij. Një numër i madh varietetesh rreth

22 është në përbërje të ullishteve shekullore, pa përfshirë përbërjen e popullatave të tyre, me një ndryshueshmëri të dukshme, që përbëjnë një pasuri të madhe për të sotmen dhe të ardhmen e ullishtarisë. Ullishtet e krijuara në vitet 1960-1970 kanë një përbërje varietore shumë të ngushtë. Dominojnë kultivarët “Kalinjot” dhe “Kokërr Madh i Beratit” dy varietetet e prodhuara nga fidanishtet e mëdha rajonale. Para viteve’90 nuk ka patur strategji kultivarësh. Kultivari “Kalinjot” arriti 42% në strukturën e kultivarëve. Në tabelën 1 tregohen llojet kryesore të kultivarëve, me përjashtim të kultivarit “Frantoio” i ardhur nga Italia, ndërsa në figurën 3 tregohet struktura ekzistuese e këtyre kultivarëve. Ndërveprimi i varieteteve shqiptare me mjedisin lokal (toka, klima, lartësia) dhe praktikat kulturore rezultojnë në karakteristikat e veçanta dhe shije të dallueshme të vajrave të prodhuar në rajone të ndryshme në gjithë Shqipërinë.

Tabela 1. Varietetet kryesore në Shqipëri (Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Mbrojtje e Konsumatorit, 2009)

Varietete	Numri i pemëve	Sipërfaqja(Ha)	Prodhimi maksimal i vajit (% e peshës)	Përdorimet kryesore
Kalinjot	2,335,000	17,700	27	Tavoline & Vaj
Kokërrmadh i Beratit	1,000,000	7,700	18	Tavoline
Frantoio	470,000	2,600	19	Vaj
Kokërrmadh Elbasani	450,000	4,000	20	Tavoline & Vaj
Mixan	430,000	3,770	25	Vaj
Ulli i Bardhë Tiranës	200,000	1,500	28	Vaj
Nisiot	120,000	900	12	Vaj
Ulli i Hollë I Himarës	70,000	800	15	Vaj



Figura 3: Struktura e kultivarëve në ullishtet ekzistuese.

TEKNOLOGJIA E PËRPUNIMIT TË ULLIRIT DERI NË PRODHIMIN E VAJIT TË ULLIRIT

Për të prodhuar vaj me cilësi të lartë, ullinjtë duhet të vilen pa demtuar lëkurën e tyre, dhe duhet të përpunohen brenda 12 deri në 24 orë nga koha e vjeljes. Frutat duhet të ndahen sipas cilësisë, me çdo cilësi të përpunuar veçmas (Hermoso Ferna'ndez et al, 1998).

Larja dhe largimi i gjetheve

Ullinjtë fillimisht kalojnë mbi një sitë vibruese dhe një ventilator i cili ndihmon të largojë gjethet dhe mbeturinat e tjera. Ullinjtë lahen vetëm nëse ata pas vjeles kanë rënë në tokë apo kur ata kanë mbetje të solucioneve të përdorura për mbrojtje. Larja shtesë mund të zvogëlojë efikasitetin e ekstraktimit, për shkak të emulsionit ujë /vaj të formuar. Vajrat e bëra nga ullinjtë e larë janë zakonisht më pak të dëshirueshme, me një hidhërim dhe djegësirë, por gjithashtu kanë më pak aromë fruti (Civantos, 1999 ; Hermoso Fernandez et al, 1998) .

Bluarja ose shtypja

Ullinjtë e larë bluhën në mullinj. Gjatë bluarjes qelizat e tulit çahën në mënyrë që të ekstraktohet vaji dhe më tej të formohen pika më të mëdha të cilat ndahen nga fazat e tjera. Në përgjithësi, ullinjtë bluhën me mullinj me gur graniti. Në mullinjtë me gurë, ullinjtë copëtohen pa forcë të madhe mekanike, pa shkaktuar emulsione dhe kontaminim nga metali. Në përgjithësi mullinjtë përbëhen nga një bazë cilindrike graniti e lejuar për 2 ose 3 gurë cilindrikë ose të prerë në formë konike që rrotullohen rreth një boshti.

Homogjenizimi

Pas bluarjes së ullinjeve, pasta e përfutur duhet të përzihet në mënyrë të vazhdueshme në përzierës gjysëm sferikë ose gjysëm cilindrikë. Ata janë të pajisur dhe me një sistem ngrohje me qarkullim uji të nxehtë,

muret e tyre të brendshme përbëhen prej çeliku inox për të shmangur kontaminimin e mundshëm nga metali. Temperaturat e përdorura në këtë proces janë rreth 30-35° C. Qëllimi i këtij stadi është rritja e madhësisë së pikave të vajit, për të lehtësuar ndarjen dhe për të ndaluar emulsionin vaj / ujë. Në rastin e sistemeve të presimit, homogjenizimi zgjat 10 – 12 min.

Presimi

Presimi është metoda më e vjetër për ekstraktimin e vajit të ullirit. Ai bazohet në parimin që, kur pasta e ullinjve presohet çlirohet faza e lëngët (vaj + uji i vegjetacionit) e cila ndahet nga faza e ngurtë. Presimi aplikon një presion specifik 120-200 kg/cm² dhe procesi i ekstraktimit zgjat 1-1.5 orë.

Dekantimi

Pas presimit të pastës së ullinjve, fitohet një fazë e lëngët që përmban, vaj ulliri, ujë vegjetacioni dhe një sasi të vogël lëndë e ngurtë që shpëtojnë nga presimi. Veprimi i pare që duhet të kryhet është largimi i lëndës së ngurtë, nëpërmjet një site vibruese që mban materialin e ngurtë që përmban faza e lëngët. Ndarja e dy fazave në përzierjen e lëngët kryhet nëpërmjet dekantimit. Vaji është më i lehtë ($d \sim 0.91$) se sa uji i vegjetacionit ($d \sim 1.01$). Kur faza e lëngët lihet të qëndrojë për një kohë të caktuar, vaji ngrihet në sipërfaqe. Ky proces ndan vajin nga uji. Vaji rrjedh nga një depozitë në tjetrën përmes sifonëve të vendosur në pjesën e sipërme të depozitës duke sjellë sedimentimin e ujit. Uji i vegjetacionit qarkullon në drejtim të kundërt me anë të sifoneve në pjesën e poshtme të depozitës me qëllim mbajtjen e një sasia sa më të madhe të vajit në sipërfaqe.

Sistemi i centrifugimit tre - fazor

Ky proces konsiston në ekstraktimin e vajit të ullirit me anë të sistemit të centrifugimit. Vaji ndahet veç nga uji i vegjetacionit dhe mbetjet e ngurta. Ky proces kryhet në një fabrikë me centrifugim të vazhduar. Përpunuesit e sistemit trefazor përdorin dy centrifuga : një për vajin “ e lagësht” nga dekantuesi dhe një të dytë për të ndarë vajin e frutit nga uji i dekantuesit (Alba Mendoza, 2001). Cilësia e ullirit dikton sistemin e përdorur për përpunimin e tij. Procesit tre-fazor redukton sasinë e antioksidantëve natyralë në vaj nga uji i shtuar për hollimin e pastës së ullinjve. Problemi më i madh i procesit tre-fazor është sasia e madhe e mbetjeve të ujit të procesit. Këto mbetje të ujit shkaktojnë një ndotje të lartë të mjedisit.

Procesi i centrifugimit dy- fazor

Sasia e madhe e mbetjeve të ujit nga procesi tre- fazor i përpunimit të vajit të ullirit ishte një problem serioz për industrinë e ekstraktimit të vajit, prandaj disa prodhues të pajisjeve të linjave të vajit të ullirit prodhuan një model të ri të dekantoreve. Këto pajisje ndajnë vajin nga pasta e ullinjve pa shtuar ujë të ngrohë. Kjo do të thotë që nuk

prodhojnë mbetje të mëdha ujore nga procesi me përjashtim të ujit vegjetal nga ullinjë.

Dy proceset e para (bluarja dhe homogjenizimi) janë të njëjta me ato të sistemit tre-fazor, ndryshimi i vetëm është në centrifugimin e pastës dhe fazës së lëngët.

Sistemi dy-fazor është sistemi më i përdorur në vendin tonë për faktin se rendimenti i prodhimit të vajit nga ullinjë është më i lartë në procesin e centrifugimit dy-fazor se në atë tre-fazor. Kjo i atribuohet faktit që nuk shtohet ujë për të holluar pastën dhe shmanget formimi i emulsionit vaj/ujë. Prosesi i ekstraktimit dy-fazor nuk prodhon mbetje të mëdha uji, vetëm një sasi të vogël të ujit larës të vajit në centrifugë. Ky proces mënjanon problemet e largimit të ujit të vegjetacionit me avullim dhe kostot e larta. Cilësia e vajit të prodhuar në këtë proces është më e mirë se ajo e vajit të ekstraktuar nëpërmjet procesit tre-fazor, sepse përmban një koncentrim më të madh të polifenoleve dhe o-difenoleve. Kjo do të thotë se ky vaj është më i qëndrueshëm gjatë ruajtjes, për më tepër kufizimi i ekspozimit ndaj oksigjenit zvogëlon aktivitetin enzimatik që mund të prishë polifenolet, të cilat janë komponimet kryesore për aromën e vajit të ullirit (Alba Mendoza, 2001 ; Di Giovacchino et al, 2002a ; Hermoso Fernandez et al, 1998) .

Ruajtja e vajit të ullirit

Tanket e ruajtjes së vajit duhet të jenë prej materiali të papërshkrueshëm nga uji, inert ndaj vajit dhe të mos kontaminonjë ose oksidojnë vajin (metal). Tanket duhet të ruajnë vajin nga drita dhe ajri prania e të cilëve mund të sjellë ndryshime në cilësinë e tij dhe në temperature konstante (15-18°C), për të shmangur ndryshimet në vaj. Temperaturat e ulëta provokojnë ngrirjen e vajit, ndërsa temperaturat e larta sjellin oksidimin e tij. Sot përdoren depozita prej celiku të pandryshkur të kapaciteteve të ndryshme (50 ton). Ato vendosen në magazina të mbuluara, të ngjashme me ato të verës. Materialet dhe produktet që mund të dëmtojnë aromën e vajit nuk duhet të ruhen në të njëjtën magazinë. Vaj 'I ri', i cili është i ambalazhuar dhe është shitur menjëherë pas përpunimit, duhet të konsumohet shpejt (brenda rreth 6 javë) për të shmangur ndryshimet në shije brenda shishes. Vajrat të cilësisë "Premium" duhet të ruhen në çelik inox dhe të mbahen në një temperaturë konstante prej në mes 45-65° F (7,2-18,3°C) (Alba Mendoza, 2001; Hermoso Fernandez et al, 1998.)

Përpunimi i mbetjeve

Në vendet me të rëndësishme të prodhimit të vajit të ullirit, mbetjet nga ekstraktimi i vajit përdoren për ekstraktimin e mëtejshme të vajit me solventë. Sot në Shqipëri vazhdon të jetë problematike përpunimi i këtyre mbetjeve.

VLERËSIMI SENSORIAL I VAJRAVE

Një nga aspektet më të rëndësishme të klasifikimit dhe vlerësimit të cilësisë së vajit të ullirit, është analiza shqisore/organoleptike. Ngjyra, era dhe shija, përbëjnë tre parametrat cilësorë organoleptike që luajnë një rol të rëndësishëm psikofiziologjik tek konsumatori që e bëjnë produktin të pranueshëm ose jo prej tij (Donika Prifti, 2009; Innocenzo Muzzalupo et. al, 2012) Objektivi kryesor në vlerësimin organoleptik të vajit të ullirit është përcaktimi nëse vajrat përmbajnë një ose më shumë nga defektet që zakonisht ndodhin në vajra nga magazinimi i papërshtatshëm i lëndës së parë, problemet nga trajtimi, infeksionet nga insektet, ruajtja ose përpunimi i vajit. Vaji i ullirit duhet të ketë aromën e frutit të ullirit që është karakteristikë e varietetit ose përzierjeve të varieteteve të ndryshme nga prodhohet vaji. Objektivi i dytë i vlerësimit organoleptik të vajit të ullirit është përshkrimi i karakteristikave pozitive të vajit, sipas intensitetit të tyre. Hidhësia dhe djegësia janë shpesh të pranishme në vajrat e ullirit, sidomos kur vaji është i sapo prodhuar. Këto nuk janë defekte dhe zbuten me vjetërimin e vajit. (Alba Mendoza et al, 1997; Harwood and Aparicio, 2000; International Olive Oil Council, 1996; Kiritsakis et al, 1998; Uceda Ojeda, 2001). Karakteristikat organoleptike janë të lidhura pozitivisht me komponimet natyrale të pranishme në frut dhe në vaj dhe të ndikuara negativisht nga komponimet e pranishme në vaj si rezultat i proceseve që kanë pësuar vajrat (rancidimi, oksidimi etj). Përbërësit origjinalë përgjegjës për karakteristikat organoleptike janë acidet yndyrore, polifenolet dhe disa komponime volatile, aldehide, alkoole alifatike dhe terpenike dhe me C6 të ngopur ose të pangopur, esteret, hidrokarburet, të cilët përcaktojnë aromën e njohura “të frutit”, shijen “e hidhur” ose “të ëmbël” “djegës” apo “therëse shpuese” (Donika Prifti, 2009) Shija karakteristike e vajit merret nga ullinjat e ruajtura në grumbuj, të cilat i janë nënshtruar një stadi të avancuar të fermentimit anaerobik. Shoqërohen me n- oktanin, të prodhuar nga shpërbërja e hidroperoxidit-10 të acidit oleik dhe alkoolit izoamilik të formuar nga fermentimi.

VARIETETE DHE VAJRA TË ULLIRIT NË DISA VENDE TË MESDHEUT

Më poshtë përshkruhen disa nga kutivarët kryesorë dhe vajrat e tyre në Spanjë Itali dhe Greqi.

Spanjë. Varieteti kryesor është “*Arbequina*”, i cili prodhon një vaj shumë aromatik me një shije të freskët ulliri, dhe me një djegësirë dhe hidhërim shumë të lehtë. Për fat të keq, më vonë këto vajra kanë tendencën për të humbur shumë prej karakterit të tyre aromatik brenda disa muajve. Varieteti tjetër është “*Empeltre*” i cili prodhon vaj shumë aromatik me pak hidhësi. Këto vajëra janë të cilësisë së mirë vecanërisht kur konsumohen brenda muajve të parë të prodhimit. Varietete të tjera janë “*Farga*”, “*Sevillena*”, “*Morrut*”, dhe “*Verdena*”. Vajra të cilësisë ekselente janë të prodhuar fillimisht nga varietetet “*Cornicabra*”, “*Carrasquena*”, “*Morisca*”, “*Verdial Badajoz*”, “*Manzanilla*”

Cacerena, *Castellana*, dhe *Alfafara*. *Blanqueta* është një tjetër varietet që rritet në zonat 'Villalonga', 'Lechin', 'Changlot', dhe 'Cornicabra. Një tjetër varietet jo pak i rëndësishëm është *Picual* i cili prodhon vajra me përbërje të lartë polifenolesh, të hidhura dhe shumë të athëta. Më shumë se gjysma e sasisë së ullinjve vilet në fund të sezonit, disa të marra nga toka të cilat me anë të disa operacioneve trajtohen për të prodhuar një vëllim të madh vaji por me një cilësi shumë të ulët, i cili më pas i nënshtrohet procesit të rafinimit (Romero et al, 2005; Vossen, 1997).

Itali. Varieteti kryesor në një prej rajoneve të saj, Ligurias është *Taggiasca*, dhe ky varietet vilet zakonisht në fund të sezonit për të prodhuar vaj me shumë shije i cili shkon shumë me dietën e prodhimeve të detit në këtë rajon. Në rajonin e Toskanës *Frantoio* dhe *Leccino* janë dy varietetet kryesore prej të cilëve më dominant është *Frantoio* i cili vilet më herët për të shmangur humbjet që rezultojnë nga ngricat që zakonisht ndodhin pas muajit dhjetor. *Frantoio* i vjelë herët ka ngjyrë karakteristike të gjelbër të fortë, aromatik dhe me një djegësirë të fortë. *Leccino* është një pjesë e rëndësishme e përzierjes sepse maturohet më herët dhe është më e lehtë në shije me karakterin e vet pikant. Përgjatë bregdetit rreth Lucca kultivuesit kanë tendencë të rrisin varietetin *Leccino* dhe vajrat e tyre janë më pak intensivë në shije dhe ngjyrë. Toskana jugore ka ullishte më të mëdha të cilat përfshijnë varietetin *Coratina*. Vajrat toskanë kanë njohje të konsiderueshme në gjithë tregun botëror. Varieteti *Coratina* piqet shumë vonë dhe në disa raste asnjëherë nuk arrin ngjyrën e tij. Vajrat kanë përbërje shumë të lartë polifenolesh, shumë të qëndrueshëm, me ngjyrë jeshile të fortë dhe shpesh përdoren për tu përzierë me vajra të rafinuar. Një varietet tjetër i pemëve të ullirit është *Bosana* i cili mbulon ishullin e Sardenjës. Varieteti *Canino* përfshin rajonin perëndimor dhe qendror të Italisë që prodhon vaj nga disa ullishte të kësaj zone. Vajrat klasikë të rajonit jugor të Italisë janë zakonisht të gjelbra me shkëlqim të artë. Shumë prodhues të vajt në këtë rajon kanë prezantuar prodhimet e tyre me varietete të ndryshme dhe vajrat ekselentë të tyre. (Cimato et al., 1996; Vossen, 2000).

Greqi. Varieteti *Koroneiki* është dominant në gjithë Peloponezin, Zakinthos, dhe Kretë. Këto vajra janë me përbërje të lartë polifenolesh, shumë të qëndrueshme dhe shumë aromatike me shijen e frutit të ullirit dhe ngjyrë karakteristike jeshile. Fruti është shumë i vogël në madhësi dhe është e vështirë vjelja e tij. Shumica e vajrave grekë prodhohen nga frutat e dëmtuara dhe ruhen për disa kohë përpara se të përpunohen. Kur fruti është i pa dëmtuar dhe i përpunuar me kujdes prodhohen disa vajra ekselentë. (Vossen, 1999).

PËRFUNDIME

Prodhimi vajt të ullirit mund të bëhet një aspekt shumë i rëndësishëm në bujqësinë shqiptare. Kjo për faktin që ullishtet tona shekullore janë një pasuri e madhe gjenetike, me varietete me përshtatshmëri të lartë

pedoklimatike. Edhe varietete të ashtuquajtura “dytësorë” paraqesin vlera të larta produktive dhe ekonomike, duke vënë në funksion aftësitë e tolerancës ose rezistencës ndaj kushteve të papërshtatshme biotike dhe abiotike. Për shkak të kushteve të favorshme klimatike ullinjtë, mund të kultivohen në një formë më intensive, pavarësisht nga fakti, se zonat nën kultivimin e ullirit në Shqipëri në krahasim me zonat në Greqi apo Itali janë shumë të parëndësishme. Pas një pauze relativisht të gjatë që lidhet me ndryshimet politike demokratike në vend pas viteve '90, industria e ullirit dhe vaji shqiptar i ullirit ka pasur një rritje që vlen për tu theksuar. Gjendja aktuale e ullishtarisë, përveç investimeve relativisht të konsiderueshme për mbjelljet e ullishteve të reja (vetëm në fillim të vitit 2007 janë mbjellë me financim nga shteti 350 ha ullishte të reja) është rritur jashtëzakonisht. Këto mbjellje janë bërë mbi bazën e praktikave moderne dhe mirëmenaxhimit. Ullishtet e reja janë bërë më efikase në prodhimin e vajit me cilësi të lartë për tregjet e brendshme dhe të huaja. Gjithashtu industria e përpunimit të vajit ka pësuar rritje të ndjeshme. Gjatë dekadës së fundit në këtë sektor janë investuar mbi 11 milion dollarë kryesisht në ngritjen e linjave të reja me teknologji të përparuar. Vajrat e prodhuara në Shqipëri kanë gjetur dhe do të gjejnë një treg botëror për vetë faktin se cilësia e tyre krahasohet me shumë vajra të ullirit në zonën medhetare.

Megjithatë, sektori i vajit të ullirit përballet me disa problematika që kanë të bëjnë me:

- Interesimin ndaj cilësisë dhe mungesës së pajisjeve laboratorike
- Problemet e prodhuesve të ullirit në lidhje me copëtimin e fermerëve të ullirit me prona tepër të vogla; Pothuajse 100% të operacioneve bëhen me punë krahu dhe duke shtuar dhe vështirësitë në zonat rurale bëhet e qartë se kjo është arsye për të rritur koston e prodhimit.
- Niveli i mirëmbajtjes në ullishte është i vogël
- Periodiciteti ka qënë dhe mbetet një fenomen karakteristik në vendin tonë
- Përpunimi i mbetjeve

Nisur nga kjo gjëndje janë duke u aplikuar skema mbështetëse për shtimin e ullishteve, për prodhimin e vajit cilësor, për certifikimin dhe stimulimin e vajit cilësor, për prodhimin e vajit organik të ullirit si dhe për shtimin e varieteteve autoktonë në fidanishtet e ullirit.

Referenca

Alba Mendoza J. (2001): Elaboración de aceite de oliva virgen. In: D. Barranco, R. Fernández-Escobar, and L. Rallo (eds.). El cultivo del olivo. 4th ed. Ediciones MundiPrensa, Madrid, Spain. 551–587

Alba Mendoza J., Izquierdo J. R. and Gutiérrez Rosales F. (1997): Aceite de olive virgen: Análisis sensorial. Editorial Agrícola Española, S. A. Artes Gráficas COIMOFF, S. A. Madrid.

Aparicio R., Morales M. T., and Alonso V. (1997): Authentication of European extra-virgin olive oils by their chemical compounds, sensory descriptors, and consumer attitudes. *J. Agr. Food Chem.* 45:1046–1083.

Baeten V., Aparicio R (2000): Edible oils and fats authentication by Fourier transform Raman spectroscopy. *Bitechnol. Agron. Soc. Environ.* 4, 196–203.

Bartolini G., Messeri C., Prevost G. (1994): Olive tree germplasm: Descriptor list of cultivated varieties in the world. *Acta Hort.* 356:116–118.

Blazquez Martínez, J. M. (1996): Evolution and history In: International Olive Oil Council (IOOC) (eds.). *World Olive Encyclopedia*. IOOC, Madrid, Spain. 17–54.

Cimato A., Baldini A., Caselli S., Marronci M., Marzi L. (1996): Observations on Tuscan olive germplasm. 3: Analytical and sensory characteristics of single variety olive oils. *International Olive Oil Council. Olivae* 62: 46–51.

Civantos L. (1999). Obtención del aceite de oliva virgen. 2nd edición. Editorial Agrícola Española, S.A.—Artes Gráficas COIMOFF, S.A., Madrid, Spain.

Civantos L. (2001). La olivicultura en el mundo y en España. In: D. Barranco, R. Fernández-Escobar, and L. Rallo (eds.). *El Cultivo del Olivo*. 4th ed. Ediciones MundiPrensa, Madrid, Spain. 17–34

Civantos López-Villalta L. (1998): The olive tree, the oil, the olive. *International Olive Oil Council. ADICOM*, Madrid.

Di Giovacchino L., Costantini N., Ferrante M. L. and Serraiocco A. (2002): Influence of malaxation time of olive paste on oil extraction yields, chemical, and organoleptic characteristics of virgin olive oil obtained by a centrifugal decanter. *Grasas Aceites*. 53:179–186.

Donika Prifti: Analizat shqisore të produkteve ushqimore (2009) 43: 131-141..

European Commission. (2001): Olive oil and table olive sector. Council regulation no. 1513/2001. 29 May 2007. <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:32001R1513:EN:HTML> .

European Commission. (2003). Communication from the commission to the council and the Europeanparliament. Sections (2003) 1022 and 1023 Olive Oil. 29 May 2007.

http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/site/en/com/2003/com2003_0554en01.pdf.

Filo della Torre R. (2002): Olive growing in Italy: Facts and figures. International Olive Oil Council Publication – Olivae No. 93:12–15.

Fiorino P. and Alessandro S. (1996): Agronomic techniques and characteristics of olive oil. In: International Olive Oil Council (IOOC)(eds.). World Olive Encyclopedia, IOOC, Madrid, Spain. p. 195–217

Harwood J. L., Aparicio R.. (2000): Handbook of olive oil: Analysis and properties. Aspen Publishers, Gaitherburg, MD.

Hermoso Fernánde z M., Gonzá les J., Uceda M., Garcí a-Ortiz A., Morales J., Fri'as L., Fernánde z A.(1998): Elaboracio' n de aceite de oliva de calidad II. Obtencio' n por el sistema de dos fases. Estacio' n de Olivicultura y Elaiotecnia. "Venta del Llano" Mengi'bar (Jae' n) Spain. Vol. 61/98.

Instituti i Statistikave, 2008

Muzzalupo I., Pellegrino M., Perri E. (2012): Sensory Analysis of Virgin Olive Oil. InTech. <http://dx.doi.org/10.5772/51721> .

International Olive Oil Council. (1996): General methodology for the organoleptic assessment of virgin olive oil. IOOC standard procedure COI/T.20/Doc. no. 13. November.

International Olive Oil Council (IOOC). (2003a). The world olive oil market. Olivae No. 97:19–25.

International Olive Oil Council (IOOC). (2003b): Trade standard applying to olive oil and olive pomace oil . RES. COI/T.15/NC no. 3/Revision 1 (Dec. 5).

International Olive Oil Council (IOOC). (2004): The world olive oil market and the world table olive market. Olivae June, No. 102:14–20.

Kiritsakis A. K., Lenert E. B., Willet W. C., Hernandez R. J. (1998) Olive oil: From tree to table. 2nd ed. Trumbull, CT, Food and Nutrition Press, Inc.

Lavee S. (1996) Biology and physiology of the olive.In: International Olive Oil Council (IOOC)(eds.). World Olive Encyclopedia, IOOC, Madrid, Spain 59–104.

Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Mbrojtje e Konsumatorit, (2009)

Rallo L. (2005). Antecedentes y presentacio' n. In: L. Rallo, D. Barranco, J.M. Caballero, C. Del Rí o, A. Martí n, J. Tous, and I. Trujillo (eds.).

Variedades de olivo en España, Junta de Andalucía, M.A.P.A. y Ediciones Mundi-Prensa, Madrid, Spain. 17-44.

Romero A., Tous J. and Guerrero L. (2005). Caracterización sensorial del aceite. In: L. Rallo, D. Barranco, J.M. Caballero, C. Del Río, A. Martín, J. Tous, and I. Trujillo (eds.). Variedades de olivo en España, Junta de Andalucía, M.A.P.A. y Ediciones MundiPrensa, Madrid, Spain. p. 373-382

Schafer-Schuchardt H. and Wetenkamp K. (2005). Olive oil label fraud in discount supermarkets. May. Der Feinschmecker Magazine, Hamburg, Germany. May. 87-89

Uceda Ojeda, M. (2001). La calidad del aceite de oliva. In: El cultivo del olivo. 4th ed. Ediciones Mundi-Prensa, Madrid.

Vossen, P. M. (1997) Spanish olive oil production. Technical report on the olive oil production tour (11-28 to 12-8). University of California Cooperative Extension, Sonoma County, Santa Rosa, CA.

Vossen, P. M. (1999). Olive oil production in Greece. Technical report on the olive oil production tour (11-28 to 12-8). University of California Cooperative Extension, Sonoma County, Santa Rosa, CA.

Vossen, P. M. (2000). Italian olive oil production. Technical report on the olive oil production tour (11-25 to 12-9). University of California Cooperative Extension, Sonoma County, Santa Rosa, CA.

Vossen, P.M. (2005). In: Producing olive oil. In: Olive production manual. 2nd ed. University of California Ag and Natural Resources publication no. 3353, 157- 173

KULTI I DETIT, ULLIRIT DHE I DIELLIT, SI KANË MBIJETUAR NË SHEKUJ NË BRIGJET E JONIT PALASIKOT

Odise Çaçi

Abstrakti

Trajton në këndvështrimin historik këto tre kulte. Nuk është rastësi që Palasa ka mjaft vende pelegrinazhi që mendohet me një histori mbi 2600 vjeçare. Nëpërmjet këtij studimi sjell në kujtesë, një realitet të jetuar nga paraardhësit tanë, pellazgë. Legjendat, mitet, përrallat, na ngacmojnë kujtesën për tua kaluar atë brezave siç na e lanë të parët tanë. Këto kulte kanë jetëgjatësi mbijetese si dielli, ulliri dhe deti.

Kulti i detit. Palasa nëpërmjet *detit* lidhej me Adriatikun dhe Jonin, dy dete që të nxirrnin në Mesdhe dhe prej këtej kalohej në Lindje e Perëndim. Anijet palasikote kontrollonin rrugët detare, bënë tregti me vendet përreth rajonit. Por deti kishte dhe mitologjinë e vet: Pra zanafilla e këtyre kulteve është rrjedhojë e rëndësisë, që kanë këto kulte, si burim ekonomik, në jetën e banorëve të bregdetit jonian. Në det jetonin qeniet mitologjike që sipas banorëve zbrisnin nga Malet e Akrokeraumit, në det jetonin nimfat e mitologjisë etj. Po deti ka qenë shpesh shkaktar i furtunave shkatërrimtare, i largimit të bregasve drejt perëndimit, një breg i "lotëve".

Ulliri ishte pemë e pjellorisë, paqes e fitores, konsiderohej i shenjtë, ku shpesh i lihej si amanet kishës, pas vdekjes.

Kulti i diellit lidhej me jetën, me bimësinë, me ardhjen e pranverës, ku njerëzit e adhuronin si gjë të shenjtë. Pa diell nuk ka jetë. Dielli ishte strumbullari kryesor i jetës mbi tokë, prandaj nuk kishte shtëpi, që nuk kishte të gdhendur në qoshet e murit një diell, që simbolizonte jetën.

Fjalët kyçe: Ulliri, dielli, deti, teta, zërat e detit, zanat, "nëna e detit" etj.

Abstract

Treat in historic point of view those three cults. It is not casual that Palasa has many places of pilgrimage which is believed to be with a history of over 2,600 years. Through this study brings into memory a living reality from our pre-comers, Pelasgians. Legends, myths, teasing our memory to past it to young generations, as our fathers left us. These cults have longevity survival as the sun, olive and sea.

Cult of sea: Palasa though the sea was connected with Adriatic and Ionian, two seas to disclose in the Mediterranean, and from there, passing into East and West. Palasians ships controls sea routes, do trade with countries around the region. But the sea had its own mythology and: So the origin of these cults is the result of importance that these cults have as a source of economic resource in the lives of the residents of the Ionian coast. Mythological beings living in the sea that according to residents comes down from the Akrokeraum Mountains, in

the sea lived nymphs of mythology. But the sea has often been the cause of devastating storms, the removal of coastal residents to westward, and a shore of "tears".

Olive was the tree of fertility, peace and victory, considered sacred that often was left to the church as a trust after death.

Cult of Sun was connected with life, with vegetation, spring coming, where peoples adore as something saint. Without sun has no life. The sun was the main yardstick of life on earth, so there wasn't any home that was not inscribed a sunny on wall corners, that symbolized life.

Key words : olive, sun, sea , Teta, sea voices, zanat, "mother of sea" etc.

"PALASA NGA PREHISTORIA DERI NË DITËT TONA"(SI PJESË E KAONISË)

Palasa është një fshat i vogël që shtrihet deri në 340 metra mbi nivelin e detit, në rrëzë të Akrokerauneve i quajtur dikur Palestae, më vonë Palesti e sot Palasë. (1-6)

Për nder të Perëndeshës Athina, që sipas Plinit, banorët besonin se kishte rënë nga qielli një shtatore me shëmbëlltoren e perëndeshës Athina, që ishte prej metali të rrallë e të shndritshëm si floriri quhej Palladium. Ndaj dhe e quanin Pallada Athina. Mendoj se ekzistenca e Paladiumit lidhet me krijimin dhe ekzistencën e një vendbanimi, që këtu e 2600 vjet para erës sonë. Por ky vendbanim mund të kërkohet edhe tek vendi që njihet me toponimin Ar-Ilë. Në Paleastre aplikohet kulti i Apollonit dhe e një truproje të mermertë të Palladhos-Athinasë (7).

Bregdeti palasikot i Jonit, e konsideronte vëndin e vet, si vendbanim të këtyre perëndive, një vend tepër konkret, siç ishte mali Vetëtimave (Akokerauneve).

Irena Gjoni "mendon se banorët e Palestit besonin se Zeusi në zemërim e sipër lëshonte vetëtimin dhe statujën e Paladiumit e kishte hedhur Zeusi". (8)

Pellazgët, kishin personifikuar si hyjni dukuritë e natyrës, "Hyjnitë e pellazgëve, sipas E. Jacques ishin: dielli, hëna, toka, lumenjtë, agimi, mëngjesi, erërat, orioni, etj" (9). Çdo i përndjekur gjente strehë në të dhe gëzonte mbrojtjen e saj. Hyrja në tempull e ndjekësve, quhej përdhunim i tempullit dhe ndëshkohej me vdekje. Ky tempull ka qënë deri në shek. IV pas Krishtit, kur u shkatërruan monumentet e kulturës pagane nga të krishterët e parë. (10). Mendoj se aty ku sot është Palasa si vendbanim, (në Fugni, në Shën Koll, Shën Jorgji, Sone ...) ka qënë faltorja pagane ku zhvilloheshin ritet. Kjo kërkon gërmime arkeologjike... Mendohet se miti i rrufesë dhe shkretimës nderohej tek banorët e palesties. Malet Akrokeraune (malet e vetëtimave) ato kishin vendbanimin e tyre, keraunos-perëndi e bubullimës dhe vetëtimës (11)

Në Palasë janë 16 kisha dhe dy manastire, të cilat sjellin zërin e Zanës hyjnore pellazgjike. (12)

A. SI MBIJETOI KULTI I DETIT NË PALASË DERI NË DITËT TONA.

Kulti i detit

Deti është një hapësirë e pakufishme për aventura dhe bashkë me to dhe bëma të pa imagjinueshme. Nëpërmjet detit Palasa e vjetër lidhet me Adriatikon dhe Jonin, dy dete komunikonin me detin Mesdhe ku kalohej drejt Lindjes e Perëndimit. Anijet palasikote çanin detrat duke bërë tregti, duke kontrolluar rrugët detare, shpesh duke plaçkitur dhe duke u bërë tmerri i anijeve që kalonin në këto anë. Nga portet e Palasës, si Gonia, Jaliskari, Gjipea, Grama etj niseshin mallrat për në portet e Italisë, Francës, Gjenovës, Venetikut, Triestes, Greqisë, Egjiptit, etj. Nëpër këto porte zbarkonin shpesh piratët dhe grabisnin qytetarët e bregut.

Por deti kishte dhe mitologjinë e vet: Pra, zanafilla e këtyre kulteve është rrjedhojë e rëndësisë që kanë këto dy burime ekonomike (ulliri dhe deti) në jetën e banorëve të bregdetit. Bregdeti është një nga trevat më të bukura e më të rëndësishme në Shqipëri dhe është krahina që shtrihet përgjatë detit Jon. Përbëhet nga Bregdeti i Poshtëm dhe Bregdeti i Sipërm, ku përfshihen 14 vendbanimet: Nivicë – Bubari deri në Palasë. Por historikisht kjo krahinë ka qenë zemra e një treve shumë më të gjerë në jugperëndim të vendit, ka qenë e banuar historikisht nga kaonët. "Krahina e Himarës nuk ngeli gjithmonë e madhe dhe e fuqishme. Duke u islamizuar ajo filloi të zvogëlohej edhe si juridiksion episkopati. Nga 47 fshatra që u privilegjuan me fermanin e sulltanit në vitin 1518 me 1577 ishin 37 fshatra, me 1634 ishin 35 fshatra, me 1732 mbetën 19 fshatra, më pas u islamizua gjithë Kurveleshi, Himara mbeti me 14 fshatra. Pas Tanzimatit (pas 1842) u privilegjuan vetëm për mospagim taksash. E mos detyrim ushtarak. Ajo mbeti me 7 fshatra (pa episkopatë fetare)." Aristotel Spiro Mëhilli, Piqerasi, f.52

Në popullsinë e Bregdetit është shumë i përmendur fisi i Keraunëve. Kaonët kanë qenë një nga fiset e Ilirisë Jugore që përmenden për herë të parë prej Hekateut, dijetar grek i fundit të shek. VI dhe fillimit të shek. V p.e.s.(13) I përmend edhe Pseudo - Skylaksi, bashkëkohës i Hekateut, i cili shprehej: "Pas ilirëve vijnë kaonët,..."

Palasa e vjetër ishte anës detit. Popullsia e saj ishte lidhur pazgjidhmerisht me të. Në det ata gjenin ushqimin e përditshëm, komunikonin me botën, me detin ata bënin tregti, prisnin e përcillnin miqtë, por përplaseshin dhe me armiqtë. Mbijetesa i kishte mësuar të ishin të ashpër siç ishin brigjet e tyre. Ata mendonin se nga Malet e Akrokeraunëve vinin qeniet mitologjike që zbrisnin nga këto male dhe largoheshin në detin e pamasë. Sipas tyre në det jetonin nimfat e mitologjisë gjysmënjëri e gjysmëpeshk, grabitqarë të ujit, peshkaqenë etj. Po deti ka qenë shpesh shkaktar i furtunave shkatërrimtare, në Palasë edhe sot thuhet se "doli Sillua", (Tornado) nga deti kanë ardhur ushtritë pushtuese romake Pal Emili, Jul Qezari e deri në pushtimet e Luftës së Parë e të Dytë Botërore. Për detin kanë ngelur deri sot disa rite që praktikohen ende. P.sh.

Të sapo martuarit në çdo 15 gusht shkojnë e lahen në det dhe i luten detit t'u falë një fëmijë. Palasikotët shkonin në Gonia e Jaliskar.(14)Kjo lidhje gjenetike dhe simbolike ujë-pjellori-amësi. Të moshuarit Palasikotë thoshin se kur fëmijët nuk jetonin duhet ti nxirrje në mëngjes herët në një kryqëzim rruge dhe ai që e gjente bëhej kumbar(pagëzuesi, i vinte emrin); ndërsa të tjerë kujtojnë se një fëmijë duhej hedhur në det duke e flijuar, por tregojnë se shën Spiridhoni e ndihmoi dhe e nxori në anë duke e mbajtur mbi një ashkël etj. Ndërsa të afërmit e tyre luteshin: "O Shën Spiridhon, na i shpëto! Të venë shëndoshë e të kthehen shëndoshë!". Kur ishin në det në rrezik, detarët bregdetarë i drejtoheshin njëri – tjetrit: "Bëni kriq, kriqi ju ndihetë". Shpesh këtë ritual e shoqëronin me hedhjen e kryqit në det.

Kur u vonoheshin njerëzit në detin me tallaz, gratë dilnin karshi Korfuzit, bënin kryq dhe luteshin: "Shpëtoma burrën e djalën, o Shën Spiridhon i kasës!" Dhe si shpërblim për shenjtërinë e tyre, Shën Spiridhoni, që i ndihmonte dhe s'i braktiste kurrë, bregdetasit tradicionalisht më 12 dhjetor të çdo viti, ua hipnin karaveve (anijeve) e shkonin në Manastirin e Shën Spiridhonit në Korfuz. E çanin detin më 12 dhjetor edhe në furtunë, vetëm e vetëm për të arritur tek fryma e shenjtë e Shën Spiridhonit.

Shumë detarë Palasikotë i luteshin detit t'i shpëtonte nga furtuna dhe kur të ktheheshin në stere(breg) do ti çonin peshqeshin më të mirë , një varkë të artë, ose njerëzit vendosnin një qiri mbi një dërrasë dhe e lëshonin në det duke rrëshqitur. Faleshin e luteshin në kishën e Korfuzit duke qëndruar tërë natën jashtë, ndonëse në kohë shumë të ftohtë, në dhjetor. Besohej se Shën Spiridhoni natën ngjallej e ditën futej në arkivol, duke lënë këpucët jashtë (këtë unë e kam

parë nga afër në korrik 1992 kur emigrova për herë të parë në Korfuz dhe vizitova kishën e Shën Spiridhonit, një relikte e gjallë.. (O. Çaçi, korrik 1992), ndërsa sipas mitologjisë netët e tjera qëndronte buzë detit. Ndër dhuratat më të preferuara që njerëzit çonin te Shën Spiridhoni ishin këpucët. Natën e Shën Spiridhonit burra, gra e fëmijë që nuk shkonin dot në Korfuz, mblidheshin në sheshet e kishave e bënë një zjarr të madh. Djemtë i kapërcenin zjarret e shenjtë për të komunikuar me forcat e mbinatyrshme. Në këto zjarre piqnin kurbanët që kishin ther për Shën Spiridhonin.

Mendohet se këtë kult e kanë marrë me vete Palasikotët në Hidra dhe Spece në Greqi, ku në muajin Shtator hedhin në det anije prej letre për të përkujtuar Bubulinen arvanitase nga Palasa(15). Çfarë koicidence, apo një vazhdimësi tradite nga brezi në brez?.. Ka përjasje e shkëmbime kultesh, rritesh e zakonesh me popujt fqinjë, me Greqinë Veriore, me shtatë ishujt Jonianë dhe me pjesën jugore të Italisë, me të cilët banorët e Bregut kanë pasur shumë marrëdhënie historike, kulturore e tregtare.

Palasikotët kanë besuar në Perëndinë e Detit (si kultet e Rodonit Ilir), i cili mendohet që gjatë krishtëritimit u kthye në Shën Spiridhon. Detarët para se të shkonin në udhëtim shkonin në kishë, bënë meshë dhe i thoshin njëri tjetrit: Bëni kriq, kriqi ju ndiftë! Në kohë furtune ata hidhnin kryqin në det etj, pra kemi nënshtrimin e perëndisë pagane ndaj atyre të Krishtëritimit... Egzistencën e hyjnisë së detit në Kaoni, e vërteton tërthorazi edhe një figurë mitologjike që quhet "Nëna e detit", konceptimi popullor i së cilës paraqet ngjashmëri me perëndeshën e deteve oqeanëve, Tetis.

Dukuria kuptimore e sinonimisë karakteristike për gjuhën e përgjithshme është e pranishme edhe në terminologji. Në këtë drejtim nuk bën përjashtim as terminologjia e së drejtës gjatë viteve të Luftës së Dytë Botërore. Fillimisht punimi paraqet një panoramë të shtresimit të kësaj terminologjie sipas grupeve tematike e leksiko - semantike. Materiali i vjelë nga letërsia juridike e veprat kodifikuese të kësaj periudhe është vetëm një pjesë e gjithë pasurisë leksikore që përdorej për të emërtuar nocionet e së drejtës në gjuhën shqipe. Termat bazë dhe larmia e grupeve të identifikuar, megjithatë, japin mundësinë për të ndjekur zhvillimin e dukurisë së sinonimisë duke vënë në dukje shfaqjet e shfaqjes së kësaj dukurie dhe analizën e termave sinonimë nga pikëpamja leksiko- gramatikore, semantike e strukturore.

Fjalë kyçe: sinonimi, terminologji e së drejtës, term, dukuri kuptimore

Abstract

The phenomenon of the characteristic synonymous for the general language is present even in the terminology. There is no exception even in the terminology of law during the Second War. Initially in this work is submitted the stratification overview of this terminology according to the thematic groups and the semantic lexicon. The material obtained from the juridical literature and from the codification writings of this period, is just a part of the lexical heritage that was used to appoint the notions of law in Albanian language. The basic terms and the variety of the identified groups however, gives the opportunity to pursue the development of the synonymous phenomenon in terms of grammar

lexicon, noting the causes of this phenomenon and the analysis of synonymous terms from the grammar lexicon semantic and structural point of view.

Fjalë kyçe: synonymous, terminology of law, terms, lexical phenomenon

1. Hyrje

Në vitet 1939–1944, kohë që përkon me zhvillimin e Luftës së Dytë Botërore, Shqipëria u kthye në një fushë beteje. Institucionet e shtetit shqiptar u zëvendësuan me struktura të organizuara nga pushtuesit për të kontrolluar dhe administruar territorin e vendit. Veprimtaria e strukturave të reja u shoqërua me hartimin e një shumësi dokumentesh që përmbajnë bazën normative mbi të cilën është mbështetur funksionimi i tyre. Në këto dokumente është fiksuar gjithashtu edhe një pjesë e madhe e pasurisë leksikore të së drejtës gjatë kësaj faze të historisë së vendit.

Në këtë punim materiali faktik i vjelë nga dokumente zyrtare e tekste kodifikuese do të analizohet në rrafshin sinkronik për të vënë në dukje arsyet e shfaqjes së sinonimisë, veçoritë e saj në aspektin leksikor, semantik e strukturor dhe vendin që zë kjo dukuri në terminologjinë e së drejtës gjatë viteve 1939–1944.

2. Shtresimi i terminologjisë së të drejtës në vitet 1939–1944

Terminologjia e së drejtës në periudhën e Luftës së Dytë Botërore (1939-1944) nga pikëpamja leksikore përbëhet nga: **1.** fondi i termave që emërtojnë nocione të ndryshme të fushës, të trashëguar nga legjislacioni i mëparshëm shqiptar i periudhës së monarkisë; **2.** fondi i termave të rinj që e pasuruan këtë fushë si rrjedhim i reformave institucionore të ndërmarra nga autoritetet italiane për riorganizimin e pushtetit legjislativ, ekzekutiv e gjyqësor pas pushtimit të vendit.

Në *fondin e trashëguar dallohen*: **a)** fondi i termave bazë që emërtojnë nocione themelore në fushën e së drejtës p.sh. *dekretligj, dispozitë ligjore, e drejtë, drejtësi, efekt ligjor, juridiksion, kod civil, kod penal, kod tregtar, konvencion, ligj, pushtet gjyqësor, pushtet ekzekutiv, pushtet legjislativ, traktat, urdhënesë* etj.; **b)** fondi i termave që emërtojnë nocione të veçanta sipas disiplinave juridike: në fushën e së drejtës kushtetuese: *abrogim, dekret mbretnor, dekret legjislativ mbretëror, dekret - ligjë mbretënore, deputet, imunitet parlamentar, iniciativë legjislative, ministër, parlament, qeveri, sistem i zgjedhjeve, vendim i këshillit ministrues* etj.; në fushën e së drejtës civile: *adoptim, çiflig i shtetit, drejtësi civile, hipotekë, konfiskim me të drejtë riblerjeje, kontratë, kontratë - qira e pasurisë së paluejtshme urbane, pasuni patrimoniale shtetnore, pasuni shtetnore, pasuni urbane, pasuni patrimoniale, pasuni të paluejtshme urbane, peng, pranim*

trashëgimi, pranim pasunie (lanë prej të ndjerit), pronë, rekuizim toke, servitud, trashëgimi, testament, zgjatje rekuizimi pasunie etj.; në fushën e së drejtës administrative: bashki, dekret lajmërim - pagimi, komunë, këshill i komunës, këshill bashkijak, kryeplak, kryetar bashkije, nënprefekt, nëpunës botor, nëpunës civil, nëpunës shtetnor, prefekt, prefekt i klasit të parë, prefekt i klasit të dytë, prefekturë, sekretar prefekturë, trup arbitruer për çpronësime etj.; në fushën e së drejtës tregtare: aval, çek, e drejtë e liçensës mbi importimet, ent tregtar, këshill administratuer i shoqnis, kambial, likuidim i shoqnisë, shoqni anonime, shoqni aksionare, shoqni koncensionare, shoqni tregtare, tregtar etj.; në fushën e së drejtës penale: amnisti, delikt, delikt kundër personalitetit shtetnuer, drejtësi penale, fajë kundër personalitetit të shtetit, falje e dënimit, falje pjese dënimi, faj politik, kontravencion, vjedhje e pasurisë së tjetrit etj.; në fushën e së drejtës proceduriale penale e civile: falje dënimi, falje pjese dënimi, gjana të sekuestrueme, Gjykatë ushtarake për delikte kundër personalitetit të shtetit, Gjykatë e Posaçme për Mbrojtjen e Atdheut, gjykim i fajit për arsye politike, Gjyq i Posaçëm i Shtetit, Gjykatë ushtarake tokësore, gjykim në mungesë, gjykim i drejtpërdrejtë, gjyqtar i klasit të parë, gjykatës i klasit të dytë, gjyqtar filluer, gjyqtar hetues, gjyqtar paqtues, konfiskim, masë disiplinore, masë penale, ndihmës gjyqtar paqëtues, ndihmës gjyqtar, ndihmës sekretar gjyqësor, nënsekretar gjyqësor, nëpunës gjyqësor, padi kambjalore, padi civile, pezullim i padisë penale, përgjegjësi penale, procedurë civile, pushtet përmbarues, sekretar gjyqi etj.

Në fondin e termave të rinj dallohen: a) terma që emërtojnë institucione karakteristike të ushtrimit të pushtetit shtetëror dhe organizimit e funksionimit të sistemit gjyqësor pas vendosjes së regjimit fashist: Drejtori e Përgjithshme për shtypin, propagandën e turizmin / ministri e kulturës popullore; Këshill i Epërm Korporativ Fashist, Këshill Kontrollues, Këshill i Lartë i Regjencës, Këshill Qëndruer i Ekonomisë Korporative, Këshill i shtetit, Kolegj arbitruer për rekuizime, Komisariat Civil për Ushtrimin e pushteteve civile, Komitet ekzekutiv i përkohshëm, Kryesi e këshillit të Ministrave, Kuvend Kombëtar, Mëkëmbësi e Përgjithshme Mbretnore, Gjindarmëri, Gjykatë ushtarake e luftës, Gjykatë e Fuqive t'Armatosuna t'Unjisueme etj.; b) terma që emërtojnë individë sipas funksioneve që ushtrojnë në struktura të ndryshme të organizimit të pushtetit shtetëror e gjyqësor: agjent gjyqësor, gjyqtar relator, gjyqtari, Këshilltar i Përhershëm, Këshilltar i posaçëm për çështje agrare të Tokave të lirueme, komisar i bashkisë, Komisar i Jashtëzakonshëm i bashkisë së kryeqytetit, Komisar i Naltë për Prefekturën, kuestor, konsulent i bashkisë, ministër sekretar shteti, ministër shteti, ndihmës kuestor, nënkuestor i policisë, nëpunës komunal, nënsekretar i shtetit, ofiqar gjyqësuer, prokuror i mbretit, regjent i prefekturës, sekretar federal etj.; c) terma që emërtojnë forma të organizimit shoqëror, politik e ekonomik: acjendë shtetnore, acjendë autonome, ent autonom, ent kombëtar, ent tregtar, ent industrial, fondatë, Këshill administrativ i fondatës, parti, rreth, sindikatë qeveritare etj.; ç) terma që emërtojnë akte ligjore e nënligjore që lidhen me veprimtarinë normative të organeve shtetërore të niveleve të ndryshme: dekret i Këshillit të Naltë, dekret

mëkambësuer etj.; **d)** terma që emërtojnë veprime që sjellin pasoja juridike: *dekretim mëkambësuer, tërheqje e dekretit të mëkëmbësit* etj.; **e)** terma që emërtojnë nocione të ndryshme të së drejtës: *gjobë pekuniare, komision për sekuestrim pasunie qytetarësh për aktivitet antikombëtar, komision për masa internimi, ligjë e luftës, legjislaturë e Këshillit të Epërm Fashist, masë internimi policuer, qendër gjyqsore* etj.

Zhvillimet politike në Shqipëri në periudhën e Luftës së Dytë Botërore ndikuan edhe në leksikun terminologjik të së drejtës ku u pasqyruan ndryshimet në formën dhe organizimin e shtetit në të gjitha nivelet. Pushtimi i vendit ndeshi në qëndresë të armatosur që më vonë u shndërrua në një luftë të organizuar me mbështetje të gjerë popullore. Në këtë periudhë u krijuan edhe formacione politike të ndryshme nga të cilat formacioni që pati rol drejtues në luftën kundër pushtuesit nazifashist shumë shpejt arriti të organizojë dhe të shtrijë strukturat e veta në mbarë vendin. Kjo bëri që, krahas institucioneve të shtetit, të ekzistonin struktura paralele që ushtronin veprimtarinë e tyre në vend e që shkallë - shkallë me marrjen e zonave të caktuara në zotërim, filluan të nxjerrin akte të ndryshme që kishin vlerë në territoret e çliruara. Leksiku terminologjik në vitet e luftës do të pasqyroste këtë realitet të ri politik që do të shërbente si embrion i shtetit të pasluftës. Prandaj në këtë leksik zënë vend të veçantë edhe një grup termash që emërtojnë organe, akte të ndryshme e vepra penale si: *Front nacionalçlirimtar, gjykatë partizane, Këshill i Përgjithshëm Nacionalçlirimtar, Këshill Antifashist Nacionalçlirimtar (përfaqëson trupin legjislativ dhe ekzekutiv), Këshill nacionalçlirimtar i qarkut, Kongres Antifashist Nacionalçlirimtar, Komitet Antifashist Nacionalçlirimtar (do të kishte atributet e qeverisë së përkohshme); Deklaratë e të drejtave të qytetarëve, Direktivë e Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar, Ligj për këshillat nacionalçlirimtare; krim kundërrevolucionar, vjedhje e pasurisë së luftës nacionalçlirimtare, krim i spekulimit, krim i tregtisë së ndaluar, kontrabandë* etj.

3. Aspekte të shfaqjes së sinonimisë në terminologjinë e së drejtës në vitet 1939–1944

I. Nga analiza e përmbajtjes kuptimore të termave të së drejtës në mjaft raste vihet re se për të njëjtin nocion përdoren dy a më shumë terma duke u bërë shkak për shfaqjen e dukurisë së sinonimisë¹. Nga analiza e terminologjisë së të drejtës, në periudhën e Luftës së Dytë Botërore, vihen re raste sinonimie midis termave shqip. Disa nga shkaqet e marrëdhënieve sinonimike midis termave shqip mund të shpjegohen me: **a.**

¹ Shiko M. T. Cabré *Terminologie : théorie, méthode et applications*, Les presses de l'Université d'Ottawa, Armand Colin, 1998

përdorimin e termave të ndryshëm në kohë për të njëjtin nocion² si: *e drejtë ndëshkimore e drejtë penale, gjyqtar gjykatës, pasuri e tundshme pasuri e luajtshme, pasuri e patundshme pasuri e paluajtshme, shkunorëzim çartje e martesës zgjidhje martesë* etj.; **b.** përdorimin e termave shqip për të emërtuar të njëjtin nocion nga anë të ndryshme si: *detyrime për ushqim pension ushqimor, nënministër nënsekretar shteti, e drejtë botore e drejtë publike, trup ministror qeveri, fuqi legjislative pushtet legjislativ, pranim trashëgimi pranim pasurie* (lanë prej të ndjerit) etj.; **c.** përdorimin e varianteve të të njëjtit term të cilat në letërsinë terminologjike konsiderohen, gjithashtu, si njësi sinonimike. *trashëgimi ligjore trashëgimi me ligj, i paragykuem i gjykuar më parë, delikt kundër personalitetit shtetnuer delikt kundër personalitetit të shtetit, dekret mëkambësuer dekret i mëkambësit* etj.; **ç.** përdorimin e formës së shkurtuar krahas formës së plotë të termit si: *ministër shteti ministër sekretar shteti*; **d.** përdorimin e termave të formuar nga e njëjta rrënjë për emërtimin e të njëjtit të shenjuar *gjyktor – gjykatës* etj.

Raste sinonimie përbëjnë përdorimi i termit të huaj krahas atij shqip si: (kontratë) *barrësore* (kontratë) *à titre onéreux, dëshmi e shtetësisë çertifikatë e shtetësisë, dhuntim concussion, enfi-teodhënësi konceduesi, faj delikt, kundërvajtje kontravencion, këshilltar konsulent, nënënim* (i trashigimtarit) *substitucion* (i trashigimtarit), *shamje diffamation*, (kontratë e) *shëgërties apprentissage, tejhedhje refuzim* (i kërkesës për falje) etj. Raste sinonimie, gjithashtu, krijohen nga përdorimi i njëkohshëm i dy termave të huaj për të njëjtin nocion si: *kompromeso arbitrazh, parlament asamble, refene cotisation, rikato – rançonnement* etj.

Nga pikëpamja e përkatësisë leksiko - gramatikore termat sinonimë organizohen në radhë apo vargje me dy ose shumë fjalë që mund të jenë: **a)** emra: *dëshmi çertifikatë, urdhën urdhënesë, gjyq gjykatë gjykatore, gjyqtar gjykatës, kuvend asamble parlament, këshilltar konsulent* etj.; **b)** mbiemra (*e drejtë*) *botore* (*e drejtë*) *publike*, (pasuni) *e paluajtshme* (pasuni) *e patundshme* etj.; **c)** folje: *tërheq revokoj, denuncoj kallxoj* etj.

Nga ana semantike dallohen terma sinonimë që emërtojnë: **a)** persona sipas funksionit që kanë a veprimeve që kryejnë dhe forma të organizimit të tyre p.sh. *gjykatës gjyqtar, këshilltar konsulent, nënministër nënsekretar shteti, ministër shteti ministër sekretar shteti, enfi-teodhënësi konceduesi, funksionar gjyqësuer ofiqar gjyqësuer, firmë tregtare shoqëni tregtare, rreth fondacion fondatë* etj.; **b)** dokumente p.sh. *dëshmi* (e shtetësisë) *çertifikatë* (e shtetësisë), *urdhën urdhënesë* etj.; **c)** institucione e organe të ndryshme shtetërore p.sh.: *Drejtori e Përgjithshme për shtypin,*

² Bëhet fjalë për terma që janë përdorur para fillimit të Luftës së Dytë Botërore dhe termave të rinj të përdorur gjatë viteve 1939-1944 për të emërtuar të njëjtin nocion.

propagandën e turizmin *Ministri e kulturës popullore, këshill ministruer qeveri* etj.; **ç**) nocione të ndryshme të së drejtës p.sh. *kujdestari mbi të miturit* *tutori, pyetje interpelancë, kundërvajtje kontravencion* etj.; **d**) veprime juridike p.sh. *denuncim kallxim, zgjidhje martesë shkunorëzim çartje e martesës, pranim trashëgimi pranim pasunie* (lanë prej të ndjerit), *shamje diffamation, tejhedhje refuzim* (i kërkesës për falje), *tërheqje* (e dekretit) *revokim* (i dekretit) etj.

Nga pikëpamja strukturore sinonimet mund të jenë:

1. terma - fjalë me terma - fjalë p.sh. *gjqy gjykatë gjykatore, gjyqtar gjykatës, këshilltar konsulent, kuvend asamble parlament* etj.

2. terma - togfjalësha me terma - togfjalësha p.sh. ndërmjet togfjalëshave të formuar nga *emër + mbiemër: fuqi legjislative pushtet legjislativ, Magjistraturë e zakonshme Magjistraturë e rendshme, e drejtë botore e drejtë publike* etj; ndërmjet togfjalëshave të formuar nga *emër + emër: zgjidhje martesë çartje e martesës, pranim trashëgimi pranim pasunie* (lanë prej të ndjerit), *dëshmi e shtetësisë çertifikatë e shtetësisë* etj.; ndërmjet togfjalëshave të formuar nga *emër + emër dhe emër + mbiemër: detyrime për ushqim pension ushqimor*; ndërmjet togfjalëshave me dy elemente të formuar nga *emër + emër dhe togfjalëshave me më shumë elemente të formuar nga emër + emër + emër, emër + emër + mbiemër: ministër shteti ministër sekretar shteti, gjykim për absencën gjykim për deklarimin si i pagjetur* etj.

3. terma - fjalë me terma - togfjalësha p.sh. ndërmjet termave - fjalë dhe togfjalëshave të thjeshtë *emër + emër: nënministër nënsekretar shteti, shkunorëzim çartje e martesës zgjidhje martesë, kontravencion kundërvajtje penale* etj.; ndërmjet termave - fjalë dhe togfjalëshave të thjeshtë *emër + mbiemër: qeveri këshill ministror* etj.

II. Sinonimia shfaqet edhe ndërmjet elementeve terminologjike të ndryshme në togfjalësha të ndryshëm. Elemente terminologjike në bashkëvajtje me të njëjtin term dalin sinonime në togfjalëshat e formuar duke përcaktuar, njëherësh, sinoniminë e këtyre togfjalëshave. P.sh. elementet terminologjike *e zakonshme dhe e rendshme* në bashkëvajtje me termin *magjistraturë* dalin sinonime dhe formojnë togfjalëshat sinonimë *magjistraturë e zakonshme dhe magjistraturë e rendshme*; elementet terminologjike *e patundshme dhe e paluejtshme* në bashkëvajtje me termin *pronë* dalin sinonime dhe formojnë togfjalëshat sinonimë *pronë e patundshme dhe pronë e paluejtshme*; elementet terminologjike *funksionar dhe ofiqar* në bashkëvajtje me termin *gjyqësuer* dalin sinonime dhe formojnë togfjalëshat sinonimë *funksionar gjyqësuer ofiqar gjyqësuer*; elementet terminologjike, *firmë dhe shoqëni* në bashkëvajtje me termin *tregtare* dalin sinonime dhe formojnë togfjalëshat sinonimë *firmë tregtare dhe shoqëni tregtare* etj.

III. Sinonimia në terminologji dallohet edhe në *elementet fjalëformuese*. P.sh. **a)** *ndërmjet ndajshitesave të huaja dhe ndajshitesave shqipe* p.sh. me parashtesën e huaj *in-* dhe parashtesën shqipe *ç-* formohen terma me kuptim të kundërt me temën prodhuese si: *injure* çnderim etj.; parashtesa e huaj *pre-* dhe parashtesa shqipe *para-* që ruan kuptimin e kohës edhe kur kalon nga ndajfolje në parafjalë e prej këtej në parashtesë³ p.sh. *parashkrim* vehtësimtar për *prescription* acquisitive etj. **b)** *ndërmjet ndajshitesave shqipe* p.sh. me prapashtesat *-im* dhe *-je* formohen emra foljorë veprimi si: *shamje, tërheqje* (e dekretit), *denuncim, dekretim, internim, konferim, konfiskim, promulgim* (i ligjës), *revokim* etj; me prapashtesat *-ës* dhe *-ues* formohen emra personash sipas veprimit që kryejnë, ose profesionit a punës që bëjnë si: *gjykatës, cedues, koncedues* etj. Prapashtesat dalin sinonime edhe me një nga elementet përbërëse të termit p.sh. *nënkuestor* *ndihmës* kuestor, *nënsekretar* gjyqësuer *ndihmës* sekretar gjyqësuer etj.

Përfundime

Në fund të kësaj analize mund të thuhet se në periudhën e Luftës së Dytë Botërore dukuria e sinonimisë në letërsinë juridike e në praktikë shfaqet si në rrafshin leksikor-semantik, ashtu edhe në rrafshin strukturor - fjalëformues. Depërtimi në masë i italianizmave, pas pushtimit të vendit, ndikoi në shtimin e rasteve të shfaqjes së dukurisë së sinonimisë në terminologjinë e së drejtës. Denduria e përdorimit të termave të ndryshëm për të njëjtin nocion jo vetëm është bërë pengesë për kristalizimin e njëkuptimisë së termit duke cënuar qartësinë e komunikimit special, por njëherësh është tregues i mungesës së një terminologjie të përpunuar e të njësuar

Literatura:

Cabré M. T., *Terminologie* : théorie, méthode et applications, Les presses de l'Université d'Ottawa, Armand Colin, 1998.

Duro, A., *Termi dhe fjala në gjuhën shqipe* (në rrafshin e formës dhe të përmbajtjes), Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 2009.

Fjalori i gjuhës së sotme shqipe. Tiranë, 1980 .

Fletore zyrtare, Nr 1 – 138, 1939.

Fletore zyrtare, Nr 1 – 103, 1940.

Fletore zyrtare, Nr 104 – 200, 1940.

Fletore zyrtare, Nr 1 – 197, 1941.

Fletore zyrtare, Nr 1 – 90, 1942.

Fletore zyrtare, Nr 91 – 156, 1942.

³ Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 1995, f.145.

Fletore zyrtare, Nr 1 – 110, 1943.

Fletore zyrtare, Nr 1 –71, 1944.

Kodi civil, 1928

Kodi penal, Vlorë, 1927.

Gramatikë e gjuhës shqipe I, Tiranë, 1995.

Meksi, V., *Për një terminologji të saktë juridike*, “Drejtësia popullore”, 1959, nr. 6.

Pasho, H., *“Vështrim mbi disa shfaqje të shumëkuptimësisë, të sinonimisë dhe të antonimisë në terminologjinë e ekonomisë në gjuhën shqipe”*, “Studime filologjike”, 1986/3.

Pasho, H., *Zhvillime kuptimore në terminologjinë e ekonomisë në gjuhën shqipe pas Çlirimit*, “Studime filologjike”, 1988, nr. 2.

Lafe, E., *Leksiku terminologjik si problem gjuhësor dhe kombëtar*, Konferencë shkencore: “Gjendja dhe zhvillimi i terminologjisë shqipe probleme e detyra”, Tiranë, 2009.

FAKTORËT E TREGTISË NDËRKOMBËTARE DHE MODELI I GRAVITETIT: RASTI I SHQIPËRISË¹

Visar Malaj* (Dr), Soana Teka (Dr), Ahmet Mançellari***
(Prof. Dr.)**

*University of Tirana, Faculty of Economy, Department of Economics. Mail: visarmalaj@feut.edu.al

**University of Tirana, Faculty of Economy, Department of Economics
Mail: soanateka@feut.edu.al

***University of Tirana, Faculty of Economy, Department of Economics
ahmetmancellari@feut.edu.al

Abstrakt

Variabli i varur në një ekuacion graviteti, një fluks individësh, asetesh apo mallrash, është një funksion i disa variablave të lidhura me origjinën, variablave të lidhur me destinacionin dhe variablave që përafrojnë distancën (gjeografike) midis vendeve. Modeli bazohet në teorinë e gravitetit të Newtonit për vlerësimin dhe parashikimin e flukseve tregtare ndërkombëtare. Qëllim kryesor i këtij artikulli është formulimi dhe vlerësimi i disa modeleve të ndryshme graviteti për flukset tregtare bilaterale midis Shqipërisë dhe partnerëve të saj kryesorë. Në këtë punim zbatohet disa metoda të njohura të vlerësimit, duke marrë në konsideratë tre variabla të varur: flukset tregtare, importet dhe eksportet. Programi kompjuterik i përdorur është RGui 2.14.1, një paketë efektive për analizë përshkruese, inferenciale dhe optimizim.

Fjalë kyçe: modeli i gravitetit për tregtinë, rajoni i Ballkanit, Shqipëria.

Abstract

The dependent variable in a gravity equation, a flow of humans, assets or goods, is a function of some variables associated with the origin, variables associated with the destination and other variables that approximate the (geographical) distance between countries. The model is based on Newton's gravity theory for estimating and predicting international trade flows. The main objective of this paper is to formulate and estimate some different gravity models of bilateral

¹ Falenderojmë për sugjerimet e vlefshme, në funksion të përmirësimit të mëtejshëm të këtij punimi, pjesëmarrësit e "Konferencës I Kombëtare për Financën", mbajtur në Tiranë më 5 dhjetor 2014.

trade between Albania and its major partners. In this work we apply some well-known estimation methods, considering three different dependent variables: trade flows, imports and exports. We used RGui 2.14.1 for descriptive analyses of data and optimization, an effective and innovative language and environment.

Keywords: gravity model of trade, Balkans, Albania.

Hyrje

Modeli i gravitetit përdoret për vlerësimin e flukseve tregtare bilaterale me anë të disa variablave shpjegues. Modeli është analog me ligjin e gravitetit të Newtonit në mekanikë: tërheqja gravitacionale ndërmjet dy trupave është përpjesëtimore me produktin e masave trupore, pjesëtuar me katrorin e distancës midis qendrave respektive të gravitetit. Zakonisht koeficienti i përcaktueshmërisë (R^2) i vlerësimeve ekonometrike të modelit të gravitetit variojnë nga 65% në 95%, përqindje këto të larta të shpjegimit të flukseve tregtare bilaterale. Kjo fuqi e madhe shpjeguese i ka bindur studiuesit e kësaj fushe në përdorimin e gjerë të modelit të gravitetit.

Këto veti të modelit të gravitetit, përfshirë dhe vlerat shumë të arsyeshme të parametrave të vlerësuar, janë tregues të qartë të një ligji ekonomik veprues. Ekuacioni më i përdorur është ai klasik, i cili përfshin masat ekonomike të vlerësuar me anë të GDP-ve përkatëse, si dhe distancën midis dy vendeve. Variablat e tjerë që mund të merren në konsideratë janë të shumtë, pavarësisht performancës së mirë të ekuacionit bazë. Këto variabla mund të jenë thjesht forma të modifikuara të variablave të parë, si për shembull GDP-të për frymë, por edhe variabla të rinj që përmirësojnë modelin. Përmendim këtu gjuhën e përbashkët dhe lidhjet koloniale, efektin e kufirit midis dy vendeve, marrëveshjet e tregtisë së lirë, etj.

Objektiv kryesor i këtij punimi është përdorimi i disa metodave të ndryshme vlerësimi të modeleve të ndryshëm të gravitetit për flukset tregtare të Shqipërisë me disa prej partnerëve tregtarë kryesorë. Punimi mbyllet me disa përfundime të nxjerra drejtpërdrejt nga analiza empirike si dhe me disa sugjerime mbi përdorimin e metodave të ndryshme për analizën e flukseve tregtare bilaterale, me fokus vendet në tranzicion.

2. Materiali dhe metodat

Ekuacioni i gravitetit për përshkrimin e flukseve tregtare u shfaq fillimisht në literaturën empirike pa shumë përpjekje për ta mbështetur atë nga ana teorike. Kjo mund të justifikohet shumë mirë nga logjika e thjeshtë që karakterizon këtë ekuacion. Analogjia në rastin e tregtisë është si vijon: Fluksi tregtar midis dy vendeve është përpjesëtimor me produktin e masës ekonomike të secilit vend, kryesisht e vlerësuar me anë të GDP-së, secila e ngritur në fuqi të disa

eksponentëve që duhet të gjenden, pjesëtuar me distancën midis qendrave ekonomike të vendeve, kryesisht merren kryeqytetet, të ngritura përsëri në fuqi të eksponentëve përkatës. Një model i ndërtuar në këtë mënyrë është modeli bazë i gravitetit.

$$F_{ij} = \tau \frac{GDP_i^{S_1} * GDP_j^{S_2}}{Dist_{ij}^{S_3}},$$

ku F_{ij} është vlera e fluksit tregtar midis vendeve i dhe j , GDP_i dhe GDP_j janë të ardhurat kombëtare të vendeve i dhe j ; $Dist_{ij}$ është distanca gjeografike midis qendrave ekonomike të gravitetit midis vendeve i dhe j . α dhe β_i për $i=1, 2, 3$, janë parametrat respektivë që duhen vlerësuar. Ky model, zakonisht konsiderohet në formë logaritmike:

$$\ln(F_{ij}) = \tau + S_1 \ln(GDP_i) + S_2 \ln(GDP_j) + S_3 \ln(Dist_{ij}) + u_{ij}$$

ku me u_{ij} kemi shënuar termin e gabimit, i cili supozohet të ketë shpërndarje normale me mesatare zero dhe variancë konstante. Variablat shpjegues që mund të futen në model janë të ndryshëm si për shembull, sipërfaqja e vendit, kurset e këmbimit, kostot e transportit, tarifatat doganore, indekse të infrastrukturës, përfshirja apo jo në një marrëveshje të caktuar tregtare etj.

Tinbergen (1962) dhe Poyhonen (1963) zhvilluan studimet e para ekonometrike të flukseve tregtare bazuar në modelin e gravitetit, për të cilin ata dhanë vetëm shpjegimin logjik. Linnemann (1966) shtoi numrin e variablave dhe shkoi më tej me suportin teorik të modelit duke u bazuar në të ashtuquajturin sistemi i ekuilibrit të përgjithshëm Walrasian². Leamer dhe Stern (1970) ndoqën rrugën e Savage dhe Deutsch (1960) në përcaktimin e një modeli probabilitar shkëmbimesh. Leamer (1974) përdori njëkohësisht ekuacionin e gravitetit dhe modelin Heckscher–Ohlin për justifikimin e variablave shpjegues në analizën regresive të flukseve tregtare, por ai nuk i integroi të dy metodat teorikisht. Këto punime u ndoqën nga tentativa të tjera më formale për derivimin e ekuacionit të gravitetit nga modele të bazuara në diferencimin e produktit. Anderson (1979) ishte i pari që bëri këtë gjë, fillimisht duke marrë në konsideratë preferenca Cobb-Douglas dhe më pas, preferenca me *elasticitet konstant të zëvendësimit* (shkurtimi në anglisht: CES). Bergstrand (1985) përdor ashtu si Andersoni, preferencat CES në produktet e diferencuara

² Kjo teori është zhvilluar në vitet 1870, veçanërisht në punimin e ekonomistit francez Leon Walras në vitin 1874 (*Eléments d'économie politique pure*). Teoria e ekuilibrit të përgjithshëm i konsideron çmimet në periudhën afatgjatë si çmime ekuilibri, ndërsa çmimet aktuale si devijime nga ekuilibri.

për derivimin e një ekuacioni në formë të reduktuar për tregtinë dypalëshe, duke futur këtu edhe indekset e çmimeve.

Ekuacioni i gravitetit vërtetohet shumë thjesht duke konsideruar pikënisjen e teorive të reja mbi tregtinë deri tek punimet empirike më të fundit mbi modelet shpjegues të flukseve bilaterale. Helpman (1987) përdori lidhjen midis modelit të gravitetit dhe atij të konkurrencës monopolistike si bazë për një test empirik. Deardoff (1984) vuri në dukje parregullsi të ndryshme empirike në ekuacionin e gravitetit dhe i quajti ato paradoksale dhe jo konsistente me modelin Heckscher–Ohlin. Anderson dhe Van Wincoop (2003) kontribuan në krijimin e themelit teorik të modelit, duke treguar që ekuacioni i gravitetit mund të derivohet nga disa modele të ndryshme të tregtisë ndërkombëtare. Vitet e fundit është zhvilluar gjithashtu një klasë e re modelesh graviteti, të bazuara në ekuacione dinamike, në vend të ekuacioneve tradicionale statike (Yotov dhe Olivero, 2012; Campbell, 2013), ku fluksi tregtar varet, midis të tjerash, nga përmasa e secilit vend, kostot aktuale dhe kostot e mëparshme të tregtisë.

3. Rezultatet

Ekuacioni gravitetit i vlerësuar në këtë punim ka si variabël të varur logaritmin natyral të flukseve tregtare bilaterale midis Shqipërisë dhe vendeve partnere (tabela 1). Periudha e zgjedhur i përket viteve 1993-2012. Të dhënat janë vjetore dhe të shprehura në milion dollarë. Testojmë si variabla të varur importet, eksportet, si dhe fluksin total, të cilat jepen si shuma e eksporteve me importet.

Vendet partnere	
1	<i>Austria</i>
2	<i>Belgjika</i>
3	<i>Bosnje Hercegovina</i>
4	<i>Bullgaria</i>
5	<i>Kroacia</i>
6	<i>Republika Çeke</i>
7	<i>Finlanda</i>
8	<i>Franca</i>
9	<i>Gjermania</i>
10	<i>Greqia</i>
11	<i>Hungaria</i>
12	<i>Italia</i>
13	<i>Maqedonia</i>
14	<i>Polonia</i>
15	<i>Rumania</i>

16	<i>Serbia dhe Mali i Zi</i>
17	<i>Sllovenia</i>
18	<i>Spanja</i>
19	<i>Turqia</i>

Tabela 1. Lista e vendeve në modelin e gravitetit

Pra, modeli i gravitetit do të ketë formën:

$$\begin{aligned} \log(F_{ijt}) = & S_0 + S_1 \log(GDP_{it}) + S_2 \log(GDP_{jt}) + S_3 \log(GDPcap_{it}) \\ & + S_4 \log(GDPcap_{jt}) + S_5 \log(POP_{it}) + S_6 \log(POP_{jt}) + S_7 BORDER_{ij} \\ & + S_8 \log(DIST_{ij}) + S_9 GATT_{it} + S_{10} GATT_{jt} + S_{11} RTA_{ijt} + u_{ijt} \end{aligned} \quad (3.1)$$

ku, i tregon Shqipërinë, j tregon vendin partner, t tregon kohën e shprehur në vite, F është fluksi tregtar bilateral midis Shqipërisë dhe vendit partner, GDP është Produkti i Brendshëm Bruto, $GDPcap$ është Produkti i Brendshëm Bruto për frymë, POP është numri i popullsisë, $BORDER$ është një variabël dummy që merr vlerën një nëse Shqipëria dhe shteti partner kanë një kufi të përbashkët, $DIST$ tregon distancën midis Shqipërisë dhe vendit partner, $GATT$ është një variabël dummy që merr vlerën 1 nëse vendi është i anëtarësuar në Marrëveshjen e Përgjithshme mbi Tarifatat dhe Tregtinë³, RTA është një variabël dummy që merr vlerën 1 nëse vendet kanë nënshkruar me njëri tjetrin një marrëveshje rajonale të tregtisë së lirë. Modeli përfshin një term gabimi që supozojmë (dhe më pas kontrollojmë) me shpërndarje normale me mesatare zero dhe variancë të njohur konstante.

GDP-të dhe numri i popullsisë janë marrë nga *Indekset e Zhvillimit Botëror (WDI)*, llogaritur nga Banka Botërore. Disa informacione shtesë janë marrë nga *Madison* (<http://www.ggd.net>) dhe nga Barbieri në projektin '*Correlates of War*' (<http://www.correlatesofwar.org/>). Marrëveshjet rajonale të tregtisë së lirë (RTA-të) janë ndërtuar në bazë të *Baier dhe Bergstrand* dhe nga *siti i Organizatës Botërore së Tregtisë*. Anëtarësimet e vendeve të ndryshme në Marrëveshjen e Përgjithshme mbi Tarifatat dhe Tregtinë janë marrë nga *siti i Organizatës së Tregtisë Botërore*. Distancat bilaterale janë marrë nga *siti i CEPIT* (*CEPII distance database*). Flukset tregtare, si eksportet, ashtu dhe importet, janë marrë nga *siti zyrtar i Bankës së Shqipërisë* (www.bankofalbania.org).

Ekuacioni 3.1, i paraqitur më sipër, është vetëm forma e përgjithshme e ekuacionit që testojmë. Dy teknikat që zbatojmë dhe krahasojmë janë karakteristike për studimin e të dhënave Panel. Të dhënat Panel konsistojnë në vëzhgime të përsëritura për të njëjtat njësi, në rastin tonë, shtetet partnere. Vëzhgimet ndodhin në çaste të ndryshme kohore, vjetore për të dhënat që ne analizojmë. Periudha e vëzhgimit është 19 vjeçare, nga viti 1993 në vitin 2012.

³ Organizata Botërore e Tregtisë (WTO) zëvendësoi në 1 janar 1995 Marrëveshjen e Përgjithshme mbi Tarifatat dhe Tregtinë (GATT), e vendosur në vitin 1948.

'Paneli' ynë është i balancuar, që do të thotë se periudha kohore është e njëjtë për çdo shtet. Një *model i efekteve fikse* (FE) për studimin e të dhënave Panel, konsideron variablat shpjegues si jo rastësorë. Ky fakt është në kontrast me *modelin e efekteve 'random'* (RE), i cili i konsideron variablat shpjegues si të përfutur nga ngjarje rastësore. Në analizën e të dhënave Panel, termi 'vlerësues i efekteve fikse' (ose '*within estimator*') përdoret për evidentimin e vlerësuesve të parametrave të modelit të regresionit. Një model i tipit FE përdoret për identifikimin e impaktit të variablave, të cilat ndryshojnë me kalimin e kohës. Kjo teknikë eksploron lidhjen midis variablave të pavarur dhe '*outputit*' brenda të njëjtës njësi (vendit partner). Çdo vend partner ka karakteristikat e tij individuale që ndoshta, mund të ndikojnë te variablat e pavarur (për shembull, sistemi politik i një vendi të veçantë mund të ketë efekt mbi GDP-në).

Në këtë pjesë të analizës, do të vlerësojmë flukset tregtare të Shqipërisë me partnerët e saj me anë të metodës së efekteve fikse (FE). Në tabelën 2, kemi rezultatet e regresionit me anë të metodës FE. Siç shihet nga tabela, variablat që nuk ndryshojnë brenda për brenda vendit (*border, distanca*) nuk përfshihen në këtë vlerësim. Vërejmë se variablat e GDP-së për frymë janë të gjithë të vlefshme statistikisht, me përjashtim të një rasti: logaritmi i GDP-së për frymë i Shqipërisë në ekuacionin e eksporteve ka një alfa të vëzhguar rreth 53%. Një problem të tillë hasin dhe Blazevski dhe Petreski (2010), të cilët analizojnë performancën e eksporteve të Maqedonisë për 10 vitet e fundit. Koeficienti i tyre i logaritmit të GDP-së për frymë të Maqedonisë është -0,495 dhe i pavlefshëm statistikisht. Kjo tregon se ky variabël nuk shpjegon në asnjë nga këto raste eksportet. Koeficientët e tjerë janë të ngjashëm, në veçanti për variablat RTA dhe GDP-në për frymë të vendit partner. Blazevski dhe Petreski (2010) pohojnë se modeli i efekteve rastësore (RE) është më i përshtatshëm në këtë rast.

<i>Variabli i pavarur</i>	<i>Variabli i varur: Flukset tregtare</i>	<i>Variabli i varur: Eksportet</i>	<i>Variabli i varur: Importet</i>
<i>ln(GDPcap)Al</i>	0,365(0,0055)	-0,1042(0,53)	0,549(0)
<i>ln(GDPcap)j</i>	0,934(0)	1,654(0)	0,754(0)
<i>GattAl</i>	0,316(0,021)	-0,33(0,125)	0,4251(0,003)
<i>Gattj</i>	-0,747(0,13)	-1,82(0,11)	-0,658(0,09)
<i>RTA</i>	0,143(0,237)	0,82(0)	0,144(0,3)
<i>Adjusted R katror</i>	0,6654	0,4831	0,6024
<i>Alpha e testit F</i>	0	0	0

Tabela 2. Koeficientët e modelit tonë të gravitetit të vlerësuar me anë të metodës Fixed Effects. Në kllapa: niveli i vëzhguar i alfës (kufiri i refuzimit 5-10%). Kolona e dytë: modeli me variabël të varur 'flukset tregtare' (importe + eksporte). Kolona e tretë: modeli me variabël të varur 'eksportet'. Kolona e katërt: modeli me variabël të varur 'importet'. Rreshti i shtatë: vlera e R katrorit 'adjusted'. Rreshti i fundit: Alfa e vëzhguar për testin F.

Probleme me vlefshmërinë statistikore vërejmë në disa raste lidhur me anëtarësimin në Marrëveshjen e Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë, si dhe për variablin dummy të RTA-së. R katrori 'adjusted' paraqitet relativisht i lartë, përjashtim bën ekuacioni i eksporteve, i cili ka një koeficient R^2 nën mesataren, me rreth 48%. Në tabelën 3, kemi rezultatet e vlerësimit RE për tre ekuacionet tona. Vërejmë se ekuacionet në përgjithësi, i përgjigjen teorisë përkatëse, sidomos në rastin e modelimit të flukseve tregtare. Viojmë të kemi të pavlefshëm statistikisht variablin e GDP-së për frymë të Shqipërisë në ekuacionin e eksporteve. Variabli i distancës, si në rastet paraardhëse, ndikon negativisht në shkëmbimet bilaterale. Koeficientët përkatës marrin vlera relativisht të larta dhe janë gjithmonë të vlefshëm statistikisht, gjë që tregon se distanca vijon të jetë një pengesë domethënëse dhe se duhen bërë përpjekje për përmirësimin e infrastrukturës rrugore, në mënyrë që të ulen kostot e transportit. Këto vlera përputhen me Rault, R. Sova dhe A. Sova (2007) si dhe me Xhepa dhe Agolli (2003).

Variabli i pavarur	Variabli i varur: Flukset tregtare	Variabli i varur: Eksportet	Variabli i varur: Importet
Termi konstant	12,458 (0)	18,451 (0)	17,248 (0)
ln(GDPcap)Al	0,3978 (0)	-0,159 (0,486)	0,521 (0,0066)
ln(GDPcap)j	1,12(0)	1,831(0)	0,923(0)
Border	0,5431(0,745)	1,282(0,188)	0,447(0,525)
ln(Dist)	-1,109(0,025)	-1,966(0,0048)	-1,081(0,0364)
GattAl	0,299(0,0276)	-0,385(0,054)	0,429(0,012)
Gattj	-0,456(0,038)	-1,492(0,072)	-0,325(0,185)
RTA	0,089(0,421)	0,7672(0)	0,072(0,655)
Adjusted R katror	0,681	0,483	0,629
Alpha e testit F	0	0	0

Tabela 3. Koeficientët e modelit tonë të gravitetit të vlerësuar me anë të metodës Random Effects. Në kllapa: niveli i vëzhguar i alfës (kufiri i refuzimit 5-10%). Kolona e dytë: modeli me variabël të varur 'flukset tregtare' (importe + eksporte). Kolona e tretë: modeli me variabël të varur 'eksportet'. Kolona e katërt: modeli me variabël të varur 'importet'. Rreshti i gjashtë: vlera e R katrorit 'adjusted'. Rreshti i fundit: Alfa e vëzhguar për testin F.

Edhe në këtë rast, rikonfirmohet efektin domethënës (pozitiv) i kufirit të përbashkët midis dy vendeve mbi flukset tregtare. Disi i paqartë mbetet efekti i variablave GATT të lidhura me anëtarësimin në OBT. Duket se ky fakt nuk ka ndikuar statistikisht në rritjen e shkëmbimeve me vendet partnere. Efekti i marrëveshjes rajonale të tregtisë së lirë është më evident në rastin e eksporteve, ndërsa në dy rastet e tjerë nuk është i vlefshëm statistikisht.

4. Përfundime

Synimi kryesor i këtij punimi është përshkrimi dhe më pas zbatimi i modelit të gravitetit në flukset tregtare të Shqipërisë me 19 partnerë të saj kryesorë. Një vëmendje e veçantë në këtë analizë i kushtohet dy metodave të ndryshme të vlerësimit të modelit: RE (Random Effects) dhe FE (Fixed Effects). Variablat e varur të marrë në konsideratë janë tre: flukset tregtare, importet dhe eksportet. Programi kompjuterik i përdorur për paraqitjen grafike të të dhënave dhe llogaritjen e koeficientëve të modeleve është RGui 2.14.1. Ky program, siç vërejmë nga grafikët e ndërtuar dhe tabelat e rezultateve është shumë efektiv në përpunimin e këtyre të dhënave (Panel Data).

Metodat e zbatuara janë tipike për analizën e të dhënave Panel, vëzhgime të përsëritura për të njëjtat njësi (shtete, në rastin tonë). Ne kontrollojmë fillimisht me anë të grafikëve, më pas me anë të modelit FE, heterogjenitetin e fshehur, i cili supozohet të jetë i pavarur nga koha e vëzhgimit dhe i korreluar me variablat e pavarur. Këtu hasim probleme në rastin e ekuacionit të eksporteve, ku parametri i masës ekonomike të Shqipërisë është i pavlefshëm statistikisht. Parametrat e tjerë janë në përgjithësi të vlefshëm dhe koeficienti përcaktueshmërie të kënaqshëm. Metoda e dytë, me anë të së cilës vlerësojmë ekuacionin tonë të gravitetit është ajo RE. Në vend që të mendojmë se çdo partner tregtar ka ecurinë e tij sistematike (si në rastin e metodës FE), ne supozojmë se secila nga këto ecuri është rezultat i një shpërndarje rastësore normale. Një avantazh i këtij supozimi është se kemi përsëri në model variablat shpjegues, të cilët nuk ndryshojnë me kohën brenda për brenda vendit partner. Vërejmë nga tabela e rezultateve se kemi disa probleme me vlefshmërinë e koeficientëve, në rastin e ekuacionit të eksporteve. R katrori përkatës është gjithashtu, disi më i ulët se zakonisht. Ekuacionet e tjerë (flukset tregtare dhe importet) shpjegojnë më mirë variancën e variablit të varur.

Përpjekje shtesë duhen bërë për vlerësimin e metodave të modelimit, duke marrë në konsideratë kampionë të ndryshëm dhe më pas duke krahasuar rezultatet përkatëse. Përcaktimi, unifikimi dhe vlerësimi i metodës analitike është hapi i parë dhe kryesor për arritjen e rezultateve të besueshme, të vlefshëm për orientimin e politikave që duhet të ndjekin institucionet përgjegjëse.

Literatura

- Anderson, J. (1979): A theoretical foundation of the gravity model. *American Economic Review* 69(1), 106-16.
- Anderson, J.E., Van Wincoop, E. (2003): Gravity with gravitas: a solution to the border puzzle. *American Economic Review* vol 1.
- Bergstrand, H. J. (1985): The gravity equation in international trade: some microeconomic foundations and empirical evidence. *The Review of Economics and Statistics*, Vol. 67, No. 3 pp. 474- 481.

- Blazevski, P., Petreski, T. (2010): Trends in the foreign trade of Macedonia in 2010: annual report on foreign trade of Macedonia. Skopje, University American College Skopje.
- Campbell, A. (2013): Relative prices, hysteresis, and the decline of american manufacturing. Working Paper no.3 February.
- Deardorff, A. V. (1998): Fragmentation in simple trade models. Discussion Paper No. 422, Research Seminar in International Economics, University of Michigan, January 7.
- Helpman, E. (1987): Imperfect competition and international trade: evidence from fourteen industrial countries. *Journal of the Japanese and International Economies I*: 62-81.
- Hummels, D., Levinsohn, J. (1995): Monopolistic competition and international trade: reconsidering the evidence. *Quarterly Journal of Economics*, 110, 3:799-36.
- Leamer, E. (1974): The commodity composition of international trade in manufactures: an empirical analysis. *Oxford Economic Papers*, 26. 350-374.
- Leamer, E., Stern, M. (1970): *Quantitative International Economics*. Allyn and Bacon Edition.
- Linneman, H. (1966): *An econometric study of international trade flows*. North Holland Publishing Company, Amsterdam.
- Olivero, M. P., Yoto, Y. (2012): Dynamic gravity: endogenous country size and asset accumulation. *Canadian Journal of Economics* 45 (1): 64-92.
- Xhepa, S., Agolli, M. (2003): Albania's foreign trade through a gravity approach, ACIT.
- Tinbergen, J. (1962): *Shaping the world economy*. Twentieth Century Fund, New York, NY (1962).
- Poyhonen, P. (1963): A tentative model for the volume of trade between countries. *Weltwirtschaftliches Archiv* 90, 93-100.
- Rault, C., Sova, A., Sova, R. (2007): The endogeneity of association agreements and their impact on trade for eastern countries: empirical evidence for Romania. William Davidson Institute Working Paper No. 868.
- Savage, I. R., Deutsch, K. W. (1960): A statistical model of the gross analysis of transaction flows. *Econometrica*, July.